


391
9:55

ANDROMAQI GJERGJI

VESHJET
SHQIPTARE
NE SHEKUJ





391
9.55

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË

INSTITUTI I KULTURËS POPULLORE

Dr. ANDROMAQI GJERGJI

VESHJET SHQIPTARE NË SHEKUJ

Origjina Tipologjia Zhvillimi



Tiranë, 1988

P Ë R M B A J T J A

HYRJE	(f. 7-14)
-------------	-----------

KREU I PARË

VËSHTRIM HISTORIK MBI VESHJET NË SHQIPËRI

1. Veshja në shekujt XIV-XV!	(f. 15-26)
a) Lloje tekstilësh të përdorura për veshjet	(f. 15-17)
b) Forma veshjesh, nga fustanella e vitit 1335 tek «mëngoret e modës shqiptare»	(f. 17-26)
2. Veshja në shekujt XVII-XVIII	(f. 26-42)
a) Veshjet shqiptare përballë ndikimit oriental	(f. 26-30)
b) Zejtaria vendase për veshjet popullore në shek. XVIII: Luksi oriental i aristokracisë qytetare	(f. 30-33)
c) Dëshmi mbi veshjet popullore në afreska, gravura e dokumente arkivore të shek. XVIII	(f. 33-39)
ç) Dorëshkrimi i Kieutit për veshjet e arbëreshëve të Italisë	(f. 39)
d) Veshje luftëtarësh shqiptarë në vepra udhëtarësh të huaj	(f. 39-41)
dh) Prirje të zhvillimit të veshjeve popullore në shek. XVII-XVIII	(f. 41-42)
3. Veshja në shekujt XIX-XX	(f. 42-67)
a) Penetrimi i mëtejshëm i prodhimit zejtar në veshjet fshatare:	(f. 42-44)
b) Apogjeu i kostumit me fustanellë dhe të tjera veshje bu rrash në shek. XIX	(f. 44-52)
c) Veshje të shqiptarëve kryengritës nga Lidhja e Prizrenit në Shpalljen e Pavarësisë (1878-1912)	(f. 52-57)

- c) Veshje të arbëreshëve të Greqisë (f. 58-61)
 d) Burimet vendase nga gjysma e dytë e shek. XIX e këtej. (f. 62-65)
 dh) Pak fjalë mbi evolucionin e veshjeve në fshat e në qytet nga 1912 deri në prag të Çlirimit (1944) (f. 65-67)

KREU I DYTË

VARIACIONE TË KOSTUMEVE POPULLORE SIMBAS FUNKSIONEVE QË KRYEJNË

- I. Veshja e përditshme ose për punë (f. 69-76)
 a) Pjesë të posaçme veshjesh për punë dhe përshtatje në të veshur. (f. 70-73)
 b) Përshtatje të veshjeve simbas stinës (f. 74-76)
- II. Dallime të veshjes sipas moshës, seksit e gjendjes civile (f. 76)
 a) Ndryshime në veshje sipas moshës dhe seksit të bartësit. (f. 77-81)
 b) Ndryshime në veshje sipas gjendjes civile të bartësit (f. 81-83)
- III. Veshjet e mira ose «për të dalë» (f. 83)
 a) Kostumi i martesës (f. 84-88)
 b) Veshja e dasmorëve (f. 88-89)
 c) Veshje të përzishme (veshje për të marrë pjesë në ceremoni të përmortshme, veshje zije, veshja e të vdekurit) (f. 89-91)
- IV. Dallime në veshje sipas përkatësisë social-klasore të bartësit. (f. 92-100)
 a) Diferencime sipas klasave dhe shtresave të ndryshme shoqërore (f. 92-94)
 b) Dallime sipas përkatësisë fetare (f. 94-96)
 c) Veshja e kaçakëve dhe e luftëtarëve të lirisë (f. 96-98)
 ç) Veshja e gruas që e kishte burrin larg shtëpisë (f. 98-99)
 d) Shenja dalluese në veshje sipas detyrës e profesionit (f. 90-100)
- V. Shprehje të funksionit etnik të veshjeve popullore (f. 100-103)
 VI. Aspekti estetik i veshjeve popullore (f. 103-105)

KREU I TRETË

KLASIFIKIMI I VESHJEVE POPULLORE SHQIPTARE (f. 107)

- Veshje për burra (f. 110)
 I. Veshja me fustanellë (f. 110-113)
 II. Veshja me këmishë të gjatë e xhoke (cibun, dollamë) (f. 113-115)
 III. Veshja me tirq (f. 115-119)
 IV. Veshja me brekushe (f. 119-121)
 V. Veshja me poture (f. 121-127)
- Veshje për gra (f. 127)
 I. Veshja me xhubletë (f. 127-130)
 II. Veshjet me këmishë të gjatë e një përparje (f. 131-137)
 III. Veshjet me këmishë të gjatë e dy futa (f. 137-141)
 IV. Veshjet me mbështjellëse (f. 141-143)
 V. Veshja me brekushe (f. 143-144)

KREU I KATËRT

SHQYRTIM HISTORIK-KRAHASUES I DISA ELEMENTEVE TË VESHJEVE
POPULLORE (f. 149)

1. Xhubleta	(f. 150-155)
2. Brezat	(f. 155-161)
3. Futat (përparjet dhe futëprapësit)	(f. 161-169)
4. Mbështjellëset	(f. 169-171)
5. «Fustani» a fustanella	(f. 171-175)
6. Linja ose këmisha	(f. 175-187)
7. Xhokat (jakucet a xhurditë dhe xhokat me shtat të drejtë)	(f. 187-197)
8. Strukat, tallaganet e veshje të tjera që hidhen supeve.	(f. 197-202)
9. Llabanet e kaculitat	(f. 202-205)
10. Mbulesat e kokës dhe frizura	(f. 205-216)
11. Stolitë dhe aksesore të tjerë të veshjes	(f. 216-227)
12. Opingat e të tjera mbathje për këmbët	(f. 227-230)
— Përmbyllje	(f. 230)
— Summary	(f. 233)
— Fjalor	(f. 245-274)
— Tregues i emrave të njerëzve e të vendeve	(f. 275)
— Bibliografi	(f. 281)

Hyrje

Specifika etnike e një populli përcaktohet nga një varg manifestimesh të kulturës materiale dhe shpirtërore të tij. Veshja, nga roli i saj i dobishëm dhe funksioni që kryen, përbën një nga elementet më të rëndësishme të kulturës materiale. E parë nga elementet e zbukurimit që ajo përmban, nga format artistike që merr, nga roli dekorativ që luan, ajo përbën edhe një element të çmuar estetik, duke u integruar kështu në kulturën shpirtërore si pjesë përbërëse e artit popullor. Struktura morfologjike e veshjes, karakteri i veçantë i elementëve të zbukurimit etj., pasqyrojnë specifikën kombëtare të çdo populli në këtë fushë. Pra, nga çdo pikëpamje që ta shohim, veshja mbetet një nga manifestimet më të fuqishme të kulturës popullore dhe për këtë arsye studimi i saj kontribuon për të ndriçuar disa aspekte me interes në historinë e çdo populli.

Në gjendjen e studimeve tona në këtë fushë detyrë e dorës së parë ishte njohja e hollësishme e të dhënave dokumentare që disponojmë mbi veshjet popullore, qoftë ky material etnografik autentik që ruhet ende në kujtesën e popullit dhe në mjediset fshatare të shumë zonave të vendit, qofshin burimet e shumëllojshme muzeale, arkivale, ikonografike etj. Kjo vepër që po paraqesim është para së gjithash, një përpjekje për një njohje sa më të thellë të materialeve të shumëllojshme ekzistuese mbi veshjet popullore. Ajo është një kontribut i frymëzuar nga ajo porosi e shokut E. Hoxha që thotë: «... Të luftohet me këmbëngulje për të studiuar karakteristikat kombëtare në drejtime të ndryshme të kulturës dhe të arteve tona dhe për zbatimin e tyre në mënyrë krijuese në veprat e sotme të artit dhe në punën kulturore artistike me masat».¹

1) E. Hoxha, *Populli ynë ka trashëguar një kulturë të madhe me tradita përparimtare*, «Vepra», vëll. 21, Tiranë, 1976, f. 369.

1. — Veshjet e popullit janë zhvilluar e kanë ndryshuar vazhdimisht nga një epokë në tjetrën. Ky zhvillim është bërë jo vetëm në varësi të nënshtresës bazë nga e cila kanë zënë fill, por edhe në varësi të kushteve konkrete historike, ekonomike dhe shoqërore në të cilat ka jetuar dhe punuar populli shqiptar. Për këtë arsye ato janë një burim konkret dhe mjaft i pasur që na ndihmon të rindërtojmë aspekte të rëndësishme të mënyrës së jetesës të masave të gjera popullore në periudha të ndryshme historike. Nëpërmjet materialeve të përdorura për veshjet, mund të njohim konkretisht se ç'prodhonin masat e gjera brenda ekonomisë shtëpiake, me ç'vegla pune e prodhonin e ç'siguronin në treg. Nëpërmjet prerjes e zbukurimeve kuptojmë si është zhvilluar shija për të bukurën tek populli ynë, cilat stoli të trupit e mënyra zbukurimi parapëlqente ai. Larmia e madhe e varianteve të shumta krahinore na jep të kuptojmë jo vetëm aftësitë krijuese të masave fshatare, por edhe se deri në ç'masë ruhej izolimi krahinor, kurse ekzistenca e tipave të përbashkët të veshjes për zona të gjera tregon se në ç'shikallë ishte arritur afrimi ndërkrahinor e kombëtar në këtë fushë. Në veshje kanë gjetur gjithashtu pasqyrim të dukshëm dallimet klasore, diferencimi midis shtresave të ndryshme shoqërore, dallimet fetare etj., që dëshmojnë për një shoqëri të përbërë nga klasa e shtresa të ndryshme shoqërore dhe për raporte vartësie e sundimi midis këtyre klasave.

Kështu pra të dhënat e ndryshme mbi veshjet, materiali i përdorur, teknikat e punës, veglat e mjetet e punimit të tyre etj., shumë herë mbështetin e plotësojnë burimet e shkruara ku jo gjithnjë, gjejmë të pasqyruara në masën e duhur, kushtet materiale të jetesës së masave të gjera të popullit. Historia e veshjes duhet parë si një realitet lëndor pa të cilin mënyra e jetesës do të mbetej e mangët dhe pa atë notë gjallërimi që mënyra e të veshurit i jep historisë së zhvillimit shoqëror të një vendi.

2. — Një arsye tjetër për të cilën i studiojmë dhe i çmojmë veshjet popullore është vlera artistike e tyre. Me shumëllojshmërinë e formave, me gjallërinë e ngjyrave, me karakteristikat e shumta zonale në kombinimin e elementeve të ndryshme dhe përgjithësisht me vlerat e shumanshme artistike që përmbajnë, kostumet popullore dëshmojnë për shije estetike të zhvilluara, për një jetë të pasur shpirtërore të masave të gjera punonjëse. Duke folur për këto çështje, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Ndjenja e hollë për të bukurën dhe shija e lartë artistike e popullit tonë, kanë spikatur kudo, në rapsoditë e mrekullueshme, në kostumet fantastike, në vallet e mahnitëshme, në shkrimet e rilindasve apo në këngët «rebele» e të ndritshme partizane. Shkurt, gjenia artistike e popullit tonë duket ngado që të hedhësh vështrimin, ngado që të vesh dorën. Artin populli ynë e ka konsideruar dhe e konsideron si pjesë të pandarë të jetës së tij»².

Ky vlerësim i lartë për artin popullor përlligjet plotësisht qoftë edhe sikur të marrim parasysh vetëm kostumet popullore. Larmia e madhe krahinore e tyre nuk është aq rezultat i ndryshimeve në strukturë sa frut i ngjyrave, zbukurimeve dhe kombinimeve të shumta që përftojnë variante të shumta nga disa tipa. Elementet dekorative të veshjeve popullore herë janë të thjeshta, herë më të rënduara, diku përdoren ngjyra më të qeta, diku ngjyra shumë të forta. Sipas traditës pjesët më të zbukuruara të veshjes janë, në veshjet e grave kryesisht këmishët, mbulesat e kokës, përparjet, brezat e çorapet, kurse

2) PPSH, *Dokumente kryesore*, vëll. V, Tiranë, 1974, f. 13 (Përsëritje e KQ të PPSH drejtuar shkrimtarëve dhe artistëve me rastin e themelimit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, 22.X.1970).

në veshjet e burrave, brezat e çorapet. Motivet e përdorura më shumë në zbukurimin e veshjeve popullore shqiptare janë në shumicën e rasteve gjeometrike dhe të vendosura në breza ornamentale. Ato nuk përbëjnë kurrë një njollë të ngjeshur ngjyrash, por përkundrazi janë shumë të ajrosura dhe me kalime të shkallëzuara nga qendra drejt periferisë.

Vlerat artistike të veshjeve popullore duhet t'i shohim edhe në tërësinë e tyre, pra në mënyrën si janë kombinuar pjesët brenda së tërës. Kështu vëmë re se, me anën e ngjyrave të përdorura në zbukurimet është arritur të krijohet një e tërë me lidhje të fortë organike midis pjesëve përbërëse, ku një ngjyrë bazë, përgjithësisht ngjyra e gajtanit, përsëritet në zbukurimin e pjesëve të veçanta. Më anë tjetër, vendosja e pjesëve të veçanta është e tillë që nga një pjesë shumë e dekoruar kalohet në një tjetër më të qetë dhe vetë fushat e zbukurimeve vendosen me qëllime efektshëm dekorative të caktuara në objektin që zbukurojnë.

3. — Në veshje pasqyrohet si njësia ashtu dhe larmia e kulturës sonë tradicionale. Duke ndjekur zhvillimin e kostumeve popullore mund të ndiqet mjaft qartë procesi i formimit të disa tipareve të përbashkëta kulturore në shkallë kombëtare.

Larmia në veshjet popullore është një tipar që bie në sy menjëherë, bile tërheq vëmendjen me shumëllojshmërinë e saj. Ku e ka burimin kjo larmi? Ajo gjen shpjegim, në radhë të parë, në shkallët e ndryshme të zhvillimit ekonomik-shoqëror të krahinave. Dihet mirë se në të kaluarën zhvillimi ekonomik i tyre, e për pasojë edhe kushtet materiale të jetesës, ishin shumë të pabarabarta. Për këtë ndikonte izolimi gjeografik i zonave të thella, mungesa e theksuar e komunikacionit e shumë faktorë të tjerë. Si rrjedhim, edhe gjatë shekullit XIX kishte krahina ku veshja prodhohej kryesisht brenda ekonomisë shtëpiake, sipas gjedheve tradicionale, të trashëguara brez pas brezi dhe plotësohej kohë më kohë me ndonjë element të ri, në përshatje me kërkesat shoqërore të kohës, mundësitë që ofronte tregu etj. Në këto rrethana kanë lulëzuar ato veçori të ngushta lokale që vëmë re edhe sot dhe janë ruajtur edhe elemente veshjeje me origjinë të lashtë.

Në zonat e tjera ku marrëdhëniet me tregun ishin më të gjera, vinte gjithnjë duke u shtuar edhe numri i pjesëve të veshjes që blidheshin të gatshme në treg, e kjo ndodhte, në radhë të parë, për kostumin e martesës. Në këto kushte e bënë evolucionin e tyre spontan shumica e kostumeve popullore dhe, duke dalë herë njëra pjesë e veshjes, herë tjetra nga prodhimi brenda kuadrit shtëpiak, hynë gradualisht në sferën e prodhimit zejtar. Me këtë hap vendimtar veshjet fituan një stabilitet të ri dhe u pasuruan me forma dhe elemente të reja, krahas atyre tradicionale. U rrit kështu ndikimi reciprok midis fshatit dhe qytetit, sidomos nëpërmjet mjeshtërive zejtarë, si ishin rrobaqepësit, qendistarët, opingarët, argjendarët etj., u përgjithësuan forma prerjeje për shumë pjesë të veshjes, duke i kapërcyer shumë herë dallimet e vogla lokale që ekzistonin më parë. Ky proces evoluimi mund të vihet re mjaft qartë, p.sh., në jelekët e mëngoret e burrave, në xhokat e cibunët e shumë zonave, po ashtu në brezat, kësulatat, opingat, këpucët e sidomos në stolitë. Duhet vënë mirë në dukje se zejtarët prodhonin veshje që ndryshonin shumë nga cilësia, duke iu përgjigjur mundësive ekonomike të blerësve dhe pasqyronin kështu edhe diferencimin klasor në veshje.

Në këtë proces zhvillimi u formuan gradualisht edhe disa tipare unitare në fushën e veshjeve. Kështu në shek. XVIII-XIX fizionomia që kishin marrë veshjet popullore shqiptare, me gjithë larminë e madhe, ishte e tillë që kishte arritur të kristalizonte disa tipare të

përbashkëta për shumë krahina e zona ose në shkallë kombëtare. I tillë ishte p.sh. kostumi me fustanellë, i cili në shekullin XIX përdorej ende, nga shtesa të ndryshme të popullsisë, pothuaj në gjithë Shqipërinë dhe jo vetëm në zonat e jugut, si mendojnë gabimisht disa. Ai kishte arritur të bëhej një «veshje kombëtare» e burrave shqiptarë në tërë kuptimin e fjalës. Në vepra të shumta dijetarësh e udhëtarësh të ndryshëm që kanë vizituar vendin tonë në këtë kohë, shprehjet «kostumi tipik i burrave shqiptarë», «kostumi i plotë shqiptar» etj., i referohen të gjitha kostumit me fustanellë. Më vonë, nga fundi i shek. XIX në çerekun e parë të shekullit tonë, krahas daljes graduale nga përdorimi të kostumit me fustanellë, një tjetër veshje burrash që i pat kapërcyer mjaft kufijtë e zonave ku mbahej më parë, ishte kostumi me tirq të bardhë a të zinj. Po kështu mund të themi për atë tip veshjeje grash ku, mbi këmbishën e gjatë ose fustanin, vishej xhoka e leshtë, tip i cili ka qenë fort i përhapur pothuaj në gjithë Shqipërinë.

4. — Këto shfaqje të njësive e të larmisë në fushën e veshjeve popullore s'duhet të shihen të shkëputura, por në lidhje dialektike me njëra tjetrën. Larmia dhe njësia, pra krahinorja dhe kombëtarja, qëndrojnë ndaj njëra tjetrës si pjesa ndaj së tërës, si e veçanta ndaj së përgjithshmes.

Specifika kombëtare ose etnike në kulturën popullore përbëhet jo vetëm nga ajo çfarë është e përbashkët midis krahinave apo zonave të vendit, por edhe nga tiparet që e dallojnë nga kultura e popujve të tjerë. Kjo specifikë pra mund të ndihet më mirë po t'i krahasojmë veshjet tona me ato të popujve të tjerë e në radhë të parë me popujt fqinjë. Dallimi ndihet menjëherë, edhe për një sy sadopak të stërvitur. Specifika etnike në këtë fushë shprehet jo vetëm me forma e prerje veshjesh, që janë tipike për popullin tonë e jo për të tjerët, por edhe me një varg treguesish të tjerë si janë p.sh. repertori i motiveve dekorative të përdorura në veshjet dhe lidhjet e shumë prej këtyre motiveve me besime të stërlashta vendase, preferenca e theksuar për disa ngjyra dhe funksioni i tyre për të shprehur moshën, për të cilësuar gjendjen civile e shkallën shoqërore të bartësit etj. Këta tregues, të krahasuar me veshjet e popujve fqinjë më një anë dhe me gjetjet arkeologjike mesjetare, antike apo edhe më të lashta, më anë tjetër, ndihmojnë për të zbuluar ngjashmëritë dhe dallimet me kulturën e popujve të tjerë dhe lidhjet gjenetike me kulturën e paraardhësve tanë, shqiptarëve të hershëm, dhe më tej të stërgjyshërve tanë ilirë.

Në shekullin XIX manifestimi i specifikës etnike në veshje ka qenë një shprehje e jashtme e përforcimit të tipareve kombëtare në kulturë dhe, në një plan më të gjerë, shfaqje e përforcimit të ndërgegjes kombëtare. Kështu ka ndodhur që në vargje të ndryshme të epikës historike, pamja e jashtme, veshja të merrej si simbol për të cilësuar anën etnike. Jo njëherë rilindasit tanë më të shquar janë krenuar me veshjet popullore po aq sa edhe në gjuhën shqipe apo me traditat e tjera kulturore. Edhe sot i ruajnë veshjet popullore apo elemente të veçanta të tyre dhe krenohen me to, shumë nga shqiptarët jashtë atdheut, qofshin këta shqiptarët e Kosovës a të Çamërisë, qofshin shqiptarët e shkëputur prej shekujsh si arbëreshët e Greqisë (arvanitët) e të Italisë etj. Ata i kanë ruajtur me dashuri kostumet e tyre popullore si një shenjë të jashtme që i dallonte nga kombësitë e tjera. Njohja më e thellë e burimeve ekzistuese, padyshim që do të konturojë sa vjen më plotë e më qartë shprehjen e specifikës etnike në veshjet tona popullore dhe do ta dokumentojë atë edhe më mirë.

Njohja sa më e mirë e specifikës etnike të kulturës popullore është një detyrë me përgjegjësi në kohën tonë për faktin se, — ashtu si ka porositur gjithmonë PPSH, ne duhet të ruhemi fort nga konceptet borgjezo-revizioniste, të cilat, duke predikuar ndërkombëtarizimin e kulturës, «përpiqen në të vërtetë të zhdukin traditat kulturore të popujve të vegjël e t'i nënshtrojnë ata, prandaj ta konsiderojmë si një detyrë të ngutshme ruajtjen e fizionomisë kombëtare dhe të origjinalitetit të kulturës»³⁾.

Si shihet studimi i veshjeve popullore paraqet interes të veçantë edhe për faktin se ato janë një tregues i rëndësishëm etnik.

*
* *
*

Veshjet, si u vu në dukje edhe më lart, kanë pasur kurdoherë një karakter historik, domethënë kanë ndryshuar vazhdimisht nga një periudhë historike në tjetrën. Ky zhvillim ka qenë herë më i vrullshëm herë më i qetë, ai ka ndjekur zig-zaget e së kalurës sonë, ashtu si çdo kronikë tjetër e ngjarjeve të rëndësishme. Për shkak të mungesave të ndjeshme që kanë burimet tona historike të kohës së mesme për të krijuar një përfytyrim sa më të saktë të veshjeve në këtë kohë duhej mbështetur edhe në të dhëna disi të tërthorta si janë p.sh. njoftimet mbi lëndët e para që përdoren për veshje (lëkurë, lesh, lin, mëndafsh etj.), jo vetëm për ato lëndë që prodhoheshin në vend, por edhe për ato që sillleshin nga jashtë, njoftime mbi zejtarët e kohës, për ata lloj mjeshtrish që përgatishnin pjesë të ndryshme veshjesh, si ishin rrobeqepësit, qendistarët, këpucarët, argjendarët etj. Për dy-tre shekujt e fundit disponojmë gjithashtu disa burime të vlefshme ikonografike, gravura e stampa të kohës, përshtime studiuesish e udhëtarësh të ndryshëm, të cilat, të ballafaquara e të krahasuara me materiale të koleksioneve tona muzeale të dy shekujve të fundit, arrijnë të kuptohen e të interpretohen më mirë e më drejt. Jemi munduar t'i shfrytëzojmë të gjitha këto burime të pjesshme, duke i plotësuar me njohuritë e përfutuara nga kërkimet e gjera shumëvjeçare në terren. Në gjendjen e tanishme të burimeve ekzistuese mund të përcaktojmë vijën e përgjithshme të zhvillimit të veshjeve në vendin tonë, që nga shekujt XIII-XIV e deri në shekullin XX.

Përsa i përket veshjes së shek. XIV-XVI, me të cilën hapet kapitulli i parë «Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri», vihet re mungesa e të dhënave për veshjen e shtresave të gjera punonjëse, e njerëzve të thjeshtë, kurse për veshjen e shtresave të larta, fisnikëve, oborrtarëve etj, të dhënat janë disi të kënaqshme. Kjo gjendje është deri-diku e kuptueshme.

Gjatë mesjetës veshjet janë kryesisht rezultat i arritjeve krijuese vendase, në kushtet e zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit në atë kohë, trashëguese të shumë elementeve të një nënshtrese më të lashtë kulturore, por edhe shprehje e marrëdhënieve me popujt e tjerë, si pasojë e të cilave janë krijuar ato tipare të përbashkëta ballkanike në kulturën materiale të tyre, që njihen mirë. Për veshjet e shekujve XVII-XIX burimet janë shumë më të pasura e më të shumëllojshme. Në këtë periudhë vihet re një shtrirje e shumë varianteve

3) E. Hoxha, *Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre*, Tiranë, 1973, f. 28.

të ngushta lokale në variante më të përgjithshme, rezultat që ilustron më së miri atë proces afrimi midis krahinave që sjell kristalizimin e disa tipareve kombëtare edhe në veshje. Ky vështrim historik mbi materialet dokumentare që ekzistojnë për veshjet dhe interpretimin e tyre, është e para përpjekje sistematike që bëhet në këtë drejtim dhe, si e tillë, paraqiste edhe vështirësi.

Në një kapitull të veçantë janë shqyrtuar variacionet dhe përshtatjet e kostumeve popullore, sipas funksionit që kryejnë. Funksioni mbrojtës i veshjes dhe karakteri i saj praktik janë konkretizuar me format e ndryshme që ajo ka marrë gjatë shekujsh në varësi të nevojave të punës e të kushteve natyrore, duke iu përshtatur edhe stinëve. Veshja ndryshonte jo vetëm sipas moshës e seksit të bartësit, por edhe sipas gjendjes civile. Në veshjet për të dalë, funksioni estetik e ceremonial e zbehte deri diku funksionin praktik. Masat e gjera të popullit kanë arritur që brenda kuadrit të veshjeve të krahinës të gjejnë mënyrën për t'i dhënë bartësit herë pamjen e gëzuar të atij që shkon të marrë pjesë në ngjarje të këndshme, herë pamjen e trishtuar e hijerëndë të atij që shkon në një ngjarje të hidhur. Veshja ishte pra si një lloj letërnjoftimi i hapur, që të jepte të kuptoje që së largu, krahinën e shtresën shoqërore, moshën e seksin dhe destinacionin për ku qe nisur bartësi. Në mënyrë të veçantë tërheqin vëmendjen e studiuesit dallimet në veshje sipas klasave e shtresave të ndryshme shoqërore. Deri aty nga fillimi i shekullit tonë, në qytetet kryesore të vendit, vepronin ende rregulla të rrepta që nuk lejonin që përfaqësues të një shtrese më të ulët të visheshin njësoj si ata të një shtrese më të lartë. Të gjitha këto tregojnë se veshja është një fushë e rëndësishme e mënyrës së jetesës, ku janë mpleksur, në lidhje të shumëllojshme, faktorë të shumtë që kanë të bëjnë jo vetëm me kushtet ekonomike e natyrore, por edhe me karakterin e marrëdhënieve shoqërore e familjare në rëndë të ndryshme shoqërore. Kështu, p.sh., nuk është një gjë e rastit që veshjet e grave paraqiten, në shumë raste më konservatore se ato të burrave. Kjo padyshim ka lidhje me jetën e mbyllur shtëpiake të grave në të kaluarën, me daljen e tyre të kufizuar në shoqëri, ndërsa burrat i thyenin më shpesh kufijtë e ngushtë të fshatit a të krahinës, krijonin kontakte më të gjera. Mbas çlirimit ngritja e përgjithshme e nivelit të jetesës solli përmirësime të dukshme edhe në veshje, duke i zhdukur kontrastet e mëdha të së kaluarës, dallimet klasore etj. Lufta e madhe kundër zakoneve prapanike, e udhëhequr nga PPSH, zhduku shumë shenja diskriminimi, sidomos për vajzat, duke i çliruar nga shumë paragjykime të së kaluarës. Janë pakësuar gjithashtu dallimet në veshje sipas përkatësisë fetare etj. Këtu trajtohen edhe shprehje të funksionit etnik të kostumit popullor si edhe aspekti estetik i tyre. Në përgjithësi problemet që trajton ky kapitull janë rrahur shumë pak tek ne, deri tani.

Kapitulli që pason, kushtuar klasifikimit të veshjeve popullore synon të japë një grupim më të plotë e të argumentuar sesa arritjet e deritanishme në këtë drejtim. Ky klasifikim mbështetet kryesisht në tipologjinë e pjesëve të sipërme të veshjes e sidomos të atyre që mbulojnë trupin nga mesi e poshtë, por duke i parë gjithmonë në lidhje të ngushtë me vendin që zënë në strukturën e përgjithshme të veshjes përkatëse. Ky kriter është më i përshtatshëm sepse, ashtu si është vënë re edhe në vise të tjera të Ballkanit, elementet e veshjes që mbulojnë këtë pjesë të trupit janë më karakteristike si nga format e prerjes, ashtu edhe nga vendosja e materialit. Si rrjedhim tipologjia e tyre jep mundësinë të përcaktohen më mirë si dallimet, ashtu edhe ngjashmëritë, në raport me veshjet e popujve të tjerë, ndërsa po të ndjekim tregues të tjerë (p.sh. elemente të veshjes që mbulojnë pjesën e

sipërme të trupit) këto dallime zbehen dhe specifika etnike nuk del në pah sa duhet. Më anë tjetër kriteri i mësipërm lejon të bëhen për-qasje dhe krahasime më të qarta midis pjesëve të veshjeve ekzistuese dhe të dhënave figurative e dokumentare nga koha e mesme, koha e lashtë dhe periudha të tjera më të hershme të zhvillimit kulturor të popujve dhe të zbulohen sidomos lidhjet me veshjet e të parëve tanë, ilirëve,⁴ për të cilat jemi pa dyshim shumë të interesuar.

Në kapitullin e fundit është bërë një përpjekje për t'i njohur sa më me hollësi format dhe variantet ekzistuese të elementeve të ndryshme të veshjes. Kjo jep mundësinë që ato të radhiten në një rend kronologjic relative përbrenda tyre, rend ky që lejon të zbulohet rruga e zhvillimit të elementit përkatës. Qëllimi është të arrihet të gjurmohet se cilat janë elementet më të vjetra të ruajtura në veshjet popullore, të përcaktohet se me veshjet e cilit popull të lashtësisë paraqesin afri më të mëdha, cili është karakteri i këtyre lidhjeve etj. Këtu pikësynimi kryesor ka qenë gjurmimi i lidhjeve shqiptare-ilire, për të përcaktuar çkemi trashëguar në këtë fushë nga kultura e stërgjyshërve tanë dhe për të vendosur një shtresim kronologjik sa më të saktë të pjesëve përbërëse të kostumeve popullore.

Në veshjet, ashtu si edhe në fusha të tjera të kulturës materiale ruhen shtresa shumëshekullore të cilat mund të zbulohen me anë të ballafaqimit me elemente analoge të kulturave me të cilat populli ynë ka pasur të bëjë gjatë historisë së tij.

Janë shqyrtuar në këtë kapitull një varg elementesh të rëndësishme nga veshjet popullore, duke skicuar historinë e zhvillimit të secilit prej tyre, në bazë të asaj që kanë dhënë kërkimet e deritanishme etnografike, duke u ndihmuar nga burimet letrare e dokumentare, nga të dhënat arkeologjike etj. Elementet e shqyrtuara janë xhubleta, brezat, futat duke përfshirë si përparjet ashtu edhe futëprapesit, mbështjellset apo fundet e hapura a «gjysmëfundet», fustanella, linja, xhoket, strukat e kapuçët, opingat, mbulesat e kokës e stolitë. Nga ky shqyrtim del në pah fakti se në veshjet popullore shqiptare janë ruajtur një varg elementesh që mund të konsiderohen si pasardhëse veshjesh të përdorura nga ilirët. Por më anë tjetër kjo nuk do të thotë aspak se në kulturën tonë popullore çdo gjë lidhet vetëm me trashëgiminë ilire; përkundrazi ekzistojnë në këtë fushë një mori elementesh që u përkasin shtresave të tjera kulturore, që vijnë p.sh. nga koha e mesme, madje edhe nga kohët e reja dhe që dëshmojnë për lidhjet e kontaktet e botës shqiptare me popujt e tjerë.

Materiali i paraqitur në këtë kapitull duhet parë si një përpjekje për të hedhur dritë mbi gjenezën e disa elementeve të kostumeve popullore dhe karakterin etnik të tyre, fushë në të cilën deri tani është punuar pak.

I tërë punimi mbështetet në materiale etnografike të mbledhura në terren gjatë ekspeditash të shumta në zona të ndryshme të vendit, në njohjen e kujdesshme të koleksioneve muzeale në qendër e në rrethe dhe në një informacion të gjerë të vjelë nga literatura e nga burime të tjera të shumëllojshme dokumentare.

Jam përpjekur që në këtë vepër të ndriçoj sado pak rrugën historike të zhvillimit që ka përkrahur kjo sferë e kulturës popullore, të

4) Këto lidhje shqiptaro-ilire në fushën e veshjeve janë trajtuar në: «Analogji shqiptaro-rumune në veshjet popullore» dhe «Elemente të përbashkëta të veshjes së fiseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet popullore shqiptare», nga A. Gjergji, botuar në «Studime historike» 1967, nr. 2 dhe «Studime historike» 1969 nr. 2.

shtjelloj përmbajtjen dhe domethënien e pasur të formave të saj të larmishme, të zbuloj cilat janë elementet më me interes që mund t'i shërbejnë ripërtëritjes së vazhdueshme të kulturës sonë të re në procesin dialektik të zhvillimit të saj, që ajo të bëhet, ashtu si na mëson Partia, thellësisht kombëtare nga forma e socialiste nga përmbajtja.

Vepra shtron kështu një varg problemesh për të cilat mund të jenë të interesuar rrethe të ndryshme lexuesish, që nga specialistët e studimeve historike e shoqërore, tek ata të artit e të kulturës etj.

Duke i paraqitur lexuesit rezultatet e punës së deritanishme në këtë fushë interesante gjurmimesh shkencore, jam e ndërgjegjshme se kërkimet mund dhe duhet të vazhdojnë më tej dhe do të mirëprisja prej lexuesve çdo vërejtje e sugjerim të dobishëm.

Autorja

Tiranë, nëntor 1987

VËSHTRIM HISTORIK MBI VESHJET NË SHQIPËRI

Këtë vështrim historik mbi veshjet po e fillojmë me një shqyrtim të hollësishëm të burimeve dokumentare e historike që kemi mundur të gjejmë deri më sot, duke nisur nga shekulli XIV. E meta kryesore këtu, si do të shihet edhe nga materiali i parashtruar më poshtë, është se burimet i referohen, në shumicën dërrmuese të rasteve, veshjes së shtresave të larta të fisnikëve ose asaj të luftëtarëve dhe shumë rrallë veshjes të shtresave të gjera qytetare ose fshatare të popullsisë. Kjo zbrazësi bie më fort në sy për shekujt XIV-XVII, por kërkimet e mëvonshme ndoshta do të arrijnë ta plotësojnë në një farë mase.

1. - VESHJA NË SHEKUJT
XIV-XVI

a) Lloje tekstilësh të përdorura për veshjet.

Kur flasim për historinë e veshjes në periudhën e feudalizmit duhet të kemi parasysh karakterin e prodhimit në këtë kohë. Pjesët e veshjes për masat e gjera fshatare në këta shekuj punoheshin kryesisht brenda kuadrin të ekonomisë së mby-

llur shtëpiake, me lëndë që nxirrej nga prodhimet bujqësore e blegtorale, si ishin lëkura, leshi, liri, kërpi e mëndafshi.

Pëlhura më e vjetër prej kërpi e ruajtur deri më sot në vendin tonë është e vitit 1373⁵, por dihet mirë se pëlhura prej liri e kërpi kanë vijuar të përdoren gjerësisht në veshjet popullore deri në fillim të shekullit tonë, e në disa krahina edhe më vonë. Kultivimi i mëndafshit gjatë shekujve të mesjetës përmendet në disa dokumente, duke filluar që nga vitet 1335, 1348⁶ etj. Madje që në fund të shekullit XIV përmenden dogana të mëndafshit në Shkodër e në Drisht, gjë që dëshmon se mëndafshi tashmë edhe eksportohej.⁷ Krahinat ku lulëzonte më shumë kjo kulturë gjatë mesjetës ishin rrethet e Vlorës, Beratit, Durrësit etj. Edhe disa toponime si Kokoman e Manskuri, janë dëshmi të zhvillimit të kulturës së manit në këtë trevë.⁸

Përsa u përket ngjyrave, duhet patur parasysh se përgjithësisht në tekstilet e punuara në shtëpi nga gratë fshatare, mbizotëronin ngjyrat natyrore të leshit (pra e bardhë, e zezë, e murme dhe bojë kafe), por përdoreshin edhe ngjyrosësit bimorë⁹.

Krahas prodhimeve të ekonomisë shtëpiake, një sasi pëlhurash silleshin edhe nga jashtë. Ato më të lirat ishin pëlhura liri, që destinoheshin kryesisht për njerëzit

5) Është fjala për epitafin e madh të Glavinicës, që ruhet në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë. Mbishkrimi i këtij epitafi mban datën 1373. Për këtë mbishkrim shih «Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë», vëll. II, shek. VIII-XV. Përgatitur nga prof. Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo (redaktor përgjegjës Kristo Frashëri). Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1962, f. 194.

6) L. Thallosy — C. Jireček — E. Šufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae-Aetatis illustrantia*, Vindobonae, 1913, vëll. I dok. 746, 798, vëll. II, dok. 46.

7) Po atje, vëll. I, dok. 789.

8) Shih E. Šufflay, *Stadte und Burgen Albaniens*, Wien und Leipzig, 1924, f. 42.

9) Shumë bimë janë përdorur deri vonë si ngjyrosës p.sh. frashëri, për ngjyrën e zezë, broshtha për një të kuqe në vishnje, molla e egër për një të verdhë të fortë etj.

ë shërbimit, «*pro servientibus*», si thuhet shprehimisht në dokumentet përkatëse të periudhës së mesjetës para turke. I tillë është ai «*panno lineo*», pëlhurë liri (?), si edhe pëlhura e Bergamos, (Itali) (*panno borgomasco*) të cilat i takojmë në dokumente që në fund të shekullit XIII. Ato silleshin kryesisht nga Puglia (Itali).¹⁰

Dihet gjithashtu se në shekullin XIV, për shërbëtorët, lajmëtarët etj. janë përdorur pëlhura me vija ngjyrash të ndryshme «*pani vergati*», të cilat silleshin me anë të Raguzës, në Shkodër dhe në Tivar.¹¹

E një cilësie gjithashtu modeste ishte një pëlhurë e quajtur fustan («*fustagno*»), importimi i së cilës përmendet në një varg dokumentesh, duke filluar që nga fundi i shekullit XIII (viti 1297). Gjatë gjithë shekullit XIV ajo sillej më fort me anë të Raguzës, por më vonë në shekullin XV sillej nga Venediku¹². «Fustani» ishte një pëlhurë pambuku ose pambuku të përzierë me lin, e punuar dendur, me qëndrueshmëri të madhe dhe kështu përshtatej edhe për veshjet e njerëzve të punës e të shërbimit. Një dokument i vitit 1403 e përcakton qartë se për cilën shtresë shoqërore destinohej kjo pëlhurë në atë kohë. Atje flitet për dy-tre topa fustan që u jepen dhuratë fisnikëve vendas për vartësit e tyre, «për ata shërbëtorë të zotërisë suaj, që banojnë në vilat»¹³. Mendoj se me këtë lloj pëlhure bëhej në këtë kohë fustani (a fustanella), prej së cilës ai mori, me sa duket edhe emrin, si ka ndodhur shumë herë në historinë e veshjeve, jo vetëm tek ne, por edhe në popuj të tjerë¹⁴.

Cilësia e pëlhurave dhe e stofave të përmendura më lart, sigurisht nuk mund të kënaqte kërkesat e fisnikëve dhe të bujarëve të kohës. Ata, ashtu si edhe kleri i lartë, përdornin për veshjet e tyre pëlhura të importuara, shumë të shtrenjta, të cilat ishin objekte të veçanta luksi.

Dokumente të shumta të shekujve XIV e XV përmendin stofa të ndryshme që u jepen nga ana e Venedikut dhe Raguzës, jo vetëm krerëve të vendit, për të cilët rezervohen stofat më të mira e më të shtrenjta, por edhe cohëra më të lira për fisnikët e vegjël dhe pasuesit e tyre. Ndër to përmendim në radhë të parë cohërat me ngjyrë të kuqe (*panni de scarlato*, *panni scarlatina*, *panni scarlati fini*, *panni scarlati de grana fine*, *panni de grana*)¹⁵, gjithmonë shumë të shtrenjta, por edhe shumë të kërkuara nga fisnikët e kohës. Përmenden, përveç tyre, edhe lloje cohësh të tjera: «*panni stametti*» ose «*panni rubei de stametto*», që ishin të leshta, si edhe «*panni rubei boni*» «*panni rubei quarantini*» «*panni de Cumis*», «*panni de Florentia*» dhe «*panni viridi*»¹⁶. Në këtë kohë këto ishin stofat më të çmuara e më të vlefshme që përdornin shtresat e larta të shoqërisë jo vetëm tek ne, por edhe në vende të tjera. Dihet se në këta shekuj edhe ngjyrat e stofave të përmendura ishin të përcaktuara sipas shtresave shoqërore; kështu e kuqja, e gjelbra dhe manushaqja e mbyllët (*pao-nazzo scuro*) ishin ngjyrat e rezervuara për fisnikët. Shumë të preferuara prej tyre ishin edhe pëlhurat e mëndafshita të qen-

10) *Acta et diplomata*, vëll. I, dok. 385, viti 1278; dok. 407, viti 1280.

11) Po atje, vëll. I, dok. 386, viti 1383.

12) Po atje, vëll. I, dok. 528; viti 1297, dok. 533, viti 1301, dok. 639, viti 1318, dok. 789, viti 1335, dok. 790, viti 1336; vëll. II, dok. 386, viti 1383, dok. 723, viti 1403, dok. 737, viti 1403.

13) Po atje, vëll. II, dok. 737, viti 1403 («*quas dividam eciam inter aliquos servitores vestre dominationis habitantes in villis*»).

14) P.sh. «*coha*», ai mantel i grave të Lunxhërisë, që bëhej prej cohe, «*tirqit*» që bëheshin me një lloj pëlhure të leshtë që quhej «*tirk*»; «*allaxhaja*», një veshje e sipërme grash, e bërë me një lloj pëlhure të mëndafshhtë me vija, që quhej *allaxha*; «*dylbeni*» një mbulesë koke për gra që bëhej prej një pëlhure të hollë të bardhë, e cila thirrej «*tylbend*». Shih: E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, Buletin i U.S.H.T. 1961, 1, f. 65.

15) Po atje, vëll. II dok. 391, 422, 444, 537, 610.

16) Po aty, vëll. II, dok. 312, 386, 737, 386, 391, 414, 526, 573, 384; kurse për «*panni rubei quarantini*» shih Dh.S. Shuteriqi, *Dy dokumente të kohës së Skënderbeut*, në gazetën «*Drita*» Tiranë 1965, 24 janar, f. 2 (Et pro habendis nonnullis ipsorum principium nostro dominio affectis emantus quator peti *pani rubei quarantini* Illustrissimoque Bayolo Dyrachii mittantur,.... Dhe që disa nga ata më të parët t'i kemi të dashur ndaj zotërimit tonë, të blihen katër topa cohë të kuqe, *kuarantine* dhe t'i dërgohen të përndriturit Bajl të Durrësit,....).

disura me ar¹⁷. Vetëm në një rast përmenden, në një dokument, stofra të Flandrës dhe po ashtu ende rrallë përmendet kadifeja (velluto)¹⁸, e cila do të mbetet për shumë kohë një plaçkë shumë e çmuar për veshje.

Të gjitha këto stofra silleshin përgjithësisht nëpërmjet Venedikut dhe në këtë rast «taksa doganore ishte më e ulët se taksa e stofave që vinin nga vende të tjera në viset e Arbërisë e të Sklaponisë»¹⁹.

Shumë nga princat e fisnikët shqiptarë blinin me anë të Venedikut stofat që u duheshin për nevojat e familjarëve të tyre e të njerëzve të shërbimit. Kështu p.sh., dimë se familja e Gjon Kastriotit furnizohej me stofa nga Venediku, sepse në një dokument të vitit 1433²⁰ thuhet se «një i dërguar i Gjon Kastriotit i është paraqitur Venedikut duke kërkuar që: a) pëlhurat që blihen për shtëpinë e tij, të përjashtohen nga taksa doganore...». Po kështu në Venedik, i blinin stofat që u nevojiteshin për përdorim Arianit Komneni,²¹ Balsha²² dhe fisnikë të tjerë. Si shihet edhe gjatë shekujve XV-XVI, stofrat si edhe moda e veshjes për aristokracinë e vendit, vinin ende nga perëndimi, kryesisht nëpërmjet Venedikut, por edhe nëpërmjet Raguzës.

Në shek. XVI, për shkak të pushtimit osman, u ndërpre për një kohë tregtia me Venedikun e vende të tjera të perëndimit, por nga fundi i këtij shekulli shohim se krahas mallrave që vijnë nga Lindja (Stambolli, Brusa etj.), rifillon sjellja e mallrave edhe nga perëndimi. Llojet e stofrave që importoheshin në këtë kohë, nga skela e Vlorës, p.sh., ishin: mëndafsh i llojit qemha (camha), kadife, tafta, valë, tylbend, bogas, astar, beze, shamira e mahrama, në

përgjithësi pëlhura të mëndafshita, stofa të leshta etj., artikuj të pambuktë dhe lëkura kafshësh të egra (dhelpa, ketra etj.)²³. Po në këtë kohë prodhoheshin në vend, jo vetëm për nevoja shtëpiake, por edhe për treg, një sasi e mirë pëlhurash të mëndafshita, shajak (*çuka*) dhe veshje, të cilat dilnin i shisnin në treg vetë gratë, sikurse thuhet shprehimisht në Kanunamenë e Shkodrës të vitit 1570²⁴.

Pra në kuadrin e përgjithshëm të veshjeve të përdorura në Shqipëri në shekujt XIV-XVI duhet të mendojmë se krahas masës së gjerë të veshjeve të konfeksionuara me material të punuar në vend, një numër jo shumë i kufizuar njerëzish përdorte në veshjen e vet, në mos të përditshmen, në atë të festave, pjesë veshjeje të konfeksionuara me stofa të importuara, prodhime të modës për atë kohë.

b) Format e veshjeve, nga fustanella e vitit 1335 tek «mëngoret e modës shqiptare».

Përsa i përket formës së veshjeve, të dhënat që disponojmë janë shumë të njëanshme, sepse janë ruajtur përgjithësisht vetëm ato që u përkasin shtresave të larta të shoqërisë dhe mungojnë, ose janë të pamjaftueshme a të tërthorta, të dhënat për masat e gjera të popullit.

Gjatë shekullit XIV, në veshjen e tyre fisnikët e kohës ndiqnin modën bizantine, për të cilën mund të krijojmë një përfytyrim deri-diku të qartë nga afresket e ruajtura ende në disa nga kishat më të vjetra të vendit, sidomos nga portretet e ktitorëve. Ata janë paraqitur të veshur së

17) J. Radonić, *Gjuragj Kastrioti Skënderbeg i Arbanija u XV veku*, Beograd, 1942, dok. 55; *Dokumente të shekullit XV*, dok. 619, viti 1425 (Arkivi i Institutit të Historisë).

18) *Dokumenta të shek. XV*, dok. 849, viti 1435.

19) Po atje, dok. 892, viti 1438.

20) J. Radonić; *vepra e cit.*, dok. 6, dt. 25 Maj 1433.

21) Në një akord të Venedikut me Skënderbeun, lidhur më 4 tetor 1448, thuhet: «Item che le grate che al signor Areniti altro volte fo concesse per la antedita signoria de Venezia, zoé de poter comprare per suo uso pani et quelli trar da Durazzo senza alcun datio, i siano liberamente confirmati». (cituar sipas F. Babinger: *Arianit Komneni, vjehërr i Skënderbeut*. «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 480).

22) *Dokumente të shekullit XV*, nr. 309, viti 1417, Qershor 9, Venedik.

23) «*Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë*», vëll. III. Shqipëria nën sundimin feudal-ushtarak otoman (1506-1839), përgatitur nga Injac Zamputi, Stavri Naçi, Zija Shkodra, Redaktor përgjegjës Prof. Aleks Buda, Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Historisë, Tiranë, 1962, f. 50-51 (Kanunameja e Livasë së Vlorës, viti 1583).

24) Po atje.



pari, me një rrobë të gjatë deri te nyjet e këmbëve, të mbyllur përpara, me mëngë të gjata, por fare të ngushta mbi të cilën vjen sakoja e rëndë, e kopsitur përpara, po aq e gjatë sa rrobja e brendshme. Sakoja ka mëngë të shkurtra gjer te bërryli që përfundojnë në ca lapa të gjata që varen poshtë (shih portretin e familjes së ktitorit Cezar Novak, viti 1369)²⁵. Si shihet ajo është një veshje e rëndë, ende plotësisht bizantine, e drejtë, e gjerë, e ngrirë nga zbu- kurimet e shumta me fiye ari e gurë të çmuar, ku forma e trupit humbet krejt (Fig. 1 a, b).



Fig.1 — Veshja e Ktitorit Cezar Novak. Afresk në Kishën e Maligradit të Prespës (rr. Korçë), t viti 1369. a) foto e afreskut

Veshja e grave (në po atë afresk) përbëhej gjithashtu nga një rrobe e brendshme e gjatë. Sipër saj vishej një sako e gjatë edhe kjo deri për tokë dhe shumë luksoze. (Fig. 2 a, b). Gratë e mbështillnin kokën me një pëlhurë të hollë, që u mbulonte edhe qafën e pjesërisht supet, gjur-



b) skicë.

mët e së cilës do ti ndeshim deri vonë në mbulesat e kokës të grave në disa kra- hina të vendit (p.sh. në Dropull, Has etj).

Në shek. XIV në përgjithësi zbu- kurimi i veshjes së fisnikëve bëhej ende me që- ndisje me fiye ari, perla e gurë të çmuar. Veshja plotësohej me një varg aksesorësh si ishin brezat prej argjendi, vathët e tëm- thoret prej perlash, dhe sidomos kurorat,

25) Portret familjar i ktitorit Cezar. Novak, afresk i vitit 1369, në kishën e Maligradit të Prespës (rrethi i Korçës).



Fig. 2 — Veshja e Kalisë, gruas së Cezar Novakut. Afresk në kishën e Maligradit të Prespës (rr. Korçë). Viti 1369. a) foto e afreskut

diademat e skeptrat. Diademë e tëmthore perlash mban p.sh. Kalia, gruaja e Cezar Novakut, në afreskun e përmendur më lart. Për një kurorë të zbukuruar me perla e gurë të çmuar flitet në një dokument të vitit 1353²⁶, kurse për një kurorë të artë e katër palë vëthë me perla, që i përkisnin gruas së Gjergj Topisë, bëhet fjalë në dokumente të viteve 1393, 1399, 1400²⁷. Ato tregojnë se bujaria e kohës tek ne ndiqte modën bizantine jo vetëm në veshje, por edhe në zbukurimet e kushtueshme. Në shekujt e ardhshëm bëhet fjalë gjithënjë më pak për të tilla stoli, gjë që tregon se fasti bizantin ishte tashmë në rënie. Në dokumente të shekullit XIV përmenden edhe breza argjendi për gra²⁸. Këta breza vazhduan të përdoren edhe në shekujt e mëvonshëm, si na dëshmon një këngë arbëreshe e dorëshkimit të Kieutit (viti 1737)²⁹ si edhe objekte të shekujve XVIII-XIX të ruajtura në koleksionet tona muzeale.³⁰

Shekulli XIV është shekulli i flokëve të gjata për burrat, që i mbajnë të lëshuara supeve e prapa ose të thurura gërshet. Përveç figurave të paraqitura në freskaktitorësh të kohës, një dëshmi tjetër për këtë e kemi tek pohimi i fisnikut shqiptar Gjon Muzaka, i cili në testamentin e vet



b) skicë.

drejtuar të bijve, tregon se Teodor Muzaka (që jetoi në shek. XIV) mbiquhej «Chiscetis», se i mbante flokët e gjata «ksheta», ashtu si ishte zakoni i përgjith-

26) *Acta et diplomata...* vëll. I, dok. 186.

27) Po atje, vëll. II, dok. 510, 621, 661.

28) Po atje.

29) «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar» I (1635-1912) nga: Z. Sako (redaktor përgjegjës), A. Fico, K. Harito, Q. Haxhihasani. Botim i Institutit të Folklorit, Tiranë 1961, f. 37 (Çë stolj më taksi mëma?/ Nende cohe e nende linjë./ nende brezaz të regjendë...).

30) Instituti i Kulturës Popullore. Fondet Etnografike (F.E.) shih p.sh. objektet me numra inventari 4031, 7990.

shëm në atë kohë,³¹ zakon që vazhdoi edhe në kohën e rinisë së Gjon Muzakës, pra në shek. XV. Gratë gjithashtu i mbanin flokët të gjata thurur gërsheta.

Shumë të pakta e të paplota janë të dhënat që gjejmë nëpër dokumente për veshjen e njerëzve të thjeshtë. Më i rëndësishmi ndër ta është një dokument i vitit 1335, që tregon se një marinari në portin e Drinit, pranë Shkodrës, i marrin ndër të tjera, këto plaçka: tunikën, mantelin, *fustanin*, *këmishën* etj. («ei guarnacionem, tunicam, mantellum, maçam de ferro, *fustanum*, *camisiam* abstulerunt»)³². Kjo është dëshmia më e hershme që njohim deri tani, ku «fustani» përmendet tashmë si një pjesë e veshjes, krahas *këmishës*. Në një kontratë të lidhur në Raguzë më 1330, thuhet se Gjergji, i biri i Pjetrit nga Tivari, pajtohet në punë për një vit tek abati i manastirit Lacromens, dhe ky si shpërblim do t'i japë «8 përpera, një rrobe, një *xhokë*, e një *kapuç* dhe ushqim (gonella I, *capa* I et *caputeo* I et *victu*)»³³. Kurse në një dokument tjetër të po atij viti thuhet se Pjetri nga Shkodra, pajtohet për të punuar si këpucar për 1 vit tek një mjeshtër në Raguzë dhe ky duhet t'i japë «9 përpera, ushqimin, 1 palë opinga nga Raxa(?), 1 palë *brekesha* dhe 1 palë ndërresa» (1 pari *chalegarum* de Raxa, 1 *braga* et 1 *interula*)³⁴. Megjithatë, në këtë shekull gjejmë në disa qytete të Shqipërisë, mjeshtër që punojnë artikuj të ndryshëm veshmbathjeje, si rrobaqepës (*sartores*), këpucarë a opingarë (*calligari*)³⁵ etj. Kjo tregon se nëpër qytete kishte tashmë një shtresë njerëzish që kërkonin punën e këtyre mjeshtërve.

Gjatë shekullit XIV, një varg qytetesh si Vlora, Durrësi, Berati, Shkodra e Pulti arritën kulmin e zhvillimit të tyre e ky zhvillim ishte kryesisht pasojë e lulëzimit

të zejtarive e të tregtisë. Shumë zejtarë si rrobaqepësit, lëkurëpunuesit, gëzoftarët, opingarët, qendistarët etj. përgatisnin artikuj të ndryshëm veshmbathjeje ose i konfeksiononin ato me stofa të shtrenjta të importuara. Këto stofa ishin, të shumtat, prodhime të qyteteve të lulzuara italiane të kohës, si Gjenova, Livorno, Firenze etj. Përpjekjet e Venedikut për të penguar hyrjen e stofave nga vende të tjera, janë të pareshtura në këtë kohë. Tab. IIa.

Në shekullin XV veshja që përshkruam më sipër pëson disa ndryshime. Sakoja e sipërme zëvendësohet nga një lloj xhybeje a manteli (pellanda), që shumë herë në vend të astarit kishte gëzof. Mëngët nuk i kishte më në formë lape, si sakot e shekullit të mëparshëm, por në formë gypi, të qepura te supi vetëm pjesërisht, në mënyrë që të varreshin prapa krahut. Më 1413 Balshë Strazimiri merr dhuratë nga i dhëndrri, Sandali i Bosnjës, dy pellanda të sjella nga Venediku.³⁶ Për një pellandë bëhet fjalë gjithashtu në testamentin e Marinit, kryepeshkopit të Tivarit më 1420.³⁷ Me një pellandë të veshur me lëkurë ermellini dhe të garnirur me tufëza të zeza, si ishte zakoni për veshjet mbretërore, është paraqitur Skënderbeu në një portret (Fig. 3), autori i të cilit nuk dihet.³⁸ Të tilla pellanda ishin në modë në këtë kohë jo vetëm në vende të tjera të Ballkanit, por edhe në Venedik. Por dihet se moda e veshjeve të kushtueshme prej gëzofrash të rralla, u soll në Evropë nga vendet e Lindjes. Ky lloj manteli a xhybeje, me ndryshime të vogla, kryesisht të mëngët, do të vazhdojë të mbahet nga fisnikët e vendeve të Ballkanit edhe në shek. XVI e më tej, si na tregon një gravurë e vitit 1577 në veprën e N. Nikolait.³⁹

Edhe në shekullin XV fisnikët parapëlqenin për rrobat e tyre cohën e kuqe, por

31) Shih: Ch. Hopf, *Chroniques gréco-romanes inédites*, Berlin 1873, f. 279: «E dove troverete Theodoro Mosachi Chiscetisi, Chiscetis vuol dire capilli longi, che così lui li portava et il proprio vocabolo in lingua albanese *chiscetisi* vuol dire *trezze*, Che così lui soleva portare, com me ricordo ch' tempo nostro in questo Regno generalmente il portavano insino alle spalle...»

32) *Acta et diplomata*, vëll. I, dok. 790.

33) *Acta et diplomata*, vëll. II dok. 65 dt. 1350 shkurt 7, Raguzë.

34) Po atje, dok. 80, dt. 1350 dhjetor 1, Raguzë.

35) Po atje, vëll. I, dok. 15, dt. 1345, prill 27 (përmenden me emra katër këpucarë në Vlorë).

36) *Dokum. të shek. XV*, dok. nr. 215 dt. 4 maj 1413.

37) Po aty, dok. dt. 12 janar 1420.

38) Skicoteca Etnografike, nr. inv. 72.

39) N. de Nicolai, *Le navigazioni et viaggi nella Turchia*, Anversa 1577, f. 326 që paraqet një fisnik grek.



Fig. 3 — Portret i Skënderbeut i veshur me gëzof («pelandë») (autor i panjohur). a) foto

edhe e gjelbra ishte ngjyrë e nderuar. P.sh. konti Niketë i Arbërisë përmendet më 1410 i veshur me rrobe të purpurta,⁴⁰ ndërsa Gjergj Jura (më 1422) me rrobe të gjelbra.⁴¹

Në çerekun e parë të shekullit XV janë mbajtur ende një lloj pelerinash në formë hlamide. Kështu në një dokument të vitit 1403 përmenden dy pelerina të tilla, së bashku me dy kapuçë të Demetër Jonimës dhe një pelerinë e një kapuç të Gjergj Dukagjinit.⁴² Këto pelerina cohe në formë hlamide, të dubluara shumë herë me astar dhe të zbukuruar e të përforcuara anëve me kordonë e shirita ari, duket se ishin pjesë të zakonshme në veshjen e fisnikëve shqiptarë të kohës. Pamja e tyre e jashtme madje kishte diçka specifike që i dallonte nga hlamidet e vendeve të tjera, sepse në doku-



b) skiçë e pletësuar për gjithë trupin.

mentet thuhet shprehimisht se ato ishin «sipas mënyrës së shqiptarëve» (ad modum

40) «Dokumenta të shek. XV», dok. 127 dt. 15 korrik 1410.

41) Po aty, dok. dt. 4 Tetor 1422.

42) «Acta et diplomata...» Vol. II, dok. 725 dhe 726 dt. 5 maj 1405.

Albanesibus) ose «sipas zakonit të tyre» (secundum eorum ritum).⁴³

Së fundi do të përmendim për këtë shekull një shënim të shkurtër nga një dokument i vitit 1467, ku flitet për një vasal të Arianitëve në tokat përqark Qukësit e Bërzeshitës (rrethi i Librazhdit), të quajtur Ilija Bosi, të cilit i jepen si dhuratë nga ana e Venedikut «një petk kadifeje sipas mënyrës së tij» (Item Illustrissimus Helyas Induatur una veste veluti more suo)⁴⁴, pra me një prerje të ndryshme nga ajo e veshjeve të Venedikut.

Pra gjatë shekullit të XV zbehet sa vjen më shumë ndikimi bizantin në formën dhe prerjen e veshjeve, por ai ndihet ende i fortë në preferencën për disa ngjyra të konsakruara (si ishin e kuqja, e gjelbra, manushaqja), në qendisjet me ar e zbukurimet e tjera të rënduara, në mëngët me llapa të zgjatura përtej dorës e në të tjera karakteristika, të cilat si do ta shohim më tej arrijnë të lenë disa gjurmë edhe në veshjet popullore të shekujve të mëvonshëm.

Dëshmi të veshjes së shek. XV gjejmë edhe në diasporën shqiptare, sepse shumë nga këto koloni janë themeluar pikërisht në këtë shekull. Në to gjejmë veshjen me fustanellë për burra dhe atë tip veshjeje për gra që përbëhet nga një këmishë e gjatë pëlhere (e zbukuruar me qendisje jo vetëm për fundi, por edhe te jaka, gjoksi, supet e mëngët), mbi të cilën vishej një lloj xhoke prej shajaku a cohe, e gjatë gjer në gju dhe zakonisht pa mëngë. Për historinë e kostumeve tona kjo ka rëndësi se tregon se ky tip veshjeje, me element bazë

një këmishë të gjatë të zbukuruar, ekzistonte si i tillë që në kohën e Bizantit.⁴⁵

Ka edhe pjesë të tjera veshjeje të ruajtura tek arbëreshët e Italisë si *mendi*, ai mantel tradicional që përdorej në Piana degli Albanesi, *tabani*, një gunë barinjsh a *pelicuni*, lëkurçja a delesi, që përdornin barinjtë në Frasnitë (Kozencë),⁴⁶ të cilat ata duhet t'i kenë sjellë me vete që në kohën e emigrimit të tyre. Dihet mirë se në mesjetë lëkura e dhenve përdorej gjerësisht në veshje të cilat, në gjuhët neolatine perëndimore quheshin «peliçon» a «pelligon»⁴⁷ etj. prej ku, ka të ngjarë të ketë origjinën edhe fjala *pelicum* e arbëreshëve tanë. Një autor arbëresh e përshkruan «pelicunin» si një kapotë pa mëngë, e bërë me tri lëkura dhensh, një në mes e dy të tjera anëve⁴⁸. Një paraqitje figurative të këtij delesi mesjetar shohim tek veshja e bariut, në një afresk të kishës së Valshit (rrethi i Elbasanit), pikturuar rreth vitit 1554 nga piktori ynë i madh i këtij shekulli, Onufri⁴⁹ (Fig. 4), si edhe në një ikonë të Beratit. Një figurë analoge na sugjerojnë vargjet e një kënge të vjetër arbëreshe: një plak ligjëron me malet dhe u lutet ta përtërijnë vit për vit, si veten e tyre. Pastaj ai kujton se si kur ishte i ri, vinte shpatën në brez, pushkën në krah, shalonte kalin e merrte përppjetë malit. Ndërsa tani që është plakur s'i mbetet veç të varë kungullin në brez, dhe trastëzën krahaqafë, të marrë kërrabën në dorë dhe të shkojë derë më derë, duke lypur bukë e verë.⁵⁰ Sidoqoftë veshja e bariut të Onufrit meriton një vëmendje të veçantë, sepse dësh-

43) Është fjala për një dokument të datuar 4 prill 1423 (shih «Dokumenta të shek. XV, dok. nr. 565»), ku bëhet fjalë për 50 pelerina (L clamides secundum eorum ritum), të sjella nga Venediku për Pastroviqët, dhe për një dokument tjetër të po atij viti, ku thuhet se Senati merr vendim që dy pamaliotëve të dërguar në Venedik për çështje të ndryshme të vendit të tyre, t'u jepej si dhuratë «una clamis pro quolibet, dupla cum cordonis et doplonibus aureis ad modum Albanesibus», shih A.S.V. Del Mistre. Sen LIV/102 103, dt. 1423, 30 prill. (Sipas një shënimi që pati mirësinë të ma japë I. Zamputi).

44) Dh.S. Shuteriqi: *Dy dokumente të kohës së Skënderbeut*, gaz. «Drita», Tiranë, 1965, 24 janar.

45) M. Roussel de Fontanés: *Les costumes traditionnels calabrais*, «Objets et Mondes», Tome III, fasc. I, Paris 1963, f. 79.

46) E. Giordano, *Fjalor i Arbëreshëve të Italisë*, Bari 1963 (shih zërat përkatës).

47) M. Leloir, *Dictionnaire du Costume*, Paris 1961 (Zëri: Agneau).

48) «Kapot pa mëng, i bën me tri lëkur dhensh: një në mest e një kanjan e kanjetër» shih H.B. Frasnjoti, *La pastorizia a Frascineto*, Tradizioni popolari albanesi della Calabria, Roma 1964.

49) V. Puzanova, *Piktori shqiptar i shekullit të XVI, Onufri nga Neokastra (Elbasani)*, «Buletin për shkencat shoqërore» Tiranë, 1953, 3, f. 16.

50) *Dorëshkrimi i Chieutit, viti 1737*, në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar», vëll. II, Tiranë, 1961, f. 24.



Fig. 4 — Veshje bariu në një afresk të Onufrit në Kishën e Shelcanit shek. XVI (rr. Elbasan).

mitë e këtij lloji, sidomos për njerëz nga masat e gjera fshatare, janë të rralla në këtë periudhë. Ky bari mban një veshje të bërë prej lëkure dhensh, nën të cilën duhet të ketë një këmishë po kjo nuk duket. Kjo veshje prej lëkure është e gjatë gjer mbi gju, e hapur përpara, me mëngë të shkurtra deri në bërryl dhe e ngjeshur për mezi me një brez të ngushtë, tek i cili varet anash një kungull uji. Në njerën dorë ka një kërrabë. Në këmbë ka një lloj çorape ose çizme prej shajaku, të gjata pothuaj deri në pulpë. Ai është paraqitur me mjekër, mustaqe e flokë të gjatë. Kapela e tij është shumë karakteristike: ajo ka formën e një kalote shumë të lartë, me strehë anëve. Atë e shohim edhe në dy portrete shenjtorësh në kishën e Shën Mëhillit në Berat. Kjo lloj kapele bëhet shumë e njohur në Evropën Perëndimore, sidomos në shekujt

XVI-XVII, ndoshta si një ndikim i veshjes së stradiotëve shqiptarë të kohës. E gjejmë të përmendur disa herë nga shkrimtari i njohur freng i shek. XVI Fransua Rabele në veprën e tij «Gargantya dhe Pantagryel» me fjalët «kapelë shqiptare», përdorur si një term krahasimi për të treguar një të dalë shumë të theksuar.⁵¹ Kurse më vonë, një ribotues freng i veprës së Nikolait, Mezerai, (Mezeray), për po këtë figurë thotë: në kokë ai mban një lloj kapele të zeze sipas modës shqiptare (*une sorte de chapeau noir à l'albanaise*) dhe si e tillë përmendet ajo edhe në burime të tjera të mëvonshme.⁵²

Një kapelë të tillë të lartë mban në kokë edhe bujari shqiptar (Epiroti) i paraqitur në një gravurë të vitit 1581,⁵³ (fig. 5). Ai



Fig. 5 — Veshje e një fisniku shqiptar të vitit 1581 (sipas J. J. Boissard «Habitus variarum orbis gentium».

51) F. Rabelais, *Gargantua et Pantagruel*, Livre IV, Chap. XXX: Le mirach comme un chapeau Albanois»; Livre IV Chap. XXXII: á haute bonnets, comme Albanois» etj.

52) Shih A. Gjergji, *Të dhëna mbi veshjet në Shqipëri në shekujt XIV-XVI*, «Studime Historike» 1967, 4 f. 188-189.

53) J.J. Boissard, *Habitus variarum orbis gentium*, 1581, fig. 34.

është i veshur me një rrobe të gjatë gjer në fund të këmbëve, të mbyllur mirë përpara me kopsa të vogla. Kjo rrobe ka mëngë të gjata e të ngushta dhe është e ngjeshur për mezi me një shall të gjatë të mëndafshhtë. Mbi të ai ka hedhur supeve mantelin e tij të gjatë në formë pelerine. Kjo veshje duket se mbahej edhe në fillim të shekullit XVI, sepse pak a shumë kështu do ta përfytyronim të veshur, që në vitin 1501, bujarin shqiptar Kostandin Komnen Ariani, nga ai përshkrim i shkurtër, që na jepet në një dokument të këtij viti: «Ishte i veshur me një xibun të artë e sipër një petk mëndafshi ngjyrë manushaqe, kësulë (barete) kadifeje e një gjerdhan të trashë në qafë, flokët e zes; është i madh me shtat të hijshëm...»⁵⁴ Kjo, me sa duket ishte veshja e bujarëve të krishterë të kohës edhe në vende të tjera të Ballkanit, sepse me një veshje të tillë, është paraqitur në një monedhë të kohës Joan Vodà Çel Kumpulit, zot i Moldavisë në vitet 1572-1574⁵⁵ dhe shumë të krishterë ballkanas në Konstandinopol, si na dëshmojnë vizatimet e N. Nikolait.⁵⁶

Disa përshkrime të shkurtra kemi edhe për veshjen e grave të arbëreshët e Italisë (Krotone, Kalabri), të dhëna nga G. Marafioti. Ai thotë: «Gratë arbëreshe mbajnë veshje (pëlhurash) të ashpra, nga mezi e poshtë — (me sa duket, prej pëlhure të punuar vetë, A. Gj.) — kurse nga mezi e lart veshja e tyre është prej cohe, me ngjyra të ndryshme, sepse pjesën e sipërme të rrobës e bëjnë me rripa lloj-lloj ngjyrash, të qepur njeri mbas tjetrit; opingat e tyre nuk janë me lëkurë të butë por me lëkurë të ashpër, si ato që mbajnë burrat; nusët e reja — vazhdon autori — mbajnë, si për bukuri, mëngë të mëndafshhta, të lidhura (te supi, A. Gj.) me rripa (kordele) ngjyrash të ndryshme».⁵⁷ Ky përshkrim i veshjes së grave arbëreshe të Krotones të kujton menjëherë një veshje gruaje tjetër arbëreshe të paraqitur në një gravurë që ndoshta i përket shekullit XIX. (fig. 6).⁵⁸ Marafioti



Fig. 6 — Veshje gruaje arbëreshe në një stampë të vjetër (sipas L. Russu).

thotë se arbëreshët në Krotone ishin të shumtë, ata jetonin në vise malore, nuk u nënshtroheshin feudalëve të vendit dhe midis tyre nuk kishte bujarë.

Në vitin 1596 përmenden dhjetëmijë luftëtarë himariotë nën udhëheqjen e Atanasit, mitropolitit ortodoks të Ohrit, të cilët ishin gjithmonë të veshur me kostumet e tyre në ngjyrë të kuqe⁵⁹. Këtu duhet të jetë fjala për mëngoret e tyre të kuqe, sepse që në vitin 1504, flitet në një dokument për xhamadanët prej kadifeje të kuqe me astar cohe të gjelbër, që u përkasin dy stradiotëve

54) M. Sanudo, III, 1381. Viti 1501. «Vene il signor Constatin Comino... veludo e una colladona al collo grossa, capelli negri; é grande bella statura...» (Për këtë informatë falënderoj I. Zamputin).

55) Shih A. Alexianu, *Mode si vesminte din trecut*, Bucuresti 1971, vëll. I, f. 139, 157-158, 215-216 dhe fig. 139.

56) N. de Nicolai, po atje.

57) G. Marafioti, *Croniche et antichità di Calabria*, Padova 1601, f. 273-274. Botimi i parë i kësaj vepre është bërë në Napoli më 1596.

58) Shih L. Russo, *Gli Albanesi d'Italia*, Palermo 1975, fig. XVIII.

59) M. Shuflai, *Sërbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë 1969, f. 158.

shqiptarë Reposh dhe Dedë Busukit.⁶⁰ Duket se kjo lloj veshjeje e shqiptarëve ishte bërë shumë e njohur në Evropë në shek. XVI, përderisa dramaturgu i njohur englez E. Spenseri (1552-1599) në veprën e tij «Faerie Queen» (III, XII, 10) i quan «të modës shqiptare» xhamadanët me mëngë të hapura e të varura prapa (sleeves dependent Albanese-wise)⁶¹. Shtojmë se Spenseri përmend edhe një gunë të modës shqiptare: «huge capoto albanese-wise».

Një tip tjetër veshjeje popullore në këtë shekull (përveç bariut të Onufrit) e kemi në një afresk të vitit 1576,⁶² ku është paraqitur ktitori i ulur në gjunjë. Ai me sa duket ka veshur një këmishë të gjatë me mëngë, sipër së cilës ka një lloj kaporane me mëngë të shkurtra, që të kujton kaporanet e Lumës a xhurditë e Tiranës. Në kokë ai mban një takije të bardhë të ngjashme me ato të Myzeqesë (fig. 7).

Kështu deri në fund të shekullit XV zhvillimi i veshjes eci i pandërprerë. Veshja e fisnikëve vazhdoi të zhvillohet jo vetëm nën ndikimin e traditës bizantine, por edhe nën ndikimin perëndimor, që hynte tek ne kryesisht nëpërmjet marrëdhënieve me qytetet italiane.

Nuk duhet harruar se shumë nga familjet bujare të kohës, si Balshajt, Zaharijat, Dukagjinët, Jonimët, Topiajt, Gropajt, Arianitët, Muzakët, Kastriotët etj. në shek. XV ishin përzierë midis tyre me lidhje të shumëfishta gjaku e krushqie. Shumë prej tyre kishin të tilla lidhje edhe me dinastitë e mëdha të kohës si Paleologët, Asienët, Anzhuinët, despotët e Janinës dhe me gjithë aristokracinë serbe, kroate e bosnjake, pra e mbanin veten të barabartë jo vetëm me ta, por edhe me bujarët e Italisë të Jugut.

Këto familje fisnikësh kishin secila oborrin e vet ku vërtiteshin një varg zotërinjsh e bujarësh, kancelarësh, qefalinjsh e vojvodësh të rangjeve të ndryshme, si edhe një mori kalorësish, lajmëtarësh e shërbëtorësh.

Kjo bujari, nga kontakti me fisnikët e



Fig. 7 — Veshje burri sipas një afreske të vitit 1586 (Ktitori i Dhërmiut) sipas Coronelli-t.

perëndimit, përpiquej të jetonte e të zbavitej si ata. «Për një kohë shumë të gjatë — thotë Shuflai — bujaria dhe zotërinjt e hinterlandit, kishin zakon të shkonin në Durrës, shumë herë në vit, për punët e veta e për dëfrim (pro suis factis vel pro place-re)». Në një marrëveshje midis Anzhuinëve e despotit shqiptar Andrea II Muzaka (në vitin 1336) u jepej anëtarëve të kësaj familjeje liri që të vinin në Durrës sa herë dëshironin, dhe ata mbetën deri në shpërnguljen e tyre në Itali (në vitin 1476) në raporte miqësore me familjet fisnike të Durrësit⁶³. Këto lidhje miqësie që favorizonin shtrirjen e modës venedikase në gjithë mënyrën e jetesës, duket se vazhdonin edhe në she-

60) G. Sathas, *Strat. Doc. CXLIII*, f. 75 (casacha una per cadaun de veludo cremexin, fodrada de pano verde fino).

61) Cituar sipas H. Hobheuse, *A. Journey through Albania and other provinces.... during the years 1809-1810*, London 1813, f. 134.

62) Afresku në fjalë ndodhet në kishën Panaia të fshatit Dhërmi, rrethi i Vlorës.

kullin XVI⁶⁴. Nën ndikimin perëndimor, e sidomos të Anzhuinëve, fisnikët e vendit tonë fillojnë të përdorin edhe stemat e vullat dhe të hartojnë gjenealogjitë e tyre, — si bën për shembull Gjon Muzaka — kryesisht për të konsakruar origjinën e tyre të lartë dhe për t'u treguar pinjovje pasardhës pronat e tyre. Tradita e shkruar e kohës i lavdëron shumë herë këta fisnikë edhe për bukurinë trupore të tyre. Burra shtatlartë e të pashëm na i përshkruan humanisti shqiptar Marin Barleti shumë përfaqësues të Kastriotëve, Topiajve, Ariantëve etj.

Sidoqoftë, përsa i përket veshjes në veçanti, dokumentet që kemi parashtruar më lart, vënë mirë në dukje se në veshjen e burrave të kësaj kohe, disa pjesë përmenden si tipike shqiptare. Të tillë janë xhamadanët me mëngë të lëshuara prapa, kapotat e rënda prej shajaku, pelerinat e kuqe në formë hlamide, kapelat e larta e me strehë etj. Kjo tregon se veshjet shqiptare në këtë shekull gëzonin një popullaritet të gjerë në shumë vende të Evropës. Në disa vepra letrarësh të shquar të kohës, në gravura e vizatime, në dokumente arkivale etj. flitet shprehimisht për veshje të «modës shqiptare». Ky fakt nuk mund të mos vihet në lidhje me jehonën e gjerë të luftës së madhe të popullit shqiptar kundër pushtuesve osmanë, luftë e cila bëri që trimëria le gjendare e shqiptarëve të ngjallte interesimin dhe admirimin e gjithë Evropës. Pa dyshim përhapja e këtyre elementeve të veshjes u detyrohet edhe stradiotëve shqiptarë, atyre ushtarëve të kohës, që angazhoheshin në shumë vende të Evropës (Francë, Spanjë, Vendet e Ulëta, Mbretëria e Napolit etj.), të cilët gëzonin një famë të merituar për cilësitë e tyre të larta luftarake. Si dihet ata shkonin me pajisjet e veta (armë, kuaj, veshmbathje) dhe shtegtimitet e tyre, me sa duket, janë ato që e bënë të njohur nëpër Evropë kostumin me fustanellë.

Në të dhënat e këtyre shekujve vemë re se përmenden disa tipa veshjesh, ndër të cilat veshja me këmishë të gjatë, veshja me brekesha e veshja me fustanellë, si kos-

tume për burra, dhe veshja me këmishë të gjatë e xhokë, për gra. Dëshmohet përdorimi në këta shekuj edhe për disa pjesë të veçanta që janë: delesi a gozhupi, tallagania a pelerina, kaporania, kapela e lartë me strehë, takija, opingat, si edhe pjesët përbërëse të kostumeve që zumë në gojë më lart.

Vendi ka rënë tashmë nën pushtimin turk që do të zgjasë disa shekuj. Shtypja e masave të gjera fshatare nga feudalizmi turk ishte e ashpër. Ky pushtim jo vetëm që shkatërroi shumë vlera kulturore të arritura gjer atëherë, por pengoi edhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik e kulturor të vendit. Në këto kushte të reja shoqërore filloi të ndërrojë edhe pamja e veshjes, sidomos me islamizimin e parisë vendase. Për këto ndryshime do të flasim më poshtë.

2. - VESHJA NË SHEKUJT XVII-XVIII

a) Veshjet shqiptare përballë ndikimit oriental.

Pas një rënieje të theksuar të jetës qytetare gjatë shekullit XVI, që erdhi si pasojë e pushtimit osman, që shkatërroi shumë qytete, sidomos në veri të vendit, u shtrënguan të largohen edhe shtresa të gjera zejtarësh. Por në fund të shekullit XVI, e sidomos gjatë shekullit XVII, vihet re një rigjallërim i qendrave qytetare.

Dokumentet tregojnë se rreth mesit të shekullit XVII qytetet më të mëdha ishin: Elbasani, Prizreni, Berati, Shkodra, Prishtina, Gjirokastra etj. Si qytete më të vogla numëroheshin Vlora, Ulqini, Kruja, Gjakova, Lezha, Pogradeci, Kavaja etj.⁶⁵

Në shekullin XVII pothuaj dy të tretat e popullsisë qytetare që përfaqësonin jo më shumë se 3-7% të popullsisë së përgjithshme të vendit në atë kohë, ishin kthyer në fenë myslimane, si pasojë e politikës së

63) M. Shuflai, vepër e cit. f. 104.

64) Kështu kordhëtari shqiptar nga Janina, Zot Cigara, i cili martohet më 1587 me Marian, të bijën e Pjetrit, vojvod i Moldavisë dhe vdes më 1599 në Venedik, ndiqte në veshje krejtësisht modën perëndimore, po të gjykojmë simbas një gravure të kohës, të punuar nga Antonio Bosio (Shih A. Alexianu, *Mode si vesmintë din trecut*, Bucuresti 1971, Vol. I, f. 225, fig. 143).

65) Shih: Z. Shkodra. *Esnafët shqiptarë*, Akademia e Shkencave e RPSH, Tiranë, 1973, f. 46.

rëndë fiskale, e propagandës dhe e masave të forta diskriminuese që ndiqte qeveria turke.

Edhe vetë pamja e qyteteve po merrte gjithnjë e më shumë tipare orientale disi të ballkanizuara që pasqyroheshin në urbanistikën dhe arkitekturën e kohës. Objekte tipike të kultit mysliman, si tyrbet, xhamitë, hamamet, namazgjahet, varret brenda lagjeve, po dukeshin shpesh në qytetet tona.

Këto ndryshime u shtrinë dalngadalë edhe në veshjen qytetare të pjesës së myslimanizuar, e sidomos në parinë e shtresat e larta, të cilat filluan të ndjekin modën orientale në veshje.

Dihet se nga të gjitha format e kulturës materiale, veshja është ajo që përhapet me lehtësinë më të madhe. Moda ka qenë dhe është si një kontaminim i vërtetë, që përhapet në mënyrë spontane, me anë të imitimit. Sepse ajo është një shfaqje e jashtme që kapet lehtë. Megjithatë, duke pasur parasysh se kontakti midis dy kulturave në fjalë ishte pasojë e një pushtimi të egër që erdhi mbas luftërash të gjata e të përgjakshme dhe jo në rrugë paqësore, shohim se gjatë shekullit XVII tiparet e veshjes qytetare të shtresave të larta e të mesme, ende lëkundën midis lindjes e perëndimit.

Të dhënat që disponojmë për veshjet në këtë shekull janë ende fare të pakta e të pamjaftueshme për të krijuar një përfytyrim të plotë të gjendjes. Nga një dokument i viteve 1647-1649⁶⁶ mësojmë se në qytetet Elbasan, Berat e Korçë, në këtë kohë përdoreshin disa lloje stofrash të shtrenjta, të importuara nga Venediku dhe të cilësuar me emrat: pirango, ska(r)lato, meneviz (ose romeneviz), koskorel ose moralso, arqimadho, stof i gjelbër, korelo (ngjyrë koral) e jargavan. Meqë këto stofra shiteshin me çmime shumë të larta (140-170 aspra krahu), nënkuptohet se ato destinoheshin kryesisht për shtresën tregtare e sidomos për klasën feudale, që përpiqej të jetonte tashmë me luksin e shkëlqimin e modës orientale. Ato ishin stofat më të përdorura në këtë kohë edhe në parinë e gjithë qyteteve të bregdetit dalmatin.

Një raport i vitit 1699⁶⁷ na tregon se tregtarët e skelës së Durrësit sillnin çdo vit

1500 topa cohë të Venedikut (draps de Venise), të punuar posaçërisht për Shqipërinë, 300 topa stofra londrine, 5-6 arka pëlhurë mëndafshi etj.

Stofrat londrine silleshin me shkëmbim, 3 krahë londrin kundrejt 1 kv. lesh të rudë. Si dihet londrinet fabrikoheshin në fillim në Angli, prej ku morën emrin, por më vonë edhe në Francë.

Industria e përpunimit të leshit u inkurajua në Venedik në shekujt XVII-XVIII. Tregtarët venedikas kërkonin shumë leshin e Shkodrës, të cilin e transportonin vetë dhe me të prodhoheshin cohëra të cilësisë së parë nëpër fabrikat e ngritura në qytete të ndryshme, si në Padova, Vinçenca, Verona, Bosano, Skio, (Schio), Foline (Folline), të cilat pastaj shiteshin me përfitim të madh në skelat e ndryshme të Shqipërisë. Më të kërkuara ishin stofrat e përmendura «londrine» e pastaj stofra të tjera si ishte saja «parangone» si edhe kadifeja e mëndafshi etj. Këto stofra importoheshin në Shqipëri në sasi të mëdha që arrinin në disa mijëra topa (pezze) në vit.⁶⁸

Dimë më anë tjetër se në këtë shekull pothuaj në të gjitha qytetet kryesore të vendit, punonin një numër i mirë rrobaqepësish dhe zejtarësh të tjerë, që prodhonin artikuj të ndryshëm veshmbathjeje ose aksesore të veshjes. P.sh. në Elbasan, në gjysmën e parë të shekullit XVII kishte 36 takijehinj, 34 regjes lëkurash, 27 kazazë a mëndafshpunues, 27 papuxhinj, 17 rrobaqepës (terzinj), 14 pashmakçinj, 13 argjendarë, 12 qyrkçinj a gëzoftarë, 3 leshpunues (çullha), 2 xhybexhinj, 2 shajakpunues e 1 xhokaxhi.⁶⁹ Një xhokaxhi i këtij shekulli ka qenë edhe Nikodemi i ri nga Vithkuqi (rrethi i Korçës), i vrarë në Berat më 1714. Pra popullsia e qytetit kishte kërkesa të vazhdueshme për prodhimet e këtyre zejtarëve. Bile vetë ndarja në specializime të ngushta brenda së njëjtës mjeshhtëri tregon se kërkesat e blerësve ishin të shumta dhe të ndara deri-diku sipas shtresave shoqërore. Le të vëmë re p.sh. se krahas terzinjve e xhybexhinjve, në tregun e Elbasanit kishte edhe shajakpunues e xhokaxhinj.

Në grupin e zejeve artistike në këtë kohë u dallua edhe argjendaria. Argjendarët

66) S. Naçi, *Të dhëna mbi Shqipërinë e mesme e të jugut, sipas një dokumenti të shek. XVII*, në «Buletin për Shkenca Shoqërore», 1957, 2, f. 222-234.

67) Shih F.C. Pouqueville, *Voyage de la Grèce*, Paris, 1826, vëll. II, f. 419.

68) G.A. Morana, *Saggio dei commerciali rapporti della Venezia con Durazo ed Albania*, Venezia 1816, f. 42-49.

69) Shih për këto Z. Shkodra, vepra e cit. f. 62.

e Shkodrës, Elbasanit, Prizrenit, Beratit etj. prodhonin shumë stoli që plotësonin veshjen. Të tilla ishin vëthët, byzylykët, gjerdanët, qostekët, unazat etj. prej ari e argjendi, të cilat kërkoheshin në gjithë vendin.⁷⁰

Udhëtari turk i shekullit XVII Evlia Çelebi thotë se në tregun e Beratit, dy nga qendrat më kryesore ishin tregu i mestexhinjve dhe ai i tabakëve (regjësve) dhe ndër esnafët e këtij qyteti përmend ata të qendistarëve, argjendarëve etj. Për tregun e Peqinit ai thotë se kishte shumë këpuçarë. Me ato shprehjet e veta emfatike, që janë karakteristike për këtë autor, ai lavdëron shumë punën e qendistarëve në Elbasan, po ashtu edhe kazazët e armëtarët. Ditën e tregut qyteti i Elbasanit duket se merrte gjallëri të madhe. «Çdo të dielë në Elbasan bëhet tregu publik dhe mblidhet popull me shumicë, të vegjël e të mëdhenj, gra e burra, të ardhur nga krahinat, katundet, qytetet, e fortesat që janë në kufi. Në tregun e këtij qyteti gjendet çdo gjë e çmueshme, si brilante e diamante, pëlhura të mëndafshhta, grana e atllase e çdo lloj stofi. Populli vesh një xhybe edhe dyleme, lidh çallmë. Të rinjtë veshin një hirkë (peshli, xhamadan) të kuqe edhe tirq me komçe e këpuçë.⁷¹ Kurse në një vend tjetër të veprës së tij «Udhëpërshkrimet», Evlia Çelebi thotë: Banorët e Vuçiternës mbajnë cohë, qyrk dhe fes të kuq me shall perqark, ngjeshin xhokë e në xhokë mbajnë thikën. Mbajnë tirq të ngushtë, të kuq, me sumbulla argjendi dhe në këmbë papuçe «kabadije». Dhe më poshtë: (Banorët e Shkupit) janë në zë për disa prodhime tekstili të punuara me dorë...⁷²

Lidhjet tregtare përbrenda vendit ishin mjaft të rregullta, sidomos në krahasim me shekullin e mëparshëm. Karvane të shumta transportonin mallra nga një qytet në tjetrin. Kështu p.sh. tregtarët e Elbasanit dërgonin mallra në Berat, Ohër, Strugë, etj., ata të Shkupit mbanin lidhje me Durrësin, Vlorën, etj.⁷³

Gjatë këtij shekulli tregtarët e vendit tonë mbanin shkëmbime të rregullta edhe me

vendet e tjera të Ballkanit dhe merrnin pjesë nëpër panairët që organizoheshin në këto vende, e që, si dihet, ishin kryesisht një vend takimi për tregtarët pjesëmarrës, ku bëheshin marrëveshje e lidheshin kontrata të reja. Kështu në gjysmën e dytë të shekullit XVII tregtarët shqiptarë i shohim të pranishëm në panairët e Plovdivit, Xhuma-Pazarit, Nevrokopit, Doljanit, Serresit e Mavronorosit. Ndonjëherë ata shkonin edhe në Itali në panairin e Sinigaljes. Në këtë kohë pra qarkullimi i mallrave ishte i rregullt jo vetëm me Selenikun, Sofjen, Perastin, Ishujt Jonianë, Buduen, por edhe me vende jashtë Ballkanit. Tregtarët e Prizrenit dërgonin lesh për të shitur në Gjermani, ata të Shkodrës dërgonin në Venedik, ndërsa elbasanasit mbanin lidhje me tregtarët e Romës e të Firencës, prej ku sillnin ndër të tjera artikuj të ndryshëm manufakture, kadife, pëlhura mëndafshi, pasqyra e qelqurina e artikuj të tjerë luksi që kërkoheshin nga aristokracia feudale e kohës, jo vetëm në qytetet tona, por edhe në qytetet e tjerë të Ballkanit.⁷⁴

Për sa i përket prodhimit vendës, si e kemi përmendur edhe për shekullin e XVI, brenda ekonomisë shtëpiake, këtu qe zhvilluar mjaft punimi i shajakut edhe për eksport, aq sa filloi të njihet edhe jashtë vendit me emrin «arnaut kebesi». Mjerisht, konkurrenca e huaj ia preu hovin më vonë.⁷⁵

Sidoqoftë edhe për këtë shekull të dhënat dokumentare tregojnë se dallimet klasore dukeshin qartë edhe në veshje. Relatori shqiptar Frang Bardhi, në një relacion të vitit 1637 thotë shprehimisht: «Qefalijt (krerët), mbajnë në mbërthejcën e grykës së xhamadanit (kamizolës), një sumbull argjendi të praruem, në madhësi të një molle mesatare, dhe kush asht ma i fuqishëm e ma i pasun mban dy sumbulla edhe tri po asi lloji e po në atë vend. Këta qefalij, që të njihen se janë qefalij, kur dalin për të udhëtuar e për të shkuar në ndonjë kuvend a për ndonjë festë, a në ndonjë panair, e lidhin kokën me një shami mëndafshi të qëndisur».⁷⁶ Këto na i dëshmon

70) Po atje.

71) «Burime të zgjedhura për Hist. e Shqip». vëll. III, f. 182.

72) Cituar sipas «Gjurmime albanologjike» V, Prishtinë 1977 f. 271-272.

73) «Burime të zgjedhura ejt.» vëll. III f. 62.

74) Po atje, f. 79-80.

75) Po atje, f. 60.

76) I. Zamputi, *Dukagjini dhe Pulti në gjysmën e parë të shekullit XVII*, «Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës» Seria Shkencat Shoqërore, 1959, 1, f. 18.

Bardhi për krahinën e Dukagjinit, por shfaqje të dallimeve klasore në veshje ekzistojnë pa dyshim edhe në krahina të tjera. Mjafton të kujtojmë këtu ato që na tregojnë një tjetër relator i këtij shekulli, Marin Bicci, i cili gjatë një udhëtimi të tij nëpër Shqipëri ka vizituar Mirditën në vitin 1610. Përshkrimi i tij tregon se burrat mirditas kishin në këtë kohë një veshje sa të thjeshtë aq dhe të varfër. Ata mbanin brekë të gjata pëlhere e mbi to një këmishë të gjatë. Ecnin këmbëzbathur ose mbanin opinga prej lëkure të paregjur. Por ishin të armatosur mirë me shqyta, topuza, shigjeta e shpata. Gratë e mbulonin trupin me një xhup (xhokë) të thjeshtë shajaku, i cili ishte pa mëngë; vetëm pak prej tyre kishin nën të një këmishë.⁷⁷ Por nëse në Mirditë, këmisha përdorej rrallë nga gratë, për shkak të varfërisë së madhe, në krahina të tjera këmisha e gjatë prej pëlhere ishte në përdorim të zakonshëm. P.sh. në një dokument të Sherisë së Elbasanit të vitit 1605, thuhet se për një këmishë vajze të rritur duheshin 12 kut pëlhurë.⁷⁸

Për çerekun e fundit të shek. XVII, të dhënat arkivale tregojnë se në qytetet tona veshjet e shtresave të pasura e të zanatçinjve e kishin ndier mjaft ndikimin e modës orientale, si tek myslimanët ashtu edhe tek të krishterët. Sipas shumë testamentesh, aktesh trashëgimi etj. të ruajtura nga Sheria e Beratit^{78/1} shihet se disa nga pëlhurat e stofrat e përdorura në këtë shekull, duke filluar nga më të lirat për të shkuar tek më të shtrenjtat, ishin: pëlhurë liri, beze, bokasin, astar, pushai, allaxha, cohë (piranogon, grizhë e kuqe, jeshile etj.), kumash (i kuq i qëndisur me tel), atllas (i verdhë), qemha me ngjyra të ndryshme (të kuqe, të verdhë, jeshile, qelallëk) etj.

Pjesët e veshjes për gra që përmenden në këto teste janë këmishë e të mbathura, fustane e funde, breza e peshtemalla, pastaj jelekë, mintanë, dolloma të ndryshme e vetëm në një rast çitjane; veshje të sipërme si kaftan, zibon, qyrdi, manto, ka-

banicë, qyrke e ferexhe të shtrenjta si edhe një varg mbulesash të kokës e të fytyrës si: mahramë, fes, burumllëk, buzubend dhe peçe. Gratë mbanin edhe shumë lloj zbu- kurimesh, veçanërisht ato të shtresave të pasura: vëthë, unaza e sumbulla argjendi, byzylkë, karfica e kurora flokësh, merxhane qafe, gjerdanë të kushtueshëm me florinj ose inxhi, breza argjendi etj.

Për burra gjithashtu përmenden një varg elementesh të veshjes si: këmishë e të mbathura, jelekë e mintanë, breza, kaftanë, dollakë, çakshirë gjunjësh e vetëm në një rast shallvare; pastaj toslukë, dizga, papuçe e çizme dhe si veshje të sipërme të kushtueshme, qyrke; për kokë përmenden takije e mahrama të ndryshme. Stolitë karakteristike për burrat në këtë kohë janë unazat, sumbullat e zinxhirët prej argjendi, por ata mbanin edhe armë të kushtueshme si shpata me dorëza argjendi, thika, pushkë etj.

Nga të paktat materiale figurative që na tregojnë forma veshjesh në këtë shekull, po përmendim dy skica, që paraqesin një burrë e një grua epirote, në një vepër të Koronelit botuar më 1676⁷⁹. Veshja e burrit epirot është një përzierje elementesh vendase me ato orientale (fig. 8). Ai ka në kokë një «kapelë shqiptare», si ato që kemi përmendur për shekullin XVI, por të zbukuruar me një pendë, çizme të shkurtra si ato të bariut të Onufrit (shih fig. 4), poture të gjera, mintan me mëngë të gjata një kapotë të gjatë me mëngë të shkurtra, si edhe armët e kohës: topuzin, shpatën e harkuar dhe shigjetat.

Gruaja epirote e Koronelit ka veshur një këmishë të gjatë, mbi të një mintan me mëngë të gjata, si të burrit, një kapotë me po ato mëngë të shkurtra përmbi bërryl dhe një mbulesë koke shumë të veçantë (fig. 9).

Në këtë shekull, si kudo në Ballkan, edhe tek ne, kanë hyrë në përdorim disa fjalë turke që tregojnë elemente të veshjes orientale si ferexhe, gjurdi, çakshirë etj. Madje sipas dëshmisë së qartë të Buzukut,

77) «Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shekullin XVII». Teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi, redaktor përgjegjës Prof. Aleks Buda. Vëll. I (1610-1634). Botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1963, f. 160-161 (Relacioni i arqipeshkvit të Tivarit, Marin Bicci, viti 1610).

78) Arkivi Shtetëror, Tiranë, Dok. Nr. 707 505, Sixhili i Sherisë së Elbasanit, Kap. II, Akti 32, dt. Shkurt 1605.

78/1) Arkivi Qëndror Historik i RPSSH, Sheria e Beratit, Dosja 15 Libri 61 b; Dosja 16 Libri 28 b; Dosja 21 Libri 57 b.

79) *Citta, fortezze ed altri luoghi principali dell'Albania, Epiro e Livadia*, Venezia, 1676, fig. 65.



Fig. 8. — Një luftëtar epirot i vitit 1676 (sipas Coronelli-t).



Fig. 9 — Grua epirote e vitit 1676 (sipas Coronelli-t).

kemi edhe fjalë turke të sferës së veshjeve që kanë hyrë që në shekullin XVI si është fjala «cohë» për të treguar një stof të lehtë, të butë, por edhe një petk stofi për gra (kuptim me të cilin kjo fjalë përdoret dhe në arbëreshët e Italisë), dhe fjala «dolloma» ose «dollamë» në kuptimin e një manteli prej cohe, fjalë të cilat sipas Prof. E. Çabejt janë nga më të parat huazime turke të shqipes⁸⁰. Me kohë disa nga këto fjalë turke filluan të përdoren edhe për të emërtuar elemente të përngjashme të veshjeve popullore vendase, emri i vjetër i të cilave u mënjanua pak nga pak e filloi të lihet në harresë. Kështu ndodhi p.sh. që fjala «çakçirë» (ose çakshirë) në përdorimin e sotëm të popullit, nuk u përgjigjet çakçirëve origjinalë të modës turke, por tirqeve të vjetra vendëse, po ashtu shallvare për brekushe etj.

b) **Zejtaria vendase për veshjet popullore në shek. XVIII. Luksi orientali i aristokracisë qytetare.**

Në shekullin e XVIII një numër i mirë veshjesh të modës së Stambollit zënë vend gjithnjë e më shumë në garderobën e fisnikëve tanë dhe të shtresave të tjera të myslimanizuara të vendit. Ato janë përgjithësisht veshje të rënda e të kushtueshme, jo vetëm nga stofrat e çmuara që përdoren, por edhe nga zbukurimet që kanë me gëzofra të shtrenjtë, çapraze, gajtanë e shirita ari e të tjera zbukurime. Këto veshje nuk janë një notë e veçantë për vendin tonë, ato kanë marrë tashmë një qarkullim ballkanik, si rrezatime të modës së kryeqytetit të Perandorisë Turke dhe i sheh në të gjitha qytetet e rëndësishme të Ballkanit si në veshjen e burrave, ashtu edhe në atë të grave. Pjesë veshjeje të kësaj kategorie të

80) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, II dhe III. Buletini U.S.H. të Tiranës, 1961; nr. 1 f. 66 (për fjalën «cohë» dhe nr. 2 f. 67-68 (për fjalën «dollama»).

përdorura në këtë shekull janë mintanët, dollomatë, zibonet (a cibunët), anteritë e gjata, kaftanët, libadet, xhybet, kondoshët, binishët, qyrket, degërmitë, mahramat, mes-tet, jemenijet etj. Në testamente të vitit 1701 përmenden edhe shallvare e çakshire (pantallona të gjera cohe, me prerje orientale).

Shumë prej këtyre veshjeve, edhe pse konfeksionoheshin me stofra të importuara si nga vendet e Lindjes, ashtu edhe nga Venediku e vende të tjera të Evropës, qepeshin nga mjeshtrit rrobaqepës të vendit, duke ndjekur prerjet e modës sipas modeleve të ardhura krejtësisht nga Stambolli.

Dokumentet e kohës tregojnë se në këtë shekull kishte rifilluar tregtia e Shkodrës me Venedikun, porse në tregun e këtij qyteti tashmë vinin mallra të importuara dhe nga qendra të tjera të Italisë si Ankona, Trieshti etj. Kurse tregtarët e Voskopojës në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, i ndërpresin shkëmbimet me Venedikun dhe fillojnë të punojnë me Vjenën e Budapestin.⁸¹

Për historinë e kostumeve është me interes të dimë se ç'loje stofash importoheshin për veshje. Sipas një raporti të konsullit venedikas, La Fontana, në vitin 1769, në skelën e Shkodrës vinin: cohëra, pëlhura mëndafshi, damask, stofa të holla të endura me fije ari e argjendi.⁸²

Konsulli venedikas në Durrës, A. Bartoloviç, në një raport të vitit 1762 thotë se prej Ankone, janë çuar në Durrës «cohëra londrine ngjyrë rubini dhe zendale të zeza, që shërbejnë për përdorimin e këtij kombi dhe që shkojnë e tregtohen në Rumeli, sepse pranohen me ëndje dhe çmohen ato cohëra dhe zendale, të parat për veshjet e grave dhe të dytat për shiritat e festeve të këtyre shqiptarëve.»⁸³

Nga Venediku vinin në Shqipëri mallra jo vetëm për tregtarët e Shkodrës, por edhe

për tregtarë të tjerë nga Tirana, Kruja, Elbasani, Kavaja e Berati, pra furnizonin një pjesë të mirë të Shqipërisë. Kjo tregti thotë dokumenti i përmendur më lart «përmbahet në cohëra qoftë Venedike ose të mënyrës së Francës, në kadife e të tjera manufatura ari e mëndafshi.⁸⁴

Cohëra, kadife e brokarte importoheshin në vitin 1769 edhe me anë të Durrësit.⁸⁵

Edhe në këtë shekull përmenden në shumë qytete esnafa të forta mjeshtrish që përgatishnin artikuj të shumtë veshmbathjeje. Kështu në vitin 1736 dy esnafet më të forta në Shkodër ishin ai i lëkurëregjësve dhe ai i terzinjve⁸⁶, në vitin 1738 në qytetin e Korçës ekzistonin esnafa lëkurëregjësish, opingarësh, papuxhinjsh, terzinjsh e qyrkçinjsh.⁸⁷ Mjeshtër rrobaqepës me esnafet e tyre përmenden në këtë kohë (1754) edhe në Llëngë, në Voskopojë e në Shpëskë, krahas këpucarëve e mjeshtërve të tjerë.⁸⁸ Pra kemi arsye të mendojmë se fakti që këta zejtarë, të cilët përgatishnin artikuj të ndryshëm veshmbathjeje, ishin shtuar shumë në krahasim me shekujt e mëparshëm, tregon se punimet e tyre i kërkonte e i blente një klientelë gjithnjë e më e gjerë, që përfshinte jo vetëm shtresat e larta e të mesme të shoqërisë qytetare, por në disa raste edhe një pjesë të mirë të popullsisë fshatare. Kjo do të thotë se për këto shtresa, përgatitja e veshjes kishte filluar, që për disa artikuj, të delte tashmë nga kuadri i ekonomisë së mbyllur shtëpiake.

Veshjet e modës turke i ndeshim në radhë të parë në aristokracinë e kohës, si shtresa shoqërore më e hapur ndaj ndikimit të huaj dhe që, për vetë pozitën e saj, ishte në kontakte më të shpeshta me shoqërinë e mënyrën e jetesës së Stambollit e të qendrave të tjera të rëndësishme të Perando-

81) S. Naçi, *Rreth tregtisë së sanxhakut të Shkodrës me Republikën e Venedikut gjatë shek. të XVIII*, USHT, Shkencat Shoqërore, Tiranë 1963, nr. 1, f. 32-33.

82) Po aty, «pani seda lavorata, damaschetii, drappi leggeri d'oro e d'argento».

83) *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, Tiranë 1962, vëll. III, f. 249. (Zendali (ose sandali) ishte një lloj pëlhure e hollë, orientale, e mëndafshët, që përdorej për astar. — A. Gj.)

84) Po aty, f. 251 (me sa duket është fjala për ato «draps de Venise» që përmenden që në shek. e kaluar. Shih shën. 64 në këtë kapitull — A. Gj.)

85) Sipas S. Naçi, *art. i cit. f. 38.*

86) *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, Tiranë 1962, vëll. III, f. 221.

87) Po aty f. 194. Shif edhe Kodikun e Mitropolisë së Korçës.

88) Po aty f. 201.

risë. Kështu veziri i Shkodrës, Mahmut Begolli, në vitin 1739 mbante «kondosh», një veshje e sipërme, me origjinë orientale, që ishte sa elegante aq e kushtueshme.⁸⁹

Për veshjen e grave myslimane të shtresave të larta qytetare kemi të dhëna nga një testament i shkruar në fund të shekullit, në të cilin përmenden pjesë veshjeje që janë mbajtur në gjysmën e dytë të shek. XVIII. Atje mësojmë se në këtë kohë veshja e grave të kësaj shtrese në qytetin e Shkodrës përbëhej nga një këmbishë e gjatë pëlhere, brenevekë pastaj vinte dollomaja e gjatë dhe e kushtueshme e bërë prej shahmerani⁹⁰ a tjetër plaçkë, mbi të anteria po aq e gjatë, pastaj jeleku prej kadifeje dhe së fundi saja⁹¹ prej kumashi ose xhybja prej cohe a kadifeje, që ishte tashmë e preferuar. Për të dalë jashtë shtëpie gruaja hidhte mbi kokë binishin⁹² e kushtueshëm. Në këmbë gratë e kësaj kohe mbanin meste të punuara nga papuxhinjtë prej saftiani⁹³ të butë. Gratë e kësaj shtrese mbanin stoli shumë të kushtueshme, unaza, vathë, gjerdanë e vathë me inxhi.⁹⁴ Të tilla stoli të kushtueshme mbanin edhe gratë e aristokracisë feudale të qyteteve të tjera të vendit në shek. XVIII. Në një testament të vitit 1740, në Elbasan, përmenden, një gjerdan gryke i stolisur me inxhi (me vlerë, 10.000 akçe), një lidhje (karficë) flokësh (10.000 akçe), një gjerdan (7400 akçe), një brez argjendi (5000 akçe) e shumë stoli të tjera, që i përkisnin si trashëgim Hasan Beut, të birit të Veiz Beut. Pjesë të ngjashme veshjeje, por jo kaq të shtrenjta përmenden edhe në disa teste të Beratit.⁹⁵

Edhe në veshjen e parësisë së krishterë tiparet orientale ishin mjaft të dukshme. E tillë është veshja e ktitorit Shamo⁹⁶ rreth vitit 1725 në Korçë, e përbërë nga një këmbishë e bardhë mbi të cilën vjen dollomaja e gjatë deri në pulpë të këmbëve e pastaj anteria, e ngjeshur për mezi me një rrip të gjerë. Veshja plotësohet me një xhybe stofi të shtrenjtë, të veshur së brendshmi me gëzof (fig 10), i cili duket te jaka, anëve të xhybes dhe përfundi saj, si edhe te buzët e mëngëve të gjera. Në kokë ai ka një feste të kuqe, përçark së cilës ka lidhur një sham. Flokët i ka të shkurtra, nuk ka mjekër, por ka mustaqe. E ngjashme me veshjen e



Fig. 10 — Veshje burrash në Korçë në vitin 1725 (ktitorët e Mitropolisë së Korçës).

89) Po atje f. 222.

90) Shahmeran (shohmarand) — stof shumë i shtrenjtë, i endur me fije ari e argjendi, që sillej nga Stambolli.

91) Saja, ishte një cohë e leshtë që, sillej nga Stambolli ose nga Venediku, prej së cilës duket se mori emrin kjo veshje e sipërme.

92) Binishi, veshje e gjatë luksoze prej cohe, me mëngë të hapura dhe me gëzof anëve.

93) Saftiani, ishte lëkurë e butë dhije.

94) Simbas dokumentit të Zyko Hanëmit, në Shkodër, viti 1799, Shih H. Bushati, të dhëna etnografike rreth qytetit të Shkodrës, f. 116-121 (dorëshkrim) Arkivi Etnografik. Për të formuar një ide më të qartë po shënojmë këtu edhe vlerën e veshjeve të këtij testamenti: këmbishë pëlhere 300-900 akçe brenevekë faqelli 1335 akçe, dollamë shahmerani 8600-8800 akçe, anteri e gjatë 1700 akçe, jelek kadifeje 6270 akçe, sajë kumashi 3240 akçe, xhybe cohe 5200 akçe, xhybe kadifeje 7200, binish 7260 akçe, meste saftiani 220 akçe, unazë 1230 akçe, vathë 3630 akçe, gjerdan 20520 akçe, vathë me perla (inxhi) 18400 akçe.

95) Arkivi Shtetëror, Tiranë, Dok. nr. 707 895, Sixhili i Sherisë të Elbasanit, Kap. VII, Akti 130 dt. Tetor 1740, si edhe Sheria e Beratit, Dosja 21, Libri 57 b.

96) Një kopje e kuadrit në fjalë ruhet në Sektorin e Etnografisë të Institutit të Historisë (Skicoteca, nr. inv. 72).

Shamos është edhe veshja e ktitorit të pikturuar në një afresk në kishën e Shën Thanasit të Voskopojës⁹⁷, më 1745. Ai mban një xhybe pothuaj të njëjtë, por me ngjyrë të gjelbër (fig. 11). Gjithashtu e kësaj kohe duhet të jetë edhe xhybeja me gëzof e paraqitur në një afresk në Katedralen e Beratit. Këto xhybe, me ndryshime fare të lehta, do të mbeten në përdorim edhe gjatë shekullit XIX.



Fig. 11 — Veshje burri qytetar në vitin 1726 (ktitori i kishës së Shën-Thanasit në Voskopojë, rr. Korçë), afresk.

c) Dëshmi veshjesh popullore në afreske, gravura e dokumente arkivore të shekullit XVIII.

Në dallim nga shekulli i mëparshëm, për shekullin XVIII, materialet që disponojmë për veshjen popullore janë mjaft të pasura dhe ç'është më e rëndësishme, ato nuk janë lënë vetëm nga autorët e huaj, por edhe nga burime vendase. Një vend me rëndësi këtu zenë veshjet laike të paraqitura në shumë freska të kishave të ndryshme, të punuara nga piktorët vendas.

Në një relacion që flet për krahinën e Himarës në vitet 1785-1788 thuhet se «veshja e zakonshme shtëpiake, sidomos e grave dhe e fëmijve, endet e gjitha me dorë, prej leshi, në një mënyrë trashamane e të keqe; në fshatrat Vuno, Dhërmi, Borsh ka edhe dërstila të shajakut, kurse veshja më e mirë bëhet prej pëlhure të blerë në viset e Venedikut.⁹⁸

Në këtë shekull bëhen përpjekje për prodhimin në vend të fijes së pambukut, e cila deri atëherë duket se vetëm importohej. Kështu një nga sundimtarët më në zë të vendit, Mehmet Pasha i Shkodrës, urdhëronte, në vitin 1767, mbjelljen e pambukut në tokat e veta, pambuk, që, sipas një dokumenti të kohës delte «me të vërtetë i dalluar si për cilësinë, ashtu edhe për sasinë e tij»⁹⁹. Përpjekje analoge në këtë periudhë, bëhen edhe në tokat e ulëta të Shqipërisë së Jugut.

Nga materialet dokumentare që disponojmë, duket se tipi më i përhapur në veshjen e burrave në këtë kohë, ishte ai me fustanellë e tirq (kofsharë) të ngushtë nën të, kurse në pjesën e sipërme të trupit, këmbishë, jelek e mëngore, dhe në mes ngjeshur një brez të gjatë; në këmbë opinga me lëkurë lope e çorape. Një lloj xhoke a flokatë me lapa të gjata trekëndëshe në supet (në vend të mëngëve), e cila shihej ose hidhej në një sup, duket se ishte shumë e zakonshme në krahinat e Jugut, sepse e shohim në kuadrin që paraqet ktitorët e Mitropolisë së Korçës (Haxhi Koci e Mako Vasili) (shih. fig. 10) në vitin 1725, në veshjen e ktitorit të kishës së Mesodhit në Vuno të Himarës, (Kristofor Dhimo Savo)¹⁰⁰ në vitin 1783 (fig. 12 a, b,) në vesh-

97) Shih. V. Puzanova, *Prap mbi artin shqiptar në shekullin XVIII*, «Bulletin për Shkencat Shoqërore, 1958, 2, f. 152-156.

98) P. Pepo; *Materiale për historinë e krahinës së Himarës në vitet 1785-1788*, «Studime historike», Tiranë 1964 nr. 3 f. 143.

99) S. Naçi; *Të dhëna mbi tregtinë e Shkodrës etj...f. 44* («la semina di bombace che riesche veramente distinta, si per la sua copia...»).

100) Afresk që ndodhet në kishën e fshatit Vuno.



Fig.12 — Veshje burri në Vuno (rr. Vlorë) në vitin 1783 (ktitori i kishës së Mesodhit), afresk. a) foto;

jen e një bariu të paraqitur në një freskë në bazilikën e Libofshës (fig. 13 a, b) dhe pastaj në një varg gravurash të shek. XIX, që do t'i përmendim më vonë.



Fig.13 — a) Veshje e një bariu në vitin 1782 (nga një afresk i kishës së Shën-Gjergjit në Libofshë rr. Fier).



b) skicë.



b) skicë.

Në veshjen e stinës së verës, shumë shqiptarë duket se mbanin vetëm një këmishë të gjatë gjer te gjuri, me mëngë të gjata, dhe të ngjeshur për mesi me një rrip të ngushtë, ashtu si na paraqiten dy fshatarë në një afresk të vitit 1782, që ndodhet në kishën e fshatit Libofshë.¹⁰¹ (fig. 14).



Fig. 14 -- Veshje fshatarësh myzeqarë. Viti 1782

Në këmbë ata mbajnë po ato lloj çizme a çorape shajaku, të gjata gjer te pulpa, që kemi vënë re te bariu i Onufrit (shih fig. 4). Me të njëjtën veshje është paraqitur edhe një bari i vogël, që i bie fyellit, në një pikurë murale të vitit 1744¹⁰². Po për kohë më të ftohtë, mbi këtë këmishë të gjatë deri te gjunjët, në shekullin XVIII vishej një lloj dollomaje, pak më e shkurtër se këmisha me mëngë të gjata e të ngushta dhe sipër saj vinte xhoka prej shajaku, me prerje që ndryshonin pak nga një krahinë në tjetrën. Në Myzeqe kjo xhokë shajaku ishte po aq e gjatë sa dollomaja dhe nuk kishte mëngë por latica në formë trekëndëshi, si na tregon mjaft qartë afresku i përmendur më lart i vitit 1782 (fig. 13), që ndodhet në bazilikën e Libofshës.¹⁰³

Me interes është edhe veshja dimërore e barinjve të paraqitur në dy afreske të vitit 1744, njëra punë e Kostandin Shpatarakut dhe tjera (fig. 15) punë e Zografëve korçarë.¹⁰⁴ I pari ka një farë bruce të bardhë të trashë e me thekë së jashtmi, pa



Fig. 15 — Veshje dimërore e një bariu. Viti 1744 (afresk në Kishën e Shën Thanasit në Voskopojë, rr. Korçë).

mëngë e pa kapuç, të cilën nuk e ka hedhur supeve, por mbi kokë. Përpara ajo qëndron pak e hapur dhe lejon t'i duket një lloj dollomaje me ngjyrë të errët dhe e gjatë deri mbi gju. Kurse bariu i Voskopojës ka një gunë me kapuç, të cilin e ka vënë mirë mbi kokë. Anët e përparme të kësaj gune janë të prera në formë harku dhe lejojnë t'i duket edhe atij një linjë a këmishë e gjatë gjer tek gjunjët.

I njëjti tip veshjeje për burra, pra me një linjë a këmishë të gjatë, mbi të cilën vishej një xhokë e leshtë, mbahej edhe te arbëreshët e Greqisë (arvanitët). Udhëtari freng A. L. Kastelan, ka takuar në vitin 1797 një familje shqiptare, duke udhëtuar nga Navarini në Pyrgos (More) (fig. 13). Ja si e ka përshkruar ai veshjen e tyre: «Burrat

101) Afresk i punuar nga Konstandin e Tërpo Zografi në kishën e Shën-gjergjit në Libofshë (rrethi i Fierit).

102) Ndodhet në kishën e Shën Thanasit në Voskopojë (Korçë).

103) Shih shënimin 101.

104) E para ndodhet në Llëngë të Mokrës dhe e dyta në Shën Thanas të Voskopojës.



Fig. 16 — Familje shqiptarësh në More (Greqi) në vitin 1797, sipas A. S. Castellan.

mbajnë një këmishë prej pëlhure të pambuktë të bardhë, që u zbret deri te gjunjët, ajo është e hapur përpara te gjoksi i cili rri zbuluar. Kanë një lloj dollomaje pa mëngë, një brez që mbërthehet me kopsa, i zbukuruar me sumbulla të vogla, dhe gjithfarsoj armësh; tirqit (kofsharët) e bardhë me gajtanë e sumbulla prej leshi të kuq, lidhen nën gju e përfundojnë te nyja e këmbës. Këmbët i mbështjellin nganjëherë me peca; opingat lidhen me retra si ato antiket. Kokën e mbulojnë me një kalotë prej lëkure të zezë me tufëza e sumbulla; mbajnë një kapotë të gjerë të bardhë ose ngjyrë kafe, me gajtana me ngjyra dhe me jakë të madhe katrore, me të cilën mbulojnë kokën për t'u mbrojtur nga reshjet.¹⁰⁵

Për sa i përket veshjes së grave të shqiptarët e Greqisë në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, udhëtari englez R. Çandler thotë se gjatë udhëtimit të tij në Greqi në vitet 1764-1766, gratë shqiptare të Athinës vishnin një këmishë të gjatë gjer në fund të këmbëve, të ngjeshur për mesin me një brez të gjerë dhe mbi të një lloj xhoke prej shajaku, të gjerë dhe të shkurtër, flo-

kët i mbanin të ndara në mes të thurura në dy gërsheta dhe të lidhura në fund me një gajtan të kuq të mëndafshhtë. Përpara ato mbanin shumë monedha me madhësi të ndryshme. Të shumtat rrinin këmbëzbathur. Kokën e mbështillnin me një rizë të gjatë, skajet e së cilës vareshin njeri përpara e tjetri prapa. Vajzat mbanin në kokë kësula prej pëlhure të zbukuruara me pare argjendi të shpuara e të qepura, duke i vendosur si luspa peshku.¹⁰⁶

Kastelani jep një tip tjetër veshjeje për gra. Është fjalë për veshjen me dy futa. Ai thotë se mbi këmishë ato vishnin një lloj jeleku të gjatë deri nën bel (gilet), të ngjeshur për mesin me një brez dhe pastaj vinin «një futë të bardhë përpara dhe një copë katrore shumëngjyrshë prapa»¹⁰⁷, të cilat linin të dukej këmisha anëve. Kjo ishte veshja që mbanin brenda në shtëpi, kurse kur udhëtonin vishnin përsipër edhe një fund të gjerë ngjyrë blu, të përveshur përpara, dhe nganjëherë edhe një xhokë (kapotë). Kjo lloj veshjeje mbahej edhe të shqiptarët e ishullit Hidra, si na dëshmon më von një vizatim i Shtakelbergut¹⁰⁸ dhe

105) A. L. Castellan, *Lettres sur la Morée* Paris 1808, f. 96-97.

106) R. Chandler, *Voyages de l'Asie Mineure et en Grèce.. dans les années 1764-66*, Tome III, Paris 1806, f. 28-29.

107) A. L. Castellan, *vepra e cituar*, f. 97.

108) O. M. de Stackelberg, *Costumes et usages des peuples de la Grèce moderne*, Paris 1825 (?) fig. 22.

një përshkrim i shkurtër i Dora d'Istrias.¹⁰⁹
 Në një dokument të vitit 1716, përmenden këto pjesë veshjeje për një familje myslimane që banonte në fshatin Çerdik të kazasë së Shpatit (rrethi i Elbasanit): tri këmbishë, katër jelekë, një takije dhe dy ferexe grash.¹¹⁰ Më në veri, për qytetin e Shkodrës, kemi të dhëna me vlerë nga një varg testamentesh të shekullit XVIII¹¹¹. Këto testeamente të thjeshta, nga vetë përmbajtja e tyre tregojnë se kemi të bëjmë me persona nga familje me gjendje ekonomike modeste. Do të ishte më e saktë, madje që ato t'i konsideronin si porosi të lëna para vdekjes, në prani të priftit e të ndonjë dëshmitari të rastit, për të ndarë teshat e arkës e pjesë veshmbathjeje, midis njerëzve të afërt. Nga 14 prej këtyre testeamenteve ku përmenden veshje të ndryshme, 12 janë lënë prej grash dhe vetëm 2 prej burrash. Në to përmenden një varg rrobesh të kohës për gra, ndër të cilat këmbishë, raxha, xipunë e dollama, anteri, jelekë, e xhamadanë, breza, xhybe, japanxhe, futa, degërmi dhe mahrama etj., të cilësive të ndryshme sipas gjendjes ekonomike të personit. P.sh., përmenden shumë lloj jelekësh; jelekë të thjeshtë prej pëlhure liri e prej shajaku, jelekë të mirë, jelekë me sumbulla, jelekë kadifeje, jelekë të qendisur me ar. Prej këtyre testeamenteve mësojnë gjithashtu se në këtë shekull xhybet visheshin së brendshmi edhe me gëzof, ndërsa raxhat sipas një testeamenti të vitit 1782, i ngjeshnin për mesi me një brez me çapraze (tokëza metalike). Tek testeamenti i Marijes, gruas së Ndoc Zadrimës (viti 1799), përmenden edhe dy koretë e një stravecë (përparje me thekë — A. Gj.). Dy straveca të tjera, njëra e qepur e tjetra jo, përmenden më përpara, në një testament të vitit 1778. Pjesa më e madhe e veshjeve të përmendura në këto testeamente, patën arritur në përdorim deri në fillim të shekullit tonë.

Për shekullin XVIII kemi edhe disa të dhëna për veshjen e kelmendasve, të shpërngulur nga Shqipëria Veriore e të vendosur në Srem (fshatrat Nikinci e Hrtkovci). Letrari hungarez Daniel Kordinez i ka vi-

zituat shqiptarët e Sremit rreth vitit 1750 dhe ka ndenjtur atje për pesë vjet. Më vonë, në vitin 1782 disa informata mbi ta i kemi nga Vindish (fig. 17) dhe disa vjet më vonë



Fig. 17 — Veshja e Kelmendasve të Sremit më 1782 (sipas Windisch)

(1790) edhe nga mjeku francez Hake. Sipas përshkrimit të Kordinezit, veshja e burrit kelmendas përbëhej nga këmbisha e gjatë deri në gju (mbi të cilën, në ditë festash, vishej një dolloma cohe të kuqe) dhe mbi të një lloj xhamadani i gjatë gjer në kërdhokla, me mëngë të gjata dhe i zbukuruar përpara me gajtan ari e sumbulla.¹¹² Haké thotë se ai ishte i bardhë me zbukurimet blu.¹¹³ Këmbët i mbështillte deri në gju me kallma (qafa çorapësh) laramane e mbi to mbathte shputat e pastaj opingat (fig. 18).

109) Dora d'Istria, *Femmes d'Orient*, f. 400.

110) Arkivi Shtetëror, Tiranë. Dok. nr. 707 848, Sixhili i Sheries të Elbasani, Kap. VII, Akti 89.

111) Arkivi Shtetëror, Tiranë. Fondi i Klerit katolik, Testamente të Shkodrës, Dosja 19, dok. nr. 3, 5, 6, 10, 11, 13, 22, 24, 29, 30.

112) Cituar sipas Krunoslav Tkalac, *Narodne nošnje Sremski Klimentata u Hrtkovcima i Nikincima* (Rada Vojvodanskih Muzeja), Novisad 1954 (?) f. 119.

113) Hacquet, *L'Illyrie et la Dalmatie*, Paris 1790. vol. II, f. 151, fig. 28.



Fig. 18 — Luftëtar kelmendas më 1790 (sipas Hacquet).



Fig. 19 — Grua kelmendase më 1790 (sipas Hacquet).

Si shihet, kjo veshje, në pjesët kryesore dhe në strukturën e saj, është shumë e afërt me veshjen e përshkruar më sipër sipas Kastelanit për shqiptarët e Greqisë në fund të shekullit XVIII.

Për gratë kelmendase të Sremit, Kordinëz jep dy lloje veshjesh: së pari veshjen me xhubletë e pastaj atë me dy futa. Ai përshkruan hollësisht se si bëhej xhubleta (me rripa shajaku 7-8 cm. të gjera, të qepur horizontalisht njeri mbas tjetrit, në mënyrë të tillë që të merrte formë këmbane) dhe pastaj si zbukurohej me gajtanë shumëngjyrësh. Prej këtij dëshmitari, që i ka parë me sytë e vet gratë e Sremit mësojmë se ngjyrat e përdorura në zbukurimin e xhubletës ishin aq të shumta sa i kanë dhënë shkas të thotë se «As palloi as ylberi nuk kanë aq shumë ngjyra sa gratë kelmendase.»¹¹⁴ Kjo veshje është mbajtur te kelmendasit e Sremit gjer në fund të shekullit XIX. Veshja tjetër e cila mbahej në ditët festash gjatë verës (fig. 19), dhe që e shohim të vizatuar tek Haké, kishte për bazë një këmishë të gjatë dhe të ngushtë, ngjeshur për mesi me një brez leshi të kuq,

mbi të cilën viheshin dy futa, një përpara dhe një prapa.

Edhe këtë tip veshjeje për gra, me dy futa, e kemi përmendur më lart, duke folur për shqiptarët e Greqisë.

Një element tjetër i rëndësishëm në kostumin e grave kelmendase ishte pa dyshim ai lloj xhamadani me mëngë të shkurtra, që të kujton përnjëherë gjurditë e zeza të burrave të Malsisë së Madhe, apo të grave të Mirditës. Vindish (Windisch) thotë se e quanin «ling», Haké e quan «camisole» dhe thotë se bëhej prej stofi të kuq e zbukurohej me tufa.

Flokët gratë i mbanin të gjatë, të thurur gërsheta. Si gratë e martuara, ashtu edhe vajzat e mbulonin kokën me «rubë» prej pëlhure liri ose mëndafshi, që varej lirshëm prapa dhe ishte e zbukuruar me shirita me ngjyra. Haké e cilëson veshjen e grave kelmendase «si një nga më elegantet e këtyre krahinave». Veç kësaj ai shton se këto gra kishin «trupa imponantë po aq sa edhe burrat, flokë të zez e sy të mëdhenj me një gjallëri të jashtëzakonshme».

Tkalac, në punimin e tij mbi veshjen e

114) K. Tkalac, po atje, f. 119.

kelmendasve të Sremit, përshkruan edhe një veshje plakash, e cila, në pjesën e poshtme të trupit kishte një fund a kotull prej shajaku «futgunj», i përbërë prej dy copash pothuaj katrore (50 cm x 57 cm.), që qepeshin në dy anët. Ato endeshin në vegël, në një fushë kafe ose të zezë, me ornamente ngjyrë të verdhë ari, të bardhë, vjollcë etj. Tkalac nuk është i sigurt nëse këtë veshje kelmendasit e kanë sjellë që nga atdheu i tyre apo kanë filluar ta përdorin në Srem, pasi u zhduk xhubleta.¹¹⁵ Ky kostum i plakave është i njëjtë në strukturë me kostumin e grave me dy futa, po të mënjanojmë këmishën, prandaj nuk më duket se ka vend dyshimi nëse ai është sjellë nga Shqipëria ose jo.

c) — Dorëshkrimi i Kieutit për veshjet e arbëreshëve të Italisë.

Një burim me interes për këtë shekull është pa dyshim dhe folklori gojor. Në dorëshkrimin arbëresh të Kieutit të vitit 1737 përmenden një varg pjesësh veshjeje, si për burra dhe për gra, mbi të cilat kemi, për fat të keq, shumë pak të dhëna ilustrative. Atje ku kënga flet për martesën e një vajze të bujarisë, pyetjes së poetit «Ç'pajë të taksit (të premtos) yt atë?», vajza i përgjigjet se ai i premtos malet e luginat, fushat me lule e katër anije (galé) të armatosura, etj., kurse pyetjes se ç'stoli i premtos e ëma, i përgjigjet duke i numëruar veshjet e zbukurimet:

«Nendë cohë e nendë linjë,
nendë brezaz të regjendë,
nendë kezë të viliusta,
nendë sqopez të hollë
edhe vijli me kurorë¹¹⁶

Këtu janë përmendur pjesët kryesore të kostumit tradicional të martesës të arbëreshëve të Italisë, që ruhej mjaft mirë deri në fillim të shekullit tonë, por që po humbet me shpejtësi. Ky kostum, si shihet, përbëhet nga linja e gjatë, mbi të cilën vishej «coha» a xhoka dhe ngjishej për mesi me një brez argjendi. Kostumi plotësohej me atë zbukurim koke, karakteristik për gratë e martuara që ishte keza «e viliustë» (prej kadifeje).¹¹⁷ Nga ky dorëshkrim i Kieutit marrim vesh gjithashtu se burrat mbanin si aksesore të veshjes një «trastëzë armakoll» (krahaqafë), «zabien» (shpatën) dhe kungullin në brez.¹¹⁸

Pjesë të tjera veshjesh të shqiptarëve të Italisë si cilonë, tirq, pastemall, brekë e guarnaca, i gjejmë të përmendura tek autorë të tjerë arbëreshë.

d) Veshje luftëtarësh shqiptarë në vepra dhëtarësh të huaja.

Dëshmi interesante për veshjet luftarake shqiptare të shekullit XVIII kemi edhe në burime të huaja. Shumë nga suitat që shfaqëronin personalitetet e huaja që kalonin nëpër vendin tonë përbëheshin nga shqiptarë trima e të shkathët, «të veshur me rrobat e tyre (fustanellat — A. Gj.) të bardha e të pastra, që mbanin në supe pushkët e gjata sikur të mos e ndjenin fare peshën e tyre, dhe ai që ecte përpara ia merrte një kënge të ashpër por jo të pakëndëshme, ndërsa të tjerët i mbanin zë në kor». Kështu i përshkruan *ledi Montegu* në një letër të vitit 1717, shqiptarët e kohës ^{118bis} të tjera të dhëna kanë të bëjnë me kostumin e trupave shqiptare që përbënin gardën e princave të Moldavisë në pallatin e tyre në Jashi. «Në ka patur ushtarë të veshur në mënyrë madhështore dhe të pajisur si duhet me armë, në Moldavinë e këtij shekulli — shkruan një

115) K. Tkalac, po atje, f. 132.

116) Dorëshkrimi i Kieutit, në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar» Tiranë 1961, Vëll. I, f. 37.

117) Për hollësi të tjera mbi kostumin arbëresh shih M. Roussel — de Fontanès, *Les costumes traditionnels calabrais*, në «Objets et Mondes» la revue du Musée de l'Homme, Paris 1963, Tome III, fasc. I, f. 71-80 dhe Lia Russo, *Gli Albanesi d'Italia*, Palermo 1975.

118) Dorëshkrimi i Kieutit, po atje, f. 34. Këtë kungull në brez e kemi ndeshur që në shekullin XVI te bariu i Onufrit (shih figurën 5).

118 bis) M. Wortely-Montagu *Letters*, London 1816, f. 13.

XIX pothuajse nuk e gjejmë më në përdorim. Duhet theksuar mirë se, ndërsa në shtresa të caktuara qytetare, pjesë veshjeje të modës së kohës, të rrezatuara kryesisht nga Stambolli, por edhe nga qytete të tjera të Perandorisë Osmane, hynë në përdorim, së bashku me emrat e tyre, në shtresat e gjera të popullsisë, sidomos në popullsinë fshatare, me kohë hynë në përdorim shumë emra të veshjeve të modës, jo së bashku me objektin përkatës, por për të emërtuar pjesë ekzistuese të veshjeve vendase. Kështu ngjau, që xhoka ose xhupa e vjetër vendase prej shajaku, filloi të thirret «dollo-ma», brekeshat vendase të burrave filluan të thirren edhe «shallvare»; në disa kra-hina tirqit u quajtën «çakshirë», ose «çedikë», guna e gjerë «jepinxhe» ose «japan-xhe», mëngorja «hirkë» etj. Ky fenomen i futjes së fjalëve na objektin origjinal përkatës, krijon përshtypjen e rreme se ndikimi turk në fushën e veshjeve ishte më i gjerë e më i thellë nga sa ishte në të vërtetë.

Në këta shekuj na tërheq vëmendjen edhe një fenomen tjetër me rëndësi, shtrirja e një tipi kryesor të veshjeve shqiptare për burra, shumë përtej kufijve të vendit tonë. E kemi fjalën për veshjen me fustanellë, aq të admiruar nga të gjithë ata që patën rast ta njihnin në fazën e lulëzimit të plotë të saj që shkon afërsisht nga mesi i shek. XVIII në mesin e shek. XIX. Ky kostum, me bukurinë e madhështinë e tij i zbehte kostumet e tjera të kohës. Fustanella e gjerë, e bardhë, u jepte burrave shqiptarë atë pamje krenarie e luksi, atë karakter marcial e njëkohësisht elegant në ecje, që s'kish të krahasuar me veshjet e tjera popullore të Ballkanit. Në shekujt e mëparshëm kemi parë shtrirjen e këtij kostumi në Greqi e në Itali, me anë të shqiptarëve të shpërngulur në këto vende si edhe me anën e stradiotëve. Si pasojë e ekspeditave ushtarake, ku merrnin pjesë edhe trupa luftarake shqiptarësh, fustanella në shekujt XVI-XVII ishte bërë e njohur edhe në shumë vende të Evropës Perëndimore, kurse në shekullin XVIII ajo kishte marrë një popullaritet shumë të gjerë në gjithë vendet e Ballkanit e në Turqi. Kjo përhapje favorizoi zhvillimin e lulëzimit të saj, që arrin kulmin në fillim të shekullit XIX.

3. VESHJA NË SHEKUJT XIX-XX

a) Penetrimi i mëtejshëm i prodhimit zejtar në veshjet fshatare.

Shekulli XIX është shekulli i lindjes dhe i zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste në vendin tonë. Në këtë periudhë ndër faktorët që kanë ndikuar mbi disa aspekte të zhvillimit të veshjes, mund të përmendim: shpërbërjen e ekonomisë së mbyllur shtëpiake, ndikimin gjithmonë në rritje të qytetit mbi fshatin, rritjen e shkëmbimit e të qarkullimit të mallrave që solli hyrjen sa vinte më intensive të materialeve të fabrikuara në veshjen fshatare dhe, në rrafsh shoqëror, thellimin e shtresëzimit të shoqërisë dhe të kontradiktave midis klasave shoqërore.

Me lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste prodhimet e industrisë hyjnë në gjithnjë më shumë në fshat, qoftë si material (cohë, mëndafshra, faqell, pëlhurë shami etj.) me të cilin konfeksionohen veshjet, qoftë si materiale ndihmëse për zbuturimin e tyre (shirita, gajtanë, dantela, pulla, sumbulla, penjë, rruaza, temina etj.) ose më në fund si elemente të gatshme veshjeje (feste, breza e rripa, stoli etj.). Shumë prej këtyre artikujve të veshmbathjes importoheshin tashmë jo vetëm për përdorim të shtresave të pasura, por edhe për shtresa të tjera më të gjera të popullsisë, sidomos për kostumin e martesës. Kështu udhëtari anglez J. C. Hobhauz. (Hobhouse) dëshmon se në fillim të shekullit XIX, konsulat që përdornin shqiptarët silleshin nga qytetet e Italisë, Trieste, Livorno dhe Gjenova; thikat, tehet e shpatave dhe tytat e pushkëve silleshin nga Venediku dhe shiteshin në të gjitha portet e Shqipërisë.¹²⁴ Gajtanët prej ari e argjendi që përdoreshin për zbuturimin e veshjeve, vinin nga Vjena. Stofrat e manifakturave gjermane dërgoheshin me anë të Laipzigit. Ky ishte një nga artikujt kryesorë të importit. Stofrat anglezë përdoreshin më pak se kushtonin shtrenjtë. Ndër artikujt e importuar aty nga mesi i shek. XIX G. Hahn përmend edhe gjyrmshin, atë fije të hollë ari ose

¹²⁴ Shih për këtë J. C. Hughes, *Travels in Sicily, Greece etc.* London 1820, f. 73.

argjendi që përdorej për qëndisje (rreth 2000 libra në vit) dhe sillej nga Napoli.¹²⁵ Në disa zona të vendit të paktën në gjysmën e dytë të shek. XIX, për rrobet festive të fshatarësisë, përdorej një shajak industrial që i afrohej kohës. Ai sillej nga vise të ndryshme të Ballkanit që kishin atelie e fabrika të specializuara për këto prodhime. E tillë ishte p.sh. coha e bardhë e prodhuar në Brashovë (Rumani), që përdorej për tirq e mëngore në rrethin e Korçës, coha blu e Samokovit dhe Preshevës, që përdorej për poture e xhamadanë në pjesën më të madhe të Shqipërisë Jugore etj. Sidoqoftë nevojat më të shumta të fshatarësisë për veshmbathje sidomos për veshjen e përditshme vazhdonte t'i plotësonte tregu i brendshëm dhe prodhimi shtëpiak.

Në qendrat më të lulëzuara ekonomike të vendit (Shkodër, Prizren, Gjakovë, Elbasan, Berat, Korçë, Janinë etj.) gjatë shekullit XIX shtohen zejtarë rrobaqepës që merren me qepjen e zbukurimit e rrobave për fshatarësinë, duke iu përgjigjur kërkesave të konsumatorëve. Këta zejtarë shtonin sa vinte më shumë numrin e pjesëve të veshjes që prodhonin për fshatarët sidomos për kostumin festiv të tyre. Kështu hynë gradualisht në sferën e prodhimit zejtar veshjet popullore të shumë krahinave. Duke u punuar nga zeytari ato fituan një stabilitet të ri në format e prerjes dhe u pasuruan me elemente të reja zbukurimi krahas atyre tradicionale. U rrit kështu edhe ndikimi reciprok midis fshatit e qytetit dhe u kapërcyen shumë dallime të vogla lokale që ekzistonin më parë. Është me rëndësi të theksojmë se zejtarët prodhonin veshje me cilësi të ndryshme, që u përgjigjeshin mundësive ekonomike të blerësve dhe pasqyronin kështu edhe diferencimin klasor në veshje.

Në tregun e brendshëm shiteshin shumë lloj pëlhurash të vendit (të pambukta, të mëndafshta e të leshta) për ata konsumatorë që nuk i prodhonin dot vetë. Një zonë e tregut të qytetit, që quhej «pazari i grave» u rezervohet zakonisht grave që dilnin për t'i shitur këto pëlhura, të cilat i punonin vetë. Tregtoheshin gjithashtu breza të ndryshëm, shirita e gajtanë, sumbulla të veshura me gajtanë, e sidomos çorape leshi.

Edhe në këtë shekull pjesa më e madhe

e fshatarësisë vazhdoi t'i prodhojë vetë pjesët më të shumta të veshjes së përditshme, brenda ekonomisë së saj në bazë të industrisë tekstile shtëpiake, nganjëherë edhe me ndihmën e zejtarëve rrobaqepës ambulantë dhe të teknologjisë popullore (dërstitat e batanët për dendësimin e pëihurave dhe formimin e pushit, mënyrat tradicionale për të përgatitur pëlhurë të rrudhur, funde leshi me pala të dendura etj.). Këto janë arsyet që veshjet popullore në shumë zona ruajtën një specifikë krahinore mjaft të dallueshme në format e prerjes e sidomos në zbukurimet.

Ndikimi i qendrës më të afërt ku bëhej tregu ka ushtruar një veprim afrues e nivelues midis zonave që e frekuentonin këtë treg. Këto qendra kanë qenë në një farë mase edhe rrezatuese të modës qytetare të veshjes ose të elementeve të veçantë të saj, në veshjen e krahinave që e frekuentonin. Mund të kujtojmë këtu p.sh., ndikimin e veshjes së grave (katolike) shkodrane mbi atë të grave të Bregut të Drinit e të Bregut të Bunës (në jelekët e xhamadanët e në motivet e zbukurimit të tyre), ndikimin e veshjes së grave (myslimane) qytetare të Prizrenit e të Pejës në shumë zona përfaqëse të tyre, ndikimin e veshjes qytetare të Korçës në zonat përfaqëse etj. e deri në Skrapar, meqë skraparlinjtë frekuentonin pazarin e Korçës.

Pra, më një anë rritja e prodhimit dhe hyrja në fshat e materialeve të fabrikuara, më anë tjetër kontakti më i ngushtë me qytetin, kontribuan për zhvillimin e veshjeve popullore si përsa i përket përmbajtjes, ashtu edhe përsa i përket formës, sepse hynë në përdorim lëndë të para të reja, teknika të reja pune si edhe motive të reja zbukurimi. Efekti pozitiv i tyre ndihet plotësisht në veshjen popullore. Përdorimi i gajtanëve e tehrive të mëndafshta apo me fije ari e argjendi, përdorimi i penjëve të fabrikuar me ngjyra të ndryshme, për zbukurimin e disa pjesëve, ua shtoi shumë vlerën artistike veshjeve popullore në përgjithësi.

Nga mjetet mekanike të punës duhet shënuar makina qepëse, që pat hyrë në përdorim në qytetet tona që në dhjetëvjeçarët e fundit të shek. XIX. Duke lehtësuar qepjen ajo solli si pasojë edhe prerje më të ndërlikuara. Ajo u përdor gjithashtu edhe për qëndisje që mbanin si bazë motivet tradicionale, por ekzekutoheshin me makinë, pra

125) G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena 1853, f. 57.

shumë më shpejt e me forma më të rregullta.

S'ka dyshim se shkak kryesor i ndryshimeve që ngjanë në veshje në shekullin XIX ishte pasojë e ndryshimeve në jetën ekonomike, në shfaqjen e marrëdhënieve të reja kapitaliste. Kështu ndryshimet në veshje qenë më të shpejta në zonat që ishin më të zhvilluara në pikëpamje ekonomike, ku qenë bërë ndryshime të gjithanshme në mënyrën e jetesës, ku marrëdhëniet e reja kishin sjellë në mënyrë të natyrshme futjen në përdorim të elementeve të reja, të konfeksionuara me materiale importi, prerje të reja të modës për atë kohë, si në veshjen e burrave ashtu dhe në atë të grave. Ndryshime të dukshme pati, p.sh., në disa krahina të Jugut ku dallimet e vogla nga një zonë në tjetrën, u kapërcyen duke formuar njësi më të mëdha.

Ndryshimet që u vërtetuan në marrëdhëniet shoqërore të kohës ndikuan tërthorazi edhe në veshjet. Lindja e shtresës së re borgjeze në qytetet kryesore të vendit solli fenomene të reja. Përfaqësuesit e kësaj borgjezie dhe gradualisht edhe shtresat e borgjezisë së vogël, në gjysmën e dytë të shekullit XIX po shkëputeshin gjithnjë e më shumë nga ndikimi i modës orientale të deriatëhershme dhe ndiqnin modën qytetare të vendeve të Evropës Perëndimore, duke u veshur jo më «alla turka», por «alla frënga». E provojnë këtë fotografi të shumta familjare nga qytetet Korçë, Gjirokastër, Durres, etj.

Në këto shtresa tashmë ishin zhdukur dallimet kryesore në veshje midis myslimanëve e të krishterëve, që ishin shumë të dukshme më parë, ose ishin reduktuar në ruajtjen vetëm të ndonjë elementi si p.sh. të festeve.

Duke i krahasuar veshjet e shekullit XIX me ato të shekullit XVIII bie në sy një lehtësim i shkallëzuar i tyre nga elemente të ndikimit oriental. P.sh., del nga përdorimi dollomaja e tipit oriental që mbanin burrat qytetarë, ashtu si dalin krejtësisht xhybet me gëzof. Mendoj se si dalja nga përdorimi i këtyre elementeve dhe përhapja e modës perëndimore, ashtu edhe rivlerësimi i veshjeve popullore, shënojnë një kthesë, e cila duhet vënë në lidhje, ndër të tjera, me rritjen e ndërgjegjes kombëtare e të urrejtjes për pushtuesin, me punën e madhe që zhvillonin rilindësit për ruajtjen dhe forcimin e traditave kombëtare, interesimin e tyre për mbledhjen dhe botimin e thesareve të kulturës popullore,

shkurt me fuqizimin e lëvizjes kombëtare në shumë plane.

b) Apogjeu i kostumit me fustanellë e të tjera veshje burrash në shek. XIX.

Një varg burimesh për veshjet shqiptare të shekullit XIX, i kemi, si edhe në shekujt e mëparshëm, nga udhëtarë të ndryshëm që kanë vizituar Shqipërinë në atë kohë. Shumicën e tyre (funktionarë e diplomatë të huaj) në gjysmën e parë të shekullit XIX i tërhiqte më fort Shqipëria e Jugut, për shkak të ngjarjeve politike e shoqërore të kohës, si ishin rritja e fuqisë së Ali Pashë Tepelenës dhe e rolit të tij në dy dhjetëvjeçarët e parë të shekullit, pastaj kryengritjet e ndryshme fshatare në disa zona të Jugut etj. Shumë nga autorët që vizitojnë Greqinë flasin edhe për arbëreshët e Greqisë.

Ndër të gjitha këto burime përshkrimet dhe ilustrimet më të shumta i janë kushtuar kostumit me fustanellë, jo vetëm në variantet e tij më luksoze të mbajtura nga parësia dhe si veshje e luftëtarëve dhe e gardave të oborrëve feudalë, por edhe në format më të thjeshta si veshje e fshatarëve. (fig. 21).



Fig. 21 — Një shqiptar. Viti 1809. (Sipas J. Hobhouse)

Udhëtari englez i fillimit të shekullit XIX J. C. Hobhauz, i cili pat qenë në Shqipëri së bashku me poetin e mirënjohur Bajron (në vitet 1809-1810), ka vënë re mirë se, ndërsa deri në afërsi të Delvinës shihej veshja me poture të gjera shajaku, blu, më tei shihej «këmisha prej pëlhure të pambuktë ose *kilti* (pra fustanella — A. Gj.) i shqiptarëve. Ai jep një përshkrim mjaf të plotë dhe interesant të kësaj veshjeje, duke përmendur pjesët e saj: këmishën e të mbathurat prej pëlhure të pambuktë, xhokën e bardhë prej leshi me thekë (the *uante*), brezin dhe silahun, xhamadanin, opingat prej lëkure, një kësulë të vogël të kuqe dhe armët e plota. Ai vë theksin në mënyrë të veçantë tek përshkrimi i flokatës a i gunës:¹²⁶ «...ajo që përbën mbrojtjen e tyre kryesore ndaj kohës së keqe dhe shërben edhe si mbulesë për fjetje është një kapotë e madhe, e gjerë, me mëngë të hapura dhe me një kapuç që i varet prapa te jaka si një copë katrore, por kur vihet në kokë mer formën e duhur duke u kapur sipër me anën e një ghylneri ose ndonjë herë me harbinë e kobures. Kjo kapotë është e leshtë e me thekë, e bardhë ose e zezë, ka shumë mundësi që ajo të jetë një veshje e posaçme e këtij populli, sepse — sikurse ma shtiri në mend miku im (është fjala për poetin Bajron — A. Gj.) — poeti ynë Spenser i ka dhënë njerit prej personazheve të tij.

«një gunë shumë të madhe të modës shqiptare»¹²⁷ Fustanellën shqiptare Bajroni e përmend në vargjet e tij të famshme që fillojnë: kështu «shqiptari i ashpër me fustanellën deri në gju...» «me kokën mbështjellë me shall dhe pushkën e stolisur «dhe veshjet e tjera qëndisur me ar, i këndshëm për t'u parë...

Kurse në një vend tjetër të veprës së vet «Çailld Harold», ai thotë edhe këto: «Arnautët ose Shqiptarët më kanë bërë shumë përshtypje për ngjasimin që kanë me malësorët e Skocisë, në veshjen, pamjen dhe mënyrën e jetesës... Kilti (fustanella — A. Gj.) megjithëse i bardhë... të folurit e tyre kelt në tingëllim dhe zakonet e tyre të ashpra, gjithçka më çonte larg në Morven. Më pëlqejnë shqiptarët.»¹²⁸ Shtojmë se në Galerinë Kombëtare të Portretit («National Portret Gallery») në Londër ruhet një portret i Bajronit veshur me kostum shqiptar.

Udhëtari tjetër englez i viteve 1812-1813 H. Holland, përshkruan gjithashtu të njëjtin kostum si veshje të një ushtari shqiptar në Prevezë dhe të rojeve të Ali Pashës në Janinë. Edhe gravurat e vëna për ilustrim të këtyre përshkrimeve në veprat respektive, janë shumë të afërta, për të mos thënë të njëjta.¹²⁹ «Fshatari apo ushtari shqiptar, fjalë të cilat në këtë vend duket se janë pothuaj sinonime, shihet këtu në gjithë karakterin dhe kostumin e tij. Përgjithësisht burrnor në personin e tij, me tipare që e tregojnë të panënshtuar ndaj poshtërimit të skllavërisë, me dinjitet e madhështi në të ecurit dhe në qëndrimin e tij, mënyra se si vishet ia shton këto veçanti dhe e bën figurën e tij më të spikatur dhe piktoreske se çdo tjetër nga sa kam njohur».¹³⁰ Edhe Holland, sikurse Hobhauz, në përshkrimin e pjesëve të kostumit shqiptar vë theksin tek guna, për të cilën thotë: «Kapota ose guna e madhe, një nga veçoritë që spikat më shumë në elementin shqiptar, është një veshje shajaku të ashpër me thekë, me mëngë të hapura dhe një copë të madhe katrore prapa (te jaka), që shërben, kur është rasti, si një kapuç dhe ka ngjyrë gri ose të bardhë. Unë nuk do të ku-

126) J. C. Hobhouse, *Turkey during the years 1809-1810*; London 1812. f. 134.

127) Spenser, dramaturg englez i shekullit XVI, Vargu i cituar, në origjinal është: «*huge capoto Albanese-wise*».

128) G. Byron, *Notes to Child Harold*, London, 1935, f. 860. Vargu i cituar këtu, në origjinalin inglisht është: «the wild Albanian kilted to the knee.» Këtij vargu i janë referuar shumë autorë të tjerë më von, sa herë ka qenë fjala për kostumin me fustanellë, si në Shqipërinë e Jugut ashtu edhe në atë të veriut, p.sh. E. F. Knight, më 1880 për Shqipërinë e Veriut, H. Callan, më 1898 gjithashtu për në veri etj.

129) H. Holland, *Travels in the Jonian Isles, Albania etc. during the years 1812-1813*, London 1815, f. 78, gravura me titullin «Ushtar shqiptar në Prevezë».

130) H. Holland, po atje, f. 76.

Një ushtar shqiptar i fillimit të shek. XIX ndodhet në vepra e Pouqueville it, «*Reise durch Morea und Albanien nach Constantinopol*», Band III, Leipzig 1805.

turis të them nëse kjo është *sagumi* i kohës antike, por pa dyshim ekzistojnë shumë pika përngjasimi midis kostumit shqiptar dhe atij të ushtarit grek ose romak». Si shumë autorë të tjerë, sidomos anglezë, edhe ky e përqsas fustanellën shqiptare me «kiltin» e skocezëve: «një (fund) këmishë prej pël-hure të ashpër pambuku, i cili fillon nga beli dhe varet poshtë deri pak nën gju, ashtu si kilti skocez, duke mbuluar të mba-thurat që janë gjithashtu prej pël-hure». Ai e mbyll përshkrimin e veshjes së burrave shqiptarë me këto fjalë: «Duke krahasuar pamjen e jashtme të kësaj veshjeje kombë-tare me atë të vendeve të tjera, unë nuk gjej ndonjë që t'i përngjajë aq sa ai i fshat-rarëve të Sardenjës. Por krahasimi këtu është në favor të shqiptarëve; sardi gjysëm i zhveshur ashtu si shihet nëpër rrugët e Kaljarit, nuk është veçse një paraqitje e mjeruar e figurave madhështore që bëjnë roje për qark sarajeve të Ali Pashës.»¹³¹

Kostumin për burra në Shqipërinë e Jugut e përshkruan edhe G. de Vodonkur nga një udhëtim i tij në vitin 1807.¹³² Atë e shohim gjithashtu në një vizatim të Kokër-il-it (Cockereell-it) «Shqiptarë në ndjekje të armikut», botuar në, veprën e T. S. Hiugs-it, (Hughes), bashkë me të cilin ai pat vizituar Shqipërinë e Jugut dhe Greqinë në vitet 1812-1813¹³³ (fig. 22).

Njëkohësisht me ta vizitoi Shqipërinë e Jugut dhe Greqinë, grafisti francez nga Al-zasa, Baroni Shtakelberg, i cili i botoi më vonë punimet e veta në një album të ve-



Fig. 22 — Shqiptarë në ndjekje të armikut. Viti 1813 (sipas Cockerill).

çantë.¹³⁴ Ato shquhen në mes të shumë pu-nimeve të tjera të bashkëkohësve. Në 30 gravura me ngjyra që përmban ky album, disa paraqesin veshje shqiptare. Ndër to dallohen në mënyrë të veçantë për saktësi-në dhe madhështinë e figurave, gravurat e titulluara «Oficer shqiptar» dhe «Jeni-çer nga Janina» (Tab III a, b,) në të cilat janë dhënë me besnikëri, por dhe me shumë art, kostume shqiptare të kohës. Në gra-vurat e përfshira në këtë album Shtakel-bergu ka vizatuar edhe një numër të mirë kostumesh të shqiptarëve të Greqisë, si p.sh. një burrë e një grua nga rrethet e Athi-nës¹³⁵, një grua me veshjen e banorëve të

131) H. Holland, po atje.

132) G. de Vaudoncourt, *Memoirs on the Jonien Islands etc.*, Lonon 1816. f. 317, thotë: «Shqiptarët kanë ruajtur në përgjithësi veshjen ushtarake të romakëve. Ata mbajnë një tunikë të ngjeshur për mes të një brez lëkure, ku vënë koburet, hanxharin e varin dy vezme...; një xhamadan pa mëngë në të cilin shiritat e qendisjet kanë zenë vendin e rrjetës prej lëkure; xhokën që varet prapa dhe nuk kopsitet përpara, pastaj gunën e gjerë pa mëngë që e mbajnë me vete në çdo kohë, një palë pantallona të ngushta, diçka e, ngjashme me «karakalat» e përhapura në Mesjetë në ushtrinë romake, të cilat pjesërisht i mbulon tunika (është fjala për tirqit e ngushtë prej shajaku — A. Gj.); opinga të ngjashme me ato që shihen në monumentet antike, që paraqesin ushtarë romakë, të lidhura mbi tirqit me ripa lëkure, tek të cilat varen tri pafta argjenti për zbulurim. Në kokë mbajnë një kësulë të vogël të kuqe, zakonisht të mbështjellë me një shall pël-hure në formë turbani». Më poshtë ai flet për gunën e tyre të trashë që u shërben edhe si mbulesë për të fjetur dhe në f. 321 flet për armët e tyre.

133) Th. S. Hughes, *Travels in Sicily. Greece and Albania*, London 1820.

134) O. M. de Stackelberg, *Costumes et Usages des Peuples de la Grèce Moderne*, Paris 1825.

135) Një kostum gruaje shqiptare nga rrethet e Athinës (së bashku me dy gravura të tjera, riprodhuar këtu në fig. 27, 28, 29. Ushtar shqiptar nga Moreja dhe Vajzë shqiptare nga Livadhjaja) e pat paraqitur me 1803 J. L. Bartholdy, në veprën e vet «Voyage en Grèce» dhe pastaj më 1826 J. C. Pou-queville, e pat paraqitur po atë kostum si veshje të grave të Sulit, shih *Voyages de la Grèce* Tome II, f. 177, të cilën po e paraqesim në fig. 27.

ishujve Poros e Hidra etj. (fig. 23, 24, 25). Ja-shtë këtij albumi edhe gravura të tjera të këtij autori, e të tjerëve paraqitin veshje të shqiptarëve të Greqisë.¹³⁶ (fig. 26, 27, 28, 29, 30.).

«Mbrojtësit e fundit të Misolongit» (1826), të piktorit frëng Ari Shefer (Arry Scheffer), në vepra të Delacroix e më vonë të L. Zhe-romë.



Fig. 23 — Fshatare nga rrethet e Athinës. Viti 1825 (sipas Stackelberg).



Fig. 24 — Veshje gruaje fshatare nga rrethet e Athinës. Vitin 1825 (sipas Stackelberg)

Disa kostume shqiptare i gjejmë të paraqitura në veprën e ilustruar të Filip Delpinos.^{136 bis} Ndër to më interesante janë padyshim «Gjuetari shqiptar» dhe grupi tresh (dy burra e një grua); veshjet e këtyre të fundit janë fare të ngjashme me ato të paraqitura në disa vepra të fundit të shekullit XVIII (p.sh. Kastelani) ose të bashkëkohësit Shtakelberg. (Tab. IV a, b; V a dhe fig. 31).

Kostumi i burrave shqiptarë me fustanellë është paraqitur bukur edhe në figurat dinamike të suliotëve, në tablonë e titulluar

Një pasqyrë mjaft të gjerë për veshjet shqiptare të kohës ka dhënë konsulli frëng Ami Bué, në vëllimin e dytë të veprës së tij «Turqia Evropiane» por duhet thënë se në të dhënat e tij vende-vende ka edhe pasaktësira. Kjo tregon se në shumë raste ato janë marrë tërthorazi.

Bué, ashtu si shumë autorë të tjerë, quan «kostum shqiptar» për burra atë që përbëhet nga këmisha e shkurtër, të mbathurat, fustanella, toslukët ose kalçet, jeleku e xhamadani, dollama, flokata, fesi e opingat¹³⁷. Më poshtë duke fo-

136) Është fjala për gravurën «Barinj shqiptarë në Arkadi» dhe «Familje shqiptare» botuar në veprën e A. e M. Haberlandt. Për këtë të fundit shih fig. 34.

136 bis) F. Delpino, *Vestiario ed usi della corte*, Torino (pa datë botimi), fig. 91, 101, 105, 122.

137) A. Boué *La Turquie d'Europe*, Paris 1843, vol. II. f. 199. Në f. 207 e më poshtë ai vazhdon me një përshkrim të hollësishëm se si pritet e qepet fustanella, si vishet, ku punohen fustanellat më të mira e sa kushtojnë.



Fig. 25 — Veshje gruaje shqiptare nga ishulli Hidra (viti 1825) (sipas Stackelberg).



Fig. 27 — Veshje gruaje shqiptare nga rrethet e Athinës. Viti 1803 (sipas J. L. Bartholdy, «Voyage en Grèce»).



Fig. 26 — Bareshtë nga Kepi Sunit në Atikë. Viti 1826 (sipas Pouqueville).




Fig. 28 — Ushtar shqiptar nga Moreja (Greqi). Viti 1803, (sipas J. L. Bartheldy, Voyage en Grèce).



Fig. 29 — Vajzë shqiptare nga Livadhaja (Greqi).
Viti 1803. (sipas J. L. Bartholdy, Voyage de la
Grèce).



Fig. 30 — Familje shqiptare në Arkadi. Sipas Stackelbergut.



Fig. 31 — Burrë qytetar shqiptar. Viti 1826 (sipas F. Delpino).

folur për përdorimin e kostumit me fustanellë në pashallëket e Novipazarit e të Prishtinës, ai vë në dukje këto analogji për fustanellën: «Fistani» ose fundi i shkurtër shqiptar... të kujton *kiltin* e keltëve dhe fundin e ushtarëve romakë», analogji për të cilat patën folur para tij edhe autorë të tjerë, sikurse e pamë më lart. Pastaj Buë përshkruan shkurt veshjen e shqiptarëve gegë¹³⁸, të Arnautëve të Moezisë së Epërme dhe të Toskëve dhe së fundi flet përmbledhtas edhe për veshjet e grave të malësisë, të qyteteve etj.¹³⁹

Me syrin e një vrojtuesi objektiv i ka parë e i ka vlerësuar kostumet popullore shqiptare konsulli austriak J. G. Hahn, si domos për disa elemente të veçanta si janë flokata, fesi etj.¹⁴⁰ Në udhëtimin e tij gjatë luginës së Drinit ai pati konstatuar se në Karmë, afër Pukës, burrat mbanin veshjen me tirq të ngushtë të bardhë, zbukuruar me gajtan të zi. «Dukej përnjëherë-komenton ai-që ajo veshje nuk ishte bërë as për një bujk as për një njeri dosido por për një luftëtar.¹⁴¹ Një shënim të vlefshëm kemi prej Hahn-it edhe përsa i përket përdorimit të kostumit me fustanellë në viset e veriut, gjatë luginës së Drinit. «Ne u çuditëm kur konstatuam — dëshmon ai — që në Bicaj (rrethi i Kukësit — A. Gj.), fustanella përdorej si veshje burrash në një masë mbizotëruese. Këtë veshje ne e kishim ndeshur edhe më parë... në Mërtur si edhe gjatë Drinit deri në Prizren, mirëpo në Bicaj ajo përbënte kostumin kombëtar më karakteristik».¹⁴²

Kostumeve shqiptare të mesit të shek. XIX u ka kushtuar vëmendjen e duhur gjatë dy udhëtimeve të tij në vise të ndryshme të Shqipërisë, në vitet 1847 dhe 1850 edhe udhëtari anglez E. Spenser, në veprën e tij në dy vëllime «Udhëtime në Turqinë Evropiane». Atij i detyrojmë, para së gjithash një paraqitje të kryengritsit fshatar Gjoleka diku në malet e Skraparit,¹⁴³ i veshur ashtu si e portretizon edhe kënga popullore me «fustanen mbi gju hajduçe». Më tej në veprën e tij ky autor thotë se ka takuar shqiptarë të veshur me fustanellë edhe në luginën pjellore të Toplicës, në Moezinë e Epërme, pra në perëndim të Nishit, përtej kufirit verilindor të krahinës autonome të Kosovës.¹⁴⁴ Ai përshkruan gjithashtu kostumin e shqiptarëve që e shoqëronin në udhëtimin e tij nga Prishtina në Mitrovicë, duke përmendur fustanellat e tyre të bardha, me qindra kinda, xhamadanët prej cohe ose kadifeje të kuqe, toslukët po ashtu prej cohe të kuqe, fesin, opingat, brezin e mëndafshhtë dhe natyrisht edhe armët e tyre (pushkën e gjatë, koburet e shpatën e harkuar), të gjitha të zbukuruara

138) A. Boué, *vep. cit.* f. 223.

139) Po atje f. 224.

140) J. G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854, f. 29.

141) J. G. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*, Wien, 1867 f. 50.

142) G. Hahn, po atje, f. 82.

143) Vinjetë në frontespicin e veprës së E. Spencerit, vëll. II.

144) E. Spencer, *Travels in European Turkey*, London 1853, vëll. II, f. 169.

pasurisht, dhe e quan këtë «veshje të një luftëtari shqiptar»¹⁴⁵. Spenseri shton se po këtë veshje mbante edhe shoqëruesi, një shqiptar nga Novobrdra, i cili dallohej në veshje nga pasuesit e tij vetëm sepse e kishte më të kushtueshme. Spenseri shënon gjithashtu se këtë kostum e ka parë edhe në Guci, qytet i vogël me 300 shtëpi: «Ne arritëm në Guci në një moment turbullire të madhe... Atje ishin Arnautët galantë me kostumin e tyre piktoresk, xhamadanin zbukuruar me gajtanë dhe fustanellën (kiltin) e bardhë...»¹⁴⁶.

Për të njohur shtrijën e veshjeve shqiptare një dëshmi interesante është ajo e diplomatit rus Hilferding, e vitit 1859, i cili thotë se popullsia në fushën e Sjenicës, në VP të Novipazarit, ku fillojnë vendbanimet shqiptare, gjysma është shqiptare myslimane, kurse gjysma tjetër ortodokse dhe se qytetarët e Sjenicës veshin kostumin popullor shqiptar me tirq të ngushtë zhguni, me xhamadan me gajtan të zi, kurse ata më të pasurit veshin fustanellën.¹⁴⁷

Veshjet qytetare të Shkodrës në mesin e shekullit të kaluar, për burrat e për gratë, për myslimanët dhe për katolikët i kemi të përshkruara mjaft gjerë në veprën e konsullit freng në Shkodër në këtë kohë H. Hekar (Hecquard)¹⁴⁸. Por le të theksojmë se një kontribut të rëndësishëm në hartimin e kësaj vepre ka dhënë letrari dhe patrioti ynë i mirënjohur i Rilindjes, Zef Jubani. Këtë gjë na e dëshmon me gojën plot ai vetë: «Zotni H. Hekar e përshkroi Shqipërinë e epër mbi gjurmët e një veprës sime të pabotueme e shtini mbrendë disa këngë të ndryshme të përmbledhjes sime, që unë ia kishëm huajtë për nderë vetëm në përthimin italisht.»¹⁴⁹ Përshkrimet e H. Hekar tregojnë se në mesin e shekullit XIX në këtë qytet, ndërsa burrat myslimanë vazhdonin të mbanin kostumin vendas (me fustanellë) në variante që u përshtateshin shtresave të ndryshme shoqërore, katolikët kishin adoptuar veshjen me brendavekë të zinj të gjatë deri nën gju, që kishte një ndikim të theksuar oriental. Këtë veshje

mbanin burrat në shekullin XIX, në shumë ishuj të Jonit e të Egjeut; në fakt ajo ishte e përhapur në disa shtresa shoqërore e kryesisht në të tregtarëve e të detarëve, si e vënë në dukje autorë të ndryshëm të kohës.

Një varg të dhënash me vlerë për veshjet në vitet '60 të shekullit XIX kemi edhe nga dy autorë të tjerë J. Roskiewicz dhe F. Kanic. I pari, në veprën e vet «Studime mbi Bosnjën dhe Herzegovinën»¹⁵⁰ në figurën që po parashtröjmë, titulluar «Një Arnaut» (fig. 32), paraqet veshjen e burrave shqip-



Fig. 32 — Shqiptar nga Novipazari. Viti 1868 (sipas J. Roskiewicz)

145) Po atje, f. 290.

146) Po atje f. 381.

147) Cituar sipas M. Krasniqi, *Gjurmë e gjurmime*, Prishtinë 1979, f. 294.

148) H. Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie ou Gueguerie*, Paris 1858.

149) Z. Jubani, *Vepra të zgjedhura*, Tiranë 1966, f. 55.

150) J. Roskiewicz, *Studien uher Bosnien und die Herzegovina*, Leipzig, und Wien 1868, fig. 3.

tarë në rrethinën e Novipazarit. Në këtë figurë vërejmë se fustanella e këtij shqiptari është e shkurtër deri te gjuri dhe ai mban krahëve një lloj struke të trashë. Kurse F. Kanic në udhëtimin e tij në vitin 1864, ka konstatuar se kostumi shqiptar shtrihet në Serbi deri në Kamenicë e Aleksinac (në veri të Nishit).¹⁵¹

ç) Veshje të shqiptarëve kryengritës nga Lidhja e Prizrenit në Shpalljen e Pavarësisë (1878-1912).

Çereku i fundit i shekullit XIX është i mbushur me ngjarje të rëndësishme politike. Gjallërohet në të katër anët e atdheut lëvizja kombëtare, shtohet lëvizja e armatosur në shumë rrethe, veçanërisht në zonat që kërcënohen t'i shkëputen atdheut nga lakmitë e fqinjëve dhe ndërhyrja brutale e Fuqive të Mëdha. Masat popullore ngrihen në këmbë, protestojnë kundër vendimeve të padrejta e luftojnë për mbrojtjen e trojeve të tyre. Çështja shqiptare tërheq vëmendjen e opinionit publik evropian. Diplomata e gazetarë të huaj vizitojnë zonat e kontestuara, shkruajnë e flasin për karakterin etnik të banorëve të tyre. Dhe për këtë arsye shumë vizitorë të huaj përpiqen të shkojnë pikërisht në zonat ku zhvillohen luftime sidomos në zonat verilindore. Në shkrimet e tyre ata kanë lënë ndër të tjera edhe informata me interes mbi gjendjen shpirtërore të malësorëve, jetesën, veshjen e sidomos armët e tyre. Në të tilla rrethana kuptohet lehtë se përse të dhënat mbi veshjet e grave janë shumë më të kufizuara se ato të burrave.

Në këtë grup duhen përmendur në radhë të parë ilustrimet e veprave të një grupi gazetarësh të huaj,¹⁵² të cilët në tetor të vitit 1879, janë përpjekur të arrijnë në zonat e luftimeve, në rrethinat e Plavës e të Gucisë për t'u siguruar për identitetin etnik të tyre dhe, me këtë rast, na kanë lënë disa nga paraqitjet më të bukura të veshjeve shqiptare për burra në zonat ku kanë kaluar. Duke u nisur prej Shkodre ata shkuan në Kastrat e pastaj në Selcë të Kelmendit, në shtëpinë e një luftëtari aktiv të

Lidhjes Shqiptare, Nik Lekës, por nuk mundën të vazhdojnë më tej. Ndër personazhet e paraqitur nga ky udhëtim (malësori Nik Leka (fig. 33), bylykbashi i Kelmendit Adem Aga (fig. 34), dhe dy roje kufiri (fig. 35, 36), dy janë të veshur me tirq shajaku gajtan të zi e gjurdinë karakteristike, kurse dy të tjerët me kostumin me fustanellë.



Fig. 33 — Veshje e malësorit Nik Leka në Selcë të Kelmendit. Viti 1879, (sipas A. Mayhew).

Meihju thotë se i veshur me kostumin e tij të mrekullueshëm shqiptari shquhet edhe sot për pamjen e tij piktoreske e madhështore në çdo pazar po aq sa atëherë kur Bajroni e pa atë në jug të vendit, në fillim të shekullit. «Por kjo figurë, — vazhdon ai, — nuk i përshtatet gegës katolik (të veshur me brenavek të gjera të zeza, të gjata deri

151) F. Kanitz, *Reise in Sud-Berbien und Nord-Bulgarien*, Wien 1868, f. 34.

152) Është fjala për A. Mayhew, e shkrimit e tij «*In Albania with the Ghegs*», të ilustruar nga R. C. Woodville dhe E. F. Knight e veprën e tij «*Albania, a narrative of a recent travel*» etj.



Fig. 34 — Shkodrani Adem Aga. Viti 1879 (sipas A. Mayhew).



Fig. 35. — Roje kufiri (pranë Gucisë). Viti 1879 (sipas A. Mayhew).



Fig. 36 — Roje kufiri në detyrë (pranë Gucisë). Viti 1879 (sipas A. Mayhew).

në gju — A. Gj). Kilti i bardhë si dëborë ose fustani, mbahet vetëm nga myslimanët e fushës në veri, kurse fiset malësore, që nga koha e Skënderbeut mbajnë veshjet e tyre të veçanta prej shajaku të bardhë. «Për Adem Agën, Mejhju thotë se në qytet (në Shkodër, ku e kishte takuar — A. Gj.) ai mbante fustanellën e gjerë e jelek të kuq të qëndisur, kurse kur do të nisej për në Kelmend veshi tirqet e bardhë me gajtanë të zi e gjurdinë¹⁵³. Po kjo gjë del edhe nga konstatimi i Naitit (Knight-it), sipas të cilit, në rrugët e Shkodrës njeriu mund të shihte si «myslimanin me fustanellë ashtu edhe arnautin (është fjala për malësorin — A. Gj.) me tirq, të dy të armatosur deri në dhëmbë». Në Shqipëri, thotë ai, mund të dallojmë tri klasa të ndryshme: «Shqiptarët myslimanë të veshur me fustanella që jetojnë nëpër qytete,... krenarë për kastën e tyre;

së dyti, katolikët qytetarë me brendavekë të gjerë ala turka e të gjata deri në gju, kryesisht tregtarë të pasur; së treti, fshatarët ose malësorët, këta janë arnautët krenarë, të pavarur e të panënshtuar turqve, veshur me tirq të bardhë të ngushtë..., gjithmonë të armatosur... Një i tillë është Nik Leka... ekzemplar i shkëlqyer i një luftëtari të ashpër...»¹⁵⁴. Piktori i këtij grupi R. C. Udëvil (Woodville), i cili e ka ilustruar me 12 vizatime shkrimin e Mejhju-it ka punuar me mjeshtëri dhe ka arritur të japë me besnikëri tipin e shqiptarit në pamjen e jashtme, në qëndrimin dhe në veshjet përkatëse. Për të mos u larguar nga subjekti mund të përmendim këtu edhe dy gravura të tjera që paraqesin gjithashtu luftëtarë të kësaj kohe.

Në gravurat e shumta të kësaj periudhe është vështirë të gjesh paraqitje burrash shqiptarë pa armë, qofshin vizatuar ata edhe larg zonave ku luftohej. Pushka e gjatë, koburet e brezit e shumë herë edhe shpata ose hanxhari, janë pjesë pothuaj e pamungueshme pajisjeve të tij. (fig. 37, 38).



Fig. 37 — Ushtarë shqiptarë viti 1805.

153) A. Mayhew, *In Albania with the Ghegs*, në «Scribner's Monthly» vol. XXI, Neu-York 1881, f. 381.

154) E. F. Knight, *Albania, a narrative of a recent travel*, London 1880, f. 117-120.



Fig. 38 — Shqiptarë që i kanë zënë pusi armikut. viti 1878.

Le të sjellim edhe disa shembuj si janë p.sh., dy gravura të T. Valerio (*Burrë e grua toskë*, 1875 dhe *Luftëtar pranë topit*, 1855 (fig. 39, 40.), gravurën e titulluar «Shqiptarë» (1882 fig. 37), në librin e M. Sadhërlend;¹⁵⁵ kuadrin e famshëm «Shqiptarë që shoqërojnë robinat» (fig. 41) të piktorit çek Çermak, atë të një bariu me brucë pranë Tivarit,¹⁵⁶ e shumë të tjera (fig. 42).

Nga veshjet e grave kanë gjetur pasqyrim në botimet e kësaj periudhe kryesisht ato të grave qytetare, bile të shtresave të pasura të vendit, ku kishte gjetur më fort përhapje moda orientale në veshje. Le të

shohim p.sh. veshjet e grave në një gravurë të L. E. Petrovic-it (fig. 43), veshjen e gruas në gravurën e Fritelit «Arnautë pasanikë» (fig. 44), një grua myslimane nga Prizreni,¹⁵⁷ (fig. 45)) gruan katolike të vizatuar nga R. C. Udevil, dy nga gratë e paraqitura në veprën e A. Meilanit të cituar më lart,¹⁵⁸ një bareshë të vizatuar nga Th. Valerio më 1976 e shumë të tjera.¹⁵⁹



Fig. 39 — Luftëtar shqiptar pranë topit. Viti 1855 (sipas T. Valerio).

155) M. Sutherland, *Turkey old and new*, London 1882, f. 365.

156) A. Meylan, *A. travers l'Albanie*, Paris 1885, f. 59.

157) Kjo gravurë ndodhet në librin E. Reculs, *Nouvelle géographie universelle*, Paris 1876, f. 162.

158) A. Meylan, *vep. cit.* f. 33.

159) Botuar në «*Le tour du monde*» XXXIII, Paris 1878, f. 411.



Fig. 40 — Burrë e grua toskë. Viti 1875 (sipas T. Valerio).

Fig. 41 — Shqiptarë që shoqërojnë robinat 1874 (sipas Çermak).



Fig. 42 — Bari nga rrethet e Tivarit.



Fig. 43 — Veshje grash shqiptare. 1875 (Meylan Petrovits).



ç) Veshje të arbëreshëve të Greqisë.

Këtë zbrazëti mbi veshjet e grave, e plotësojnë deri-diku gravurat që paraqesin kostumet e shqiptarëve të Greqisë e të Italisë gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX. Ndër to po përmendim veshjen e grave shqiptare të Eleusinës (fig. 46), ashtu si e ka parë udhëtari A. Prus (Proust) gjatë vizitës së tij në një familje ku bëhej një dasmë¹⁶⁰.



Fig. 44 — Shqiptarë pasanikë. 1876 (sipas E. Reclus).



Fig. 46 — Grua shqiptare nga Eleusina (Greqi) 1858 (vizatuar nga A. Proust).



Fig. 45 — Grua shqiptare nga Prizreni. 1876 (E. Reclus).

Ai shënon se vajzat e reja shqiptare kanë një zakon të veçantë: monedhat e arta që kanë për t'i marrë si pajë kur të marthohen, i mbajnë të varura në formë gjer-dani, në ballin e tyre.

Autori francez Hanri Bel,¹⁶¹ i cili ka bërë udhëtime në Greqi në vitet 1861-1868 sjell të dhëna me interes për veshjen e

160) Në «Le tour du monde, fash. V. Paris 1858, f. 72.

161) Po atje, fash. XXXII, Paris 1874, f. 7.

shqiptarëve të Greqisë të shoqëruara edhe me disa ilustrime që janë bërë, të shumtat, në bazë të fotografive ekzistuese. Veshja e gruas nga ishulli Hidra, është një veshje për të dalë; një variant të saj e kemi paraqitur në fig. 25 (sipas Stackelbergut). Autori na tërheq vëmendjen tek mbulesa e kokës e bërë prej një pëlhure të hollë mëndafshi zbukuruar me ar; pastaj ai thotë se këto gra mbanin përmbi këmishën e bardhë prej batiste, një mëngore ose mitan prej kadifeje të kuqe, qendisur me ar, që ishte e ngushtë e mjaft e hapur përpara dhe mëngët i kishte gjithashtu të ngushta; ato mbaronin me lapa të rrumbullakosura tek dora. Ai shton se vajzat e reja në Hidra punonin me avlemend pëlhura të holla mëndafshi të zbukuruara me fije ari.

Veshja e burrit dhe e gruas nga Glosa (shih fig. 47) është vizatuar në vend. Autori thotë se veshja e gruas përbëhej nga



Fig. 47 — Veshje burri dhe gruaje shqiptare nga Glosa (1877).

një këmishë pëlhure pambuku e gjatë, e ngushtë që kishte përfundi një rrip mëndafshi të kuq; mbi këtë këmishë vishej një lloj manteli i gjatë gjer te gjuri, me mëngë të gjera të zbukuruara me qendisje ngjyre të kuqe mbi të akoma një lloj jeleku shumë i shkurtër, me mëngë të ngushta e të gjata deri tek bërryli ¹⁶². Ai jep më poshtë veshjen e një shqiptari mysliman me fustanellë (fig. 48)¹⁶³, dhe së fundi atë të një gruaje shqiptare nga fshatrat pranë Kalavritës. (fig. 49))¹⁶⁴.



Fig. 48 — Burrë shqiptar mysliman. 1878.

Në Tab. VI b paraqitet veshja e grave arvanite të Salaminës, kurse në fig. 50, 51, 52 dhe Tab. VII veshje të arbëreshëve të Italisë.

162) Po atje, f. 72.

163) » , fash. XXXIII, f. 102.

164) » XLVII, f. 237.



Fig. 49 — Shqiptare nga rrethet e Kalavrites (Greqi).



Fig. 50 — Familje nga arbëreshët e Kalabrisë (gravurë N. Lako).

Fig. 51 — Veshje gruaje arbëreshe 1910.



Fig. 52 — Veshje të arbëreshëve në Kalabri. (1910).

d) Burimet vendase nga gjysma e dytë e shek. XIX e këtej.

Krahas burimeve që përmendëm deri tani, për shekullin XIX ekzistojnë edhe një numër i mirë burimesh vendase. Freskat janë tashmë të rralla në këtë shekull, megjithatë nuk mungon edhe në to ndonjë personazh laik, si p.sh: Hedhësi i farës e ndonjë tjetër.

Në gjysmën e dytë të shekullit, sidomos në tridhjetë vjetët e fundit, një burim autentik me shumë vlerë janë fotografitë e bëra në studiot e fotografëve që punonin tashmë në qendrat qytetare kryesore të vendit. Midis tyre, materiale me interes të madh për studimin e veshjeve gjenden në fototekën shumë të pasur të Marubit në Shkodër, si fotografi më i vjetër, i pasuar më vonë edhe nga fotografë të tjerë, si në Shkodër ashtu edhe në qytete të tjera, ndër të cilët shquhet pa dyshim piktori ynë i mirënjohur Kolë Idromeno, që ishte edhe fotograf.



Fig. 54 -- Fshatarë nga fusha (foto Marubi)



Fig. 53 — Grua nga Shllaku, 1870. (foto Marubi)

Nga Marubi fotografitë që paraqesin veshje të kohës janë me mijëra, por u referohen kryesisht veshjeve qytetare dhe janë të pakta në krahasim me to, fotografitë e veshjeve popullore fshatare. Sidoqoftë ato paraqesin pa dyshim vlerë të madhe njohëse e dokumentare për studiuesin, mbi të gjitha sepse janë më besnike ndaj origjinalit. Krahasimi i materialeve vërteton pa mëdyshje se fototeka e pasur e Marubit u ka shërbyer shumë studiuesve të kohës për të hartuar dhe ilustruar veprat e tyre, por ata rallëherë e kanë cituar burimin e vyer prej nga i kanë marrë këto materiale. Kështu fotografi të shumta të Marubit kanë përdorur E. Shnaider (Schneider), L. Mihaçeviq (Mihaceviç), X. M. Çerminski (Czerminski), L. Penaci (Pennazzi), E. Degran (Degrand), F. Nopça (Nopcsa) etj. Në fig: (53, 54, 55), po paraqesim disa nga fotografitë më të hershme të Marubit me kostume popullore.

Në dy dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar studio fotografësh kishte edhe në Korçë (e ndoshta e në ndonjë qytet tjetër) sikurse dëshmojnë fotografi të shumta familjare që ruhen nëpër shtëpi, nga të cilat po paraqesim një ekzemplar me interes të bërë rreth vitit 1880 (shih foto 56).

Fig. 55 — Burrë e grua nga Shkodra (foto Marubi)



Fig. 56 — Familje pasanikësh korçarë rreth vitit 1880



Në fototekën etnografike të Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë ruhen edhe një numër i mirë fotografish që paraqesin kostumet popullore shqiptare për burra, të rrethinave të Dibrës e të Strugës, të cilët janë fotografuar në vitet e fundit të shekullit të kaluar në Manastir.¹⁶⁵ (fig. 57, 58).



Fig. 57 — Veshje burri me tirq (fotografuar në Manastir më 1898)

Duke kaluar në shqyrtimin e burimeve letrare vendase të kësaj periudhe, mendoj se në radhë të parë duhet të përmendim me respekt kujdesin me të cilin i ka përshkruar veshjet e personazheve kryesore, qytetarë a malësorë qofshin, rilindësi ynë i nderuar Pashko Vasa në romanin e vet «Bardha e Temalit». Ai i ka veshur ata në funksion



Fig. 58 — Veshje burri nga Berati (?) fotografuar në Manastir më 1898)

të rrethanave në të cilat vepronin, duke theksuar me kujdes edhe dallimet e shtresave të ndryshme shoqërore të cilave u përkisnin¹⁶⁶ Mjafton të krahasojmë, p.sh., veshjen e Aradit të Vlashajve me veshjen e malësorit Gjelosh etj.

Kontributi i patriotit tjetër të kësaj periudhe, Zef Jubanit, na është transmetuar në rrugë të tërthortë. E kemi fjalën për ndihmën e madhe që i ka dhënë konsullit frëng Hekar (Hecquard), të cilën e përmendëm edhe më lart. Të sjellim ndër mend këtu edhe njëherë pohimin e vetë Jubanit: «Zotni Hekar e përshkroi Shqipërinë e Epër në gjurmët e një veprës sime të pabotue-me». Në shumë vende të shkrimeve të tij Jubani jep vlerësime pozitive për kulturën popullore e traditat e mira të malësorëve

165) Është fjala për fotografi të bëra në vitet 1896-1898 nga foto Manaxhi.

166) Albanus Albano (Pashko Vasa), *Bardha e Temal* (Scenes de la vie albanise), Paris 1886. Shih edhe përkthimin shqip të bërë nga Y. Jaka, dhe të botuar në Prishtinë më 1969 me titull «Bardha e Temalit», Skena të jetës shqiptare.

dhe shtron nevojën e inkurajimit të tyre. Ai vëren se edhe shqiptarët e shpërngulur në Itali i kanë ruajtur këto tradita sidomos në veshje. «Gratë e tyre që janë më të qëndrueshme se tonat, mveshin ende xhokën dhe e stolisin kryet me kezën, siç përdorej ndër kohnat e lashta në Shqipëri; edhe në punët ma të vogla shtëpiake rrujnjë me imtësi zakonet e vjetra, të sjelluna prej Shqipnie që prej katër shekujsh e këndej».¹⁶⁷ Me interes në veprën e tij janë gjithashtu disa të dhëna mbi tregtinë e Shkodrës ku përmenden edhe artikuj importi që kanë të bëjnë me veshjet.¹⁶⁸

Rilindës të tjerë po ashtu nuk kanë munguar të shfaqin vlerësime të ndryshme mbi veshjet popullore. Kështu ideologu e dijetari Sami Frashëri, i ka çmuar veshjet dhe aspekte të tjera të kulturës popullore si një tregues etnik.¹⁶⁹ Kurse në një vend tjetër, duke konstatuar rënien dhe varfërimin e vendit nën shtypjen e madhe politike e shoqërore të pushtimit të huaj, ka shkruar: «Ata shqiptarë që pak kohë më parë ishin të veshur me rroba të arta e të farkuarë me armë të argjenta e të lara, ata a të bijt e tyre janë sot lakuriq me një këmishë që s'ka ku ta zërë as qeni.»¹⁷⁰

Mendimin se veshjet popullore janë pjesë e trashëgimisë së vyer kombëtare, e ka shfaqur në shkrimet e tij edhe Fan Noli. Ja se ç'ka thënë ai në fjalën e mbajtur në një miting të madh në qershor të vitit 1911: «Natyrisht gjuha, veshja, vallet, zakonet, traditat historia dhe përgjithësisht shpirta dhe gjenia kombëtare janë ato që e ndajnë (një popull) nga të tjerët dhe këto duhen mësuar dhe lëruar».¹⁷¹ Këtu ka pa dyshim rëndësi momenti historik kur janë shfaqur këto mendime. Jemi në kohën e një shpërkëtimi të frymës kombëtare, në kohën e kryengritjeve të viteve 1910-1911, e këto fjalë të Nolit ishin një thirrje për të vlerësuar pikërisht ato tradita që shprehnin më qartë individualitetin kombëtar të popullit tonë.

Në këtë kuadër duhet parë edhe përpjekja e një punëtori të palodhur si ishte N. Lako, për të paraqitur një seri mjaft

të plotë kostumesh shqiptare të dy shekujve të fundit, duke ribotuar në formë kartolinash, gravura autorësh të ndryshëm me veshje shqiptare. Ato qenë pa dyshim një propagandim i mirë i pasurisë së kulturës popullore shqiptare dhe i shërbenin rritjes së ndjenjës e të krenarisë kombëtare.

dh) Pak fjalë mbi evolucionin e veshjeve në fshat e në qytet nga 1912 deri në prag të çlirimit (1944).

Pasi parashtruam burimet ekzistuese dhe disa vlerësime të autorëve të ndryshëm mbi veshjet popullore, le të shohim tani si paraqitet kuadri i përgjithshëm i evolucionit të veshjes në fshat e në qytet.

Deri në prag të Shpalljes së Pavarësisë (1912) pothuaj të gjithë fshatarët vazhdonin të mbanin veshjet popullore lokale të përgatitura pjesërisht brenda ekonomisë shtëpiake sipas prerjeve tradicionale, me tipa të kristalizuar mirë, të cilët trajtohen më gjatë në kapitullin kushtuar klasifikimit të veshjeve popullore. Kurse veshjet «alla frënga» për burra kishin hyrë në përdorim në shtresa të ndryshme shoqërore të qytetit që në çerekun e fundit të shekullit XIX, si provohet nga shumë fotografi të kohës.

Vëmë re se mbas 1912 përdorimi i fustanellës për burra, e cila më përpara shtrihet pothuaj në gjithë vendin, erdhi duke u ngushtuar shumë dhe brenda pak viteve (deri rreth vitit 1920) ajo doli krejt nga përdorimi. Po kështu doli nga përdorimi në këtë kohë veshja e burrave me dollamë ose cibun shajaku dhe këmishë të bardhë nën të. Më anë tjetër erdhi duke u zgjeruar përhapja e veshjes me tirq, e cila mbahej tashmë jo vetëm në gjithë Shqipërinë Veriore, por edhe në pjesën juglindore të vendit, ajo u shtri në rrethin e Librazhdit e deri në Pogradec. Po kështu një shtrirje më të madhe sesa përpara mori veshja me brekushe, e cila prej zonës tradicionale të saj që ishte pjesa perëndi-

167) Z. Jubani, *vep. e cit.*, f. 86.

168) Po atje, f. 89.

169) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhet*, Prishtinë, 1978, f. 57.

170) Po atje, f. 52.

171) «Dielli e Flamuri» Boston, 16 qershor 1911.

more e Shqipërisë së Mesme erdhi duke u shtrirë drejt Jugut në Dumre, Sulovë, Myzeqe etj. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX një përhapje të konsiderueshme patën marrë në shumë zona të Jugut, poret e gjera prej cohe ose shajaku blu (ose të zi), të cilat arrinin deri në gju (Labëri, Mallakastër, rrethet e Sarandës e të Gjirokastrës etj.). Ato zëvendësuan gjithashtu fustanellën.

Përsa u përket veshjeve të grave ndryshimet që ngjanë janë të një natyre tjetër. Këtu ka rëndësi të theksohet se gjatë pjesës së dytë të shekullit XIX, në një varg krahinash të myslimanizuara (si Opari, Skrapari, Kolonja, Labëria e Çamëria etj.) veshjet e mëparshme popullore u zëvendësuan dalngadalë me veshje të tipit oriental (çitjane ose tumane me anteri të gjata, xhybe etj.), të cilat kishin hyrë më përpara në veshjen qytetare. Ato vazhduan të mbahen në disa krahina deri rreth vitit 1920 duke u transformuar gradualisht derisa u zëvendësuan me fustane të gjata deri në pulpë të këmbës që kishin një prerje pothuaj qytetare.

Si shihet, Lufta e Parë Botërore shënoi një kthesë të madhe në modën e veshjeve, kthesë që preku në një shkallë të gjerë jo vetëm veshjet qytetare, por edhe ato fshatare.

U rrallua gjithnjë e më fort punimi e përdorimi i pëlhurave të pambukta të punuara në avlemend, duke u zëvendësuar me kambrikun e fabrikuar, sidomos në krahinat që kishin tradita më pak të zhvilluara në punimin e tyre. Edhe në skajet më të largëta të vendit hynë në përdorim të gjërë shamitë e mëdha të importuara si për në kokë, ashtu edhe për në brez. Në vend të shajakut shtresat e mesme e të pasura përdornin tashmë cohë ose kadife të importuar për jelekët e xhamadanët e tyre. Tregu u ofronte në këtë kohë fshatarëve edhe një mori artikujsh të imët që përdorshin për zbukurimet e ndryshme të veshjes dhe të aksesorëve të saj. Të tillë artikuj ishin rruazat, teminat, gajtani i ngjyrosur, gajtan ari e argjendi, shirita të ndryshëm si edhe stolitë e shumta metalike për gra edhe për burra.

Për veshjen qytetare, periudha 1912-1939 është periudha e ndryshimeve të mëdha. Prirja themelore e këtyre ndryshimeve ishte largimi i shpejtë nga moda orientale, e cila pati hyrë në popullsinë e shumë qyteteve sidomos në dy shekujt e fundit të pushtimit turk — dhe përhapja e vrull-

shme e modës perëndimore. Në disa qytete kjo e fundit u shtri me shpejtësi të madhe pothuaj në të gjitha shtresat e popullsisë, sidomos për moshën e re e të mesme. Kjo duhet shpjeguar, veç të tjerash, edhe me shkaqe politike, sepse, të ndiqje modën turke në veshje në një kohë kur luftohej për afirmimin dhe konsolidimin e shtetit shqiptar të porsashpallur si shtet i pavarur, ishte një shenjë e hapët konservatorizmi, një gjest jopatriotik, e kjo në radhë të parë për burrat.

Rrobot «alla frënga» në veshjen e burrave të krishterë e myslimanë, mbas 1912-ës visheshin radhazi në Korçë, Gjirokastrë etj., por nuk duhet harruar se shumë burra të aristokracisë qytetare patën filluar t'i përdornin ato që në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar (shih. fig. 56). Mbas Luftës së Parë Botërore, për dhëndëri djemtë vishnin kostum të zi, këmbë të bardhë me qafore e mansheta të kollarisura dhe në vend të kravatës vinin një papijon të bardhë ose të zi. Në kokë vinin kapela të zeza bombé (derbi) ose republikë dhe këpucët i mbanin të zeza lustrina. Djemtë e borgjezisë së lartë vishnin redingote dhe në duart do të kishin dorashka të bardha dhe një bastun me kokë argjendi. Mbas 1912 vajzat qytetare përnusëri visheshin radhazi me fustan të bardhë, këpucë të bardha me taka, velo të bardhë në kokë etj. Gratë vishnin fustane të gjata, me trup të ngushtë e mëngë mollokof, me pelerina të hedhura krahëve, kapela me strehë të gjerë e ombrella me bisht të gjatë. Këto veshje i shohim në fotografi të shumta familjare të kohës në qytete të ndryshme të vendit.

Rrobot «alla frënga» patën hyrë pothuaj njëkohësisht në qytetet Korçë, Gjirokastrë, Durrës e Vlorë. Ato patën filluar po ashtu të hyjnë edhe në qytetet e tjera si Shkodër, Tiranë e Elbasan, por këtu ato u përgjithësuan me njëfarë vështirësie. Shtresa të gjera të popullsisë në këto qytete (sidomos myslimanët) edhe mbas 1912-ës vazhduan të mbajnë veshje popullore ose orientale (me brekesha, tirq, brandavekë etj.) duke krijuar atë laramani kontrastuese në rrugët e këtyre qyteteve, që është bërë aq herë subjekt shkrimesh satirike në shtypin e kohës.


Mbas vitit 1925 fustanet e grave shkurtohen e thjeshtohen; pelerinat zëvendësohen me pallto. Fillojnë të përdoren në shtresat e pasura gëzofe të shtrenjta (dhelpra, kunadhe etj.) që vihen për qark qafës. Në për-

gjithësi moda e perëndimit fillon të ndiqet me besnikëri të plotë. Sillen katalogë mode nga Parisi dhe shumë rrobaqepës shkojnë të bëjnë një stazh praktike në Paris, sepse kështu mund të sigurojnë një klientelë të mirë kur të kthehen në vend.

Në vitin 1929 shpallet një urdhëresë qeveritare për heqjen e festeve të burrave dhe të perçes e çarçafit që mbanin ende gratë myslimane në shumë qytete të vendit. Reagimet e shtresave konservatore e reaksionare qenë të mëdha, për të frenuar entuziazmin me të cilin u përpoqën ta venë në jetë këtë ndryshim shtresat përparimtare të vendit. Publicisti i mirënjohur Chri-Chri, (Nonda Bulka), tallet hidhur në një pamflet: «Një hoxhë i bërtet me zë rrufe

Muhametit: — «Mblidhu mendjen shqiptarve që duan ta bëjnë Shqipërinë kauristan duke na vënë kapella dhe duke u hequr çarçafët grave». Po kështu bëri edhe Migjeni në prozën e titulluar «Të çelen arkapijat».

Duke mbyllur këtë paraqitje të veshjeve në Shqipëri në shekujt XIX-XX duhet të themi se në prag të Çlirimit kostumi qytetar për gra e për burra ishte transformuar nën ndikimin e drejtpërdrejtë të zhvillimit ekonomik e shoqëror, ishte larguar nga veshjet popullore, të cilat vazhdonin të mbaheshin ende në zona të ndryshme të vendit, sigurisht në faza të evoluara, në përshtatje me mundësitë e tregut dhe me gjendjen shoqërore të bartësit.



VARIACIONE TË VESHJEVE POPULLORE SIPAS FUNKSIONIT QË KRYEJNË

Atij që studion veshjet popullore, përveç morfologjisë së pasur dhe interesante, për të cilën flitet në kreun kushtuar klasifikimit të tyre, i tërheqin vemendjen edhe semantika e simbolika e veshjeve, pra kuptimet e ndryshme që rezultojnë nga zgjedhja dhe mënyra e kombinimit dhe e zbukurimit të pjesëve të ndryshme në një të tërë, lidhur me funksionin kryesor të kostumit në rrethanat për të cilat vishet.

Studiues të ndryshëm që janë marrë me këtë aspekt të veshjeve dallojnë katër funksione kryesore të kostumit, që janë funksioni praktik, ai estetik, funksioni ceremonial dhe ai ritual. Këto funksione janë të lidhur ngushtë njëri me tjetrin, shumëherë të ndërvarur njëri nga tjetri dhe me mundësi të shumta kombinimesh që ndjekin shndërrimet që pëson kostumi kur kalon nga përdorimi i përditshëm në atë për të dalë ose anasjelltas. Ndodh kështu sepse, ndërsa në kostumin e përditshëm p.sh., mbizotëron funksioni praktik e ndihet më dobët funksioni estetik, në kostumin e martesës mbizotëron funksioni ritual dhe ai estetik dhe është mjaft i zbehur funksioni praktik. Por, më anë tjetër materiale të shumta tregojnë qartë se në veshjet shprehet gjithashtu përkatësia krahinore e kombëtare e bartësit, përkatësia social-klasore e tij etj. Janë gjithashtu të pranishme dallime të shkallëzuara sipas grupmoshave kryesore për gjithë harkun e jetës, nga fëmijëria në pleqëri të shtyrë, si për femrat dhe për meshkujt. Shumica e këtyre funksioneve shprehen më qartë në kostumin për të dalë (festiv) sesa në atë të përditshmin (për punë), për arsye se disa funksione lidhen herë me kostumin si objekt i mirëfilltë veshjeje dhe herë me kostumin pjesërisht si veshje e pjesërisht si shenjë apo simbol, qoftë i përkatësisë social-klasore apo etnike, qoftë i gjendjes civile të bartësit etj.

Veshja, në përgjithësi ka një funksion informues mbi personin që kemi përpara, pikërisht sepse pasqyron ndryshimet që përmendëm më lart dhe me këtë paraqitje njeriu merr kontakt me njerëzit e tjerë. Nëse funksioni praktik i veshjes është më i qartë dhe më i lehtë për t'u kapur, funksionet e tjera shoqërore të saj mund t'i kapë përgjithësisht vetëm syri i atij që është mësuar t'i dallojë që kur është i vogël, nga përvoja dhe kontaktet e vijueshme me mjedisin përkatës; të tjerët duhet të mësojnë t'i njohin e t'i kuptojnë ashtu sikurse mësojnë të lexojnë gjuhë të huaja dhe t'i kuptojnë si një kod, si njohin, p.sh., shoferët shenjat e rrugëve.

Nëpërmjet veshjes pra, qoftë edhe jashtë dëshirës së bartësit ndonjëherë, mund të përcaktojmë përkatësinë social-klasore të tij, nivelin kulturor etj. Por, më anë tjetër veshja duhet të kënaqë edhe kërkesat e mjedisit shoqëror, të respektojë shijen e tij, dhe, në përgjithësi t'u konformohet kërkesave të kolektivit ose rregullave të vendosura prej tij. Risitë në kostumin popullor nuk mund të bëhen sipas shijeve vetjake, por vetëm mbas një miratimi kolektiv.

Tani le të shohim me shembuj konkretë disa nga ndryshimet që pëson veshja lidhur me funksionin kryesor që ajo kryen.

I. VESHJA E PËRDITSHME OSE PËR PUNË.

Veshja e përditshme bie më fort në sy për karakterin e saj praktik, në përshtatje me lëvizjet e shumta të gjymtyrëve të trupit në proceset e ndryshme të punës qoftë jashtë në natyrë, qoftë brenda në shtëpi a në mjedise të tjera pune. Në përgjithësi

ajo dallohet për një farë thjeshtësie (përbrenda tipit dhe variantit të cilit i përket), zbukurimet i ka të kufizuara etj.

1. Pjesë të posaçme veshjesh për punë dhe përshtatje në të veshur.

Materiali etnografik i mbledhur dhe vrojtimet e bëra në terren në zona të ndryshme të vendit, tregojnë se, në gjysmën e parë të shekullit XX, fshatarët përgjithësisht, përgatishnin veshje të posaçme për të mbajtur përditë dhe të tjera për të veshur në ditë të kremte ose për të dalë. Kostumi i përditshëm mund të ishte një variant më i thjeshtuar i veshjes «së mirë» që mbahej në zonën përkatëse, duke qenë shpeshherë dhe varianti më arkaik, qoftë si strukturë në tërësi, qoftë nga niveli i zhvillimit të pjesëve përbërëse. Veç kësaj, edhe përsa i përket zbukurimit, duke qenë se veshja e përditshme bëhej me material më pak të kushtueshëm, edhe zbukurimet i kishte të një cilësie modeste, madje në ndonjë element ato edhe mungonin fare.

Të sjellim disa shembuj, këmishët që merrnin në pajë vajzat e Zadrimesh ishin tre llojesh: a) për punë, b) «të mira» domethënë për të dalë, dhe c) «ma e mira», për nusëri. Në shumë zona këmishët e përditshme për punë, përgatiteshin prej një pëlhere më të plotë, e cila mund të ishte prej liri ose kërpi, ndërsa këmishët e mira prej pëlhere të mirë pambuku ose mëndafshi, të stolitur me qenarë etj. Këmishët e përditshme, të cilat në Përrenjas (rr. Librazhd) quheshin «*këmishë rendje*» (pra të rendit, të radhës) kishin më pak kinda anëve, domethënë 3-4 në çdo anë, ndërsa këmishët e mira kishin 18-24 kinda në çdo anë. Ndryshime vihen re aty-këtu edhe për brezin. Një brez bezeje të thjeshtë, me vija, «brez radhëtar»¹, si e quanin në Borsh (rr. Sarandë) mbanin për punë gratë e Bregdetit, ndërsa në veshjen për të dalë përdornin një brez mëndafshi. Në shumë zona të Shqipërisë së Mesme ishte traditë që vajza kur martohej të merrte në pajë

një numër të madh përparjesh të pambukta (40-60 copë) dhe mbulesash koke, ngjyrat dhe dekorit i të cilave ishin shumë të shkallëzuara; ato ishin të caktuara, një pjesë për punë e tjera për të dalë. Ndryshime të këtij karakteri viheshin re edhe tek pjesë të tjera të kostumit si jelekët, xhoket etj.

Ndeshen raste kur veshja e përditshme përbëhej pothuaj nga të njëjtat pjesë si ajo e festave, por me material më të lirë ose të përgatitur në shtëpi. Kështu ngjiste, psh. në kostumin e Lunxhërisë, në atë të Delvinës etj. Sidoqoftë, po të shqyrtohen me kujdes marrëveshjet që bëheshin midis të dy palëve në raste martesash, bie në sy fakti që për vajzën që martohej do të përgatiteshin disa palë tesha («3 fill petka» deri në 6-7 palë, sipas shtresës shoqërore e gjendjes ekonomike të familjeve përkatëse) ku më të thjeshtat ishin veshjet e përditshme për punë. Këtë zakon e kanë ruajtur edhe arbëreshët e Italisë, të cilët me rastin e martesës përgatishnin tri palë rroba a) për të veshur në ditë pune, b) për të djela dhe c) rrobat e mira» që i vishnin me rastin e martesës dhe pastaj në festat e mëdha si pashkët etj. Kështu p.sh., për ditë pune nuk vishej «*ncilona*» e mëndafshhtë, me pala e qëndisje, por «*xhëgona*» e thjeshtë e zezë etj.²

Si veshje pune mund të përdoreshin edhe «rrobat e mira», që tashmë ishin vjetëruar. P.sh. në Kolonjë, një cibun i vjetëruar mund të përdorej edhe si «përveshkë» për ta vënë në shpinë kur mbanje ngarkesa, që të mbroheshin nga fërkimi e konsumimi i shpejtë rrobat e tjera.³ Tek të vobektit aty-këtu vihej re edhe veshja së prapthi e pjesëve të sipërme të kostumit në ditë pune, si p.sh., e xhokave apo e përparjeve, kurse për të dalë i kthenin së mbari.⁴ Është e qartë se kjo bëhej për t'i ruajtur për një kohë më të gjatë në gjendje të mirë ngjyrat dhe ornamentet e tyre.

Në Mirditë pajisje e zakonshme e gruas në veshjen për punë ishte tërkuza e leshtë dhe «*shpinakja*», që përdoreshin për të ngarkuar barrë në shpinë. (fig. 59) Edhe në pajë vajza merrte një tërkuzë. Po kështu pjesë e pajës ishin edhe «tojet» (fig. 60) e

1) Përgjigje pyetësorit mbi veshjet popullore në Borsh (Sarandë) 1973, AE.

2) Sipas R. Parisi, *Costumi albanesi d'Italia*, në «Rivista Europea» Roma 1881, f. 546, K. K. Shqiptarët e Italisë. Vësja, «Leka» 1935 nr. 6, f. 248.

3) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore në Rehovë (Kolonjë) 1973 Arkivi Etnografik (AE).

4) Përgjigje pyetësorit të veshjeve në Kakodhiq (Sarandë) 1974 AE.



Fig. 59 — Grua pa ngarkesë por me tojet në brez (Derjan, Mat).



Fig. 60. — Tojet, mjet për të lidhur ngarkesën në shpinë.

«shrregullat» e grave të zonës së Kallmetit (rr. Lezhë)⁵. Me to gratë mbanin në

shpinë shumë lloje ngarkesash, që nga bu-lierat me ujë (fig. 61) e djepi i fëmijës deri tek drutë për ngrohje e gjethet e dushkut për kafshët. Në Myzeqe, ku praktikohet bartja në kokë, (fig. 62) vajzat merrnin në pajë për këtë qëllim disa «kurorëza» të le-shta⁶; kurorëza vihej në kokë sidomos për të mbajtur enët e ujit. (fig. 63). Dëshmitë ar-keologjike tregojnë se të tilla kurora për-doreshin në viset e Mesdheut për të mbaj-tur pesha të ndryshme në kokë, të paktën që në antikitet.⁷



Fig. 61 — Grua mirditore me një enë uji në shpinë (Rrëshen).

Veshja e përditshme kishte, në përgji-thësi forma të tilla që lejonin lëvizje të lira të gjymtyrëve, mënjanonin ndrydhjet e muskulaturës, sidomos të belit e të kryqeve dhe e mbronin njeriun nga ndryshimet e temperaturës gjatë kohës së punës. Jo ras-

5) Shih Rr. Zojzi, *Veshje popullore të rrethit të Lezhës*, Buletin i USH, 1958 f. 225; M. Prendushi, *Vështrim etnografik mbi zonën e Kallmetit*, «Etnografia shqiptare» II, Tiranë 1963, f. 243.

6) Ll. Mitrushi, *Veshje myzeqare të shek. XIX-XX*, «Etnografia shqiptare» VII, Tiranë 1976, f. 160.

7) Shih Dahremberg et Saglio, *Dictionnaire des Antiquités greco-romanes*, zëri: «cecticullus» (fig. 1339, 1340).

2. Përshtatje të veshjeve sipas stinës.

Në veshjet popullore ka pasur edhe shumë përshtatje sipas stinës. Kjo bëhej duke zëvendësuar disa pjesë veshjeje si psh., jekët e xhamadanet e pambuktë të verës me të tjerë të leshtë për kohë më të freskët, por edhe duke shtuar pjesë të tjera të posaçme. Kështu në Zadrinë, gjatë punëve bujqësore të verës shumë burra mbanin brekushe pëlhure liri ose pambuku, kurse në stinën e ftohtë vishnin tirqet prej shajaku. Po kështu ndodhte edhe në Mirditë e në Rrafshin e Dukagjinit (Kosovë) ku gjatë verës burrat nuk mbanin tirq, por mbi brekët e gjata prej pëlhure, lëshonin këmishën, e cila u arrinte deri në gjunjët (fig. 66).



Fig. 66 — Burrë kosovar me tirq e xhurdi (herkë) për stinën e ftohtë (katundi Isniq, Kosovë).

Për të mbrojtur këmbët nga lagështia, në shumë krahina, burrat mbathnin jo vetëm çorape leshi, por edhe shputa të dhirta për mbi to, e pastaj opingat. Kërcinjtë e

këmbës gjithashtu i mbronin me kallçinj shajaku, që i vinin mbi tirqit e zakonshëm. Në veshjet e përditshme janë përdorur, jo vetëm lloje të ndryshme kapuçash (llabane, kauk, kapole, gaxhup, gugë, kaculitë), por edhe veshje të trasha të sipërme (xhurdi, kaporane, jakuce, morosë, xhuli) të pajisura qoftë me kapuç, qoftë me një jakë të madhe katrore, me ose pa thekë, e cila mund të kthehej lehtë në kapuç për ta mbrojtur kokën nga erërat e forta dimërore, nga rreshjet, nga të ftohtit (fig. 67). Këto pjesë veshjesh, me ndryshime të vogla lokale, janë mbajtur rëndom në gjithë vendin, nga veriu në jug. Kjo tregon se përvoja e lashtë popullore u është përshtatur kushteve klimatike të vendit tonë që ndodhet në brezin mesdhetar dhe karakterizohet nga reshje të shpeshta. Ata që puna i detyronte të rrinin jashtë në natyrë edhe në kohë dimri, kryesisht barinjtë, përdornin disa veshje të sipërme më të rënda. Të tilla ishin: struka, bërruci (fig. 68), flokata, tall-



Fig. 67 — Grua mirditore me xhurdi.



Fig. 68 — Burrë me bërruc (Labëri)

ganet, jepinxhet e gunat (fig. 69, 70), kllashat etj., të shumtat veshje në formë pelerrine, pa mëngë ose me mëngë thjesht dekorative, të pajisura me kapuçë. Ato ishin të ngrohta e të papërshkueshme nga uji, sepse përgatiteshin zakonisht me endje të leshta, të rrahura në shkaltore; për të mos thithur ujë, përdorej leshi i deles i përzier me lesh dhie. Kështu, edhe në reshjet më të forta sigurohej një mbrojtje efektive. Me këto lloj gunash barinjët mbulohehin për të fjetur dhe shumë herë, të mbështjellë me to, e kalonin edhe natën jashtë, pranë bagëtive në kullotë. Ato kishin zakonisht ngjyrat natyrore të leshit, pra të bardhë; gri të përhimtë, të murme ose ishin ngjyer bojë kafe e errët a e zezë.

Një veshje e posaçme dimri ishte edhe «deleshi» i bërë me tri lëkurë të paqethura delesh qepur si një jelek i gjatë (fig. 4) i përdorur gjerësisht edhe në Mesjetë. Ky vazhdonte të përdorej edhe në shekullin

tonë në arbëreshët e Italisë⁹, përdorej gjithashtu në Shqipërinë Veriperëndimore, si nga burrat ashtu edhe nga gratë. Në trevat e Shqipërisë Verilindore edhe në Kosovë mbahej edhe një gozhup i gjatë, për të cilin duheshin pa dyshim, më shumë lëkura (fig. 71).



Fig. 69 — Malësor me gunë të gjerë (jepinxhe). (Kosovë).

Të gjitha këto përshtatje të veshjeve popullore sipas stinës kanë të bëjnë me funksionin praktik mbrojtës që kryen veshja, sidomos ajo e përditshmja.

Përsa i përket vlerës estetike të kostumit të përditshëm mund të thuhet se nuk mungojnë përpjekjet për ta bërë sa më të paraqitshëm e më të pëlqyeshëm, kryesisht duke e mbajtur të pastër e të rregullt, edhe pse materiali i përdorur për konfeksionimin e tij është më i thjeshtë, më i lirë e me zbukurime të pakta. Për kostumin e përditshëm përdorehin zakonisht materiale të

⁹) H. B. Frasnjoti, *La pastorizia a Frascineto*, Tradizioni popolari albanesi della Calabria, Roma 1964.

prodhimit shtëpiak, ndërsa për veshjen për të dalë, përdorej material i fabrikuar, i blerë në treg. Por shpeshherë ka rëndësi të dimë se kë çmon fshatari si më të bukur sipas shijes së tij estetike. Ne vlerësojmë si më të bukur p.sh., veshjen e grave të rrethit të Tiranës, me linjë të gjatë pëlhere të pambuktë, që e përmendim më lart, ndërsa fshatarëve të kësaj zone në vitet '30 u dukej shumë më i bukur kostumi qytetar me dimite mëndafshi, të cilin e kishin adoptuar si veshje martese.



Fig. 70 — Bari me gunë të dhirtë (Mallakastër, Fier).




Fig. 71 — Bari me gozhup (rrethi i Kukësit).

II. DALLIME TË VESHJES SIPAS MOSHËS, SEKSIT E GJENDJES CIVILE

Kur flasim për dallime që karakterizojnë veshjen sipas seksit, moshës dhe gjendjes civile të bartësit duhet të mbajmë parasysh se në to funksioni praktik i veshjes natyrisht është i pranishëm por, krahas tij, ndihen me intensitet të shkallëzuar edhe funksione të tjera sidomos ai estetik dhe ai ritual.

1) Ndryshime në veshje sipas moshës dhe seksit të bartësit

Edhe dallimet sipas moshës e seksit janë një aspekt i funksionit shoqëror të veshjes. Të dhënat e mbledhura mbi veshjet e fëmijëve janë ende të pakta. Megjithatë dimë se deri në prag të çlirimit kishte zona ku fëmijët deri në moshën 7-8 vjeç visheshin njësoj, si djemtë dhe vajzat, e konkretisht me një këmishë disi të gjatë prej pëlhere shtëpiake (fig. 72) ndonjëherë edhe të zbukuruar pak me motive të posaçme për këtë moshë, si ndodhte p.sh. në Myzeqe, ku këmishët e fëmijëve të kësaj moshe kishin si motiv zbukurimi një kaposh¹⁰ të vendosur tek zona e stomakut.



Fig. 72 — Veshje fëmije (Mat).

Ky motiv nuk qe i qendisur, por i endur në pëlhurë gjë që tregon se pëlhura në fjalë endej posaçërisht për këmishët e fëmijëve. Duhet shtuar këtu se në rrobet e fëmijëve shiheshin shpesh, të qepur ose të varur me

penjë, objekte të ndryshme me funksion magjik si p.sh., dy-tri pare metalike, guaska deti, dhëmbë kafshësh dhe hajmali tre-këndshe.

Më vonë, duke u rritur fëmijët fillonin të mbanin edhe të mbathura, brez, jelekë të thjeshtë që ndryshonin si në prerje dhe në ngjyra, të djemve nga të vajzave. Po ashtu dallonin edhe tek flokët, të cilët djemtë i prisnin fare shkurt, kurse vajzat mbanin baluke në ballë e prapa flokë të shkurtër (fig. 73, 74, 75, 76).

Veshjes së djemve, edhe mbas moshës 12-13 vjeç nuk i kushtohej ndonjë vëmendje e posaçme. Ata mbanin po atë tip veshjeje që mbanin të rriturit, por me disa thjeshtime, p.sh., sa qenë pa martuar nuk mund të vishnin fanellë me dorëza të zbukuruar as mëngore me mëngë të varura prapa e as këmishë me mëngë të gjera treçerekshe, pjesë këto që ishin attribute të kostumit të dhëndërisë në pjesën më të madhe të krahinave të Shqipërisë së Jugut.



Fig. 73 — Veshje e një djali të vogël rreth vitit 1908 (Korçë)

10) Shih Ll. Mitrushi, art. i cituar, f. 161.



Fig. 74 — Vajza të vogla zadrimore rreth vitit 1936 (rr. Lezhës)

Pra mund të themi se në veshjen e fëmijëve e të rinjve mbizotëronte funksioni praktik, por gradualisht manifestohej edhe specifika krahinore dhe dallimet socialklasore. (fig. 77, 78, 79).

Vajza bënte ndryshime të mëtejshme në veshjen e saj kur hynte në moshën e pubertetit (13-15 vjeç). Në këtë moshë ajo konsiderohej tashmë e rritur. Për të thekstruar këtë kapërcim nga një grup moshe në tjetrin, veshja e vajzave duhet të ishte përgjithësisht e thjeshtë, shumë e përmbajtur në ngjyra, me kërkesën e shprehur qarkrahet e këmbët, dhe sidomos flokët dhe deri diku balli. Këto rregulla shpreheshin me intensitet të ndryshëm nga një krahinë në tjetrën dhe kushtëzoheshin sigurisht edhe nga përkatësia fetare e të tjerë faktorë socialklasorë.

Në veshjet popullore të vajzave të rritura ngjyrat më të zakonshme ishin e bardha dhe e zeza, ngjyra këto që karakterizojnë edhe veshjen e grave të moshuara. Shtajnmec (Steinmetz), në fillim të shekullit tonë, ka vënë në dukje se në Nikaj (rr.



Fig. 75 — Veshje e një vajze shkollare (Gramsh, Zadrinë).

Tropojë) «vajzat e kishin të ndaluar të mbanin çfardo petk me ngjyrë të kuqe»¹¹. Në Rrafshin e Dukagjinit (Kosovë) vajzat e kësaj moshe mbajnë ende një veshje karakteristike të përbërë nga një bluzë e bardhë dhe një fund i ngushtë e i shkurtër, pa përparje (fig. 80).

Shpesh vajzat e rritura, për punë visheshin me rrobe të vjetëruara, që i hiqnin nga përdorimi pjesëtarë të tjerë të rritur të familjes dhe në shumë zona, nuk mbanin përparje por, edhe atje ku mbanin, përparjet e tyre ishin shumë më të thjeshta se ato të grave, kështu p.sh., në Zadrinë përparjet e vajzave ishin me vija ndërsa të nuseve me katrorë. Në Mirditë vajza e ndërronte brezin e kuq që kishte mbajtur deri në moshën 12-13 vjeç me një brez të zi. Po kështu ndryshonin në ngjyra edhe çorapet e vajzave nga ato të grave, e ndonjë-

11) Cituar sipas F. Nopsca, Albanien, Bauten, Trachten und Geräte, Leipzig 1926, f. 174.



Fig. 76 — Djalë e vajzë nga fshati Derven (Fushë-Krujë).

herë edhe në formë (si ndodhte me çorapet e nuseve në Mirditë).

Në veshjen e vajzave të rritura rëndësi të posaçme merre rregullimi i kokës, qoftë mënyra e mbajtjes së flokëve, qoftë mënyra e lidhjes së shamisë. Në moshën 13-14 vjeç, vajza që deri atëherë i kishte mbajtur flokët të shkurtër, fillonte t'i zgjaste, sepse kur të martohej duhet t'i kishte gërsheta të gjata. Por ajo duhej t'i mbështillte me kujdes flokët që të mos i dukeshin nga shamia. Vajzat e mbështillnin kokën, në të shumtët e rasteve, me shami të bardha ose të zeza të lidhura nën gushë; shamia duhet të ulej përpara sa të mbulononte ballin madje nganjëherë edhe sytë pjesërisht. Ja përse poeti popullor lutej: «Ngrije dy gishtrinj shaminë/ Të ta shoh një çikë sinë».¹²

Kishte edhe zona ku vajzat përdornin shami koke me ngjyra p.sh., në Labinot (rr. Elbasan) vajzat kur arrinin moshën e duhur për fejesë fillonin të mbanin në kokë



Fig. 77 — Veshje të rinjsh nga katundi Val i Martaneshit)

shami të verdha dhe jo më shaminë e kuqe që kishin mbajtur kur ishin të vogla, ndërsa në Martaneshin fqinj ndodhte pikërisht e kundërta.

Në Iballë të Pukës deri në Luftën e Parë Botërore, vajzat mbanin në kokë një lloj kapuci të gjatë që thirrej «kapolë» e punohej me fije leshi në avlemend,¹³ ndërsa «kaculita» që mbanin vajzat e rritura në Mirditë ishte më e shkurtër. Këta lloj kapuçesh përshtateshin edhe me jetën që bënin vajzat e rritura pra mund t'i konsiderojmë, jo vetëm si shenja dalluese të moshës, por edhe të gjendjes civile të atyre që i mbanin.

Ka mjaft zona ku, kontrasti midis mbulesave të kokës të vajzave dhe atyre të grave të martuara, ka qenë shumë i thellë, si p.sh., zonat ku deri në prag të Çlirimit gratë mbanin ende lëvere koke prej pëlurash pambuku a mëndafshi, të zbukuruara pasurisht me motive shumëngjyrëshe, të përgatitura me kujdes e dashuri nga vetë gratë fshatare, si qenë Myzeqeja, Dumreja, Sulova, Fusha e Krujës, Zadrime, Bregu i Bunës, pastaj Malësia e Gjakovës, Rrafshi i Dukagjinit në Kosovë etj.

¹² Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912) vëll. III Tiranë 1962, f. 94.

¹³ Përgjigje pyetsorit të veshjeve popullore në Iballë (rr. Pukë) AE 1974.



Fig. 78 — Veshje vajze mirditore nga Rrësheni.



Fig. 80 — Veshje vajzash nga Rakoshi Podgur (Kosovë)



Fig. 79 — Veshje djemsh të vegjël nga Zadrime

Që nga nusëria e deri në pleqëri të shtyrë gratë bënin ndryshime të ngadalshme në veshjen e tyre, duke e shndërruar e thjeshtuar pamjen e saj. Përgjithësisht nuk ndërronte tipi i veshjes, por vinte një dobësim i shkallëzuar i ngjyrave të saj, i ornamenteve dhe i stolive të tjera trupore që mbante gruaja. Kështu p.sh., në disa zona të Shqipërisë Juglindore ku gratë mbanin, deri në vitet '20 të shekullit tonë veshjen me fustan të gjatë e cibun, ndërsa në vitet e para të martesës gruaja mbante fustan të kuq mbas disa vitesh vishte fustan ngjyrë kafe ose të gjelbër të errët, për të kaluar më tej në një ngjyrë blu të thellë ose të zezë. Stolitë e ndryshme të qafës, të gjoksit e të duarve i mbante kryesisht sa s'kish fëmijë, pastaj me kohë i pakësonte. Këto shkallëzime përshpejtoheshin kur gruas i vdiste njeri i afërt dhe duhej të mbante zi. Për gratë e martuara rrobet ato të pleqërisë.

Në një zonë të gjerë të Shqipërisë së Mesme e sidomos në rrethin e Tiranës rol të madh në këtë shkallëzim të veshjes sipas moshës, luante përparja prej pëlhure të pambuktë të prodhimit shtëpiak, që vihej mbi linjën e gjatë gjithashtu prej pëlhurave pambuku (dhe mbas Çlirimit edhe mbi dimitet e zeza). Gruaja e martuar, që nga periudha e nusërisë e deri në pleqëri përdorte një varg përparjesh të cilat, në bazë të ngjyrave të tyre iu përshtateshin fazave të ndryshme të jetës të saj si grua e martuar. Është me të vërtetë për t'u admiruar

shkathtësia me të cilën janë kombinuar në to katër ngjyra bazë, e bardha, e verdha, e kuqja dhe e zeza, për t'iu përshtatur fazave të ndryshme të jetës (për nuse, gjysmake për gratë e moshës së mesme dhe për plaka). Paralel me përparjen ndryshonte edhe intensiteti i ngjyrave të qenareve në pëlhurën e linjës së gjatë dhe ngjyrrat e lëveres së kokës.

Përbrenda zonave të veçanta etnografike ka pasur edhe pjesë të veshjes që përdoren nga grup-mosha të caktuara. Le të sjellim ndonjë shembull. Në Mokër (rr. Pogradecit) në kostumin popullor tradicional të grave bënin pjesë tri-katër guna të ndryshme shajaku të paracaktuara për periudha të ndryshme të jetës për gruan e martuar (guna «mëngëgjatë» për nusëri, guna «me veshëza» për moshën e mesme dhe guna «xhulkë» për pleqëri). Në Mirditë gruaja e re vishte gjaheng e xhup shajaku, ndërsa plaka xhupin e mbi të xhurdinë e zezë. Por ka patur edhe raste kur elemente që kanë qenë dikur tipike për një grup-moshë të caktuar, me kohë janë përdorur edhe nga moshat e tjera. Kështu opingat, dikur zbukuroheshin me tufa leshi shumëngjyrëshe vetëm për fëmijët, pastaj edhe për nusët dhe me kohë (aty nga gjysma e dytë e shek. XIX) ky zbukurim u shtri edhe në moshat e tjera.

Na tërheq vemendjen fakti që, në shumë raste, vihen re afrime midis veshjes së vajzave të rritura dhe asaj të plakave dhe jo vetëm në kromatikën e përgjithshme të kostumit, që shpesh reduktohet në dy ngjyra të vetme, bardhë e zi, por edhe në pjesët e veshjes që përdornin. P.sh., në Mokrën e Poshtme (rr. Pogradecit), ndërsa gratë e reja të besimit mysliman mbanin përparje të bardha, vajzat e rritura dhe plakat i mbanin të zeza; shamitë e kokës gjithashtu si për vajzat dhe për plakat ishin të bardha ose të zeza. Bie në sy se këto dy mosha skajore janë më konservatore në pikëpamjen e veshjes dhe kanë ruajtur, për një kohë më të gjatë se moshat e mesme, veshjen e vjetër. Në shumë fotografi familjare të çerekut të shekullit XIX (të bëra në Korçë) bie në sy se ndërsa burrat e moshës së mesme janë të veshur me kostume «alla frënga» pleqtë dhe fëmijët mbajnë ende dollama të gjata. (shih fig. 56).

Në shekullin tonë e sidomos mbas Luftës së Parë Botërore, nën ndikimin e marrëdhënieve më të shpeshta me tregun, veshjet popullore pësonin ndryshime të vazhdueshme, qoftë në materialin e përdorur e në zbukurimet, qoftë në vetë strukturën e tyre, deri rreth moshës 40-45 vjeç, pastaj hiqej dorë nga përshtatjet e mëtejshme dhe mbahej po ajo veshje deri në pleqëri të shtyrë. Kështu ndodh që edhe sot, nëpër fshatra të Shqipërisë Jugore, burrat më pleq do t'i shohësh të veshur me rrobe shajaku e feste të zezë kadifeje, ndërsa moshat e reja vishen si punëtorët e qytetit.

2) Ndryshime në veshje sipas gjendjes civile të bartësit.

Më lart duke folur për ndryshimet e veshjes në përshtatje me moshën dhe seksin vumë në dukje disa ndryshime themelore midis veshjes së vajzave dhe asaj të grave të martuara, të cilat natyrisht kanë të bëjnë jo vetëm me moshën, por edhe me ndryshimin e gjendjes civile të tyre. Këto dallime në lidhje me gjendjen civile nuk ishin fakultative por, përkundrazi, të detyrueshme. Kështu një grua e martuar edhe në qoftë se e konsideronte veshjen e grave më pak të përshtatshme se atë të vajzave, përsëri nuk kishte lejë të kthehej e të vishej rishtaz «vajzënisht». Këtë ndalesë e vënë në dukje shumë këngë dasme në të cilat me vargje shumë prekëse i thuhej vajzës se ajo paskëtaj s'kish për t'i veshur më «petkat e vajzënisë». Kjo thekson qartë funksionin e dyfishtë të veshjes si objekt praktik e si simbol.

Tani do të flasim për veshjen e një kategorie të veçantë vajzash si ishin «virgjnate», ato vajza të cilat, për ndonjë arsye madhore, hiqnin dorë vullnetarisht e botërisht nga martesja, ndërronin emrin e tyre kundrejt një emri mashkulli, rrinin ndër burra, nuk bënin punë grash por shkonin me bagëti, prisnin flokët etj. Në shumë zona ato visheshin tërësisht si burrat, madje thuhet se kështu të veshura si burrat kanë marrë pjesë, pa u diktuar, në formacione luftarake e si të tilla kanë hyrë edhe në këngë popullore.¹⁴ Në të tjera zona ato visheshin

14) Shih: M. Krasniqi, Gjurmave të një kënge popullore, *Kënga e Hasimes*, «Gjurmime albanologjike Folklor dhe etnologji», IV. Prishtinë 1976, f. 159-189.

pjesërisht si gratë e pjesërisht si burrat.¹⁵ Kështu në Malësi të Madhe (rr. Shkodër) e në Mirditë ato visheshin me tirq si burrat, kurse në Dukagjin (rr. Shkodër, visheshin me xhubletë si gratë, e gubere si burrat, por në kokë vinin kapuç, jo shami.¹⁶ Në Martanesh (rr. Mat) virgjnat visheshin me brekushe shajaku të zeza dhe me «morosë» (xhurdi) të zezë (ashtu si visheshin gratë e martuara të kësaj krahine kur shkonin për ngushëllim në një vdekje) pra me veshjen e përzishme të grave; flokët virgjnate nuk i thurnin gërsheta, por i mbanin derdhur krahëve dhe në kokë lidhnin një shami të verdhë dhe jo të kuqe si vajzat e tjera.¹⁷ Këto përshtatje, në mënyrën e vet, e kanë shprehur qartë gjendjen e ndërmjetme të këtyre vajzave. Këtu përdorimi i veshjes së plotë të burrave ose i pjesëve të veçanta të saj, për «virgjnate» merr një kuptim simbolik të veçantë.

Gjendjen civile të gruas e tregonin në disa zona edhe hollësira të tjera, të cilat është vendi t'i përmendim.

Në Myzeqe, gruaja e martuar po të ishte një amvisë e mirë mbante me vete pothuaj gjithnjë «kurorëzën» e leshtë që i shërbente për të bartur ngarkesa në kokë; zakonisht ajo e vendoste këtë mjet në palëzat e brezit të saj. Edhe gruaja mirditore duhet të mbante tërkuzën lidhur për mesi edhe kur nuk kishte ndonjë ngarkesë, sepse vetëm gruaja «e lshueme» pra e ndarë nga burri, mund të dilte pa të, jashtë mjedisit farefisnor.

Një tjetër shenjë e gruas «së lshueme» ishte «prerja e thakut». Thakët janë tufa leshi që varen tek brezi i gruas në kostumin popullor të Mirditës. Në kanunin e Lekë Dukagjinit, shprehja «me i pre thakun grues» do të thotë ta ndash gruan, ta kthesh tek prindët përgjithmonë.¹⁸ Në fakt kësaj gruaje «të lshueme» burri i pri-

ste me të vërtetë disa thekë tek brezi. Kjo shprehje e kanunit (me i pre thekun) në mënyrë figurative përdorej edhe në krahina të tjera, si p.sh., në Kurbin (rr. Krujë), në Nikaj-Mërtur (rr. Tropojë) etj. ku gratë nuk mbanin brez me thekë prapa, si në Mirditë. Në banorët e Malësisë së Vogël «grues së lshueme» i prishin bishtalecin ose thekët e jelekut në njërin sup, kurse në Kosovë burri që donte ta ndante gruan «i priste pshtjellakun (përparjen) ose flokët dhe nusja shkonte kështu në shtëpi të vet tek i ati»¹⁹. Në Malësi të Madhe «grues së lshueme» burri i priste një tufë flokësh ose i priste brezin më dysh²⁰. Tek arbëreshët e Italisë ndarja bëhej kur pritej përgjysmë një rrip duke lënë njërin pjesë në dorën e burrit dhe tjetrën në dorën e gruas.²¹

Të gjitha këto rregulla e zakone tregojnë se shoqëria e kohës e shihte të nevojshme ta bënte të njohur publikisht gjendjen civile të gruas edhe me shenja të jashtme të dukshme për këdo, aq më tepër kur ishte fjala për qëndrimin moral të saj.

Gratë e veja zakonisht bënin disa ndryshime në veshjen e tyre: Këtu nuk e kemi fjalën thjesht për shenjat e përkohshme të zisë, (për të cilat do të flitet gjetiu) por për disa ndryshime më të qëndrueshme, si domos në rastet kur gruaja mbetej e ve në moshën mbi dyzet vjet.

Në Shqipërinë e Mesme, gruaja e mbetur e ve në moshë të tillë po të vendoste të mos martohej më, vinte në kokë leverën e bardhë dhe vishej me të errëta. Mbi një dylben të zakonshëm trekëndësh me të cilin mbulonte me kujdes gjithë flokët, vejusha vinte leverën e bardhë të cilën e lidhte nën gushë ose e fuste anës veshëve dhe nuk e hiqte më për tërë jetën; edhe përparjet e saj të pambukta do të ishin vetëm bardhë e zi.

15) Kjo të sjell ndër mend një zakon të disa viseve të Evropës Qendrore, p.sh. te Sllovakisë, ku një veshje të tillë të përzier detyroheshin ta mbanin vajzat-nëna (sipas P. Bogatiriev.).

16) A. Gjergji, *Gjurmë të matriarkatit në disa doke të dikurshme të jetës familjare. Virgjnate*. Buletin i USHT, 1963, nr. 2, f. 286.

17) Simbas S. Cerga, *Martesa në Çermenikë*, revista «Minerva», Tiranë 1932, tetor, nr. 3 f. 29-30.

18) Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër, 1933, nyja 39.

19) K. Halimi, *Esnafët në Kosovë-Metohi*, «Përparimi», Prishtinë 1958, nr. 2-3 f. 112.

20) K. Ulqini, *Terma dhe emërtime në Kanunin e Skënderbeut dhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit*, «Kumtar i Muzeut Popullor të Shkodrës», 1974, f. 123.

21) A. Masci, *Discorso sulle origini, costumi e stato attuale della nazione albanese*, 1808, f. 58.

Në Shqipërinë Juglindore shenja më e dukshme e grave të veja (ish-ortodokse) ishin rrobet e zeza dhe mbështjellja e kokës me dy shami të zeza, nga të cilat e para mbulonte mirë flokët, duke i lidhur çipat në majë të kokës (si gratë e martuara), kurse e dyta lidhej nën gushë (si vajzat e rritura).

Gratë ish-katolike të Shkodrës që kur martoheshin merrnin në pajë, përveç xhybes së kuqe të martesës edhe një xhybe prej cohe blu të errët, të zbukuruar me gajtanë mëndafshi të zi, të cilën e përdornin si veshje zije të përkohshme, por e mbanin përgjithnjë po të mbeteshin të veja (sepse në këtë rast nuk mund ta vishnin më xhyben e kuqe).

Në përgjithësi mund të thuhet se elementet më shprehëse në veshjen e gruas së ve ishin mënyra e mbështjelljes së kokës dhe ngjyra e shamive, rrobet e errëta si dhe kufizimi ose heqja e plotë e stolive metalike, sidomos mospërdorimi i stolive të gjoksit.

Për meshkujt ndryshimet e veshjes sipas gjendjes civile të bartësit janë shumë më të pakta se ato të femrave. Kështu në disa zona djemtë e pamartuar nuk mund të mbanin këmbë me mëngë të gjera, këmbë të tyre ishin më pak të zbukuruar se ato të burrave të rinj, në disa vende ata nuk mbanin as jelek e xhamadan të mirë (mëngore) dhe do t'i vishnin së pari për dhëndëri.²² Në disa zona të Shqipërisë Verilindore, ashtu si edhe në një pjesë të mirë të Kosovës djemtë e rinj, «djemt azganë» mbanin tirq të zinj ose të murmë dhe jo të bardhë. Në Shqipërinë e Jugut djemtë fshatarë të kësaj moshë shkonin zakonisht malit për të kullotur tufat e bagëtive, prandaj në një pjesë të madhe të vitit në veshjen e tyre nuk mungonte guna karakteristike, guna çile ose e dhirtë. Në një këngë të mbledhur nga Spiro Dine thuhet.

«Të kesh mall të flesh me gunë
Djalë më nuk bënesh kurrë»²³

Mund të themi pra se në përgjithësi ndryshimet që pëson veshja sipas moshës kanë herë një funksion magjik mbrojtës

nga syri i keq p.sh., (tek të rinjtë para martesës) e herë një funksion estetik si për t'i dhënë më shumë shkëlqim pastaj kostumit të martesës. Në veshjen e virgjnavave e të grave të veja, funksioni estetik zbehet mjaft dhe merr përparësi funksioni ritual.

III. VESHJET E MIRA OSE «PËR TË DALË»

Fshatarët përgjithësisht përdorin shprehje të ndryshme për të treguar veshjen festive e ceremoniale: diku thonë «rrobet e mira» apo «për të dalë», diku i quajnë «veshje e parë» e «veshje e dytë» e diku gjetkë i cilësojnë sipas pjesës më të vlefshme, si p.sh., veshja me koret në Zadrimë, apo veshja me allaxha (rr. Sarandë) etj.

Rrobet e mira përdorëshin për të dalë, pra për të shkuar në vizita apo në kishë, për të pritur miq, për të shkuar në gëzime familjare të të afërmeve e sidomos në dasma, për të shkuar në treg ditën e pazarit etj. Në disa krahina nuset e reja, vitin e parë të martesës, e vishnin më shpesh kostumin e mirë, bile edhe kur shkonin për «upri» apo «falanikë» ndër fqinjë e dashamirë (sidomos në Mirditë e në Mat). Burrat do të visheshin me rrobe të mira edhe kur shkonin për të marrë pjesë në kuvend, e sidomos «pleqtë e katundit» në tubimet e tjera të rëndësishme të fshatit a të krahinës. P.sh. në Labëri burri vishte «xhokë e gunë për punë, xhokë e shark për plak fshati».

Rrobet e mira mund të bëheshin me material më të mirë se ai i veshjes së përditshme, psh., në vend të pëlhurës shtëpiake mund të përdorej faqelli i fabrikuar ose në vend të shajakut mund të përdorej coha etj., por karakterin festiv atyre ua jepte zbukurimi me oja e dantela, me gajtanë e shirita të ndryshëm, sumbullat dhe paftat e ndryshme metalike dhe sidomos stolitë («stringlat», rrgjanat») e shumta, të cilat luanin një rol të rëndësishëm, qoftë për funksionin dekorativ e qoftë për atë magjik, që lidhej me lloj-lloj besimesh.

22) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore në fshatin Sopik (rr. Sarandë dhe në fshatin Shëmri (rr. Krujë), 1972, AE.

23) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vëll. II, Tiranë 1962, f.

Rrobet më të mira që mbante njeriu gjatë jetës ishin zakonisht rrobet e martesës, kudo në Shqipëri e për të gjitha shtresat shoqërore. Shumëkush ruante një palë rrobe të mira («një fill petka»)²⁴ edhe për vdekje, duke e konsideruar këtë një rast solemn. Në varrime, vizita ngushëllimi, në përkujtimore e raste të tjera hidhërimi, shkohej gjithashtu me rrobe të mira, por pa stoli.

1) Kostumi i martesës.

Ndër veshjet e mira a për të dalë karakteri i theksuar ceremonial, kërkesat më të mëdha estetike spikasin më shumë se kudo në kostumin e martesës. Ai konsiderohej si më i miri dhe më i bukuri, sipas shijes kolektive të zonës etnografike përkatëse. Përgjithësisht ai i shprehte në mënyrë më të plotë veçoritë e kostumit tradicional të krahinës.

Ky ishte varianti më i pasur i veshjes, si për gra e për burra, në çdo krahinë. Në evolucionin e kostumit të martesës vihen re dy prirje të kundërta. Shpeshherë ai ruante në strukturën e tij edhe elemente të vjetra tradicionale që nuk përdorehin më në kostumin e zakonshëm, si ishte xhubleta në disa zona të rrethit të Shkodrës apo koreti në veshjen e grave të Zadrimës a «gunëza» në veshjen e Kallmetit (rr. Lezhë) etj. ose elemente që paraqiteshin tashmë në forma të reduktuara, të ndrydhura, si do t'i shohim më poshtë. Por në shumë raste të tjera, pikërisht në kostumin e martesës hynin së pari elemente të reja, ndikime të kohës ose bëhej zëvendësim i plotë me një tip të ri veshjeje. Po japim ndonjë shembull. Që nga Shpallja e Pavarësisë (1912) e deri në mbarim të Luftës së Parë Botërore, në një pjesë të madhe të Shqipërisë së Jugut, fustanella e burrave doli nga përdorimi dhe u zëvendësua me kostume të tjera. Të dhëna nga shumë zona të vendit na tregojnë se këtë zëvendësim meshkujt e bënë kur martoheshin. Të dhëna të tjera tregojnë se edhe kur e kishin adoptuar me kohë kostumin e

ri të modës pak a shumë qytetare, për rastin e martesës vishnin kostumin tradicional të krahinës, i cili përgatitej posaçërisht për këtë rast ose merrej hua për disa ditë. Kështu p.sh., në disa zona rreth viteve '20, edhe pse ishte në përdorim të rregullt për burra veshja me pantallona shajaku si ato të fushës së Korçës, djemtë bëheshin dhëndurë të veshur domosdo me fustanellë, e flokatë²⁵. Në Mokër, ashtu si në shumë krahina të tjera veshja popullore tradicionale për gratë e reja doli nga përdorimi mbas Çlirimit, megjithatë vajzat vazhdonin të «bëheshin nuse» me kostumin popullor. Sot ka zona në Kosovë ku vajzat nuk e mbajnë kostumin popullor në veshjen e tyre të përditshme, por megjithatë ditën e martesës e veshin si një kostum feste. Në çdo familje bëheshin përpjekjet maksimale për të siguruar një kostum martese sa më të mirë, sa më të zgjedhur. Kjo ishte, veç të tjerash, edhe një çështje prestigji për familjen.

Këmisha e përgatitur për nusëri ishte ekzemplar i veçantë, i posaçëm për këtë rast. Ajo bëhej prej pëlhure të një cilësie të zgjedhur, pëlhurë mendafshi ose prej faqelli a kambriku, kishte shumë kinda, mëngë të gjata e të gjera dhe shumë zburkime me qëndisje, rruaza etj. Mbas Luftës së Parë Botërore e këtej bie në sy një fenomen, që vjen e shtrihet gradualisht nga një zonë në tjetrën: në kostumin e martesës, përmbi këmishë vishet një fund i gjerë kambriku, me shumë pala, që i përgjigjet fustanellës së dikurshme të burrave.

Mbi këmishë visheshin një mbi një disa pjesë analoge, p.sh., jelekë e xhamadanë, ose xibune e xhoke, ashtu si nuk mbahehin zakonisht dhe pa iu përshtatur stinës. P.sh., gruaja Rajcës (rrethi i Librazhdit), në kostumin e saj të nusërisë vishte, njëri mbi tjetrin, jelek me mëngë, jelek cohe, jelek behari, mbi ta xhoken prej shajaku e mbi të akoma qesiken (jelek shajaku), e zburkuar me tufa. Gruaja ortodokse e Mokrës në ditën e martesës vishte cibunin, gunën me veshëza e gunën mëngëgjatë, që ishte një pjesë e posaçme për nusëri.²⁶ Në Mirditë e në Fushën e Krujës nusja vinte e veshur me «gjaheng» e me «xhupe», që të dyja veshje prej shajaku të trashë. (fig. 81).

24) Kështu ndodhte p.sh. në qytetin e Shkodrës.

25) P.sh., në rrethin e Pogradecit.

26) Shih. A. Gjergji: «*Dy variante të veshjes së grave në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit*, «Etnografia shqiptare» IV, Tiranë 1972, f. 150.



Fig. 81 — Nuse nga Fushë Kruja (rr. Krujë).

Në Mirditë, stravecë të gjatë dhe çorapë të gjerë me shputa të qendisura përmbi to, mbanin vetëm nusët. Në Zadrinë nusja ditën e dasmës vinte jo një, por dy përparje, njëra mbi tjetrën (një bohçe të leshtë zadrimore me katrore dhe një tjetër të pambuktë si bohçet e dikurshme të Shkodrës) dhe tre jelekë (mëngoren, jelekun me sumbulla e jelekun me ar), që bashkë me trupin e koretit bëheshin katër.²⁷ Nusja e ngarkuar me gjithë këto tesha dhe me shumë stoli shndërrohej në një kukull të ngrirë, sepse çdo lëvizje e gjymtyrëve të trupit të saj vështirësohej nga veshjet e shumta që mbante (fig. 82). Me sa duket veshja e kaq shumë teshave në ditën e dasmës, kishte lidhje me marrëveshjen që bëhej midis palëve kontraktuese të martesës, në bazë të së cilës shtëpia e dhëndrit duhej t'i sillte nusës teshat e nusërisë (ose

të paguante për përgatitjen e tyre) dhe ajo duhet t'i vishte për të parë të pranishmit se teshat qenë sjellë me cilësinë e duhur, sipas marrëveshjes.

Në kostumin e martesës hasej edhe ndonjë element veshjeje në formë të ndrydhur a të cinguar. Le të përmendim këtu «nipten» kurioze që vishnin nusët në Gur të Bardhë të rrethit të Matit e në disa fshatra të Malësisë së Tiranës. E reduktuar në tre rripa të ngushtë shajaku, njeri në shpinë e dy të tjerët përpara (fig. 83), ajo ishte një atrofizim i vërtetë i «nemtes» apo xhokës së zakonshme prej shajaku të bardhë, që mbanin gratë e shumë zonave të tjera. Një element i ndrydhur ishin edhe ata dy



Fig. 82 — Nuse nga Zadrina (rr. Lezhë).

riipa të ngushtë shajaku që varehin nga supet, në vend të mëngëve, tek guna «më-

²⁷ Shih A. Gjergji, *Vërejtje rreth veshjes së grave në Zadrinë*, «Studime Historike», Tiranë 1970, nr. 1, f. 95-96.

ngëgjatë» që mbanin dikur gratë e reja ortodokse në Mokër.²⁸




Fig. 83 — Nipte nuseje nga Guri i bardhë (rr. Mat).

Një shfaqje analoge ishte edhe «krahoçi» ose «krahat», ai rrip spiku për nuse, në formën e dy rrahëve (në të cilët futen krahët) të qepur njeri me tjetrin vetëm pak në shpinë. (fig. 84). E mbanin nusët e




Fig. 84 — Krahoçi nuseje (Rugovë), Kosovë

reja, në Malësinë e Gjakovës dhe në ndonjë pjesë tjetër të Kosovës.

Shenja dalluese më karakteristike e nusës ditën e martesës në tërë Shqipërinë ishte pa dyshim «duvaku». Me këtë fjalë populli tregon një copë pëlhurë, diku më të trashë e diku më të hollë, me ngjyrë përgjithësisht të kuqe,²⁹ qepur në formë koni, që i hidhej nuses mbi kokë dhe i mbulonte jo vetëm kokën, por edhe trupin pothuaj gjer në mes (fig. 85, 86). Në Mirditë kjo pëlhurë e kuqe kishte të qëndisur në mes një dorë, një shqipe ose një diell.



Fig. 85 — Nuse e mbuluar me duvak (rr. Mat).

Duvaku zbukurohej në majë me xhufka, kordele, lule, degë ulliri (në zonat e

28) Shih. A. Gjergji, *Dy variante të veshjes së grave në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit*, Etnografia Shqiptare, IV, Tiranë 1972, f. 141 (fig. 10, 23).

29) Sipas informatës së një bashkëpunëtori nga rrethi i Sarandës, në fshatin Borsh duvaku bëhej prej një cohe blu të thellë me vija të verdha anëve (shih. Përgjigje pyetësorit të familjes për fshatin Borsh (Rrethi i Sarandës) A. E.



Fig. 86 — Nuse e mbuluar me duvak (Malësia e Madhe, Shkodër).

ulëta bregdetare) ose me tufa të vogla borziloku³⁰. Kjo mbulesë koke e posaçme për nusen në ditën e dasmës përdorej në fund të shekullit XVI edhe tek shqiptarët e Kalabrisë (Itali). Një dëshmi për këtë e kemi tek shënimet e G. Marafiotit, i cili e përshkruan kështu: «(ditën e dasmës) nusja e re mban një vello përpara dhe nuk mund t'ia shohësh fytyrën veçse kur arrin tek dera e kishës, ku e heq vellon dhe kumbarja i vendos kurorën në kokë»³¹. Me sa duket këtu e ka bazën ajo mbulesë koke e grave arbëreshe të shekullit XIX që quhet «skjepëz» ose «napëzë».

I njohur në botën mesdhetare që në antikitet³², duvaku në mendësinë e stërgjyshëve tanë qoftë si mbulesë e fytyrës, qoftë nga ngjyra e tij e kuqe, ishte një masë për

ta mbrojtur nusen nga syri i keq ditën e martesës, kur asaj i drejtoheshin sytë e qindra të ftuarve e të njerëzve të rrugës. Ai i rezervonte dhëndrit ose «vëllamit» të drejtën për ta parë ai i pari fytyrën e nuses në çastin kur do t'i hiqte duvakun. Nga fillimi i shekullit tonë, nëpër qytete, në ndikimin e modës së kohës, duvaku filloi të zëvendësohej me vellon e bardhë. Nëpër fshatra ky zëvendësim u bë më vonë, madje në disa zona, u bë mbas Çlirimit (1944) ose nuk u bë fare.

Ndër arbëreshët e Italisë është ruajtur edhe një zbukurim karakteristik koke, që ishte shenja dalluese e grave të martuara. Ky zbukurim thirrej «kezë» dhe vihej për herë të parë ditën e martesës. Keza ishte një lloj kësule e vogël në formë vezore, që përgatitej me një copë mëndafshi ose kadifeje, ngjyrë të kuqe ose të gjelbër dhe qëndisej pasurisht me fije ari dhe argjendi. Flokët e gruas, të thurur në dy gërsheta, mblidheshin shuk prapa kokës, mbi to vihej keza, e cila fiksohej me një ose dy gjilpëra të mëdha me kokë. Pastaj mbi kezë hidhej lirshëm «skjepëza», një vello e bardhë e qëndisur që varej prapa, pasi që fiksoar edhe kjo me gjilpëra të mëdha argjendi. Tek arbëreshët gruaja e martuar as mund të përfytyrohej pa «kezë» dhe pa «cohë»³³.

Në Malësinë e Madhe (rr. Shkodër) ditën e martesës nusja vinte për herë të parë në kokë «kopicën» tradicionale prej kadifeje të zezë, të zbukuruar me pafta të ndryshme prej filigrane argjendi, mbi të cilën hidhej një napë e bardhë e zbukuruar. E ngjashme me të ishte edhe kapela e vogël dekorative që mbanin nuset me kostumin e vjetër të Drenicës në Kosovë. (fig. 216).

Në zona të ndryshme të Shqipërisë edhe pse mbulesa e kokës për nuse mund të kishte të njëjtën formë me atë që mbahej zakonisht, ditën e martesës ajo lidhej e rregullohej në kokë në një mënyrë të posaçme. P.sh., në zonën ku mbahej veshja me dhipllar (rr. Gjirokastër), mahramën prej pël-hure liri nusja e rregullonte në mënyrë

30) Ll. Mitrushë, *Dasma në lalët e Myzeqesë*, «Etnografia Shqiptare, II Tiranë 1963, f. 205.

31) G. Marafioti, *Croniche et antichità di Calabria*, Padova 1601, f. 274 (La novella sposa porta un velo inanzi la faccia, e mai si puo vedere eccetto quando é giunta alla porta della chiesa, se le toglie il velo, et il compare le pone la corona o ghirlanda nel capo).

32) Shih Dahremberg et Saglio, *Dictionnaire des antiquités greco-romaines*, zëri «Flammeum».

33) Shih shënimin 2.

të tillë që skajet të vareshin njëri përpara e tjetri prapa, duke mbështjellë edhe qafën, ndërsa përditë skajet e saj paloseshin mbi kokë, duke lënë krejt të lirë qafën.

Në një mënyrë interesante «e sukullonte» kokën nusja e re në zonën e Prellit (rr. Mat) duke formuar, me shaminë e qendrisur një lloj rrethi të ngritur, që linte të zbuluar majën e kokës. (fig. 207).

Në zona të tjera me ndikim më të theksuar oriental, ditën e dasmës nusja vinte në kokë lloje të ndryshme kësulash cohe të kuqe, mbi të cilat qepeshin monedha të ndryshme ari e argjendi, shirita, tufa etj. Të tilla ishin p.sh., kësula me florinj e nuseve të reja në Lunxhëri apo kësulat e grave myslimane të Shkodrës, Elbasanit, Tiranës etj. Po me këtë grup lidhet edhe kësulëza e nuseve të Rajcës (rr. Librazhd), megjithëse shumë e reduktuar në përmasat e saj. (fig. 119).

Një veçori karakteristike e kostumit të martesës janë gjithashtu çorapet me qafa të fryra që mbanin nuset në gjithë Mirditën e në pjesën veriperëndimore të rrethit të Dibrës.

Disa ndryshime në kostumin e dhëndërisë kishte edhe për burrat. P.sh. në kostumin me fustanellë këmisha për dhëndëri i kishte mëngët më të gjera se zakonisht, dhe fustanella synohej të kishte sa më shumë kinda. Ditën e martesës dhëndri do të kishte një flokatë leshi të rudë ose një gunë «larë». Çorapet e dhëndërisë bëheshin me shumë lule dhe opingat zbukuroheshin me xhufka të kuqe. Në vend të jelekt e mëngores prej shajaku, për dhëndëri djali mund t'i bënte ato prej cohe të importuar, kur gjendja ekonomike e familjes e lejonte këtë shpenzim. Familja, në këto raste, ishte e gatshme të bënte çdo sakrificë të mundshme, sepse «njeriu një herë martohet». Sidoqoftë, materialet tregojnë qartë se në mbarë vendin djali vishej dhëndër me rroba krejt të reja, që të ishin sa më të paraqitshme, natyrisht për aq sa lejonte gjendja ekonomike e familjes.

Le të përmendim këtu, në lidhje me kalimin e djalit beqar në radhën e burrave të martuar, zakonet sipas të cilit nusja do të sillte si dhuratë për burrin e saj një veshje të plotë, të cilën dhëndri duhet ta vishte medoemos të nesërmen e konsumimit të martesës së tij, për të treguar se ai qe

tashmë burrë i martuar dhe i kishte hequr «rrobet e beqarisë». ³⁴ Mendoj se këtë zakon duhet ta shohim si një ndër ritet e shumta që shoqëronin dikur kalimin e djalit të ri nga një grup moshe në një tjetër.

Veshja e martesës pra, duke synuar të shprehë shumë funksione, ishte përgjithësisht tepër e rënduar dhe e parehatshme, sidomos për nuset e reja, në veshjen e të cilave funksioni ritual e ai estetik ishin më të theksuar. (fig. 221).



Fig. 87 — Çift të martuarish rreth vitit 1920. (Korçë)

2) Veshja e dasmorëve.

Dasmorët e sidomos krushqit që shkolin të merrnin nusen, do të visheshin me rrobet më të mira që kishin, sepse paraqitja e jashtme në këto tubime të gjera ishte një çështje prestigji. Kush nuk kishte rrobe të mira sa duhej do të merrte ndonjë gjë hua në miq e dashamirë. Në disa zona të Jugut krushqit që shkolin të merrnin nusen, merrnin me vete gunat e tyre më të mira («laroshe»), edhe pse mund të mos

³⁴ Shih. Përgjigje pyetësorit të familjes nga fshatrat Xibër e Dars (rr. Matit) (A. E.).

qe stina ende shumë e ftohtë, meqë shumica e dasmave bëheshin në vjeshtë. Pajisjet e kuajve gjithashtu do të ishin sa më të mira dhe samarët të mbuluar krejtësisht me velenxa të vogla shumëngjyrëshe të posaçme për këtë punë. Vargu i dasmorëve në kuaj, me gunat e tyre të errëta hedhur në një sup merrte një pamje solemne e tërheqëse.

3) Veshje të përzishme.

Nën këtë emërtim po përfshijmë veshjet për të dalë në raste ngjarjesh të hidhura si p.sh., për të marrë pjesë në një varrim ose në një përkujtim, për të shkuar në vizita ngushëllimi — («për të folur», a «për kryeshëndoshë» — si thuhet në popull) etj., po ashtu edhe veshjen e të vdekurit e të atyre që mbajnë zi. Ndryshimet për këto raste ishin më të dukshme në veshjen e grave dhe shumë më pak në atë të burrave. Dallimin e veshjes së përzishme nga ajo e festave të gëzuara e ndeshim që në vargjet e baladës popullore «Kostandini e Garentina» kur motra e pyet vëllanë e vogël që ka ardhur ta marrë:

— Po thuan vëllau im
se ndë kam të vinj ndë helme
vete veshem ndër të zeza.
Ndë na vemi ndë harë
U të marr stolitë e mira.³⁵

a) Veshja për të marrë pjesë në ceremoni të përmtshme

Kishte zona ku burrat shkonin me rrobet e zakonshme të tyre në këtë ceremoni³⁶ por në të tjera zona ishte rregull që ai që shkonte për të paraqitur ngushëllimet të vishej me rroba të mira e të kishte paraqitje të rregullt.³⁷ Dikur, në disa vise të Labërisë³⁸,

burrat edhe çirreshin në fytyrë për një vdekje të hidhur, ashtu si ishte zakon në ato zona të Shqipërisë së Veriut ku praktikohesh «gjama», ai vajtim kolektiv burrash që, në shumë pikëpamje, të sjell ndërmend zakone të lashtësisë.

Në zonat ku mbahej «xhurdia» ose «kaporania», ajo xhaketë shajaku me mëngë të shkurtra e jakë të madhe katrore, e sidomos nga rrethi i Matit e lart, si burrat, ashtu edhe gratë që shkonin në një vizitë për rast vdekjeje, kur i afroheshin shtëpisë së të vdekurit e ngrinin mbi krye jakën e madhe të xhurdisë dhe pastaj hynin brenda (shih fig. 88).



Fig. 88 — Grua me jakën e xhurditit në kokë, që shkon për vizitë ngushëllimi.

Në disa zona të Shqipërisë Juglindore deri në Luftën e Parë Botërore, ekzistonte një zakon i tillë: Kur një djali i vdiste i ati, duke e lënë të ri e të pamartuar, në shenjë dëshpërimi e zije, ditën e vdekjes,

35) De Rada, *Rapsodi të një poemi shqiptar*, në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar», vëll. I, f. 140.

36) Kështu ndodhte p.sh., në Skrapar në Dumre, në Shpat, në Bendë, në Mat, në Krumë, në Kelmend etj. (Shih përgjigjet e pyetësorit të familjes përkatësisht për fshatrat Potom, Belsh, Shelcan, Bruz, Dars, Dibër, Gur i Bardhë, Golaj, Fushë-Arrëz, Helshan, Zall-Mner në Arkivin Etnografik të IKP.

37) P.sh. në Hasdushk (rr. Durrës), në Kurjan (Fier), në Çamëri etj. (Sipas përgjigjeve të pyetësorit të familjes në A.E.).

38) Përgjigje pyetësorit të familjes në Ramicë (rr. Vlorë) A. E. Shih vëllimin «Folklor shqiptar», Tiranë 1972, f. 149.

pavarësisht nga stina, djali do të mbështillej me një gunë të zezë dhe kështu i mbështjellë do të rrinte te këndi i vatrës për të pritur ngushëllimet e rastit.

Gratë që shkonin për ngushëllime në shtëpinë e të vdekurit, kudo në Shqipëri do të visheshin me rrobe të mira, por pa zbukurime të dukshme; sidoqoftë në të tilla raste, një rol të madh në veshjen e tyre luante shkalla e afrisë, mosha e të vdekurit dhe mosha e atij që shkonte për ngushëllim. Në Malësinë e Madhe (rr. Shkodër), nëse xhubletat e zakonshme kishin përfundi një rrip shajaku të bardhë, ato që visheshin për ceremoni të përmortshme ishin krejt të zeza.

Shpesh një shenjë dalluese ishin mbulesat e kokës. P.sh., në Shqipërinë e Mesme deri vonë, gratë që shkonin tek shtëpia e të vdekurit për ngushëllim kishin të gjitha lëvete të bardha në kokë e përparje të zeza me vija të bardha. Kurse në Shqipërinë e Jugut për të tilla raste gratë lidhnin në kokë jo një, por dy shami të zeza (njëra mbulonte krejt flokët e pjesërisht ballin, kurse tjetra mbulonte edhe qafën e lidhej nën mjekër).

b) Veshje zije

Kur vdiste dikush, familjarët dhe të afërmit e tjerë mbanin zi për një periudhë kohe që zgjaste herë më pak e herë më shumë, në varësi të moshës e të pozitës familjare të të vdekurit. Zinë më të fortë e mbante nëna për djalin dhe motra për vëllanë. Njeriu që ishte në zi dallohej menjëherë nga veshja që mbante.

Burrat vetëm në rast të ndonjë vdekjeje shumë të hidhur mund të bënin ndryshime në veshje. Shenja e jashtme më e rëndomtë ishte të rrinin pa rrojtur 7-9 ditë. Në Shqipërinë e Jugut deri në Luftën e Parë Botërore, në shenjë zije burrat hiqnin stolitë metalike të tyre p.sh., gostekët e gjoksit, teslimët e krahut etj. Në Malësinë e Madhe, burrat në zi lidhnin në kokë, për qark qeleshës së tyre të bardhë, një rubë (shami) të zezë.

Ka megjithatë një përjashtim. Ende sot në ditët tona, në zona të ndryshme të vendit duke filluar nga Shqipëria e Mesme e

lart, fshatarët tregojnë me këmbëngulje e krenari se, shumë pjesë të veshjes së burrave janë kthyer në të zeza mbas vdekjes së Gjergj Kastriotit e në shenjë zije të përgjithshme për të. P.sh., në Shëngjergj të Tiranës thonë se për zi të Skënderbeut populli u vesh me xhupa, xhamadanë e shallvare të zeza, Xhurdia (jakucja, kaporania) është pjesa që përmendet më shpesh si shenjë e kësaj zije të thellë edhe në Mat, Krujë, Mirditë, Dibër e gjetiu. I njëjti shpjegim u është dhënë nga fshatarët e malësorët shqiptarë shumë udhëtarëve të huaj që kanë vizituar Shqipërinë gjatë shekullit të kaluar³⁹. Edhe në mos qoftë historikisht e vërtetë kjo lidhje, ky është një homazh prekës që populli i bën kujtimin të Skënderbeut, duke e konsideruar humbjen e tij si një dhimbje për gjithsecilin, si një vdekje që meriton të mbahet zi nga një brez në tjetrin.

Gratë mbanin zi më gjatë dhe me shenja të jashtme më të dukshme. Në disa krahina, për të tilla raste, ngjyenin me bojëra të errëta ato pjesë veshjeje që kishin ngjyra të forta, si jelekun, allaxhanë etj. Në vende të tjera, pothuaj deri në mesin e shekullit tonë, gratë e martuara i vishnin praptazi xhupat, xhokat e cibunët që kishin zbukurime të shumta e me ngjyra të gëzueshme; kështu ndodhte në zonën e Kallmetit (rr. Lezhë), në Mirditë, në Fushë-Krujë (rr. i Krujës), në Lunxhëri (rr. i Gjirokastrës), në rrethin e Sarandës, në një pjesë të rrethit të Korçës etj.⁴⁰

Në fshatrat e Pogonit gratë e përzishme në vend të «kavadhes», asaj xhokës prej cohe të stolisur pasurisht, mbanin, për një kohë, një lloj palltoje të zezë prej shajaku, me mëngë të shkurtra deri në bërryl, që quhej «kapë»⁴¹. Edhe pjesë të tjera të veshjes që ishin të stolisura, gratë që ishin në zi ose që shkonin në varrime, i vishnin praptas, si bënin gratë e Iballës (Pukë) me pshtjellakun (futën e stolisur që vihet prapa) dhe kërdhoklën (brezin e gjerë prej shajaku) e tyre⁴². Në shumë raste të tjera, në vend të përparjeve me ngjyra të forta që mbanin zakonisht, për zi gratë vinin përparje më të errëta.

Sidoqoftë, shenja më e dukshme e zisë për gratë ishte mbulesa e kokës. Deri në fillim të shekullit tonë, koka mbështillej me

39) Shih, p.sh. A. Mayhew.

40) Nga përgjigjet përkatëse të pyetësorit të veshjeve popullore për fshatrat Perlat i Epër, Kallmet, Derven, Dhoksat, Sopik, Pustec. A. E.

41) Përgjigje pyetësorit të familjes për fshatin Hllomo (Pogon) A. E.

42) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore për fshatin Iballë (Pukë). A. E.

«lëvere» të bardhë dhe, në Shqipërinë e Mesme, këto lëvere kanë vazhduar të mba-hen edhe në shekullin tonë si shenjë zije, kurse në vende të tjera ato janë zëvendësuar me shamitë e zeza të importuara, që u përhapën me shpejtësi në një pjesë të madhe të Shqipërisë Jugore. (fig. 89).



Fig. 89 — Shenja zije në veshje. Grua me të zeza (Korçë)

Në shumë vende të Shqipërisë së Mesme, gruaja së cilës i vdiste i shoqi, i nënshtrohej një rregulli të tillë: në qoftëse vendoste të largohej nga shtëpia e burrit, ajo, që ditën e vdekjes së të shoqit, vishej

krejt në të zeza dhe i mbante ato rrobe de-ri të largohej nga shtëpia e burrit e të kthehej tek i ati, kurse po të vendoste të qëndronte tek shtëpia e burrit për të mos u martuar më, atëherë vinte në kokë lë-veren e bardhë.

Në disa fshatra të vendit, ruhej deri në dhjetëvjeçarët e fundit kujtimi i një zakoni të stërlashtë, vajtimi me flokë lë-shuar⁴³ dhe prerja e flokëve, në shenjë zije të thellë për një vdekje fort të dhimb-shme. P.sh., një vajzë mund të shkurtonte flokët për vdekjen e të atit⁴⁴ etj. Prerja e flokëve, që ishin stolia më e madhe naty-rove e vajzës, mbahej si shenjë e një dë-shpërimit të madh, të ndier thellë. Për të njëjtën arsye, gruaja së cilës i vdiste burri, po të ishte e re e me fëmijë, hiqte përgjith-monë gërshetat e rreme që i mbanin zako-nisht, për bukuri, gratë e martuara.

c) Veshja e të vdekurit.

Njeriut që vdiste i visheshin, në shu-më vende, rrobet e nusërisë ose të dhën-dërisë, të cilat ruheshin posaçërisht për këtë rast; pleqve u vishnin rrobet më të mira që kishin. Në disa zona të besimit mysli-man, të vdekurit, pasi e kishin mbështjellë me qefin, i vinin përsipër veshjen e tij të plotë⁴⁵. Kishte vende gjithashtu myslima-ne, ku të vrrarët nuk i mbështillnin me qefin, por i varrosnin me ato rrobe që ki-shin ndodhur⁴⁶. Në fshatin Gur i Bardhë të Matit të vdekurin e vishnin me rrobe të mira veç po të që në moshë të re⁴⁷, përn-dryshe e mbështillnin me qefin.

Së fundi në lidhje me veshjen e të vdekurit le të shënojmë se, në disa vende gratë i përgatisnin me kohë rrobet e vdek-jes dhe në to bënë pjesë një palë ndërresa të reja (të papërdorura). Këmisha bëhej prej pëlhure, e qepur gati, por nuk çahet tek pjesa ku do të futej koka⁴⁸; kjo do të ha-pej kur njeriu të vdiste. Është e qartë se kjo gjë bëhej për të mos ndjellë vdekjen.

43) Përgjigje pyetësorit të familjes për fshatin Shelcan (rr. Elbasanit) A. E.

44) P. sh., në Zhulat e në Dhemblan të rr. Tepelenë (sipas përgjigjeve të pyetësorit të veshjeve popullore, A. E.).

45) Sipas një të dhëne nga fshati Xibër (në Mat).

46) Përgjigje pyetësorit të familjes në fshatin Menkulas (rr. Korçë), A. E.

47) Përgjigje pyetësorit të familjes në fshatin Gur i Bardhë (rr. Mat), A. E.

48) Në fondet etnografike të IKP ndodhen disa këmishë të tilla me nr. inventari 2741, 2742 etj.

IV. - DALLIME NË VESHJE SIPAS PËRKATËSISË SOCIALKLASORE TË BARTËSIT

Këto dallime janë të shumëllojshme dhe kanë të bëjnë jo vetëm me veshjen si objekt, por edhe me rëndësinë e posaçme që merr ajo si shenjë dalluese, si simbol i kësaj përkatësie dhe, në këtë kuptim, janë më të dukshme në kostumin festiv se sa në atë të përiditshmin.

Pasqyrimi i këtyre dallimeve socialklase ka qenë më i mprehtë e më i shprehur por edhe më i ngurtë në periudhën e feudlizmit, sidomos në shekujt e pushtimit osman ku, një varg faktorësh politikë e shoqërorë, ndikuan në thellimin dhe ruajtjen e këtyre dallimeve. Ato vinin në dukje hierarkinë shoqërore prandaj ishin të detyrueshme e nuk mund të shkeleshin lehtë. Le të kujtojmë p.sh., se ka patur herë pas here vendime të ndryshme të komuniteteve fetare në lidhje me kremtimet e fejesave e të martesave ku përcaktohej shprehimisht edhe rangi i veshjeve apo rregulla e urdhëresa të pushtuesve osmanë për veshjen e rajasë apo të fisnikëve të krishterë etj.

1) Diferencime sipas klasave e shtresave të ndryshme shoqërore.

Burimet mesjetare që kemi paraqitur në pjesën e parë të këtij studimi⁴⁹, tregojnë fare qartë se, nga veshja e shtresave të gjera të popullsisë (si ishte, bariu i Onufrit apo çirakët që pajtoheshin të mjeshtër për të mësuar zanat), tek veshja e krerëve të aristokracisë vendase (si ishin sundimtarët e kohës si Topiajt, Balshajt etj., apo ktitorët e ndryshëm), dallimet kanë qenë shumë të thella.

Përveç ndryshimit të përgjithshëm midis të pasurve dhe të varfërve, që shfaqej në cilësinë e materialit dhe të zbukurimeve, një notë dalluese kanë qenë edhe stolitë e ndryshme. Tek autori ynë i shekullit XVII,

Frang Bardhi, kemi një dëshmi interesantë për këto dallime. Në një relacion të vitit 1637 mbi Zadrimën, ai thotë se qefalinjtë (krerët), për t'u dalluar se ishin krerë, mbanin dy sumbulla të mëdha argjendi tek jakka e xhamadanit të tyre dhe e mbështillnin kokën me riza mëndafshi⁵⁰ (fig. 90).




Fig. 90 — Jelek burri me sumbulla te jaka.

Për shekullin XVIII një dëshmi pamore të këtyre dallimeve klasore kemi tek kuadri që paraqet ktitorët e Mitropolisë së Korçës (viti 1725). Atje arhondi korçar Shamo paraqitet i veshur me anteri e dolloma të ngjeshur për mesi me një brez të gjerë dhe sipër tyre me një xhybe luksoze, të zbukuruar rreth e qark anëve dhe te jaka me gëzof të shtrenjtë. Personazhi tjetër, Mako Shkundra, i veshur me fustanellën tradicionale e me xhokë shajaku me lapa trekëndëshe tek supet dhe i mbathur me çorape leshi dhe opinga të thieshta lëkure me gjalma, i përket pa dyshim një klase tjetër shoqërore.

Ndryshimet klasore në veshje mbeten të thella gjatë shekujve të pushtimit osman, madje bëhen ndonjëherë edhe më të dukshme kur dallimeve klasore u shtohen edhe faktorët politikë e fetarë. Në këta shekuj kemi së pari një kundërvënie të mprehtë: më një anë, kostumet e mirëfillta popullore të masave të gjera fshatare, më anë tjetër, veshje të modës turke që hynë në aristokracinë e myslimanizuar vendase, me hir ose me pahir, veshje të cilat, duke mos pasur analogji me tipat ekzistues të veshjeve

49) Shih edhe «Etnografia Shqiptare» VII, Tiranë 1976.

50) Mendoj se një reminishencë e qartë e tyre janë ato dy sumbulla dekorative argjendi, që shiheshin ende në shekullin tonë te jaka e xhamadanëve të burrave të Shqipërisë Veriore e Verilindore. (Shih objektet me numra inventari 1805, 2571 etj. në fondet e etnografisë).

tona, nuk depërtuan në popullsinë fshatare, se nuk ishte lehtë të përthitheshin. Veç kësaj, ato veshje ishin një shfaqje e kulturës së pushtuesit dhe, si të tilla, shiheshin me urrejtje nga populli. Kështu ka ndodhur që ato të stigmatizohen ashpër e me sarkazëm në shumë vargje të këngëve popullore, ku përmenden si attribute për të karakterizuar shtypësin e huaj.

O halldup *shallvaregjërë*
Në të zënça dot *guberë*
Do t'ta bëj si tjetër herë...

thuhet në një këngë popullore kushtuar kryengritjeve kundër Tanzimatit më 1847. Në vargjet e një kënge tjetër popullore që janë ankimi i singertë i një fshatari të thirrur për të shkuar nizam, thuhet:

Ktheva kokënë nga mali,
O shokë m'u tha kufari,
Shokë do xhvishet *fustani*
Do na vishetë *shallvari!*⁵¹

Burime të tjera tregojnë gjithashtu se dallimet klasore në veshje sipas hierarkisë shoqërore, kanë qënë të gjalla e të dukshme edhe në shekullin e XIX. Udhëtari frëng i shekullit të kaluar A. Bué, vë në dukje se shqiptarët ortodoksë të shtresave të pasura, dalloheshin nga fshatarët e tjerë, nga festja me majë, toslukët dhe jelekët prej cohe të kuqe të zbukuruar, brezat e kuq si edhe nga fustanellat e tyre prej kambriku të hollë.⁵² Konsulli frëng në Shkodër H. Hekar, duke përshkruar kostumet e qytetarëve shkodranë të kohës së tij (mes i shekullit XIX), thekson se burrat muslimanë të shtresës së pasur mbanin këmishë prej pëlhere të mëndafshhtë dhe fustanella me 500-750 kinda dhe mbi to dollamën e kuqe, e cila, po ashtu si xhamadani, je-

leku e toslukët, ishte e stolisur me shirita ari. Edhe armët e tyre të brezit ishin prej argjendi të lara në ar dhe të zbukuruar me shumë skalitje artistike. Madje ai thotë shprehimisht se «luksi i shqiptarëve muslimanë qëndron në pasurinë e armëve të tyre». Më anë tjetër ai vë në dukje se malësorët mbanin (shumica), dollamë shajaku të bardhë, stolisur me gajtan të zi dhe vetëm ata më të pasurit, bajraktarët, bylyk-bashkët etj., mbanin xhamadanë stofi të kuq të zbukuruar me shirita ari si edhe fes të kuq, në vend të qeleshes së bardhë që mbanin të tjerët⁵³.

Dallime klasore në veshje, në këtë kohë, viheshin re pa dyshim edhe në qytete të tjera të vendit, siç na dëshmojnë shumë lloj burimesh të tjera të kohës. (fig. 10, 44). Këto ndryshime u ruajtën më gjatë në ato qytete të vendit ku tiparet e shoqërisë feudale qënë më të forta se në qytete të tjera. Kështu, në Shkodër edhe në fund të shekullit të kaluar e në fillim të shekullit tonë ende, as burrat, as gratë nuk visheshin njësoj, por tri duarsh. Burrat e dorës së parë vishnin dollamë «gjake» (të kuqe), ata të dorës së dytë dollamë cohe jeshile dhe ata të dorës së tretë dollamë «more» (kafe të errët), kurse malësorët dollamë shajaku të bardhë. Dallime në veshje kishte gjithashtu edhe midis shtresës së zejtarëve e shtresave të varfra të qytetit. Këto ndryshime në veshje ishin vetëm një anë e manifestimit të dallimeve klasore. Dihet mirë se këto dallime pasqyroheshin edhe në shumë shfaqje të tjera të jetës së përditshme: në llojin, madhësinë, cilësinë dhe pajisjet e brendshme të shtëpive, si në qytet edhe në fshat,⁵⁴ në etiketën e ndërlikuar të pritjeve, ku kryet e vendit u përkiste jo më të moshuarve, por përfaqësuesve të dyerve të para, në shprehjet dhe formulat e mirësjelljes me të cilat duhet t'u drejtoheshe përfaqësuesve të shtresave të larta shoqërore në përshëndetjet e bisedat e drejtpërdrejta me ta etj.⁵⁵

Tradita gojore na dëshmon se edhe në veshjet fshatare kishte dallime, ku më të

51) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, vëll. III, Tiranë 1962, f. 27.

52) A. Boué, *La Turquie d'Europe*, vëll. II, Paris 1840, f. 199.

53) H. Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie ou Gueguerie*, Paris 1857, f. 285.

54) Në Shkodër, p.sh. «shtëpitë e pasura», pra shtresa më e lartë kishin banesa të mëdha «me ahër e harem», të dytat kishin një krah të banesës së rezervuar për pritjen e miqve (selamllëk), të tretat kishin vetëm një dhomë për miqtë.

55) Sipas shtresës përkatëse, p.sh., gruaia thirrej hanëme, hake, kadëne etj.

vogla e ku më të mëdha, sipas shtresave të ndryshme shoqërore. Në shtresat me gjendje ekonomike më të mirë, shajaku i përdorur ishte i një cilësie më të zgjedhur, i prodhuar në vend ose i sjellë nga vise të tjera të Ballkanit, të specializuara në prodhimin e tij. Të tillë ishin: shajaku i bardhë i Brashovës (Rumani), i njohur dhe i kërkuar më tepër për veshje festive në rrethet e Korçës e të Pogradecit, shajaku blu i Samokovit (Bullgari) dhe i Preshevës (Maqedoni), i përdorur në disa zona të Shqipërisë së Jugut për poturet dhe xhamadanët e burrave⁵⁶ etj. Në zona të ndryshme të Veriut, përveç tirqeve (çakçirëve) prej shajaku të bardhë të zakonshëm për burra, ka pasur edhe tirq «dumashi» (shajaku të butë), por ato i përdorte një pakicë njerëzish me gjendje të mirë ekonomike. Në rrethin e Tiranës «dallamanin», veshje e sipërme prej shajaku të bardhë, e gjatë gjer në gju, «nuk e vishte dot kushdo, sepse kushtonte shumë», prandaj e përdorin vetëm ata që ishin në gjendje të mirë ekonomike.⁵⁷ Po kështu ndodhte edhe me disa elemente të veshjes së grave. Në zonën e Pogonit (rrethi i Gjrokastrës) p.sh., «kavadhin», veshje e sipërme luksoze prej cohe ose kadifeje të zezë, që vishej në ditë festash, nuk e kishte çdo nuse e re, sepse kushtonte shumë⁵⁸ kështu që ajo mbetej një veshje e rezervuar veç për gratë e familjeve me gjendje ekonomike të mirë. Një tregues i këtyre dallimeve është edhe sasia e cilësia e përdorimit të stolive. Sa më e pasur të ishte familja që e jepte ose e merrte vajzën, aq më shumë stoli e zbukurime të ndryshme metalike do të kishte ajo kur bëhej nuse.

Rritja e vullshme e lëvizjes kombëtare nga koha e Lidhjes së Prizrenit e deri në kurorëzimin e saj me Shpalljen e Pavarësisë më 1912, rriti ndërgjegjen kombëtare të masave popullore, solli një afrim të parë midis krahinave dhe nxori në pah vlerën e kostumeve tradicionale si një tregues etnik. Rëndësia e këtij treguesi në ato rrethana të caktuara historike e politike, e zbehu në një farë mase shkallën e pasqyrimin të diferencimit klasor në veshje. Kurse

në periudhën pas Shpalljes së Pavarësisë dhe sidomos mbas Luftës së Parë Botërore dallimet klasore në veshjet popullore nuk e kanë më ngurtësinë e mëparshme ndër të tjera edhe për faktin se në shumë zona ato dalin krejt nga përdorimi, sidomos veshjet për burra, duke u zëvendësuar me veshje të modës qytetare. Në zonat ku vazhdojnë të mbahen vihet re se me përparimet e industrisë tekstile evropiane, shumë artikuj «luksi» të përdorur dikur vetëm nga parasi ishin p.sh., coha e kuqe dhe qendisjet me fill ari, bëhen tashmë të arritshme për një numër gjithnjë e më të madh njerëzish, sidomos për kostumin e martesës, por kjo nuk do të thotë se dallimet klasore janë zbehur.

2) Dallime sipas përkatësisë fetare.

Një faktor që ndikonte në veshje ishte përkatësia fetare e bartësit dhe këtu është fjala kryesisht për ndryshime që kanë ngjarë në veshjet popullore të dy-tre shekujve të fundit, si pasojë e përhapjes së islamizimit, kurse dallimet midis katolikëve e ortodokseve ishin më pak të rëndësishëm.

Duke ndjekur me kujdes të dhënat e ndryshme ekzistuese për këta shekuj (testamente, akte gjyqësore, marrëveshje paje, gravura e të tjera dëshmi) në mënyrë paraprake mund të themi se ndikimi islamik në veshje është ndier më fort nga mesi i shekullit XVII e deri në çerekun e parë të shekullit XVIII, natyrisht jo kudo, por në shtresa të caktuara të popullsisë qytetare dhe në zonat e islamizuara që ndodheshin në afërsi të qyteteve⁵⁹. Provë për këtë është fakti që, në zona me shtrije të konsiderueshme, popullsia edhe pse u islamizua, i ruajti në përdorim veshjet popullore vendase të trashëguara nga shekujt e mëparshëm. Kurse gjatë shekullit XIX bie në sy mjaft qartë një proces i vërtetë pastrimi nga shumë elemente veshjeje të ndikimit të kulturës orientale-islamike, si ishin dëlomatë e anteritë e gjata, kaftanët e xhybet, lloje të shumta papuçesh e çizmesh:

56) Ll. Mitrushi, art. i cituar.

57) Përgjigje e pyetësorit «Etnografia shqiptare» VII, Tiranë 1975, f. 145.

58) Përgjigje e pyetësorit për veshje popullore për fshatin Zall-Dajt (Shurrokastër) 1974. A. E.

59) Përgjigje e pyetësorit të veshjeve popullore në fshatin Hllomo (rr. Gjirrokastër) 1974. A. E.

59) Shih kreun e parë të kësaj vepre.

dhe sidomos mbulesa koke të shumëllojshme, si për burra dhe për gra. Mjafton të krahasojmë p.sh., veshjet e shqiptarëve, të paraqitur në shumë gravura të Stackelbergut, Delpinos etj. me ato që gjejmë në veprat e shumë autorëve të dy-tre dhjetëvjeçarëve të fundit të shek. XIX dhe do të kuptojmë qartë ndryshimet. Mendoj se ky proces pastrimi, që vihet re kryesisht në veshjet e burrave, duhet parë i lidhur dhe i kushtëzuar nga ato procese shndërrimesh që po ndodhin në këtë kohë tek ne, nën ndikimin e ideve iluministe dhe të rritjes së ndërgjegjes kombëtare që rilindësit përpiqeshin t'i përhapnin me aq zell e këmbëngulje.

Ndikimi fetar në veshje ka qenë më i hershëm e më i dukshëm në popullsinë qytetare, ku krahas pjesës së islamizuar pati përfshirë ndonjëherë edhe atë të krishterën, si p.sh., në Shkodër, Prizren, (fig. 91, 92), Pejë, Tiranë, Elbasan, Berat etj., dhe pjesërisht fshatrat pranë qyteteve ose fshatra të një farë rëndësie, kurse në zonat e brend-



Fig. 91 — Grua nga Prizreni me fytyrë të mbuluar.



Fig. 92 — Grua shkodrane me fytyrë të mbuluar

shme të vendit ishte mjaft i zbehtë. Këtu ngrinin peshë natyrisht edhe faktorët ekonomikë, dendësia e lidhjeve me tregun, niveli i përgjithshëm i jetës e i zhvillimit shoqëror të fshatrave etj., Kështu në disa zona të Jugut si Labëria, Skrapari, një pjesë e Kolonjës dhe e Oparit etj. në gjysmën e dytë të shekullit XIX, disi më vonë Shqipëria e Mesme, të islamizuarit i lanë pak nga pak kostumet popullore të mëparshme për gra, dhe adaptuan, ku më shumë e ku më pak, kostume ose pjesë kostumesh të modës orientale (çitjane, anteri të gjata, xhybe, jelekë etj.) Në popullsinë fshatare myslimane të Shqipërisë Veriore, me përjashtime fare të rralla, pothuaj as mund të flitet për një ndikim të tillë. Pra, në pjesën më të madhe popullsia fshatare edhe pse u kthye myslimane, nuk adoptoi veshjen turke, por i ruajti veshjet popullore vendëse. Megjithatë ndikimi i kulturës islame u ndie në këto zona në disa aspekte të veçanta të kostumit popullor si ishin, p.sh. përdorimi i zbukurimeve të tepruara të kokës, të qafës e të gjoksit e stolitë metalike të shndritshme me pjesë, të luajtshme e tingëlluese (kryesisht vargje

monedhash), format tipike të disa stolive si ishin hajmalitë trekëndëshe të varura me zinxhirë, në fesat e kokës të nuseve etj.

Në zonat e islamizuara që ruajtën veshjet e tyre popullore, me kohë, duke filluar nga fundi i shek. XIX, vihet re një farë divergimi midis tyre dhe pjesës së banorëve që kishin mbetur të krishterë. Këto divergime manifestohen në drejtime të ndryshme: diku disa elemente të veshjes fillojnë të emërtohen me fjalë të huazuara turke, diku ndërron ngjyra e gajtanit që përdoret për qepje e zbukurime të disa pjesëve, nga e zeza në të gjelbër, diku modifikohen pak ornamentet e diku shtohet ndonjë element i ri sidomos për kokën. P.sh., xhupi ose xhoka në disa zona të islamizuara filloi të thirrej «dollamë», brezi prej leshi «qemer», përparjet e ndryshme «bohçe», mëngorja «mintan» ose «xhamadan», këmisha e shkur-tër ose bluza «xhymlek». Në Fushë-Krujë e në Mat xhokat e dollamat e myslimanëve filluan të zbukurohen me gajtan të gjelbër e jo të zi si më përpara etj. Si pasojë e këtyre divergimeve, në Mokër veshja e grave myslimane u largua disi nga ajo e grave të krishtera, veshja e grave myslimane të Prellit, të Selitës (Mirditë) e të Lurës bëri disa ndryshime nga ajo e popullsisë së krishtere të Mirditës, veshja e grave myslimane në Myzeqe gjithashtu bëri ndonjë ndryshim nga ajo e të krishterëve etj.

Këto ishin disa shenja që u lejonin fshatareve që, në kontaktet e tyre të përditshme, të kuptonin menjëherë përkatësinë fetare të njerëzve që nuk i njihnin, por që i takonin kudo në vende publike, në treg, në rrugë etj. Më anë tjetër, vetëm në fare pak raste kemi hasur në simbole fetare të qarta të fiksuara në veshje, më shumë me funksion zbukurues «mbrojtës» sesa prezantues. Të tillë janë p.sh., kryqat e vegjël të qëndisur në shpinë të xhubletës (M. Madhe), nën jakën e këmishës prapa te qafa (Zadrimë), në pjesën e lëveres së kokës që bie mbi ballë (Fushë-Krujë) etj.

Në mjediset më konservatore, sidomos në periudhat e rënies së lëvizjes kombëtare, qarqe të interesuara përpiqeshin me mënyra të ndryshme të diferencoheshin në veshje, sidomos në ato raste kur diferencimi fetar përputhej me diferencimin klasor. Rregulla dhe urdhëresa të ndryshme të kohës kërkonin shprehimisht që të krishterëve të mos u lejohej të mbanin rroba me po atë luks e shkëlqim si myslimanët, të mos u lejohej përdorimi i veshjeve prej cohe të gjelbër (meqë e gjelbra ishte ngjyra e

islamit) etj. Vendime të komuniteteve fetare, të përsëritura herë pas here bëjnë fjalë për kufizimin e stolisjes me fiqe ari e zbukurime të tjera, duke u rekomanduar të krishtereve veshje më të thjeshta e me zbukurime të pakta. Këto vendime nuk priteshin mirë, sidomos në shtresa të caktuara të popullsisë qytetare. Ekziston p.sh., një këngë popullore e mbledhur nga S. Dine në Korçë, në të cilën qortohet koxhabashi i qytetit Nuri Beu, për një urdhër të tillë. Kënga thotë: «More Nurkë kurriz-dalë/ Mos të mbett as çup' as djalë/ Bëre beden treqind grosh/ Pullat sa një karagrosh». Vendime të tilla i përgjigjeshin politikës së njohur diskriminuese të qeverisë turke ndaj rajasë së krishterë. Natyrisht jo të gjitha shtresat shoqërore i respektonin këto rregulla dhe kështu me gjithë vendimet e koxhabashit e të Mitropolisë, borgjezia korçare që po pasurohej e po fuqizohej gjithnjë më shumë, i theu këto rregulla duke u shkëputur krejt nga veshja e mëparshme e duke u veshur «alla frënga», proces ky që, në qytetin e Korçës, u krye në periudhën nga Lidhja e Prizrenit në Shpalljen e Pavarësisë (1878-1912).

Në mbyllje le të theksojmë se është me shumë interes që të ndiqen më së afërmi e të studiohen më thellë ndryshimet që kanë ngjarë në veshjet popullore në krahinat ku, në pikëpamje fetare, popullsia ishte e përzier. Në mënyrë paraprake do të vemë në dukje se në këto zona veshja e të krishterëve paraqet herë-herë një strukturë më të vjetër në krahasim me atë të myslimaneve. Kjo e fundit, për një periudhë të caktuar historike që arrin deri në kohën e Rilindjes, në shumë elemente të saj, paraqitej më novatore dhe më e hapur ndaj evolucionit dhe ndikimit qytetar.

3) Veshja e kaçakëve dhe e luftëtarëve të lirisë.

Në përshtatje me kushtet e jetës që bënin, rrobat e kaçakëve ishin zakonisht me ngjyra të errëta, që të mos binin në sy. Kështu, që në shekullin e kaluar disa nga trimat më të shquar, pjesëmarrës të kryengritjeve fshatare, kënga popullore na i paraqet të veshur me fustanellë të zezë, të shkurtër për mi gju, të pajisur me armët më të mira të kohës.

Duallë kapedanë me dyfek martinë
Fanellat u zbardhën, *fustanet* u

nxinë⁶⁰

ose si janë karakterizuar në vargje të tjera:

As më sheh as më kish parë
Fustanzi e pallë-larë.

ose gjetiu:

Gjon Leka në Shur e Kuq
Fustan e zi gjer më gjut.⁶¹

Fustanella të zeza mbanin edhe luftëtarët e Çetave të lirisë të fillimit të shekullit tonë. Kështu visheshin pjesëtarët e çetës së Shahin Matrakut (Shih fig. 93), trimi kryengritës Qamil Panariti e shumë të tje-

rë. (fig. 94). Kjo ishte, padyshim, edhe një nevojë praktike për jetën e tyre prej kaçaku, për të mos rënë në sy në lëvizjet e tyre, sidomos natën kur bardhësia e fustanellave mund t'i tradhtonte lehtë. Atribute të tjera të këtyre trimave ishin mjekra e flokët e gjata dhe guna e dhirtë he dhur shkujdesur në një sup.

Një paraqitje besnike të veshjes së tyre e kemi tek skulptura monumentale «Luftëtari kombëtar» e artistit të mirënjohur O. Paskali, që zbukuron prej më shumë se 40 vjetësh një nga sheshet kryesore të qytetit të Korçës (fig. 95).

Një fenomen analog vihet re në fillim të shekullit tonë edhe në pjesën verilindore të Shqipërisë, e sidomos në Kosovë, ku trimat e rinj mbanin përgjithësisht tirq të zinj e jo të bardhë për të mos u diktuar në lëvizjet e tyre natën. Tirq të zinj mbanin edhe



Fig. 93. — Çeta e Shahin Matrakut (S. Xega).

60) Th. Mitko, Dorëshkrimi i Pragës, në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar», vëll. II, Tiranë 1961, f. 236.

61) S. Dine, *Valët e Detit*, në «Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar» III, f. 104 dhe 25.

luftëtarët e lirisë të kësaj zone, në kohën e kryengritjeve të viteve 1909-1911 e në luftërat e mëvonshme. Me tirq të zinj vishej trimi Azem Galica e gruaja e tij luftëtare Shote Galica, «Heroinë e Popullit». (fig. 96).



Fig. 94 — Luftëtari Qamil Panariti me fustanellë të zezë (1910)



Fig. 95 — Luftëtari kombëtar — Korçë (Skulpturë e O. Paskalit, 1936).

4) Veshja e gruas që e kishte burrin larg shtëpie.

Në të tilla raste gruaja nuk vishej me rroba festash e nuk stolisej. Përkundrazi, ajo duhej të vishej sa më thjeshtë e zbukurimet e veshjes të binin sa më pak në sy. Duke pasur parasysh se veshjet e grave fshatare ishin të kufizuara në numër dhe zbukurimet e tyre ishin detyrimisht vetëm ato të repertorit tradicional të zonës, ishte vështirë që gruaja të gjente veshjen e duhur për çdo rast. Prandaj shumë herë vëmë re që gratë fshatare të kenë përdorur zgjidhjet që u impononin rrethanat. Kështu, në Fushë-Krujë mund të gjeje nuse të reja që vishnin grykësen ose xhupin nga

faqja e prasmë për të mos u dukur shumë zbukurimet, gjatë periudhës që e kishin burrin ushtar ose larg shtëpisë për një kohë disi të gjatë. Sidoqoftë, duhet theksuar se nuset e reja vitin e parë të martesës e vishnin shumë shpesh kostumin e dasmës, bile jo vetëm kur shkonin për vizita, por edhe kur shkonin «falanike», domethënë për të ndihmuar për punë bujqësie tek fqinjët, dhe në festa e kremte.

Në ato zona të Jugut ku kurbeti në të kaluarën ishte një plagë e rëndë shoqërore, gratë qenë ato që i ndienin më fort pasojat e tij, sepse në marrëdhëniet e përditshme shoqërore, gjendja e tyre si «grapa burra», iu kufizonte shumë sjelljet në



Fig. 96 — Çeta e Azem Galicës (me tirq të galem).

shoqëri dhe kishte pasoja edhe në pamjen e jashtme të tyre.⁶²

Këto gra jetonin pa gëzime, si gjysmë të veja, visheshin përgjithësisht me ngjyra të errëta. Jo rastësisht që nga çereku i fundit i shekullit XIX, kur kurbeti mori përpjesëtime të gjera, sidomos në disa zona të Shqipërisë së Jugut, gratë atje mbanin fustane ngjyrë blu të errët, kafe të errët ose të gjelbër të errët me zbukurime shiritash prej kadifeje të zezë, cibunët, xhokat ose flokatet e tyre ishin të zeza ose blu të thellë dhe shamitë e kokës gjithmonë të zeza, «shami-murgë» si thonë këngët popullore:

Mikja ime shami-murgë
Del e përletet në rrugë.⁶³

5) Shenja dalluese në veshje sipas detyrës e profesionit.

Edhe pse kjo fushë është gjurmuar ende fare pak, po mjaftohem të sjell dy tre shembuj, sa për të mos e injoruar këtë

aspekt, me shpresë se kërkimet e ardhshme do ta pasurojnë më tej.

a) Çdo plak kanuni, kur shkonte të pleqëronte një çështje, të zgjidhte një grindje a të merrte pjesë në kuvend, do të vihej pastër e mirë, diku-diku, si p.sh., në Kosovë, do të merrte edhe qyrkun me vete. Kjo ishte një shenjë e jashtme që tregonte se ai, nuk po shkonte në punë të vet, por po shkonte të kryente një funksion shoqëror. Kuptohet këtu rëndësia që i vihej pamjes së jashtme të personit, e cila synonte t'ia rriste autoritetin.

b) «Mësi» apo mblesi ishte dikur një figurë pothuaj e pa mungueshme në lidhjen e martesave. Kur arrinte ta përfundonte marrëveshjen për një fejesë, në Suharekë (Kosovë) në shtëpinë e djalit mësitit i falnin një palë shputa ose një palë çorape leshi. Të lidhura njëra me tjetrën me gjalma ai i varte ato në qafë kur e përcillnin te dera e oborrit, e ashtu me tonë qafë shkonte gjatë rrugës derisa arrinte në shtëpinë e vet⁶⁴. Kjo ishte jo vetëm një rast për ta përhapur lajmin, por edhe si

62) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, vëll. III; Tiranë 1962, f. 144 (Mos e laj linjënë kurrë/ Të njihesh që je pa burrë).

63) Q. Haxhihasani, *Fjalë të pambledhura*, «Buletin për shkencat shoqërore», Tiranë 1954, nr. 4 f. 144 (Labovë e Zhapës)

64) N. Bajraktari-Doçi, *Tipare të fejesës e të martesës në Suharekë*, në «Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore» Prishtinë 1983, f. 328.

një farë reklame që i bënte vetes e aftësive bindëse të tij.

c) Në Kosovë, midis zejtarëve ka qenë një zakon i tillë: kallfës që kishte dhënë provimin për t'u bërë mjeshtër, do t'i ngjishnin një brez të posaçëm që quhej «ku-shak» e kjo ishte dëshmi për provimin e dhënë, gjithashtu ishte zakon (në Gjakovë) që kryetari i esnafit, i cili kishte fuqi të madhe, të mbante një shkop të posaçëm, si shenjë të pozitës që kishte. Me këtë shkop ai jepte shenjë që t'i mbyllej dyqani atij zejtarit që shkelte rregullat e esnafit. Në Prizren atij zejtarit që shkelte rregullat e esnafit apo bënte ndonjë faj tjetër kryetari i esnafit i *priste jakën e fermentit* për t'i lënë një shenjë turpi e për ta marrë vesh të tjerët se ç'kishte ndodhur.⁶⁵

V. SHPREHJE TË FUNKSIONIT ETNIK TË VESHJEVE POPULLORE

Veshjet popullore gjatë zhvillimit historik të tyre kanë fituar me kohë një funksion etnik, pikërisht nëpërmjet larmisë krahinore dhe unitetit kulturor që shprehej në to. Me tiparet e tyre të përbashkëta të formuara e të zhvilluara gjatë shekujsh në shkallë kombëtare ato kanë marrë tek çdo popull një fizionomi të tyre, të veçantë që i bën të dallohen nga veshjet e popujve të tjerë.

Ndryshimet lokale e krahinore në veshje, sado të vogla qofshin, mjaftojnë për ta dalluar kostumin e një zone apo të një krahine nga ai i një zone tjetër. Ka raste kur edhe përbrenda së njëjtës krahinë, në fshatra fqinje, veshjet popullore paraqesin ndryshime të rëndësishme. Një shembull tipik në këtë drejtim ishte Zagrave (rr. Lezhë) ku gjejmë kostumin e të grave malësore me xhubletë, kostumin mirditor me xhup etj. Duke i studiuar veshjet lokale edhe në pikëpamje historike, vihet re se në këto ndryshime një rol të madh ka luajtur prejardhja e banorëve të zonës dhe lëvizjet e popullsisë, sepse në të kaluarën, ata që kishin prejardhje të përbashkët mbanin përgjithësisht të njëj-

tin kostum. Ndikonte gjithashtu edhe fakti se me cilat zona bëheshin lidhjet martesore. Por s'ka dyshim se larmia në veshjet popullore shpjegohet sidomos me veçantitë e zhvillimit ekonomik-shoqëror të zonave apo krahinave përkatëse. Nga gjysma e dytë e shek. XVIII dhe gjatë shek. XIX kishte krahina ku veshja prodhohej kryesisht brenda ekonomisë shtëpiake, sipas modeleve tradicionale të trashëguara bres pas brezi dhe plotësohej herë pas here me ndonjë element të ri, në përshtatje me kërkesat e shijet e grupit përkatës. Në këto rrethana kanë lulëzuar ato veçori lokale që vemë re edhe sot — veçanërisht në kostumet e grave — dhe janë ruajtur edhe elemente veshjeje me origjinë të lashtë.

Në zona të tjera, ku marrëdhëniet me tregun ishin zgjeruar më shumë, vinte duke u shtuar edhe numri i pjesëve të veshjes që bliheshin të gatshme në treg, sidomos për kostumin e martesës. Nga marrëdhëniet me tregun u rrit ndikimi i ndërsjellë midis fshatit dhe qytetit, sidomos nëpërmjet mjeshtërve zejtarë (rrobaqepësve, qëndishtarëve, opingarëve, argjendarëve etj.), u përgjithësuan forma prerjeje për shumë pjesë të veshjes, duke i kapërcyer dallimet e vogla krahinore që ekzistonin më parë. Ky proces evoluimi mund të vihet re mjaft qartë, p.sh. në format e prerjes së jelekëve e të mëngoreve, të xhokave a cibunëve të shumë zonave, po ashtu ai duket edhe në kësulata, opingat e këpucët si edhe në stolitë. Përbrenda këtij afrimi në format e prerjes apo në strukturën e kostumit, zejtarët përgatisnin veshje që ndryshonin shumë nga cilësia, duke iu përgjegjur mundësive ekonomike të blerësve. Kështu pasqyrohej diferencimi socialklasor në veshje.

Në këtë proces zhvillimi u formuan gradualisht edhe tipare të njësuara në fushën e veshjeve. Materialet dokumentare ekzistuese tregojnë se në shek. XVIII-XIX, në fizionominë e veshjeve popullore krahas larmisë, ishin formuar edhe tipare të përbashkëta për shumë krahina e zona ose me shtrirje mbarëkombëtare. I tillë ishte p.sh., kostumi me fustanellë, i cili në shek. XIX përdorej pothuaj në gjithë trojet shqiptare, diku si veshje e përgjithshme, diku si veshje e disa shtresave të caktuara apo si veshje festive (për dhëndëri). Në shekullin e kaluar, përdorimi i fustanellës në veri të Shqipëri-

⁶⁵ Për të gjitha këto raste shih K. Halimi, *mi» Prishtinë 1958, nr. 2-3 f. 112.*

Esnafet në Kosovë «Përpari-

së, sipas shumë dëshmime të kohës⁶⁶, shtrihet nga Shkodra drejt veri-lindjes, përfshinte gjithë Kosovën e arrinte deri në Novi-Pazar dhe prej atje zbriste në krahinat shqiptare të Tetovës, Gostivarit, Dibrës etj. Ajo kishte arritur të bëhej, në tërë kuptimin e fjalës, «veshja kombëtare» e burrave shqiptarë. Në vepra të shumta dijetarësh e udhëtarësh të ndryshëm, që kanë vizituar vendin tonë në këtë kohë, shprehjet «kostumi tipik i burrave shqiptarë»; «kostumi i plotë shqiptar» etj. i referohen të gjitha kostumit me fustanellë. Ai është një nga kostumet shqiptare, më i njohur e i përdorur në mbarë Shqipërinë, që i pati karakterizuar shqiptarët për shumë shekuj në pikëpamje të veshjes, e sidomos në shekujt XVIII-XIX. Përhapja e tij ilustron më së miri një nga shfaqjet e karakterit unitar të kulturës sonë popullore.

Më vonë, në çerekun e parë të shek. XX krahas daljes graduale nga përdorimi të kostumit me fustanellë, një tjetër veshje burrash, që i pati kapërcyer mjaft kufijtë e zonave ku mbahej më parë (Shqipëria Veri-lindore e Kosova) ishte kostumi me tirq të bardhë ose të zinj. Po kështu mund të themi për atë tip veshjeje grash, në të cilën mbi këmbishën e gjatë ose fustanin mbahej xhoka e leshtë.

Këto shfaqje të njësisë e të larmisë, pra të krahinore e kombëtares në fushën e veshjeve popullore duhen parë në lidhje dialektike me njëra tjetrën dhe jo si të përhershme. Pra duhet menduar se në një periudhë të caktuar mund të jetë më e përgjithësuar një veshje, kurse në një tjetër të marrë përhapje më të gjerë një tjetër veshje.

Funksioni i kostumit të një krahine apo të një grupi sado të vogël fshattrash synon që forma dhe pamja e tij të dallohet nga kostumet e tjera, pavarësisht në është ose jo më praktik, më elegant etj. pikërisht ashtu sikurse ngjet me funksionin dallues sipas gjendjes civile të bartësit, ku është e domosdoshme, që gruaja e martuar të mos vishet më si vajza («vajzërisht») ose anasjelltas.

Në kuadrin e larmisë krahinore janë ruajtur tek ne edhe kostumet e veçanta të pakicave kombëtare në rrethet Sarandë e Gjirokastrë, në zonën e Prespës (rr. Kor-

çë) e ndonjë tjetër, të cilat dallohen ku më shumë e ku më pak nga veshjet shqiptare. Këto pakica etnike kanë të gjitha kushtet për ta ruajtur kostumin e tyre popullor e sidomos si veshje festive apo për të marrë pjesë në manifestime të ndryshme kulturore artistike, sepse veshja e tyre e përditshme tashmë ka evoluar shumë.

Përgjithësisht grupet e ndryshme etnike qoftë në shkallë lokale e krahinore, qoftë në shkallë kombëtare, i kanë ruajtur me devotshmëri kostumet e tyre popullore, krahas shumë traditave të tjera. Gjatë shekullit XIX manifestimi i specifikës etnike në veshje ka qenë një shprehje e jashtme e përforcimit të tipareve kombëtare në kulturë dhe, në një rrafsh më të gjerë shprehje e përforcimit të ndërgjegjes kombëtare. Kështu ka ndodhur që në vargje të ndryshme të epikës popullore historike, pamja e jashtme, veshja, të merret si simbol për të cilësuar anën etnike. P.sh. në një këngë popullore thuhet: «O Vladika, i biri i shkinës/ mos ia ven topat Vraninës/... Nuk i njoftë *fustanllijt* (pra shqiptarët — A. Gj.) /se me dor' t'mbyllin franjit»/. Jo njëherë Rilindasit tanë më të shquar, janë krenuar me veshjet popullore po ashtu si krenoheshin me gjuhën tonë të bukur shqipe apo me tradita të tjera kulturore. Edhe sot i ruajnë kostumet e tyre popullore si p.sh., shumë zona të Rrafshit të Dukagjinit në Kosovë dhe zona të ndryshme të banuara prej shqiptarësh në Mal të Zi e në Maqedoni ose ruajnë vetëm ndonjë element shprehës të kostumit si është rasti i qeleshtës (kapuçit) se bardhë, i konsideruar si një simbol i kombësisë së tyre. Edhe shqiptarët e shkëputur prej shekujsh nga dheu mëmë si janë arbëreshët e Greqisë e të Italisë i kanë ruajtur për një kohë të gjatë me dashuri e përkushtim kostumet e tyre popullore jo vetëm si shenjë të jashtme që i dallonte nga kombësitë e tjera, por edhe si një formë të qëndresës kundër asimilimit nga kulturat e tjera. Një studiuese e huaj, duke folur për veshjen e arbëreshëve të Kalabrisë (në vitet '60) vinte në dukje: «Kohët e fundit është përhapur një qëndrim i veçantë. Njerëz të shtresave të pasura të borgjezisë së re, pohojnë besnikërinë e vet ndaj vendit të tyre të origjinës, duke përgatitur për nuset e reja në ditën e martesës, një kostum tradicional. Në fshatrat ku vesh-

66) Të dhëna mbi shtrirjen e përdorimit të fustanellës në veri mund të shihen p.sh., tek A. Boué. *La Turquie d'Europe*, vëll. II Paris 1840 f. 223-224; E. Spencer, *Travels in European Turkey*, London 1853 vol. I f. 29; 382, vëll. II f. 51; J. G. Hahn, *Reise durch die gebiete Drin und Wardar* Wien 1867, f. 82 E. F. Knight, *Albania*, London 1880, f. 117-118, 219-220 etj. si edhe në shumë gravura të kohës.

ja popullore mbahet në jetën e përditshme faktikisht vazhdon edhe të punohet. Tek arbëreshët e Kalabrisë këtë punë e bëjnë rrobaqepësat, në të tjerat gratë që endin pëlhurat e nevojshme, po vetë i presin e i qepin... Italo-shqiptarët... ruajnë me xhelozi si shenjë të partikularizmit të tyre, shumë zakone.»⁶⁷

Pse ndodhin të tilla dukuri? Përse që në fillim të shekullit tonë, në disa zona kostumet popullore filluan gradualisht të lihen duke u zëvendësuar me veshje pak a shumë të modës qytetare, kurse në të tjera ato u ruajtën deri në ditët tona? Këto janë dukuri që nuk mund të gjejnë shpjegim të plotë po të nisemi vetëm nga niveli i zhvillimit kulturor të zonave përkatëse, nga marrëdhëniet e fshatarësisë me tregun, nga izolimi krahinor etj. Ndikimi i këtyre faktorëve ishte padyshim i fuqishëm, por ai nuk shpjegon gjithçka, kështu që del e nevojshme që faktet etnografike të shqyrtohen edhe nga pikëpamja e funksionit që kryejnë.

Dy nga funksionet e rëndësishme të kostumit popullore janë funksioni etnik-kombëtar dhe ai socialklasor. Në rrethana të caktuara historike, kur përfaqësuesit e klasave në fuqi marrin anën e pushtetit ose të kombit shtypës dhe vihen në shërbim të tij, këto dy funksione të veshjes përzihen. Kështu vihet re se, me kohë këta përfaqësues heqin dorë nga veshja e tyre tradicionale dhe adoptojnë një veshje që është tërësisht ose pjesërisht nën ndikimin e kulturës së pushtetit osman, kur një pjesë e mirë e përfaqësuesve të shtresave të larta të shoqërisë shqiptare, mbas kthimit në fenë myslimane, i lanë veshjet vendase e filluan të vishen sipas modës turke-orientale. Kjo shtresë, duke humbur pak nga pak traditat e saj etnike e kulturore jo vetëm në paraqitjen e jashtme (në veshje), por edhe në aspekte të tjera të mënyrës së jetesës e në ndjenjat e saj, gradualisht vinte duke u shkombëtarizuar. Dukuri të tilla nuk kanë ndodhur vetëm tek ne, por edhe në popuj të tjerë që janë ndodhur në situata analoge.

Ndryshe ndodh me masat e gjera popullore, të cilat në situata të tilla duket se qëndrojnë të lidhura shpirtërisht edhe më fort me kostumet «e tyre» dhe i ruajnë

ato si një nga shenjat më shprehëse të përkatësisë së tyre kombëtare. Besnikëria ndaj tyre rritet në rrethanat kur ajo kërcënohet ose rrezikohet. Ndodh kështu sepse në të tilla rrethana traditat kombëtare ashtu si edhe gjuha kombëtare veprojnë si një forcë e vërtetë kohezioni që i mban të bashkuar pjesëtarët e një etnie apo të një kombi.

Kostumi popullore është një nga shenjat e simbolet me ndihmën e të cilave masat e gjera popullore gjatë shek. XIX u kundërviheshin jo vetëm pushtuesve osmanë, por edhe gjithë krerëve të myslimanizuar që kishin hequr dorë nga kostumi popullore, sidomos në periudhat më kulminante të lëvizjes kombëtare. Arrin një kohë që edhe disa nga rilindësit tanë më të ndritur ta mbajnë kostumin popullore kryesisht duke e vlerësuar si shenjë të identitetit kombëtar. Kështu vëllezërit Frashëri i shohim të fotografohen të veshur me kostumin me fustanellë, patriotë të shquar si Bajram Curri e Isa Boletini, në takime zyrtare, paraqiten të veshur me kostumin e tyre kombëtar me tirq të bardhë etj. etj.

Kjo tregon se në këto rrethana kostumi popullore rivlerësohet duke nxjerrë në pah funksionin etnik-kombëtar të tij, funksion i cili bëhet mbizotërues. Këtu duhet kërkuar edhe burimi i asaj ndjenje të thellë devotshmërie me të cilën populli i ruante kostumet popullore.

Kjo shpjegon gjithashtu ashpërsinë e masave me anën e të cilave janë përpjekur t'i zhdukin kostumet popullore të disa fiseve shqiptare në Mal të Zi qarqet zyrtare të Çetinjës, si një nga mjetet për shkombëtarizimin e tyre. Kështu më 1860, pushteti i Çetinjës nxori së pari urdhrin që të hiqeshin zburimet e qëndisimat në pjesët e ndryshme të kostumit të grave të Vasojeviqëve (Vasajve), si në xhubletat, përparjet, xhokat etj. dhe në vend të tyre të mbahej veshja malazeze; pastaj qeveritari dërgoi njerëzit e vet tek Vasojeviqët dhe «ju nxorri grave nga sëndyqet xhokat shumëgjyreshe dhe ua ndërroi, që populli të vishte kostumin malazez. Po kështu bëri njëkohësisht edhe në viset fqinje të Moraçës, Ravnëve, Bratonozhiqëve e të tjerëve, sepse edhe atje mbahej një veshje e ngjashme grash»⁶⁸. Me gjithë këto masa drastike, gratë tek Vasojeviqët (Vasajt) e ruajtën kostumin e tyre

67) M. Roussel — de Fontanes, *Les costumes traditionnels calabrais*, «Objets et Mondes», Tome III, fasc. 1, Paris 1963; botuar edhe shqip në: «Kultura Popullore», Tiranë 1984, nr. 2, f. 198.

68) M. Vlohović, *Narodna nošnja u Vasojevicima*, «Glasnik Etnografskogo Muzeja u Beogradu», Beograd 1934, tom. IX, f. 82.

popullor deri në fillim të shekullit tonë.

Ky funksion etnik-kombëtar i veshjeve popullore ndihet ende i qartë e i fuqishëm edhe sot në shumë zona të Kosovës dhe të viseve të tjera në Jugosllavi, të banuara prej shqiptarësh. Ruajtja me besnikëri e tyre tregon se ata duan ta bëjnë publikisht të njohur në çdo rast identitetin e tyre kombëtar.

Kështu studimi historik krahasues i veshjeve popullore ndihmon të karakterizohen elementet e përbashkëta për gjithë shqiptarët dhe, duke nxjerrë në pah veçoritë krahinore dhe etnike kombëtare, bën të mundur njëkohësisht që të hetohen ngjashmëritë dhe dallimet me popujt e tjerë, veçanërisht në zonat e kontakteve me ta.

Këtu del një problem me interes: Cili është ndikimi i çlirimit kombëtar në përhapjen ose ruajtjen e kostumeve tradicionale?

Në vendin tonë fati i kostumeve popullore duhet ndjekur në dy periudha: nga Shpallja e Pavarësisë deri në Çlirim dhe nga Çlirimi në ditët tona. Në periudhën e parë ato ndoqën një zhvillim spontan. Edhe pse mbaheshin ende në shumë zona prirja e përgjithshme ishte se, duke filluar nga periudha menjëherë mbas Luftës së Parë Botërore, shumë prej tyre filluan të dalin nga përdorimi si ndodhi p.sh., në shumë zona të Shqipërisë së Jugut. Në zona të tjera kostumet popullore vazhduan të zhvillohen e të pasurohen gjithnjë e më shumë me pjesë veshjeje të punuara nga zejtarët për katës. Kurse në periudhën mbas Çlirimit, pothuaj të gjitha veshjet popullore ekzistuese e kishin mbyllur tashmë ciklin e evolucionit të tyre. Duke filluar nga vitet '50 zona të ndryshme njëra mbas tjetrës në varg fillojnë t'i heqin nga përdorimi krejt ose t'i veshin rrallë e më rrallë si veshje festive e ceremoniale pra kryesisht me një funksion estetik. Por krahas këtij procesi fillon një interesim dhe rivlerësim i tyre mbi një bazë të re për të marrë prej tyre gjithçka të vlefshme e pozitive që mund t'i shërbejë kulturës sonë të re socialiste.

VI. ASPEKTI ESTETIK I VESHJEVE POPULLORE

Veshja për të dalë ka përgjithësisht një funksion estetik më të shprehur se veshja për punë. Kjo duket nga kujdesi i posaçëm

me të cilin punohet, nga zgjedhja e materialit nga zgjedhja e ngjyrave etj.

Në veshjet popullore zbukurimet janë shumë të larmishme dhe me karakteristika të veçanta nga një krahinë në tjetrën. Këto karakteristika përftohen nga repertori i motiveve, nga parapëlqimi i disa ngjyrave të caktuara në këtë apo atë krahinë, nga kombinime të caktuara të llojeve të ndryshme të zbukurimeve (teknika të ndryshme qëndisjeje, dantela, shirita, tufa e thekë etj.), nga realizimi i një lidhjeje midis pjesëve të ndryshme të veshjes etj. Megjithatë zbukurimet e veshjeve popullore kanë edhe disa karakteristika të përbashkëta ndër të cilat mund të përmendim këto:

a) Në veshjet e shekujve të fundit mbi-zotëronte zbukurimi me gajtanë ngjyrash të ndryshme si për anët, ashtu edhe për motifet dekorative. Gajtani jo vetëm me ngjyrat e ndryshme, por edhe me shtrirjen e tij lineare është një mjet artistik ndër lidhës midis elementeve përbërëse të kostumit, që jep kompaktësinë midis pjesëve dhe së tërës.

b) Pjesët më të zbukuruara ishin zakonisht gjoksi dhe mëngët e këmishëve,⁶⁹ jeklekët e mëngoret dhe për gratë, në mënyrë të veçantë, përparjet dhe mbulesat e kokës.

c) Kur dy-tre elemente visheshin njeri mbi tjetrin, i sipërmi do të ishte pak më i shkurtër se i poshtmi që të lejonte të dukeshin bordurat zbukuruese.

e) Pothuaj kudo zbukurimi i kostumit plotësohej me disa aksesore metalikë, «rgjannat», ose «stringlat» jo vetëm për gratë, por edhe për burrat, si ishin sumbullat, pafatit e togëzat, vezmet e qostekët, varëset, vëthët, e unazat, gjerdanët e ndryshëm etj.

d) Në shumicën e krahinave binte në sy prirja për zbukurime të rënduara në kostumin e martesës, sidomos për nuset e reja.

Megjithatë mbeten ende shumë gjëra për të thënë po të duam të karakterizojmë vlerën estetike të kostumeve tona popullore qoftë nga forma e përgjithshme e tyre, qoftë sipas krahinave të ndryshme apo për raportet e elementeve të veçanta ndaj kostumit në tërësi, natyrën dhe kuptimin e motiveve zbukuruese e të ngjyrave etj.

Për sa i përket siluetës së përgjithshme të kostumit, mund të vihet në dukje se si në kostumet e burrave, ashtu edhe në ato të grave, ka një larmi të këndshme. Kështu, në kostumin me fustanellë, gjerësia e konsiderueshme e saj dhe mëngët e xhamadanit të qëndisura e të lëshuara prapa, me valë-

69) Në shekullin e kaluar këmishët zbukuroheshin edhe përfundi, sikurse e tregojnë qartë ilustrime të shumta që i kemi paraqitur në kreun e parë.

vitjet e tyre bënin që të dukeshin më dinamike lëvizjet e gjymtyrëve të burrit shqiptar jo vetëm kur ai hiqte një valle, por edhe kur ishte thjesht në ecje. Ndërsa veshja me tirq, qoftë me ngushtësinë e pantallonave që rrinin të puthitura pas këmbë, qoftë me gajtanin e zi, i cili nxirrte në pah vijat e prerjes së tyre e të jelekut, ndikonin për ta paraqitur më të gjatë e më të zhdërvjellët trupin. Në veshjet e grave nuk mungojnë siluetat me fund të gjerë e bel të theksuar, si janë përgjithësisht veshjet me fustan të gjatë të shoqëruara me «cibun» me kinda verëf, të shumë zonave të Shqipërisë Juglindore, krahas atyre ku fundi i xhokës nuk vjen tepër i zgjeruar dhe për pasojë beli nuk theksohet aq shumë. Një notë më vete ruan kostumi i grave me mbështjellëse (veshja e Kallmetit me «shage» dhe ajo e Zadrimes), me ato rrudha të dendura vetëm tek ijat (si tek mbështjellësja, ashtu edhe tek përparja e Zadrimes) që bëjnë të theksohet shumë beli, silueta e tyre karakterizohet edhe nga mbulesat transparente të kokës, të vendosura lirshëm përmbi flokët të prerë shkurt deri tek tëmthat, që e nxjerrin edhe më tepër në pah gjatësinë e qafës së tyre.

Veshjet popullore u janë përshtatur disa kërkesave estetike të bartësve të tyre, në përputhje me nivelin e zhvillimit të shijes artistike popullore e të konceptit të tyre për të bukurën. Kështu mënyra dhe stili i zbukurimit të veshjes së grave të Lunxhërisë, të Zagorisë, të rretheve të Delvinës, të shumë zonave të rretheve Përmet, Kolonjë, Korçë etj., pasqyrojnë nivelin e zhvillimit të shijeve estetike të përafërta në këto zona, ndërsa zbukurimet e veshjeve të grave në skajin verilindor të vendit (rrethet Kukës, Tropojë etj.) tregojnë se shijet e tyre estetike ndryshojnë nga grupi i parë dhe i përkasin një tjetër nivel zhvillimi.

Repertori i ngjyrave që përdorte çdo krahinë në zbukurimin e pjesëve të veshjes, ishte në përgjithësi i njëjtë me gamën e ngjyrave që ndeshim në artin e zbatuar popullor të zonës përkatëse. Kjo varet sigurisht edhe nga përdorimi i bimëve ngjyrosëse të kësaj apo asaj zone, por varet edhe nga shijet estetike të grupit përkatës. Mjafton të sjellim ndërmend p.sh., ngjyrat karakteristike të Hasit apo të Malësisë së Gjakovës dhe t'i krahasojmë me ato të Zadrimes, të Myzeqesë apo të Mokrës së Sipërme etj., për të kuptuar dallimin e shijeve. Këtu ka rëndësi të vihet re jo vetëm se cilat ngjyra përdoren më fort në ve-

shjen e kësaj apo asaj krahine, por edhe shkalla e intensitetit të përdorimit të tyre. Veshje me zbukurime më të shumta dhe kromatikë të pasur në ngjyra të forta, kanë qenë karakteristike për disa zona si Zadrima, Dumreja, Sulova e Myzeqeja: ngjyra jo aq të zjarrta dhe zbukurime më të përmbajtura, karakterizojnë kostumet e Hasit, të Malësisë së Gjakovës, pjesërisht të Pukës e të një grupi zonash pak më në jug. Tone përgjithësisht të errëta, me zbukurime interesante në formë por disi të varfëra nga ana kromatike, mbizotërojnë në veshjet e Malësisë së Madhe, të Dukagjinit, të Çermenikës etj., për të përfunduar në kostumet më të qeta si janë veshja e grave të Kallmetit, ajo e grave të Bërzeshtës, Mokrës së sipërme etj. Zbukurimet më diskrete, sidomos qoftë janë ato që bëhen me të njejtën ngjyrë të sfondit, p.sh. qëndisjet me penjë të bardhë mbi fushën e bardhë të pëlhurës së këmishëve të burrave në Zadrimë, qëndisjet me penjë leshi të zi në jakat dhe pëqinj-të e xhurdivë prej shajaku të zi etj.

Duhet mbajtur parasysh, më anë tjetër, se zbukurimet e çdo elementi të veshjes kanë lidhje të ngushtë edhe me rastin për të cilën ai vishet, moshën dhe seksin e bartësit, gjendjen civile të tij.

Në një plan tjetër do të themi se shkalla e zbukurimit të kostumit sinkronizohet plotësisht me shfaqje të tjera të artit popullor të zonave përkatëse sidomos në raste festash, si p.sh. me vallet e muzikën, me dekorin e interioreve fshatare etj.

Nga gjurmimet e kryera në terren rezulton ky vlerësim artistik-emocional i ngjyrave: për ngjarje të gëzueshme, për nuse etj., konsiderohen të përshtatshme zbukurimet me ngjyrë të kuqe, kurse në disa zona për këto raste vlerësojnë si më të përshtatshme të parën ngjyrën manushaqe, të cilën e quajnë «bojë bukur» (p.sh. Malësia e Madhe) ose gjetiu «hashash», pas saj vijnë ngjyrë limoni, «të kuq të çelët», «të kuq Shkodre etj. Për moshën e mesme konsiderohen të përshtatshme këto ngjyra «bojë bari» ose «bojë hoxhe», pra e gjelbra, bojë kafe e aty këtu bojë qielli e blu, kurse për plakat, e zeza dhe e bardha veçmas ose të përziera. Për raste zije rregulli më i përhapur ka qenë jo të përdoret e zeza, por të përdoren ngjyrat e grupmohës pasardhëse të asaj që është në zi; kështu nuset e reja, në raste zije përdornin për një kohë të caktuar ngjyrat e grave të moshës së mesme e këto të fundit ngjyrat e plakave.

Rëndësia e madhe që i vihet zbukurimit të kostumit festiv ka të bëjë jo vetëm me

ndjenjat estetike që e duan veshjen të jetë sa më e bukur, por edhe me funksionin magjik që shprehej dikur si në motivet e përdorura, ashtu edhe në ngjyrat e sidomos në lidhje me pjesët e vendin e trupit ku vendosej ornamentin. Në fazën që na kanë arritur këto zbukurime, në shumicën e rasteve funksioni magjik ose ka humbur krejt ose është zbehur aq shumë sa nuk jepen dot shpjegime nga bartësit dhe ata thonë se bëhen për më bukur ose se kështu duhet. Sidoqoftë nuk është vështirë të kuptohet se vendosja p.sh., e një motivi në formë këndezi në zonën e stomakut, në këmbët e fëmijëve të Myzeqesë, (që i kemi përmendur më lart), ka pasur dikur një kuptim magjik; edhe fakti që fushat ornamentale të kostumeve popullore për gra vendosen jo vetëm në pjesët më të dukshme të kostumit, por edhe atje ku kostumi mbulon disa nga pjesët më delikate e më të lidhura me seksin, si janë jelekët e përparjet nuk mund të mos vihet në lidhje me funksionet magjike të këtyre ornamenteve. Dihet gjithashtu se ngjyra e kuqe, ngjyra e flakës dhe e gjakut, ka qenë një nga mjetet më të përhapura për t'u mbrojtur nga syri i keq; po këtë qëllim kishte edhe përdorimi i lloj-lloj zbukurimeve të shndritshme si temina, rruaza etj., që me reflekset e tyre të largonin efektet e syrit të keq. Përdorimi i shumë stringlave e xhinglave me pare e pjesë të tjera metalike tringëlluese si zbukurime gjoksi për nuset e reja bëhej po ashtu me besimin se shkëlqimi e zhurma e tyre largonin shpirtrat e këqij. Në kuadrin e këtij kapitulli ne s'mund të ndalemi më gjatë në këto çështje, por theksojmë se kuptimi e simbolika e shumë zbukurimeve të veshjes meriton, pa dyshim, një vëmendje më të madhe e gjurmime të mëtejshme.

Nga sa thamë më lart del e qartë se kostumet popullore, sidomos ato të grave fshatare, ruajnë në tërësinë e tyre, vlera të shumta artistike. Shumë herë me elegancën e vijës së përgjithshme apo me zbukurimet e pasura e interesante të përqendruara sidomos në disa pjesë të veshjes, me unitetin kromatik që karakterizon kostumin e çdo zone etnografike, veshjet popullore dëshmojnë për një ndjenjë të fortë estetike, të përpunuar e të stërholluar nga një brez

në tjetrin, dhe të pleksur me simbole botë-kuptimesh e mentalitetesh që i kanë rrënjët thellë në lashtësi. Mund të themi gjithashtu se me gjithë pasurinë dhe nganjëherë mbingarkesën me ornamente që paraqesin disa pjesë, kostumet popullore në tërësi e ruajnë sensin e masës dhe lidhjet plastike me lëvizjet e trupit.

Në ditët tona vendi dhe roli i kostumeve popullore nuk është më ai i paraluftës, shumë nga funksionet e tyre janë zbehur ose kanë humbur krejt. Kështu funksioni praktik i veshjes tradicionale është i papërfillshëm, sepse ato pothuaj kanë dalë krejt nga përdorimi. Ky funksion praktik ka kaluar në veshjen e re, që e ka bazën tek veshja qytetare dhe që ka zëvendësuar veshjet tradicionale. Ka megjithatë mjaft zona ku kostumet popullore ruhen si veshje ceremoniale dhe vishen jo vetëm në rast martesë, por edhe në festa e veprimtari të ndryshme kulturore-artistike. Natyrisht për të tilla raste parapëlqehen variantet më të plota të kostumit festiv të zonës, por në këtë rrjedhë të ngjarjeve përdodh një ngushtim gjithnjë e më i madh i veshjeve që riprodhohen duke lënë mbas dore dallimet që ekzistonin në veshje në bazë të moshës, seksit, gjendjes civile, shtresave shoqërore, stinëve të motit etj. Kështu gjithnjë e më rrallë po shihen në këto veprimtari kostume vajzash, fëmijësh, pleqsh, veshje dimri apo vere etj.

Me anë tjetër duhet të vemë në dukje se kostumet popullore ceremoniale, të cilat sikurse u vu në dukje më lart — shprehin shumë mirë edhe specifikën etnike — kanë fituar një popullaritet shumë më të madh nga ç'e kanë pasur në të kaluarën. Kjo ka ngjarë falë kujdesit të veçantë që PPSH i ka kushtuar ruajtjes dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore artistike. Kontribuojnë për këtë, organizimi me objektiva të qartë shkencorë i Festivaleve Folklorike të Gjirokastrës (në çdo pesë vjet njëherë), koleksionet e pasura muzeale në qendër e në rrethe dhe propagandimi i përhershëm i tyre në ekspozita të shumta brenda dhe jashtë vendit, botimet shkencore si dhe institucione të tjera të profilizuara si Ansambli i këngëve dhe i valleve popullore etj.

KLASIFIKIMI I VESHJEVE POPULLORE SHQIPTARE

Njohja e hollësishme e varianteve të shumta të veshjeve popullore që mbaheshin në Shqipëri jo vetëm gjatë shekullit XIX, por edhe në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë, si dhe përpjekjet për të zbuluar lidhjet midis varianteve të ndryshme dhe shkallët e afrisë midis tyre, lindën në mënyrë të natyrshme për studiuesit, nevojën e grupimit e të sistemimit të tyre.

Nuk është pa interes të përmendim së pari këtu mendimin e shprehur nga M. Haberlandt, sipas të cilit në Shqipëri mund të gjejmë pothuaj të gjithë tipat e veshjeve të përdorura në Ballkan.¹

Në fillim të shekullit tonë studiuesi hungarez Franc Nopça, krahas gjurmimeve në fusha të tjera të kulturës materiale e shoqërore të popullit tonë, është marrë edhe me gjurmimin e veshjeve shqiptare. Në veprën e vet «Shqipëria», botuar më 1925², në pjesën kushtuar veshjeve, ai na ka lënë përshtime të gjera të veshjes qytetare për gra e burra në Shkodër, si edhe për veshjet popullore në Zadrimë, Malësi të Madhe, Malësi të Vogël, Dukagjin e Mirditë, pra kryesisht për Shqipërinë Veriore.

Duke qenë se fusha e gjurmimeve të Nopçës përfshin vetëm një pjesë të Shqipërisë, klasifikimi i dhënë prej tij natyrisht që s'mund të konsiderohet i plotë. Një kufizim tjetër është padyshim materiali i pakët arkeologjik që ekzistonte në atë kohë si edhe dëshmitë e tjera dokumentare ven-

dase të përdorura për krahasim. Sidoqoftë ai ka mbledhur një material të pasur për kohën e tij, mbi veshjet e këtyre zonave në fillim të shekullit tonë, veçanërisht për veshjet e burrave, kurse përshtimet e veshjeve të grave, shumë herë lënë mjaft për të dëshiruar. Ai ka shfrytëzuar edhe fototekën e pasur të Marubit në Shkodër³, dhe ka arritur të japë një kuadër mjaft të plotë të veshjeve në zonën e marrë në studim.

Nga autorët vendës klasifikimin e parë të veshjeve popullore e ka bërë etnografi Rrok Zojzi i cili, në një studim të shkurtër të titulluar «Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë»⁴, botuar në vitin 1935, pjesën e parë ia ka kushtuar grupimit të veshjeve popullore. I nisur nga një material shumë më i gjerë se ai i etnografëve të huaj paraardhës, dhe nga një njohje e përgjithshme shumë më e plotë e kulturës sonë popullore, ai ka dhënë të parin grupim që përfshin gjithë territorin e Shqipërisë dhe me këtë, natyrisht, shënon një hap të madh përpara, në krahasim me grupimin e bërë nga F. Nopça, më 1925.

Në klasifikimin e tij, Rr. Zojzi është përpjekur të koordinojë tregues të ndryshëm, që duhen marrë parasysh siç janë: materiali i përdorur (leshi, lini etj.), përshtatja e materialit (vendosja e pëlhurës në trup vertikalisht apo horizontalisht), prerja (e shkëputur në mes ose jo, e hapur përpara ose jo) dhe mënyra e qepjes, të cilën

1) M. Haberlandt, *Die Völker Europas und ihre volkstümliche Kultur*, Stuttgart, 1928, f. 139.

2) F. Nopcsa, *Albanien, Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens Leipzig*, 1925, 138 faqe (ku pjesa e III kushtuar veshjeve zë 70 faqe). Shih edhe *Aus Šala und Klementi, albanische Wanderungen*, Sarajevo, 1910, f. 43-44, nga i njëjti autor.

3) Pothuaj të gjitha veshjet e paraqitura në të shtatë tabelat e vendosura në fund të veprës janë vizatuar në bazë të fotografive të Marubit.

4) Rr. Zojzi «Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë», «Studime Historike», Tiranë, 1965, 4, f. 143-152.

e konsideron si treguesin më pak të rëndësishëm. Rrok Zojzi veshjet popullore i merr së bashku, qofshin për burra, qofshin për gra, dhe i grupon në dy tipa: tipi i gunës dhe ai i xhubletës, të cilët sipas tij nuk kanë asnjë pikë takimi. Këta dy tipa me kohë, dhanë variante lokale dhe derivatet e tyre.

Tipi i gunës, i cili nga struktura morfologjike «përbëhet nga pesë pjesë kryesore: linjë, gunë, kofsharë, brez dhe, për gruan edhe përparje», ka një shtrirje shumë të gjerë gjeografike dhe ka dhënë variante të shumta, në bazë të materialit të përdorur për gunën, ngjyrave, formës dhe zbukurimeve të saj. Ky tip ka edhe derivate të shumta ndër të cilat, si më të rëndësishme Zojzi përmend kostumin me fustanellë, atë me tirq ose kofsharë dhe kostumin me brekushe.

Tipi i xhubletës, i përdorur vetëm nga femrat, si strukturë përbëhet nga xhubleta, kraholi, grykëza, mëngët, paraniku e mbështjellaku, dhe ka një shtrirje gjeografike të kufizuar. Xhubleta paraqit tre variante sipas ngjyrës së saj (e bardhë, e zezë, e kuqe) dhe dy të tjera sipas formës (xhubleta e gjerë dhe xhubleta e ngushtë). Prej këtij tipi veshjeje, gjithënjë sipas Zojzit, kemi vetëm një derivat, atë të kanacit të leshtë me pala (në Pukë, e Malësi të Gjakovës).

Si tipi i veshjes me gunë edhe ai me xhubletë janë plotësisht të motivuara dhe përfaqësojnë dy tipat më të largët në veshjet tona popullore. Por mendoj se disa nga ato që Zojzi i konsideron si «derivate», i kanë të gjitha kushtet që të konsiderohen si tipa më vete, e sidomos po të mbajmë parasysh, krahas strukturës, edhe gjenezën e tyre. Kështu p.sh., mendoj se duhet konsideruar si një tip më vete veshja me fustanellë, sepse për të ekzistojnë dëshmi të qarta arkeologjike që nga shek. V-IV p.e.r. si veshje e përdorur nga fiset ilire. Më anë tjetër, në pikëpamje etnografike mund të themi se midis këmishës së tipit të veshjes me gunë dhe fustanellës ekzistojnë ndryshime thelbësore. Po kështu është shumë vështirë të pranohet se veshja me brekushe është një derivat i tipit të gunës, kur të mendojmë se brekushet janë të dokumentuara qartë arkeologjikisht të paktën që në shek. III p.e.s. Edhe veshja me mbështjellëse (kanac), mendoj se nuk mund të konsiderohet një derivat i tipit të xhubletës, sepse format paraardhëse të saj i përkasin një kulture krejt tjetër nga ajo e qytetërimit të

lashtë kreto-mikenas, me të cilin lidhet xhubleta. Shtojmë se struktura e saj bazohet mbi parime krejt të ndryshme nga ato të xhubletës. Tek mbështjellësja materiali vendoset horizontalisht dhe mblidhet përqark belit, ose vetëm tek ijet me rrudha ose me pala mjaft të dendura dhe, duke qenë relativisht i butë qëndron disi i derdhur, kurse xhubleta vjen e zgjeruar vetëm për fundi, duke formuar një farë kloshi mjaft të ngurtë, sepse materiali i përdorur (zhgund dhe shumë fije gajtani, zbukurimet me aplikim e qendisje të shumta) nuk lejojnë të derdhet butë.

Për këto arsye jam e mendimit se klasikimi i dhënë nga Rr. Zojzi, megjithëse shënonte një arritje me vlerë për kohën kur është paraqitur dhe gjendjen e atëherëshme të gjurmimeve, është mjaft i përgjithshëm dhe si i tillë nuk lejon të zbulohen sa duhet veçoritë e veshjes së popullit tonë kundrejt popujve të tjerë në këtë fushë të rëndësishme të kulturës popullore, nuk ndihmon sa duhet për të vënë në dukje çkemi të përbashkët me ta e çkemi të veçantë. Ai i grupon në një tip të vetëm të gjitha veshjet e popullit tonë, si për burra e për gra, duke përjashtuar vetëm xhubletën, gjë që është vështirë të mendohet për një popull si i yni, që ka jetuar në një trevë ku janë kryqëzuar në periudha të ndryshme historike disa nga kulturat më të mëdha që njeh historia. Ato as kanë kaluar, as mund të kalonin pa lënë gjurmë të ndikimit të tyre edhe në këtë fushë. Nga ana tjetër, klasikimi i Zojzit nuk merr parasysh aq sa duhet edhe faktin se, disa veshje janë të dokumentuara si tipa më vete nga gjetjet e ndryshme arkeologjike, të paktën që në periudhën e hekurit (shek. VIII-IV p.e. sonë), kohë kur specifika etnike e kulturës së stërgjyshërve tanë ilirë ishte tashmë e formuar. Mendoj se ata tipa veshjesh që i gjejmë të dalluar që në këtë kohë, me karakteristika të veçanta si pjesë të kulturës ilire, duhet të jenë baza tek të cilët të kërkojmë lidhjet e kulturës sonë, në qoftë se duam të kapim specifikën etnike të saj.

* * *

Në klasikimin që do të japim më poshtë janë përfshirë veshjet e mirëfillta popullore kryesisht në gjendjen e dokumentuar të tyre në fund të shek. XIX — fillim i shek. XX, duke lënë jashtë ato veshje që

janë ndikim i qartë dhe relativisht i vonë i qytetërimeve të huaja që patën hyrë në shtresa të caktuara të shoqërisë sonë.

Klasifikimi i veshjeve popullore mund të bëhet duke marrë për bazë kritere të ndryshme. Ky që do të paraqesim më poshtë mbështetet kryesisht në tipologjinë e atyre pjesëve të sipërme të veshjes që mbulojnë trupin sidomos nga mesi e poshtë, pa injoruar pjesët e tjera të kostumit, kriter ky i përdorur gjerësisht edhe në vende të tjera të Ballkanit.

Në veshjet tona popullore vëmë re se elementet që mbulojnë pjesën e sipërme të trupit janë disi më uniforme, ndërsa ato që mbulojnë pjesën e poshtme janë më të shumëllojshme si nga format e prerjes, ashtu edhe nga përshtatja e materialit. Prandaj mendoj se tipologjia e këtyre të fundit, së pari, na jep mundësinë t'i përcaktojmë më mirë si dallimet ashtu edhe analogjitë, në raport me veshjet e popujve të tjerë të Ballkanit; po të merren për bazë tregues të tjerë, këto dallime zbehen dhe kështu nuk del në pah sa duhet specifika etnike; së dyti, ajo na lejon të bëjmë përqasje dhe krahasime midis pjesëve të veshjeve ekzistuese dhe të dhënave figurative e dokumentare nga koha e mesme, koha e lashtë dhe periudha të tjera më të hershme të zhvillimit kulturor të popujve dhe të zbulojmë sidomos lidhjet me veshjet e të parëve tanë, ilirëve, lidhje për të cilat ne, pa dyshim, jemi shumë të interesuar.

Kështu pra, për rëndësinë që paraqet, si ndriçimi i lidhjeve me veshjet e popujve fqinj, ashtu edhe ai i lidhjeve me paraardhësit tanë, ne morëm si element përcaktues në këtë klasifikim atë pjesë të veshjeve ku këto çështje dalin më mirë në pah, pra pjesët e sipërme që mbulojnë trupin nga mesi e poshtë, duke mbajtur parasysh mirë llojin e materialit të përdorur, format e prerjes e përshtatjen e materialit si edhe qepjen e zbukurimin e tyre. Veç kësaj edhe vetë populli shprehet pak a shumë mbi këtë bazë. Kështu p.sh. ai thotë: gratë e Malësisë së Madhe «visheshin me xhubleta» dhe nuk thotë, bie fjala «visheshin me krahola»; ose thotë labët visheshin me poture dhe jo «visheshin me xhamadane».

Duke mbajtur parasysh karakterin historik të veshjeve, d.m.th., zhvillimin deri në një lulëzim të plotë të pjesëve kryesore, pastaj rënien dhe zëvendësimin e tyre me të reja ose mbijetesën në formë gjurmësh

të zbehta krahas elementit të ri, do të kuptojmë se si janë shdërruar ato, nga një brez në tjetrin. Zëvendësimet e plota të kostumeve janë të rralla. Ato janë vërtetuar vetëm në raste kthesash të mëdha shoqërore e politike.

Për sa i përket shtrirjes territoriale të një kostumi a të një tjetri, luhatjet kanë qenë të vazhdueshme. Shkaqet e këtyre luhatjeve kanë qenë të shumta. Po përmendim ndër të tjera, qendrat tradicionale të tregjeve krahinore e ndërkrainore, ku shiteshin prodhimet zejtare dhe ato të importuara, mbyllja e disa rrugëve tregtare (sidomos mbas 1912-ës), forca e rrezatimit të modës së qendrave qytetare, huazimet midis zonave dhe, mbi të gjitha këto, zhvillimi i forcave prodhuese të zonës përkatese. Kanë ndikuar gjithashtu lëvizjet e brendshme të popullsisë, zonat tradicionale me të cilat bëheshin lidhjet martesore, përhapja e myslimanizmit dhe e kulturës islame e në një farë mase edhe faktorët subjektivë, sidomos për ato pjesë veshjeje që konfeksionoheshin brenda ekonomisë shtëpiake. Uniteti ekonomik i një zone, ka sjellë përgjithësisht afrime edhe në veshjen e burrave, kurse veshjet e grave paraqiten më të copëzuara në variante të ngushta lokale, në krahasim me ato të burrave.

Ka ndodhur shumë herë që, në të njëjtën krahinë, të bashkëjetojnë dy ose më shumë tipa veshjesh. Kjo duhet shpjeguar, së pari, me lëvizjet e popullsisë e përzierjen e anasve me të ardhurit, sidomos në shekujt e Mesjetës, por edhe me marrëdhëniet shoqërore midis krahinave e faktorë të tjerë. Një shembull i qartë i këtyre përzierjeve është, p.sh., fusha e Zadrimës, ku gjejmë kostumet e Malësisë së Madhe, të Mirditës, të Rranzave e të vetë fushës. Në një masë, ku më të madhe e ku më të vogël, të tilla përzierje popullore e afrime kulturore kanë ndodhur kudo. Kjo ka sjellë me kohë afrimin e disa llojeve veshjesh me të tjera të një tipi të afërt, njësimin e disa elementeve, të cilat kanë marrë kështu një shtrirje ndërkrainore, si ka ndodhur p.sh. me kësulat e takijet, xhurditë, brezat, opingat, tirqit etj. Por vëmë re se në rast se veshjet kanë qenë të largëta nga pikëpamja tipologjike, përzierja ka qenë e kufizuar në elemente të parëndësishëm ose nuk ka ndodhur fare. Kështu p.sh. në Zadrimë, veshja me xhup (e Mirditës) me atë me xhubletë (e Malësisë së Madhe) nuk janë përzier fare. Po kështu ka ndodhur

edhe për veshjen me mbështjellëse (të Kallmetit) dhe atë me xhubletë.

Në disa raste ka ndodhur edhe një tjetër dukuri. Është kryer një diferencim në veshje, sidomos në veshjet e grave, në varësi nga feja së cilës i përkiste bartësi Kështu, brenda të njëjtit fshat ose së njëjtës zonë, kostumi i myslimanizuar ndryshonte nga ai i të krishterëve. Këto ndryshime mund të ishin të vogla, duke mbetur brenda të njëjtit tip, por mund të ishin edhe të mëdha, domethënë të mbareshin tipa të ndryshëm veshjesh. P.sh. në Mokrën e Sipërme ka pasur ndryshime midis veshjes së grave myslimane e atyre të krishtera. Po kështu ka ndodhur në Opar, në Myzeqe e gjetkë. Ndryshime midis veshjes së grave myslimane e të krishtere kishte padyshim edhe në qytet.

Si do të vihet re nga përshkrimet e shkurtra që jepen më poshtë, për çdo variant të veshjes është marrë në konsideratë kryesisht kostumi që vishet për të dalë dhe jo ai që përdoret si veshje e përditshme pune, për shkak se gjurmimet kanë treguar qartë se i pari është më i plotë në pjesët përbërëse dhe ruan vlera më të mëdha artistike. Por ku ka qenë e nevojshme i jemi referuar edhe veshjes së përditshme.

Njohuritë e fituara nga materialet ekzistuese mbi gjendjen e veshjeve popullore në tre-katër shekujt e fundit, të cilat i kemi parashtruar në kapitullin e parë të kësaj vepre, kanë ndihmuar shumë për të kuptuar dhe interpretuar më mirë format e evoluara të shumë kostumeve popullore në fillim të shekullit tonë dhe për të zbuluar lidhjet me zonat apo grupet e tjera.

Tipat e veshjeve qoftë në tërësi, qoftë në elementet e veçanta të tyre, nuk kanë të njëjtën moshë dhe origjinë. Një shqyrtim më të hollëqishëm që të sqarojë prej ç'kohe janë në përdorim të popullit tonë këto veshje dhe ç'dihet për origjinën e tyre, do ta parashtrojmë në kreun IV.

Renditjen e mëposhtme të tipave të veshjes jemi përpjekur ta bëjmë duke mbajdy faktorë: vjetërsinë e tyre dhe shkallën e shtrirjes.

Veshjet popullore do t'i shqyrtojmë në dy grupe të mëdha që janë: 1) veshjet për burra dhe 2) veshjet për gra. Përbrenda secilit grup do të përshkruajmë përmbledhtas formën, strukturën dhe përhapjen e çdo tipi të veçantë dhe të varianteve kryesore të tij.

VESHJE PËR BURRA

I. Veshja me fustanellë.

Pjesa më karakteristike këtu ishte *fustani* a *fustanella*. Ky fund i gjerë me kinda e rrudha që ngjishej për mes, arrinte deri te gjunjët. Fustanella ishte përgjithësisht e bardhë, e bërë me pëlhurë të pambuktë, të punuar në shtëpi ose të fabrikuar. Në disa raste, kryesisht për kaçakët, komitet e luftëtarët e çetave të lirisë, ka ndodhur që ajo të mbahej edhe e murrme ose e zezë. Gjatësia e fustanellës luhatej nga një krahinë në tjetrën, që nga mbi gju deri në pulpë. Fustanellat mbi gju i mbanin përgjithësisht djemtë, burrat e rinj, komitet. Fustanellat më të gjata (deri në pulpë të këmbës), janë mbajtur nga burrat e parisë shkodrane deri në Shpalljen e Pavarësisë, pastaj filluan të lihen.

Sikurse u vu në dukje më lart kjo pjesë veshjeje përmendet me emrin «fustan» që në shekullin e XIV (viti 1335)⁵, por origjina e saj shkon shumë më thellë, me sa kanë treguar gjurmimet e deritanishmë.

Në pjesën e sipërme të trupit burri vishte një këmishë të gjatë deri në kërdhokla. Në shtresat qytetare të mesme e të larta, kjo këmishë, gjatë shekullit XIX, bëhej prej pëlhure të mëndafshhtë të punuar në shtëpi⁷; në disa qytete kjo traditë pati vazhduar edhe në shekullin tonë. Këmisha njihëj me emra të ndryshëm lokalë sipas krahinave. Për burrat e moshës së re ajo bëhej zakonisht me mëngë të gjera e të gjata deri te llëra. Për moshat e tjera mëngët ishin përgjithësisht të gjata e të drejta.

5) *Acta et diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*, Wien, 1913, vëll. I, dok. 790.

6) A. Gjergji, *Elemente të përbashkëta të veshjes së fiseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet tona popullore në vëllimin «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve»*, Tiranë, 1969, f. 156-157. Shih edhe kap. IV të kësaj vepre.

7) G. Hahn, *Albanesische Studien*, Jena, 1854, f. 108.

Nën këmishë burri mbante shumë herë një fanellë leshi, me mëngë të ngushta. Mbi këmishë, sipas stinës, vishte ose vetëm jelekun, ose bashkë me të edhe mëngoren, të bëra prej shajaku, cohe ose kadifeje dhe të stolisura me gajtanë leshi a fije ari, sipas shtresës shoqërore dhe gjendjes ekonomike.

Në pjesën e poshtme të trupit burri mbante të mbathurat e gjata prej pëlhere dhe mbi to kalçet a kofsharët, të cilët ishin si gypa të ngushtë shajaku që fillonin nga nyja e këmbëve e arrinin deri lart në rrëzë të kofshëve. Por forma më e vjetër duket se kanë qenë kallçijt a toslukët, copa shajaku këto, që mbulonin këmbët nga nyja deri në gju dhe mbërtheheshin në një rën anë. Për burrat e shtresave të pasura, ato bëheshin prej cohe ose kadifeje të njëjtë me atë të jelekut e të mëngores dhe, njëllonj si ato, zbukuroheshin me qendisje me gajtanë mëndafshi ose me fije ari, ashtu si i shohim nëpër shumë gravura e piktura të shekujve XVIII-XX. Në fillim të shekullit tonë kishte disa zona si Bregdeti⁸, një pjesë e Myzeqesë, Mallakastra, Skrapari, një pjesë e Kolonjës etj. ku burrat vishnin nën fustanellë edhe poturet prej shajaku ose cohe ngjyrë blu të thellë.

Kostumi me fustanellë plotësohej me një brez të gjatë të leshtë (ose të mëndafshhtë, në shtresat e pasura qytetare) e me një silah lëkure sipër, çorapet e leshta, opingat prej lëkure dhe lloje të ndryshme festesh a takijesh, përgjithësisht të bardha për fshatarësinë. Për kohë të ftohtë burrat hidhnin sipër flokatën e trashë, të bardhë prej leshi, me thekë përbrenda e të dërstilur mirë, e cila nuk kishte mëngë, por lapa të mëdha në formë trekëndëshi që vareshin nga supi, deri afër bërrylit. Burrat e shtresave të pasura mbanin, në vend të flokatës, dolloma ose xhybe të ndryshme cohe të kush-tueshme, të qendisura me ar ose gajtanë mëndafshi, si p.sh. dollama prej cohe të kuqe e qendisur me ar e burrave pasanikë shkodranë.

Në ekzemplarët më të pasur ku jeleku, mëngorja, tosluket dhe silahu, qenë të mbuluar me qendisje me fije ari, kostumi i

fustanellës merrte një pamje madhështore. Fustanella e bardhë e pala-pala i jepte burrit shqiptar në ecje një pamje shumë të veçantë. Ajo lejonte lëvizje të lira e të shka-thëta, qoftë kur vargu i burrave kërcente vallet energjike e burrërore të vendit, qoftë kur nisej me kuaj për luftë etj.



Fig. 97 — Veshje burri me fustanellë të gjatë (Shkodër 1890).

Deri në fillim të shekullit tonë veshja me fustanellë është mbajtur nga burrat pothuaj në gjithë vendin nga jugu në veri shumë herë krahas me tipa të tjerë veshjesh që përdoreshin në zona të veçanta. Në shekullin e kaluar përdorimi i fustanellës, në veri, sipas shumë dëshmimeve të kohës, shtrihej nga Shkodra deri në Novi-Pazar prej atje zbriste në jug deri në krahinat shqiptare në Maqedoni.⁹ (shih edhe fig. 32, 35, 36, 38 etj.).

8) Përgjigje pyetësorit mbi Veshjet popullore, për fshatin Borsh (rrethi i Sarandës) 1973,

9) Shih A. Boué, *La Turquie d'Europe*, vol. II, Paris 1840, f. 224; J. Roskiewitz, *Studien über Bosnien und die Herzegovina*, Leipzig, und Wien, 1868, fig. 3; E. Spencer *Travels in European Turkey*, London, 1853, f. 290, 381; J. G. Hahn, *Reise durch die Gehiete des Drin und Wardar*, Wien 1867, f. 82.



Fig. 98 — Veshje burri (poeti Naim Frashëri më 1900).

Le të theksojmë se përhapja e këtij kostumi ilustron më së miri një nga shfaqjet e karakterit unitar të kulturës sonë popullore në shekujt XVIII-XIX dhe, si i tillë, duhet vlerësuar edhe si një nga shfaqjet e specifikës së popullit tonë në raport me popujt e tjerë.

Meriton të vihet në dukje fakti se që

në shekullin e kaluar ishte kryer, në disa zona, një diferencim i qartë klasor në përdorimin e veshjes me fustanellë. Kështu krahas atyre krahinave ku fustanella ishte një kostum i gjithë shtresave shoqërore, kishte të tjera krahina ku ajo ishte veshje e pasanikëve¹⁰, e bejlerëve e agallarëve apo dhe e «trimave» që përbënin suitat e tyre. Në këto shtresa fustanella njohu për një kohë apogjeun e lulëzimit të saj dhe pastaj edhe deformimet që shënuan fazën e rënies. Ajo mori kështu, herë-herë gjerësi e gjatësi të tepëruar, që vërtet i jepte një pamje madhështore atij që e mbante, por ishte shumë e parehatshme, për shkak të peshës së saj të rëndë. Qytetarët pasanikë shkodranë të mesit të shekullit XIX visheshin me fustanella që kishin 500-750 kinda dhe me jelekë, xhamadanë e toslukë cohe të kuqe të qëndisur me ar.¹¹ Rilindësi ynë i shquar Pashko Vasa, i cili padyshim i njihte mirë traditat e qytetit të vet, na i paraqet të veshur me fustanella të gjera, e xhamadanë të kushtueshëm si Aradin e Vlashajve, ashtu edhe Osman Agë Hotin, të dy përfaqësues të parisë shkodrane¹² në romanin e vet etnografik, si mund ta quajmë, «Bardha e Temalit», ku ngjarjet e trajtuara, i përkasin mesit të shek. XIX. Fustanella në Shkodër mbahej krahas kostumit me tirq. Na e provojnë këtë persona të ndryshëm, kryesisht myslimanë, që i shohim nëpër fotografi të çerekut të fundit të shek. XIX. Për këtë mund të sjellim edhe dëshminë e një udhëtarit që ka vizituar Shqipërinë e Veriut në vitin 1879¹³.

Dëshmi të tjera për karakterin klasor të ndryshimeve të kostumit me fustanellë kemi edhe më vonë, nga fillimi i shekullit tonë, kur ky kostum del gradualisht nga përdorimi. Në shtresat e pasura ai kishte

10) A. Boué, *vep. cit.*, f. 199 «Shqiptarët ortodoksë të shtresave të pasura dalloheshin nga fshatarët nga fesi me majë, toslukët dhe jelekët prej cohe të kuqe, me gajtan të zi ose me qëndisje me fije ari e argjëndi, nga brezat e kuq që u shtrëngonin belin si edhe nga fustanellat e tyre prej pëlhere të hollë». Dhe më poshtë, në f. 224: «Tek Arnautët e Moezisë së epërme e ata pranë Fushës së Kosovës... po ashtu si tek Gegët që jetojnë në fushë, njerëzit më të pasur mbajnë kostumin e plotë shqiptar, domethënë fustanin, toslukët, opingat, jelekun prej cohe të kuqe, xhamadanin me anë të rrumbullakosura e prej së njëjtës cohe të jelekut dhe kalotën e kuqe shqiptare. Një trupë shqiptarësh të veshur kështu dhe të armatosur, bën një përshtypje me të vërtetë të mrekullueshme.»

11) H. Hecquard, *Histoire et description de la Haute Albanie ou Gueguerie*, Paris, 1859, f. 285.

12) Albanus Albano (Pashko Vasa), *Barda de Temal*, Paris, 1890, f. 17, 181.

13) A. Mayhew, *In Albania with the Ghegs*, në «Scribner's Monthly» vol. XXI, New-York, 1881, f. 385. Shih edhe kap. I f. 97, shën. 155, të kësaj vepre.

degjeneruar në forma që s'ishin aspak praktike.¹⁴

Me kohë përdorimi i këtij kostumi erdhi duke u kufizuar. Në prag të Luftës së Parë Botërore ai kishte dalë nga përdorimi dhe në vend të tij ishin përhapur kostume të tjera, si brekeshat e trasha prej leshi në rrethet e Elbasanit e në një pjesë të Myzeqesë dhe poturet në Mallakastër, në Myzeqe, në Labëri e gjetkë. Mbi shkaqet e daljes nga përdorimi të fustanellës në Malësitë e Shkodrës F. Nopça, më 1910 shkruante: «Duket qartë se pesha e madhe dhe çmimi i lartë janë shkaku i zhdukjes së fustanellës. Tradita sipas së cilës nja 50 vjet përpara kjo pjesë veshjeje mbahej edhe në malësi, jeton ende; në shumë vende të fushës ka malsorë që flasin ende për këtë përdorim...»¹⁵

Si na tregojnë materialet që kemi paraqitur në pjesën e parë, fustanella ishte në përdorim edhe te arbëreshët (arvanitët) e Greqisë (shih fig. 48) e të Italisë dhe, (fig. 50) si një ndikim shqiptar, ishte bërë e njohur edhe në popuj të tjerë të Evropës Juglindore. Madje si veshje tipike e stradios Juglindore. Madje si veshje tipike e stradios Juglindore. Madje si veshje tipike e stradios Juglindore. Madje si veshje tipike e stradios Juglindore. Shumë ndryshme të Evropës Perëndimore. Shumë udhëtarë të huaj shënojnë se me rrobe «të modës shqiptare», visheshin gardat e shumë oborreve feudale,¹⁶ suitat që shoqëronin konsujt a personalitete të tjera të rëndësishme të kohës etj.

Kjo veshje është një nga kostumet më tipike shqiptare, e njohur dhe e përdorur në mbarë Shqipërinë, që i pati karakterizuar shqiptarët, në pikëpamje të veshjes, për shekuj të tërë e sidomos në shekujt XVIII-XIX. Në përhapjen e këtij kostumi tek fqinjët tanë duhet të shohim pra rolin aktiv dhënë të kulturës sonë materiale në këtë fushë të rëndësishme, si është veshja e popullit.

II. Veshja me këmishë të gjatë e cibun (dollamë)

Në këtë kostum pjesa themelore ishte këmisha e gjatë deri nën gju, me mëngë të gjata, e bërë prej pëlhure të bardhë të punuar në avlëmend ose të blerë. Në variantet e saj më të zhvilluara kjo këmishë kishte një gjerësi të konsiderueshme kështu që, pamja e saj, nga mesi e poshtë i afrohej fustanellës. Shtresat e varfra e mbanin prej pëlhure liri ose pambuku, kurse të tjerët prej faqelli të fabrikuar.

Për të plotësuar kostumin, burri kishte nën këmishë një fanellë dhe një palë të mbathura të gjata e mbi to kallçijt ose kofsharët. Pastaj vishte sipër dollamë shajaku e xhurdi (përgjithësisht në Veri) dhe cibun me ose pa mëngore sipër (në Jug). Mbi dollamë ose cibun ngjishte brezin e leshtë. Në kohë mbante feste të kuqe ose të bardhë.

Për sa i përket strukturës së këtij kostumi në shekullin XVIII, le të vemë në dukje se materiale të ndryshme figurative të kohës (si janë p.sh., *Kelmendasi* i Haketit, *Shqiptarë nga Atika*, vizatuar nga Kastellan, *bariu myzeqar*)¹⁷ tregojnë se burrat shqiptarë të shtresave të ndryshme shoqërore, vishnin përmbi këmishë një anteri të gjatë pothuaj aq sa këmisha, krejt të hapur përpara, pëqinjtë e së cilës kryqëzoheshin njëri mbi tjetrin, e përmbi të ngjishnin brezin. Sipër saj vishnin xhokën prej shajaku, të gjatë deri mbi gju. Gjatë shekullit XIX kjo anteri e gjatë, e ndikimit oriental, del nga përdorimi duke i lënë vendin një anterie më të shkurtër, deri në bel, që quhet edhe mintan.

Tek kjo anteri e gjatë, e cila në disa zona të Jugut quhej edhe dollomà, mendoj se duhet të shohim një rrezatim të veshjeve qytetare të kohës, veshje si ajo e ktitorit korçar Shamo (1725),¹⁸ ndikim i cili

14) Shih M. E. Durham, *Through the land of the Serbs*, London, 1913, f. 105. Autorja këtu shkruan: «Fundi për ne është një element veshjeje veç për femra, por fundi i «barbarëve» është zhvilluar në Shqipëri duke dhënë një kilt të gjerë dhe të rëndë dhe beu muhamedan kapardiset i veshur me një fustanellë të parehatshme, që i arrin deri te nyjet e këmbëve. Ai nuk punon dot sepse mban fustanellë dhe, thonë se ai vesh fustanellën që të mos mundë të punojë. Nevojiten 40 m. pëlhurë për këtë veshje kolosale.»

15) F. Nopcsa, *Aus Sala und Klementi*, Sarajevo, 1910, f. 44.

16) A. Gjergji, *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri*, në «Etnografia Shqiptare» VII, Tiranë, 1975, f. 100, 114, 116.

17) A. Gjergji, *Vështrim historik*, etj. f. 89-134, fig. 15, 18, 20.

18) A. Gjergji, *po aty*.

nuk arriti të asimilohet e të integrohet plotësisht në kostumet e mirëfillta popullore e kështu nuk pati jetë të gjatë¹⁹. Në paraqitjet e shumta figurative që kemi nga fundi i shek. XIX e këtej, kjo pjesë e kostumit nuk shfaqet më. Duket se pikërisht daljes së saj nga përdorimi i detyrohet ai zhvillim që merr në kostumet e Jugut, në fillim të shek. XX, këmisha e gjatë, duke u zgjeruar nga mesi e poshtë, ndoshta edhe për të imituar sadopak pëmjen e fustanellës krenare, që gëzonte prestigj të lartë.

Këmisha e gjatë, me shtat të drejtë dhe me mëngë të gjata, që është elementi themelor në këtë tip veshjeje, në dokumente përmendet edhe në shekujt XVII, por origjina e saj shkon shumë më përpara.²⁰

Tek ky tip veshjeje për burra mund të dallojmë dy variante kryesore:

1. — Në variantin e parë mbi këmishën dhe të mbathurat e gjata burri vishte, për kohë të freskët, një «dollamë» shajaku të bardhë, të gjatë deri nën gju, që mund të ishte me ose pa mëngë dhe mbi të xhurdinë e shkurtër prej shajaku të zi, me mëngë të shkurtra dhe jakë të madhe katrore prapa, shumë herë e zbukuruar me tufa e qendisje të ndryshme.

Kostume të përbëra nga pjesët kryesore që përmendëm më lart, si na tregojnë shumë të dhëna nga terreni e nga literatura, që i referohen fillimit të shekullit tonë, janë mbajtur në pjesën më të madhe të Shqipërisë Veriore, duke filluar nga Shala (rrethi i Shkodrës), në Mirditë, Malësi të Lezhës, Lurë, Kurbin, Mat, Dibër etj. dhe, në shekullin e kaluar, në Malësi të Shkodrës. Ja si e përshkruan këtë kostum në 1840, udhëtari frëng A. Bué: «Shqiptarët e rretheve të Shkodrës, dhe mirditasit, me ose pa këmishë, mbështillen me një lloj redingote (dollamë — A. Gj.), prej shajaku të bardhë, e cila është e çarë anëve në katër vende... Këto të çara janë bërë për të lehtësuar ecjen... Xhamadani i tyre është i kuq, mbi të silahu prej lëkure...; kallçijt, opin-gat çorapet prej leshi dhe kësula e kuqe e plotësojnë kostumin. Për kohë të ftohtë ata kanë strukën dhe rrallëherë një kapotë

apo gunë të shkurtër, me ngjyrë të errët, që vishet mbi redingotën. Mungesa e këmishës në verë nuk është gjithnjë shenjë e një varfërie të thellë, se në Shqipëri, si në Mal të Zi, banorët e ndjejnë veten më lirshëm kështu pa këmishë në kohën e të nxehtit»²¹. Këtij përshkrimi i përgjigjen më së miri mirditasit e fotografuar rreth viteve 1875-1880²² (fig. 99).

Veshja me këmishë të gjatë, dollamë e xhurdi sipër, është mbajtur deri në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit tonë (me përjashtim të malësive të Shkodrës ku ka dalë nga përdorimi më herët) krahas ndonjë ko-



Fig. 99 — Burrë me dollamë shajaku të bardhë (Mirditor) viti 1875 (Marubi 40/3).

19) F. Nopcsa, mendon se një ndikim të tillë duhet të shohim edhe tek etj., f. 159-160, 195.

20) A. Gjergji, *Elemente të përbashkëta* etj. Tiranë, 1969, f. 154-157.

21) A. Boué, *vep. cit.*, vëll. II, f. 223-224.

22) Shih fotot me nr. RA-40/3 dhe RA-23/6, Fototeka shtetërore Shkodër (foto të Marubit).

stumi tjetër. Më vonë vendin e tij e zë kryesisht veshja me tirq, e cila, në zonën e Mirditës, hyri së pari në Orosh e pastaj u përhap në fshatrat e tjera²³. Sidoqoftë, zhurdia qe një element që qëndroi edhe në kostumin e ri me tirq.

2. — Varianti tjetër ishte ai ku, mbi këmishën e të mbathurat e gjata, burri vishte «cibunin» e gjerë kinda-kinda nga mesi e poshtë dhe mbi të mëngoren e bardhë. Në kokë mbante feste belluzi të zezë.

«Cibuni» (ose «sheguni» si quhej në disa zona), bëhej prej shajaku të bardhë. Deri në bel vinte i drejtë pastaj nga mesi e poshtë, zgjerohej shumë. Kindat e mëdhenj anësorë lëshoheshin verëf në pala të dendura. Ai nuk kish mëngë dhe zbukurohej anëve me gajtan leshe, gjithashtu të bardhë. Kostumi plotësohej me «mëngoren» (një lloj xhamadani i shkurtër gjer në bel me mëngë të hapura të lëshuara prapa, që bëhej po ashtu prej shajaku të bardhë), me brezin e gjatë e të leshtë dhe me «kalcat» (kofsharët) prej shajaku që mbatheshin mbi të mbathurat e gjata (fig. 100).

Që nga fundi i shekullit të kaluar, cibuni, mëngorja dhe kalcat filluan të mbahen jo vetëm prej shajaku të bardhë, por edhe në ngjyrën blu të errët, (fig. 101), bile edhe të përziëra, domethënë me cibunin blu, kalca të bardha etj.

Kjo veshje mbahej krahas kostumit me fustanellë dhe midis tyre janë vënë re edhe ndikime reciproke. Megjithatë mund të vemë në dukje se, ndërsa kostumi me të fustanellë ishte veshje e preferuar, jo vetëm e më të pasurve, por edhe e fshatarëve myslimanë të Jugut, ai me këmishë të gjatë e cibun, mbahej më fort nga fshatarët ortodoksë, krahas kostumit me fustanellë, që ishte për ta më shumë një veshje festash.

Kostumi me këmishë të gjatë e cibun mbahej në shumë zona të Shqipërisë së Jugut, si në rrethet e Korçës, të Pogradecit e të Kolonjës, në fshatrat e Prespës, në rrethin e Sarandës etj.

Veshja me këmishë të gjatë e dollamë shajaku është përdorur edhe në shumë vende të tjera të Evropës Juglindore e Qendrore, sidomos deri nga fillimi i shekullit tonë. Por megjithëse tipi është i përbashkët, variantet që mbaheshin në vendin tonë paraqesin disa karakteristika të veçanta,



Fig.100 — Burrë me cibun shajaku të bardhë (Opar) (1951).

të dallueshme nga ato të popujve të tjerë, qoftë në kombinimin e pjesëve, qoftë në zbukurimet e tyre.

III. Veshja me tirq.

Elementi më karakteristik në këtë kostum ishin tirqit, pantallona të ngushta prej shajaku të bardhë e ndonjëherë edhe të murrme ose të zi, me dy shqeka përpara, që ngjisheshin pak më poshtë belit. Tirqit zbukuroheshin anës të qepurave dhe për-qark xhepave e shqekave me gajtan të zi ose të bardhë, (fig. 102). Në vendosjen e këtyre zbukurimeve, pra edhe në vetë prerjen,

23) «Më 1907- shënon Nopcsa për këto zona — shiheshin shpesh dollama të kombinuara me elemente të kostumit të ri me tirq»Shih Albanien.... etj. f. 160.



Fig. 101 — Burrë me cibun shajaku blu (Kolonjë).

kishte dallime nga një zonë në tjetrën. E vetmja zonë që, përveç gajtanëve, i zbukuronte tirqit edhe me disa qëndisje të tjera poshtë xhepave ose pranë nyjeve, ishte Malësia e Madhe (dhe malësorët e rënë në rrethin e Lezhës). Sidoqoftë duhet vënë në dukje se numri i fijeve të gajtanit që vihej për zbukurim rritej sa më e lartë të qe shtresa shoqërore dhe sa më i pasur të qe ekonomisht ai që i mbante. Tirqit që mbanin, pasanikët muhamedanë shkodranë, kishin deri në 10-12 fije gajtani. (fig. 103). Shumë të zbukuruar me gajtanë ishin edhe tirqit e Elbasanit. (fig. 104).

Në disa zona në rrethet e Krujës, të Matit, të Mirditës si edhe në Kosovë, në dimër tirqit i shoqëronin me kallçij shajaku mbi ta, për një mbrojtje më të mirë nga të ftohtit, por edhe për t'i ruajtur nga konsumimi i shpejtë pjesët e poshtme të tyre.

Në një pjesë të Shqipërisë Veriperëndimore tirqit njiheshin me emrat «çakçirë» (përgjithësisht, në rrethin e Shkodrës) dhe



Fig. 102 — Burrë me tirq të bardhë nga Kraja (foto Marubi)

«xhedikë» (sidomos në rrethin e Krujës e të Dibrës etj.) Që të dyja këto fjalë janë të burimit turk. Tirqit kanë një origjinë mjaft të lashtë, prandaj përdorimi i termave «çakçirë» dhe «xhedikë» është i pasaktë dhe relativisht i ri, po t'i krahasojmë me vetë objektin që emërtojnë.

Në pjesën e sipërme të trupit burri vishte një këmishë të bardhë me mëngë të gjata, mbi të mintanin, gjithashtu me mëngë të gjata, e pastaj jelekun e xhamadanin prej shajaku të bardhë ose prej cohe, të zbukuruar me gajtan të zi²⁴ ose me qëndisje ngjyrash të ndryshme. Mesin e mbështillte me një brez të gjatë me ngjyra, në të cilin vendoste edhe «armët e brezit». Nën tirqit mbante zakonisht brekë të gjata pëlhure. Mbathte çorape dhe mbi to shputa leshi shumëngjyrëshe dhe pastaj opinga lëkure (më vonë edhe llastiku), të punuara

24) Në Selcë të Kelmendit xhamadani bëhej prej cohe të zezë dhe zbuksur me gajtan gjithashtu të zi (shih F. Nopcsa, *Albanien*, f. 167).



Fig.103 — Burrë me tirq me shumë gajtan nga Tuzi (Marubi 24/24).



Fig.104 — Burrë me tirq të bardhë nga Elbasani

vetë. Në kokë mbante qeleshe të bardhë, në formë gjysmësphere ose rrafshatake.

Ky kostum kishte në përgjithësi një pamje tërheqëse dhe elegante e, me tirqit e ngushtë pothuaj të puthitur mbaës këmbëve, me vijat e gajtanit të zi që spikasin mbi sfondin e bardhë të shajakut, sikur e zgjaste edhe më tepër siluetën e malësorëve shqiptarë dhe ruante disa tipare tradicionale të veshjeve mesjetare.²⁵

Në veshjet e shumta me tirq mund të dallojmë tre grupe: 1 — Grupin e parë e përbëjnë veshjet e atyre zonave ku tirqit prej shajaku të bardhë, zbukuar me gajtan të zi, shoqëroheshin me xhurdinë e shkurtër prej shajaku të zi, me mëngë të shkurtra e të zbukuruara me tufa të dendura prej fijesh leshi të qëndisura te jaka, anëve, përpara e te supet. Tirqit e këtij grupi ishin më të zbukuarit, sido-

mos te prehri.

Me këtë kombinim veshja me tirq mbahet në rrethet e Shkodrës, në Mirditë, në një pjesë të rrethit të Matit e të Elbasanit si edhe në rrethet e Durrësit, Tiranës e Krujës, ashtu si në Zadrimë e në Rranxat e Lezhës ku tirqit mbaheshin vetëm në stinën e dimrit.

2. — Në rrethin e Dibrës e në një pjesë të rrethit të Kukësit (sidomos në Lumë), tirqit mbaheshin të bardhë ose të zinj; nuk ishin aq të ngushtë sa ata të Shkodrës (sidomos në pjesën e prapme) dhe ishin të zbukuar më thjesht, sidomos te prehri. (fig. 105). E kishin shtratin më të shkurtër se të tjerët dhe kështu nuk arrinin deri në bel, por vetëm deri në kërdhoklat. Në pjesën e sipërme të trupit shoqëroheshin, përveç këmishës e jelekut, me «kaporanen»,

25) «I veshur si është me tirq të ngushtë pas këmbëve, të zbukuruara me gajtan — vinte në dukje M.E. Durham — dhe me xhurdinë e shkurtër të zezë, pamja e tij (e malsorit të Shkodrës) është jashtëzakonisht mesjetare. Brezi i tij është plot armë të veshura me argjend... Zbukurimet me gajtan ndryshojnë sipas fisit të cilit i përket». Shih M. E. Durham, *Through the land of the Serbs*, London, 1913, f. 80.



Fig. 105 — Burrë me tirq të bardhë nga Dibra (foto Managji)



Fig. 106 — Burrë me hërkë të bardhë (Kosovë) 1972

një xhaketë karakteristike prej shajaku përgjithësisht të zi, me mëngë të shkurtra përmbi bërryl, e pajisur me një jakë të madhe, e cila mund të formonte lehtë një kapuç për të mbrojtur kokën në kohë reshesh. Në dallim të theksuar nga xhurdia e grupit të parë, kaporania ishte e gjatë deri nën bel dhe nuk kishte zbukurime as me tufa, as me thekë, as me qëndisje në jakë. Me këtë kostum mbahej, zakonisht një qeleshe rrafshatake dhe opinga të thjeshta me lëkurë gjedhi; jeleku bëhej më shumë prej cohe të kuqe e zbukurohej me gajtan të zi. Si në prerje ashtu edhe në zbukurime, dallohej nga jelekët e zonave të tjera.

3. — Grupin e tretë e përbën varianti

26) A. Gjergji, *Materiale të ekspeditës etnografike në Kosovë*, shkurt 1972, A. E.

27) Shih përgjigjet e pyetësorit mbi Veshjet popullore për fshatrat Ukth, Iballë, e Fushë-Arrëz të rrethit të Pukës, viti 1973, 1974, që ndodhen në arkivin e Sektorit të Etnografisë, Tiranë.

28) F. Nopcsa, *Albanien f. 176* («Në Berishë, në Iballë, në Thaç e në Dardhë xhurdia mungon krejt»).

që mbahej në Kosovë, në rrethin e Tropojës e në rrethin e Pukës, ku tirqit, mbaheshin përgjithësisht të bardhë me gajtan të zi, por edhe të «galëm» (të zinj). Ata shoqëroheshin me xhamadanin prej shajaku të bardhë dhe me «gujen» ose «hërkën», që ishte pak më e shkurtër se kaporania, por disi më e gjatë se xhurdia. Kur bëhej prej shajaku të bardhë stolisur me gajtan të zi, si mbahej në Kosovë (fig. 106), ajo ia shtonte shumë bukurinë kostumit me tirq, por në shumë zona të tjera ajo mbahej krejt e zezë.²⁶

Rrethi i Pukës ishte zona ku, rreth vitit 1912, përdorehin krahas njëra-tjetrës si xhurdia me thekë e tufa, ashtu dhe «guja» e thjeshtë, shoqëruar me tirq të qepur në Gjakovë (Kosovë)²⁷. Një dëshmi më e vjetër na tregon se xhurdia nuk përdorej më parë në Pukë²⁸, pra duhet të mendojmë

se kjo është koha kur xhurdia, prej rretheve të Tiranës e Krujës, filloi të përhapet me shpejtësi drejt verilindjes.

Veshja me tirq në shekullin tonë ka ardhur duke u shtrirë vazhdimisht edhe në zona ku nuk mbahej më parë, sidomos mbas daljes nga përdorimi të kostumit me fustanellë e atij me këmishë të gjatë e dollamë. Por treva tradicionale e tirqve duket se ka qenë Shqipëria verilindore. Më e hershme duket se është përhapja e tyre tek malësorët e rretheve të Shkodrës (por jo përpara mesit të shekullit XIX), sepse, më 1840, A. Bué i përshkruan ata të veshur me dollamë shajaku të bardhë, po ashtu si edhe Mirditasit²⁹. Sidoqoftë burra të veshur me tirq, nga Malësia e Madhe, Shala, Shoshi, Postriba e Mirdita i shohim në shumë fotografi e vizatime të çerekut të fundit të shek. XIX³⁰.

Në Mirditë tirqit janë përhapur gjerësisht në fillim të shekullit tonë, së pari në Orosh e pastaj në zonat e tjera, kur zëvendësuan veshjen e mëparshme me këmishë të gjata e dollamë.³¹ Nga Dibra tirqit u përhapën në rrethin e Librazhdit e në një pjesë të rrethit të Pogradecit pas 1912-ës, kur doli nga përdorimi kostumi me fustanellë.

Kostumi me tirq ndeshet deri në rrethin e Beratit,³² ku tirqit bëheshin prej shajaku të bardhë ose të zi, zbukuruar me gajtan të zi anëve e tek prehri.

Sot përdorimi i këtij kostumi është kufizuar shumë sepse, që nga çlirimi e këtej, ai ka ardhur duke dalë gradualisht nga përdorimi, sidomos në moshat e reja dhe shihet vetëm rrallë ndër pleq.

Pra koha e shtrirjes maksimale të këtij kostumi në Shqipëri është periudha nga çereku i fundit i shekullit të kaluar deri në çlirimin e vendit, kohë në të cilën ai përbbente veshjen më të përhapur për burra në Shqipëri, veshje që kishte kapërcyer dasitë fetare (myslimane e të krishterë), por që pasqyronte mjaft qartë dallimet klasore të shoqërisë shqiptare të kohës, nga numri i gajtanëve të vënë nëpër zbukurim, nga cilësia e shajakut të përdorur si dhe nga stolitë që plotësonin veshjen.

Kostumi me tirq i përdorur tek ne dhe në të gjitha zonat me popullsi shqiptare në Jugosllavi, gjen ngjashmëri të mëdha me kostumin e burrave që përdorej në Rumani, (në Olteni e në Banat), ku zbukurohej, po ashtu si te ne, me gajtan të zi. Ky tip kostumi përdorej gjithashtu në disa zona të Bullgarisë, me prerje e zbukurime që ndryshonin disa nga ato të vendit tonë.

IV. — Veshja me brekushe.

Ky është ai tip veshjeje për burra ku pjesa që karakterizon kostumin janë «brekushet» apo «brakeshat», një lloj pantallonash të gjata deri te nyjet e këmbëve dhe disi të gjera, të prera njësoj si mbathjet e gjata të burrave. Ato mund të ishin prej liri ose pambuku, për stinën e verës, ose prej lesi të shkelur (të dërstilur) ose jo, përgjithësisht si veshje për dimër. Ngjisheshin për beli me anë të një ushkuri të gjatë, që kalonte nëpër të thyerën e pjesës së sipërme të tyre.

Në pjesën e sipërme të trupit burri ishte një këmishë me mëngë të gjata dhe mbi të jelekun e xhamadanin.

Në veshjet me brekushe të mbajtura në vendin tonë mund të dallojmë këto grupe:

1) Varianti me brekesha të përgatitura me një lloj stofi veror të leshtë por të hollë; ato ishin të bardha, për verë ose të leshta e përgjithësisht në ngjyrë kafe të mbyllur a të zezë, për dimër. Shoqëroreshin, në pjesën e sipërme të trupit, edhe me xhurdinë e zezë e cila thirrej «jakuçe» (fig. 107, 108). Kjo ishte e shkurtër deri në bel, e zbukuruar me shumë tufa e qendisje, sidomos te jaka e saj e madhe me thekë të gjatë deri në 20 cm., që i vareshin prapa. Në këtë veshje, ku zotëronin ngjyra e bardhë dhe e zezë, brezi i gjatë i leshtë me ngjyra të forta, ashtu si edhe çorapet, i jepnin një farë gjallërie pamjes së përgjithshme të kostumit, i cili plotësohej me opingat prej lëkure dhe me qelshen e bardhë të lartë, tipike për këtë veshje.

29) A. Boué, *La Turquie d'Europe*, vol. II, Paris, 1840, f. 223-224.

30) Fotografi të Marubit të viteve 1875-1890 në fototekën shtetërore të qytetit të Shkodrës (një burrë nga Shkreli R.A. 23/1, rreth vitit 1885; RA-40/7 burrë nga Pulti rreth vitit 1875 RA-40/5 burrë nga Shoshi, rreth vitit 1875; RA-23/10 burrë nga Shala rreth vitit 1890).

31) F. Nopcsa, *Albanien*, etj. f. 159, 160.

32) Objektet me nr. inv. 3324 dhe 77/115 në Fondet etnografike të I K P, Tiranë.



Fig. 107 — Burrë me brekushe të bardha (Shqipëria e Mesme).

Vendi tradicional i përdorimit të këtij varianti duket se ka qenë Shqipëria e Mesme, pra zonat përçark Shijakut, Kavajës, Peqinit, Tiranës, Krujës si dhe pjesa perëndimore e luginës së sipërme të Matit (Kryet e Matit, Përtej Uji, zona Gurrë-Batër etj.), prej ku u përhap më vonë në krahinat fqinjë. Nga pikëpamja klasore duhet vënë në dukje se veshja me brekesha mbahej nga masat e gjera të fshatit e të qytetit, kurse burrat e shtresave të pasura, si veshje për të dalë, mbanin kostumin me fustanellë.

Veshja me brekushe (sidomos të bardha) nuk përdoret më as nga pleqtë. Duke filluar nga vitet '30 të shekullit tonë, ajo u zëvendësua gradualisht me një lloj shallvaresh të gjera prej sateni të zi, me prerje orientale, të shoqëruara në pjesën e sipërme të trupit me xhaketa të zakonshme të kostumit qytetar, në vend të «jakuces».

Mbas çlirimit edhe këto lloj shallvaresh dolën nga përdorimi, sidomos mbas vitit 1957.

2) Varianti me brekushe prej pëlhere të bardha pambuku ose liri, që thirreshin «brakesha». Në veshjen për punë këmisha lëshohej përsipër. Në pjesën e sipërme të trupit, burri vishte jelek me xhamadan shajaku të bardhë me gajtan të zi dhe mbi të xhurdinë, kurse në kokë mbante qeleshe të bardhë në formë gjysmësferë. Kjo ishte më tepër një veshje e stinës së verës, e cila në shekullin tonë mbahej kryesisht në Bregun e Bunës, Bregun e Drinit, Anën e Malit, në Zadrime³³ e në Mirditë duke u shtrirë deri në Breg të Matit e Fushë-Krujë³⁴. Në këtë kohë brekushe si të zadrimerëve mbareshin edhe në zonën e Mbi shkodrës (Grudë, Kastrat, Hot e Shkrel) në Krajë, në Postribë si edhe nga kelmen-dasit që dimëronin në fusha³⁵ (fig. 109).



Fig. 108 — Burrë me brekushe shajaku të zi (Mat).

33) F. Nopcsa, *Albanien*, f. 163-164.

34) Shih përgjigjet e pyetësorit të veshjeve popullore për fshatin Dërven, Krujë 1975, AE.

35) F. Nopcsa, *Albanien*, etj. f. 168.



Fig. 109 — Burrë me brekushe (Zadrimë).

Në Zadrimë, Breg të Bunës e Breg të Drinit «brakeshat» e burrave të rinj, sidomos ato që visheshin me rastin e martesës, zbukuroheshin për fund këmbëve dhe për qark xhepave me qëndisje shumë të bukura, të cilat, edhe pse kishin motive të thjeshta dhe ishin të qeta nga ana kromatike (sepse përdorej për të qëndisur mbi pëlhurën e bardhë fije mëndafshi gjithashtu e bardhë dhe vetëm disa fije të kuqe), ishin shumë herë punë të një përsosmërie të rrallë, dëshmi e një shijeje të hollë artistike të banorëve të këtyre krahinave, ashtu siç provojnë qartë edhe shumë pjesë të veshjes së grave e shfaqje të tjera të artit popullor në këto zona.

«Brakeshat», megjithëse rrallë, ndeshen ende në përdorim në zonat e lartpërmendura, sidomos në veshjen e përditshme për punë, ndërsa xhurdia është zëvendësuar me xhaketa të zakonshme burrash.

3) Grupin e tretë e formojnë ato zona ku brekushet u përhapën kryesisht nga fillimi i shekullit tonë, duke zëvendësuar kostume të mëparshme që dolën nga përdorimi. Për këtë arsye ato shoqëroheshin shu-

më herë, në pjesën e sipërme të trupit, me pjesë të veshjes së mëparshme. Kështu në Myzeqenë e Lushnjës e të Beratit, në Dumrë e Sulovë ato visheshin me jelekë shajaku të bardhë ose të zinj e me xhamadanë me mëngë të hapura që vareshin prapa, gjithashtu prej shajaku të bardhë; kostumi plotësohej me takijen karakteristike të Myzeqesë. Në Martanesh mbaheshin të shoqëruara, përveç mintanit të leshtë, me një kaporane të zezë si të Dibrës e me qeleshe rrafshatake, kurse për djemtë e rinj me xhurdi të shkurtër pa thekë e tufa etj.

Brekeshat u patën rezistuar ndryshimeve që solli në veshje periudha mbas Luftës së Parë Botërore dhe u mbajtën kështu mjaft rëndom deri në çlirim. Në periudhën mbas Çlirimit erdhën duke u rralluar vazhdimisht dhe u zëvendësuan me pantollona të zakonshme qytetare të kohës.

Relatori shqiptar i shekullit XVII Marin Bici, i përmend «brakeshat» si veshje të kohës së tij për mirditorët. Ato përmenden gjithashtu si veshje të një shegerti, në një dokument të shekullit XIV³⁶. Të tjera dokumente, tregojnë se ato janë një element veshjeje paraturke, me origjinë të vjetër. Si dëshmon prerja e tyre, «brakeshat» nuk janë njëloj me shallvaret e modës turke, prandaj nuk duhen ngatërruar me to, edhe pse u patën thirrur ndonjëherë edhe këto të fundit «brekushe». Shallvaret orientale përfaqësoheshin tek ne me veshjen që mbanin burrat katolikë shkodranë deri në Shpalljen e Pavarësisë («brendavekët» shumë të gjera, në ngjyrë të zezë) me veshjen e disa përfaqësuesve të aristokracisë feudale të myslimanizuar jo vetëm tek ne, por edhe në vise të tjera të Ballkanit, veshje që bëhej prej cohe të kushtueshme të kuqe etj.

Duke qenë se prerja e «brekeshave» ishte identike me atë të të mbathurave tradicionale të burrave, ajo është e njohur në mbarë Shqipërinë.

V. — Veshja me poture.

Elementi përcaktues në këtë tip veshjeje për burra janë «poturet», një lloj pantallonash të gjata deri nën gju dhe mjaft të

36) Dokumenti i vitit 1350. Shih A. Gjergji, *Vështrim historik etj.* f. 95-96, shënim. 30.

gjera që, me sa duket, e kanë ndier mjaft ndikimin oriental në prerjen e tyre. Në dallim nga tirqit që ishin të ngushtë e pothuaj të puthitur mbas këmbëve, apo të brekusheve, poturet arrinin, jo poshtë të nyja e këmbës, por vetëm deri nën gju dhe kishin një shtrat të gjerë³⁷. Kjo veshje është mbajtur vetëm në Shqipërinë e Jugut e kryesisht në Labëri, Myzeqe, Mallakastër e Sarandë.

Veshjet me poture do t'i grupojmë në dy variante që shprehin më fort dallimet klasore midis bartësve të tyre sesa dallime midis zonash të ndryshme etnografike.

1) Burrat e shtresave me gjendje të pasur e mbanin këtë kostum me poture, jelek e mëngore prej cohe blu të errët, të importuar («cohë bullgare» — thonë në Konispol)³⁸ ose prej shajaku të një cilësie të lartë («shajak Samokovi» e cilësojnë në rrethin e Lushnjës)³⁹ dhe të zbukuruara anëve me gajtan të zi. Kalcet nga nyja deri mbi gju mbeteshin të bardha. Këto rroba i qepte zakonisht rrobaqepësi. Në këtë variant poturet ishin më të gjera se ato prej shajaku dhe ngjisheshin për mesin me anë të një ushkuri. Jeleku kryqëzohej përpara dhe mbërthehej pak mënjanë. (fig. 110). Kostumi plotësohej me një feste të zezë belluzi.

Veshje të tillë «të mirë» aspironin të bënin të gjithë djemtë e rinj me rastin e martesës, por natyrisht jo të gjithë arrinin ta bënin, sepse coha blu kushtonte shtrenjt. Poturet më të stolisura janë mbajtur në rrethin e Beratit (fig. 111).

2) Poture, jelek e mëngore prej shajaku të bardhë, të punuar nga vetë gratë e familjes mbaheshin, me sa dimë, vetëm në Labëri, nga fshatarët e shtresave të mesme e të varfra. Këto poture nuk ishin aq të gjera sa ato prej cohe dhe zbukuroheshin me gajtan të zi ose ngjyrë tulle. Kostumi plotësohej me tirqit e ngushtë nga nyja e këmbës deri mbi gju, (tirq gjunjarë) me qylafin e lartë të bardhë, me çorape leshi



Fig. 110 — Burrë me poture blu (Mallakastër).

dhe opinga të rënda, më fort për blegtorët. (Fig. 112).

Veshja me poture ka pasur një përhapje jo fort të kufizuar. Ajo është ruajtur në zonën juglindore të rrethit të Sarandës⁴⁰, në Pogon dhe në zonën e Kardhiqit të rrethit të Gjirokastrës,⁴¹ në pjesën më të madhe të rrethit të Tepelenës e atij të Vlorës, në rrethet Lushnje, Berat, Kolonjë, Korçë etj. përgjithësisht si një veshje që ka zëvendësuar kostumin me fustanellë (shih fig. 113). Sidoqoftë mendoj se poturet nuk kanë mundur të hyjnë në popullsinë fshatare të këtyre zonave më herët se mesi i shek. XIX, sepse shumë këngë popullore të epikës historike na tregojnë se kryengritësit fshatarë kundër reformave të Tanzimatit, Gjoleka e Rapo

37) Për këtë tip veshjeje shih edhe Ll. Mitrushi, *Veshje myzeqare të shek. XIX dhe të fillimit të shek. XX*. «Etnografia Shqiptare» VII, Tiranë, 1976, f. 144-145.

38) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore në Konispol (Sarandë) 1973 A.E. (veshje e burrave myslimanë mbas vitit 1900).

39) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore në Karavasta (Lushnje), 1973, A.E.

40) Shih përgjigjet e pyetësorit mbi veshjet popullore, për fshatrat Konispol, Pandelejmon e Leshnicë të rrethit të Sarandës, A.E.

41) Sipas përgjigjeve të pyetësorit mbi veshjet popullore për fshatrat Hllomo e Zhulat të rrethit të Gjirokastrës, A.E.



Fig. 111 — Burrë me poture Llu (Berat).



Fig. 112 — Burrë me poture të bardha (Labëri).

Hekali, mbanin jo poture, por «fustanen mbi gju hajduçe»⁴².

Në disa zona të Bregdetit⁴³, në zonën e Tërpanit (rrethi i Beratit), në Skrapar, në malësitë e rrethit të Kolonjës, në pjesën jugore të Myzeqesë, në fillim të shekullit tonë, në veshjen festive, poturet blu visheshin nën fustanellë. Ky është një kombinim që shfaqet vetëm në këto zona dhe të kujton kostumin e burrave të Sarandës.

Le të shënojmë se kishte disa vende si psh. Myzeqeja, Dumreja, Sulova etj., ku poturet njiheshin me emrin «çedikë» ose «çidikë»⁴⁴.

Veshja me poture mbahej edhe në vende të tjera të Evropës Juglindore, sidomos në Jugosllavi (Bosnjë), ku poturet ishin zakonisht ngjyrë blu të errët ose të zezë, të stolisura me gajtan të kuq, në Bullgari etj.

Si shihet nga materialet që parashtruan më lart, veshjet për burra paraqitin herë karakter të veçantë herë karakter të përbashkët, në raport me popujt e tjerë të Evropës Juglindore kurse, përsa i përket vjetërsisë së tyre, lidhen me kulturat e lashta të kësaj treve, me përjashtim të veshjes me poture, përdorimi i së cilës tek ne është, padyshim, shumë më i vonë se tipat e tjerë. (fig. 114).

* * *

42) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, vëll. III f. 21.

43) Shih përgjigjen pyetësorit mbi veshjet popullore për fshatin Borsh, A.E.

44) Shih Ll. Mitrushi, art. i cituar f. 144, si edhe Përgjigjet pyetësorit për veshjet popullore për fshatin Karavasta, rrethin e Lushnjës, për fshatin Tunjë në rrethin e Gramshit etj. A.E.




Fig. 113 — Hartë e përhapjes së tipeve të veshjeve për burra në fillim të shek. XX.



a



b



c



e



d

Fig.114 — Skica të tipeve të veshjeve për burra
a) veshje me fustanellë
b) veshje me dollame
c) veshje me tirq
e) veshje me poture
d) veshje me brekesha

Para se ta mbyllim përshkrimin e tipave të veshjeve për burra është mirë të japim këtu një përshkrim të shkurtër të veshjes «me qillota» (ose «me bollka») (fig. 115). Ajo përbëhej nga një këmishë kambriku, pantallona shajaku blu të thellë ose të zi, jelek e një pallto e shkurtër gjithashtu prej shajaku. E gjithë prerja e këtij kostumi ishte nën ndikimin e uniformës së ushtrisë frënge të Luftës së Parë Botërore. Stofi ngjyrë kaki ishte zëvendësuar me shajakun vendas dhe xhaketa ishte disi më e gjatë kështu që dukej më fort si një pallto e shkurtër. Si mbulesë koke



Fig. 115 — Veshje me qillota ose bollka.

burrat mbanin më të shumtit qylafë be-lluzi të zi, kurse në Fushën e Korçës e në Devoll filluan të përdornin kasketat me strehë. Opingat qenë zëvendësuar me një lloj këpucësh me gomë poshtë. Ky kostum, i cili ishte mjaft praktik, u përhap me shpejtësi e me lehtësi të madhe në rrethin e Korçës menjëherë mbas Luftës së Parë Botërore, kurse në rrethet e tjera të Shqipërisë së Jugut diçka më vonë. Në kohën tonë ai mbahet vetëm nga burrat e moshuar.

Shihet qartë se kjo veshje (ashtu si mba-

hej sidomos në Devoll e në fushën e Korçës) shënoi një shkëputje të plotë nga veshjet e mëparshme popullore, si në strukturë, ashtu edhe në prerje: këmisha, jeleku e pantallonat kanë prerje krejt tjetër nga ato të mëparshmet; brezi i gjerë prej leshi është zëvendësuar me një rrip të ngushtë lëkure për pantallonat; opingat u kanë lënë vendin këpucëve etj. E vetmja notë përshtatjeje është nërdorimi i shajakut vendas, që qepet tashmë në makinë e s'ka nevojë për gajtanë. Për këto arsye, nuk di gjer në ç'masë do të pranohet ta quajmë veshjen me qillota një tip të veçantë veshjeje popullore për burra, edhe pse nuk ka arsye të inorojmë përhapjen e tij si veshje e një periudhe të caktuar 30-40 vjeçare për zonat e përmendura më lart.

Duke iu referuar të gjitha veshjeve për burra konstatojmë se në popullin tonë kanë jetuar krahas njëra-tjetrës, për shekuj të tërë, veshjet në formë fundi të gjerë nga mesi e deri në gju (fustanella) dhe ato me këmishë të gjatë deri në gju, me veshjet në formë pantallonash (tirqit, brekeshat, poturret), por të parat patën dalë nga përdorimi më herët se të dytat.

Mjedisi gjeografik e klima duket se nuk kanë qenë faktorë vendimtarë për sa i përket përhapjes së tipave. Ndikimi i këtyre faktorëve ndihet më fort në veshjet e sipërme, të rënda për dimër, që ndryshonin nga zonat malore në ato fushore, dhe në faktin se, disa nga pjesët e kostumit, si psh., jelekët, xhamadanët, mintanët, bëheshin prej pëlhurash më të holla në verë, me ose pa mëngë, si e kemi vënë në dukje më hollësisht në të tjera raste. Megjithatë, si veshje për klimë të butë, në origjinën e tyre, mund të cilësohen veshja me fustanellë e ajo me «brakesha» liri e pambuku. Në lidhje me brekushet vëmë re se, ndërsa Shqipëria e Mesme i mbante ato si në verë (të bardha të holla) dhe në dimër (të trasha prej leshi, ngjyrë kafe ose të zezë), në fushat bregdetare përqark Lezhës mbaheshin «brakesha» liri e pambuku në verë, por në dimër ato shpesh zëvendësoheshin me tirq shajaku, sidomos për burrat e moshuar.

Për sa i përket anës artistike të veshjeve për burra bie në sy se, në dallim nga popujt e tjerë të trevës ballkanike, këmishët e burrave nuk zbukuroheshin me qëndisje veçse në Zadrinë dhe, me dantella, në Shkodër e Kosovë. Zbukurimi i pantallonave bëhej përgjithësisht me fije gajtani të zinj anës të qepurave dhe, me përjashtime të rralla, përqark xhepave, si ishin

p.sh. tirqit e Malësisë së Madhe dhe poret e Beratit. Le të përmendim edhe qëndisjet e mrekullueshme në brekeshat e Zadrimës. Brezat ishin herë të thjeshtë (me dy ngjyra), herë me vija ngjyrash të forta si në rastin e Tiranës. Pjesët më të stolisura të veshjes së burrave ishin jelekët dhe xhamadanët e kostumit festiv të çdo krahine, që i jepnin, sidomos në disa zona, shkëlqim të veçantë paraqitjes së tyre.

VESHJET PËR GRA

I. Veshja me xhubletë.

Pjesa më karakteristike këtu është pa-dyshim xhubleta, një fund që vjen i hapur në formë këmbane të valëzuar, sidomos në pjesën e prapme të tij. Ai bëhej prej rripash e copash shajaku, me një prerje shumë të ndërlikuar dhe donte mjeshtri të madhe në të qepur, që të mund të merrte gjerësinë dhe valëzimin e dëshiruar. Për të qëndruar më mirë në trup i viheshin dy rrypa shajaku që ta mbanin varur te supet, por mbahej edhe e lidhur për mes të një rrip.

Në pjesën e sipërme të trupit, për të mbuluar gjoksin, gruaja vinte «grykën» ose vishte një këmishë të shkurtër (si bluzë) pastaj një mintan me mëngë të gjata dhe mbi të xhokën (kraholin)⁴⁵ e shkurtër prej shajaku të zi, (dikur edhe të bardhë) e cila deri nga fundi i shek. XIX duket se ka qënë më e gjatë. Një përparje e madhe në formë trapezi, pak e valëzuar nga fundi, me një strukturë të ngjashme me atë të xhubletës, si dhe brezi e kërdhokla plotësonin veshjen, (fig. 116, Tab. VII a).

Xhubleta është një veshje me tradita mijëravjeçare. Ajo përfaqëson një tip shumë të lashtë veshjeje në brigjet e Mesdheut dhe ka arritur të mbijetojë në një zonë të kufizuar të Shqipërisë veriore, megjithëse dëshmi arkeologjike të përdorimit

të dikurshëm të saj ka në shumë zona të Mesdheut.

Duke mbajtur parasysh pjesët përbërëse të këtij kostumi mund të dallojmë dy variante kryesore të tij.



Fig. 116 — Veshje me xhubletë nga Gruda (Marubi).

1. Në grupin e parë pjesët kryesore të kostumit ishin xhubleta shumë e valëzuar, përparja e madhe në formë trapezi (pësh-tjellaku), brezi i gjerë prej lëkure mbuluar me plumbça sipër ose «kërdhokla prej shajaku e spiku» si një brez rreth 20 cm. i gjerë, i mbërthyer përpara me një kapse teli e, së fundi, xhamadani me mëngë të gjata⁴⁶, përgjithësisht i zi. Çorapet e shkurtër prej leshi ngjyrë vjollcë ose trëndafili qepeshin mbas kallmave. Këto bëheshin në formën e kallçijve (të kopsitur më një anë), prej shajaku të zi, me shumë zbukurime

45) Kjo pjesë veshjeje në shek. XVIII duket se quhej «ling», sipas dëshmisë së Windisch (shih Dh. S. Shuteriqi, *Tekste të shqiptarëve të Sllavonisë* «Buletin për shkencat shoqërore». Tiranë, 1955, nr. 2, f. 183.

46) Edhe në këtë variant mbahej nganjëherë një «prapanik», por ky vihej së brendshmi nën xhubletë. Shih përgj. pyetësorit të veshjeve për fshatin Selcë (Kelmend).

sipër. Mbi to mbatheshin shputat. Në kokë gratë e reja mbanin një kësulë të vogël kadifeje të zezë («kapticën»), të zbukuruar me pafta argjendi që paraqitnin simbole të kulteve të lashta të diellit e të hënës. Te kjo kapticë varej shamia e bardhë e kokës (ruba), që lëshohej lirshëm mbi supe. Nuset e reja këto shami i mbanin me ngjyra të forta e me lule. Shumë gra të moshuara dhe, përgjithësisht, gratë që ishin në zi, mbanin lidhur në ballë e prapa, një shami të zezë të palosur si një rrip 4-5 cm. të gjerë.

Ky variant i veshjes me xhubletë që thirrej edhe «**veshje malsore**» mbahej përgjithësisht në Malësinë e Madhe (në veri të Shkodrës), duke përfshirë edhe malësorët e shpërngulur nga këto zona e të vendosur në fushën e Ulqinit, në Breg të Bunës (Velipojë), në Breg të Matit deri në Gurrëz e Milot. Ai mbahej gjithashtu në disa zona shqiptare përtej kufijve të sotëm shtetërorë të RPS të Shqipërisë si në Triepsh e në Hot të Malit të Zi etj.

Ky është varianti i veshjes me xhubletë që ka pësuar një zhvillim të ndjeshëm këto 50-60 vjetët e fundit, (që nga Shpallja e Pavarësisë e këtej), sidomos në disa pjesë të tij si janë përparja e xhamadani. Këto ndryshime bien në sy qoftë edhe me një shqyrtim të thjeshtë të fotografive të fillimit të shekullit me ato të kohës sonë. Ndryshimet vihen re, në mënyrë të theksuar, tek malësorët e zbritur në fushë. Kështu, kadifeja e zezë, që prej kohësh përdorej për t'i vënë xhubletës disa rripa të hollë mbi rrogzinat prej shajaku, filloi të përdorej edhe për të bërë përparjet⁴⁷, me një formë që i afrohej deri diku asaj tradicionales. Prej kadifeje të zezë bëheshin edhe mëngët ose xhamadanët me mëngë të gjata për nuse, grykset etj. Me kohë këto pjesë të kostumit sidomos për kostumin e martesës, filluan të bëhen edhe me copa të tjera mëndafshi (atllazi) e stofi të importuar, kryesisht ngjyrë blu ose vishnje në kafe⁴⁸. Sidoqoftë elementi që ka rezistuar më shumë mbetet xhubleta, e cila edhe në ditët tona konsiderohet e domosdoshme në kostumin ceremonial të martesës, edhe pse nuk mbahet në veshjen e përditshme. Praktika që vihet re në shumë raste, tek malësorët e zbritur në fusha, për të vënë në ditën e martesës, përveç përparjes së

kostumit të tyre, një përparje të dytë prej pëlhere të pambuktë të kuqe me katrore të bardha (bohçe Shkodre), e cënon shumë bukurinë e kostumit, megjithëse në shijen e malësorëve ngjyra e kuqe mbetet kurdoherë e pëlqyer, veçanërisht për nusët.

Gratë e moshës së mesme në kostumin e tyre të përditshëm, që në vitet '30, kanë filluar ta zëvendësojnë xhubletën tradicionale me një fund stofi ose bezeje të zezë, me pala të gjera ose me rrudha.

2) Në variantin e dytë të këtij tipi, pjesët përbërëse ishin: xhubleta, (më e ngushtë dhe më pak e valëzuar se ajo e Malësisë së Madhe e përgjithësisht pa rrogzinë të bardhë për fundi), grykëza, «*kraholi*» (një



Fig. 117 — Veshje me xhubletë (Pukë)

xhaketë e shkurtër shajaku të zi pa pala prapa, por me thekë të gjata leshi te supet), një brez lëkure i gjerë 8 cm., (i zbukuruar me pafta dhe unaza treshe prej bronzi ku vareshin stolitë e brezit), dy futa në formë trapezi, njëra më e madhe, *paraniku*, rreth 60 cm. i gjatë me thekë leshi ngjyrë vjollcë

47) Fondet etnografike, objektet me nr. inventari 6580, 7896, etj.

48) F.E. Objektet nr. inventari 7888, 3300, 70/391 etj.

përfundi si ato që kishte kraholi te supet) e tjetra, *prapaniku*, (rreth 30 cm. i gjatë) që vihej prapa. Në këmbë gruaja mbathte çorape leshi të zeza dhe nuk përdorte kallma si në Malësinë e Madhe. Në kokë mban-te shami të lidhur nën gushë.

Ky variant i kostumit me xhubletë (fig. 117) që thirret edhe «*veshje pultake*» ka ruajtur disa tipare arkaike, si në pjesët që e përbëjnë, ashtu edhe në dekorimin e tyre. Ai mbahej kryesisht në zonën e Shllakut⁴⁹ e të Temalit, (në verilindje të Shkodrës) në një pjesë të rrethit të Pukës e shtrihej drejt verilindjes deri në Nikaj-Mërtur të rrethit të Tropojës. Krahas xhubletës në këto vende, sidomos në stinën e ngrohtë, mbahej veshja me këmishë të gjatë e të ngushtë pëlhere të leshtë (që quhej «*gjupetë*»), mbi të cilën ngjisheshin «*paraniku*» e «*prapaniku*», por për të do të flitet tek grupi i veshjeve me dy futa.

Në Shalë e në Shosh xhubleta herë shoqërohej me futën e vogël prapa (prapaniku), herë jo. Kjo ndodhte me sa duket për shkak të marrëdhënieve ekonomike dhe shoqërore që kishte kjo zonë si me Malësinë e Madhe (që nuk e përdorte prapanikun), ashtu edhe me Nikaj-Mërturin.

Pra, si e pamë, në disa zona xhubleta plotësohej shpesh me një «*prapanik*». Si duhet shpjeguar kjo dukuri? Duke pasur parasysh përshtatjet e shekullit XVIII për veshjen e grave kelmendase dhe gravurat ekzistuese për këtë kostum, të cilat na tregojnë qartë se, në stinën e ngrohtë, ato mbanin jo xhubletën, por një këmishë të gjatë e të ngushtë, të leshtë, të shoqëruar me dy futa (paranikun e prapanikun), mendoj se përdorimi i «*prapanikut*» edhe me xhubletën (në dimër), është një dukuri sekondare, që ka lidhje me ndikimin e veshjes verore mbi atë dimëroren dhe që u shfaq në ato zona ku kostumi vazhdoi të jetojë deri në ditët tona. Ajo nuk u ruajt ose kaloi nën xhubletë në ato zona ku tipi i kostumit veror me dy futa doli plotësisht nga përdorimi (si p.sh., në Malësinë e Madhe).

Në lidhje me këtë tip interesant veshjeje për gra do të vëmë në dukje se në shekullin tonë forma më e thjeshtë ishte ajo që mbanin vajzat e reja, ku mbizotëronin

rripat e bardhë, ndërsa xhubletat e grave shumëherë ishin krejt të zeza ose kishin vetëm një rrip të bardhë përfundi. Vajzat gjithashtu nuk mbanin as kërdhokël as krahol, as kallma e as stoli metalike, si gratë. Në të kaluarën xhubletat e vajzave bëheshin edhe me rripa të kuq ose në ngjyrë tulle, në vend të të zinjve.⁵⁰ Xhubletat e vajzave duket se punoheshin jo vetëm me rrogzina shajaku, por edhe me fije të bardhë leshi të thurur me grep. Një xhubletë e tillë me prejardhje nga Malësia e Madhe,⁵¹ ruhet në fondet e Sektorit të Etnografisë. Kjo nuk duhet të jetë një përjashtim, sepse, vëmë re se me grep dhe me fije leshi të zi ishte punuar shumë herë jo vetëm gjoksi, por edhe ajo pjesë e xhubletës që mbulohej nga përparja.⁵²

Kostumi me xhubletë ka jo vetëm një pamje të veçantë dhe shumë origjinale në anën e jashtme të tij, por edhe një prerje shumë të veçantë, që mund ta quajmë të jashtëzakonshme. Pjesët kryesore të tij si xhubleta, përparja, kraholi, kërdhokla, përbëhen nga një numër impresionant copash e rripash shajaku që nuk gjejnë ngjasim në asnjë tip tjetër veshjeje popullore për gra. Përkundrazi, në veshjet e tjera prerjet janë shumë të matura e të kursyera. Le të përmendim p.sh. se xhubletat përbëhen nga 13-17 rrogzina apo iva (rripa), dhe 5 copa shajaku, përparjet nga 7 rrogzina dhe 6 copa të tjera, kraholi nga 30 copë dhe kërdhokla nga 7 copë. Kuptohet se të prisje e të qepje një kostum të përbërë prej kaq shumë copash, nuk ishte e lehtë.

Edhe zbukurimi i këtij kostumi ishte një punë po aq e ndërlikuar sa edhe prerja e qepja. Përdorimi i një sasive të konsiderueshme spiku të zi, i cili vendosej në 5-6 rreshta të ngjeshura, kudo që kishte një të qepur, kërkonte shumë durim e shkathësi. Motivet e zbukurimit, vendoseshin horizontalisht në disa hapësira të ngushta (rreth 4 cm.), në pjesën e prapme të xhubletës, në pjesën e poshtme të përparjes, në kërdhokël etj. E vetmja copë tekstili me dekoracion që përdorej në këtë kostum, vendosej në pjesën qendrore të përparjes. Ajo ishte e punuar me dy lisa, indi shumë i hollë, fusha e zezë ose ngjyrë tulle dhe disa motive të thjeshta të ekzekutuara për-

49) Objekti nr. inv. 8460 në Fondet Etnografike.

50) Bruhn-Tilke, *Das Kostümwerk*, Berlin 1941, f. 160, fig. 10.

51) F.E. nr. inventari 7383.

52) F.E. Objektet me nr. 7885, 9237 etj.

gjithësisht me fije ari e argjendi ose me ngjyrë manushaqe, të kuqe, vishnje e portokall. Përparjes mund t'i aplikoheshin edhe rripa të ngushtë cohe të kuqe, vishnje ose çiklamin, në pjesën e poshtme të saj. (E zbukuruar në të njëjtin stil ishte edhe torba e vogël me rrip të gjatë që mbante përgjithësisht çdo grua kur ishte jashtë shtëpie). Xhubleta me të tilla zbukurime quhej «xhubletë e kuqe» dhe mbahej vetëm nga gratë e martuara sa ishin ende në moshë të re, në dallim nga «xhubleta e bardhë» që mbanin vajzat dhe «xhubleta e zezë» që mbanin gratë e moshuara. Motivet e qëndisura në pjesë të ndryshme të këtij kostumi përbëjnë një repertor më vete, që shumë pak afrohet me atë të krahinave të tjera. Ato paraqesin forma arkaike, të skematizuara, por me shumë interes për gjurmuesit e artit popullor.

Në shekujt e mëparshëm, si na tregojnë disa burime të shkruara të cilave u jemi referuar gjerësisht në pjesën e parë të këtij studimi, si edhe një varg fotografish shumë të vlefshme të çerekut të fundit të shekullit XIX të bëra nga Marubi në Shkodër⁵³, kostumi me xhubletë ka pasur zbukurime të shumta, veçanërisht në përparjet, xhokat, kërdhoklat, shamitë e kokës, zbukurimet metalike të gjoksit etj. Në shekullin tonë, kjo veshje erdhi duke i pakësuar e thjeshtuar shumë ngjyrat e zbukurimet. Ngjyrat që mbizotëronin në kostumin me xhubletë të shek. XIX kanë qenë, përveç së bardhës, ngjyra e tjegullës dhe ajo çiklamin, me nuanca herë të thella deri në vjollcë, herë më të çelura.⁵⁴ (shih fig. 118). Nga këto xhubleta ka mbetur vetëm kujtimi në shprehjen «xhubletë e kuqe». Kështu xhubletat që mbaheshin mbas Luftës së Parë Botërore, qenë pothuaj krejt të zeza, me ndonjë rrip të bardhë e zbukurime rruezash me ngjyra të errëta. Gratë malsore binin në sy jo vetëm për trupat e tyre imponantë, me atë siluetë interesante që u jepte valëvitja e xhubletës kur ecnin, por edhe me madhështinë që u jepte ngjyra e zezë që mbizotëronte në veshjen e tyre.

Përdorimi i kostumit me xhubletë në ditët tona është rralluar. Ai ka mbetur vetëm si një veshje ceremoniale për di-

tën e martesës ose për ditë festash të mëdha, ku ngjyra e zezë mbizotëron ende.

Kostumi shqiptar me xhubletë, nga sa kanë treguar gjurmimet e deritanishme në këtë fushë, është një tip i veçantë dhe shumë interesant veshjeje për gra, që nuk gjen analogji me ndonjë veshje tjetër të kohës së re në vendet e Evropës Juglindore. Megjithatë disa analogji të pjesshme, si p.sh. në përparjet, ekzistojnë në popujt fqinjë, por për to do të flasim më gjerë në kreun që pason.

Mosha e lashtë e këtij kostumi dëshmohet nga gjetje të ndryshme arkeologjike në Kretë, Mikenë e Vrhac-Zhutobrdë (Jugosllavi) e në vende të tjera të Mesdheut, sikurse është vënë në dukje edhe nga studiues të mëparshëm.



Fig. 118 — Veshje me xhubletë

53) Fototeka shtetërore, pranë Komitetit Ekzekutiv të KP Shkodër. Fotot me nr. negativ RA-31/1, RA-37/2, etj.

54) Shih figurën e një malësoreje me xhubletë në: Bruhn-Tilke, *Das Kostümwerk*, Berlin, 1941, f. 160 fig. 7.

II. — Veshjet me këmishë të gjatë e një përparje.

Ky është tipi më i përhapur i veshjeve për gra në vendin tonë. Pjesët kryesore përbërëse janë: këmisha e gjatë, përparja, xhoka dhe brezi. Gjatë stinës së dimrit në zonat me klimë më të ftohtë, gruaja shtonte dhe ndonjë veshje të sipërme më të rëndë. Ky tip ka dhënë variante të shumta në zona të ndryshme të vendit. Me kohë disa nga këto janë zhvilluar më tej duke iu larguar mjaft tipit bazë, dhe më të evoluarat i gjejmë përgjithësisht në Jug.

Në shqyrtimin e varianteve të këtij tipi, do të merret parasysh, krahas këmishës dhe përparjes, edhe xhoka (gjatësia, gjerësia, profili dhe zbukurimet e saj) për arsye se ajo mbulon jo vetëm shpinën, por edhe një pjesë të trupit nga beli e poshtë, sidomos prapa, pra u përmbahet kritereve që kemi caktuar në klasifikimin tonë.

Variantet e shumta të këtij tipi do të mundohemi t'i paraqitim më poshtë të ndara në grupe, sipas shkallës së afrisë që paraqesin në strukturën e tyre. Ndryshimet nga një grup në tjetrin shfaqen më tepër tek gjatësia dhe gjerësia e këmishëve dhe e xhokave, por edhe në pjesë të tjera përbërëse të kostumit.

1. — Në grupin e parë do të përfshijmë disa variante ku këmisha arrinte përgjithësisht deri në gju, me luhatje të vogla mbi ose nën të. Për këtë arsye dukeshin mirë çorapet me qafa të gjata deri te gjuri, dhe nganjëherë kur këmisha ishte përmbi gju, dukeshin pak edhe të mbathurat të cilat mbulonin gjunjët e futeshin në qafat e çorapeve. Përmasat dhe zbukurimet e përparjeve paraqisnin gjithashtu veçori lokale. Xhoka ishte disi e shkurtër (rreth 60-70 cm.), përgjithësisht e bardhë, sidomos ajo e veshjes festive, por edhe e zezë për veshjen e përditshme. Ajo kishte dy-tre kinda të ngushtë anëve si dhe zbukurime të veçanta për çdo variant. Përdorshin gjithashtu, sipas stinës e rastit, jelekë e mintanë të ndryshëm, me ose pa mëngë, prej shajaku, allaxhaje a pëlhurash të tjera.

Në një variant të këtij grupi, jo vetëm xhoka ishte thjeshtë e bardhë e pa zbukurime⁵⁵, por edhe përparja ishte gjithashtu e thjeshtë, njëngjyrëshe (e bardhë për nuset, e zezë për vajzat e për plakat). Ai mbahet në një grup fshatrash ish myslimanë që qarkojnë fushën e Domosdovës (si Radokal, Urakë, Rajcë, Prrenjas etj.), por edhe në Lin pranë Pogradecit. Nga fillimi i shekullit tonë ai pësoi disa ndikime orientale, sidomos në mënyrën e lidhjes së kokës dhe në stolitë.⁵⁶ (fig. 119).



Fig. 119 — Grua nga Rajca

Një variant më vete mund të konsiderohet ai me këmishë të gjatë pëlhure liri ose pambuku (të qendisur jo vetëm tek mëngët, por edhe përfundi), xhokë me veshëza tek supet e me gajtan ngjyrë vish-

55) Në variantin e vjetër të veshjes së grave të kësaj zone, sipas pohimit të një informuesje të dtl. 1880, nga katundi Urakë, qesikja nuk bënte pjesë.

56) Për një përshkrim të hollësishëm të saj: A. Gjergji *Dy variante të veshjes së grave në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit*, «Etnografia Shqiptare» IV, Tiranë, 1972, f. 145-149.

nje anëve, me përparje të ngushta leshi shumë të dekoruara me motive gjeometrike, dhe mbulesë koke prej pëlhere shtëpiake, të zbukuruar me motive karakteristike. Ky variant mbahej si në Shpatin e Sipërm, ashtu edhe në Shpatin e Ulët. (fig. 120). Me kohë në veshjen e Shpatit të Ulët është ndier edhe ndikim i Dumresë, sidomos me zëvendësimin e përparjeve të leshita me ato të pambuktat, që kanë përmasa më të mëdha.



Fig. 120 — Grua nga Shpati

Pamje tjetër merrte varianti që mbahej në Çermenikë, dikur edhe në Martanesh, ku përmbi këmishën që mezi arrinte deri në gju, përparja e vogël katrore bardhë e zi, zbukuruar me tufa përfundi, lëshohej lirshëm tek prehri, kurse xhoka, për kostumin festiv bëhej e bardhë, ndërsa në veshjen për punë mbahej e zezë; në këtë mënyrë ky variant afrohej me atë që mbahej në disa zona në verilindje të Martaneshit, si p.sh. me veshjen e Zerqanit, por këtu përparja ishte pak më e madhe dhe me vija bardhë e zi. Edhe xhoka ishte pak më e gjatë. Në këtë grup meriton të për-

mendet edhe një variant tek i cili, mbi këmishën e gjatë deri nën gju, binin në sy përparja dhe xhoka, për zbukurimet e veçanta të tyre dhe një mënyrë e posaçme e lidhjes së kokës. Është fjala për veshjen e zonës së Zogajt në rrethin e Dibrës.

Së fundi, me këtë grup lidhet edhe varianti i veshjes së grave të zonës së Shëngjergjit, në rrethin e Tiranës, i cili dallohet vetëm në llojin e zbukurimeve të përparjes e të xhokës.

2. — Grupi i dytë i veshjeve me një përparje karakterizohej nga ajë këmishë më e gjatë sa ajo e grupit të parë, e shoqëruar me xhokë gjithmonë prej shajaku të bardhë, aq të gjatë sa linte të dukej vetëm pak këmisha (rreth 10 cm.) dhe këtu qëndronte ndryshimi kryesor me grupin e mëparshëm. Të mbathurat ishin të gjata e çorapet të shkurtra. Përparjet e mbulesat e kokës ndryshonin nga një variant në tjetrin, si nga madhësia, ashtu edhe nga zbukurimet.

Karakteristikë tjetër është se në të gjitha variantet e këtij grupi, në kohë të ftohtë dimri gratë vishnin sipër xhurdinë e shkurtër ngjyrë të zezë, me jakë katrore prapa dhe mëngë të shkurtra, që zbukurrohej me thekë të gjatë e tufa.

Varianti më i njohur i këtij grupi është ai në të cilin përmbi këmishën (dikur prej pëlhere të leshtë) vihej një përparje e vogël me thekë të gjatë (straveca), përdorimi i së cilës ishte mjaft i kufizuar në vendin tonë; ajo është një nga format më të lashta të përparjeve, ashtu si edhe brezi me tufa të varura prapa, që e shoqëron. Ky variant mbahej në gjithë Mirditën dhe në Kurbin (fshatrat katolike). (fig. 121).

Një variant tjetër është ai ku përmbi këmishën vihej një përparje e pambuktë me përmasa mesatare dhe vishej një xhokë me prerje të afërt, por me zbukurime të ndryshme, sipas zonave, p.sh. në krahinën e vogël të Prrellit (rrethi i Matit) apo në fshatrat myslimane të Kurbinut, në fshatrat e Bendës (rr. i Krujës e i Tiranës), të Luznisë e të Kacnisë (në rrethin e Dibrës) etj.

3. — Në një grup tjetër të veshjeve me një përparje mund të bashkojmë variantet që mbaheshin në zonat e ulëta bregdetare. Përparjet këtu ishin me përmasa të mëdha e shumë të dekoruara, po ashtu edhe mbulesat e kokës, që vareshin prapa pa u lidhur.

Veshjet e këtij grupi ishin më të lehta, sepse në një pjesë të madhe të vitit

gruaja mbante vetëm këmishë e jelek dhe vetëm në ditë të ftohta të dimrit, vishte xhokën e leshtë. Ato duhen karakterizuar si veshje zonash me klimë të butë.



Fig. 121 — Grua nga Mirdita

Varianti kryesor është ai me këmishë të gjatë dhe mund të pohojmë se këto ishin ndër këmishët më të mëdha që njihen në vendin tonë (130-140 cm. gjatësie dhe rreth 30 kinda anësore në formë trapezi). Edhe mëngët e tyre ishin të gjera e shumë të zbukuruar, me një fushë ornamentesh që fillonte nga supi e zbriste poshtë deri tek dora. Meqë nuk kishin zbukurime tek gjoksi, mbi këmishë mbahej një «grykë» e vogël prej së njëjtës pëlhurë, shumë të zbukuruar me qëndisje të imta dhe karakteristike vetëm për këtë kostum. Ky variant që thirrej në popull edhe «*veshje arbnore*» mbahej në një pjesë të mirë të Fushës së Krujës, dhe me disa ndryshime tek zbu-

rimet edhe në fshatrat e Fushës së Tiranës deri në vitet '20 të shekullit tonë.

Shumë e afërt me këtë të fundit ishte veshja e stinës së ngrohtë e grave të zonës kodrinore të rrethit të Tiranës, ku këmisha ishte pak më e shkurtër dhe linte të dukeshin të mbathurat e gjata; kjo këmishë kishte më pak kinda anëve dhe që e zbukuruar me qenarë të hollë ngjyrat e të cilëve ndryshonin në funksion të moshës së bartëses. Ky variant gjithashtu ka dalë nga përdorimi në periudhën midis dy luftërave botërore.

Në një variant tjetër këmisha e gjatë e pambuktë, bëhej me një pëlhurë vegje, jo të bardhë, por me vija e motive të thjeshta të kuqe e të zeza etj. dhe paraqiste disa tipare të veçanta edhe në prerje.⁵⁷ Përparjet e pambukta që mbaheshin në këtë variant ishin më të mëdhatë që janë mbajtur në vendin tonë. Rrallë, në stinën



Fig. 122 — Grua nga Dumreja

57) Këmishët e grave të kësaj zone shiheshin edhe të ndara dy pjesësh, sidomos mbas 1912-ës, pra një këmishë e shkurtër si bluzë që quhej «*mëngët*» dhe fundi i gjerë që thirrej «*linjë*».

e ftohtë, gratë vishnin një xhokë të shkurtër shajaku të bardhë, me prerje si të Shpatit. Kjo është veshja që mbanin gratë ish myslimane të Myzeqesë e të Dumresë, të Sulovës etj. (fig. 122).

4 — Ekzistojnë edhe disa variante veshjesh të tipit me këmishë të gjatë e një përparje, të cilat është vështirë të grupohen së bashku, sepse elementet përcaktuese kanë prerje e zbukurime të veçanta. Të tilla janë veshja e Kallmetit me «gunëzë»⁵⁸, (fig. 123), ajo e Zadrimës, Bregut të Bunës etj. me «koret»⁵⁹, të dyja veshje të nusërisë në këto zona, ndërsa veshjet e përditshme i përkasin një tjetër tipi, atij me mbështjellëse, si do ta shohim më poshtë. Po



Fig. 123 — Grua nga Kallmeti

kështu më vete qëndron edhe veshja e Krajes, krahinë shqiptare në Mal të Zi.

Me rëndësi për ruajtjen e pastërtisë së strukturës dhe për disa karakteristika të xhokave të ndryshme të saj, është edhe veshja që mbanin deri në vitet '50 gratë ortodokse të Mokrës së Sipërme (rr. Pogradec).⁶⁰

5. — Në disa zona të rretheve Gjirokastrë e Sarandë veshja me një përparje, përveç këmishës së gjatë, përbëhej edhe nga një lloj dollomaje me mëngë të shkurtër përmbi bërryl, mbi të cilën vishej xhoka e leshtë dhe pa mëngë. Veshja plotësohej me brezin, përparjen dhe mbulesën e kokës.

Në këtë variant si këmisha, ashtu edhe dollomaja bëheshin me pëlhurë të bardhë prej pambuku ose liri, të punuar në shtëpi. Xhoka prej shajaku të bardhë zbukurohej me gajtan të zi e të kuq anëve dhe në shpinë.

Kjo lloj veshjeje është mbajtur deri në prag të Luftës së Parë Botërore në Dropull dhe në një grup fshatrash në pjesën lindore të rrethit të Sarandës (Leshnicë e Sipërme dhe e Poshtme, Melçan, Çërkovicë, Dhivrë, e Shëndre)⁶¹ dhe quhej «Veshje e bardhë».

Kurse në një variant tjetër mbi këmishën e bardhë gruaja vishte dollomanë ose «cipunin» me mëngë të shkurtër dhe mbi të xhokën pa mëngë. Këto bëheshin që të dyja prej shajaku ngjyrë blu të errët ose të zezë dhe zbukuroheshin anëve me gajtan ngjyrë vjollcë të çelët. Kostumi plotësohej me shaminë e zezë në kokë, brezin e leshtë blu ose të zi dhe përparjen e leshtë pothuaj katrore me vija të bardha e vjollcë të çelur. Ky kostum mbahej në një pjesë të Vurgut.

Si shihet përhapja e tipit të veshjes me një përparje mbulonte një territor të gjerë të vendit tonë, nga veriu në jug (shpeshherë krahas përdorimit të tipave të tjerë, si p.sh. në Zadrimë etj.) dhe pati dhënë variante të shumta lokale, në varësi me kushtet e zhvillimit ekonomik e shoqëror të zonave përkatëse, me kontaktet e tyre ndër-

58) Rr. Zojzi, *Veshje popullore të rrethit të Lezhës*, në «Buletin i Universitetit Shtetëror», Tiranë, 1958 nr. 3, f. 231.

59) Sipas dëshmisë së F. Nopcsës, në Zadrimë «koret» në fillim të shekullit tonë quhej «xhokë» («Albanien» f. 164).

60) Shih shënimin 56.

61) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore për fshatin Leshnicë e Sipërme, A.E.

krahinore, me rrezatimin ku më të fortë e ku më të dobët të ndikimit qytetar që, edhe në pikëpamje kronologjike, qe diku më i hershëm, diku më i vonë. Ai është gjithashtu tipi që përshkoi shkallë të shumta evoluimi derisa u përzie pak nga pak me veshjen e masave të gjera qytetare, disa nga këto shkallë evolucioni po i përshkruajmë më poshtë.

6 — Shumë veshje të grave në zonat e Jugut, nën ndikimin e modës qytetare, patën kaluar nëpër një varg transformimesh në pjesët përbërëse, duke u shkëputur gjithnjë më shumë nga baza e tipit të veshjes popullore me këmishë të gjatë e përparje, për t'u integruar gradualisht në veshjet qytetare të kohës. Pa dyshim kjo ngjau kryesisht në zona me një zhvillim shoqëror të përparuar ku, përgatitja e pjesëve të ndryshme të veshjes, sidomos e veshjeve të martesës, kishte dalë pothuaj krejt jashtë kuadrit të prodhimit shtëpiak.

a) Në një grup veshjesh të rretheve Sarandë (zona kodrinore në lindje të këtij rrethi, Gjirokastër (zona e Lunxhërisë e një pjesë e Pogonit) dhe Korçë, me popullsi ish ortodokse, ku më herët e ku më vonë, ishte kryer një shndërrim i mëtejshëm i tipit të veshjes së grave me një përparje, me futjen në përdorim të një elementi tjetër me prejardhje të qartë qytetare, në formën e një dollomaje që vitesh mbi këmishë dhe e mbulonte krejtësisht atë, duke e kthyer kështu përfundimisht këmishën në veshje të brendshme, në ndërresë. Ky ndryshim kishte rëndësi të madhe, sepse tregonte një hap të madh përpara në evolucionin e veshjes, që e bënte atë shumë më higjienike. Këmisha, duke u zhveshur nga funksioni i saj si veshje e sipërme, do të fitonte me kohë disa tipare të reja si ndërresë e brendshme. Me këtë mënyrë, në këtë grup veshjesh, kryhet edhe një ndryshim në pamjen e jashtme të kostumit, nga i cili zhduket ngjyra e bardhë. Gratë që mbanin këto veshje për shkak të ngjyrave të errëta të sfondit, kishin një pamje disi të trishtuar e hijerëndë, me gjithë zbukurimet e shumta me gajtanë të veshjeve të tyre të sipërme.

Elementi i ri që hyri në përdorim, dollomaja e gjatë, quhej në disa zona «*allan-xha*». Ajo kishte mëngë të gjata që mbaronin, me thepa në formë trapezi, në shpinën

e dorës. Nën të vishej këmisha e bardhë e gjatë, kurse sipër saj «*cipuni*» më mëngë, apo edhe që të dyja së bashku. Dy pjesët e fundit bëheshin prej shajaku ose cohe blu të errët a të zeze dhe zbukuroheshin, ashtu si edhe allanxhaja, me gajtan ngjyrë vishnje ose vjollcë të çelët. Në këtë variant përparja e leshtë katrore, e mëparshme, ishte zëvendësuar tashmë me një përparje në formë trapezi, që bëhej me kadife ngjyrë vishnje ose vjollcë.

Ky kostum mbahej në zonën kodrinore të rrethit të Sarandës dhe, me disa ndryshime të parëndësishme, në zonat që përfshijnë fshatrat që vijnë: a) Kakodhiq, Lefterohor, Kardhikaq, Pecë, Kostar e Muzinë etj.; b) Livadhja, Sopik, Hoxhë, Llazat, Vagalat, Lefter Talo etj.; c) Leshnicë e Sipërme dhe Leshnicë e Poshtme, Partizani, Melçan, Çerkovicë, Dhivrë, Shëndre etj., ku kishte zëvendësuar «veshjen e bardhë», për të cilën folëm më sipër.

Të tjera variante, me luksoze, u përfutuan në ato zona ku dollomaja e gjatë bëhej prej pëlhure shami e mbi të vishej «*fermeleja*» a «*karamantoja*», pjesë të sipërme veshjeje këto, të përgatitura, me material të importuar, që pasqyronin gjendjen më të ngritur ekonomike dhe një ndikim më të fortë të modës qytetare. Kjo veshje u përhap më fort pas 1912-ës në Lunxhëri dhe Pogon dhe u transformua më tej në dhjetëvjeçarët pasues, me futjen në përdorim të «*cohës*» dhe të «*kadifesë*» veshje luksoze këto, të zbukuruara me qëndisje, me gajtan mëndafshi e shirita ari, por që ruanin në prerjen e tyre, po ashtu si dhe fermeleja e dollomaja, ngjashmëri të mëdha me elemente veshjeje qytetare të shekujve XVIII-XIX, që kishin pasur përhapje të gjerë në Ballkan. Mëngët e tyre të gjata përtej dorës, mbaronin në formën e një lape të gjerë të rrumbullakosur, që të kujton veshjet e fisnikëve mesjetarë.

Formën më origjinale të veshjeve, me strukturën që përshkruan më lart mendoj se mund ta shohim tek veshja e vjetër e grave të qytetit të Korçës, një ekzemplar i rrallë i së cilës, që i përket ndoshta gjysmës së parë të shek. XIX, ruhet në Muzeun Lokal të këtij qyteti.⁶² Kjo veshje pati dalë pothuaj krejt nga përdorimi që në çerekun e fundit të shek. XIX. Tek ky kostum martesë, dollomaja e gjatë e quajtur cibun, që

62) Objektet me numra inventari 4/1, 4/2, 4/3.

vishej mbi këmishën prej pëlhure, është bërë prej cohe të kuqe të importuar dhe, për shtresat me gjendje ekonomike më modeste, ndoshta bëhej edhe prej shajaku të kuq.⁶³ Ai zbukurohej me qëndisje të shumta me gajtan mëndafshi të zi, sidomos tek mëngët. Mbi të vishej «bedeni» prej cohe të hollë, blu e errët, i zbukuruar me gajtan të kuq anëve dhe tek ijet. Një këngë popullore e mbledhur nga Spiro Dine dëshmon se para vitit 1830 në vend të gajtanit të mëndafshtë përdorej kryesisht fije ari⁶⁴, në mënyrë të veçantë për rrobet e martesës. Përparja prej cohe ose shajaku të kuq, në formë trapezi, ishte e zbukuruar me motive analoge me ato të cibunit. Brezi i ngushtë me një pafte metalike përpara dhe një rrip i gjatë pëlhure të bardhë, të rrudhur («*prosopi*») me të cilën mbështillej koka, si edhe çorapet e bardha prej leshi plotësonin kostumin.

b) Variantet më të zhvilluara ishin ai grup veshjesh ku jo vetëm këmisha ishte kthyer plotësisht në ndërresë të brendshme, por mbi të, në vend të dollomasë së gjatë e të hapur krejt përpara (me origjinë orientale), përdorej tashmë një veshje e mbyllur, në formën e një fustani të gjatë, deri në pulpë të këmbëve, me trup të ngushtë e fund të gjerë pala-pala, që tregonte shkëputjen nga ndikimi oriental⁶⁵. Sipër tij vishej «cibuni» prej shajaku blu të errët, me kindat e tij të gjerë të vendosur verë. Pastaj ngjishej për mesi brezi i ngushtë dhe përparja, dikur me formë katërkëndëshi e më vonë në formë trapezi. Kështu gruaja e veshur me këtë kostum kishte përgjithësisht një siluetë elegante, me bel të hollë e fund të zgjeruar (fig. 124) (Le të kujtojmë p.sh. pamjen e grave të Dardhës në rrethin e Korçës, që mbanin një kostum të tillë).

Transformimi i ndjeshëm i këtij kostumi solli daljen gradualisht nga përdorimi, gjatë viteve 1920-1940, të «cibunit» dhe të përparjes në formë trapezi, kështu që kostumi përbëhej kryesisht nga fustani i gja-



Fig. 124 — Grua nga Zagoria

të e përparja (prej të njëjtit stof), përshtatur prerjes së fustanit. Në këtë formë ai kishte arritur të shkëputej plotësisht nga veshja popullore e mirëfilltë.

Kështu në veshjen e grave ish-ortodokse të rretheve të Korçës, të Kolonjës e të Përmetit mbizotëronin ngjyrat e errëta. Fustanet bëheshin dikur prej shajaku blu ose të kuq (për nusët e reja) dhe më vonë prej cohe ngjyrë blu të thellë, kafe të errët, të gjelbër të errët, bojë vaji të errët dhe vetëm për gratë e reja vishnjë; cibuni ishte gjithnjë blu i errët, shamia e kokës e zezë, me ndonjë lule në qoshe, vetëm

63) Më shtyn në këtë supozim fakti që, ndër përparjet e shumta prej cohe të kuqe që ruhen në koleksionet tona muzeale të veshjeve janë edhe disa prej shajaku të kuq, me zbukurime të thjeshta me gajtan të zi.

64) Kënga në fjalë është një mallkim koxhabashit të qytetit (Nuri Efendiut), veshje të qëndisura me fije ari. Shih: *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, Vol. II, Tiranë, 1964, f. 137.

65) Fustane të këtij tipi shihen në përdorim të grave të qytetit të Korçës, që në çerekun e fundit të shekullit të kaluar, si dëshmojnë shumë fotografi familjare të kësaj periudhe.

për nusët e reja, këpucët e zeza etj. Në veshjen e përditshme këto fustane në zonat malore mbaheshin edhe prej shajaku. Në vitet '20-'30 të shekullit tonë në këto zona cibunet u kishin lënë vendin xhaketave të trasha të trikotuara, kurse përparjet bëheshin me të njëjtën copë si ajo e fustanit, të mbledhura me disa pala sipër tek mesi, duke u shkëputur kështu pothuaj krejt nga tipi bazë.

Të njëjtin tip fustani mbanin edhe gratë e disa krahinave të tjera në rrethin e Përmetit, të Vlorës (Narta) e të Gjirokastrës (veshja e vjetër e Lunxhërisë).

Në këtë grup mendoj se duhet përfshirë edhe veshja e grave ish-ortodokse të Myzeqesë, varianti me një fustan pëlhere të leshtë me vija, i punuar në shtëpi («*gullina*»), mbi të cilin ngjishej përparja⁶⁶. Edhe këtu këmisha kishte marrë funksionet e një veshjeje të brendshme.

Do të hynin në këtë grup, nga struktura që kanë, edhe veshjet e shumë zonave të tjera të Jugut të cilat, në vitet '20-'30, lanë dalngadalë veshjet e mëparshme të tipit oriental (me çitjane, dollama të gjata sipër e jelek), që i kishin adaptuar nga shekulli XIX dhe filluan të vishen me fustane të gjata të po atij tipi që mbahej në rrethet e Korçës. Këto ndryshime u vunë re kryesisht në ato zona, ku për shkak të një zhvillimi ekonomik më të përparuar, marrëdhëniet me tregun ishin më të shpeshta dhe veshja kishte dalë nga sfera e prodhimit shtëpiak. Ndër këto zona mund të përmendim Gorën e Oparin, Skraparin, Tomoricën e Sipërme, rrethet e Kolonjës e të Përmetit, zonat më jugore të rrethit të Beratit etj.

Veshja me këmishë të gjatë e një përparje ka qenë përhapur gjerësisht në vendet e Evropës Juglindore, bile edhe më tej, por zhvillimi që pati marrë, mënyra e kombinimit të pjesëve përbërëse, ngjyrat e zbukurimet e përdorura paraqesin veçori të shumta lokale nga një popull në tjetrin.

III — Veshja me këmishë të gjatë e dy futa.

Ky tip veshjeje, ashtu si edhe ai i përparshmi, përbëhej nga një këmishë e gjatë prej pëlhere vegje, përmbi të cilën gruaja ngjishte, nga beli e poshtë, dy futa, njëren përpara e tjetren prapa.

Në pjesën e sipërme të trupit ajo vishte jelek e mintan. Një brez i leshtë ose i pambuktë ngjishej për mesi. Në këmbë mbathte çorape leshi dhe mbi to opinga lëkure.

Sikurse e kemi vënë në dukje në kreun e parë, ky tip veshjeje është i dokumentuar në shekullin XVIII në veshjen e këmbësve të Sremit dhe, në shekullin XIX, te shqiptarët e Greqisë, (arvanitët). Gjurmimet etnografike kanë hetuar përdorimin e saj në Përdhanë (rrethi i Lezhës),⁶⁷ si edhe në jug, në Bregdet, në Labëri e deri në rrethin e Sarandës⁶⁸. Në shekullin tonë ky tip nuk është ruajtur më në pjesën jugore të Atdheut, kurse në Veri ka qenë përdorur në disa zona.

Nga një shqyrtim i kujdeshëm i materialit ekzistues, te ky tip veshjeje mund të dallojmë disa variante:

1) Varianti ku futat bëheshin prej leshi të kuq, të kombinuar me vija të holla me fije pambuku, të bardhë dhe quheshin «*cullinë*» e përparmja dhe «*pshtjellcë*» e prapmja. Për vajzat e rritura, si dhe për gratë që ishin në zi, ato bëheshin me vija bardhë e zi. «*Cullina*» dhe «*pshtjellca*» kishin përmasa të njëjta (40 cm. gjerësi e 30 cm. gjatësi). I punonin vetë gratë me dy fletë të ngushta pëlhere të vendosura së gjati. Mbulesa e kokës në këtë kostum ishte e bardhë, e thjeshtë.

Ky variant i veshjes me dy futa mbahej në Postribë vetëm në fshatrat Mes, Myslim, Drisht, Boks, Dragoç, Kullaj, Domën e Vilzë. Gratë e fshatrave të tjera, të pjesës veriperëndimore si Shakota, Suma. mbanin kostumin me xhubletë.

66) Për një përshkrim më të hollësishëm të veshjeve të Myzeqesë, Shih Ll. Mitrushi, *Veshjet myzeqare nga shek. XIX — në fillim të shek. XX*, Etnografia Shqiptare» VII, Tiranë, 1975, f. 159; fig. VIII, 6, 7.

67) Rr. Zojzi, *Veshje popullore të rrethit të Lezhës*, Buletin i Universitetit Shtetëror, Tiranë 1954, nr. 3, f. 218-228.

68) Rr. Zojzi, *Raport i ekspeditës në Luginën e Vjosës, 1950*, II f. 158. (Dorëshkrimi ndodhet në arkivin e Sektorit të Etnografisë); A. Gjergji, *Shënime nga terreni viti 1951*, B1: 6, f. 124 (për fshatin Himarë, sipas pohimeve të një fshatari të datëlindjes 1881), f. 191 (për fshatin Lefterohor) dhe f. 196 (për fshatin Nivicë-Bubar).

Shumë i afërt me këtë ishte dhe varianti që mbahej në zonën e Gurit të Zi (në juglindje të Shkodrës) dhe në German (fig. 125) e Bajzë të rrethit të Matit, por vetëm nga gratë myslimane.



Fig. 125 — Grua nga Germani

Në ditët tona përdorimi i kësaj veshjeje me dy futa është rralluar mjaft.

2) Një variant tjetër ishte ai ku futat kishin formë trapezi. Ato bëheshin me shumë copa e rripa shajaku, të kombinuara me spik të zi dhe viheshin mbi një këmishë të bardhë. Ajo që vihej përpara quhej «paranik» dhe kishte përmasa më të mëdha (60 cm. gjatësia, kurse baza lart 50 cm., poshtë 70 cm.), ndërsa tjetra ishte e vogël (30 cm. gjatësia, bazat: lart 20 cm., poshtë 30 cm.) dhe quhej «mbrapanik», ose «shtjellak». Gruaja mbante gjithashtu të ngjeshur për brezi në pjesën e prapme, «kërdhokllën».

Kjo ishte veshja e stinës së ngrohtë e grave të Pultit, kurse në dimër mbahej xhubleta.

Dëshmi të ndryshme të shekullit XIX na tregojnë se në formën e saj më të vjetër kjo veshje ka pasur jo këmishë kambriku, por një këmishë të ngushtë e të trashë leshi që quhej «gjupetë», të zbukuruar përfundi dhe anëve me rripa dhe shirita të kuq, të zinj e ngjyrë tulle. Futat kanë qenë më të mëdha (sidomos prapaniku), në formë katërkëndëshi këndrejtë, me dy shtesa të vogla trekëndëshe në të dy cepat e poshtëm. Këtë e shohim mjaft qartë në disa fotografi të viteve 1870-1880 (fig. 126) dhe në një vizatim me ngjyra⁶⁹. Ky i fundit tregon se në atë kohë, në këtë veshje, mbizotëronin veç së bardhës, ngjyra e kuqe në tullë dhe ajo çiklamini në vjollcë.



Fig. 126 — Grua nga Shoshi (rreth vitit 1875)

69) Fototeka shtetërore e K.E. të KP Shkodër, Foto të Marubit me nr. neg. RA-40/9, RA, RA-40-123, RA-40/15 etj. të riprodhuara me ngjyra në veprën e cituar të Bruhn-Tilke, f. 160, fig. 9.

Ka pasur raste që «pshtjellaku» të mbahej edhe mbi xhubletë, në disa zona të cilat i kemi përmendur më lart, kur folëm për kostumin me xhubletë. Duke pasur parasysh të dhënat e Kordinez-it për veshjen e grave kelmendase të Sremit, rreth vitit 1750⁷⁰, i cili na thotë se gjatë verës ato nuk mbanin xhubletën por një këmishë të gjatë e të ngushtë e dy futa, përdorimin e «prapanikut» ose «pshtjellakut» mbi xhubletë, do ta konsideroja si një ndikim të veshjes verore mbi atë të dimrit.

Fare e afërt me këtë paraqitej veshja e vjetër e grave tek Vasojeviqët (Vasajt) që banojnë në luginën e epërme të Limit, në zonën e Alpeve, në Mal të Zi.⁷¹

Me këtë grup mendoj se afrohet shumë edhe «veshja e ngushtë» e grave të Gashit, të Krasniqes dhe të Bytyçit (rrethi i Tropojës) dhe veshja që mbahet ende në ditët tona në Rugovë (krahinë e vogël me 13 fshatra, që shtrihet në perëndim të Pejës, në Kosovë) (fig. 127), për faktin se ato ruajnë «pshtjellakun» e vogël në formë trapeci⁷², kurse paranikun e kanë në formë katërkëndëshi kënddrejtë. Ato mbajnë gjithashtu një rrip të ngushtë të zbukuruar me rruaza të vogla, të cilin e vendosim pak përmbi pshtjellakun, ndoshta në vend të kërdhoklës së Nikaj-Mërturit. Mbjajnë gjithashtu çorape leshi të zeza, të gjata deri në gju, dhe opinga lëkure. Gratë e moshuara lidhin në ballë një shami të zezë, të palosur si një rrip i ngushtë, krerët e së cilës varen prapa kokës. Për të shpjeguar këtë afri nuk duhet harruar se rugovasit janë të gjithë të fisit Kelmend. Megjithatë veshja e tyre ka fituar me kohë edhe elemente që e afrojnë edhe me veshjen e Hasit.

3. — Në një variant të tretë futat paraqiteshin të dyja në formë katërkëndëshi kënddrejtë, e përpamja gjithmonë më e madhe se e prasmja. Ato bëheshin përgjithësisht prej një pëlhure të rrallë me ngjyrë të zezë, vishnje ose kafe dhe zbukuroheshin me qëndisje të shumta me ngjyra të ndryshme, kurse anëve u vihej një dantelë e gjerë, e zezë, punuar me fije të hollë leshi.



Fig. 127 — Grua nga Rugova

Këmisha prej pëlhure vegle të pambuktë, e bardhë me «gishta» dhe «ujsa» ngjyrë bezhë ose kafe, ishte e gjatë deri poshtë te nyja e këmbëve, por ngrihej në bel duke u lëshuar mbi përparje. Mëngët e saj ose bëheshin të shkurtra deri në llërë të krahut, ose bëheshin të gjata e të drejta, por ngriheshin të rrudhura deri mbi bërryl. Gratë e kësaj zone mbanin të mbathura pëlhure, të cilat mbaronin te gjunjët me «këmbëza» leshi të punuara në avlëmënd, me motive të thjeshta ngjyrash të ndryshme mbi një fushë të zezë. Kostumi plotësohej nga një brez leshi, nga një jelek i shkurtër shumë i zbukuruar dhe nga mbulesat e bardha të kokës, që lidheshin në një mënyrë të veçantë, duke kaluar nën mjekër.

Ky variant mbahej në krahinën e Hasit si në pjesën e këtejme, ashtu edhe në atë përtej kufijve të sotëm shtetërorë; mbahej gjithashtu në një pjesë të madhe

70) A. Gjergji, *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri*, në «Etnografia Shqiptare» VII, Tiranë, 1976, f. 112.

71) Shih një përshkrim të hollësishëm të saj nga M. Vlahović, *Zenska nošnja u Vasojevičima*, në «Glasnik» Beograd 1934 nr. 82.

72) Shih pshtjellakun nga Rugova me nr. inv. 7858 në fondet e Muzeut etnografik (Tiranë) dhe filmat nr. 13 dhe 365 në fototekën etnografike. Shih gjithashtu A. Gjergji, *Shënime nga ekspedita në Kosovë* (Janar — Shkurt 1972), dorëshkrim në arkivin etnografik.

të Rrafshit të Dukagjinit, në Kosovë. (fig. 128).




Fig. 128 — Grua nga Hasi

Veshja e re e Drenicës (Kosovë)⁷³, megjithëse i përket këtij grupi, dallohet nga përparja e saj, me përmasa më të mëdha (afërsisht 65 cm. x 70 cm.) dhe nga zbukurimet me ngjyra të forta e të çelura në gjithë sipërfaqen e saj.

4 — Në një variant tjetër, mbi këmishën e gjatë prej pëlhure ngjishej brezi dhe dy futa: e përparmja, me përmasa afërsisht 55 x 70 cm., prej pëlhure të pambuktë të kuqe me vija të bardha, e zbukuruar përfundim me tufëza, ndërsa e prasmja, që thirrej pikërisht «futë» kishte po ato ngjyra e përmasa veçse dy qoshet e poshtme të saj përthyeshin së brendshmi, duke i dhënë fundit formën e një këndi të ngushtë.

Me kohë si një ndikim qytetar, në veshjen e nuseve filloi të përdoret mbi këmishë edhe një anteri e gjatë ose allaxha, e mbu-

shur lehtë me pambuk. Kostumi plotësohej pa dyshim me fanelën, të mbathurat e gjata; çorapet prej leshi; opingat prej lëkure e shaminë e kokës. Ky variant mbahej në dy -tre fshatra të rrethit të Dibrës, si Trebishti, Pasingu etj.

5. — Në tipin e veshjeve me dy futa, *veshja e vjetër* e Pdhanës (rrethi i Lezhës) paraqet veçori që e bëjnë të dallohet nga variantet e tjera. Ndër këto veçori kryesore është se këtu futa e prasje është shumë e vogël dhe e zbukuruar anëve me thekë të gjata fijesh leshi. Ajo i afrohej shumë përparjes me thekë (rrethocës së ngushtë), që përdorte dikur Mirdita, veçse siç thamë, në Pdhanë ajo vihej prapa.

6. — Nga disa të dhëna të paplota që disponojmë, ka të ngjarë që edhe në Skrapar të ketë ekzistuar një variant i veshjes me dy futa. Është fjala për veshjen e vjetër të grave myslimane në fshatin Vërzhezhë, të cilat, sipas pohimeve të një bashkëpunëtori⁷⁴, në fillim të shekullit tonë vishnin linjën, hirkën dhe pastaj ngjishnin në mes brezin dhe përparjen, «mësallën». «Vinin edhe një *perde* prapa, vazhdon ai, — që ishte më e gjerë dhe zbukurohej me qëndisje, si «mësalla».

Edhe në Labëri, pleqtë kujtojnë se, para se të hynte në përdorim veshja me çitjane të zeza, gratë kanë mbajtur këmishë të gjatë liri, mbi të cilën vinin dy futa, një-rën përpara e tjetrën prapa. Këto dy raste janë të vetmet të dhëna që kemi deri tani nga gjurmimet në terren, për përdorimin e këtij tipi veshjeje në jug të Shqipërisë. Të dhëna nga literatura dëshmojnë se ai mbahej edhe nga shqiptarët e Moresë në Greqi, të paktën deri në fund të shek. XVIII,⁷⁵ Kostumin me dy futa e gjejmë dhe në disa vise të Jugosllavisë (si në Shumadi, në Posavinë etj.), në Bullgarinë Veriperëndimore (në rrethet e Vidinit e të Belogradçikut) dhe sidomos në Rumani (në Banat etj.), por kudo në këto vise futat shoqërohen me këmishë të tipit dak (me rrudha tek qafa) dhe kanë gjithnjë formë katërkëndëshi këndrejtë. Një afri e theksuar vihet re midis kostumit të vjetër të Pdhanës në rrethin e Lezhës (varianti 4 i përshkruar më lart) dhe veshjes së grave në Banat (Rumani), për faktin se në të dy rastet futa e prasje ishte me për-

73) Shih objektet me nr. inv. 73/26-73/34.

74) Përgjigje pyetësorit të veshjeve popullore në fshatin Vërzhezhë (Rrethi i Skraparit). Dorëshkrim në Arkivin Etnografik).

75) A. L. Castellan vep. cit. Shih shënimin 105 në Kap. I të kësaj vepre.

masa të vogla dhe me thekë të gjata anëve.

Sikurse kanë provuar dëshmitë e ndryshme arkeologjike dhe etnografike, ky është një tip veshjeje shumë i lashtë dhe lidhet me disa nga kulturat më të njohura prehistorike në viset e Evropës Juglindore.

IV. — Veshja me mbështjellëse

Për këtë tip veshjeje të grave ishte karakteristik një lloj fundi i hapur dhe i gjerë, i cili mbulonte trupin nga mesi e poshtë. Mbi të mund të vihej ose jo një përparje. Si do të shohim më poshtë, ky fund i gjerë bëhej prej pëlhure liri, pambuku ose leshi (me ngjyra të ndryshme), mund të kishte rrudha vetëm tek ijet ose pala rreth e qark belit, sipas zonave ku mbahej. Fundi konfeksionohej gjithnjë duke qepur njëra me tjetrën dy fletë pëlhure të vendosura horizontalisht. Mbështjellësja ngjishej zakonisht përmbi këmishë, pastaj vihej brezi dhe në pjesën e sipërme të trupit vishej një jelek ose anteri e shkurtër. Kostumi plotësohej me të mbathurat e gjata, çorapet e opingat. Mbulesat e kokës në veshjen me mbështjellëse ndryshonin nga një zonë në tjetrën.

Në veshjet me mbështjellëse dallohen disa variante, të cilat po përipiqemi t'i përshkruajmë shkurtimisht më poshtë.

1) Në variantin e parë, mbi një këmishë pëlhure të gjatë deri në pulpën e këmbës, gratë vinin mbështjellësen prej pëlhure të bardhë liri ose pambuku, që quhej «shage» dhe arrinte deri nën gju, kështu që nën të dukej këmisha nja 20-25 cm. Shagia ishte e mbledhur me rrudha vetëm në ijet⁷⁶. Atje ku bashkoheshin të dy fletët kishte një «rrexë» (dantelë të thjeshtë) me po ato ngjyra që kishin zbukurimet e këmishës. Mbi «shage» gruaja vinte një përparje të pambuktë, të ngushtë e të drejtë (afërsisht 35 cm. x 45 cm) që quhej «përparcë» dhe që ishte shumë e zbukuruar. Kostumi plotësohej me jelekun e shkurtër, brezin dhe mbulesën e lekur të kokës, lidhur në një mënyrë shumë të hijshme. Ky variant mbahej në zonën e Kallmetit (rr. i Lezhës). (fig. 129).

Shumë e afërt me «shagen» (përsa i përket prerjes së saj), ishte mbështjellësja që përdornin gratë dhe vajzat e Zadrimës (rre-



Fig. 129 — Gra me shage (Kallmet)

thi i Lezhës) në veshjen e tyre të përditshme. Ajo bëhej vetëm e zezë; me një pëlhurë të leshtë të rrallë, të punuar me dy ose me katër lisa, veçse ishte më e ngushtë se shagia (për gratë ajo arrinte deri në 120-130 cm. gjerësi), kurse për vajzat bëhej pak më e ngushtë, prandaj afrohej shumë me veshjen me dy futa. Ajo quhej «mbështjellak» ose «faqore» dhe shoqërohej me një përparje pëlhure të pambuktë me ngjyra të forta, e cila gjithashtu kishte pak rrudha tek ijet. Edhe në këtë rast këmisha zgjatej nja 20 cm. nën mbështjellësen.

2. — Në një variant tjetër mbështjellësja kishte formë katërkëndëshi kënddrejtë, bëhej me dy fletë pëlhure të leshtë me fushë të bardhë e vija të gjera, ngjyrë të verdhë, të gjelbër, manushaqe etj., të vendosura horizontalisht e të qepura njëra me tjetrën. Gjerësia e mbështjellësës arrinte rreth 70 cm. Mbi të vendosej jastëku i vitheve, 10-12 cm. i gjerë dhe i mbushur me bar të ngjeshur. Pastaj vihej përparja prej pëlhure të hollë leshi, ngjyrë të kuqe dhe e zbukuruar

⁷⁶ M. Prendushi, *Vështrim etnografik mbi zonën e Kallmetit «Etnografia shqiptare» II*, Tiranë, 1963, f. 12.

me disa motive rombrike të bardha. Vetëm për nusëri gruaja mbante edhe një «*mbra-panicë*» pak më të vogël se përparja, në ngjyrë të kuqe me vija të bardha, të cilën e ngjishte mbi mbështjellësen. Pjesët e tjera ishin këmisha e gjatë prej pëlhure, jeleku, të mbathurat e gjata me këmbëza të lesh-ta. Ky variant mbahej në një grup fshatrash të rrethit të Kukësit (Gjinaj, Domaj, Shalqi, Cahan e Vlahën) si edhe në Kosovë, në një grup fshatrash në rrethinat e Gjakovës e të Prizrenit.

Shihet qartë se ky kostum nusërie paraqet disa afri edhe me tipin e veshjes me dy futa.

3. — Një variant tjetër veshjeje me mbështjellëse, gjithmonë me dy fletë pëlhure të vendosura horizontalisht, por shumë më e gjerë se «shagia», e mbledhur me pala të dendura dhe e fiksuar te beli me një lidhëse, mbahej si veshje për të dalë në stinën e ftohtë. Ajo bëhej vetëm e bardhë, ishte e lehtë (ose me majën prej pambuku) dhe quhej «*xhubletë*». Gjerësia e saj arrinte deri në 5 m.

Ashtu si «shagia» edhe mbështjellësja me pala («xhubleta») vishej mbi këmishën e gjatë dhe shoqërohej me po ato pjesë kryesore. E mbanin një grup i vogël fshatrash në rrethin e Lezhës (Kallmeti, Gramshi, Rraboshta e Mërqinja).

Në Zadrinë kjo mbështjellëse me pala ishte e zezë, nuk kishte asnjë zbukurim dhe vishej mbi këmishën e gjatë. Ishte një pjesë veshjeje që e përdornin vetëm gratë e martuara, jo vajzat. Ajo bënte pjesë në veshjen e mirë për të dalë dhe thirrej «*kotull*», «*pshtjellak*», ose «*pshtjellcë*». Gjerësia e saj arrinte deri në 8-9 m.

Pjesët e tjera që plotësonin kostumin ishin analoge me ato të veshjes së përditshme veçse bëheshin me material të një cilësie më të mirë.

Në variantin më të vjetër të veshjes së Zadrinës, «*kotulla*» shoqërohej në pjesën e sipërme të trupit, sidomos për kohën e ftohtë, me një xhokë prej shajaku të kuq, pa mëngë. Një petk analog, por me ngjyrë të bardhë, duket se mbanin edhe vajzat gjatë stinës së dimrit.⁷⁷

4. — Një variant tjetër i veshjes me mbështjellëse dallohej nga variantet e mësipërme për mënyrën si që kombinuar mbë-

shtjellsja me pjesët e tjera të veshjes. Këtu ajo kishte marrë një pamje më luksoze jo vetëm nga ngjyra e pëlhurës me të cilën përgatitej, por edhe nga zbukurimet e shumta që i bëheshin duke i qepur në buzën e poshtme shirita e dantela të ndryshme dhe duke e qëndisur fushën e saj me fiqe teli të shndritshëm, me një efekt të rrallë. Ajo mbahej në një grup fshatrash myslimane të rrethit të Pukës dhe quhej «*veshje kabashisht*» pra veshje e Kabashit.

Në këtë zonë mbështjellësja quhej «*kanac*». Ajo vishej përmbi një këmishë të shkurtër kambriku, që kishte qëndisje të ndryshme te gjoksi e te mëngët. Këta tre-katër dhjetëvjeçarët e fundit përparja nuk përdoret më përmbi «*kanac*» dhe gratë parapëlqejnë që në vend të saj të lidhin në mes, për bukuri, një shami të madhe mëndafshi të verdhë. Në pjesën e sipërme të trupit gruaja vishte një jelek të zi. Çorapet e saj ishin të zeza, të gjata gjer në gju. Edhe mbulesa e kokës ishte një shami e thjeshtë.

Në rrethin e Pukës «*kanaci*» mbahej më shumë i kuq ose i gjelbër. Me kohë përdorimi i tij u shtri edhe në Malësinë e Gjakovës (pra në disa pjesë të rretheve Tropojë e Kukës). Atje bëhej më shumë, ngjyrë vjollcë dhe quhej «*pshtjellak i gjanë*», për ta dalluar nga pshtjellaku i veshjes me dy futa.

4. — Një tjetër variant i veshjes me mbështjellëse ishte ai ku përmbi këmishën e gjatë prej pëlhure vegle të lehtë vishej «*pshtjellca*» e gjerë krejt e bardhë që arrinte deri nën gju. Ajo linte të dukeshin nën të jo këmisha, e cila ishte pothuaj njësoj e gjatë, por këmbëzat e të mbathurave që bëheshin prej një pëlhure të lehtë e të kuqe me vija e motive ngjyrash të ndryshme. Në pjesën e sipërme të trupit gruaja vishte një jelek e mbi të xhokën e ngushtë prej shajaku të zi. Si zakonisht ajo mbante për mes një brez të gjatë, por nuk vinte përparje. Ky variant mbahej në krahinën e Lumës në rrethin e Kukësit. (fig. 130). Shumë i afërt me të ishte edhe varianti që mbahej në krahinën e Gorës (në juglindje të Kukësit). Ndryshimi më i dukshëm ishte se këtu pshtjellca bëhej me dy fletë pëlhure të lehtë e jo të bardhë, por të kuqe të fortë me vija të holla blu, të bardha e me ndo-

77) Për një përshkrim më të hollësishëm të kësaj xhoke (dollamë), shih A. Gjergji, *Materiale të ekspeditës së Zadrinës* (viti 1969, dorëshkrim).

një motiv të thjeshtë. Gjerësia e saj ishte afërsisht 2-2,5 m.



Fig. 130 — Veshje e Nangës (Kukës) me mbështjellëse

Siç shihet pra, veshja me mbështjellëse është përdorur në një zonë të ngushtë, që fillon nga Kallmeti e Zadrime dhe shkon drejt verilindjes duke u zgjeruar, por në variante që paraqesin karakteristika të veçanta mjaft të dallueshme nga një grup në tjetrin.

Gjurmimet e deritanishme nuk kanë hetuar ndonjë rast të përdorimit të saj në pjesën qendrore e jugore të Atdheut.

Variantet e kostumit me mbështjellëse të përmendura në pikat 1,2, me sa dimë, nuk janë hetuar në ndonjë vend tjetër të Evropës Juglindore. Ngjashmëri të qarta bien në sy midis veshjes me «kanac» (të përshkruar në pikën 3) dhe disa veshjeve popullore të përdorura në Bullgarinë Veriperëndimore dhe në Rumani, por duhet të shtojmë se atje shoqërohen me këmishë të tipit dak (me rrudha përçark qafës) dhe dallohen gjithashtu nga ngjyrat dhe zbukurimet e veçanta të tyre.

V. — Veshja me brekushe. —

Në prerje brekeshat e grave ishin të njëjta me ato të burrave, por duhet theksuar se për gratë ato bëheshin vetëm prej tirkut të zi a ngjyrë kafe dhe jo të bardha.

Kjo veshje, siç është vënë në dukje edhe gjatë trajtimit të tipave të tjerë, ka pasur një përhapje relativisht të vonë dhe disi të kufizuar, si në kohë ashtu edhe në vend.

Me sa kemi mundur të hetojmë deri tani, veshja me brekesha për gra është një dukuri relativisht e vonë, që u përhap me shpejtësi (sidomos pas 1912-ës) në një varg krahinash malore që përfshiheshin në rrethet: Tiranë, Mat, Librazhd dhe Elbasan, në fillim si veshje e përditshme për punë, krahas veshjes me këmishë të gjatë e përparje, që mbahej për festa, për nusëri etj.

Pjesët e tjera përbërse pothuajse nuk ndryshojnë nga ato që mbaheshin me kostumin e mëparshëm me një përparje. Pra gruaja mbi këmishën jo fort të gjatë e të mbathurat, vishte, në pjesën e sipërme të trupit, jelekun ose mintanin, mbi to xhokën prej shajaku me zbukurime që ndryshonin sipas zonave, të cilën e fuste përbrenda brekusheve. Mbi to për stinën e ftohtë, ajo mbante edhe veshje të rënda dimri, përgjithësisht të gjata deri pak nën bel, me mëngë të shkurtra, të pajisura me kapuç (si ishte rasti i «xhupit» të zi që mbanin gratë e Malësisë së Tiranës) ose me një jakë të madhe katrore që mund të kthehej lehtë në kapuç (siç ishte «xhulini» që përdornin gratë e rrethit të Matit) etj.

Hyrja në përdorim e brekusheve solli si pasojë përdorimin e këmishëve më të shkurtra dhe të çorapeve të shkurtra, duke nxjerrë nga përdorimi ato qafa çorapësh që përdornin dikur gratë në disa zona të rrethit të Librazhdit. Por nuk mundi të nxjerrë nga përdorimi përparjen, për vetë rëndësinë e madhe praktike që ka për gruan, në punët e përditshme, kjo pjesë e veshjes. Kështu edhe mbi brekushtet e gjera, të zeza, gruaja vinte përparjen e leshtë ose të pambuktë, përgjithësisht të zbukuruar me vija ose motive të tjera shumëngjyrëshe.

Gjerësia e madhe ua humbte deri diku praktikitetin brekusheve dhe ua shëmton pamjen grave që i mbajnë. Ato kanë pam-

je më të pranueshme nga ana estetike, kur bëhen me pëlhurë leshi të hollë (të punuar me dy lisa) dhe disi më të ngushta.

Brekushet e zeza prej leshi nuk duhen ngatërruar me çitjanet e modës turke që kanë hyrë në përdorim në shumë zona të Shqipërisë së Mesme, sepse ato kanë prerje të ndryshme dhe origjinë krejt tjetër.

Përshkrimi i varianteve kryesore të tipave të veshjes për gra që u parashtrua më lart tregon se ato qenë më të shumëllojshme se veshjet e burrave. Ky fakt shpjegohet me jetën më të mbyllur që bënin gratë në krahasim me burrat, me kontaktet e kufizuara që ato kishin me krahinat e tjera dhe mbi të gjitha me disa faktorë ekonomikë.

Theksojmë edhe njëherë se në veshjet e grave ka tipa dhe variante që nuk ndeshen në popujt fqinjë, si p.sh. tipi i veshjes me xhubletë, disa variante të veshjes me dy futa e të asaj me mbështjellëse. Tipat e tjerë paraqiten të përbashkët me shumë nga veshjet e popujve të tjerë të Evropës Juglindore, gjë që presupozon kontakte të shumëllojshme midis tyre.

* * *

Në këtë klasifikim nuk janë përfshirë veshjet qytetare, të cilat, në disa raste, për periudha kohe të ndryshme, janë përhapur së pari në fshatrat përfaqëse qyteteve dhe gradualisht edhe në zona të tjera më të thella, atje ku kushtet e zhvillimit ekonomik e shoqëror ishin pjekur për një përthithje të tillë.

Le të shohim shkurtazi disa nga veshjet e tipit qytetar dhe kohën e vendin kur u përhapën ato. Këto veshje, padyshim, kishin ndikime të dukshme të modës së huaj; kryesisht të asaj orientale, që qarkullonte me lehtësi pothuaj në të gjitha qytetet kryesore të vendeve ballkanike, gjatë tre-katër shekujve të pushtimit osman.

Në veshjet e burrave ky ndikim ka qenë më i kufizuar, në krahasim me ato të grave, dhe mendoj se kjo ka ndodhur në radhë të parë në saje të afirmimit të gjerë të kostumit me fustanellë, si një kostum që plotësonte edhe kërkesat e burrave qytetarë. Në anë tjetër duhet thënë se ndikimi i veshjeve qytetare mbi ato fshatare është ndier në pjesë të veçanta të kostumit, festiv e sidomos në veshjen e fshatarëve të pasur.

Midis veshjeve të burrave qytetarë që pasqyrojnë ndikime të modës së huaj, kryesisht të asaj orientale, mund të përmendim disa.

— Veshja me «brandavekë» të zinj, shumë të gjerë, që mbanin burrat katolikë të Shkodrës, që nga mesi i shekullit XIX e deri në vitet '20 të shekullit tonë. (fig. 133).

Një lloj «brandavekësh» shumë të gjera e të gjata deri në gju, me ngjyrë blu të errët, vishnin në shekullin e kaluar detarët shqiptarë, si ata të Ulqinit, ashtu edhe ata të «ishujve lundëtarë» të Egjeut (Hidra, Specia, Poros etj., të banuar prej Shqiptarësh)⁷⁸. Në prerjen e tyre këto poture afronin më shumë me brendavekët e burrave katolikë shkodranë sesa me poturet prej shajaku, që mbanin fshatarët në disa zona të Shqipërisë së Jugut.

— Veshja me shallvare të gjera prej kože të kuqe, të zbukuruar me shumë shirita ari, që mbanin disa krerë të parisë, sidomos disa krerë familjesh feudale.

— Veshja me dolloma të gjatë e xhybe me gëzof, që mbanin burrat ortodoksë të qytetit të Korçës, të Voskopojës etj., të pak-tën që nga fillimi i shek. XVIII e deri në Shpalljen e Pavarësisë (shih fig. 10).

— Në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit XIX, nëpër qytetet kryesore të vendit, filloi të përhapej me shpejtësi, sidomos në burrat e moshës së re të shtresave të bor-gjezisë, kostumi evropian i kohës. Këtë e provojnë fotografi të shumta familjare që ruhen nga kjo kohë në qytete të ndryshme të vendit.

78) Le të përmendim për ilustrim veshjen e kapitenit Kanaris nga Hidra, vizatuar më 1804 dhe atë të një marinari «grek». Shih Pouqueville, *Histoire de la régénération de la Grèce*, Tome IV, Paris, 1824, (në faqen përballë titullit) dhe po ai, *Voyage de la Grèce* Tome VI, Paris, 1824 (në faqen përballë titullit).




Fig.131 — Hartë e përhapjes së tipeve të veshjeve për gra



a



b



c



e



d

Fig. 132 — Skica të tipeve të veshjeve për gra
 (a) veshje me xhubletë
 b) veshje me këmishë të gjatë e xhokë,
 c) veshje me këmishë të gjatë e dy futa
 e) veshje me mbështjellëse
 d) veshje me brekeshë)



Fig. 133 — Burrë shkodran me brandavekë

më i dukshëm. Më vonë zhvillimi i mëtejshëm i këtyre veshjeve është bërë në një rrugë të vetën, i shkëputur nga qendrat fillestare të rrezatimit të kësaj mode dhe ka marrë forma e variante lokale me disa karakteristika vërtet të dorës së dytë, por që nuk gjejnë analogji të plota me ato të vendeve të tjera ballkanike.

Nga fillimi i shekullit tonë, nëpër qytete dhe diçka më vonë nëpër fshatra, anteritë dhe dollomatë e gjata qenë zëvendësuar me anteri të shkurtra nën bel ose me fustane të gjata të modës evropiane, si ato që mbanin gratë e krishtera, kurse xhybet e zeza (e të kuqe) kishin dalë nga përdorimi gradualisht që në pjesën e dytë të shek. XIX duke ua lënë vendin sakove, libadeve, hirkave ose veshjeve të tjera të gjata sa një xhaketë, që linin të dukeshin më tepër çitjanet. Me këtë tip veshjeje arritën deri

Për veshjet e grave po përmendim këto:
— Veshja me çitjane (tumane, dimite), mbi të cilën vinte një anteri ose dolloma e gjatë gjer në fund të këmbëve dhe mbi të një xhybe cohe e zezë, qëndisur me ar për nusëri edhe e kuqe (fig. 134). Nga fundi i shek. XIX, kjo veshje e përgatitur me materiale më pak të kushtueshme kishte marrë përhapje të madhe në shtresat e gjera të popullsisë qytetare myslimane si edhe në disa krahina të thella, si: në Skrapar, në fshatrat myslimane të rretheve Kolonjë, Korçë, Përmet etj. Elemente të veçanta të saj, si p.sh. xhybja e sipërme, arritën të përhapen edhe më shumë, duke u kombinuar, në mënyrë jo gjithnjë fatlume, me veshjet fshatare vendase, sidomos për kostumin e martesës. Si kohë ky depërtim u bë më vonë, përgjithësisht atëherë kur filloi të dilte nga përdorimi në qytet. I tillë ishte, p.sh., rasti i xhybes së kuqe që përdorej në vitet '20-'30 për nusëri nga gratë e disa fshatrave të rrethit të Librazhdit si: Rajca, Uraka, Kotodeshi etj.) e shartuar keq me kostumin popullor të krahinës.



Fig. 134 — Veshje grash me çitjane

në prag të Çlirimit disa zona të Shqipërisë së Mesme, të rrethit të Dibrës, të Labërisë etj. Materiali, ngjyrat dhe zbukurimet ndryshonin nga një zonë në tjetrën, por struktura dhe prerja e pjesëve themelore ishin shumë të afërta.

— Gjysmës së dytë të shek. XIX duket se i takon dhe hyrja në përdorim e «brandavekëve» prej perkaline të zezë, jashtëzakonisht të gjera, të shoqëruara me jellekë e xhybe cohe vishnje, (ose blu), të qëndisur me gajtan të zi, si veshje e grave katolike të Shkodrës. Këta brandavekë nga prerja i përkasin tipit të çitjaneve orien-

Në veshjet me çitjane, dolloma të gjatë e xhybe sipër, ndikimi turko-oriental ishte



Fig. 135 — Veshje gruaje nga Berati.

tale. Duhet theksuar se kjo veshje për gati një shekull që qe në përdorim, mbeti e

kufizuar tek ish-katolikët e Shkodrës dhe nuk u shtri më tej. Ajo doli plotësisht nga përdorimi vetëm mbas Çlirimit të vendit.

— Gratë e shtresave më aristokratike të vendit, por edhe ato të tregtarëve e zejtarëve të pasur, sidomos në Shqipërinë e Jugut, kanë mbajtur deri në prag të Luftës të Parë Botërore veshje të ndryshme kadijeje të qëndisur pasurisht me fije ari. Ato kishin formën e një fundi të gjatë me xhakëtë (sako) ose të një rrobeje të drejtë, të gjerë, të gjatë e pak me bisht prapa, të shoqëruar gjithashtu me një xhakëtë ose pelerinë, (fig. 135) Prerja dhe zbukurimi i ngarkuar i tyre të kujton veshjet e rënda princore të mesjetës së vonë, që ruajnë diçka nga shkëlqimi bizantin.

Veshje të tilla janë mbajtur deri në çerekun e parë të shekullit tonë edhe në qytete të tjera të Gadishullit Ballkanik. Tek ne ato janë punë e mjeshtërve qëndistarë të Beratit, të Janinës, të Manastirit etj.

— Veshje me origjinë qytetare ishte pa dyshim edhe ajo që mbanin gratë ortodokse, të qytetit të Korçës në çerekun e fundit të shek. XIX, dhe që, me transformime graduale, arriti deri në vitet '30. Është fjala për fustanet e gjera (me prerje të modës evropiane të kohës), të shoqëruara me një xhybe cohe të zezë me gëzof te qafa dhe te anët përpara dhe me shami të zezë në kokë. Mbas Luftës së Parë Botërore kjo veshje u përhap pothuaj në të gjithë fushën e Korçës, në fshatrat e luginës së Devollit dhe në shumë zona të tjera të Shqipërisë Jugore.

SHQYRTIM HISTORIK KRAHASUES I DISA ELEMENTEVE TË VESHJEVE POPULLORE

Në kuadrin e kulturës së një populli veshja paraqet interes të veçantë po të mbajmë parasysh se ajo është rezultat i një procesi të gjatë, dhe përftohet gjatë zhvillimit historik të tij.

Përpyekja për t'i njohur sa më me hollësi format dhe variantet ekzistuese të elementeve të ndryshme të veshjes si dihet, jep mundësinë për t'i renditur këto forma dhe variante në një rend kronologjik përbrenda tyre, rend ky që tregon edhe rrugën e zhvillimit të elementit përkatës. Kjo ndihmon të ndiqet zhvillimi i veshjeve popullore në drejtim të kundërt, domethënë nga ditët tona drejt së kaluarës. Qëllimi është të arrijmë të vjetra të ruajtura në veshjet popullore, të identifikojmë se me veshjet e cilit popull të lashtësisë paraqesin afri më të mëdha, cili është karakteri i këtyre lidhjeve etj. Këtu pikësynimi kryesor ka qenë gjurmimi i lidhjeve iliro-shqiptare, ç'kemi trashëguar në këtë fushë nga kultura e stërgjyshëve tanë etj. Por për këtë duheshin shqyrtuar të dhënat dokumentare të kohës së mesme, si hallkë ndërmjetese, pastaj materialet e vlefshme të dala nga zbulimet e arkeologëve tanë në fushën e kulturës ilire etj. Kështu do të arrihej realizimi i një prej pikësynimeve kryesore për të cilat gjurmohet evolucioni i veshjeve, domethënë një shtresim kronologjik sa më i saktë i pjesëve përbërëse të tyre.

Kostumet popullore janë përpunuar në rrjedhën e shekujve dhe paraqesin elemente ose gjurmë elementesh të shumë ndikimeve kulturore, që janë futur në popullin tonë në sajë të ngjarjeve dhe kontakteve të ndryshme historike e shoqërore. Të tilla janë gjurmët e kulturave të hershme ballkanike e mesdhetare, të kulturës klasike antike, të asaj bizantine e orientale dhe në shekujt e fundit edhe të kulturës së Europës Perëndimore. Këto ndikime kulturore kanë lënë

mbresat e tyre mbi kostumet tona, mbresa diku më të lehta, diku më të forta sipas zonave të ndryshme, madje edhe kanë kontribuar në diferencimin e tyre, gjithmonë në varësi të zhvillimit ekonomik e shoqëror të zonave përkatëse.

Pra në veshjet, ashtu si edhe në fusha të tjera të kulturës popullore, ruhen shtresa të ndryshme nganjëherë edhe shumëshekullore, të cilat mund të zbulohen me anë të ballafaqimit me elementet korresponduese të kulturave me të cilat populli ynë ka pasë të bëjë gjatë historisë së tij mijëra vjeçare.

Është vështirë të flitet për gjenezën e kostumit në tërësi sepse ai, në përgjithësi, paraqitet si një njësi me stabilitet relativ, e përbërë nga bashkimi i disa pjesëve të veçanta. Këto pjesë të veçanta, me kohë, kanë pësuar ndryshime ose janë zëvendësuar nga një pjesë e re, herë njëra e herë tjetra, prandaj detyra ndërlikohet shumë.

Më poshtë do të shqyrtojmë disa elemente të veçanta (por themelore) të veshjes, duke u përpjekur të skicojmë historinë e zhvillimit të secilit prej tyre, në bazë të asaj që kanë dhënë kërkimet dhe gjurmimet e deritanishme etnografike, burimet letrare e dokumentare të njohura deri tani etj. Kuptohet se hetimi dhe identifikimi i formave më të vjetra ndër ato ekzistueset, do të na e bëjë më të lehtë përqasjen e tyre me të dhënat historike e dokumentare që disponojmë mbi veshjet dhe do të na ndihmojë që t'i kuptojmë më mirë këto të fundit. Megjithatë ka një varg elementesh për të cilat ende nuk mund të jepet një mendim i plotë, sepse të dhënat e deritanishme nuk e sqarojnë sa duhet gjendjen, por kjo nuk do të na pengojë për të parashtruar edhe në këto raste ndonjë mendim, qoftë edhe si hipotezë pune.

SHALLAKUT: XHUBLETA

Element me interes të madh nga fusha e veshjeve është pa dyshim «xhubleta» ai fund i krekosur, disi i valëzuar e në formë kambane, që mbahej i varur në supet me dy rripa të gjerë.

Duke mbajtur parasysh prerjen e xhubletave të përdorura në vendin tonë dhe përshkrimet e pakta ekzistuese mbi prerjen dhe formën e tyre, mund t'i grupojmë ato në dy variante kryesore:

1) Në variantin e parë xhubleta kishte vetëm 5-6 iva ose rrogzina (rripa të ngushtë shajaku) në pjesën e poshtme të saj, ndërsa pjesa tjetër përbëhej nga dy copa të drejta prapa e përpara, të plotësuara me nga tre kinda të ngushtë në secilën anë (shih fig. 136 a, b). Kjo xhubletë nuk kishte gjërësi të madhe, iva e fundit e saj arrinte rreth 180-200 cm., ajo shoqërohej me dy futa dhe kërdhoklën.

Ky variant i xhubletës i përkiste kryesisht «veshjes pultake» (apo të Pultit) dhe mbahej në zonën e Shllakut dhe në pjesën lindore të rrethit të Pukës.

2) Në variantin e dytë, e tërë pjesa e prasmë e xhubletës bëhej me iva të ngushta të qepura njëra mbas tjetrës, që nga beli






Fig. 136 — Xhubletë nga Shllaku a) foto



b) skicë e prerjes,



b) skicë e prerjes

papritur entuziazmi me të cilin shprehej letrari hungarez i shekullit XVIII Daniel Kordinez, kur shkruante për pasurinë e ngjyrave të xhubletës së grave kelmendase⁴.

Zbukurimi i xhubletës, po ashtu si të qepurit e saj, ishte një punë e vështirë dhe donte shumë mjeshtëri. Repertori i motiveve të përdorura është nga më interesantët në artin tonë popullor; ai ruan një fizionomi shumë origjinale e specifike që s'mund ta ngatërrosh me ornamentet e veshjeve të tjera. Në sistemin dekorativ të xhubletave vihet re një unitet i theksuar, edhe përbrenda vetë pjesëve përbërëse të kostumit pra xhubletës, përparjes, xhokës etj., bie në sy një përshtatje e plotë e motiveve të zbukurimit nga njëra pjesë tek tjetra e deri tek trajsta e vogël e dorës.

Disa nga tiparet arkaike të xhubletës që bien më fort në sy janë këto: ashtu si edhe veshjet e kohës homerike, xhubleta injoron krejtësisht parimin e veshjes që bie lirshëm duke iu përshtatur formës së trupit, sidomos kur lidhet për beli me një rrip. Përkundrazi ajo rri e ngrirë dhe pa shumë përkulje. Kjo formë e ngrirë tek xhubleta përftohet jo vetëm nga vetë materiali me të cilin konfeksionohet, por edhe nga përdorimi i shumë gajtanëve, shiritave e zbukurimeve të ndryshme të aplikuara në dytri shtresa njëra mbi tjetrën, me shumë të qepura, të cilat japin shumë herë efekte zbukurimi, dhe të gjitha këto e shtojnë trashësinë e saj dhe e bëjnë të rrijë si e ngrirë. Përdorimi i thekëve të gjata për zbukurim, qoftë tek supet e xhokës, qoftë anës së poshtme të përparjes, ka gjithashtu ka-

4) D. Kordinez i ka vizituar kelmendasit e Sremit rreth vitit 1750. Cituar sipas K. Tkalac, *Narodna nošnja Sremski Klimentata u Hrtkovcima i Nikincima*, në: «Rada Vojvodanskih Muzeja», Novisad 1954 (?) f. 119.

rakter arkaik. Në këtë kompleks karakteris-
tikash arkaike duhet futur edhe përdorimi
i «kërdhoklës» ai brez i fortë e i gjerë (afër-
sisht 18-20 cm.) që mbulon mesin.

Karakteristikat që përmendëm e bëjnë
xhubletën të dallohet në shumë drejtime nga
 shumica dërrmuese e veshjeve të tjera po-
pullore në vendin tonë.

E përdorur vetëm nga shqiptarët në një
zonë të ngushtë rrëzë alpeve⁵, jo vetëm
brenda kufijve të sotëm të atdheut, por
edhe në shqiptarët e Malit të Zi e ata të
Rugovës në Kosovë, me vetë pamjen dhe
prerjen e saj të jashtëzakonshme, që nuk
gjen paralele të gjalla në vise të tjera të
Ballkanit, ajo ka tërhequr me kohë vë-
mendjen e studiuesve. Hëpërhë nuk njihen
paraqitje figurative të xhubletës përpara
shek. XIX dhe përshkrimit të Kordinezit
për shek. XVIII. Kjo mangësi e vështirëson
gjurmimin e origjinës së saj, por nuk e
bën të pamundur.

F. Nopça, i cili, si dihet, i ka gjurmuar
mjaft kostumet e Shqipërisë së Veriut, i ka
kushuar vëmendjen edhe xhubletës. Ai
shkruan: «Xhubleta në pikëpamje kostu-
mologjike është shumë interesante, për ar-
syse se përkon kryekëput me veshjet në for-
më fundi, të njohura nga disa terrakota të
zbuluara në Sërbi dhe me gema të shumta
të Mikenës, pastaj me objekte të Kretës.
Terrakota sërbe (e gjetur në Kliçevaç —
A. Gj.) tregon se në të gjitha këto raste
kemi të bëjmë, si e theksojnë Hërnës
(Hoernes), Uaid (Wide), Evans dhe Vasic
(Vasits), me një veshje në formë këmbane,
të njohur që nga koha e vjetër.»⁶

Rr. Zojzi në kumtesën e tij «Mbi veshjet
tradicionale të popullit tonë»⁷ mbështet plo-
tësisht mendimin e Nopcsës mbi prejardh-
jen e xhubletës nga qytetërimi kreto-mike-
nas. Këtë mendim e kanë pranuar edhe disa
autorë të tjerë si Haberlandt, Garashanin
(Garašanin), Kovaçević etj.

Duke i shtyrë më tej mendimet e shpre-
hura nga autorët e lartpërmendur mbi li-
dhjet e xhubletës tonë më një anë dhe figu-
rinës së Kliçevaçit më anë tjetër, do të the-
mi se V. Trbuhoviç, që i kundërshton këto
lidhje, gabon rëndë kur thotë se «Nuk ka

asnjë ngjashmëri midis këtyre dy veshjeve
sepse në veshjet e fiseve shqiptare (është
fjala për Kastratin e Kelmendin — A. Gj.)
nuk ka asnjë përparje (dhe ky është ele-
menti më interesant i idolit të Kliçevaçit),
pastaj xhubleta e Kastratit dhe e Kelmendit
është monokrome dhe pa ornamente⁸.
Në fakt ngjashmëritë midis veshjes me
xhubletë dhe figurinës së Kliçevaçit janë
me të vërtetë «frapante» si i pati karakte-
rizuar Garašanin. Kështu rreshtat e trekën-
dëshave me viza, në shpatullat e figurinës
duhen interpretuar pikërisht ashtu si thotë





Fig. 138 — Figurina e Kliçevaçit (Jugosllavi) mi-
jëvjeçari i dytë p. e s. (skicë e pamjes përpara a)

5) Që nga fillimi i shek. XIX xhubleta shihet edhe në zonat bregdetare
midis Matit e Bunës, ku janë vendosur herë pas here malësorë të zbritur nga
Malësia e Madhe (rrethi i Shkodrës).

6) F. Nopcsa, *Albanien*. f. 215.

7) Rr. Zojzi, *Mbi veshjet tradicionale të popullit tonë* në: «Studime His-
torike», Tiranë 1965, nr. 4, f. 151.

vetë Trbuhović, «si paraqitje zbukurimi të thakëve». Tek veshja e gruas me xhubletë këto janë thakët që ka xhoka tek lapat e supeve (shih fig. 138 a, b...). I njëjti element zbukurimi shihet edhe tek përparja e figurinës. Dhe përsëri Trbuhović tregon se nuk është interesuar t'i njohë sadopak kostumet e grave malësore sepse, përndryshe, do të kishte parë në to shumë përparje të dekoruara me motive të pasura e të zbuçruara anëve me thakë. Ato që u thanë më lart mbi karakterin e zbuçrimeve të xhubletës e mbi ngjyrat e shumta të përdorura në to, tregojnë se Trbuhović përsëri gabon rëndë kur pretendon se xhubleta është njëngjyrëshe dhe pa ornamente.



Figurina e Klicevacit (skica b) (pamje prapa)

Figurina e Klicevacit, e cila i përket kohës së bronzit, pra mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, është një dëshmi, jo vetëm shumë e hershme, por edhe mjaft e plotë, e cila mund të konsiderohet një paraardhëse e hershme e xhubletës sonë. Përmjet saj mund të shihen edhe lidhjet me figurina të tjera analoge të gjetura në brigjet e Mesdheut, që përfaqësojnë kultura shumë të lashta të kësaj treve.

Që largësia kohore midis figurinës së Klicevacit dhe xhubletës sonë të mos duket e pakapërcyeshme, duhet ta shohim pak në pikëpamje etnografike karakterin e xhubletës.

Ç'mund të themi për formën e saj?

Një fund disi i gjatë, në formë kambane të valëzuar, që lë zbuluar një pjesë të mirë të trupit, sidomos krahët e supet, në qoftë se nën të nuk vishet një këmishë apo një bluzë. Këto karakteristika të shtojnë që djepin e saj ta kërkojnë në vende me klimë të butë, si ishin brigjet e Mesdheut. Edhe ngjyrat e saj të forta (e kuqe, portokalle etj.) pajtohen me këto rrethana, si edhe ornamentet e shumta dhe arkaikë të saj.

Po ashtu ajo ngurtësia relative e saj gjen analogji të dukshme në paraqitjet e veshjeve tek qytetërimet e lashta të Mesdheut Lindor (egjiptiane, asire etj.).

Fakti që në shekujt e fundit xhubletën e gjejmë kryesisht si një veshje zonash mallore shpjegon disa transformime dhe përshshatje të saj si janë: varfërimi i ngjyrave shoqërimi i saj me veshje të sipërme të rënda për dimër etj. Por këto zona të thella mallore ku ka arritur të mbijetojë xhubleta, duhen menduar si bastioni i fundit, rezultat i tkurrjes së vazhdueshme të popullsisë nga rrebeshet historike të kohëve, ndërsa rrënjët e historisë së banorëve të këtyre viseve duhen kërkuar poshtë në zonat e ulëta. Një argument për këtë është edhe vetë xhubleta e tyre, procesi i gjenezës të së cilës nuk mund të jetë zhvilluar veçse në zona me klimë të butë.

Për këto arsye, xhubleta, si një veshje me karakteristika shumë specifike, meriton vëmendje dhe analiza të mëtejshme. Ajo qëndron para nesh si një dëshmitare e rrallë qytetërimesh të lashta, të cilën ende nuk e kemi bërë të flasë aq sa duhet.

Edhe pse gjeneza e saj s'mund të konsiderohet thjesht ilire, për shkak të analo-

8) V. Trbuhović, *Plastika Vrasacko-Zutobrdske kulture grupe*, «Starinar» novaja serija, nr. VII-VIII, 1956-1957 f. 137.

gjive që paraqet me disa tipare të veshjeve të qytetërimit kreto-mikenas, s'ka dyshim se xhubleta ka qenë një veshje që ka jetuar për shekuj në qytetërimin ilir, është integruar në të dhe, me sa dihet deri më sot, i është përcjellë përmes shekujve kulturës popullore shqiptare dhe vetëm asaj.

Së fundi pak fjalë për emrin e këtij elementi, i cili tek ne thirret «xhubletë» ose «gjupetë» dhe deri tani nuk njohim për të ndonjë sinonim a paralele tjetër. Fjala «xhubletë» është përdorur, në disa zona, për të treguar edhe ndonjë element tjetër veshjeje. Kështu në Zadrimë thirrej me këtë emër një fund pëlhere të hollë të leshtë, me pala të dendura. Në Vasojeviqët e Malit të Zi, «xhubletë» ose «oblanjë» quhej një këmishë e gjatë gruaje që bëhej prej një pëlhere të leshtë të punuar në shtëpi, e cila ishte e zbukuruar me qëndisje të shumta.⁹ Kurse në rrethin e Kukësit, thirrej gjupetë një këmishë burri prej pëlhere leshi. Pra emri i saj relativisht i vonë, duket se lidhet kryesisht me faktin se xhubleta ishte një veshje e bërë prej pëlhere të leshtë.

B R E Z A T

Brezi shfaqet që në periudhën prehistorike dhe ka patur një përdorim universal; atë e kanë mbajtur edhe popujt e zonave të nxehta që nuk mbajnë veshje.

Brezi ishte një element i pamungueshëm në veshjet tona popullore, si për burra dhe për gra. Ai kryente funksione të ndryshme, që vareshin nga forma, madhësia dhe paraqitja e tij, ndër të cilat kryesore ishin funksioni mbrojtës dhe ai dekorativ. Shumë herë brezi shërbente edhe si një mjet për të mbajtur ngjeshur pas trupit pjesë të ndryshme të veshjes.

Tek ne janë mbajtur breza të shumëllojshëm, ndër të cilët ka edhe disa me origjinë të lashtë. Këto forma të ndryshme brezash po i analizojmë më poshtë të ndarë në dy grupe të mëdha, që mendoj se du-

hen konsideruar si tipa më vete: I. — Brezat që mbështillen disa herë rreth belit dhe II. — Brezat që e qarkojnë belin vetëm njëherë, format dhe karakteristikat e të cilëve do t'i paraqesim veçmas për gra e për burra.

Konstatimi i parë, që bie në sy menjëherë, është se brezat e grave janë më të shumëllojshëm se ata të burrave.

I. — Në brezat e tipit të parë, të cilët mbështillen disa herë rreth trupit, do të përmendim dy variante.

Brezat «me rrema», të njohur vetëm në një zonë të vogël të rrethit të Krujës, të cilët janë nga brezat më të hershëm që njihen në vendin tonë. Ata bëheshin me një tufë gjalmash leshi të dredhur mirë (28-40 fije), të lidhur njëri me tjetrin vetëm në njërin skaj. Gjatësia e tyre arrinte 4-5 metra (fig. 139). Në shekullin tonë ata mbahehin vetëm nga gratë dhe zakonisht me ngjyrë të kuqe ose vishnje¹⁰; ngjisheshin mbi këmishën e gjatë të bardhë. Brezat «me rrema», janë nga brezat më arkaikë, të cilët në kohë të vjetra pa dyshim bëheshin me çfarëdo fije vegjetale.



Fig. 139 — Brez me «rrema»

Të ngjashëm me ta janë brezat e përdorur në veshjen e grave të zonës së Bihaç-it (veshje e tipit dinarik) në Bosnjën Veriperëndimore¹¹ dhe nuk dimë të jenë hetuar në ndonjë vend tjetër në Ballkan. Të tillë breza janë mbajtur edhe në disa vise të Afrikës Veriore.¹²

2) Varianti tjetër është ai i brezave të endur në avlemend me teknika të ndryshme

9) Shih për këtë, M. Vlahovic, *Zenska nosnja u Vasojevicima* në «Glasnik etnografskog muzeja u Beogradu, IX, 1934, f. 71-74.

10) Shih objektin me nr. inv. 9138 në F. E., Tiranë.

11) M. Draskic, *Narodne nosnje severazapadne Bosna*, Zenica 1972, f. 18, Tabela D, 3.

12) Sipas L. Saada, *Contribution à une recherche pluridisciplinaire sur la ceinture masculine et féminine*, në: «Vêtements et Sociétés», Paris 1981, f. 232.

pune, me gjerësi të ndryshme, dhe me gjatësi 2-3 metra.

Ndër brezat më të gjerë të këtij varianti mund të përmendim brezat e grave të Mokrës (rrethi i Pogradecit), ata të rrethit të Librazhdit dhe të zonave verilindore të rrethit të Elbasanit deri te Gryka e Zaranikës si edhe ata të rrethit të Dibrës etj. gjerësia e të cilëve arrinte 20-26 cm. (fig. 140).




Fig. 140 — Brez leshi i endur

Shumë të përhapur për gra ishin brezat e leshtë ose të përzier me pambuk, me gjerësi të mesme 6-8 cm. Të tillë ishin p.sh. brezat që mbaheshin në Shpat e në Dumre të rrethit të Elbasanit, në Myzeqe, në Fushë-Krujë dhe në Mirditë, në Zadrimë, e në Breg të Bunës, në Postribë etj. (fig. 141).

Breza fare të ngushtë, 2-3 cm. që ishin më fort në funksionin e lidhzave, përdorshin vetëm më pak zona, duke u lidhur mbi një brez të gjerë ose të mesëm, për ta fiksuar më mirë atë. Ndër këta mund të përmendim «*licat*» e zonës së Kallmetit¹³, «*shokëzat*» fare të holla të Anës së Malit (rrethi i Shkodrës)¹⁴ etj.

Të gjithë këta breza të endur në avlemend mund të ishin punuar thjesht me fije leshi ose edhe të kombinuar me fije pa-




Fig. 141 — Breza leshi e pambuku (Zadrimë, Fushë-Krujë)

mbuku. Ata që punoheshin me katër lisa kishin më tepër elasticitet se ata të punuarit me dy lisa. Brezat rriheshin më fort me drasëzë sesa me krëhër. Përsa i përket ngjyrës mund të themi se në shekullin tonë mbizotëronte ngjyra e kuqe (me tone më të errëta ose më të çelura) e kombinuar me ngjyra të tjera. Po kishte edhe breza në ngjyrë të zezë.

Zbukurimi më i zakonshëm për brezat e grave ishin vijat me ngjyra të ndryshme, që përshkonin të dy anët e brezit së gjati, por shumë herë krerët zbukuroheshin edhe me vija së gjeri. Skajet e brezit nuk përthyeshin, por fijet e majës liheshin si tufa 10-15 cm. të gjata. Kishte edhe zona, megjithatë, ku brezat zbukuroheshin vetëm me vija së gjeri, si p.sh. në Zadrimë, në Breg të Bunës etj.

Në disa krahina brezat kishin edhe zbukurime të tjera karakteristike. Le të përmendim këtu brezat me thekë ose tufa në pjesën e prasmë të belit, që përdorshin në Mirditë. Këto tufa ishin shumë dekorative dhe spikatnin bukur mbi sfondin e bardhë të këmishës (fig. 142) Si e përmendëm më lart, këto elemente zbukurimi kanë një moshë shumë të lashtë. Në Mokër të Pogradecit brezat qarkoheshin me «vetullore», një lloj

13) Shih. Rr. Zojzi, *Veshje popullore të rrethit të Lezhës*, Buletin i USHT, Tiranë 1958, nr. 3, f. 230.

14) Shih shokzën me nr. inv. 7911, nga Kakarriqi (dy fije gërshet i thurur me lesh ngjyrë të kuqe e vishnje; gjatësia 296 cm.)




Fig. 142 — Brez me tufa prapa (Mirditë)

fistoni i trashë i bërë me penjë leshi. Një lloj tjetër zbukurimi ishte ai me aplikime pjesësh metalike (zakonisht prej tunxhi të derdhur, me zbukurime motivesh gjeometrike me incizim ose me të rrahur), të cilat i viheshin brezit në pjesën e përparme të tij. I tillë ishte rasti i disa brezave të gjerë të Çermenikës e të Labintit (në rrethet e Elbasanit e të Librazhdit) (fig. 143), apo në Mat e Mirditë¹⁵ etj.




Fig. 143 — Brez gruaje me zbukurime metalike përpara (Shmil, rr. Elbasan)

Breza tekstili, të endur në vegël me teknika të ndryshme pune kanë përdorur edhe arbëreshët e Greqisë¹⁶ dhe ata të Italisë.

Po të këtij tipi, por me ndryshime në dekorin e tyre janë shumica e brezave të përdorur nga gratë e viseve të tjera ballkanike.

II. — Brezat e tipit të dytë që e qarkonin vetëm një herë belin, kanë qenë më pak të përhapur se ata të tipit të parë. Variantet e këtij tipi paraqesin interes si nga llojet e ndryshme të materialit që përdorej (lëkurë, tekstil, metal etj.), ashtu dhe nga format dhe zbukurimet e tyre.

1) «Kërdhokla» është pa dyshim një nga format më interesante të brezave në Shqipëri. Në Shllak, Berishë e Mërtur, ajo kishte formën e një trapezi me përmasa më të vogla (20-22 cm. x 60-70 cm. baza e poshtme) se ajo që mbahej në Malësinë e Madhe dhe në malësorët e rënë në fushën e Zadrimës ose në breg të Matit. Madje do të ishte më e arsyeshme që ajo të konsiderohej më fort si një element i veshjes për të mbuluar ijët sesa një brez i vërtetë. Le të vëmë në dukje se krahas kërdhoklës mbahej edhe një brez i ngushtë lëkure me pafta për gratë e reja.

Kërdhokla e Malësisë së Madhe ishte si një brez i plotë me gjerësi 17-19 cm. që qarkonte belin e përfundonte me formë këndi të ngushtë. Mbërthehej me kapsa të ndryshme metalike. (fig. 144 a, 6).



Fig. 144 — (a) breza gruaje prej shajaku (kërdhokël)

Kërdhokla bëhej zakonisht me 7-8 ose më shumë copa të vogla¹⁷ shajaku të bardhë ose të zi dhe me rreshta të shumtë gajtani midis tyre, me një strukturë mjaft të komplikuar, po ashtu si edhe pjesët e tjera të kostumit në të cilin bënte pjesë xhubleta, përparja, kraholi etj.). Zbukuroheshin me motive specifike për zonën, që kishin një pamje shumë arkaike.

15) Sipas A. Haberlandt, *Volkskunst der Balkanländern*, Wien 1917, f. 22, fig. 8.

16) Shih: *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, vëll. I, Tiranë 1962, f. 99, 112 (Reinhold 1855).

17) Kërdhokla nr. inv. 6578, me përmasa 19 x 116 cm. është e përbërë prej 20 copash të vogla. FE. Tiranë.



Fig. 144 b (kërdhokël)

2) *Brezat prej lëkure* që kanë përdorur gratë, kanë qenë dy llojesh:

a) Të ngushtë rreth 6-7 cm., të zbukuruar me tokëza, sumbulla e pafta të ndryshme tunxhi, sidomos përpara. Interes të veçantë paraqesin unazat treshe që kanë këta breza në pjesën e poshtme të tyre, prej të cilave vareshin vargje zinxhirësh dekorativë (shih fig. 145). Si e kanë provuar gjetjet e ndryshme arkeologjike këto kanë një moshë të vjetër¹⁸ dhe dëshmojnë për lidhjet e ngushta iliro-shqiptare në këtë fushë të kulturës materiale.

b) Breza lëkure të gjerë, të mbuluar në pjesën e sipërme krejtësisht me plumbça të vegjël; të vendosur në mënyrë dekorative. Këta breza me gjerësi 18-20 cm. dhe të gjatë rreth 12 cm. përdoreshin ekskluzivisht me kostumin e xhubletës.

3) *Breza tekstili me pafta metalike* e sumbulla të ndryshme në pjesën e përparme, ku mbërtheheshin. Në këtë grup do të përmendim, a) për zbukurimet e tyre tipike prej tunxhi, brezat e gjerë të grave që mbaheshin në disa zona të rretheve Elbasan e Librazhd (p.sh. në fshatrat Godolesh, Labinot e Shmil) të cilët arrinin 15-20 cm. gjerësi.

b) Një pamje tjetër paraqitnin brezat e grave të shumë krahinave të Jugut. Ata ishin me një gjerësi mesatare (6-8 cm) dhe mbërtheheshin përpara me pafta dekorative formash të ndryshme, madhësia e të cilave ndryshonte nga një zonë në tjetrën (fig. 145 a, b).

4) *Breza krejt prej metali* përdoreshin pothuaj vetëm në veshjet qytetare. Këta breza ishin zakonisht prej argjendi ose të larë me argjënd bile edhe me ar. Kishin kryesisht një funksion dekorativ dhe sho-



Fig. 145 — Brez lëkure me unaza treshe e zinxhira (Foto Marubi)

qëronin zakonisht veshje mëndafshi, kadi-feje ose cohe të kushtueshme. Ata ishin punë të holla të mjeshtërve më të mirë argjendarë të vendit. Në familjet e pasura ato liheshin trashëgim nga një brez në tjetrin.

Të tillë breza të çmueshëm për gratë




Fig. 146 — (a), Brez i gruas së Lunxhërisë (dy pafta)

18) Shih «Historia e Shqipërisë» f. 107. dhe Hëna Spahiu. *Disa stoli metalike*, etj. në «Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike» vëll. II, Tiranë 1969, f. 247-252, me IX tabela ilustrime.




Fig. 146 b. Brez gruaje (Lunxhëri)

ë shtresave të pasura të vendit, i gjejmë të përmenden që në fund të shek. XIV¹⁹. Në shekullin XVIII, si e kemi parë, ata vazhdonin të përdorshin edhe në kostumin e arbëreshëve.²⁰

5) Në jug të vendit përdorshin breza të qëndisur me fije argjendi, që përpiqeshin të imitonin brezat prej filigrane, (këta breza kishin ndonjëherë tokëza të vogla metalike për t'u mbërthyer përpara apo brezat prej kadifeje të qëndisur me ar, që kanë qenë përcorur në vjetërinë e Beratit. Si nga ngjyra ashtu edhe nga motivet e përdorura, ata qenë në pajtim të plotë me veshjet që shoqëronin (jelekët, sakot etj.)

b) Brezat me rruaza të vogla, të punuar nga vetë gratë fshatare. Këta nuk kishin më tepër se 3-4 cm. gjerësi dhe mund të themi se kishin më fort një rol dekorativ, sepse gratë mbanin edhe një brez të gjerë të leshtë. Të tillë breza shohim në kostumin e grave të Hasit (Kukës dhe Kosovë), në rrethin e Gjirokastrës pastaj në zonën e Prespës (rrethi i Korçës) etj.

Për të përfunduar paraqitjen e llojeve të ndryshme të brezave për gra, do të shtojmë se në shekullin tonë, si pasojë e evoluimit të mëtejshëm të veshjeve popullore dhe e transformimeve që pësuan ato, brezi filloi të zhvishej pothuaj krejt nga simbolika e dikurshme e tij dhe kështu, vende-vende, ose u eliminua fare ose mbeti vetëm si një brez dekorativ. Në kohën tonë brezat për gra ruhen vetëm atje ku mbahen kostumet popullore.

*
* * *

Brezat e burrave paraqiten në po ata tipa, por me variante më të pakta se ata të grave.

Tipi I. — Brezat prej tekstilësh të leshta që mbështilleshin shumë herë rreth belit. Punoheshin me fije leshti të hollë e të dredhur mirë dhe ishin zakonisht më të gjatë se ata të grave.

Në shumë zona këta breza, mbaheshin të bardhë, të thjeshtë ose me vija të holla të zeza. Të tillë breza janë mbajtur në pjesën më të madhe të Shqipërisë së Jugut. Gjatësia e tyre arrinte në 4-5 m., kurse gjerësia 25-30 cm. Nga fundi i shekullit të kaluar brezat e leshtë filluan të bëhen me ngjyra, fusha e kuqe me vija të holla të bardha ose ndonjë ngjyrë tjetër, por të moshuarit vazhdonin t'i mbanin të bardhë. Ky ndryshim në brezat e punuar në shtëpi nga vetë gratë fshatare, duket se u bë krahas përhapjes së brezave me ngjyra të fabrikuar në Shkodër (fig. 147), të cilët u shtrinë me shpejtësi jo vetëm në Shqipërinë e Mesme, por edhe më poshtë drejt jugut. Me ngjyrat e tyre të forta (portokall, të gjelbër, të verdhë etj.) këta breza gjallëronin mjaft pamjen e kostumit të burrave, që kishte si ngjyra bazë të bardhën e të zezën.




Fig. 147 — Brez burri punuar në Shkodër

Brezat e leshtë të burrave, vazhdojnë të mbahen edhe në ditët tona në shumë kra-hina edhe pse kostumi popullor mund të jetë lënë ose të jetë transformuar. Kjo lidhet pa dyshim me funksionin praktik të tyre.

Burrat e shtresave të pasura, sidomos në rrethin e Shkodrës, të Dibrës etj. mbanin

19) Shih, *Acta et diplomata res Albaniae*, vëll. I dok. 35,37, 218; vëll. II, dok. 454, 464.

20) Dorëshkrim i Kieutit 1737.

breza mëndafshi (me 3 fletë), me ngjyra të ndryshme që ishin rreth 3 m. të gjatë.

II. — Në brezat e tipit të dytë, për burra kemi vetëm një variant *silahet* (fig. 148). Silahu përbëhej prej disa fletësh lëkure në formë pothuaj të një katërkëndëshi kënddrejtë (40 cm. x 25 cm), të qepura anëve njëra mbi tjetrën, në mënyrë që të formonin disa të ndara të veçanta si xhepa. Silahu mbulonte vetëm pjesën përpara të belit dhe mbërthehej prapa me dy rripa të ngushtë lëkure dhe një tokëz të thjeshtë. Faqja e sipërme e silahut, ishte, në të shumtat e rasteve, e zbukuruar me qëndisje me fije ari.




Fig. 148 — Silah lëkure i qëndisur

Silahu ngjishej gjithnjë përmbi brezin e gjatë. Që nga Shpallja e Pavarësisë (viti 1912), silahet pothuaj nuk janë mbajtur më; ato dolën nga përdorimi së bashku me kostumin me fustanellë.

*
* *
*

Pasi shqyrtuam format kryesore të brezave të përdorur në Shqipëri për gra e për burra, le të shohim disa funksione e shenja të veçanta të tyre. Në bazë të gjetjeve arkeologjike ekzistuese do të përpiqemi, gjithashtu, të themi diçka për lashtësinë e disa formave të brezave.

Ky element i veshjes, i vendosur në një pjesë delikate të trupit të njeriut, e ndan atë në dy pjesë: nga brezi e lart e nga brezi e poshtë dhe s'mund të jetë një përputhje e rastit që ai emërtohet me të njëjtën fjalë si edhe pjesa e trupit ku vendoset.

Brezi shënon një cak, një kufi në trup, ai është rruga e kalimit nga lart poshtë, nga veriu në jug. Shumë besime e rite lidhen me këtë kufi, çka lejohet e çka jo, prandaj edhe në moralin popullor konsiderohet si një gjë e turpshme që gruaja ta hiqte brezin në prani të personave të tjerë. Përkundrazi ajo duhet të kujdesej që ta ngjishte mirë kur dilte nga shtëpia, sidomos sa që e re në moshë.

Deri në një të kaluar jo shumë të largët, brezi me formën edhe ngjyrën e tij, karakterizonte edhe gjendjen civile të gruas. Këtë e tregon, së pari fakti se, në shumë zona, brezat që përdornin vajzat ndryshonin nga ata që përdornin nuset e gratë e martuara. Në Mirditë, vajzat e rritura e mbanin detyrimisht të zi brezin e tyre, ndërsa nuset e reja të kuq, po ashtu dhe vajzat e vogla, kështu që kur vajza vinte brezin e zi donte të thoshte se ajo kishte hyrë në moshë martese (13-14 vjeçe). Në zonën e Kallmetit (rrethi i Lezhës) licin e hollë e mbanin vetëm gratë e martuara. Madje deri në prag të Çlirimit ekzistonte një zakon i tillë: rreth një ose dy jave mbas martese, kur nusja shkonte për herë të parë në gjini, do të vishej plotësisht me rrobet e vajzërisë, por përmbi brez do të lidhte licin, si e vetmja shenjë që tregonte se ajo ishte tashmë një grua e martuar.

Në Mirditë kur burri desh ta ndante gruan i priste asaj disa nga thekët (a tufat) e brezit dhe e kthente në gjini²¹.

Në lidhje me brezin e burrave ekziston një shprehje popullore që thotë: «X-i snkon me brez lëshuar», pra është njeri kapadai e grindavec që kërkon sherr (e lëshon vetë brezin e tij të gjatë që t'ia shkulin kalimtarët e pastaj të grindet me atë që ia shkeli). Ky është një zakon që njihet që në qytetërimin e lashtë grek.

Heqja e brezit dhe varja e tij në qafë ishte shenjë e një pendimi të thellë të fajtorit. Kështu tregohet se Moisi Golemi,

21) Për këtë shih më gjatë tek A. Gjergji, *Ndryshime morfologjike artistike në veshjet popullore*, në «Etnografia Shqiptare» VIII, Tiranë 1976, f. 12 dhe *Kanuni i Lek Dukagjinit* (Paragrafi 33 Thaku prem.).

pasi e kish tradhtuar Skënderbeun, u pendua dhe erdhi përsëri; ai i doli përpara Skënderbeut me brezin në qafë, pra i çburëruar dhe gati të pranojë varjen.

Në palat e brezit ruheshin shumë herë sende të vogla ose sende të vlefshme a të fshehta, si në një vend të sigurt. Në koleksionet etnografike kemi bile disa breza që kanë një xhep mjaft të fshehtë, në skajin e brendshëm të tyre, ku burri mbante zakonisht parat.

Të gjitha këto tregojnë se ky element i veshjes me kohë është shoqëruar në mënyrë intensive, në saje të funksioneve të shumëllojshme që kryente jo vetëm për mbrojtjen e trupit, por edhe për të vënë në dukje dallime moshe e seksi, dallime të gjendjes socialklasore, të profesionit e deri tek funksionet e shumta estetike e magjike, në lidhje me seksin etj.

Brezi është një element i lashtë i veshjes, i dokumentuar si tek shqiptarët e hershëm, ashtu edhe tek ilirët në forma të ndryshme të tij. Tokëza të shumta rripash nga koha e mesme na dëshmojnë se brezat e përdorur në shekujt VIII-XII, ishin 4-5 cm, të gjerë²².

Brezat prej argjendi si dhe ata prej rripash stofi 5-6 cm. të gjerë, të qëndisur me fije ari e argjendi (Tipi II, varianti 4,5) ruajnë ende diçka nga luksi bizantin, prej ku duket se e kanë edhe origjinën e tyre.

Moshë më të vjetër kanë brezat e gjerë të zbukuruar me pafta tunxhi (shih fig. 8). Si e kam vënë në dukje edhe gjetiu²³, në vetë motivet e incizuara në këto pafta, shihen analogji mjaft të qarta me ato të ornamentikës ilire. Në gjetjet arkeologjike të kulturës ilire, kemi edhe dëshmi të përdorimit të brezave të gjerë, të zbukuruar sipër me pafta të ndryshme metalike e sumbulla, të ngjashme me brezat e Çermenikës. I tillë është, p.sh., një brez nga Prozori (Dalmacia)²⁴.

Rripa të ngushtë te beli shihen më shumë monumente të kulturës ilire, si p.sh. tek gruaja e Dimalit (fig. 199), tek një fragment relievi i gjetur në Zenice (Jugosllavi)²⁴ etj. Zinxhirët e varur tek brezi, të gjetur në

tumat e Matit, janë krejt të ngjashëm me ata që përdornin deri në fillim të shekullit tonë gratë e Malësisë së Madhe, pra mund të mendojmë se edhe brezi tek i cili vareshin do të ketë qenë i ngjashëm.

Një brez me tufa të varura prapa, shumë i ngjashëm me atë të grave mirditore, është paraqitur qartë tek statueta neolitike e Kliçevaçit, (fig. 138). Mendoj gjithashtu se një paraqitje të brezit «me rrema» mund ta konsiderojmë atë tufë vijash të dendura tek beli, në disa fragmente statuetash të gjetura në stacionin neolitik të Maliqit (rrethi i Korçës).²⁵

F U T A T

Do të shqyrtojmë këtu jo vetëm futat që viheshin përpara (përparjet), por edhe futat e ndryshme që viheshin prapa (mbrapanikët), sepse ato kanë shumë tipare dhe funksione të përbashkëta.

Përparja ka qenë një element që plotësonte në mënyrë të detyrueshme strukturën e veshjes së gruas. Në veshjet popullore për gra, përparja ishte pjesë e pamungueshme, me rëndësi të madhe praktike dhe me funksione të rëndësishme estetike e magjike. Ndërsa nga përmasat dhe dekori futat paraqitnin veçori të shumta lokale nga një krahinë në tjetrën, nga mënyra se si kombinoheshin me pjesët e tjera të veshjes ato mund të merren si element përcaktues për të karakterizuar tipa të ndryshëm veshjeje. Sikurse e kemi vënë në dukje në kreun mbi klasifikimin e veshjeve, përparjet nuk shoqëronin vetëm këmishën e gjatë, por edhe xhubletën dhe, në kohë më të vona, arritën të shoqërojnë edhe brekushet e dimitët.

Në Shqipëri, si thamë, kemi pasur futat që viheshin përpara dhe futat që viheshin prapa. Si për të parat, ashtu edhe për të dytat kanë qenë përdorur një varg emërimesh që ndryshonin nga një krahinë në tjetrën e që kanë ndryshuar edhe nga një

22) Shih materialet e ekspozuara në Muzeun Arkeologjik të Tiranës.

23) Shih A. Gjergji, *Përkime midis ornamentikës popullore shqiptare e asaj ilire*; në «Kuvendi i I i studimeve ilire», vëll. II, f. 253-254, fig. 10, 11, Tab. V, 3;

24) S. Batevic — O. Ostric, *Tragovi ilirske kulturne bastine u narodne kulture našig premorskog podrucija*. Sarajeve 1969, Tab. 5 fig. 4, për brezin nga Prozori dhe I. Cremosnik, *Nosnja na rimski spomenicama u B. CH*, f. 116, fig. 7.

25) Këto fragmente ruhen në Muzeun Arkeologjik të Tiranës.

periudhë kohe në tjetrën. Kështu futat që viheshin përpara thirrshin: përparje ose përparëse, a përparcë, paranik, futëparës, futare, futurak, barkore ose bërkore, prehër, pështjellak ose pshtjellak i parë, shpellak, faqore, peshqir, bohçe, peshtemall, stravecë, skutë, neçë, pregaç, postaq, postavë, tavolone, mësallë etj. Disi më të pakta kanë qenë emërtimet për futat që viheshin prapa: futëmbrapës, mbrapse, bythcak ose bythecë, prapanik, pshtjellak i prapmë, postavë e vogël, kanac, rrudhak etj.

Ky varg i gjatë emrash që hasim në vende dhe kohë të ndryshme vjen për shkak se ashtu si e kanë treguar gjurmimet e deritanishme — përparjet në kostumet e zonave të veçanta, kanë njohur një evoluim të vazhdueshëm, herë krahas me pjesë të tjera të veshjes, herë jo. Për këtë arsye gjejmë, në të njëjtën zonë, forma të ndryshme futash, që kanë zëvendësuar njëra-tjetrën, duke ndërruar, në të shumtët e rasteve, edhe emrin.

Futat në Shqipëri përgatiteshin më fort me pëlhura të ndryshme leshi ose pambuku, më rrallë prej liri, kërpi ose gjineshtre, të punuara nga vetë gratë fshatare në avlemend, përgjithësisht me dy lisa (aty-këtu edhe me katër). Vetëm në qytetet e Kosovës janë mbajtur përparje të bëra prej fijesh mëndafshi të kombinuar me fije leshi të importuar (lesh deveje), me ngjyra.

Më të thjeshtat ishin pëlhurat njëngjyrëshe, të bardha ose të zeza, si p.sh., «peshqirat» e Mokrës, përparjet e Hasit, poshterkat e Kacnisë etj., por kanë qenë përdorur edhe pëlhura me ngjyra të forta: të verdhë ose të gjelbër, si p.sh. «pregaçët» e dikurshëm të Devollit, të Fushës së Korçës etj. Pëlhurat e përgatitura për futa ishin në disa zona, të rralla e të rrahura lehtë (si p.sh. në Has, Zadrimë) në të tjera shumë të vejtura, endur me fije të tjerë shumë hollë e të rrahura mirë, (si në Pogon, Gollbordë, Kukës etj.).

Nga pikëpamja e dekorit mund të vëmë re se, për futat përdoreshin gjerësisht pëlhura me vija ngjyrash të ndryshme ose me tufa vijash dhe, në një varg krahinash, edhe pëlhura të endura me motive shumë të pasura, ngjyrash të ndryshme (të leshta, të pambukta ose të përziera).

Me këtë gamë të pasur pëlhurash konfeksionoheshin futa me përmasa e prerje të ndryshme. Forma e tyre ishte, në pjesën dërrmuese katërkëndëshi por janë mbajtur edhe futa në formë trapezi.

Shumica e përparjeve, që të rrinin mirë

në trup, mblidheshin me pak rrudha ose pala te beli, ose vetëm tek ijet. Nuk kishin të tilla rrudha, përgjithësisht, përparjet me përmasa të vogla e ato që bëheshin me fletën e pëlhurës të vendosur vertikalisht.

Për sa i përket mënyrës se si fiksoheshin në trup do të themi se futat lidheshin për mesi me dy gjalma të dredhura ose me rripa pëlhure që u qepeshin në të dy qoshet e sipërme; në raste të tjera, në një të përthyer të gjerë të pjesës së sipërme kalohej një gjalm, skajet e të cilit lidheshin prapa. Por ka pasur edhe një lloj përparjesh me përmasa shumë të mëdha, të cilat mbështillnin pothuaj gjithë trupin e lidheshin prapa jo me gjalmë, por me dy çipat e sipërm të tyre, si p.sh. bohçet e grave katolike të Shkodrës etj. Në disa zona ku futat ishin me përmasa të vogla, ato nuk ngriheshin lart deri te beli, por liheshin të vareshin më poshtë tek barku (përparjet) ose tek vithet (prapanikët), si p.sh. në Çermenikë, në Has e në shumë zona të Kosovës. Ky detaj ka rëndësi, sepse dëshmon për funksionin primar të përparjeve arkaike si mbulesë për prehrin.

Shqyrtimi i vëmendshëm i disa qindra përparjeve (qofshin ato që kemi parë në terrren gjatë ekspeditave të shumta në zona të ndryshme të vendit, qofshin ato që ruhen në koleksionin e pasur të veshjeve të Fondëve etnografike në Tiranë) na ka treguar se, që të mund të zbulojmë sa më mirë veçoritë e futave duhet t'i vëmë rëndësi jo vetëm formës (që sikurse thamë është përgjithësisht ajo e një katërkëndëshi), por edhe drejtimit të vendosjes së materialit, me sa fletë (ose copa) është bërë futa, lidhjes me elementet e tjera të veshjes etj.

Mund të dallojmë kështu katër grupe:

- 1) Futa me vendosje vertikale të materialit (së gjati trupit).
- 2) Futa me vendosje horizontale të materialit (së gjeri trupit).
- 3) Futa me shumë copa, të vendosura në drejtime të ndryshme.
- 4) Futa me forma të modernizuara.

1. Brenda grupit të parë mund të dallojmë dy variante: a) futa me një ose më shumë fletë pëlhure dhe b) futa me një fletë pëlhure e dy kinda anësore për fundi, që i jepnin asaj formën e një trapezi.

a) Futat e variantit të parë kishin përgjithësisht përmasa të vogla dhe plotësoheshin shumë herë me thekë të gjata anëve. Do të hynin në këtë variant: stravecet e vje-

tra të Mirditës (fig. 149), skutat e Çermenikës (fig. 150), Disi më të mëdha ishin përparjet e vjetra të Leshnicës e të Dropullit (rrethi i Gjirokastrës), përparjet bardhë e zi të Zerqanit (rrethi i Dibrës) (fig. 151). dhe përparjet e zonave malore të rrethit të Tiranës (Shupal, Qafmollë), që kishin përmasa edhe më të mëdha. (fig. 152). Në këtë variant binin në sy për diferencën e theksuar midis gjatësisë e gjerësisë së fletës së pëlhurës së përdorur, përparjet e pambukta të zonës së Kallmetit (rrethi i Lezhës).

heshin në kostume të tipit me këmishë të gjatë e një përparje.



Fig. 149 — Stravecë (Mirditë)

Futat me dy fletë së gjati, me sa tregojnë materialet, duket se nuk kanë qenë shumë të përhapura. Ato janë përdorur deri vonë në Postribë (rrethi i Shkodrës), në Pogon (rrethi i Gjirokastrës), në veshjen e grave ish myslimane të Mokrës etj. Vetëm në një rast, në një ekzemplar nga Lini (rrethi i Pogradecit), që ruhet në fondet etnografike²⁶, përparja është bërë me tri fletë të vendosura së gjati.

Përparjet e këtij varianti, me përjashtim të atyre të Kallmetit e të Postribës, mba-



Fig. 150 — Përparje (Çermenikë).




Fig. 151 — Përparje (Zerqan)

26) Objekti me nr. inv. 8044 në FE, Tiranë.




Fig. 152 — Përparje (Shupal M. e Tiranës)



Fig. 153 — Grua nga rrethet e Tivarit (Marubi 1875, RA-40/19)

b) Dëshmitë më të vjetra për futat e variantit të dytë të këtij grupi, i kemi nga disa fotografi të viteve 1870-1880 (bërë nga Marubi në Shkodër). Ato bëheshin me një copë tekstili në formë katërkëndëshi këndrejtë (ndoshta me fije të bardha e vishnje), vendosur së gjati, së cilës i shtoheshin në dy cepat e poshtëm nga një trekëndësh i vogël (fig. 153), duke i dhënë kështu futës pothuaj formën e një trapezi. Këto futa përdoreshin për t'u vënë një prapa e një përpara, por e prasmja vinte pak më e madhe. Ato duket se janë mbajtur në të gjitha ato zona ku mbahej xhubleta dhe kanë dalë me kohë nga përdorimi.

Formë trapezi kanë pasur edhe përparjet prej cohe ose shajaku të kuq, të stolisur me gajtan të zi, që mbaheshin në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Korçë (fig. 154) e më vonë në shumë fshatra të këtij rrethi. Në fondet e sektorit të etnografisë ruhen disa përparje me këtë formë, që mbajnë të shënuara data të ndryshme nga viti 1884 deri më 1909 në lidhëzat e tyre. Ato janë përdorur deri rreth vitit 1920.

Pak më vonë kanë filluar të mbahen përparjet në formë trapezi, të bëra prej



Fig. 154 — Përparje e vitit 1884 (Korçë)

kadifeje ngjyrë vjollcë, me gajtan ari ose mëndafshi të verdhë përçark, në shumë zona të rrethit të Gjirokastrës e të Sarandës (Dhrovjan, Leshnicë, Muzinë etj.), që zëvendësuan përparjet e mëparshme në formë katërkëndëshi kënddrejtë, dhe që arritën në përdorim aty-këtu deri në prag të Çlirimit të vendit.

Vëmë re se përparjet në formë trapezi të këtij grupi hynë në përdorim vetëm në kostumet me cibun (ose shegun) shajaku, që kishte kinda të gjera verëf nga mesi e poshtë. Pra ato ishin në pajtim të plotë me siluetën e kostumit në përgjithësi dhe duke qenë më të gjera poshtë e më të ngushta lart, kontribuonin për ta theksuar më mirë edhe në pjesën e përparme të trupit, belin e hollë.

2. — Në grupin e dytë kemi përfshirë përparjet me vendosje horizontale të materialit (së gjeri trupit), të cilat janë shumë të përhapura në Shqipëri.

Po përmendim disa nga variantet më tipike:

a) Me një copë fare të vogël tekstili (8 cm. x 20 cm.) shumë të dekoruar, të vendosur horizontalisht dhe të plotësuar në tri anë me thekë të gjata, bëheshin rrethocat ose stravecat e shkurtra të Mirditës, sidomos që nga fillimi i shekullit tonë e këtej, kohë kur stravecat e mëparshme me vendosje vertikale të materialit filluan të dalin nga përdorimi ose të mbahen vetëm për nusëri e për zi. Kjo me sa duket, ndodhi krahas futjes në përdorim të rregullt të këmishave të gjata për gra.

Po të këtij tipi ishin edhe «futëprapsit» e veshjes së zhdukur të Pdhanës (rrethi i Lezhës).²⁷

b) Futat e Hasit, kishin përmasa të vogla, sidomos ato që viheshin prapa, ndërsa ishin më të mëdha ato që viheshin përpara. Ato bëheshin prej një pëlhure të leshtë, të rrallë, ngjyrë të zezë, kafe ose vishnjë të mbyllët, të plotësuar anëve me dantela të punuara me grep dhe me disa qëndisje motivesh arkaike të skematizuara, në buzën e poshtme të përparjes.

Futat e Hasit ishin më të gjera se të gjata (të prasmët kishin afërsisht këto përmasa: 30-34 cm. gjerësi, 20-22 cm. gjatësi, kurse të përparmet 75-80 cm. gjerësi e 45-50 cm. gjatësi. Ato nuk lidheshin lart në bel, por liheshin të vareshin pak

më poshtë, si prapa ashtu edhe përpara.

Të tilla futa mbaheshin jo vetëm në Has, por edhe në shumë zona të Kosovës (në Rrafshin e Dukagjinit, në Drenicë etj.)

c) Futat e leshta ose të pambukta të një vargu krahinash që nga Osumi deri në Mat (si p.sh. Mokër, Shpat, Dumre, Myzeqe, Malësi e Tiranës, Fushë-Krujë, Kurbin, Prell, Gollobordë) dhe përtej kësaj zone në Shkodër, Kukës e disa vise të Kosovës etj. mbaheshin vetëm përpara. Kur ishin të leshta ato kishin përmasa më të vogla dhe ishin më të gjata se të gjera (me përjashtim të Mokrës). Të pambuktat ishin me përmasa më të mëdha se të leshtat, sidomos përparjet e Myzeqesë (të cilat arrinin deri në 110 cm. gjerësi me 90 cm. gjatësi).

Përparjet e këtij grupi mbaheshin përgjithësisht me kostumin me këmishë të gjatë, të shoqëruara në stinën e ftohtë me xhoka të ndryshme prej shajaku të bardhë.

ç) Futat me rrudha të dendura vetëm tek ijet, ishin shumë më të gjera se të gjata. Ato mbaheshin në Bregun e Bunës, e në Zadrinë (zona këto që përfshihen në rrethin e Shkodrës e atë të Lezhës). (fig. 155).




Fig. 155 — Përparje (Zadrinë)

Këto futa bëheshin me pëlhura të rralla leshi thjesht të zeza ose me katrore vijash të ndryshme, por edhe me pëlhura të pambukta me vija ngjyrash të ndryshme.

Për shkak të rrudhave të tyre tek ijet, ato i jepnin një pamje shumë të veçantë profilit të gruas, sepse theksonin shumë belin, nga zgjerimi i menjëhershëm që merrnin tek ijet.

²⁷) Shih Rr. Zojzi, *Një veshje e humbun pa lënë gjurmë*. Buletin i Institutit të Shkencave, Tiranë, 1958, nr. 3, f. 218.

Në kostumin e përditshëm ato viheshin mbi këmishën e gjatë jo vetëm përpara (ato me ngjyra), por edhe prapa (njëngjyrëshet), por të përpamet mund të kombinoheshin edhe me «pështjellshen» me pala të dendura, ose me «koretin» prej shajaku.

3. — Për shkak të strukturës së tyre shumë të ndërlikuar po i grupojmë veçmas futat që shoqëronin kostumin me xhubletë. Ato ishin në formë trapezi, pak të valëzuara përfundi, sidomos përparjet e përbëra nga një copë tekstili e leshtë, pothuaj katrore, së cilës i shtoheshin tri-katër iva shajaku e shumë gajtanë në pjesën e poshtme të saj. Këto përparje ishin mjaft të mëdha (gjatësia 65-70 cm., kurse gjerësia e bazave 50 cm. e sipërmja dhe 80-90 cm e poshtmja). (fig. 156).



FFig. 156 — Pshtjellak xhublete

Po ashtu në formë trapezi, por me përmasa të vogla (30 x 32 cm.), ishin «prapanikët» që mbaheshin sidomos në zonën e Lekbibajt (Nikaj-Mërtur), e disa zona të Rrafshit të Dukagjinit në Kosovë kryesisht Rugovë). Ato përbëheshin nga jo më pak se 6-7 copa fare të vogla, të lidhura midis tyre me gajtanë të shumtë. (fig. 157).

4. — Përparje me forma të modernizuara këmi konsideruar ato që i janë larguar krejtësisht traditës popullore vendase, si në materialin e përdorur, ashtu edhe në formën e zbukurimit. Megjithatë, duhet thënë se përparjet e këtij grupi janë zhvilluar përgjithësisht në pajtim me pjesë të tjera të veshjes që shoqëronin dhe kanë hyrë në



Fig. 157 — Prapanikë (Tropojë)

përdorim në periudhën nga Lufta e Parë Botërore deri në Çlirim. Mund të përmendim këtu përparjet me të njëjtin stof të fustaneve, që përdoreshin në rrethin e Korçës, të Kolonjës, të Përmetit, të Tepelenës, të Skraparit etj. Në këtë grup hyjnë edhe përparjet e reja (të mëndafshita me ngjyra të ndryshme) të grave të Dropullit, të Pogonit etj.

Një farë mospërputhjeje me pjesët e tjera të kostumit vihet re midis përparjes prej atllazi të grave malësore të Bregut të Matit, që shoqëronte nga vitet '30 e këtej, xhubletën e zezë të tyre.

Në vitet mbas Çlirimit, në shumë zona të Shqipërisë vihet re zëvendësimi në masë (sidomos në kostumin festiv) i përparjeve të dikurshme tradicionale, me shami katrore me lule shumëngjyrëshe të stampuara, të importuara ose të prodhuara nga industria jonë tekstile, si p.sh. në kostumin e grave të Mirditës, ose me shami të tjera me lule e thekë të gjata anëve, si p.sh. në Pukë. Kurse në jug të vendit gratë tashmë e mbajnë përparjen vetëm për punë e jo për të dalë. Përparjet që vihen për punë blihen të gatshme dhe janë të thjeshta prej basmeje të ngjyrosur.

Nga futat që përshekruam më lart, disa kanë forma e prerje origjinale tipike për popullin tonë e që nuk i ndeshim në popuj të tjerë. Të tjera paraqesin analogji të dukshme me futa të përdorura edhe në popujt fqinjë.

Është me interes të vëmë në dukje, p.sh., afritë midis përparjeve të rretheve të Pukës, në formë trapezi, me thekë të gjata anëve dhe përparjeve që mbaheshin në disa zona të Bosnjës Lindore (Jugosllavi). Po kështu përparja e vogël me thekë e Mirditës, «rrethoca», dhe futëprapsi i kostumit të zhdukur tashmë të Pdhanës (rrethi i Lezhës), paraqesin afëri të dukshme me futën me

thekë («opregul cu franjuri») të Banatit në Rumani, që vihej sikurse edhe në Pđhanë, në pjesën e prapme të trupit. Mund të vemë në dukje, gjithashtu, se tek ne nuk janë hetuar përparje shumë të ngushta, si ato që kanë pasur disa zona të Hercegovinës në Jugosllavi (p.sh. në rrethet e Konjicës e në fushën e Sarajevës).

*
* *
*

Futat janë nga pjesët më të dekoruara të kostumeve popullore, prandaj për vlerën artistike të tyre e funksionin estetik që kryenin në tërësinë e kostumit, mund të flitet shumë.

Zbukurimi i futave të krahinave të ndryshme të vendit tonë, paraqitet shumë i larmishëm si nga mënyra e organizimit të kompozimeve, ashtu edhe nga interpretimi i elementeve zbukuruese, por mbi të gjitha nga pasuria e pashtershme e motiveve.

Në shumicën dërrmuese të përparjeve zbukurimet janë bërë që në endjen e pëlhurës dhe plotësohen më tej me zbukurime të tjera anëve ose te vendi ku qepen fletët (dantela, rexa, thekë, tufa, shirita etj.). Por ka edhe mjaft përparje që bëhen prej një pëlhure ose stofi njëngjyrësh, mbi të cilin ekzekutohen qëndisje me teknika të ndryshme pune, aplikohen dantela, rruaza, shirita etj.

Në ato që janë zbukuruar që në endje mbizotëron përgjithësisht vendosja lineare e motiveve në rreshta horizontale paralele, por nuk mungojnë edhe pëlhurat me katrore ngjyrash të ndryshme (pra fijet me ngjyra janë vendosur edhe vertikalisht, në majën e pëlhurës).

Në zonat ku përdorej tipi i veshjes me dy futa, zbukurimet kanë qenë të përngjashme ose të njëjta si në përparjet ashtu edhe në futat e prasme (si p.sh., faqoret e Postribës e të Germanit paranikët e pështjellakët e Hasit etj.), por ndodhte që të ishin edhe të ndryshme.

Kemi shumë përparje me vija ose tufa vijash në krejt fushën, të cilat i japin kompozimit një sens vazhdimësie të papërcaktuar, si janë përparjet e pambukta me variacione të pafund, të rrethit të Tiranës. Kur përparja lidhej për beli, këto vija binin së gjati trupit, duke bërë që figura e gruas të dukej më e hedhur. Ndërsa në të

tjera zona, ku vijat vendoseshin së gjeri, përparja ishte përgjithësisht e ngushtë (rreth 45 cm). Kjo tregon se gratë fshatare e kanë çmuar drejt efektin e vijave horizontale e të atyre vertikale dhe kanë parapëlqyer atë që u tregonte një siluetë më të zhdërvjellët.

Shumë herë grupet e vijave alternohen me motive të thjeshta (gërshërëz, mollë etj.), të vendosura në një rresht horizontal si p.sh. në përparjet e Dumresë, të Myzeqesë etj. Kemi raste kur dekori i përparjes është ndarë në dy regjistra: në njërin, zakonisht të poshtmin, motivet janë vendosur horizontalisht, në tjetrin vertikalisht (si në përparjet e kostumit me xhubletë). Në përparjet e zonës së Kallmetit, gjithashtu, formohen dy regjistra, i poshtmi me motive të pasura, kurse i sipërmi shumë më i thjeshtë. Në disa zona të Jugut kemi përparje ku motivet zbukuruese (qëndisje me gajtan), fillojnë nga baza e poshtme, duke u ngjitur sa vjen e më të lehtësuara drejt belit (p.sh. përparjet e Devollit dhe të Fushës së Korçës, të Kolonjës etj.).

Shkëlqejnë për zbukurimet e tyre në gjithë fushën, përparjet e pambukta e të leshata të disa zonave, ndër të cilat mund të përmendim Myzeqenë e Dumrenë, Sulovën e Shpatin, pastaj Pogonin, Gollobordën, Kukësin e disa qytete të Kosovës p.sh. Prizreni, ku nëpërmjet elementesh gjeometrike apo lulësh e zogjsh, të vendosur në rreshta horizontale e të alternuar me grupe vijash, janë realizuar efekte të mahnitshme, që të marrin sytë.

Në përparjet rëndësi të madhe kanë ngjyrat e përdorura. Përparjet thjesht të bardha (për nusët) ose thjesht të zeza (për vajzat e rritura dhe plakat) janë mbajtur p.sh. në Mokër; përparje me fushë të zezë e motive të varfra nga ana kromatike janë ato të Prespës, Hasit, Malësisë së Madhe etj., me vija të alternuara bardhë e zi ose të bardhë e të kuqe, kanë qenë futat e Zerqanit (rrethi i Dibrës), të Postribës (rrethi i Shkodrës).

Mjete zbukurimi tek futat janë edhe thekët e tufat e ndryshme, që u vihen anëve. Të tilla zbukurime në futa kanë patur përparjet e Çermenikës (rrethi i Librazhdit), futëprapsit e Pđhanës (rrethi i Lezhës) stravecacat e Mirditës, paranikët e Pukës etj. Tek stravecacat e Mirditës thekët arrinin një gjatësi prej 20 cm. Ato bëheshin prej leshi të dredhur mirë, ngjyrë të kuqe, vishnje ose të zezë dhe kishin një efekt shumë

original duke i dhënë njëkohësisht një pamje arkaike kësaj përparjeje.

Në përparjet e zbukuruar me qëndisje, hasen aty-këtu edhe motive magjike, të cilat përpigën që theksojnë rëndësinë e vendit që ato mbulojnë. Bartësit e sotëm përgjithësisht as nuk dinë t'i shpjegojnë këto motive, nuk ua dinë kuptimin, por sidoqoftë vazhdojnë t'i bëjnë ato motive për zbulurim. I tillë ishte p.sh. rasti i disa strave-cave që mbaheshin për nusëri në rrethin e Dibrës të mbuluara me qëndisje me fije argjendi e ari, me motive sigmoide ose në formën e numrit 8.

Përparjet e kanë ruajtur karakterin e tyre funksional e dekorativ deri në veshjet e kohës sonë. Ato kanë patur një zhvillim dinamik jo aq në formë sa në dekorin e tyre, zhvillim që ka ardhur nga përsosja e teknikave të endjes e të qëndisjes. Këto teknika kanë lejuar jo vetëm zhvillimin e mëtejshëm të ornamenteve por edhe një variacion të pashtershëm të tyre.

Në kuadrin e elementeve përbërëse të veshjeve, kategoria e futave është po aq e pasur sa dhe ajo e këmishëve, por paraqet një diversitet më të madh në ngjyra dhe një interpretim më të gjerë e më të ngjeshur ornamental, që ka dhënë tipa më të ndryshëm se ato të këmishëve, në pikëpamje të zbukurimeve.

*
* *

Përsa i përket gjenezës, futa, si dihet, është një nga pjesët më të hershme të

zhvillimit të veshjes në popujt e ndryshëm të lashtësisë, krahas brezit. Këtë e tregon edhe vetë mënyra se si mbahet ajo e varur në trup, si një mbulesë e thjeshtë për pjesë të caktuara e delikate të trupit (sidomos të prehrit). Megjithëse në kohët e reja futat janë bërë pjesë plotësuese të veshjes, prototipi i tyre ka qenë, në kohë të hershme (ashtu sikurse vazhdon të jetë edhe sot për disa popuj primitivë të globit), pjesa e vetme e veshjes ose pjesa kryesore, padyshim në varësi të stadiit të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe të mjedisit gjeografik e klimës. Le të kujtojmë këtu se këmisha, të cilën sot e shoqëron përparja, është një veshje e konfeksionuar dhe jo një mbulojë e thjeshtë dhe, si e tillë, ajo është shfaqur padyshim, në një shkallë më të lartë të qytetërimit.

Duke shkuar prapas në kohë, në vendin tonë dëshmitë më të hershme nga Mesjeta, për futat, i kemi në shek. XVI tek vizatimet e Nicolo de Nicolait dhe në ndonjë afresk e ikonë të piktorëve vendës. Pastaj një boshllëk i madh prej 2000 vjetësh pothuaj, për të shkuar tek ato të pakta dëshmi që kemi nga koha e lashtë. Është fjala për një stelë varri që paraqet një grua ilire me linjë të gjatë e një përparje mbi të, që ndodhet në Muzeun e Zagrebit²⁸, për një statujë të zbuluar nga Patsch²⁹; për statuetat e Vinçës³⁰ (Jugosllavi) dhe statuetën e gjetur në Kliçevaç (Jugosllavi)³¹, tek e cila duket fare qartë një përparje e vogël me thekë, dhe ndonjë dëshmi tjetër e tërthortë nga gjetjet arkeologjike vendase.³²

Si duhet shpjeguar ky boshllëk i gjatë? Mungesa e deritanishme e monumenteve ku të jenë paraqitur në mënyrë realiste

28) Shih fig. 135 në f. 280 dhe fig. 283, në *Artá populára romínessca*, București 1968.

29) K. Patsch, *Archäologisch-epigraphische Untersuchungen zum Geschichte der romischen Provinz Dalmatien*, në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegovina*, Wien 1909, f. 129, fig. 22.

30) Shih fig. 11 në «Starinar» Novaja serija, nr. VII-VIII 1956-1957, f. 137.

31) Shih në faqen që pason.

32) Nga gjetjet e kulturës ilire trashëgojmë disa objekte bronzi mbi destinacionin e të cilave deri tani është diskutuar shumë, pa arritur ndonjë përfundim bindës. Është fjala për zbukurimet e ashtuquajtura «tapa shishesh», disa ekzemplarë nga të cilat janë gjetur në Kuçin e Zi (rrethi i Korçës) (gërmime të arkeologes Zh. Andrea). Duke shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e këtyre gërmimeve shohim se ato janë gjetur në pjesën e poshtme të skeletit, nga mesi te gjunjët. Për këtë arsye unë prirem të besoj se ato kanë qenë zbukurime të qepura në qoshet e poshtme të përparjes. Funkzioni praktik i tyre do të ishte që me peshën e tyre ta mbanin më të tendosur përparjen, e cila duhej të mbulonte prehrin. Më shtyn tek ky shpjegim vendosja e dekorave arkaike të disa përparjeve, si p.sh. ato të zonës së Hasit, të Prespës etj.

përparjet si pjesë veshjeje, për periudhën e lulëzimit të kulturës ilire, na shtyn të mendojmë se, nën ndikimin e fortë të kulturës klasike greko-romake, kohë për të cilën ishin karakteristike të tjera kritere në veshje (si p.sh. drapazhi e jo veshjet e prera e të qepura), edhe gratë ilire të zonave që ishin më tepër në kontakt me këtë kulturë, nuk mbanin përparje. Por ka shumë të ngjarë që veshje të tilla të na dëshmojnë në të ardhmen nga zonat e brendshme të territorit ilir. Përndryshe do të ish e pashpjegueshme se si tradita prehistorike e përdorimit të përparjes (e dëshmuar në statuetat e Vinçës e të Klicevacit) u përtëri në mesjetë dhe përparja doli rrishtaz si një element themelor e i pamungueshëm në veshjen e grave, duke ruajtur edhe emërtime që të kujtojnë funksionin primar e arkaik të saj si mbulesë e prehririt (si janë fjalët barkore, preher etj.).

Sidoqoftë, edhe nga ato pak dëshmi arkeologjike që kemi, mund të vëmë në dukje ndonjë analogji me përparjet ekzistuese.

Për sa i përket përparjes me thekë, mendoj se një paraardhëse të largët të sajën duhet ta konsiderojmë përparjen e figurinës neolitike të gjetur në Kličevač (Jugosllavi), ku dallohet fare qartë si pjesa katërkëndëshe e dekoruar me motive gjeometrike, ashtu edhe thekët e saj. K. Schurhardti ka dalluar këtë tilla futa me thekë në disa figurina të stacionit ilir të Vinçës (Jugosllavi), por të vendosura në pjesën e prasmë të trupit. Në pjesën e përparme ai shquan përparjen prej një pëlhure të dekoruar, por më të madhe se futa e prasmë dhe pa thekë. Po këtë gjë pati vënë re që më 1908 edhe E. Fisher³³. Në bazë të këtyre të dhënave të krahasuara edhe me figurinat e kohës të bronzit të gjetura në Cirna të Rumanisë, është shprehur mendimi se prania e përparjes me thekë në Banat e në Jugë të Danubit, tregon fare qartë se jemi përballë një elementi të veshjes me traditë iliro-trake³⁴. Mendoj se edhe përparjet me thekë që ekzistojnë ende sot në shumë variante të veshjeve popullore në Bosnjë-Hercegovinë, në Maqedoni³⁵, ndo-

shta, edhe në krahina të tjera të Jugosllavisë, duhet t'i konsiderojmë si ndikime të nënshtresës ilire në këto zona.

MBËSHTJELLËSET

Mbështjellëset janë pjesë veshjeje për gra, në formën e një fundi të hapur, që ngjishet për mesi dhe mbulon plotësisht, ose pothuaj plotësisht, pjesën e poshtme të trupit.

Ato janë përdorur në veshjen e vajzave e të grave në një zonë të caktuar të vendit tonë që fillon prej Kallmetit (rrethi i Lezhës) e Bregut të Bunës (rrethi i Shkodrës), duke përfshirë Zadrimën, e shtrihet drejt verilindjes, në krahinën e vogël të Malit të Zi (rrethi i Pukës) e pastaj në Malësinë e Gjakovës, në Lumë e në Gorë dhe vazhdon edhe përtej kufijve shtetërore të Shqipërisë.

Mbështjellëset përgatiteshin kudo nga vetë gratë fshatare, me pëlhura vegle, prej liri, pambuku ose leshi, por gjithnjë me dy fletë pëlhure të vendosura horizontalisht. Këto dy fletë mund të bashkoheshin drejtpërdrejt njëra me tjetrën me një qepje dekorative ose me anë të një dantele (2-3 cm. të gjerë), që kryente gjithashtu një rol dekorativ.

Mbështjellëset në vendin tonë, nuk kanë qenë asnjëherë të ngushta sa të rrinin pas trupit, por përkundrazi ishin shumë të gjera, prandaj mblihdeshin me rrudha ose me pala dhe fiksoheshin me lidhëse ose me ushkur.

Nga mënyra se si konfeksionoheshin mbështjellëset mund të dallojmë këto tre variante:

a) *Mbështjellëset me rrudha tek ijet*
Në Zadrimë ato thirreshin «faqore» a «faqëza» ose «mbështjellakë» bëheshin prej pëlhure të leshtë të zezë, pak të rrallë punuar me dy ose katër lisa dhe punoheshin nga vetë gratë fshatare e nuk janë blerë tek zejтари. Ato që mbanin vajzat ishin pak më të ngushta se ato që mbanin gratë. Ngjisheshin mbi këmishën e gjatë dhe ishin veshje për punë, jo për të dalë. Gjërësia e tyre lëkundej nga 90 në 110 cm.

33) Shih F. B. Florescu, *Geneza costumului popular românesc*, në «Studii si cercetari de Istoria Artei» Bucuresti, 1959, f. 27.

34) Po aty.

35) A. Petruševa, *Nekoí Balkanski predslovenski i staroslovenski elementi*. «Etnološki Pregled» 15, Beograd 1978, f. 103.

Në zonën e Kallmetit³⁶ ato thirreshin «shage», bëheshin prej pëlhure liri ose pambuku, gjithmonë të bardhë, ishin më të gjera (deri në 200-240 cm) dhe përdoreshin po ashtu si nga vajzat edhe nga gratë. Fletët bashkoheshin me anë të një rrexe të pambuktë ngjyrë të bardhë e të verdhë ose portokall. (fig. 158).



Fig. 158 — Shage e Kallmetit

Në të dy rastet, nën mbështjellësen dukej këmisha e gjatë nja 15-20 cm., sepse gjatësia e mbështjellëses ishte rreth 60-65 cm.

b) *Mbështjellëset me pala* bëheshin me dy fletë pëlhure të rrallë, gjithmonë prej leshi të punuar me dy lisa. Gjerësia e mbështjellëses lëkundej nga një zonë në tjetrën. Pëlhura mblidhej me pala të dendura rreth e qark belit. E mbanin vetëm gratë e martuara, jo vajzat.

Në zonën e Kallmetit mbështjellësja ishte gjithmonë e bardhë dhe thirrej «xhubletë» ose «xhubetë». Ajo bënte pjesë në veshjen e dytë të gruas. Gjerësia e saj arrinte deri në 5 metra e më tepër³⁷, kurse gjatësia lëkundej në përshtatje me trupin (nga 50 në 60 cm.). Përveç palave nuk kishte kurrfarë zbukurimi.

Në Zadrinë e në Breg të Bunës mbështjellësja, e cila bënte pjesë gjithashtu në veshjen e dytë të gruas, ishte gjithmonë e zezë dhe pa asnjë zbukurim. Ajo thirrej «kotull», «pështjellcë» ose «pshtjellak» dhe ishte shumë e gjerë (deri në 9 m.).³⁸

Si në Kallmet ashtu edhe në Zadrinë e në Breg të Bunës, mbështjellësja vihej

përmbi këmishën, e cila ishte aq e gjatë sa dukej rreth 20 cm nën të.

Në rrethet e Pukës e të Tropojës mbështjellësja me pala ndryshonte nga ngjyra dhe zbukurimet. Këto zona parapëlqenin këto ngjyra: të kuqe, çiklamin, manushaqe e të gjelbër. Këtu mbështjellësja thirrej «pshtjellak i gjanë» ose «kanac». Përfundi zbukurimej me shirita e dantela të bardha, të verdha, të gjelbra etj. Por zbukurimet më karakteristike ishin ato që bëheshin në fushën e pëlhurës së leshtë, duke përkrahur fije të ndritshme gjyrmishi, me të cilën ekzekutoheshin motive të ndryshme gjeometrike e floreale, me efekte shumë të bukura. Këmisha që vishej me këtë mbështjellëse ishte e shkurtër e nuk dukej poshtë.¹⁵⁹



Fig. 159 — Kanac (mbështjellse) e Pukës

c) *Mbështjellëset me rrudha* nuk ishin aq të gjera sa ato me pala.

Në fshatrat e krahinës së Lumës (rrethi i Kukësit) ato bëheshin me dy fletë pëlhure vegle, që bashkoheshin njëra me tjetrën me një qepje dekorative. Ky fund i hapur që thirrej «mshtjellcë», ngjishej për mes, përmbi këmishën e gjatë, gjithashtu prej pëlhure vegle, duke u vendosur ana e hapur, në njërën anë të trupit. Skajet e mbështjellëses ishin të zbukuruar me disa qëndisje motivesh të thjeshta gjeometrike (shih. fig. 130).

Në fshatrat e Gorës (rrethi i Kukësit) mbaheshin mbështjellëse pëlhure të leshtë, me fushë të kuqe të fortë e vija të bardha e blu etj., gjithnjë me dy fletë të vendosura së gjeri. Gjerësia e tyre arrinte nga

36) Përfshin fshatrat Kallmet, Rraboshtë, Mërqinjë e Grykë-Manati.

37) Shih mbështjellësen me nr. invent. 7051 në FE, Tiranë, e cila është 520 cm. e gjerë.

38) Shih mbështjellëset me nr. inv. 3961 dhe 5032 në FE, Tiranë.

180 cm. në 260-280 cm. Në këtë zonë ky element i veshjes thirrej pikërisht «*mshtjell-cë*», si në Lumë.

Të dhëna të shumta etnografike tregojnë se mbështjellëset janë përdorur si veshje për gra në shumë zona të Evropës Juglindore³⁹. Ato i gjejmë në përdorim të popujve të Jugosllavisë (sidomos tek serbët), në Bullgarinë Veriperëndimore (në rrethet Vidin, Preslav, Belogradçik dhe në shumë zona të Rumanisë (sidomos në Olteni).

Afri të mëdha vihen re midis mbështjellëseve tona me pala, të përdorura në rrethin e Pukës e të Tropojës (varianti b, i përshkruar më lart) dhe atyre të rretheve të Vidinit (Bullgari) dhe «*vîlnic-ut*» të Oltenisë (Rumani). Por në këto përqasje është me rëndësi të vihet në dukje një fakt tjetër. Për këtë element veshjeje tek ne janë ruajtur disa shkallë zhvillimi që nuk i shohim tek të tjerët. Kështu tek ne janë hetuar edhe forma të thjeshta, që pa dyshim u kanë paraprirë formave më të zhvilluara. Vendosja e një kronologjie relative përbrenda formave ekzistuese është pikërisht renditja që kemi bërë më lart, gjatë përshkrimit të tyre. Mbështjellëset me rrudha tek ijet (varianti a), ka shumë të ngjarë të jenë më të hershme se ato të dy varianteve të tjera. Ato kanë të njëjtën formë me përparjet e së njëjtës zonë dhe ndryshojnë prej tyre vetëm nga ngjyra e zbukurimet.

Të tjera veçori që e dallojnë kostumin me mbështjellëse të përdorur tek ne nga ai i përdorur tek fqinjët tanë, janë këto: e para, tek ne mbështjellësja kombinohet me një këmishë të tipit ilir (dalmatika), kurse tek rumunët e bullgarët këmisha është e tipit dak; e dyta, tek ne, në variantin më të thjeshtë, forma e mbështjellëses është e njëjtë me atë të përparjes, pra ajo mund të konsiderohet edhe si një futë e prasme (ose më mirë si një shkallë kalimi nga futa e prasme në mbështjellëse), kurse tek popujt e tjerë forma e përparjes është e ndryshme; e treta, tek ne ashtu si edhe tek rumunët, mbi mbështjellëse nuk vishet xhokë (as me mëngë e as pa mëngë), kurse tek bullgarët po.

Sidoqoftë, mbështjellësja është një pjesë veshjeje shumë e lashtë, e lidhur gjenetikisht me futën dhe qëndron midis elementeve që e *mbulojnë* trupin dhe atyre që e *veshin* atë (pra që janë konfeksionuar duke iu përshtatur trupit). Si e tillë, mosha e saj i afrohet asaj të futës, strukës (hlamidës) etj. dhe është pa dyshim, më e vjetër se vetë këmisha, të cilën e shoqëron. Ajo bën pjesë në grupin e veshjeve që ngjishen për mes.

FUSTANI A FUSTANELLA

Është një pjesë e veshjeve për burra, që njëhej në mbarë Shqipërinë nga veriu në jug dhe kishte formën e një fundi shumë të gjerë, që ngjishej për mes. Në format më të thjeshta bëhej prej disa fletësh pëlhure liri⁴⁰ ose pambuku të punuar në shtëpi, sidomos për veshjen e përditshme. Pëlhura vendosej gjithmonë së gjati trupit dhe mblidhej me rrudha të dendura te beli. Për ta zgjeruar sa më shumë fundin, çdo fletë pritej zakonisht në tre kinda në formë trapezi. Faqelli i fabrikuar që importohet, pat hyrë prej kohësh në përgatitjen e fustanellave, sidomos për veshjen festive. (fig. 160).

Burimet tregojnë se gjerësia e fustanellës lëvizte shumë nga një ekzemplar në tjetrin. Kështu ajo mund të bëhej edhe me 4-5 fletë pëlhure, por bëhej edhe me 100 e më tepër fletë. E kur të mendojmë se në secilën fletë nxirreshin të paktën tre kinda, do të kuptojmë se përse të dhënat gojore flasin për fustanella me 300, 500 e bile edhe 700 kinda, të cilat ishin aq të dendura sa po ta lëshoje fustanellën për tokë ajo nuk binte, por qëndronte drejt. Kjo gjerësi e tepërt ka bërë të nevojshme që ajo të ndahej në dy ose tri pjesë, që të mund të lahej e të thahej më lehtë.

Gjerësia e fustanellës lidhej me gjendjen ekonomike e pozitën shoqërore të bartësit. Por deri në një farë mase ajo lidhej

39) Shih: M. Veleva, *Costumes nationaux Bulgares*, Sofia 1961, f. 13-14; F. Bobu-Florescu, *Geneza-costumului popular romanesc*, në «*Studii si cercetari de istoria artei*» Bucuresti 1959, f. 40, *Costumes Serbes du XIX siècle*, Beograd, 1970, f. 2, 6, 7 etj. V. Klickova, *Narodne nosnje...* Skoplje 1964, f....; A. Hadjimihali, *Eliniqi foresia*, Athinë 1978, f. 313, fig. 330.

40) Deri vonë fshatarët e Shpatit e të Dumresë tregonin se në krahinat e tyre qenë mbajtur fustanella me pëlhurë liri.

padyshim edhe me rastin për të cilin përgatitej. Kështu p.sh., për kostumin e martesës edhe i varfri përpiqej të bënte një fustanellë më të gjerë e më të mirë se ajo që mbante përditë.



Fig. 160 — Burrë me fustanellë

Gjatësia e fustanellës lidhej kryesisht me moshën e bartësit. Të rinjtë i mbanin fustanellat përmbi gju, të moshuarit nën gju. Megjithatë vemë re se fustanellat e Jugut, në përgjithësi, ishin më të shkurtra se ato të Veriut. Fustanellat më të gjata i kanë mbajtur burrat e parisë shkodrane në fund të shek. XIX, sikur na dëshmojnë edhe shumë fotografi të Marubit, të bëra në Shkodër.

Në ekzemplarët më të pasur, të bërë prej humajve të importuar, fustanellat kishin një përthyerje të gjerë përfundi, të

përshtuar me tegela makine në formë zigzagu dhe ky ishte i vetmi zbukurim i tyre. Ngjyra karakteristike e fustanellës ishte e bardha. Ka pasur megjithatë raste të veçanta kur ajo bëhej edhe e murme ose e zezë (për kaçakët, komitet, trimat e maleve e luftëtarët e lirisë) sikurse e kemi vënë re edhe gjetiu.⁴¹

Edhe vetëm nga gravurat sikur të gjykojmë, bie në sy se, ndërsa në shekullin XVIII fustanellat kishin një gjerësi mesatare, në shek. XIX gjerësia e tyre u shtua shumë, sidomos në ekzemplarët e përgatitur për burrat e rinj e kapadainj të dyerve të pasura, për prijësa fisesh etj. Në shek. XIX fustani pat evoluar duke marrë një formë jashtëzakonisht të rënduar, me ato qindra kinda të dendur që kishte, gjë që shënon edhe humbjen e praktikitetit të saj si veshje.⁴²

Kjo është faza e rënies së fustanellës, e cila erdhi duke dalë pastaj gradualisht nga përdorimi.

Në kohët e reja fustanella mbahej jo vetëm në Shqipëri e atje ku kishte popullsi kompakte shqiptare, si në arbëreshët e Greqisë e të Italisë, në shqiptarët e Kosovës e të Maqedonisë etj., por edhe në zona të tjera të Gadishullit Ballkanik si në Greqi, Rumani etj.

Në Maqedoni fustanella bënte pjesë në veshjen e burrave në Skopske Bllatija, në Ovce Polje, në Babune, në Azat, në Marcovo, në rrethin e Gjevgjelisë në gjithë Moravën jugore, në Prespë e në Tikvesh etj. Ajo ishte e gjerë e mbledhur me shumë rrudha te beli dhe vishej përmbi tirqet, por shumë herë edhe përmbi bollkat dhe thirrej «fustan», «ajta» dhe «toska»⁴³, ndoshta sepse që huazuar nga veshjet e shqiptarëve toskë, sikurse pati ndodhur edhe për pushkët e gjata që thirreshin gjithashtu «toska»⁴⁴.

Në Rumani (në zonën etnografike midis lumenjve Olt dhe Dëmbovicë) fustani thirrej «fustë» dhe bëhej me disa fletë pëlhu-re, zakonisht pesë, të cilat nuk mblidheshin në mënyrë uniforme te beli, por përpara vihej një fletë pothuaj e shtrirë, me fare pak

41) Shih A. Gjergji; *Ndryshime morfologjike në veshjet popullore*. «Etnografika shqiptare», VII Tiranë 1979.

42) «Beu musliman i Shkodrës nuk punon dot nga fustanella e gjerë që mban, ose më mirë, vesh fustanellën që të mos jetë i zoti të punojë», vërente me ironi të hollë M.E. Durham, më 1909.

43) Shih A. Petruševa, art. i cituar f. 101.

44) Shih «Fjalor Serbo-kroatisht-shqip», Prishtinë 1978, zëri «toska».

rrudha, kurse katër të tjerat viheshin të rrudhura në pjesën e prasme. Si shihet vendosja e fletëve ishte disi e ndryshme nga e jona.⁴⁵

Një numër mjaft i madh dokumentesh të kohës së mesme flasin për importimin e një lloj plaçke të quajtur «fustagno»⁴⁶, që me sa duket përdorej radhazi në shtresat e gjera qytetare. Ajo ishte një pëlhurë e pambuktë, e bardhë, që përmendet shumë shpesh në shekujt XIII-XV. Mendoj se me këtë lloj plaçke konfeksionohej edhe fustanella e burrave. Ajo mori edhe emrin prej materialit me të cilin përgatitej, ashtu si ka ndodhur edhe me shumë pjesë të tjera të veshjes, jo vetëm tek ne, por edhe te shumë popuj të tjerë. Kjo duket qartë në një dokument të shek. XIV (viti 1335), ku fjala «fustan» është përdorur pikërisht me kuptimin e një fundi krahas tunikës, këmishës e pjesësh të tjera veshjeje.⁴⁷ Megjithëse origjina e kësaj veshjeje shkon shumë më thellë në lashtësi, për ne ky dokument ka rëndësi si një dëshmi që na tregon se kur e pse ajo u quajt «fustan» a «fustanellë».



Fig. 161 — Burrë me fustanellë (Gur varri gjetur në Smokthinë — Mesaplik, Vlorë shek. III-IV e.s.

Duke u shtyrë më praptas në kohë, do të përmendim një dëshmi të rëndësishme të kohës së vonë antike. Është fjala për një gur varri të gjetur vitet e fundit, që paraqet fare qartë një njeri të veshur me fustanellë (fig. 161). Ai është një gjetje e rastit në fshatin Smokthinë të rrethit të Vlorës, për të cilin arkeologët mendojnë se u përket shekujve III-IV të erës sonë.⁴⁸

Një varg gjetjesh të tjera nga zona të ndryshme të Gadishullit Ballkanik dëshmojnë për ekzistencën e kësaj veshjeje që në shek. V p.e.r., në përdorim si për burra dhe për gra. Mendoj se janë të veshura me fustan gratë e paraqitura në dy faqet e një urne funerare të shekujve V-IV p.e.r. që është gjetur në Ribic, në luginën

e lumit Una (një zonë midis Japodëve dhe Mëzeive)⁴⁹, po ashtu edhe Diana dhe dy nimfat përkrah saj që shihen në një basoreliev të gjetur në Glamoc⁵⁰, afër Glasinacit në Bosnjë (fig. 208). Fustani duket mjaft qartë edhe në një figurinë të gjetur në Maribor të Sllovenisë⁵¹ (Panonia e vjetër) (fig. 162). Në këtë figurë fustani është i pajisur me dy rripa të kryqëzuar në shpinë e në gjoks, që shërbenin për ta mbajtur atë më mirë në trup. Për formën e fustanit, figurina e Mariborit paraqet ngjashmëri të madhe me një terrakotë të gjetur

45) F. Bobu — Florescu, *Articole de port ignorate de etnografii din trecut*, në «Studii si cercetari de istoria artei», Bucuresti 1954 nr. 1-2, f. 215.

46) *Acta et diplomata res Albaniae...*; vol. I, dok. 528, 533, 546, 639, 789, 804; vol. II dok., 386, 612, 723, 737).

47) *Acta et diplomata*. vol. I dok. 790, viti 1335, 8 prill shih edhe shënimin në Kreun e parë.

48) Raport i Ekspeditës informative në luginën e Lumit të Vlorës — 1977 (gjetur në Shalës-Mesaplik, të Smokthinës nga arkeologu D. Komata).

49) Urna në fjalë ndodhet në Zemaljski Muzej të Sarajevës. Shih fig. 5 në artikullin e A. Gjergjit, *Elemente të përbashkëta të veshjes së fiseve ilire etj.* në vëllimin «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve», f. 165.

50) S. Ferri, *Arte Romana sul Danubio*, Milano 1933, f. 403, fig 5.

51) Shih fig. 6, në A. Gjergji, *Elemente të përbashkëta etj.*



Fig. 162 — Burrë me fustanellë (Gur i gjetur në Maribor të Sllovenis shek. V p.e.r.)

në nekropolin helenistik të Durrësit (fig. 163)⁵². Ndoshta një variant më të evoluar dhe më aristokratik të fustanit duhet të shohim te reliefi «Vajza e Vlorës» gjetur në afërsi të atij qyteti. Është shprehur me kohë mendimi se njerëz të veshur me fustan duhet të shohim edhe në disa tokëza rripash të gjetura në Vaç afër Ljubjanës (në territorin e Japodëve), si edhe në veshjen e legjionarëve, romakë.⁵³ Fustani i shkurtër që një veshje shumë e përshtatshme, për kalorësit, sepse duke qenë i gjerë, nuk pengonte aspak lëvizjet e gjymtyrëve të poshtme.

Si shihet nga figurat që përmendëm më lart fustani ka qenë një pjesë e hershme veshjeje e përdorur nga fiset e ndryshme ilire.

Ndër popujt e vjetër, një veshje shumë të ngjashme me fustanin ilir kanë pasur keltët dhe prej tyre trashëguan skocezët «kiltin» e tyre. Siç dihet keltët kanë rënë në kontakt me ilirët qysh në shek. IV p.e.r. dhe ndonjë gjurmë e këtij kontakti është vënë re edhe në gjuhë.⁵⁴ Nuk duhet harruar gjithashtu se në kohën romake (e sidomos nga mesi i shek. I p.e.r. deri në

shek. III të erës së re) kohorta të kalorësve alpinë dhe belgë shërbenin në Ilirik, kurse kohorta të përbëra prej kalorësish dalmatë, shërbenin në Bretanjë, Daki e gjetkë. Kalorës ilirë (equites Illyrici) në Daki përmenden edhe në një tekst epigrafik para shek. III⁵⁵.

E. Salio, duke folur për «zoma-n» e grekëve të vjetër dhe «cinctus-in» e romakëve thotë se ajo ishte një copë pëlhere që fiksohej tek ijet dhe arrinte deri në gjysmë të kofshëve, ishte e hapur përpara dhe e përdornin më fort fshatarët kur punonin në ara gjatë stinës së ngrohtë dhe në këtë rast quhej «campestre». Polibi tregon se për një kohë të gjatë kavaleria romake nuk kishte parzmorë dhe kalorësit vishnin vetëm një fund të shkurtër,⁵⁶ i cili ishte me sa duket i njëjti me veshjen e legjionarëve romakë që përmendëm më lart. Ky është i vetmi element i veshjes greko-romake që mund të përqaset deri në një farë mase me fustanellën ilire të këtyre shekujve, e cila paraqitet shumë më e zhvilluar.

Fustani duke qenë një element veshjeje që linte të zhveshur toraksin mendoj

52) Kjo terrakotë ndodhet në Muzeun e Durrësit.

53) F. Nopcsa, *Albanien, Bauten, Trachten und Geräte Nordalbaniens*, Berlin un Leipzig, 1925, f. 182.

54) Shih E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* (dispensë), Tiranë, 1960. f. 10.

55) Daremberg et Saglio, *vep. cit.*, zëri «Equites», f. 785.

56) Po atje, zëri «Cinctus».



Fig. 163 — Burrë me fustanellë (terrakoto e Durrësit, shek. IV e.s.)

se duhet konsideruar më fort si një veshje tipike zonash me klimë të butë. Nuk duhet harruar gjithashtu se në popullin tonë janë hetuar edhe tipa të tjerë të lashtë veshjesh (si kostumi me dy futa, mbësh-tjellëset etj.), ku pjesët kryesore ngjishen për brezi, ashtu sikurse edhe fustani. Duke u nisur nga të tilla konsiderata etnografike, prirem të mendoj se tek fustani kemi të bëjmë më fort me një element ilir. Dëshmi të reja nga gjetjet arkeologjike që për-mendëm më lart, tregojnë qartë se ai përdorej gjerësisht nga shumë fise ilire, në tërë territorin e shtrirjes së tyre nga jugu në veri, pra përforcojmë karakterin ilir të tij, i cili është pranuar me kohë nga stu-diues të ndryshëm.⁵⁷

Është një pjesë themelore e veshjes, e përdorur si për burra e për gra.

Materiali etnografik i mbledhur tregon se edhe në periudhën nga Shpallja e Pa-varësisë deri në Çlirimin e vendit këmi-shët, si për gra e për burra, bëheshin përgjithësisht prej pëlhure të pambuktë të pu-nuar në vend nga vetë gratë fshatare, në veglën e zakonshme horizontale, me dy li-sa. Në shumë zona ku rritej krimbi i mën-dafshit, ishte i rëndomtë përdorimi i pël-hurave të mëndafshita për përgatitjen e kë-mishëve. Trashësia dhe zbukurimet e pëlhu-rave ndryshonin nga një krahinë në tjet-rën e sidomos nga një shtresë shoqërore në tjetrën, duke iu përshtatur natyrisht edhe moshës së bartësit edhe rastit për të cilin visheshin.

Mbas Çlirimit vendin e pëlhurave të punuara brenda ekonomisë shtëpiake e zu-ri shkallë-shkallë bezja dhe kambriku i fa-brikuar, të cilat, para Çlirimit, kishin përdorim shumë të kufizuar në popullsinë fsha-tare, e sidomos në veshjen e përditshme të saj. Për ditët tona mund të themi se, me zhvillimin e gjerë të industrisë tekstile ve-ndase, pëlhura e pambuktë e fabrikuar është e arritshme për masat e gjera të popullsisë fshatare dhe ajo mbizotëron plotësisht në përgatitjen e këmishëve si për burra e për gra.

Megjithatë, gratë fshatare tregojnë se deri në një të kaluar jo të largët ato kanë përdorur për konfeksionimin e këmishëve edhe pëlhura liri⁵⁸, kërpi e gjineshtre⁵⁹ të punuara nga vetë ato në avlemend. Në zo-na të ndryshme të rretheve Mat, Mirditë, Pukë, Kukës e Tropojë ruhet ende kujtimi i këmishëve të përgatitura edhe me pël-hurë të hollë e të rrallë leshi.⁶⁰

Emri «këmishë», sot deridiku i përgjithë-suar në gjuhën letrare, nuk ka mundur të nxjerrë nga përdorimi disa emra më të vje-tër lokalë të kësaj pjese themelore të vesh-jes, ndër të cilët më e përgjithësuar për kë-

57) Shih F. Nopcsa, *vep. cit.*, f. 182; F. Bobu-Florescu, *Geneza costumului popular românesc*, në «Studii si cercetări de istoria artei», Bucuresti 1959, nr. 1, f. 37; po ai, *Articole de port ignorate de etnografia din trecut*, në «Studii si cercetări ect.», Bucuresti 1954, nr. 1-2, f. 215, etj.

58) P.sh. në Zadrimë, në Mokër, në Çermenikë (Shmil) etj.

59) P.sh. në Bregdet, në Labëri, në Mokër etj.

60) Shih përgjigjet e pyetësorit të veshjeve popullore.

mishët e grave ka qenë fjala «linjë». Vetë ky emër dëshmon qartë se, kjo pjesë e veshjes, bëhej dikur kryesisht me pëlhurë liri, tradita e kultivimit të të cilit ruhet në shumë zona të vendit. Të tjerë emra më pak të përhapur kanë qenë «mëngë» ose «mëngore», «shkurtë», «krahë» ose «krahëz», të cilat tregonin përgjithësisht një këmishë të shkurtër. Janë hetuar edhe emërtime me përdorim më të ngushtë si: «shtatëz», «xhubletë» ose «gjupetë», «rashë» etj.⁶¹ Kurse për këmishët e burrave gjejmë krahas fjalës këmishë edhe: mëngore, mëngaz, mëngët, krahëz, krahë, shkurtë, grykëse, brezore, etj.

* * *

Interes të veçantë paraqet pa dyshim prerja e këmishës. Si do ta shohim nga paraqitja e mëposhtme e materialit, këmishët e grave tek ne i përkasin një tipi të vetëm, atij që ne e kemi quajtur «tipi i dalmatikës ilire», në atë formë që e kemi të dokumentuar këtë veshje të stërgjyshëve tanë në dëshmi të kohës së vjetër. Midis formave të ndryshme të këtij tipi kemi dalluar disa variante, me karakteristika të veçanta të dorës së dytë, krahas tipareve themelore të përbashkëta të tyre, që janë dv:

a) Shtati i drejtë i bërë me një fletë pël-hure që kalon nga prapa përpara, pa u prerë tek supet dhe b) prania e mëngëve, që bashkohen me shtatin tek supet dhe jo tek gryka, si në tipin dak.

Varianti 1. Në këtë variant që është më i thjeshti në prerje shtati i drejtë




Fig. 164 — Prerje këmishë me kind të përbashkët të mëngës e të shtatit

⁶¹ Po përmendim disa emra të këmishës sipas të folmeve lokale: «mëngë» Mjekës (Shpat, Elbasan); «krahëzat» (Zavalinë, Shpat); «krahëzat» (Shëngjergj, Tiranë) «shkurte» (Kurdari, Mat); «Mëngët» (Kërpitë, Tomorricë), «Mëngëzt» (Seman, Fier) «mongët» (Mollas-Sulovë), «rashë» (Rrilë, Bregu i Matës; Nikej, Kelmend); «xhubletë» (Ulzë, Mat), «plahura» (Kërçisht i poshtëm, Dibër).

i bërë me një fletë pëlhure, plotësohej me nga një kind anësor gjithashtu prej një flete të plotë pëlhure. Ky kind, pa u ndërprerë tek sqetullat, vazhdonte të plotëson-te gjerësinë e mëngëve. Pra në fletën e gjatë të pëlhurës, gruaja priste një gjatësi për shtatin prapa e përpara, dy gjatësi për mëngët me gjerësinë e plotë të pëlhurës ose sa gjysma e saj dhe dy kinda anësore me gjatësi nga fundi i këmishës tek sqetulla dhe prej atje tek dora, që i shtohet mëngës në tërë gjatësinë e saj. (fig. 164).

Në fondet etnografike të Institutit të Kulturës Popullore të tilla këmishë kemi vetëm nga Korça.⁶² Ato janë bërë me pëlhurë pambuku të bardhë, të rrudhur, me gjerësi 20-30 cm. Gjatësia e tyre është 90-100 cm. Janë mbajtur deri në vitet '30 kryesisht nga gratë plaka ortodokse të qytetit dhe të fshatrave. Mendoj se një nga shkaqet që shpjegon sesi u ruajtën këto këmishë me prerje kaq të thjeshtë, është se ato prej mjaft kohësh ishin kthyer në një veshje të brendshme (ndërresë), që nuk dukej fare, kështu që nuk u zhvilluan më tej as në gjerësinë e fundit dhe as në zbukurimet e tyre, sikurse ndodhi në zona të tjera, ku ato përdorehin njëkohësisht edhe si veshje të sipërme dhe, si të tilla, duhet të plotësonin edhe disa kërkesa estetike.

Tilke e cilëson këtë prerje si turke⁶³. Një pohim i tillë sjell me vete pyetjen e vështirë se pse atëherë, tek ne kjo prerje u ruajt vetëm tek popullsia ortodokse.

Varianti 2. — Këtu shtati i drejtë me një fletë pëlhure që shkonte që prapa përpara, pa u prerë tek supet, plotësohej me mëngët e drejta të bëra me dy fletë pëlhure (ose me një fletë e gjysmë)⁶⁴. Për kindat përdorej një fletë pëlhure për secilën anë, me gjatësi nga sqetulla e poshtë, por kjo fletë e kindit mund të vendosej në tri mënyra: e plotë, e mbledhur ose jo me pak rrudha tek sqetulla; e prerë në dy kinda në formë trapezi; e prerë në tre kinda gjithnjë në formë trapezi, nga të cilët njëri më i madh e dy të tjerët më të vegjël. I gjithë ky përpunim i kindave synonte t'i jepte

këmishës së grave një gjerësi sa më të madhe përfundi, duke iu larguar kështu formave arkaike fillestare të saj, të cilat, me sa duket, ishin njëlloj të gjera si në sqetullat e në fund. (fig. 165 a, b).




Fig. 166 — (a, b) Prerje këmishë me kind nga sqetulla e poshtë.

Këmishët më të gjata me prerje të variantit 2 A (95-100) cm., janë mbajtur në

62) Shih objektet me nr. inventari 2734, 2742, 4611, 4612, 5436 në koleksionin e veshjeve të fondeve etnografike, të Institutit të Kulturës Popullore (Tiranë) (F.E.)

63) M. Tilke, *Das Kostümwerk*, Leipzig 1934, f. 106, Tab. X.

64) Në këmishët e Tiranës, të cilat ishin të shkurtra rreth 70-75 cm. dhe të bëra prej pëlhure vegle me fije mëndafshi natural, ky kind i drejtë vihej edhe me gjysmë flete gjerësi.




Fig. 164 — b

rrethin e Korçës⁶⁵ të përgatitura prej pël-hure pambuku të hollë e të rrudhur (me gjerësi 20-25 cm.), e cila, si dihet ka elasticitet më të madh se pëlhura e shtrirë. Ky variant prerjeje është përdorur edhe në këmishët e grave katolike të Shkodrës, të cilat përgatiteshin me pëlhura të pambukta ose të mëndafshita, me gjerësi që shkonte nga 40-50 cm.⁶⁶

Me sa tregojnë materialet, këmishët më të shkurtra me prerje të variantit 2 A janë ato që mbaheshin në Krrabë, në Shpat, në Dumre, në Sulovë e në një pjesë të Myzeqesë, të cilat shoqëroheshin me funde të shkëputura. Në veshjen e grave qytetare myslimane gjithashtu janë mbajtur këmishët të shkurtra me këtë prerje, të bëra me pël-hura të ndryshme mëndafshi, si janë bie fjala këmishët e grave të Shkodrës, të Elbasanit, të Tiranës, etj. shumë herë të rënduara me qëndisje të shumta me gjyrmush ose me tel, tek mëngët e tyre të gjata; këto këmishë ishin shumë të hapura tek qafa (dekolté) dhe kishin flutura tek supet. Ato shoqëroheshin me çitjane dhe ishin në funksionin e bluzës së sipërme dhe jo të ndërresës.

65) Shih këmishët me nr. inv. 9/1 e 9/2 në koleksionet e Muzeut lokal të Korçës.

66) Shih këmishën me nr. inv. 5261 (me gjatësi 96 cm) dhe atë me nr. inv. 3639 (me gjatësi 112 cm), në koleksionin e veshjeve të FE Tiranë. Këmisha e dytë e ka kindin anësor me një fletë e gjysmë.

67) Shih këmishët me nr. inv. 73/169 në F.E. Tiranë, me gjatësi 152 cm.

Varianti 3. — Ky variant ishte shumë i afërt me variantin 2 C, veçse ndryshonte në numrin e kindave, për të cilët përdorreshin dy ose më shumë fletë pël-hure. Këmishëve të këtij lloji u përkisnin përgjithësisht ato që quheshin «këmishë të mira ose për të dalë» dhe sidomos këmishët e nusërisë ose të grave me moshë të re. Për to nevojitej një sasi e konsiderueshme pël-hure (rreth 10 m.), sepse numri i kindave arrinte deri në 25-30. Këto ishin këmishë të gjata deri në pulpat e këmbëve ose deri në fund të këmbëve, si p.sh. këmishët e Shkodrës, të Zadrimës, të Fushë-Krujës⁶⁷, të cilat kryenin, në të shumtat e rasteve, jo vetëm funksionin e ndërresës, por edhe të veshjes së sipërme. Por ndodhte që gjerësia e tepruar të cenonte shumë herë bukurinë dhe elegancën e kostumit dhe ta pengonte gruan të lëvizte lirshëm, si p.sh. këmishët e grave të Fushë-Krujës.

Varianti 4. — Tek ky variant fleta e pël-hurës së shtatit shkonte nga prapa përpara, pa u prerë tek supet, por në pjesën e përparme ndërpritej tek beli. Që nga beli e poshtë shtohet një copë e veçantë pël-hure. Në secilën anë kësaj linje i shtoheshin nga dy kinda në formë trapezi të stërgjatur që fillonin jo që nga sqetulla, por që nga beli. Mëngët ishin të drejta; përfundi linjës i shtoheshin 2-3 rripa horizontale shumë të zbukuruar (shih prerjen në fig. 166). Këtë prerje kishte linja



Fig. 166 — Prerje «xhupletës» lugina e Limit

e përgatitur me pëlhurë leshi, që thirrej «xhupetë» dhe bënte pjesë në kostumin e grave të Luginës së Limit, në Alpet e veriut (që sot ndodhet në territorin e Malit të Zi). (fig. 167).



Fig. 167 — Grua me xhupletë 1905 (foto Marubi), RA-37/11)

Varianti 5. — Kemi përfshirë në këtë grup këmishët ku shtati ndërpritej te mesi ose pak më poshtë. Një fund i qepur veçmas, mjaft i gjerë, qepej me këtë këmishë të shkurtër ose visheshin së bashku si dy pjesë të veçanta. Në këto raste, përgjithësisht pjesa e sipërme i takonte variantit 165 a. Kur ishte e pangjitur me fundin kjo pjesë e sipërme thirrej «krahëz»⁶⁹ dhe «mëngë»⁷⁰,




Fig. 168 — Këmishë me dy pjesë (Myzeqe) (Skicë e prerjes)

kurse pjesa e poshtme «lijë»⁷¹ dhe në ndonjë vend edhe fustan»⁷². (fig. 168).

Këto lloje këmishësh janë mbajtur në funksionin e veshjes së sipërme, prandaj kishin edhe shumë zbukurime, kryesisht te jaka, te gjoksi e te mëngët. Në zonat ku përdorehin pëlhura me vija ngjyrash të ndryshme si në Myzeqe, në Dumre, në Sulovë etj., pëlhura që përdorej për të bërë pjesën e sipërme ishte e zbukuruar edhe me motive të tjera dhe vendosej së gjeri.⁷³

Edhe ky variant kërkonte një sasi të konsiderueshme pëlhure prandaj përdorimi i tij duhet parë kryesisht në lidhje me mundësitë ekonomike të bartësit, por edhe në lidhje me rastin për të cilin përgatitej.

Këto janë përmbledhtas variantet kryesore të këmishëve tradicionale për gra në vendin tonë.

Deri tani nuk kemi mundur të hetojmë ndonjë variant linje që të mos ketë fare kinda anësorë. Një gjë e tillë do të ishte

68) Shih përshkrimin e hollësishëm tek M. Vlahović, *Narodna nošnja u Vasojevićima*, në «Glasnik Zemaljsko Muzeja u Beogradu» 1934, nr. IX, f. 71-74.

69) Si p.sh. në Shëngjergj e Shupal të Tiranës, në Cudhin të Krujës në Shelcan të Shtatit (Elbasan) etj.

70) P.sh. në Papër e në Shtëpanj të Elbasanit.

71) Në Shtëpanj (Elbasan), në Kutalli (Berat) etj.

72) Në Bërzeshtë (Librazhd), në Shtat (Elbasan), në Cudhin (Krujë) etj.

73) Shih këmishët me nr. inv. 5303, 9966 etj. në F.E. Tiranë.

e pamundur me pëlhurat ekzistuese të teknologjisë shtëpiake, ku gjerësia maksimale vërtitej tek 40-50 cm.,⁷⁴ sepse nuk do të lejonte një ecje të lirë. Por disa dëshmi të tërthorta të shtyjnë të mendosh se të tilla këmishë të ngushta do të ketë patur në të kaluarën. Në këto raste këmishës i liheshin dy të çara poshtë tek anët e qepura, për të lehtësuar ecjen. Këmishë grash të çara poshtë tek anët ne nuk disponojmë në koleksionet e muzeve tona, por mënyra e të qepurit na tregon se në disa zona këto këmishë të çara anëve kanë ekzistuar. Të tilla janë këmishat e grave ish ortodokse të Mokrës në rrethin e Pogradecit, ku mënyra e të qepurit (*urjez*) le të mendohet se ato kanë qenë rreth 20 cm. të hapura anëve⁷⁵. Të ngushta sa pengonin ecjen kanë qenë këmishët e grave të Kelmendit, si na tregon një përshkrim nga Hakë,⁷⁶ për veshjen e grave kelmendase në Srem.

Për të plotësuar karakteristikat e prerjes mund të vihet në dukje se, në format e tyre më tradicionale, këmishët e grave në Shqipëri kanë patur një të çarë mediane për kokën (shumë rrallë ajo mund të qe anësore), me një rrip të ngushtë rrëzë qafës, që përforconte përthyerjen, gjerësia e të cililit nuk i kalonte 2-3 cm. Njihen vetëm pak zona ku këmishëve u vihej një jakë e përgatitur veçmas, si p.sh. në këmishët e Myzeqesë, në ato të Zadrimes etj., format e të cilave shihen në figurat e mëposhtme. Vetëm forma të reja të vona qytetare (si p.sh. këmishët e mëndafshta e të qendisura me gjyrmsh të Tiranës, Elbasanit etj.) kanë një çarje në formë vezore ose katrore mjaft të hapur (dekolté). Për sa u përket mëngëve ato janë përgjithësisht të gjata e të drejta dhe, në shekullin tonë edhe me kapakë te kyçi i dorës. Megjithatë në ndonjë rast ka patur edhe mëngë të fryra (si ato të Myzeqesë).

Pasi folëm për variantet e këmishëve tradicionale për gra, për të plotësuar kuadrin e zhvillimit të mëtejshëm të kësaj pjese të veshjes mund të shtojmë se, në she-

kullin tonë, sidomos mbas Luftës së Parë Botërore, së pari nëpër qytete dhe më vonë në fshatra afër tyre, filluan të përdreshin këmishë me prerje të modernizuara, krejt të shkëputura nga prerjet që përshkruam më lart. Veçoria që paraqet interes këtu është se, për konfexionimin e tyre, përdreshin ende pëlhurat e pambukta tradicionale të endura në shtëpi.

Një drejtim tjetër i evoluimit të mëtejshëm të tyre, sidomos në popullsinë fshatare, ishte zëvendësimi i pëlhurës së punuar në shtëpi me kambrikun, i cili, deri në çlirimin e vendit, importohej (faqell, humai etj.), kurse më vonë filloi të prodhohej në vend. Kjo bëhej sidomos për «këmishët e mira». Në këto raste këmisha bëhej me një të qepur tek beli dhe me një fund përgjithësisht të gjerë (me shumë kinda ose me rrudha).

Kjo tregon se, në popullsinë qytetare format e prerjes kanë evoluar më lehtë se vetë materiali, por këto forma tradicionale janë ruajtur mjaft mirë në fshat edhe kur ka hyrë në përdorim pëlhura e fabrikuar në vend të asaj shtëpiake.

Në ditët tona masa e gjerë e grave fshatare të zonave ku nuk mbahen më kostumet popullore, mbajnë zakonisht këmishë të pambukta puplini, me ngjyra të ndryshme. Ato qepen me porosi nëpër repartet e rrobaqepsisë në fshat ose shiten të qepura në njësitë tregtare lokale. Prerja e tyre është «me supe» ose «me tiranta».

Element i rëndësishëm në vlerësimin e këmishëve të grave është edhe zbukurimi i tyre.

Qartësia e vijave të prerjes, theksimi me qëllim dekorativ i vendeve të qepjes, ashtu si edhe zbukurimet e tjera, sidomos tek mëngët, janë bërë përgjithësisht me shumë shije. Megjithatë mund të vëmë në dukje se ky zbukurim paraqitej shumë i shkallëzuar: këmishët e përditshme zbuksoroheshin më pak, kurse ato për të dalë shumë më tepër.

Zbukurimi më tradicional i këmshëve të

74) Shih Rr. Zojzi, *Studime mbi veshjet kombëtare*, në «Buletin Institutit të Shkencave», Tiranë 1950, nr. 3, f. 80-92.

75) Shih skicën e prerjes me fig. në f. 155 të artikullit të A. Gjergjit, *Dy variante të veshjes së grave në rrjedhën e sipërme të Shkumbinit*, «Etnografia Shqiptare» IV, Tiranë 1972.

76) Ai thotë shprehimisht: «Këmisha zbret deri në nyjet e këmbëve dhe është aq e ngushtë sa i pengon të bëjnë hapa të mëdha. Kur duan të zbresin nga një qerre ato duhet të kërcejnë kupthi (me këmbë të bashkuara) për ndryshe do të rrezikonin që këmisha t'u çahet anëve». Shih, Hacquet «L'Illyrie et la Dalmatie», Paris 1790, vol. II f. 152.

grave kanë qenë pa dyshim «qenarët» apo «gishtat» dhe «ujsat», ato vija me gjerësi të ndryshme, që përshkonin pëlhurën së gjati. Ato bëheshin gjatë endjes dhe mund të ishin: a) me të njëjtën ngjyrë të fushës së pëlhurës (pra të bardha), por me fije më të trasha (si në këmishët e Korçës, të Shkodrës etj.) dhe b) me ngjyra të ndryshme: ngjyrë bezhë, kafe ose të zezë⁷⁷ në këmishët e pambukta të Hasit (rrethi i Kukësit) e të Rrafshit të Dukagjinit (Kosovë), ngjyrë të kuqe, të verdhë e të zezë në Dumre, Myzeqe etj.⁷⁸, ngjyrash të ndryshme mjaft të forta (portokall, lejla, të gjelbër etj.) në pëlhurat e Tiranës⁷⁹ etj. Këto vija a tufa vijash luanin pa dyshim një rol të madh dekorativ, duke e bërë këmishën një element më spikatës e më aktiv nga pikëpamja kromatike.



Fig. 169 — Këmishë Shpati

Të tjera elemente zbukurimi tek këmishët e grave ishin qëndisjet (vetëm me fije mëndafshi e pambuku, por jo leshi) ojat dhe rrexat e punuara me gjilpërë etj. të vendosura kryesisht tek jaka, mëngët e gjoksi dhe, në ndonjë zonë (si në rrethin e Shkodrës e të Lezhës) edhe tek supi (fig. 169, 170). Në këmishët e ruajtura në koleksionet tona muzeale janë fare të pakta ato që kanë qëndisje përfundi, kurse oja dhe dantela në mjaft raste kanë, ashtu si kanë edhe palëza, shirita të ndryshëm të aplikuar etj. Por mjaft gravura të shekullit të kaluar na tregojnë se ato kanë pasur zbukurime të ndryshme përfundi, sidomos këmishët e gjata të grave tek shqiptarët e Greqisë⁸⁰, ku për zbukurim janë përdorur edhe pare të vogla, të cilat mbulonin gjithë pjesën e këmishës përpara te gjoksi.⁸¹



Fig. 170 — Këmishë Zadrimë

prerjet e tyre, por mund të themi se janë zhvilluar më shpejt se ato të grave, sidomos për sa i takon futjes në përdorim të faqellit të fabrikuar dhe ndryshimeve në prerje.

Nga gjurmimet e deritanishme në terren dhe nga shqyrtimi i vëmendshëm i koleksioneve muzeale të veshjeve, duket se prerja e variantit 1 të këmishëve të grave nuk është përdorur për burra.

Këmishët e burrave, në krahasim me ato të grave, paraqesin më pak variante në

* * *

77) Objektet me nr. inven. 76/173, 76/184, etj.

78) Objektet me nr. inven. 5303, 9966 etj.

79) Objektet me nr. inven. 3073, 5781, 6118, 9414, 69/139 etj.

80) P.sh. këmishët apo linjat e gjata të Shpatit dhe figurat nr. 17, 8, 13, 14, në Stackelberg, *Moeurs et usages de la Grèce moderne*, Paris 1825, si edhe fig. 51, 52, 54 në kreun e parë të kësaj vepre.

81) P.sh. Kordinez që ka vizituar shqiptarët e Sremit rreth vitit 1850 thotë se gratë kelmendase në stinën e verës mbanin një këmishë prej pëlhure liri, që u arrinte deri te nyja e këmbëve dhe i tërë gjoksi deri në brez ishte i mbushur me pare të vogla.

Këmishët më të vjetra për burra kanë qenë këmishët e gjata, me shtat të drejtë, me një ose dy kinda të drejta në çdo anë dhe me mëngë të drejta, pra të *variantit* 2 A. Pjesa e kindave mbliidhej me rrudha tek sqetullari i vogël. Të tilla këmishë kemi nga Tirana, Shkodra etj.⁸² Të tjera këmishë burrash sidomos ato të Zadrimes⁸³, nuk i kanë kindat anësore të drejtë, por në formë trapezi (zakonisht 3, një më i gjerë e dy më të ngushtë) pra i përkasin *variantit* 2 B. Gjatësia e tyre lëkundej nga 90-95 cm.

Varianti 3 është i përfaqësuar rrallë në veshjet e burrave, për shkak se të shtuarit e gjerësisë së fundit është arritur me të tjera mjete, e në radhë të parë, me futjen në përdorim të faqellit të fabrikuar, i cili ishte më i gjerë se pëlhurat shtëpiake. Megjithatë, aty-këtu, ndeshen edhe këmishë me më shumë se 2-3 kinda në çdo anë, për të cilët është nevojitur pra më shumë se një fletë pëlhure.⁸⁴ Një ekzemplar nga Zadrime (fig. 171) ka 4 kinda në çdo anë, për të cilët janë nevojitur 3 fletë pëlhure.

Varianti 4, me trup të prerë, paraqitet me shkallë kalimi interesante. Kështu ka pasur këmishë burrash me shtat të drejtë, i cili që prapa, pa u ndërprerë te supet arrinte përpara deri në bel. Këtu pritej e i shtohet një pjesë e veçantë shumë më e gjerë. Anëve si zakonisht kishte nga dy kinda në formë trapezi, që fillonin që nga shpatullat. Pjesa e veçantë që i shtohet përpara nga beli e poshtë ishte shumë e gjerë, e bërë me 3-4 fletë faqelli që mblihdeshin me rrudha te beli (fig. 172)⁸⁵ ose e bërë prej 10-15 kindash në formë trapezi, (si ata të fustanellës), të cilët gjithashtu mblihdeshin me rrudha atje ku bashkoheshin me trupin e këmishës.⁸⁶

Këto janë këmishë të gjata, që viseshin me «cibunin» e bardhë ose blu, ku dukej disi vetëm pjesa e përparme e këmishës. Sikurse e kemi vënë në dukje edhe



Fig. 171 — Këmishë burri (Zadrime)

gjetkë, kjo bëhej për të imituar sadopak pamjen e fustanellës, e cila ishte, në fund të shek. XIX, veshja e preferuar e shtresave të larta të shoqërisë dhe vishej rrallë nga fshatarët ortodoksë (vetëm në kostumin e martesës e sa qenë të rinj në moshë).

Deri këtu evolucioni i këmishës së burrave ishte zhvilluar duke mbetur gjithmonë i lidhur me format tradicionale. Me kohë ai shkëputet krejtësisht prej tyre.

Që nga Shpallja e Pavarësisë, pjesa më e madhe e burrave fshatarë mbanin këmishë të shkurtra, sepse tashmë kishin dalë nga përdorimi si veshja me dollamë, ashtu edhe ajo me cibun, të cilat kishin pasur si pjesë themelore këmishën e gjatë.

82) Shih këmishët me nr. inv. 4678, 6012, 6137, 7668, 69/203 etj. në fondet etnografike të IKP, Tiranë.

83) Mund të sjellim për ilustrim këmishët me nr. inv. 69/346, 70/13, 70/248, 69/458 etj. në FE, Tiranë.

84) Këmisha me nr. inv. 69/4, si edhe një këmishë tjetër pa numër) në F.S.E., Tiranë.

85) Një këmishë burri me prerje të tillë ruhet në Muzeun Lokal të Korçës dhe vjen nga Opari (nr. inv. 716).

86) E tillë është këmisha me nr. 4771, Tiranë (me prejardhje nga rrethi i Korçës).




Fig. 172 — Prerje e një këmishë burri me shtesë përpara

Faqelli i fabrikuar hyri më shpejt e më gjerë në përdorim në veshjen e burrave se në atë të grave. Ai ofronte të tjera mundësi prerjeje, të cilat kursenin të qepurat e shumta të kindave. Shohim kështu që, nën ndikimin e qytetit, të futen në përdorim edhe në fshat forma të reja këmishësh. Për të ilustruar këtë kemi sjellë një prerje këmishë burri nga Dardha (rrethi i Korçës), këmishë e bërë prej faqelli të importuar⁸⁷.

Në evolucionin e përgjithshëm të këmishës së burrave ndryshim të dukshëm kanë pasur edhe elemente të veçanta të saj si janë mëngët, jaka, zbukurimet etj.

Në këmishët më të vjetra për burra, mëngët ishin zakonisht të drejta e të gjera, të bëra me 1,5-2 fletë pëlhere. Por kur filloi të përdorej faqelli i fabrikuar mëngët u shkurtuan deri në llërë dhe u zgjeruan shu-

më⁸⁸, duke u mbledhur me pala të dendura tek supi. Vemë re se kanë pasur të tilla mëngë të shkurtra e shumë të gjera ato këmishë që visheshin me fustanellën, brekeshat ose poturet. Mbas Luftës së Parë Botërore filluan të mbahen mëngë të drejta, jo shumë të gjera e të mbledhura me një kapak (dorëzë) 4-5 cm. të gjerë te kyçi i dorës, që mbërtheheshin me një kopsë të vogël të bardhë.

E çara për kokën në këmishët e burrave ishte përgjithësisht mendiane dhe në formë T, mjaft e hapur përpara, pothuaj deri në bel, por ndeshim edhe ndonjë rast me një të çelur në formë vije të drejtë, duke u prerë pëlhura së gjati. Këmishë me një të tillë të çarë për kokën janë përdorur p.sh. në Shkodër⁸⁹. Edhe forma e jakës së këmishëve të burrave ka ndryshuar nga një periudhë në tjetrën. Ka këmishë që s'kanë jakë fare, por veç një dantele mëndafshi të punuar me dorë, si është rasti i këmishëve të Shkodrës. Por shumica dërrmuese e këmishëve për burra kanë një rrip të ngushtë rrëzë qafës, që është pothuaj vetëm një mbrojtje e pëlhurës që të mos çahet më tej. Me kohë ky rrip vihet më i gjerë, e merr pamjen e një jake të vërtetë, me gjerësi 4-8 cm. që rri e ngritur lart⁹⁰. Në fazën më të fundit të zhvillimit, edhe këmishët e bëra prej pëlhere vegle e të qepura nga gruaja fshatare, kanë një jakë, që i afrohet shumë asaj të këmishëve të burrave qytetarë. Të tilla janë shumë këmishë të rrethit të Tiranës, të përgatitura nga gratë fshatare gjatë viteve '30 me pëlhura të mëndafshita e shumë të bukura, që i punonin me aq mjeshtri gratë e këtij rrethi.

Në këmishët e burrave, po ashtu si në këmishët e grave, elementi më tradicional i zbukurimit, përderisa ato bëheshin me pëlhere vegle të punuar në shtëpi, ishin qenarët e përdorur me shumë shije si në pëlhurat e pambukta, ashtu edhe në ato të mëndafshat. Sidoqoftë bie qartë në sy se në këmishët e burrave janë përdorur shumë më pak pëlhurat me vija ngjyrash të ndryshme sesa në këmishët e grave⁹¹ me përjashtim

87) Shih këmishën me nr. inv. 6204 në F.S.E., Tiranë.

88) Ka këmishë ku, mënga e shtrirë, arrin deri në 120-150 cm. gjerësi.

89) Shih këmishën me nr. inv. 4678 në FSE, Tiranë (Kjo e çelur është rreth 45 cm. e gjatë).

90) Jakat më të gjera i kemi në këmishët e burrave të Zadrimës. Shih p.sh. këmishën me nr. inv. 69/346, jaka e së cilës është 8 cm. e gjerë.

91) Përdorimin më të gjerë këto pëlhura me ngjyra në këmishët e burrave e kanë pasur në rrethin e Tiranës e në atë të Krujës.

të zonave verilindore të vendit e të shumë pjesëve të Kosovës. Tjetër element zbukurimi ishin qëndisjet e ndryshme që u bëheshin këmishëve zakonisht te jaka e ngushtë dhe te dorezat. Këtu shquhen për shijen e hollë këmishët e burrave të Zadri-mës⁹² (fig. 171). Dantelat janë përdorur gjithashtu, në vend të jakës (në këmishët e mëndafshita të burrave të Shkodrës). Të tilla zbukurime ishin edhe «rrexat» (dantela të forta), të përdorura në këmishët e Zadri-mës. Kurse në këmishët e konfeksionuara me faqell të fabrikuar, zbukurimet më të rëndomta qenë palëzat me tegel, përpara te gjoksi dhe përforcimet tek supet, të rrahura me tegela.⁹³

Në ditët tona shumica e burrave fshatarë të moshës së re e të mesme, mbajnë këmishë me prerje të njëjtë me atë që mbajnë punëtorët e qytetit, të cilat i blejnë të gatshme.

* * *

Nga sa thamë më lart del e qartë se këmishët tradicionale në vendin tonë si për gra dhe për burra i përkasin një tipi të vetëm, që karakterizohet nga shtati i drejtë i paprerë tek supet dhe mëngët që bashkohen me shtatin tek supi. Jashtë territorit të vendit tonë ky tip këmishë njihet edhe në vendet fqinje, në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik (pra në Greqi, e në popujt e Jugosllavisë) dhe shkon në lindje deri në Bullgarinë Veriperëndimore. Ndërsa në pjesën lindore të Gadishullit është më e rëndomtë këmisha me rrudha tek qafa, mëngët e së cilës nuk qepen me shtatin tek supi, por zgjaten deri tek qafa. Këta dy tipa këmishësh paraqesin, si dihet, ndryshime themelore midis tyre. Tipi i dytë nuk është hetuar, deri tashti, në asnjë vend të Shqipërisë.

Këmishët e përdorura në vendin tonë dallohen gjithashtu qartë nga tipi i «tunikës» antike, e cila bëhej me një copë pëlhere të vendosur horizontalisht, që varej lirshëm në trup, duke u kapur me fibula tek supet (ose vetëm në njërin prej tyre). Kështu, në njërin anë të trupit ajo mbetej krejt e hapur, në qoftë se nuk kapej me një fibul të gjatë.

Fakti që këmishën me shtat të drejtë e me mëngë e gjejmë të përdorur në gjithë pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik, fakti që ajo dallohet qartë si nga këmisha dake e pjesës lindore të Gadishullit (e paraqitur në monumentin e Adamklissit, shek. II e.s., Rumani), ashtu edhe nga tunika klasike greko-romake, na sugjeron, në mënyrë krejt të natyrshme, që t'i kërkojmë paraardhëset e saj në veshjen e banorëve të vjetër të Ballkanit Perëndimor, ilirëve. Nga koha e vjetër disponojmë tashmë të dhëna të qarta për këtë veshje të stërgjyshëve tanë ilirë. Ajo i përgjigjet asaj veshjeje që burimet⁹⁴ e cilësojnë me emrin «dalmatica», pra veshje e fisit ilir të dalmatëve, si e tregon vetë emri i saj dhe si na e dëshmon shprehimisht një autor i shek. II të erës sonë, Isidori, i cili shkruan: «Dalmatica vestis primum in Dalmatia, texta est.»⁹⁵ Nga monumentet e zbuluara brenda territorit të vendit tonë mund të përmendim disa: stela e gjetur në Drashovicë (Vlorë), që paraqet një mjeshtër me çekiç në dorë, (fig. 173), stela e gjetur në rrethin e Korçës, që paraqet dy farkëtarë, (fig. 174), stela e gjetur në Koplik (rrethi i Shkodrës) e ndonjë tjetër⁹⁶, ku paraqiten njerëz të veshur me dalmatikë.

Duke u udhëhequr nga qenarët e anëve dhe profili i drejtë i kësaj veshjeje, që paraqitej njësoj e gjerë si lart dhe poshtë, mendoj se ka shumë arsye të besojmë se, prerja e dalmatikave antike ishte shumë e ngjashme me atë të këmishëve të varian-

92) Shih p.sh. këmishën me nr. inv. 69/346, 70/227 etj. në FES, Tiranë.

93) Shih p.sh. këmishën me nr. inv. 6012 (FES, Tiranë) nga Rajca (rrethi i Librazhdit) për zbukurimet e saj interesante tek supet.

94) E Lampride, *Commodus Antonius*, VIII (Dalmaticatus in publico processit); po ai, *Heliogabalus Antoninus*, XXV (Dalmaticatus in publico post coenam saepe visus est) etj.

95) Cituar sipas Daremberg-get Saglio, *Dictionnaire des antiquités grecques et romaines*, Tom. II, f. 19, shën. 10.

96) Shih A. Gjergji, *Elemente të përbashkëta të veshjes së fiseve të ndryshme ilire dhe vazhdimësia e tyre në veshjet tona popullore në «Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve»* Tiranë 1969.



Fig. 173 — Mjeshtri i Drashovicës (štele varri i shek. II es)



Fig. 174 — Farkëtarët e Korçës (gur varri i shek. II-III es)

tit 2 A, në mos identike me të. Në mbështetje të këtij mendimi mund të sjellim përshkrimin që i bën dalmatikës një tekst i shek. IX që thotë: «Haec vestis in modum cruxis facta est».⁹⁷ Po të shohim skicën e prerjes së një këmishë të tipit 2A, e hapur plotësisht ajo merr vërtet formën e një kryqi. Pra ajo bëhej me shtatin një fletësh (prapa e përpara), të zgjeruar me nga një fletë pëlhere në çdo anë, që formonte kindin e drejtë. Këtij shtati i ngjiteshin mëngët, gjithashtu të drejta. Drejtimi i pëlhurës tek mëngët, në këmishët popullore, shkon përgjithësisht në drejtim të krahut. Por qenarët e mëngës së dalmatikës të paraqitur në një burim antik (fig. 175) na shtyjnë të mendojmë se pëlhura e mëngëve mund të vendoset edhe ndryshe, pra në të njëjtin drejtim me atë të shtatit. Në këtë rast gjatësia e mëngëve ishte e kushtëzuar nga gjerësia e pëlhurës. Kjo vendosje e

dytë madje ekonomizonte disa të qepura. Të tilla vendosje hasim në këmishët e Myzeqesë.

Për këto lidhje të ngushta të prerjes së dalmatikës ilire me atë të këmishëve tona popullore, është më i përshtatshëm karakterizimi i këtyre të fundit, ashtu si edhe i këmishëve të zonave të tjera të Ballkanit që kanë këtë prerje, si këmishë të tipit «dalmatika», si më i afërti tip veshjeje me to, i kohës antike në Iliri, pa qenë nevoja të adoptojmë terma të tjerë veshjesh shumë të largëta për trevat tona, si është p.sh., tipi «ponço» (i Amerikës Jugore), term ky i përdorur nga disa autorë në përshkrimet e këmishëve ballkanike.

Gjurmimet e zellshme të disa studiuesve mbi veshjet e fiseve të ndryshme ilire, interpretimin e paraqitjes së tyre në monumente të ndryshme të kohës dhe kraha-

97) Në rindërtimin që bën C.Bayet, në vendin e cituar në shënimin 93 nuk e zë në gojë këtë fletë (kind) anësore, por mendoj se po të udhëhiqemi nga drejtimi i qenarëve të pëlhurës do ta kuptojmë fare qartë praninë e saj.



Fig. 175 — Dalmatika (sipas Darembergut)

simet me veshjet popullore⁹⁸, e kanë sqaruar në mjaft anë të tij këtë problem me interes për historinë e kulturës sonë popullore.

Shumë burime të kohës së vjetër kanë treguar se ilirët merreshin me blegtori e bujqësi. Me anë tjetër dihet mirë se liri dhe kërpi janë dy bimë të kultivuara që herët në Gadishullin Ballkanik. Duhet të mendojmë, pra, që dalmatikat e stërgjyshëve tanë ilirë bëheshin prej pëlhurash të ndryshme (kryesisht liri e leshti) dhe me

cilësi të ndryshme. Kjo pasqyrohet deri-diku edhe në monumentet, ku kjo veshje herë është paraqitur më e trashë dhe e ngurtë (tek njerëz të thjeshtë si mjeshtri i Vlorës, gruaja e Dimalit etj.), herë si një pëlhurë e hollë dhe e derdhur. Në disa raste dallohen edhe qenarët (clavis). Kjo shumëllojshmëri e dalmatikave dëshmohet më vonë edhe tek Edikti i njohur i perandorit Dioklecian, i vitit 301 mbi çmimet,⁹⁹ ku përmenden dalmatika të ndryshme prej liri, leshti e mëndafshi, me qenarë (clavis) të purpurt ose jo, nga më luksozet deri tek më të thjeshtat, ku më të shtrenjtat kushtonin sa dhjetëfishi i më të lirave.

Prejardhja shoqërore e njerëzve të paraqitur në monumentet (barinj, farkëtarë, mjeshtër ndërtimi) dhe disa burime të shkruara, na lejojnë të pohojmë se, në kohën antike, dalmatika ishte veshje e shtresave të gjera shoqërore në Iliri, që u përhap me shpejtësi në të krishterët e kohës (si na dëshmojnë fresket e katakombeve) dhe arriti (në format e saj më luksoze) të hyjë edhe në përdorim të disa perandorëve të Romës, si Klaudi e Heliogabali.

Disa konstatime të tjera që mund të bëjmë janë këto: në njerëzit e shtresave të gjera të popullit, dalmatika ishte një veshje e gjatë deri në gjunjët. Ajo ishte më e gjatë (deri në pulpë të këmbëve) tek njerëzit e paraqitur në fresket e katakombeve dhe akoma më e gjatë si veshje perandorake.

Mbi dalmatikë burrat mbanin strukën (hlamis), të kapur me një fibul tek supi i djathtë, kurse gratë një tunikë të gjerë të kapur me fibula tek të dy supet dhe llabanën në kokë. Këto janë paraqitjet më të zakonshme në gurët e varreve të njohura deri tashti.

Me këtë kombinim, pra të veshur me një këmishë të tipit dalmatika, që shoqërohej me strukën e leshtë, të hedhur supëve duhet t'i mendojmë të veshur, jo vetëm ilirët e antikitetit të vonë, por edhe shqiptarët e hershëm (shek. VIII-XI), sipas gjetjeve arkeologjike të kësaj kohe, ku janë të zakonshme fibulat masive.

98) Shih bie fjala M. Tilke, *Das Kostümwerk*, Leipzig 1934, fig. 2, f. 100; një varg artikujsh të D. Sergejevskit, botuar në Glasnik Zemaljskog Muzeja (vit 1932-1941); J. Cremonnik, *Nosnja na rimskim spomenicima u Bosni i Hercegovini*, në Glas. Zem. Muz. Sarajevo 1963, f. 102-121; M. de Fontanés *Un element du costume propre à l'Europe, la chemise*, në *Vêtements et sociétés*, Paris 1981, f. 129, 133, A. Gjergji, *Veshjet popullore: Këmisha e grave*, «Etnografia Shqiptare» 11, Tiranë 1980, f. 23-67.

99) *Edictus Diocletianii, De pretiis rerum venalium*, Anno 301, shih T. Mommsen «Corpus Inscriptionum Latinarum» (vol. tertii, pars posterior), Berolini, MCCCCLXXIII.

Ruajtja gjerësisht e këtij tipi këmishe, si tip unik i këtij elementi të rëndësishëm të veshjes në vendin tonë, dëshmon për lidhjet intensive iliro-shqiptare.

X H O K A T

Kemi përfshirë nën këtë emërtim një numër të madh veshjesh të sipërme, të hapura përpara, përgjithësisht të leshta, me gjatësi që ndryshon nga nën bel deri nën gju, herë me mëngë e herë pa to, të cilat visheshin zakonisht përmbi pjesë të tjera më të holla veshjet, si ishin këmishët e gjata. Ato kanë qenë përdorur shumë në vendin tonë si nga burrat, ashtu edhe nga gratë. Që në gjysmën e parë të shek. XX shumica e tyre doli gradualisht nga përdorimi por, ka ende aty-këtu zona ku, individë të veçantë, sidomos të moshuar, vazhdojnë t'i përdorin edhe në ditët tona.

Në këtë grup do të analizojmë, në radhë të parë, ato xhoka, që konfeksionoheshin me pëlhura leshi (por edhe liri ose kërpi në disa raste) të prodhimit shtëpiak, të punuara me dy ose me katër lisa, shpesh herë edhe me thekë (flokë) përbrenda. Pothuaj në çdo rast xhokat e leshta ishin edhe të shkelura në shkaltore. Ishin zakonisht të bardha ose në ngjyrat e tjera natyrore të leshit (gri ose të murme), por edhe të ngjyera në të zezë ose blu të thellë. Vetëm në pak raste ndeshen xhoka prej shajaku të ngjyer në bojë të kuqe disi të mbyllët.¹⁰⁰

Xhokat qepeshin me dorë, me penj leshi ose liri të dredhur mirë, me ndihmën e gajtanit prej leshi ose pambuku, i cili ishte njëkohësisht dhe zburkimi i tyre. Si dihet, xhokat qepeshin jo vetëm nga gratë fshatare, por edhe nga mjeshtri xhokaxhi, i cili mund të ishte shëtitës dhe kalonte nga një fshat në tjetrin, duke qendruar për aq kohë sa të gjente punë, ose kishte

dyqanin e vet në pazar. Burimet dokumentare tregojnë se mjeshtrë xhokaxhinj ka patur në pazaret e qyteteve tona kryesorë, të paktën që në shekullin XVII.¹⁰¹ Dihet mirë se xhokaxhinjtë qepnin vetëm rrobe shajaku, si për gra e për burra.

Gjatësia e xhokave luhatej shumë por kjo nuk luan ndonjë rol me rëndësi në përcaktimin e tipologjisë së tyre. Këto veshje, në shumicën e rasteve, paraqiten pa mëngë, por ka pasur edhe shumë xhoka me lapa tek supet (me forma e madhësi të ndryshme). Lapat janë një element që ndeshet sidomos në xhokat e grave të Mokrës (rrethi i Pogradecit), të Shpatit (rrethi i Elbasanit) dhe të rrethit të Librazhdit. Kishte gjithashtu xhoka me mëngë të shkurtra përmbi bërryl dhe të tjera me mëngë të gjata. Zona më tipike për xhoka me mëngë të shkurtra ishte rrethi i Sarandës. Për kohë të ftohtë ose në raste ceremoniale të ndryshme, visheshin mbi njëra tjetrën dy-tri lloje xhokash, nga të cilat vetëm njëra mund të ishte me mëngë të gjata. Shumë xhoka qenë të pajisura me kapuç ose me një jakë të madhe që mund të kthehej lehtë në kapuç. Gjerësia dhe forma e kindave anësorë, në raport me gjatësinë e vetë shtatit të xhokës, luante një rol me shumë rëndësi në siluetën e saj, pra edhe në pamjen e bartësit.

Xhokat, lidhen gjenetikiisht me këmishën, prandaj në grupimin e tyre do t'u përmbahemi të njëjtave kritere që kemi ndjekur për këmishët. Kjo lidhje qëndron: a) në shtatin e drejtë, i cili edhe në xhokat ndeshet shumë herë i paprerë tek supet; b) në praninë e mëngëve, në formimin e të cilave merr pjesë në disa raste vetë kindi anësor, ashtu si e kemi vënë në dukje edhe tek këmishët; c) në praninë e kindave anësorë, të cilët në xhokat më të thjeshta fillojnë që nga sqetulla. Mund të vëmë në dukje se tek xhokat pikërisht zhvillimi i mëtejshëm që kanë marrë këta kinda anësorë e shkëputja e tyre nga sqetullari, kanë sjellë transformime të shumta në pamjen e jashtme të tyre, si do ta shohim me hollësi më poshtë. I njëjti mendim krejt tjetër, për sa i përket gjenezës

100) E tillë ishte dollama e vajzave në zonën e Zerqanit (rrethi i Dibrës). Dollama të kuqe kanë mbajtur edhe gratë e reja në Zadrinë, në veshjen e përditshme. (Një të tillë e kam fotografuar në fshatin Gramsh në vitin 1969. Shih filmin 313, Fototeka etnografike), IKP, Tiranë

101) Z. Shkodra, *Esnafët shqiptarë*, Tiranë 1971; f. 62 përmend një xhokaxhi në Elbasan që në gjysmën e parë të shek. XVII.




Fig. 176 — Prerja e jakucës

së këtij elementi të veshjes, është etnografi Rr. Zojzi.¹⁰²

Duke shqyrtuar me kujdes prerjen e një numri të konsiderueshëm xhokash nga zona të ndryshme të vendit, kemi arritur që, krahas larmisë së tyre, të dallojmë edhe tiparet e përbashkëta e t'i grupojmë si vijon:

I. — **Jakucet** (xhoka të shkurtra shajaku, me mëngë të shkurtra e një jakë të madhe katrore prapa). Prerja e tyre ishte fare e thjeshtë (fig. 176). Si shihet shtati përbëhej nga një fletë shajaku që shkonte që prapa përpara pa u prerë tek supet, veç hapej përpara përgjysmë. Kindi anësor dhe mënga e shkurtër formoheshin me një fletë tjetër shajaku, si tregohet në figurë. Një pjesë e gjatësisë së kësaj flete, e palosur së gjati, formonte kindin anësor, kurse pjesa tjetër, e palosur së gjeri, formonte mëngën e shkurtër. Në format më

të zhvilluara mënga pritej veçmas nga kindi anësor. Për ta bërë të rrinte më lirshëm në trup, edhe shpinës i shtoheshin dy rripa, të gjerë deri në 10 cm. të cilët e zgjeronin atë. Formë të tillë ka patur p.sh. «guja» (ose «hërka») që mbahej si në Nikaj të rrethit të Tropojës, ashtu edhe në një pjesë të madhe të Kosovës.

Ky element veshjeje njihej me emra të ndryshëm sipas krahinave ku përdorej. Kështu në Çermenikë, në Grykën e Xarranikës e zona të tjera të rrethit të Elbasanit ashtu si edhe në rrethin e Tiranës ajo thirrej «jakucë», (fig. 177), në rrethin e Matit «xhuli» ose «xhëli», në krahinën e vogël të Prellit (rrethi i Matit), «xhupe», në Mirditë, Kurbin, Zadrimë e malësitë e Shkodrës «xhurdi» ose «gjurdi», pastaj në Martanesh e në një pjesë të rrethit të Elbasanit «mrosë», në rrethin e Dibrës e në Lumë «kaporan» ose «kopran», në rrethin e Tropojës e në Kosovë «gujë» ose «hërkë» etj.

102) Shih për këtë studimin e tij *Guna në veshjet tradicionale të popullit shqiptar dhe të popujve të tjerë ballkanikë*, në «Etnografia Shqiptare» III, Tiranë 1966, f. 3-42.



Fig. 177 — Burrë me jakuce

Të gjitha këto variante lokale e krahinore të kësaj xhoke kanë të njëjtën prerje që u përshkrua më lart, bëhen të gjitha prej shajaku të zi, me përjashtim të Kosovës ku mbahet edhe e bardhë dhe të ndonjë ekzemplari të rrallë prej leshi të murmë që kam hasur në rrethin e Matit. Në Dibër, Lumë e Kosovë, jakucja ishte më e gjatë dhe rrinte disi më e lirë në trup, kurse ajo e Tiranës, Krujës etj. ishte më e shkurtër dhe disi e ngrirë nga zbukurimet e shumta.

Ky element veshjeje përdorej që nga Çermenika e Elbasani në gjithë Shqipërinë e Veriut si edhe në Kosovë, ishte pra një element me shtrirje të gjerë ndër-krahinore.

Në Çermenikë jakucja nuk kishte qëndisje e tufa, po kështu edhe në Grykën e Xarranikës (rrethi i Elbasanit) Në këto zona ajo vishej mbi dollamë, vetëm nga burrat. Por, kur në vend të dollamës burrat e shtresës së pasur vishnin fustanellën

me xhamadan cohe të kuqe, edhe jakucet i mbanin të zbukuruara me qëndisje të ndryshme me gajtan të zi, madje edhe me copa të vogla cohe të kuqe në cepat e jakës. Nën ndikimin e Tiranës filluan t'u venë edhe tufa e «shkrime» (qëndisje me gajtan)¹⁰³.

Në gjithë luginën e Matit, në Prell, në Lurë, në Mirditë, në Kurbin e Fushë-Krujë etj. jakucja ose «gjurdia» si thirrej në këto anë, vishej mbi dollamë e më vonë edhe me kostumin me tirq. Në shumë nga këto zona «gjurdinë» e mbanin jo vetëm burrat por edhe gratë, të zbukuruar me tufa e thekë. Nga këto qëndisje të shumta dhe nga materiali i ashpër që përdorej, jakucja në këto zona ishte kthyer në një petk të rëndë e të ngrirë që vështirësonte mjaft lëvizjet e gjymtyrëve të sipërme të trupit. Në Tiranë, Kavajë, Peqin etj. jakucet me shumë tufa e thekë janë mbajtur edhe të shoqëruara me brekushet e bardha.

Jakucja diku nuk zbukurohej fare, si në Dibër e në Lumë, bile qepej pa përdorur gajtan, diku zbukurohej vetëm me gajtan të zi, i cili spikaste shumë bukur mbi shajakun e bardhë, si p.sh. në Kosovë (fig. 178). Ekzemplarët e zonave perëndimore ishin të zbukuruar me qëndisje të dendura me fije leshi të zi, përpara te gjoksi, te jaka e te mëngët; thekë të gjata u vareshin prapa tek jaka e tufa të dendura dekorative u viheshin te mëngët. Motivët e qëndisura me fije leshi janë shumë arkaikë dhe paraqesin interes për ngjashmëritë që bien në sy midis tyre dhe motiveve të repertoarit të ornamentikës ilire.¹⁰⁴

Xhurditë që mbahehin në Malësinë e Madhe të rrethit të Shkodrës kanë patur për zbukurim tek gjoksi e pikërisht te pjesët e shpërvjelura, dy rripa cohe të kuqe, të gjera 5-6 cm.¹⁰⁵ F. Nopcsa e ka përshkruar imtësisht xhurdinë, ka shprehur konsiderata të ndryshme në lidhje me të, por nuk ka mundur të zbulojë lidhjet midis saj dhe elementesh të tjera të veshjeve tona.

Si u përmend edhe më sipër, jakucet kanë qenë përgjithësisht të zeza. Shumë gojëdhëna tregojnë me këmbëngulje se ato kanë filluar të mbahen të zeza mbas vdekjes së Skënderbeut, në shenjë zije për këtë hero të madh.¹⁰⁶

103) Shih Arkivi Etnografik, Raporte të vitit 1949.

104) Shih A. Gjergji, *Përkime midis ornamentikës popullore shqiptare e asaj ilire*, në «Kuvendi I i Studimeve Ilire», Tiranë 1974 v. II.

105) F. Nopcsa, *Albanien*, Leipzig und Wien 1925, f. 167.

106) Almanaku «Dibra», Peshkopi 1963, f. 47.



Fig. 178 — Burri guje të bardhë (Rugovë)

Të njëjtën prerje me jakucet ka edhe xhoka e grave të Malësisë së Tiranës (fig. 179), e bërë gjithashtu prej shajaku të zi, por disi më e gjatë (rreth 60 cm.). Ajo vjen më e gjerë se jakucja dhe ka zbukurime të një natyre tjetër, me aplikime gajtani e shiritash dekorativë me ngjyra të forta (të kuqe, të verdhë e të gjelbër). Jaka katrore nuk rri e hapur në shpinë si tek burrat por është e qepur në formë kapuçi (shih obj. nr. 9178).

Shumë e ngjashme në prerje është «guja» e gjatë e malësorëve e paraqitur nga Nopcsa¹⁰⁷. Për përdorimin e gjerë të jakuces ose xhurdisë në Shqipërinë e Veriut gjatë shekullit XIX dëshmojnë materialet e shumta ilustrative që kemi paraqitur në Kreun e parë. Një autor i mesit të shekullit XIX thotë: «Për kohë të ftohtë dhe shi




Fig. 179 — Xhoka e grave të Malësisë së Tiranës

shqiptarët gegë mbajnë një petk në formë shalli (strukën) dhe rrallë një mantel ose «guje» «ku më të shkurtër ku më të gjatë, ngjyrë të errët, që vishet mbi dollamën»¹⁰⁸.

Në pjesën jugore të vendit deri tani nuk është hetuar ndonjë veshje e sipërme me prerje analoge me atë të jakuceve.

Jashtë vendit tonë veshje me prerje të ngjashme ose të afërt me atë të jakuces gjejmë në disa popuj të Evropës Juglindore dhe tek manteli i gjatë i barinjve të fushave të Panonisë (Hungari) që thirret «szur», me të cilin është marrë gjerësisht në një studim të vetin V. Zherver-Molnar.¹⁰⁹

II. — Në grupin e dytë do të analizojmë një varg xhokash me shtat të drejtë, të shkëputur ose jo tek supet dhe me kinda të ndryshme. Këta kinda anësorë ishin të drejtë ose në formë trapezi të stërgjatur. Duke qenë se shajaku i përdorur ishte mjaft i ngushtë (24-28 cm.) shpeshherë edhe peqinjve u shtohet përpara një kind i ngushtë që xhoka të arrinte ta mbështillte disi trupin.

Ekzistojnë një varg emrash lokalë për të treguar variante të ndryshme të këtij elementi të veshjes: xhup ose xhupe: gjaheng ose gjehe, nemte, nete ose nipte, dollamë, qashë, pec, nallutë etj. dhe më e përhapura nga të gjitha xhokë ose xhoke.

Duke u udhëhequr kryesisht nga for-

107) F. Nopcsa, *Albanien*, 1925, Tab. V, d.)

108) Boué, *Turquie d'Europe*, Paris 1843, vol. II, f. 224.

109) V. Gervers-Molnar. *The hungarian «Szur» an archaic mantle*, Toronto (Canada, 1973).

ma e kindave anësorë në këtë grup të madh xhokash mund të dallojmë disa, variante.

1) Xhoka me kinda që fillonin nga sjetulla e vazhdonin duke u zgjeruar deri poshtë. Megjithëse i vogël ky grup tërheq vëmendjen për dy arsye: e para, ai afrohet më shumë me prerjen e këmishëve tradicionale ku, si e kemi treguar më lart, kindat fillonin gjithashtu nga sjetulla dhe, e dyta, pikërisht për shkak të mungesës së sjetullarit këto xhoka paraqesin një siluetë të veçantë ku beli nuk theksohej, kurse fundi vinte mjaft i gjerë.

Të tillë prerje kanë patur «dollamat» e gjata të grave në Postrisë (rrethi i Shkodrës) që visheshin vetëm për nusëri. Një ekzemplar i tillë ndodhet në Muzeun popullor të Shkodrës, një tjetër në fondet etnografike në Tiranë¹¹⁰ etj. Sipas një informate të mbledhur në vitin 1950 në fshatin Vranisht të rrethit të Vlorës, edhe «sharka» e grave të kësaj zone ka pasë kinda që fillonin që nga sjetulla. Në të dy rastet vëmë re se kindi nuk vendosej drejt, por pak pjerrëtas duke e rritur kështu diçka më tepër gjerësinë përfundi.

2) Xhoka me kinda që fillojnë nga beli e zgjaten poshtë. Ato janë të shumta dhe kanë qenë në përdorim në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Sjetullari që plotëson te kindin, kishte formën e një trapezi ose të një trekëndëshi. Pra do të dallojmë:

a) Xhoka me kindin dhe sjetullarin në formën e një trapezi. Kindi përbëhej prej një, dy ose më shumë copash.

Të gjitha këto xhoka vinin të ngushta, kishin një profil të drejtë, nuk arrinin ta mbështillnin gjithë trupin, por mbulonin vetëm shpinën dhe anët.

Xhokat ku kindi përbëhej prej një cope të vetme, kishin një pamje të thjeshtë, kurse ato ku kindi përbëhej prej disa copash të ngushta fitonin një pamje më të hijshme, për shkak të gajtanëve që vihehin tek të qepurat dhe zbukurimeve të tjera me karakter dekorativ.

Ndër xhokat më të bukura të këtij grupi mund të përmendim atë të një gruaje të fotografuar nga K. Idromeno, rreth vitit 1900 (fig. 180), krejt e ngjashme me atë të një gruaje nga Shoshi (me nga pesë kinda fare të ngushtë në çdo anë) (foto 181 a, b), si edhe një tjetër nga Puka (me nga



Fig. 180. Grua me xhokë (dollamë) rreth vitit 1900 (foto Idromeno)

shtatë kinda të ngushtë në çdo anë) të dyja prej shajaku të bardhë, me mëngë të gjata dhe me zbukurime interesante.¹¹¹ E afërt në prerje (me nga katër kinda në çdo anë), por jo aq e zbukuruar është edhe një «dollamë» gruaje nga Pllana (rrethi i Lezhës).¹¹²

b) Xhokat me kindin dhe sjetullarin në formë trekëndëshi. Këtu xhoka merrte një formë me bel të theksuar, që binte mjaft në sy dhe e dallonte profilin e saj nga ai i xhokave të tjera.

Megjithëse nuk kanë patur shtrirje të gjerë, këto xhoka paraqesin interes, sepse, në shumë raste ato janë të paprera tek supet (ose tek njëri sup), dhe me këtë tipar prerja e tyre afrohet shumë me prerjen e këmishëve tradicionale, kurse tek forma e kindit i largohen. Për shkak të ngushtësisë së tyre, ato rrinë pas trupit. Për t'u dhënë pak më tepër gjerësi shumë herë

110) Instituti i Kulturës Popullore, Fondet etnografike, Nr. inv. 2947.

111) Objektet me nr. inv. 467 dhe 452 në Fondet Etnografike, Tiranë.

112) Objekti me nr. inv. 4625, po aty.



Fig. 181 — Xhokë (dollame) shajaku të bardhë nga Shoshi (nr. inv. 4529 FE)

pëqinjve u shtohet përpara një kind i ngushtë, (shih prerjen në fig. 182) që të mund të arrijnë ta mbështjellin trupin.

Xhokat e këtij grupi që njohim deri tani janë bërë vetëm prej shajaku të bardhë. Ato janë mbajtur kryesisht në Malësinë e Tiranës, me gjatësi që arrijnë në 70-80 cm., si edhe në zonën e Pogonit në rrethin e Gjirokastrës, ku gjatësia arrijnë deri në 90 cm.

Jashtë territorit shqiptar xhoka me kinda të tillë trëkëndësh kanë qenë përdorur në disa zona të Maqedonisë, por me disa dallime nga tonat, sepse kindi i tyre vjen më i gjerë, xhoka është më e shkurtër e zbukurimet ndryshojnë shumë nga tonat.

III. — Një grup të gjerë formojnë xhokat me shtat të drejtë deri në bel dhe shumë të gjerë nga mesi e poshtë, për shkak të një kindi në formën e një sektori rrethi, i cili shumë herë i hap vend vetes të beli duke ngushtuar pjesën e prasmë të shtatit (shih prerjen e një xhoke të tillë në fig. 183 a). Në këtë grup ndeshen xhoka me gjerësi të ndryshme, në funksion të gjerësisë së kindit anësor në formën e një sektori rrethi që mund të luajë nga 45° deri 200°-230°. Në figurat 183 b, c shihen




Fig. 182 — Prerja e xhokës së bardhë të Malësisë së Tiranës (inv. 8636 FE)

disa forma të këtij kindi dhe mënyra sesi vendoset fleta e shajakut në to, gjerësia e të cilit ndryshon nga 22-32 cm.

Xhokat me kindin anësor të gjerë më pak se një çerek rrethi janë përdorur nga gratë e disa krahinave të Shqipërisë Jugore, ndër të cilat mund të përmendim «cibunet» me mëngë të shkurtra të disa zonave të rrethit të Kolonjës e të Korçës. Kinda më të gjerë se një çerek rrethi janë përdorur si për cibune grash, ashtu edhe për cibune burrash. «Flokatat» qofshin ato të grave (që kanë qenë përgjithësisht të zeza e me gajtan të kuq anëve), qofshin ato të burrave (që kanë qenë krejt të bardha) kanë patur nga një kind anësor në formë gjysmërrethi ose diçka më të gjerë se kaq. Kur vishej flokاتا këta kinda lëshoheshin në pala të thella anëve, duke e rritur së tepërmi vëllimin e pjesës së poshtme të saj. Burrat e vishnin flokatën përmbi fustanellë, kurse gratë përmbi një




Fig.182 — Prerja e xhokës së bardhë të Malsisë së Tiranës (inv. 3636 FE)





Fig.183 — Prerja cibunësh (a)



b




Fig. 183 (b, c) — Prerje cibunësh

fustan të trashë shajaku ose përmbi «cibunin», në kohë dimri.

Flokata e bardhë e burrave ka qenë shumë e përhapur në Shqipërinë e Jugut gjatë gjithë shek. XIX dhe përshkruhet nga autorët e kohës si një veshje elegante e burrave shqiptarë. Është paraqitur në shumë gravura të kohës ndër të cilat vlen të përmenden ajo e një oficeri shqiptar (vizatuar nga Stackelberg në vitin 1815) dhe ajo e një burri tosk në dy gravura të Valerios (me 1876) (për të cilat shih fig. 39, 40).

Ky grup xhokash, si shihet, janë përdorur më shumë në Shqipërinë e Jugut dhe njihen me disa emra lokale si p.sh. cibun, shengun, flokje e flokatë, në ndonjë rast edhe sharkë. Por disa fotografi të fillimit të shek. XX tregojnë se janë përdorur edhe në Shqipërinë e Veriut¹¹³ (fig. 184, 185, 186).



Fig. 185 — Xhokë e bardhë (sipas A. Haberlandt)



Fig. 184 — Veshje malsorje me xhupetë e xhokë (foto K. Idromeno)



Fig. 186 — Veshje malsoreje me xhupetë e xhokë 1875 (foto Marubi, RA — 40/12)

113) Haberlandt. *Volkskunst der Balkanländer*, Wien 1917, Tab. XVII, fig. 2 dhe ndonjë fotografi e Marubbit (Shkodër).

Veshje të ngjashme në prerje me xhokat e grave të këtij grupi kanë qenë përdorur edhe në vise të ndryshme të Greqisë e të Bullgarisë ku thirreshin «cibune», «shegunë», «saja» etj.

Ky grup i xhokave s'ka dyshim se e ka ndier mjaft thellë ndikimin e disa veshjeve bizantine e në radhë të parë të «sajës», sidomos në zhvillimin që kanë marrë kindat anësorë të saj, sikurse e kanë vënë re edhe disa studiues të tjerë.

IV. — Xhokat me trup të prerë veçmas nga fundi i kemi përmbledhur në një grup më vete. Shtati i drejtë me gjerësinë e fletës së shajakut ndërpritet në bel si prapa dhe përpara. Pastaj i shtohet fundi, i cili është formuar nga shumë kinda të ngushtë në formë trapezi të qepur njëri mbas tjetrit. Në këtë grup hyjnë koretë dhe gүнëza, të përdorura në Bregun e Bunës e në Zadrimë etj. që bënin pjesë vetëm në veshjen e nuseve të reja. Një prerje shumë të afërt me to paraqet «dollama» prej cohe vishnje me mëngë të gjata, e përdorur në Mavrovë të Dibrës së Madhe.¹¹⁴

Format e xhokave që shqyrtoam përmbledhtas deri këtu, kanë qenë format më tradicionale, në përdorim të gjerë të masave fshatare. Nuk janë përfshirë në këtë shqyrtim një mori veshjesh të tjera të konfeksionuara me material të prodhuar jashtë ekonomisë shtëpiake, nga manifaktura të ndryshme të kohës. Ato përdorehin nga shtresat e pasura të shoqërisë shqiptare dhe me kohë gjetën përhapje më të favorshme në popullsinë e myslimanizuar. Ndër materialet që mbizotëronin për këto lloj veshjesh ishin «drilla» e pambuktë, mjaft e qëndrueshme dhe allaxhaja, si më të përhapurat e më të lirë, kurse për shtresat e larta, e sidomos për veshjet e martesës, parapëlqejesh coha e zezë, kafe ose e kuqe, pastaj kadifeja ngjyrë vjollce ose të kuqe të mbyllët dhe, për aristokracinë e kohës, atllase të ndryshme e brokarte të kushtueshme. Në shekullin e kaluar të tilla veshje cohe kishin hyrë në përdorim edhe në shtresat tregtare-zejtare të krishtera në zona të ndryshme të vendit, të cilat përdornin më fort ngjyrën blu e për rast martesë të kuqe. Pjesët e konfeksionuara me këto materiale merrnin shumë herë emrin e vetë materialit me të cilin përgatiteshin: cohë,

allaxha etj., por kemi edhe emërtime të tjera, si: anteri e gjatë, dolloma, fermele, pirpiri dhe, më e përhapura, xhybe.

Në këto veshje ruhej përgjithësisht tradita e veshjeve aristokratike bizantine e ndërthurur vazhdimisht me rrezatimin kulturor të qendrave islamike, që i mbajti gjallë për disa shekuj këto veshje në gjithë popujt e Ballkanit. Kjo duket qartë si në përdorimin e ngjyrave të ashtuquajtura «mbretërore» (e kuqe, vjollcë, e gjelbër) ashtu edhe në zbulimet e rënduara me qëndisje me fije ari, të një përsosmërie që të habit. Jehona e këtyre veshjeve të rënda e luksoze ndihej ende mjaft e fuqishme në vendin tonë gjatë shekullit XIX e deri diku edhe në fillim të shek. XX. (fig. 187, 188). Fakti që në shekullin e kaluar ende një numër i konsiderueshëm rrobaqepësish qëndistarë (ilakçinj) e ushtrojnë me përfitim zejën e tyre në disa nga qendrat qytetare kryesore të vendit, si: Berati, Elbasani, Shkodra, Peja, Prizreni etj. dhe, më anë tjetër, fakti që edhe mbas Çlirimit muzetë tona në qendër e në rrethe kanë mundur të grumbullojnë pa vësh-



Fig. 187 — Cohë gruaje nga Lunxheria

¹¹⁴) Shih objektin me nr. 347 në fondet etnografike të Institutit të Kulturës Popullore (Fundi i saj përbëhet nga 31 kinda).




Fig. 188 — Xhybe me dragua

tirësi, një numër të konsiderueshëm pjesësh të tilla veshjeje, tregon se përdorimi i tyre në shekullin e kaluar nuk ka qenë tepër i kufizuar, pra shtrihej përtej aristokracisë së lartë qytetare, në shtresat e larta e të mesme zejtare dhe, elemente të veçanta, të një cilësie pak më modeste, edhe në fshat.

STRUKAT, TALLAGANET ETJ.

(Veshje që hidhen supeve)

Veshjet e sipërme që hidheshin supeve për kohë të keqe kanë qenë përdorur gjerësisht nga popullsia fshatare e vendit tonë. Ato bëheshin prej tekstilësh të leshta, të punuara me dy ose me katër lisa dhe të shkelura në dërstilë. Në disa raste (si në bërrucat labe) ato kishin edhe thekë (flokë) në njërën anë. Kishin përgjithësisht ngjyrën natyrore të leshit dhe vetëm rrallëherë, për gunat më të mira (larat a laroshet), leshi ngjyhej i zi. Ato hidheshin supeve përmbi të gjitha veshjet e tjera.

Duke mbajtur parasysh formën e tyre këto veshje të sipërme mund t'i grupojmë si vijon: 1) Ato me formë katërkëndëshi

kënddrejtë, 2), ato në formë gjysmërrethi, dhe 3) ato që kanë formë pothuaj rrethore.

1). — Tipit të parë i përkasin strukat në formën e një shalli katërkëndësh kënddrejtë; me gjerësi 70-90 cm. dhe gjatësi 180-220 cm. Ato bëheshin zakonisht me një fletë pëlhure të leshtë të bardhë, me thekë të shkurtër në të dy skajet. Herëherë kishin edhe ndonjë bordurë motivesh të thjeshta gjeometrike. Struka mbahej zakonisht e hedhur supeve, (fig. 189), por, në kohë rreshjesh, ajo vihej edhe mbi kokë dhe, që të qëndronte më mirë, kishte një copë të vogël trekëndëshe të qepur në gjysmën e gjatësisë së saj (shih. fig. 190). Këtë lloj struke e përdornin si gratë, ashtu edhe burrat në zonën e Postribas (rrethi i Shkodrës),¹¹⁵ po deri nga fillimi i shekullit tonë të tilla struka mbaheshin me sa duket në tërë Lekninë (ose Dukagjinin e vjetër), si dëshmojnë vargjet e një kënge popullore.




Fig. 189 — Postribas me strukë të bardhë, rreth vitit 1880 (foto Marubi)

115) Shih objektin me nr. inv 837 (nga Drishti) në Muzeun popullor të Shkodrës.




Fig. 190 — Prerja e strukës

— Atje m'at vathë qi na ranë
Të tanë lekë strugjebardhë..¹¹⁶

Udhëtari A. Boué, gjithashtu aty nga mesi i shek. XIX dëshmon se ato «kanë qenë përdorur nga shqiptarët gegë për kohë të ftohtë dhe shi».¹¹⁷

E po këtij tipi, po me përmasa më të reduktuara, ishte struka që mbahej nga gratë në disa zona të rrethit të Korçës, që bëhej me dy ose më shumë fletë shajaku të zi (me përmasa 72x100 cm) dhe mbërthehej përpara te gjoksi me një kapse¹¹⁸.

Jashtë vendit tonë elemente veshjeje të këtij tipi njihen edhe në popujt e tjerë të Evropës, por sidomos në Mal të Zi.¹¹⁹

2) — Tipi i dytë, është si një zhvillim i mëtejshëm i të parit, bërë me tri ose më shumë fletë të vendosura horizontalisht, duke rrumbullakosur dy cepat e poshtëm, që të mos pengojnë ecjen. Kjo veshje kështu e ndërtuar merrte pothuaj formën e një gjysmërrethi. Në zona të ndryshme të vendit ajo merrte emra të ndryshëm dhe përmasat qenë diku më të vogla, diku më të mëdha.

Në Malësi të Madhe (rrethi i Shkodrës) ajo thirrej *tallagan*, bëhej prej shajaku të zi, kishte një kapuç të qepur te qafa e shumë të zbukuruar. Diametri i saj arrinte në 2 m (fig. 191 a, b).

Në Labëri thirrej *bërruc*, bëhej prej leshi me thekë të gjatë në tërë sipërfaqen dhe dërstilej. Diametri i saj arrinte 240 cm (fig. 192). Bërruci nuk kishte kapuç. Në kohë reshjesh shoqërohej me llabanen. E mbanin vetëm burrat.

Përmasat më të mëdha në veshjet e këtij lloji i kishte *japonxha* që mbanin burrat në Kosovë. E tillë është prerja e një japonxhe të mbajtur në katundin Isniq të rrethit të Pejës.¹²⁰ Diametri i saj arrinte në 230 cm. Bëhej me 5 fletë shajaku të bardhë zbukuruar anëve me gajtan të zi. Ishte e pajisur edhe me kapuç dhe kishte një pamje shumë piktoreske (fig. 68, kreu II).

3). — Tipi i tretë i këtyre veshjeve të sipërme, kishte pothuaj formën e një rrethi (shih fig. 69) dhe ndonjëherë pajisej përveç kapuçit edhe me mëngë dekorative

116) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*; vëll. III, Tiranë 1962, f. 349, 586.

117) A. Boné, *La Turquie d'Europe*, Paris 1846, vëll. II, f. 224.

118) Shih fig. 8-9 në «*Veshja e vllahve të rrethit të Korçës*» nga A. Gjergji, në «*Etnografia Shqiptare*», III, Tiranë 1966.

119) Shih më gjerë tek P. Tomić, *Struka kao des narodne nosnje*, në «*Zbornik Etnografskog Muzeja Beogradu*», Beogradu 1953.

120) Materiale të ekspeditës etnografike në Kosovë, shkurt 1972 (Arkivi etnografik, IKP).





Fig. 191 — a) Grua me tallagan (Malsi e Madhe, Shkodër)



b) skicë e prerjes së tallaganit




Fig. 192 — Skicë e prerjes së brucit

(të mbyllura) që vareshin prapa. I përkasin këtij tipi shumica e *gunave* të Shqipërisë së Jugut, të cilat thirreshin edhe *lara* ose *laroshe* kur bëheshin me lesh të mirë.

Këto veshje të sipërme dimri njihen edhe në variante më të thjeshta, me emra të tjerë si *killashë* (Polis), *çile* dhe *vilare* (Myzeqe), *tallagane* (Fusha e Korçës) etj.

Rëndësia që i është dhënë gunës në zonat e Jugut theksohet nga fakti se dikur, me rastin e martesës, djali që martohej do të bënte me çdo kusht një gunë të mirë.

Guna ishte jo vetëm një veshje mbrojtëse për kohë dimri, por edhe veshje e rasteve të mëdha. Me gunën e mirë burri do të shkante në qytet ditën e pazarit, do të udhëtonte për të shkuar në festa e gosti etj. Gunat do t'i merrnin me vete përgjithësisht ata që shkonin krushq me kuaj për të marrë një nuse. Por guna ishte shoqe e pandarë e barinjve dhe e komitëve të cilëve u shërbente edhe si mbulesë për të fjetur natën. Të gjitha këto funksione të gunës i shohim të pasqyruara edhe në shumë shprehje popullore, e proverba të ndryshme, ndër të cilat mund të përmendim disa: Ku ke punën shtro gunën; Puna si guna; Kërko gunë mos kërko gjumë; Kush është për udhë shkopnë dhe gunën; Gun' e huaj s'të mban ngrohtë, etj.

Për sa u përket llojeve të *gunave* vëmë re se, nëpër vargje të këngëve popullore përmenden guna të bardha (o shqiptarë o gunëbardhë/ Pse muartë përpjetë malë/ Th. Mitko), guna të murme (O Mete palla, s'u tunde/ E shtrove gunën e murme/ S. Dine) guna të dhirta (p.sh. Kardhiqotë gunëdhirë/ Ku e lartë trimërinë/ Th. Mitko) guna të gjata (More gegë gunëgjatë/ A s'e shihni se më s'mbetë/ (Mitko) etj.¹²¹

Mendoj se pikërisht *gunave* e tallaganeve u referohen fjalët e një udhëtari të viteve '40 të shekullit të kaluar, i cili, duke përshkruar veshjen e burrave toskë thotë se ata mbanin «hllamida prej shajaku të dhirtë të quajtur *aba*. Të mbështjellë me to — vazhdon ai — ata nuk tuten të flenë jashtë edhe në kohë të keqe¹²². Një tjetër udhëtar i fillimit të shek. XIX i ka përqasur gunat e Shqipërisë së Jugut me «*plizid-in*» skocez dhe «*sagum-in*» romak.¹²³

Në dhjetëvjeçarët e fundit përdorimi i strukturave, tallaganeve etj. në vendin tonë ka ardhur gjithnjë duke u ngushtuar, megjithatë ato përdoren ende në disa krahina malore, sidomos nga barinjtë.

Të gjitha llojet e veshjeve të lehta për dimër që, hidheshin supeve për t'u mbrojtur nga të ftohtit dhe nga reshjet, të cilat i përshkruam më lart, kanë origjinë të la-

121) Të gjithë shembujt e këtij paragrafi (shprehje, proverba e vargje këngësh) janë nxjerrë nga vëll. II dhe III të veprës «*Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*» botim i Institutit të Folklorit, Tiranë 1962.

122) Shih A. Boué, *La Turquie d'Europe*, Paris 1840, vëll. II, f. 225.

123) T.H. Hobhouse, *A. journey through Albania and...* London 1812, f. 134.

shtë dhe janë përdorur pa ndërprerje në viset tona, ashtu sikurse edhe në shumë popuj të tjerë. Si dihet elementet më primitive të veshjes tek indoevropianët janë mbështjellëset e ngjeshura për beli dhe mantelet e leshta pa mëngë që hidheshin supeve.¹²⁴

Përdorimi i strukave dhe tallaganeve në mesjetë në vendin tonë dëshmohet, sidoqë në mënyrë pak të tërthortë, nga gjetje të shumta arkeologjike, ku krahas stolive, figurojnë fibula masive, të cilat s'ka dyshim se përdoren për të kapur këto veshje të sipërme të trasha (si janë p.sh. gjetjet e Komanit, të Krujës, të Shurdhahut etj. të cilat u përkasin shqiptarëve të hershëm, shek. VIII-XII e.s.¹²⁵

Nga koha e vjetër njohim disa monumente nga territori i Ilirisë ku janë paraqitur njerëz me struka ndër të cilët po përmendim: burrin e paraqitur në një relief varri të gjetur në Koplik (fig. 193) (rrethi i Shkodrës)¹²⁶ kalorësin e një relievi nga Apolonia (Pojani, në rrethin e Fierit)¹²⁷, një bari nga Priluka (Liburni)¹²⁸, (fig. 194) burrin e një stele funerale nga Bila (Dardani)¹²⁹, etj. Nga monumentet të krijohet përshtypja se kjo ishte një pjesë veshjeje e përdorur në lashtësi më fort nga burrat sesa nga gratë, duke e hedhur supeve, zakonisht përmbi dalmatikën.

Strukën e njihnin dhe e përdornin gjerësisht grekët e vjetër (chlamys), por shumë studiues janë të mendimit se ajo ka qenë më fort një veshje e thesalëve dhe e maqedonasve, që hyri pastaj në përdorim edhe te grekët¹³⁰. E ngjashme me të ishte saga e romakëve (sagum). Veshje të tjera të sipërme që hidheshin supeve, të përdorura në lashtësi dhe të ngjashme me tallaganet, kanë qenë me sa duket «paenula-t», «lacerna-t», «birrus-et» etj. (shih fig. 195 një penulë me kapuç).¹³¹



Fig. 193 — Relievi i Koplikut Shkodër (gur varri, shek. II p.e.r.)

Në disa dokumente përmenden të tilla veshje në përdorim të gjerë tek ilirët, duke përfurcuar kështu atë që na dëshmojnë monumentet. Kështu një autor antik flet shprehimisht për një strukë dardane: *chlamydem Dardanicam* dhe një tallagane ilirike, *paenulam Illyricianam*.¹³² Në përgji-

124) Shih J.M. Studniczka, *Beitrage zur Geschichte der altgriechische Tracht*, Berlin 1905, f. VI dhe 82.

125) S. Anamali, *Problemi i kulturës së hershme mesjetare shqiptare*, në: «Studime Historike», Tiranë 1967, nr. 2, f. 32, ku thuhet: «fibulat me këmbë të përthyme, jo vetëm janë objekti më karakteristik, por edhe ndeshen me shumicë në të gjitha vorrezat mesjetare.

126) Ky gur varri ndodhet në Muzeun popullor të Shkodrës.

127) Guri në fjalë ndodhet në Muzeun e Apolonisë.

128) Shih I. Cremosnik, *Nošnja na rimskim spomeničama u Besni i Hercegovini*, në «Glasnik Zemaljskog Muzeja u Sarajevu «Archeologia, sv. XIII. Sarajevo 1963 fig....

129) Po atje, f. 106 fig. 1.

130) Shih Daremberg et Saglio, zërat: *lacerna*, *paenula*, *chlamys*, Burimet na i përshkruajnë penulat si veshje fshatare të trasha të leshta, në formë kambane.

131) Po aty.

132) Shih Trebelius Pollio, «*Divus Claudius*», XVIII.



Fig. 194 — Bari nga Priluka, Liburni (shek. III e s).



Fig. 195 — Bari me penulë (tallagan) (terrakote e Luvrit)

thësi këto lloj veshjesh të sipërme, që të qëndronin më mirë kapeshin me një fibul në njërin sup ose përpara. Në shek. III të e. sonë Iliria, me sa duket, ishte e përmendur për prodhimin e këtyre veshjeve të sipërme. Ato ishin të leshta dhe të një cilësie të mirë; kjo pa dyshim lidhet me faktin se Dalmacia ishte e dëgjuar për dhentë e saj. Në një letër që perandori romak Claud i dërgon qeveritarit të Ilirisë Regillian, i kërkon atij dy struka, por nga ato me fibula, thekson ai. (... duo saga sed fibulatoria)¹³³, duke lënë të nënkuptohet kështu se kishte edhe struka që nuk mbërtheheshin me fibula, por me ndonjë mënyrë tjetër.

Si e pamë pra, veshjet e lashta që hidheshin supeve për t'u mbrojtur nga të ftohtit e reshjet (struka, tallagane, guna etj.) ishin të shumëllojshme dhe të përhapura gjerësisht në vendin tonë. Origjina e tyre lidhet, në shumë raste, me veshje analoge të përdorura nga stërgjyshët tanë ilirë.

LLABANIA

Një mbulesë për t'u mbrojtur nga reshjet ishte edhe *Ulabania*, ai kapuç ku më i gjatë, ku më i shkurtër, i bërë prej shajaku të dhirtë, që vendosej mbi kokë e zgjatej prapa në shpinë duke arritur zakonisht deri në bel. (shih fig. 196). Në vjeshtë e në pranverë ajo vihej mbi veshjen e zakonshme, por në dimër vihej edhe mbi veshjet e rënda që nuk kishin kapuç, si ndodhte, p.sh., në Labëri, ku e vinin mbi bërrucin.

Llabania si petk i veçantë është përdorur, në Labëri, në rrethin e Korçës e në atë të Kolonjës etj., pra në disa zona të Shqipërisë së Jugut dhe deri në fillim të shekullit tonë edhe në rrethet e Shkodrës e të Pukës. Më anë tjetër janë shumë të përhapura në Shqipëri veshjet e pajisura me kapuç ose me një jakë të madhe që kthehet lehtë në kapuç.

Llabanen e kanë mbajtur si burrat ashtu edhe gratë. Gjatësia e saj ndryshonte nga 50 në 100 cm. Në rrethin e Korçës asaj i vinin edhe një gjalm të trashë leshi, me

¹³³) Cituar sipas Daremberg et Saglio, *Dictionnaire des antiquites etc.* vol. 4, f. 1103, VIII.



Fig. 196 — Burrë me llabane



Fig. 197 — Grua me kaculetë (foto Marubi 1875)

anën e të cilit e varnin në sup si trastë kur nuk kishin nevojë më ta mbanin në kokë. Një **grua me kapuç** (kaculitë) shihet edhe në një gravurë të shekullit të kaluar (fig. 43. Kreu I) dhe në një fotografi të Marubit, bërë rreth vitit 1875 (fig. 197).

Monumentet arkeologjike nga një anë dhe burimet e shkruara të kohës antike nga ana tjetër, janë të mjaftueshme për të provuar karakterin vendas të këtij petku.

Ndër monumentet më të qarta të lashtësisë do të përmendëm një bust gruaje të zbuluar më 1962 në Krotinë (rrethi i Beratit, Dimali antik). (fig. 198). Ai paraqet një grua me llabane në kokë, që i varet prapa deri nën bel, por nuk shquhet qartë se ku mbaron, sepse pjesa e poshtme e gurit është pothuaj e papunuar. Ky bust u përket shekujve III-II p.e.r.¹³⁴. Një tjetër monument ku paraqitet një grua në llabane është

gjetur në Jugosllavi. Është fjala për kapuçin e bareshës, në relievin nga Priluka¹³⁵ (që ndodhet në territorin e dikurshëm të Liburnisë); ai duket se nuk është aq i gjatë sa ai i gruas së Dimalit, por mbulon vetëm kokën e supet. Ka mundësi që edhe gruaja e paraqitur në një relief guri të gjetur në Durrës¹³⁶ (i përket kohës së vonë romake), të ketë vënë në kokë një kapuç të gjatë a llabane (fig. 199). Nga Durrësi vjen gjithashtu edhe një fragment skulpture tjetër në gur, e shekujve II-I p.e.r., që paraqet një kokë gruaje të re të mbuluar me kapuç¹³⁷. Mendoj se mbajnë gjithashtu llabane në kokë edhe dy gratë e paraqitura në një relief varri të gjetur në Koplik (shih fig. 193), (Shkodër, pra në territorin e dikurshëm të Ardiejve).¹³⁸

Në të gjitha këto monumente të gjetura në Iliri, që përmendëm më sipër, është për

134) Burhan Dautaj, *Zbulimi i qytetit ilir në Dimal*, në «Studime historike» Tiranë 1965, nr. 2, f. 99, fig. D.

135) Sipas J. Cremosnik, *Nosnja na rimskim spomenicama B. iiH*, në «Glasnik zemaljskog Muzeja u Sarajeva» «Arheologija Sv. XVIII, Sarajevo 1965, fig. 2.

136) Fondet e Muzeut Arkeologjik, Tiranë. Objekti me nr. inv. 30.

137) Muzeu Arkeologjik, Durrës.

138) Muzeu popullor i Shkodrës.



Fgi. 198 — Busti i gruas nga Dimali (shek. III-II p.er)



Fig. 199 — Reliev nga Durrsi (koha e vonë romake)

të vënë në dukje fakti se llabane mbajnë vetëm gratë, kurse burrat e paraqitur për-krah tyre kanë vetëm strukën në formë shalli të hedhur kraheve.

Llabania është një nga të paktat elemente të veshjes ilire, që e gjejmë të përmendur edhe nga autorët antikë. Për një llabane të cilësuar si të fisit ilir të Bardejve, «*cucullus Bardaicus*» na flasin autorët romakë J. Capitolin¹³⁹, T. Pollio¹⁴⁰ dhe Martial¹⁴¹. Ky i fundit na përmend edhe një llabane të Liburnëve, «*cucullus Liburnicus*». ¹⁴² Burimet tregojnë gjithashtu se në Istrië, Liburni e Dalmaci, pra në gjithë bregun lindor të Adriatikut deri në afërsitë e Shkodrës, kanë qenë punuar stofa të trasha për «*cucullus*». Mund të mendojmë kështu se llabania në shekujt e parë të erës sonë ishte një petk i përdorur nga shumë fise ilire. Skaji më verior që njohim arrinte në Istria, kurse ai më jugor deri tani është Dimali (në rrethin e Beratit), që ka dhënë edhe dëshminë më të vjetër në kohë.

Në kohën e vjetër llabania përdorej jo vetëm si petk më vete, por edhe si kapuç që u ngjitej veshjeve të tjera, si p.sh. lacernave, penulave etj. të cilat në këtë rast quheshin «*vestis cucullata*» (veshje me kapuç). Edhe në veshjet popullore shqiptare, ruhen mjaft lloje veshjesh të sipërme të ngjashme me ato të lashtësisë, ndër të cilat mund të përmendim: tallaganin e zi të grave të Malësisë së Madhe, jepinxhen e bardhë të burrave në Kosovë, gunat e tallaganet e murme ose të zeza të fshatarëve të Shqipërisë së Jugut. Përveç këtyre ekzistojnë xhoka të ndryshme, zakonisht me mëngë të shkurtra e të pajisura me kapuç ose me një jakë të madhe katrore, e cila mund të kthehet lehtë në kapuç si tabaret e rretheve të veriut, gjurditë e kaporanet, xhokat e grave të rrethit të Tiranës etj.

Forma e llabanes që mbahet edhe sot tek ne, sidomos ajo e Labërisë, pothuaj se nuk ndryshon fare nga ajo e bustit të gruas së gjetur në Dimal. Ajo përdorej gjithashtu në disa zona të rrethit të Korçës

139) J. Capitolin, *Pertinax Imperator*, VIII (në veshjet e perandorit romak Komod që konfiskoi Pertinaksi përmenden edhe... «*cuculli Bardaici*»).

140) T. Pollio, *Divus Claudius*, XVII. «*Dardanicam mantulem unam, Paenulam Illyricianam unam. Bardocucullum unum.* cor6.

141) Martialis *Epigrammatum*, Lib. I, 54 (Sic interpositus villo contaminat uncto) Urbica Lingonicus Tyrinthiana *bardocuculli* Lib. XIV, CXXVII *Bardocucullus* (Gallia Santonica vestit te *bardocucullo*).

142) Martial, *po atje* Libri XIV, CXXXXIX, «*cuculli liburnici*».

dhe deri në fillim të shekullit tonë përdorej edhe në Mirditë e në Pukë si një kapuç (*kaculitë*), që mbanin vajzat. Formën e llabanes merrnin edhe thasët prej kërpi të palosur në dysh, që vinin në kokë fshatarët gjatë disa proceseve të punëve bujqësore, për të mbrojtur kokën dhe shpinën nga papastërtitë e ndryshme, p.sh. ata që fshinin gëzhutat e grurit kur vrau hidhej në erë, ata që mbanin koshat me pleh etj. I përdornin gjithashtu punëtorët e ngarkim-shkarkimit të produkteve që lëshonin pluhur si mielli, qymyri etj.

Përveç vendit tonë, llabania është përdorur edhe në disa krahina të Jugosllavisë. Kështu p.sh., deri nga fundi i shek. XIX mbanin llabane gratë myslimane të viseve blegtorale në rrethet e Çaplinës,¹⁴³ në Hercegovinën Perëndimore (Dalmacia e vjetër), të shoqëruar me strukën. Në dallim nga llabania jonë këto ishin më të shkurtra.¹⁴⁴

Në Rumani llabania njihej në shumë zona të Transilvanisë dhe të Moldavisë, me forma të thjeshta e variante më të zhvilluara¹⁴⁵. Gjatësia e saj mund të ishte e ndryshme: kishte llabane që arrinin deri tek beli, por kishte edhe që arrinin deri në fund të këmbëve, si p.sh., llabania që mbahej në Avrig, (Tara Oltului. Kjo pjesë veshjeje edhe në Rumani lidhej me jetën e blegtorit, të cilin puna e detyronte të qëndrojë jashtë edhe në kohë të keqe. Ajo është e dokumentuar, për rumunët, të paktën që në monumentin e Adamklissit e në kolonën e Trajanit (shek. I e.e.); Për sa i përket origjinës së saj, etnografët rumunë e kanë konsideruar herë me prejardhje trake (E. Fischer), herë dake (R. Vuia).

Megjithatë, duke marrë parasysh faktin që llabania është një mjet që shërbente më fort për t'u mbrojtur nga shiu sesa për të mbajtur ngrohtë, dhe faktin tjetër se brigjet e Ilirisë, duke qenë në zonën e klimës mesdhetare karakterizoheshin nga reshje shumë më të shpeshta se ato të territorit të Dakisë me klimë kontinentale, mendoj se një petk të tillë si llabania mund ta konsiderojmë më fort si një ndikim ilir tek dakët.

MBULESAT E KOKËS DHE FRIZURA

Mbulesat e kokës, përgjithësisht, përfshihen në elementet përbërëse të veshjes. Ato janë përdorur për ta mbrojtur kokën nga ndryshimet e stinëve e të klimës, por kanë marrë, me kohë, edhe funksione të tjera të rëndësishme, për të shprehur dallime të moshës, seksit, shtresës shoqërore, rastit për të cilin viheshin etj. Por nuk duhet harruar funksioni i theksuar estetik i tyre.

Më poshtë, gjatë shqyrtimit të mbulesave të kokës do të flitet jo vetëm për materialin me të cilin bëhen ato dhe format që marrin, por edhe për mënyrën se si vihen në kokë, si rregullohen dhe si fiksohen, do të theksohet gjithashtu kuptimi që ato kanë marrë në raste të veçanta, sipas ngjyrave apo mënyrës së lidhjes etj.

Ashtu si veshja edhe mbulesat e kokës kanë ndryshuar nga një periudhë në tjetrën, krahas zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit, por këto ndryshime nuk kanë qenë të njëjta në çdo krahinë. Shumë herë janë trashëguar nga një brez në tjetrin mënyra tradicionale fort të hershme të mbështjelljes së kokës por, krahas tyre, shumë të tjera tregojnë ndikime të ndryshme kulturore, që janë pasojat e kontakteve me popujt e tjerë dhe e kushteve konkrete historiko-shoqërore të vendit tonë, në etapa të ndryshme të zhvillimit të tij. Në shumë raste, në mbulesat e kokës është ndier edhe ndikimi fetar, në lidhje me mbulimin e fytyrës së grave etj.

Gjatë shqyrtimit të mbulesave të kokës aty-këtu do të jepen edhe të dhëna të shkurtra mbi frizurën, sidomos në rastet më karakteristike.

Parashtrimi i të dhënave do të bëhet në dy grupe të mëdha: A) mbulesa koke për burra dhe B) mbulesa koke për gra. Për secilin nga këta grupe do përpiqemi të parashtrijmë tipat kryesorë, kohën kur janë përdorur, zonat e përhapjes etj.

143) Cv. Popović-Z. Markovič. *Stocari «Balije» kod Čapljine i Ljubuskog*, G.Z.M., Sarajevo 1955, str. 147-158.

144) Shih tab. XVIII, në Z. Culić, *Narodne nošnje u Bosni i Hercegovini*, Zemaljski Muzej u Sarajevu 1963.

145) H. Formagiu, *Portul popular, romānesc*, Bucuresti, 1974, f. 127-131.

A. Mbulesa koke për burra

Mbulesat e kokës për burra në shekullin tonë nuk paraqesin aq ndryshime sa ato të grave.

Në shekujt XIX-XX nuk njohim raste mbulesash koke për burra, në kuadrin e kostumit popullor tradicional, që të kenë strehë. Atë bëheshin zakonisht prej një cope lëkure, astragani, belluzi ose kadifeje e cila pritej e qepej në forma të caktuara, ose përgatiteshin prej lesi (plisi) nga qeleshepunuesit duke «u derdhur», në mund të shprehemi kështu, në disa forma të caktuara; por mund të bëheshin edhe prej pëlhere të pambuktë a kambriku, prerë e qepur nga gra të specializuara, në formën e takijeve; ndodhte që ato të përgatiteshin edhe thjesht me fije lesi të thurur me grep (gjylnjer).

Ekzistojnë një varg emërtimesh për mbulesat e kokës të burrave, ndër të cilat po përmendim: kësulë, kapë, plis, kapuç, kopicë, qeleshe, feste, takije, qylaf etj.

Sipas materialit dhe mënyrës si konfeksionoheshin mund të dallojmë këto lloje mbulesash koke për burra.

1) Mbulesa koke prej lëkure, në formë gjysmësferë, për të cilat kemi vetëm informata të shkruara, por jo objektet përkatëse. Është fjala për ato kësula prej lëkure qengji, që mbaheshin dikur në Mirkure qengji, që mbaheshin në F. Nopçës, më ditë dhe që, sipas dëshmisë së F. Nopçës, më 1907 nuk shiheshin më gjëkund. Një të dhënë tjetër për kësulat prej lëkure e kemi nga Kastellan në vitin 1797, i cili thotë se «Shqiptarët e Greqisë e mbulonin kokën e tyre me një kësulë prej lëkure të zezë, të zbukuruar me tufëza e sumbulla».

2) Kapuçat prej lesi të thurur me grep (gjylnjer) të cilët deri tani i kemi fare pak të dokumentuar, mbaheshin në disa raste të rralla. Në fondet etnografike ruhen vetëm dy ekzemplarë të tillë, të blerë njëri më 1969, me prejardhje nga fshati Malaj i rrethit të Mirditës dhe tjetri i blerë më 1970, me prejardhje nga Kosova.

3) Kësula pëlhere, pelushi, astragani etj. të prera e të qepura nga gratë ose nga zejtarit përkatës. Këtu është fjala, në rradhë të parë a) për takijet prej pëlhere të bardhë, që mbaheshin jo vetëm në gjithë Myzeq-

në, por shtriheshin edhe në zona të pafërta, si në Sulovë, Elbasan, Shpat, Berat, Skrapar etj. Një takije në përdorim të një shpataraku përmendet që në vitin 1716 (Kreu I, shën. 110). Prerja e takijes bëhej si në fig. 200. Ll. Mitrushi, që ka gjurmuar veshjet myzeqare, për takijet thotë se ato ishin tre llojesh: myzeqare, sulovare ose shyte dhe toske. Këto të fundit ishin




Fig. 200 — Skica e prerjes së takijes.

më të zbukuruara se të tjerat, me tegela e tentene përdorehin kryesisht në rrethin e Beratit¹⁴⁶. I prisnin, i qepnin dhe i shisnin në treg gratë e shtresave punëtore, kryesisht në Berat (fig. 201) Takija zbukurohej me tegela e dhembëza dhe ishte gjithmonë e bardhë. Ajo përdorej jo vetëm me kostumin me fustanellë, me atë me brekushe, por dhe me atë me poture. Sikurse shihet zonat e përdorimit të saj shtriheshin kryesisht në Shqipërinë e Jugut. Në gjysmën e parë të shek. XVII vetëm në tregun e Elbasanit punonin 36 takijexhinj. Paraqitja figurative më e hershme është ajo e Ktitorit të Dhërmiut në vitin 1576. b) Një tjetër lloj kësulash, që i priste e i qepte zejtarit, ishin qylafet në formë varke, zakonisht prej kadifeje, pelushi ose astra-

146) Shih Ll. Mitrushi, *Veshje myzeqare të shekullit XIX dhe fillimit të shek. XX*, në «Etnografia Shqiptare» VIII, Tiranë 1976, f. 148.



Fig. 201 — Burrë myzeqar me takije

gani të zi, me astar, me anë të gjera e të forcuara me karton (fig. 110.), të cilat në shekullin tonë u përhapën me shpejtësi në disa zona të Shqipërisë së Jugut.

4) Kapuçat prej plisi ose qeleshet që përgatishnin zejtarët qeleshepunues të vendosur në dyqanet e tyre të vogla në pazaret e qyteteve. Ato mbaheshin kryesisht në Shqipërinë e Mesme dhe Veriore.

Qeleshet punoheshin me kallëpe qeramike ose druri duke larë e ngjeshur leshin, derisa të merrte dendësinë e formën e duhur. Format e qelesheve ndryshonin sipas krahinave, ato më kryesoret ishin:

a) qeleshet e larta të Shqipërisë së Mesme (Tiranë, Durrës, Kavajë), që shoqëronin kostumin me brekushe të bardha e jakuce.

b) qeleshet rafshatake që mbaheshin në Gegëri (Mat, Mirditë, Dibër) dhe shoqëronin dikur kostumin me dollamë e më vonë atë me tirq.

c) qeleshet e rrumbullakta që mbaheshin në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë dhe shoqëronin kostumin me tirq.




Fig. 202 — Forma të ndryshme qeleshesh e festesh

Veç këtyre kishte edhe të tjera me lartësi të ndërmjetme. (fig. 202, 203).



Fig. 203 — Burrë me qylaf të bardhë të lartë

Në shumë raste qeleshet e ndryshme mbaheshin të shoqëruara me shami koke, thjesht të bardha ose më vonë edhe me ngjyra e pikla të stampuara. Në Shqipërinë e Mesme gjatë stinës së nxehtë këto shami viheshin nën qeleshe dhe lëshoheshin supeve; ato shërbenin qoftë për t'i

bërë hije qafës, goftë për të fshirë djer-sët.

Në Shqipërinë Verilindore dhe në Koso-vë e në shqiptarët e Malit të Zi shamitë ose shallët, që lidheshin në kokë përqark kapuçit të bardhë në formë kalote, quhe-shin «mahramë kreje», «shall i ksulës» etj. dhe punoheshin zakonisht nga gratë në avlëmend, me fije pambuku ose mëndafshi, me krerë shumë të zbukuruar, me qenarë, me tel etj. Përmasat e këtij shalli ishin afërsisht 14 x 120 cm. (i punonte Gjakova). Sikurse na tregojnë shumë këngë popullo-re, ato ishin dhuratat më të zakonshme për dhëndrin, msitin etj¹⁴⁷ Ato na kujtojnë me-njëherë fjalët e F. Bardhit në një relacion të vitit 1637, të cilin e kemi përmendur në Kreun e parë, që thotë se qefalinjtë apo krerët e mbështillnin kokën me shami mëndafshi, të qëndisura, sidomos kur shkonin në mbledhje kuvendi, në festa të krahinës a në panaire.

Në shumë raste përqark kapuçit mbësh-tillej një rrip i gjatë pëlhere të bardhë të pambuktë, që sillej edhe në drejtim ver-tikal nga maja e kokës nën mjekër, duke mbuluar kështu edhe veshët, në formën e një turbani mjaft të trashë. Atë e mbanin malësorët e Veriut dhe gjithë Kosova. Shu-mëkush thoshte se ai ishte qefini i tyre, se vdekja mund t'i gjente kudo. Sidoqoftë, në klimën e ftohtë të alpeve ai ishte një mbrojtje e mirë edhe nga të ftohtit. Në shekullin e kaluar kemi ndonjë dëshmi të përdorimit të këtij turbani edhe në Jug. Le të kujtojmë p.sh. një gravurë të Stackel-bergut (1825) që paraqet një ushtar shqip-tar në Janinë, turbani i të cilit është shumë luksoz, i mëndafshhtë e me ngjyra (shih Tab. III, 2), dhe duket të jetë një ndikim turk.

5) Një grup më vete formonin qylahët e bardhë dhe fesat e kuq, që importohe-shin me shumicë, sidomos në shek. XVIII-XIX.

Qylahët përdoreshin në shtresa të gje-ra të popullsisë. Në shekullin XVIII qy-lahët e bardhë kishin përbrenda një astar të zi prej zendali, që delte në buzën e poshtme të tij si një; shirit i zi. Nga një raport i konsullit A. Bartoloviç në Durrës,

vitit 1762 mësojmë se prej Ankone (Itali) silleshin në Shqipëri zendale të zeza shërbenin për shiritat e qylahëve të shqip-tarëve.

Fesat e kuq ishin prej cohe, me lartësi të ndryshme, në të shumtën e rasteve kishin në majë një tufëz mëndafshi të zi ose blu. Sipas një dëshmie të vitit 1815 festa e kuqe që përdornin shqiptarët silleshin nga qytetet italiane Trieste, Livorno dhe Gjenova¹⁴⁸. Një udhëtar që ka vizituar Shqipërinë më 1867 thotë se shqiptarët në kokë mbajnë një kësulë të vogël të kuqe zakonisht të mbështjellë me një shall pël-hure në formë turbani¹⁴⁹. Me një fesë të kuq në kokë dhe një shami të lidhur rreth-tij, është paraqitur një shekull më përpara edhe ktitori i Mitropolisë së Korçës, Shamo Koci në një kuadër të vitit 1725. Ka të ngjarë pra, që fesat prej cohe të kuqe të jenë përdorur gjatë disa shekujsh në Shqi-përi por, sidoqoftë ata i mbanin kryesisht burrat e shtresave të pasura ose përdore-shin vetëm në veshjen festive nga burrat e shtresave të tjera. Madje duhet patur pa-rasysh se përhapja e tyre nuk ishte e një-hershme kudo. Kishte zona, si p.sh. Karma në Luginën e Drinit ku, sipas dëshmisë së G. Hahnit, i cili ka kaluar atje në vitin 1836, burrat në shumicën e rasteve mbanin kësula apo kapuçia leshi në ngjyrë të bar-dhë në të hirtë», ndonëse edhe fesi i kuq i prodhuar në Evropë, për shkak të cilësisë së lartë të leshit prej të cilit është bërë, po gjen, edhe në këto male, përdorim gjithë-një e më të gjerë». Për sa u përket flo-këve ai thotë se i mbanin krejt të qethur, me përjashtim të majës së kokës, ku i linin rreth trekatër gisht të gjatë, por edhe ato i mbulonte kësula¹⁵⁰.

6) Së fundi le të përmendim kapelën e lartë shqiptare, me strehë, të vizatuar disa herë nga Onufri në shekullin XVI, me ngjyrë të kuqe ose të zezë, për të cilën kemi sjellë edhe dëshmi të tjera në Kreun e parë të kësaj vepre. Gjurmët më të vona të saj i kemi në një afresk të shekullit XVIII. Shumë nga mbulesat e kokës të përmendura më lart kanë dalë nga përdorimi në shekullin tonë. Kështu mbas Luftës së Parë

147) Shih vëllimin «Këngë dasme», Prishtinë 1978, këngët me nr. 275 etj.

148) Shih: J. G. Hobhouse, vepra e cituar, London 1815.

149) Shih G. de Vaudoncourt, *Memoirs of the Jonian Islands* et London 1816, f. 318.

150) Shih J. G. Hahn. *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*, Wien 1867, f. 46.




Bari nga një ikonë e Onufrit




Shën Artiomi (Kisha e Sh. Mërisë Vllahernë-Berat)

Karl Topia (Ikonë e K. Shpatarakut)



Ktitori i shën Thanasit (Voskopojë, Korçë)






Oficer shqiptar, 1825 (Stackelberg)




Ushtar i truprojes se Ali Pashës (Stackelberg)



Tre shqiptarë, 1826 (F. Delpino)




Gjahtar shqiptar, 1826 (F. Delpino)






— Shqiptar, 1826 (F. Delpino)



Shqiptarë që shoqërojnë robinat. 1876 (sipas J. Cermak)






— Nuse shqiptare nga Atika (sipas Papantoni, 1976)



— Gra nga Salamina




Grua nga Villa Badesa (sipas L. Russtu)



Grua nga Piana degli Albanesi








Burrë me dollame (Mat)



Grua me xhublete (M. Madhe)





Burrë e grua Kurbini (Krujë)



Grua nga Macukulli (Mat)







Burrë me poture (nga Skrapari)




Grua myzeqare (Fier)



Burrë kosovar me veshje pune



Grua me veshje të përditshme (Fushe-Kruje)







Këmishë burri (Zadrimë) dhe këmishë gruaje (Has)



Pjesë të qëndrisura këmishësh (Shpat, Elbasan)







Prapanik (Has)




Përparje me thekë (Mirdite)

Përparje leshi (Dukagjin)



Përparje leshi (Shpat)







Mëngore burri (Përmet)




Pjesë flokate për gra (Kolonje)

Xhybe cohe të kuqe qëndisur me gajtan te zi



Xhybe cohe të kuqe qëndisur me ar







Vëthë gruaje



Varëse qafe



Brez argjendi



Botërore nuk janë përdorur më qylafët e bardhë të lartë që mbaheshin në Shqipërinë Juglindore dhe qenë zëvendësuar me festet prej pelushi ose kadifeje në formë varke. Kishin dalë gjithashtu nga përdorimi festet e kuqe me xhufkë së bashku me kostumin me fustanellë. Në disa zona të Jugut në vitet '20 u përhapën me shpejtësi në masat e gjera qytetare e fshatare kasketat, si një ndikim i modës perëndimore në veshje, p.sh. në rrethet Korçë, Pogradec, Përmet e më vonë dhe në shumë zona të tjera të Jugut. Sidoqoftë nga kësulata tradicionale ato që u ruajtën më gjatë, duke arritur deri në ditët tona, janë: në Shqipërinë Jugperëndimore, takijet prej pëlhere të bardhë dhe, në Veri, qeleshet e ndryshme.

B. — Mbulesa koke për gra

Mbulesat e kokës për gra, që arritën në përdorim në shekullin tonë, paraqiten me një larmi të madhe. Ato ndryshonin, jo vetëm nga një krahinë në tjetrën, por edhe sipas grupmoshave e rastit për të cilin viheshin dhe, sigurisht, edhe sipas shtresave të ndryshme shoqërore.

Në analizën që do të bëjmë më poshtë do të mbahet parasysh, së pari, forma e mbulesës dhe materiali me të cilin përgatitej dhe pastaj mënyra sesi vendosej ose rregullohej në kokë. Do të shqyrtohen në fillim mbulesat e përgatitura brenda ekonomisë shtëpiake, kryesisht nga vetë gratë, dhe pastaj ato të blerat në treg, që punoheshin nga zejtarët vendas ose importoheshin.

I. Mbulesat e përgatitura brenda eko-

nomisë shtëpiake me tekstile tradicionale, sipas formës së tyre, paraqiten në disa variante, nga të cilët po përmendim:

1) Mbulesat e kokës të bëra me një fletë të vetme pëlhere avlemendi, me gjërësi 30-56 cm. dhe të gjata 130-300 cm. Pëlhera ishte herë e pambuktë e herë e mëndafshhtë, ose e përzier. Për gratë e moshuara ishte thjesht e bardhë ose me vija, ndërsa për gratë e reja shumë e zbukuruar me vija e motive të ndryshme. Në këtë grup bëjnë pjesë disa nga pëlherat më të zbukuruara, të holla gjer në tejdukshmëri, punuar herë-herë edhe me azhure, kurse motivet janë të ekzekutuara qoftë me fije të bardhë më të trashë, qoftë me ngjyra të qeshura, si të kuqe, portokalle, të verdha etj. ose me fije ari, në variantet më luksoze.

Këto mbulesa koke thirreshin me emra të ndryshëm, sipas zonave ku mbaheshin, si p.sh., peshqir (Myzeqe, Mat), rizë (Zadrimë) ride (Kurbin), pashnik (Kallmet), marhamë ose rizë e shoqëruar me një lidhçë koke (Kosovë).

I përkasin këtij grupi pra:

a) Rizat e Zadrimës, të Bregut të Bunës etj. dhe *pashnikët* e zonës së Kallmetit, (Rranxat e Lezhës), të parat prej pëlhere mëndafshi ose pambuku me gjërësi që lëkundej nga 45 në 50 cm. dhe gjatësi që shkonte nga 140 në 250 cm., me krerët shumë të zbukuruar (fig. 204 a) dhe, të dytat, përgjithësisht të bardha, të pambukta, pak më të vogla se rizat, me gjërësi 35-40 cm. dhe gjatësi 110-140 cm., gjithashtu të zbukuruara në krerët (fig. 204 b).

Gratë e Zadrimës i mbanin flokët të prera cullufe deri tek faqet, kurse pjesën tjetër që ishin më të gjata i thurnin në dy




Fig. 204 — Risa koke (a Zadrimë e b) Kallmet)




Fig. 204/a, b — Riza Zadrimë

gërsheta dhe i mbështillnin prapa kokës me një farë kapuç basmeje fare të vogël, që shërbente edhe si një sfond për rizat e tejdukshme. Kjo prerje shkurt e cullufeve përpara dhe ngritja lart e flokëve të tjera, e bënte të dukej përgjithësisht më të gjatë qafën e tyre, duke u dhënë kështu grave të reja zadrimore një pamje tërheqëse, si i shohim të paraqitura me shumë art edhe në vepra të ndryshme të piktorit të mirënjohur Zef Shoshi.

Gratë e Kallmetit (Rranxat e Lezhës) i mbanin flokët të gjata, të ndara në mes e të kthyer përbenda, në të dy anët e fytyrës e pastaj, të thurura gërsheta; këto gërsheta i shkëmbejnë prapa kokës dhe skajet e tyre i lidhnin mbi kokë me një gjalm të kuq.

Në po këtë grup duhet të përfshijmë edhe marhamat e mëndafshita të zbukuruara me motive shumëngjyrëshe që përdornin gratë katolike në disa qytete të Kosovës, me përmasa 45-50 x 110 cm afërsisht, si edhe mbulesat e bardha të kokës që përdorën gratë në disa zona të rrethit të Matit (German,.... etj.), të cilat lidhen ndryshe nga ato të Zadrimës (fig. 125).

Shumë të afërta në strukturë paraqiten me sa duket edhe mbulesat e kokës që mbanin gratë arbëreshe të ishullit Hidra, si i shohim të paraqitura në disa gravura të shek. XIX (shih fig 25) Gratë dhe vajzat hidroite i përgatitnin vetë në avelmend këto pëlhura të holla mëndafshi, të zbukuruara me fije ari, në formën e një shalli të gjatë. Kur vihej në kokë, pëlhura kalonte edhe nën mjekër duke inkuadruar plotësisht fytyrën dhe duke lënë të dukeshin vetëm fare pak flokët përmbi ballë.¹⁵¹

Të njëjtën formë, pra me një fletë të vetme pëlhure, të thjeshtë ose me vija a me motive të ndryshme kishin edhe peshqirat e kokës që përdornin gratë ortodokse të Myzeqesë. Përmasat e tyre ishin 35 x 130 cm., por mënyra e vendosjes ishte e ndryshme nga të mësipërmet. Gruaja ngrinte lart përmbi qafë flokët e thurura gërsheta, duke i mbështjellë kotullaç duke lënë krejt të lirë qafën. (fig. 205). Kjo lidhje e kokës u jepte grave të reja myzeqare një pamje krejt të veçantë.

b) Formë katërkëndëshi kënddrejtë të tejzgjatur kishin edhe mbulesat e kokës (mahramat) që përdorshin në një pjesë të mirë të Hasit dhe në Rrafshin e Dukagjinit (në Kosovë), së bashku me «lidhesat» e tyre, me të cilat shkonin çift, sepse pasi vendosej mahrama, e cilat mbulonte jo vetëm kokën e veshët, por kalonte edhe nën gushë (fig. 128), fiksohej pastaj me lidhëzën, e cila ishte më e ngushtë Mahramat dhe lidhesat punoheshin me fije pamuku ose mëndafshi dhe i kishin vetëm krrerët të zbukuruar me ngjyrat karakteristike të kësaj zone. Përmasat e mahramave ishin afërsisht 30 x 110 cm., kurse të lidhëseve 10-12 cm. të gjera dhe 120-130 cm. të gjata¹⁵².

c) Formë katërkëndëshi të stërgjatur kishin gjithashtu mbulesat e kokës prej pëlhure të bardhë të pambuktë, me vija të holla të kuqe, që mbanin gratë e Pogohollat. Ato ishin të gjera 25-30 cm. dhe të gjata 380-400 cm. Ato mbështilleshin nga maja e kokës nën mjekër e pastaj përçark kokës, përmbi ballë, duke i mbuluar krejt flokët.

151) Sipas H. Belle, *Voyage en Grèce*, në «Le tour du monde» fash. XXX, f. 7.

152) Mund të shihen p.sh. objektet me nr. inv. 4509, 6956, 8202, e 8203, 76/198 e shumë të tjera në Fondet etnografike të IKP.



Fig. 205. — Grua myzeqare

Shumë i afërt me këtë mbulesë koke ka qenë «*prosopi*» që përdornin deri në fillim të shekullit tonë gratë qytetare të moshuara në Korçë, por pëlhura në këtë rast ishte krejt e bardhë dhe e rrudhur.

ç) Mendoj se po në këtë grup mund të futet edhe kapuçi që përdornin dikur vajzat e Pultit (rr. i Pukës), i cili bëhej me një fletë pëlhure të pambuktë të trashë rreth 30 cm. të gjerë edhe 80-100 cm. të gjatë të endur në avlemendin shtëpiak. Ajo bëhej me vija të bardha, të kuqe e të gjelbra. Fleta përthyhej më dysh dhe qepej së gjati vetëm në njërën anë. Kapuçë të tillë, ku më të gjatë e ku më të shkurtër, janë mbajtur edhe në zonat e tjera të Veriut (shih fig. 197), gjithmonë nga vajzat, shumë herë edhe prej pëlhure të lehtë.

2. — Në një grup më vete do të përshkruajmë ato mbulesa koke në formë katërkëndëshi kënddrejtë, më të gjata se të gjera, të bëra me dy fletë pëlhure të pambuktë, përgjithësisht të bardhë dhe të zbukuruar, herë vetëm me vija anëve, e herë

me motive të shpërndara në gjithë sipërfaqen.

Ato quheshin përgjithësisht *lëvere* ose *livere* koke, por edhe *dysHEME*, *rizë* etj. dhe janë mbajtur më fort në zonën fushore, duke filluar nga Myzeqeja, në Dumre, Shpat, Vërgjë e Sulovë, pastaj në pjesën veriore të rrethit të Durrësit, në Fushën e Prezës e në Fushën e Krujës deri në Kurbin.

Gjatësia e tyre shkonte nga 110 në 140 cm, gjurse gjerësia nga 84 (42 + 42) në 93 (48 + 48 cm.).

Në Myzeqe, për plakat këto levere ose dysHEME ishin të bardha me dy vija ngjyrë kafe në skajet; edhe vajzat e rritura, gjatë periudhës së fejesës i mbanin leveret të thjeshta. Ndryshe nga këto mosha, për nuset e reja leveret ishin shumë të zbukuruara, jo vetëm me vija tek krerët, por edhe me motive në gjithë fushën (fig. 206). Këto




Fig. 206 — DysHEME nga Fushë-Kruja.

motive në forma rombi ose gjashtëkëndëshi vendoseshin mbi një fushë pothuaj të tejdukshme dhe ekzekutoheshin me fije pambuku, ekzkluzivisht të kuqe në Fushë-Krujë, kurse në zonat e tjera edhe portokall, të verdhë e të zezë, me një finesë e bukuri të rrallë duke arritur efekte shumë të këndshme.

Leveret nuk lidheshin por vendoseshin mbi kokë nga ana më e gjerë e tyre, skajet me vija binin mbi supet, kurse pjesa tjetër varej prapa duke u valavitur. Për të qëndruar më mirë i fiksonin tek flokët me kapsa të ndryshme.

Gratë e Sulovës, të Dumresë e të Myzeqesë (myslimane), flokët e thurura në dy gërsheta që vareshin prapa, i mbështillnin së pari me një shami të vogël të thjeshtë e kështu punonin në shtëpi por, kur delnin jashtë, vinin lëveren. (fig. 122) Kurse gratë e Fushë-Krujës, deri aty nga vitet '50, ruanin ende një frizurë shumë interesante, me ato cullufe të ngrira e të përkulura si ark në të dy anët e fytyrës, të fiksuara me kapsa të ndryshme me ngjyra, në të cilat kapej edhe lëverja, (fig. 81),

Leverja e gjatë varur prapa pajtohej fort mirë, në tërësi, me linjat e gjera e të gjata pothuaj deri në fund të këmbëve, që mbanin gratë në këto zona, dhe, krahas përparjes, ishin elementet më dekorativë të kostumit të tyre.

Si nga forma e përmasat, ashtu edhe nga mënyra si vendosen në kokë, do të hyjnë në këtë grup edhe mbulesat e kokës të grave të një pjese të mirë të rrethit të Tiranës, nga Bërzhitë në Zall-Mner e në fshatra të tjera të Bendës (që përfshihen në rrethin e Krujës), megjithëse ato përgatiten tashmë me kambrik të fabrikuar dhe jo me pëlhurë shtëpiake, dhe stolisen me qendisje me ngjyrmish, qëndisje që kanë hyrë si një ndikim i qytetit të Tiranës jo shumë kohë më përpara. Përmasat e tyre janë afërsisht 100-130 me 130-160 cm. Nën të ato mbanin «skuninë» e vogël trekëndëshe.

Sikurse është vënë në dukje edhe gjetiu, të tilla mbulesa koke janë mbajtur edhe disa shekuj më përpara; këtë e tregojnë ngjashmëritë e theksuara që janë vënë në dukje me figurën e shën Varvarës, në një afresk të vitit 1578 në Berat,¹⁵³ të punuar nga Nikolla, i biri i Onufrit.

3. — Mjaft të përhapura veçanërisht në Shqipërinë e Mesme, kanë qenë disa mbulesa koke pothuaj katrore, prej pëlhure të punuar nga vetë gratë fshatare, që bëheshin nga dy fletë pëlhure të qepura së bashku. Ato ishin përgjithësisht të pambukta, por ndonjëherë edhe të përziara me mëndafsh (artificial). I tërë trualli bëhej me katrore të vogla të bardha, kurse anëve qarkohej me dy vija të holla, të bardha për gratë e moshuara, me ngjyrë të verdhë ose

trendafil a portokall për nuset e gratë e reja.

Në Shqipërinë e Mesme ato thirreshin përgjithësisht «*kryqe*» dhe kishin afërsisht këto përmasa 90 x 100 cm.

Në zona të tjera këto mbulesa koke ishin edhe fare të thjeshta pa zbukurime, prej pëlhure të pambuktë, si p.sh. në disa fshatra të rrethit të Matit (Kurdari, Lis etj.) ose si «*rubat*» e përditshme të grave të Malësisë së Madhe deri në fillim të shekullit tonë, që mbaheshin edhe prej liri ose kërpi, me sa duket të ngjashme me ato të grave tek Vasojeviçët, e që atje quheshin *kanave* (sipas një dëshmie të shek. XIX).¹⁵⁴

Mbulesa koke të tilla të thjeshta mbaheshin pothuaj kudo në Shqipëri edhe në pjesën e parë të shekullit tonë dhe lidheshin nën gushë ose kryqëzoheshin cepat përpara duke i futur pranë veshëve. Plakat, të cilat i vinin këto mbulesa përmbi një shami që u mbështillte krejt flokët, dy cepat anësorë i linin të vareshin lirshëm përpara dhe, vetëm kur ishte ftohtë, i lidhnin nën gushë, ndërsa në kohë të nxehtë i lidhnin lart mbi kokë.

Mendoj se në këtë grup mund të futen edhe disa mbulesa koke, që mbanin me kostumin e tyre tradicional, gratë arbëreshe të Italisë, si *napa* apo *napëza*, *pani* e ndonjë tjetër, për të cilat nuk kemi veçse pak të dhëna të paplota.¹⁵⁵

II. — Qysh nga mesi i shekullit të kaluar, shumë mbulesa koke tradicionale kishin dalë tashmë nga përdorimi duke u zëvendësuar me shami të ndryshme të fabrikuara, të pambukta, të mëndafshta ose të leshta, njëngjyrëshe, me ose pa thekë anëve, ose me një vijë përqark a me lule në të katër qoshet, apo me lule të stampuara etj. Një njoftim të vlefshëm në lidhje me përhapjen e shamive na e jep konsulli austriak G. Hahn, i cili thotë se në kohën e tij Shqipëria e Jugut importonte nga Austria rreth 2000 shami të leshta në vit dhe shton se shumë të tjera sillleshin nga Triestja. Shami shumë të mira (lahuri) vinin gjithashtu nga Stambolli. Të gjitha këto shami të importuara, thirreshin me emra të ndryshëm që kanë patur shpeshherë përdorim lokal dhe për një kohë të kufizuar. Të tilla janë p.sh. de-

153) Shih për këtë Ll. Mitrush, *art. i cituar*, f. 156.

154) Shih. M. Vlahović, *art. i cituar*.

155) Shih zërat përkatës në E. Giorçano, *Fjalor i arbëreshëve të Italisë*, Romë, 1963.

germi, dylben, faqol, futë, havli, kaftan, shami kalemqare, lahuri, mahramë, namaz-bez etj.

Disa mënyra të lidhjes së këtyre shamive në kokë kanë pasur shtrirje mjaft të gjerë, të tjëra jo. P.sh. shumë e përhapur ka qenë, në fillim të shekullit tonë, lidhja e dylbenëve duke kryqëzuar cepat anësorë në zverk e duke i lidhur pastaj përpara, përmbi ballë. Kjo mënyrë lidhjeje përdorej nga gra të moshave të ndryshme, myslimane e të krishtera dhe tregon një ndikim të qartë turk, të përhapur në shumë zona të Ballkanit. Për raste festash gratë e reja myslimane, në disa zona, e lidhnin shaminë «qeleposhe»,¹⁵⁶

Këto shami, gratë e reja, shpesh i zbu-kuronin me oja e tentene, me rruaza të vogla e temina, por edhe me tufëza të vogla me penj ngjyrash të forta.

Në shumë raste, sidomos gratë e mo-shuara, e mbulonin kokën me dy shami; të parën e lidhnin si nuset e reja, duke lidhur dy cepat e anëve në pjesën e përparme të kokës. Pastaj shaminë e dytë, përmbi të parën, e lidhnin si vajzat, pra nën gushë ose në fyt. Lidhja e shamisë në gushë ishte karakteristike për vajzat e rritura pothuaj në gjithë Shqipërinë. Ja si thuhet në disa vargje të një kënge popullore:

Mori e mira n'qat tallishte
A m'je nuse, a m'je çikë
— Me kan nuse i kam zylyftë
Po jam çikë, shaminë në fyt.¹⁵⁷

Edhe në ditët tona gratë fshatare, në mjaft zona, vazhdojnë ta lidhin kokën me shami, në format që përmendëm më lart.

Njohim deri tani vetëm një rast ku shamia e bardhë katrore nuk mbulon gjithë pjesën e sipërme të kokës por, e palosur së pari diagonalisht e pastaj si një rrip i gjerë rreth 10-12 cm. vendoset si diademë përmbi flokët e lidhet prapa, duke i lëshuar të varen prapa të dy cepat, dhe duke lënë të zbuluar çaçkën e kokës. Këtë mënyrë vendosjeje të shamisë e përdorin vetëm

gratë e reja në një grup fshatrash (Prelli) në rrethin e Matit. (fig. 207).



Fig. 207 — Lidhja e shamisë, grua nga Prelli (Mat)

III. Po veçojmë tani edhe një mënyrë tjetër mbështjelljeje të kokës që është ruajtur vetëm në veshjen e përditshme për punë, në disa fshatra të rrethit të Gjirokastrës, sidomos për stinën e verës, kur punohet në ara. Një cope pëlhure a kambriku të bardhë me madhësinë e një përparjeje, i vihet, në pjesën e sipërme, një rrip i ngushtë, duke e rrudhur pak gjerësinë e mbulesës. Skajet e këtij rripi zgjaten në të dy anët. Kjo mbulesë vihet në kokë duke e lëshuar mbi fytyrë anën që ka rripin; pastaj kjo pjesë paloset së jashtmi dhe me anë të rripit lidhet në kurorën e kokës, duke krijuar një farë strehe për ballin, ndërsa pjesa e prasmë mbron fare mirë edhe qafën. Kjo mbulesë koke tërheq vëmendjen për

¹⁵⁶ Sipas një informate të mbledhur në vitin 1951 në Moglicë të Oparit (rr. Korçë). Për ilustrim shih lidhjen e shamisë te gruaja e fig. 45 të kësaj vepre.

¹⁵⁷ «Këngë dashurie» I, Prishtinë 1979, f. 28 (Këngë nr. 19 mbledhur në komunën e Klinës, fshati Caronik).

faktin se, një paraqitje figurative të saj, e kemi që në vitin 1676, në një gravurë të Koronellit, që paraqet një grua epirote (shih fig. 9) në Kreun e parë të kësaj ve-pre).

IV. Në këtë grup do të flasim për disa lloje kësulash me forma e zbukurime të ndryshme, që janë përdorur me veshjet tradicionale, jo aq për mbrojtjen e kokës sesa me qëllime zbukurimi ose edhe funksione rituale.

1. — Së pari do të flasim për «kezën» atë lloj kësule të vogël në formë vezore, që ishte simboli i gruas së martuar tek arbëreshët e Italisë.

Në një shkrim të botuar me 1881 mbi zakonet e shqiptarëve të Italisë R. Parisi ka përrshkruar hollësisht veshjen e grave arbëreshe. Për sa i përket rregullimit të kokës ai thotë se ditën e dasmës vajza që martohet, flokët e krehur shtruar, i thurte në dy gërsheta, të cilat i lidhte në fund jo me një gjalm të bardhë, si kishte bërë sa qe vajzë, por me një gjalm të kuq e të tillë do ta mbante paskëtaj. Pastaj gërshetat i mblidhte në një top në pjesën e prasmë të kokës dhe, përmbi të, vinte *kezën*. *Kezën* e përgatitnin vetë gratë në fshatra, me një copë mëndafshi ose kadifeje ngjyrë të kuqe, të gjelbër ose bojë qielli, të qëndisur në relief me fije ari ose argjendi. Ajo kishte formë pothuaj eliptike dhe vendosej në kokë me boshtin e madh vertikalisht. Motivet e qëndisura ishin të shumëllojshme, në formë zogjsh, lulësh e gjethesh etj. Pasi qëndisej, kollaritej mirë së brendshmi që të forcohej, pastaj i vihej një astar prej pëlhere të bardhë, duke i vënë përçark buzës diçka të fortë, tel ose një purtekë, që nuk e lejonte të deformathej. Në buzën e poshtme të saj, qepej një kordele e gjatë, të dy anët e së cilës varehin prapa në shpinë, së bashku me *napën*, atë mbulesë të hollë, që arrinte deri tek mesi. Një gjilpërë e madhe dekorative me kokë, e fiksonte *kezën* mbas topit të flokëve. Çdo grua kishte disa keza të cilësive të ndryshme, më të thjeshtat për t'i mbajtur në shtëpi, të tjerat për të dalë me rrobat e mira të djelave, dhe më të mirën për festa të mëdha. Sidoqoftë gjatë ditës gruaja nuk e hiqte kurrë *kezën* as nëpër shtëpi. Ajo

ishte shenjë e gjendjes civile të saj si grua e martuar. Vajzat, për asnjë arsye, s'mund të mbanin *kezë*.¹⁵⁸

Këtë zbukurim koke e përmendin shumë nga shkrintarët arbëreshë më të njohur të shek. XIX si De Rada, G. Dara, Z. Serembe etj., por është me interes të kujtojmë këtu se ajo përmendet në folklorin arbëresh që në këngët e Dorëshkrimit të Kieutit më 1737: Çë stolij të taksi mëma?/ ...nëndë *kezë* të viliusta¹⁵⁹. pra nëntë keza të shtrenjta prej kadifeje (me rastin e martesës).

Keza e thjeshtë e përditshme e grave arbëreshe mendoj se gjen analogji me atë mbulesë të brendshme koke si një farë qeseje, që përdornin gratë e Zadrimes, nën rizën e tyre të mëndafshët, për të mbledhur flokët në pjesën e prasmë të kokës. Raste të tjera ngjashmërie nuk janë hetuar deri tani, por mendoj se ajo duhet të ketë ekzistuar në gjithë ato zona të Shqipërisë Jugore ku gratë e martuara, flokët e thurur gërshet, e kishin zakon t'i mblidhnin top, duke i përdredhur në formë spiraleje, në pjesën e prasmë të kokës dhe t'i fiksonin me furqeta teli. Sidoqoftë gjurmimet e ardhshme mund ta sqarojnë më tej këtë çështje. Me interes do të ishte gjithashtu të dimë a ka pasur raste të përdorimit të *kezës* tek shqiptarët e Greqisë.

Sikurse e thamë, vajzave të pamartuara nuk u lejohej të vinin *kezë*. Ndryshonte edhe mënyra e rregullimit të flokëve. Sikurse tregojnë fotografi të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit tonë, vajzat arbëreshe i ndanin flokët në mes, i shtronin mirë dhe i thurnin në dy gërsheta, pranë veshëve. Skajet e gërshetave i kthenin së brendshim dhe i lidhnin me gjalm, (shih fig. 51).

2. — Do të flasim shkurtazi edhe për *kapuçin me pare* të cilën na e përmendin disa autorë të shekullit XIX. Kjo ishte një skufje që mbulonte kokën e veshët e arrinte deri tek qafa, mbi të cilën qepeshin pare të shumta. Ato përfaqësonin prikën e martesës të vajzës që e mbante. Në një gravurë të vitit 1825, të vizatuar nga Stackelberg, shihet një vajzë nga arbëreshët e Greqisë, me një *kapuç* të tillë në kokë (fig. 30). Një udhëtar i mesit të shekullit XIX, që ka asistuar në një dasmë shqiptare në Eleusinë.

158) Sipas R. Parisi, *Costumi albanesi d'Italia. La vestizione*, në «Revista Europea» vol. XXIV, fase IV, Roma-Firenze 1881.

159) *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar*, Tiranë 1965, v. I, f. 37.

thotë gjithashtu se vajzat shqiptare kishin zakon që t'i mbanin gjithë monedhat e arta të tyre (në një kësulë) rreth kokës¹⁶⁰.

3. — Së fundi le të përmendim se, si një ndikim oriental, janë përdorur në vendin tonë, për të plotësuar kostumin ceremonial të martesës, edhe disa lloje kësulash të ndryshme, të zbukuruara me pare, temina e tufa tirtiri, kryesisht në veshjet qytetare e sidomos të grave myslimane, si ishin fesat e dallfesat e ndryshëm, që shoqëronin kostumin me dimite të grave të Shkodrës, Prizrenit, Pejës, Tiranës, Elbasanit, Beratit, Gjirokastrës etj. Por rrallë ka ndodhur që ato të përdoren në kostumin fshatar. Një rast i tillë është, p.sh., ai i kostumit të nuseve të Lunxhërisë, që mbanin ditën e martesës një fes të kuq shumë të zbukuruar me pare.

Krejt i veçantë gjithashtu është rasti i kësulës së vogël (me diametër 12-14 cm), të zbukuruar me pare e tufëza, që mbanin ditën e martesës gratë e Rajcës (rr. i Librazhdit) në shekullin tonë, e cila duhet konsideruar më fort si zbukurim, sepse nuk ka funksionet praktike të një mbulese ko-ke.

Nga materiali i parashtruar më lart del se mbulesat e kokës kanë qenë të shumëllojshme dhe pasqyrojnë stadi të ndryshme zhvillimi e ndikime të ndryshme kulturore. S'ka dyshim se interesi etnografik përqëndrohet kryesisht në mbulesat e kokës të grupit, I, të cilat i konsiderojmë edhe me traditë më të vjetër.

Sikurse u vu në dukje, mjaft prej tyre janë të dëshmuara që në mesjetë jo vetëm si material, por edhe si mënyra lidhjeje e rregullimi në kokë.

Duke iu referuar të gjitha mbulesave të kokës në përgjithësi, si për gra e për burra, do të theksojmë se midis tyre ka disa me origjinë shumë të lashtë, sepse forma fare të ngjashme me to i shohim të paraqitura në disa dëshmi arkeologjike. Që në vi-

tin 1908 E. Fisher pati vënë në dukje se «popujt e tanishëm ballkanikë kanë ruajtur në disa nga pjesët më themelore veshjet dhe frizurat e stërgjyshëve të tyre të Butmirit, Jablanicës, Adam-Klissit dhe Kukecinit¹⁶¹ (pra të ilirëve dhe dakëve — A. Gj.). Mendoj se me të drejtë F.B. Floresku u jep një origjinë ilire dhe kësulave aderente mbas kokës, të tipit të qelesheve që mbahen në Shqipërinë e Veriut.¹⁶² Kurse kësulat prej lëkure qengji që përmend Nopcsa për mirditasit në fillim të shekullit tonë, na sjellin ndërmend gjetjet ilire të minierës së Dürrenbergut në Austri, të epokës Hallstat,¹⁶³ në të cilat bënte pjesë një kësulë lëkure, së bashku me një opingë e një çantë lëkure.

Për sa u përket mbulesave të kokës të grave, mund të bëhet ndonjë përqasje me disa relieve guri të lashtë në të cilat janë paraqitur gra ilire. Mund të vihen në dukje p.sh., ngjasimet tipologjike të mbulesave të kokës në formë katërkëndëshi kënddrejtë që kapen tek flokët e varen lirshëm prapa (grupi, I, 2) si ato të Fushë-Krujës, në një relief ku është paraqitur Diana e dy nimfa pranë saj,¹⁶⁴ (fig 208) ose të grave të paraqitura në situlat, ¹⁶⁵ (fig. 209) e ndonjë tjetër. Mendoj gjithashtu se edhe «prosopi» (grupi I, 1c) i bardhë prej pëlhure të rruddhur, i cili është shumë i ngjashëm me një mënyrë të vjetër të mbështjelljes së kokës në disa zona të Rumanisë ¹⁶⁶, ka të ngjarë ta ketë origjinën që në kohën romake.

Në lidhje me mënyrën e mbajtjes së flokëve, le të kujtojmë vetëm atë që është thënë në Kreun I, se në shekujt e mesjetës e deri në mesin e shekullit XIX burrat shqiptarë i mbanin flokët e gjata deri në supet e më poshtë dhe se, në shek. XIV, ishte zakon që t'i thurnin në një gërshet (si bënte Andrea Kshetisi i Muzakajve). Në lidhje me këtë zakon të shqiptarëve na tërheq vëmendjen pohimi i një autori antik, Atheneut, i cili thotë se Japigët (të cilët ishin një fis ilir A.Gj.) ishin të parët që filluan të

160) A. Proust, *Un hiver à Athènes*, ne «Le tour du Monde» 1959, XXI.

161) E. Fischer, *Haar und Kleidertracht vorgeschichtlicher Karpathen und Balkanvölker*, në «Archiv für Anthropologie», Braunschweig, 1908, f. 15.

162) F. B. Florescu, *Geneza costumului popular românesc*, në «Studi si cercetări, de istoria artei», Bucuresti 1956, f. 26.

163) Shih G. Kyrle, *Reallexikon der Vorgeschichte*, zëri Dürrenberg.

164) S. Ferri, *Arte romana sul Danubio*, Milano 1933, f. 433, fig. 546, relief i gjetur në Glamoč pranë Sarajevës.

165) Është fjala për situlën e Certosës (Bologna, shih Hoernes-Menghin, *Urgeschichte der bilderen Kunst in Europa*, Wien, 1952, f. 546.

166) F. B. Florescu, *Geneze costumului popular românesc*, etj. f. 36, fig. 3 b.



Fig. 208 — Diana e dy nimfa pranë saj.

mbanin gërsheta, duke shtuar flokë të rremë (jo të vetët).¹⁶⁷ Kurse për gratë rregullimi i flokëve të mbledhur në një top prapa (shumë i zakonshëm në Shqipëri) njihet të paktën që në shekujt V-IV para e. r., si dëshmojnë shumë skulptura, i përket sferës së qytetërimit antik grek. Disa të tilla janë zbuluar edhe në vendin tonë.

STOLITË DHE AKSESORË TË TJERË TË VESHJES

Në veshjet popullore shqiptare, qofshin për gra, qofshin për burra, vëmë re se ka disa objekte të cilat e plotësojnë, e stolisin njeriun, duke i dhënë një pamje më festive, më të çelur, dhe, qoftë me pamjen e tyre origjinale, qoftë me vlerën intriseke që kanë, bëjnë që, ai që i mban, të dallohet, ku më pak e ku më shumë prej të tjerëve.




Fig. 209 — Gra të situlës së Bolonjës (Itali)

Ka raste kur këto objekte kanë edhe një funksion praktik (si p.sh., paftat që mbërthehen njëra me tjetrën, sumbullat që vihen për të kopsitur veshjen, armët e brezit etj.) por shumë herë në to mbizotëron funksioni estetik e ai magjik, si ndodh p.sh., në shumë zbukurime që u vihen fëmijëve ose nuseve të reja për të mos marrë më sysh, por edhe për bukuri.

Në përgjithësi mund të thuhet se stolitë ndryshonin sipas moshës së bartësit dhe sipas rastit për të cilin viheshin. Më anë tjetër ato ishin në vartësi të gjendjes ekonomike të familjes përkatëse, sidomos stolitë metalike e me gurë të çmuar, të cilat bliheshin. Më të pasurit mbanin më shumë stoli e më të kushtueshme. Megjithatë nuk duhet harruar se, po të kalojmë nga një krahinë në tjetrën, krahas një numri stolish që përdorshin në shumë zona të vendit, do të vëmë re se ka edhe një specifike krahinore në këtë fushë. P.sh., stolitë e grave të Zadrimesë janë të ndryshme nga ato të Çermenikës apo të Dumresë. Ky ndry-

¹⁶⁷) Cituar sipas Daremberg et Saglio, *Dictionnaire des Antiquités* etj. zëri Coma.

shim krahinor është i ndjeshëm jo vetëm në repertorin e stolive dhe në cilësinë e tyre, por edhe në sasinë e stolive të përdorura. Në shumë zona të Shqipërisë Jugore, edhe për rastin e martesës gratë përdornin një numër të kufizuar stolish, ku më shumë e ku më pak të kushtueshme, në të tjera zona ato mbingarkoheshin me stoli, duke vënë njëherësh 7-8 unaza në gishta ose 4-5 varëse te gjoksi, e të tjera zbukurime te qafa, në kokë etj.

Stolitë mund të përgatiteshin prej materialesh të ndryshme, duke filluar nga degëzat, gjethet e lulet natyrore, deri tek imitimet e ndryshme të tyre prej fijesh të ngjyera ose prej metali. Janë përdorur edhe stoli qelqi, pra rruaza të llojeve e të madhësive të ndryshme, por edhe kombinime të metalit me gurë me ngjyra, gurë të çmuar etj. Stolitë më të thjeshta përgatiteshin nga vetë gratë fshatare pjesërisht ose tërësisht me material tregu (p.sh., varëset me rruaza të imëta etj.), kurse pjesën më të madhe i punonte mjeshtri argjendar në qytet.

Stolitë vendoseshin në pjesë të ndryshme të trupit: në kokë (e pikërisht në flokët, në ballë, në veshët, në qafë), në gjoks e në bel dhe pastaj në duart (sidomos në gishtat) dhe, për burrat edhe në këmbët.

Stolitë përbëjnë një grup objektesh shumë të larmishme, që është vështirë të kapet në tërë gjerësinë e tij krahinore, qoftë edhe në një hapsirë kohe deri-diku të kufizuar, p.sh., në gjysmën e parë të shekullit tonë. Më poshtë do të përpiqemi të shqyrtojmë disa nga stolitë më shprehëse, duke iu përmbajtur një ndarjeje që është fort e respektuar, ndarjes sipas sekseve. Dihet se asnjë burrë nuk mbante stoli grash dhe anasjelltas, sepse çdo shkelës i këtij kufiri rrezikohej të bëhej qesharak.

1. Stoli dhe aksesore të veshjes për burra

Këto stoli do të shqyrtohen duke mbajtur parasysh se në ç'pjesë të trupit visheshin, pra në gjoks, në bel etj.

Para së gjithash do të vihen në dukje se, të paktën, që në shekullin XVIII — sikurse

na tregojnë shumë gravura të kohës dhe disa dokumente vendase — aksesoret kryesorë që aspironte të kishte çdo burrë shqiptar ishin armët. Jo rastësisht dita e dhënies së armëve çdo djali që arrinte moshën 14-15 vjeç ishte një festë në familje. Po ç'ishin armët? Në një testament nga Shkodra, shkruar më 1785 përmenden armët e Stefan Palucës, që ishin këto: pushka, koburja, hanxhari e vezmet, kurse në testamentin e Anton Simonit të vitit 1773, përmenden: një hanxhar e një thikë.¹⁶⁸ Po të gjykonim nga gravurat dhe nga koleksionet e armëve, të ruajtura në muze të ndryshme të vendit, armët që mbanin burrat shqiptarë në shekujt XVIII-XIX ishin përgjithësisht të zbukuruara, pra të veshura në gjithë sipërfaqen e tyre me fletëza argjendi, të dekoruara me motive të pasura, pra mund të konsiderohen me plot të drejtë edhe si stoli. Këto armë, që ishin krenaria e burrit shqiptar për ato kohë, në fillim të shekullit tonë, të paktën në Shqipërinë e Jugut nuk mbaheshin më. Mbledhësi ynë i folklorit Spiro Dine më 1908 thotë se, në kohën e tij «shqiptari nuk i mbante më stolitë e bukura, follat, tokat, zinxhirët, kryqet në krahëror, pllaskat e argjenda etj.»¹⁶⁹

Në fotografi të shumta të gjysmës së dytë të shek. XIX, shumë burra, sidomos në Shqipërinë Veriore, mbajnë në brezin e tyre të gjerë prej lëkure (silahun), dy kobure, dy vezme ose pallaska shpesh herë edhe një vezme tjetër të vogël, palcoren me pak yndyrë për ta pastruar armën, (fig. 210, a, b, c), si edhe hanxharin në kllëf.

Një objekt shumë i përhapur zbukurimi ishin follat dhe çaprazet (një ose dy çifte), një lloj paftash argjendi, përgjithësisht të rrumbullakta, të zbukuruara me të rrahur dhe me savat që kapeshin njëra me tjetrën në të dy anët e jelekut. Në vargje të epikës popullore edhe gjoksi i Halilit ishte i zbukuruar ma çapraze¹⁷⁰ madje kënga thotë se Halili i veshur tepdil kishte shkuar të rrëmbente Ruzhën e Kapedanit dhe atje një plakë e njohu nga çaprazet e tij, të cilat kishte harruar t'i hiqte. Çapraze mbanin gjithë burrat shqiptarë, si në veri dhe në jug, kryesisht si stoli. Në një këngë të mbledhur më 1855 nga Reinhold, thuhet:

168) AQSH Dosja 19, testamenti 19.

169) Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar vëllimi III, Tiranë 1962, f. 87.

170. Po atje, Kënga «Martesa e Halilit», vëll. III, f. 532.



a



b

Fig. 210 — Vezme (a, b)

Çun i vogël me çaprasie
Kujt ia bën ti ato ato nazie?¹⁷¹⁾

Kurse ndër këngët e mbledhura rreth vitit
1850 nga G. Hahn, janë edhe këto vargje:

Ngreu kapetan Nikolla
Ngjishe mesinë me folla
Vurë armë dhe pisqolla¹⁷²⁾

Në llojin e follave si stoli duhet të përfshijmë edhe ato dy sumbulla të mëdha argjendi që mbanin tek jaka e xhamadanit të tyre qefalinjt apo krerët e disa zonave të Veriut në shek. XVII, për të cilat na dëshmon një relacion i F. Bardhit, të cilin e kemi përmendur në Kreun e parë të kësaj vepre.

Shumë të pëlqyera ishin edhe sumbullat e ndryshme dekorative, që viheshin përpara në të dy anët e jelekut, jo aq për funksion praktik, sesa për zbukurim. Ato mund të ishin të derdhura në metal, në forma të

ndryshme ose të veshura artistikisht me gajtan ari ose mëndafshi ose të kombinuara me rruaza të vogla merxhani nëpër to. Të tilla sumbulla jelekësh përmenden në disa testamente të gjysmës së dytë të shek. XVIII nga Shkodra¹⁷³⁾, madje edhe në disa testamente të shekullit XVIII nga Berati, (viti 1687 dhe 1683).¹⁷⁴⁾

Një zbukurim gjoksi për burra, karakteristik për Shqipërinë e Jugut ishte qosteku në formë X që kishte në qendër një paftë metalike të derdhur, afërsisht në formë rombi, nga e cila zgjateshin në katër drejtime nga 10 zinxhirë të kapur në skajet e jashtme me pafta të tjera metalike, që mbaronin me gremça, të cilat kapeshin pas jelekut. (fig. 211 a). Këta qostekë zbukuroheshin, përgjithësisht, me savat. Kishte dhe qostekë të tjerë, më të thjeshtë e më të vegjël, me 5-6 zinxhirë, që përfundonin herë me një follë dekorative 211 b herë me një palcore të bukur. Në Shqipërinë e Veriut pëlqeheshin qostekët prej filigrane argjendi, me shumë kokrra e të përbërë prej një vargu sumbullash e sferash, të cilat shpesh herë

171) Po atje, vëll. I f. 110.

172) Po aty, » f. 76.

173) AQSH, Tiranë, Dosja 19. dokumenti 19.

174) AQSH, Dokumente të Sherisë së Beratit, Dosja 15, Libri 61/b, f. 2, ku përmendet një sumbull argjendi me vlerë 19 akçe) dhe f. 21.





Fig. 211 — a, b, c, Qostekë burrash



b

kishin edhe gurë merxhani. Ata vareshin diagonalisht në gjoks, nga supi i djathtë e poshtë në anën e majtë. Shumëkush, nga paria, varte në fund të qostekut një sahat, për të cilin bëhej posaçërisht një xhep i vogël, në faqen e brendshme të jelekut (fig. 74.c). Këta qostekë ishin shumë të kushtueshëm e të paktë ishin ata që mund t'i blinin. Të tjerët përdornin qostekë të thjeshtë, të përbërë prej një zinxhiri argjendi që varej në qafë (fig. 211 c).

Për burrat e shtresave më të pasura nuk mungonin edhe stoli të tjera më të kushtueshme. I tillë është p.sh., një çift thikash argjendi, të futura në një këllëf po prej argjendi. Si dorëzat e thikave, që mbarojnë secila me një kokë zog, ashtu edhe këllëfi,



janë punuar me mjeshtëri të rrallë (fig. 212).

Një aksesori tjetër, që e mbanin shumica e burrave që pinin duhan, ishin pipat e ndryshme (ose cigarishtet). Fshatarët i bënin më fort prej druri (dru jasemini, bu-




Fig. 212 — Çift thikash (Stilet)

shi etj); në Shqipërinë e Mesme janë përdorur pipa druri me disa zbukurime, kurse ata më të pasurit përdornin pipa argjendi, shpesh me gojëza qelibari (fig. 213 a,b). Shumë burra mbanin nga ndonjë unazë të thjeshtë argjendi, kurse disa nga krerët dhe të pasurit mbanin unaza masive argjendi të zbukuruara me gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar; disa të tjerë unaza me «myhyr» ose gur në të cilin ishte gdhendur në negativ një simbol (fig. 214).



Fig. 213 — a, b Pipa argjendi



b



Fig. 214 — Unazë argjendi

Ndër aksesorët e veshjes së burrit le të përmendim edhe plloskën e verës, që mbanëj e varur në brez, ajo ishte shumë e zakonshme në shekujt e mesjetës, por erdhi duke u rralluar nga një shekull në tjetrin dhe në shekullin tonë pati mbetur pothuaj vetëm si shenjë e grishësit për dasmë. Shumë herë plloskat ishin të zbukuruara hijshëm. Sikurse është vënë në dukje në kreun e parë, një plloskë vere mban në brez bariu i Onufrit (afresk i shek. XVI) dhe, sipas një kënge të vjetër popullore, edhe plaku që shkon derë më derë, «duke lypur bukë e verë» (sipas dorëshkrimit të Kieutit, vitit 1737).

Një zbukurim, i zhdukur kryesisht në shekullin tonë, janë follat e rumbullakta të këmbëve. Ato shihen ende nëpër gravura të fillimit të shekullit XIX, por, nga fundi i atij shekulli, nuk shihen më. P.sh., duken fare qartë tek këmbët e një luftëtari shqiptar, me sa duket nga Janina, të cilin Stackerbergu e ka vizatuar të ulur, me flokatën karakteristike në një sup dhe pushkën në dorë. Në secilën këmbë ai duket se ka tri togëza apo folla argjendi, dy tek nyjat dhe një nën gju, të lidhura me rripa lëkure. (Tab. III a, b). Këto zbukurime i përmend edhe udhëtari A. Boué i cili — duke folur për kallçijt apo tesllukët e burrave toskë dhe epirotë — thotë se «njerëzit më të shquar i zbukurojnë ato tokëza argjendi» dhe shton se kjo i kujtonte disa pajisje të ngjashme të kohës romake.¹⁷⁵

175) A. Boué, *La Turquie d'Europe*, II. Paris 1840, f. 225.

2. Stoli dhe aksesorë të veshjes për gra

Stolitë që mbanin gratë ishin përgjithësisht më të shumëllojshme se ato të burrave, sidomos gjatë shek. XIX. Ato përgatiteshin në një seri sa më të plotë e më të mirë, me rastin e martesës, por gjithnjë në varësi të drejtpërdrejtë të kushteve ekonomike të familjes dhe përgjithësisht si sasia, ashtu dhe cilësia e tyre përcaktohej mirë që në marrëveshjen e martesës¹⁷⁶. Në shumë zona të vendit të gjitha stolitë së bashku thirreshin me një emër kolektiv: argjendet, rgjanat, stringlat a spigat dhe, tek arbëreshët e Italisë, lilat.

Vajza a gruaja mund të zbukurohej edhe me mjete fare të thjeshta rrethanore, p.sh., duke vendosur një lule a një degëzë të lulëzuar në flokët e saj në stinën e pranverës apo duke vënë në palat e mbulesës së kokës një tufëz bimësh aromatike etj. Kishte zona, si Drenica në Kosovë, ku vajzat në pranverë vinin ndonjë lule në kokë «lula majë kreje», (si thuhet në këngët popullore), apo Myzeqeja ku nuset e reja mbanin, në peshqirin e kokës, një tufëz borzilok ose trëndelinë; në arbëreshët e Greqisë ato vinin një trëndafil me erë. Për një zbukurim të thjeshtë e të përditshëm përdorehin edhe gjalma të thurur me fije leshi ngjyrash të ndryshme, të cilave u viheshin vende-vende edhe tufëza leshi. Ato lidheshin zakonisht në fund të gërshetave. Në Vasojeviçët e Ljeva Rekës në Mal të Zi¹⁷⁷, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, vajzat i thurnin flokët në një gërshet të vetëm, të cilin e zbukuronin me pare e sumbulla dhe në fund varnin edhe një zile të vogël (e cila natyrisht kishte edhe një funksion magjik).

Seria më e plotë e stolive ishin ato që përgatiteshin me rastin e martesës; në shumë krahina atyre u kushtohej vëmendje e posaçme. Këto stoli përgatiteshin me mate-

riale të ndryshme (argjend, rruaza, gurë me ngjyra etj.) dhe viheshin në pjesë të ndryshme të trupit. Edhe duvaku, që i vijej nuses në kokë ditën e dasmës, zbukurohej me xhingla të ndryshme gjithfarësh, por edhe me tufëza penjsh me ngjyra.

Ndër zbukurimet e kokës duhen përmendur, në radhë të parë, disa pafta metalike, kryesisht prej filigrane që fiksoheshin në një kapele të vogël e të cekët, të veshur me stof ose kadife të zezë, që ishin shumë karakteristike për disa zona të Veriut, si p.sh., për Malësinë e Madhe (rr. Shkodër), për Drenicën (Kosovë) (fig. 215, 216.) etj. Dy pafta të tilla ka fotografuar A. Haberlandt më 1916¹⁷⁸. Shumë zbukurime koke, kryesisht prej filigrane argjendi, me gurë me ngjyra ose me monedha argjendi etj., qepeshin në pjesën e përparme të një fesi mjaft të lartë, pjesa e prapme e të cilit mbulohej nga një peshqir i pambuktë që varej lirshëm prapa. Të tilla zbukurime koke ishin mjaft të përhapura në shekullin e kaluar, në shumë zona të Shqipërisë Veriore, sikurse na tregojnë disa nga fotografitë më të vjetra të Marubit (Shkodër); të tilla janë p.sh. gruaja nga rrethet e Tivarit, gruaja nga Puka etj. Në mjaft zona ato vazhduan të mbahen edhe në shekullin tonë sidomos për nuset e reja.

Tek Vasojeviçët në Mal të Zi, me veshjen e vjetër që mbahej para vitit 1890, gratë i thurnin flokët me dy gërsheta dhe, gjatë thurjes, u vinin si zbukurim pare argjendi e të tjera më pak të vlefshme. Ato të Nahijes vinin për zbukurim edhe merxhane, dhe stoli të tjera të vogla. Në kokë vinin një kapë prej shajaku të zi ose prej cohe të kuqe, të zbukuruar me merxhane e në secilin merxhan varej një pare. Poshtë tyre vinte një rresht me rruaza të mëdha ngjyrash të ndryshme. Në Ljeva Rekë gratë e kapnin leveren e kokës tek flokët

176) Në disa kontrata martesash të regjistruara në Shkodër në mesin e shek. XIX përmenden ndër të tjera edhe stoli të ndryshme që kërkoheshin me këtë rast nga familja e dhëndrit. Kështu më 1848, Maria, e bija e Simon Sumës, detyrohet të vejë tek burri e pajisur me një stringël me gur xhevahiri, dupa Venediku të quajtur rushpe dhe vëthët me pesë çerek dupi secili: Çilja e Hil Kovaçit në vitin 1851 duhet të pajiset me dy rreshta dupa e një palë vëthë me dupa treçerekshë; Tonia, e bija e Tush Tomës, po atë vit, duhet të pajiset me një stringël me tre rreshta dupa dhe një palë vëthë ari, ndërsa Tereza, bija e Zef Tomës (viti 1851) me një stringël e dy palë vëthë. (Këto materiale pati mirësinë të m'i verë në dispozicion K. Ulqini, Shkodër).

177) M. Vlahoviç, art. i cit. f. 80.

178) Shih A. Haberlandt, vepra e cit. Tab. II, nr. 18 dhe tab. III, nr. 7.



Fig. 215 — Malsore me kopicë (zbukurim koke)



Fig. 216 — Grua me kopicë (Drenicë, Kosovë)

me dy tri gjilpëra të mëdha argjendi, me kokë shumë të zbukuruar, jo vetëm që të qëndronte më mirë, por edhe për bukuri.¹⁷⁹

Në zona të tjera të Malësive të Veriut, në vend të fesit apo të kapës me pare, vihej një gjalm i thjeshtë tek i cili ishin varur 4-5 monedha. Ai lidhej drejt mbi flokët e pastaj vihej një mbulesë koke prej pëlhure shumë të zbukuruar, si e ka p.sh., gruaja nga Shoshi në një fotografi të Marubit, të bërë rreth vitit 1890¹⁸⁰, apo një mbulesë koke të thjeshtë e të trashë si ajo e një gruaje nga Shllaku (po ashtu foto e Marubit)¹⁸¹ etj. Sipas një dëshmie të gjysmës së parë të shekullit XIX, rreth vitit 1840,

edhe gratë mirditore mbanin në kokë lëvere të bardha, të cilat për të qëndruar më mirë — i kapnin tek flokët me dy-tri gjilpëra të gjata me koka të mëdha me formë vezore¹⁸².

Një zbukurim interesant i kokës, që ka dalë nga përdorimi prej kohësh, janë tëmthoret e bukura prej bronzi, që kapeshin tek flokët ose tek leverja dhe vareshin tek tëmthat. Ato duken qartë nëpër disa fotografi malësorësh të bëra nga Marubi në shekullin e kaluar. Një palë tëmthore nga Shkreli i ka fotografuar edhe A. Haberlandt¹⁸³ më 1916.

Disa nga *vëthët*, më interesantë që kanë mbajtur gratë në Shqipëri, janë ata të Mir-

179) Sipas M. Vlahović, art. i cituar, f. 71.

180) Fotografia në fjalë është riprodhuar nga X. M. Czerminski, *Albania*, Krakovie 1893, f. 25. Shih edhe K. Ulqini, *Gjurmë të historisë kombëtare*, Tiranë 1980, f. 18.

181) Është riprodhuar nga A. Degrand, *vep. e cit.* Paris 1901.

182) A. Boué, *La Turquie d'Europe*, v. II, Paris 1843, f. 228.

183) A. Haberlandt, *vep. e cituar*, tab. I, rr. 2.

ditës, prej argjendi punuar me kokrriza, të cilët zbukuroheshin nganjëherë në pjesën e poshtme me një paftë në formë drapri, hënëze, nga e cila vareshin dy-tri monedha. (Shih fig. 217). Vëmendje të veçantë u është kushtuar këtyre vathëve, për shkak të analogjive të qarta që ata paraqesin me gjetjet mesjetare të Komanit, të Buklit, të Krujës etj. (shek. VI-VIII)¹⁸⁴. Gjithashtu interesante paraqiten, nga forma dhe dekori dy lloje të tjera vathësh të Shqipërisë së



Fig. 217 — Vëthë




Fig. 218 — Vëthë



Fig. 219 — Qafore me rruaza.

Veriut, të fotografuar nga A. Haberlandt¹⁸⁵ më 1913, ndonjë ekzemplar nga të cilët ndodhet edhe në koleksionet etnografike të Institutit të Kulturës Popullore në Tiranë (fig. 218). Për sa u përket vathëve, përveç formave që shihen në ilustrimet përkatëse, një dukuri disi e veçantë, sidomos në pjesën jugore të vendit, është përshtatja e monedhave prej argjendi ose ari për vathë duke u vënë një gremç argjendi.

Për sa u përket zbukurimeve të qafës, mund të themi se disa zona parapëlqenin qaforet apo gjerdanët me rruaza ngjyrash të ndryshme, shumë herë të kombinuara edhe me monedha nëpër to. Rruazat i blinin në treg por montimin e bënin vetë fshatarët. Të tilla zbukurime qafe mund të shihje në shumë zona të vendit, por më gjerësisht ato ishin të përhapura në disa zona të Shqipërisë së Mesme (fig. 219).

Pëlqeshin mjaft edhe vargjet njëshe ose dyshe me rruaza më të mëdha ose me një pare argjendi të varur me një gjalm apo me një zinxhir. Varëset metalike të qafës ishin të shumta e të shumëllojshme. (fig. 220 a, b).


Në disa zona zbukurimet metalike përdoreshin, mund të themi më tepër; atje stolitë e qafës përziheshin me ato të gjoksit.

184) H. Spahiu, «Disa stoli metalike të ditëve tona me tipare të trashëguara nga kultura e hershme shqiptare», në «Konferenca e dytë e Studimeve Albanologjike II, Tiranë 1969, f. 247-269; A. Degrand, vep. e cit. f. 262-263.

185) A. Haberlandt, vep. e cit. Tab. II nr. 13, 14.



Fig. 220 — a, b Varse metalike



b

Gjerdane mjaft të rëndë paresh e paf-tash dekorative të varura në tre-katër zinxhirë njëri poshtë tjetrit, ishte vështirë të mbaheshin në qafë dhe kështu fiksoheshin në supet, tek gajtanët e jelekut, me anë të dy kapsave të forta prej teli. Në këngët popullore përmenden gjerdane me monedha të ndryshme (me grosha, me rrushpe, me gjela etj). Në këta gjerdane mund të kishte — ashtu si edhe te varëset e qafës — pafta të mëdha e të bukura filigrane, të kombinuara edhe me gurë me ngjyra (të kuq, të gjelbër). Përdoreshin gjithashtu disa zinxhirë të gjatë të varur krahëqafë, në të cilët varej një paftë e madhe trekëndëshe (hajmalia) dhe monedha të ndryshme argjendi. Tipike për këto lloj stolish, në shekullin tonë, ka qenë zona fushore midis Shkodrës dhe Lezhës dhe me sa duket kjo i detyrohet ndikimit të stolive të ngjashme që mbanin gratë e qytetit të Shkodrës. Sikurse shihet në ilustrimet, fshatarët e kësaj zone ishin të mbingarkuara me të tilla stoli gjoksi, sidomos nuset e reja (fig. 123 dhe 221). Krahu të tjera si p.sh., zonat



Fig. 221 — Zadrimore me stolitë e saj

midis malësisë së Tiranës, rretheve të Elbasanit e të Librazhdit e deri në Pogradec, pëlqenin më shumë zbukurimin e gjoksit me monedha të ndryshme, të montuara në rreshta vertikale, në dy copa pëlhure të fortë ose të qepura në të dy anët e një jeleku, që merrte dhe emrin «jleku me pare», duke i kombinuar shumë herë paret me sumbulla të vogla qelqi ose porcelani apo me objekte magjike si dhëmbë sute etj. Këto zbukurime me pjesë metalike të lëvizshme e shoqëronin me një zhurmë karakteristike ecjen e nuses nëpër shtëpi ose në oborr a kudo që shkonte, sepse vitin e parë të martesës ajo duhej t'i mbante gjithmonë në trup stolitë e saj të nusërisë; në mentalitetin popullor ato ruanin ende një funksion të rëndësishëm magjik, kryesisht për ta mbrojtur nusen nga «syri i keq». Në të tjera krahu, sidomos në jug të vendit, stolitë e gjoksit ishin më të pakta, por jo më pak të bukura. Deri në Luftën e Parë Botërore, përdoreshin gjërësisht qoshtëkë të ndryshëm me zinxhirë e pafta argjendi të derdhur, të zbukuruar me savat etj., që kishin përgjithësisht një ndërtim simetrik (shih fig. 222).




Fig. 223 — Qostek gruaje (Shqipëria e Jugut)

Shumë i zakonshëm ishte përdorimi i sumbullave dhe i paftave metalike, me forma të ndryshme, të vendosura simetrisht në të dy anët e jelekut. Shumë të bukura janë dy pafta të tilla të riprodhuara nga Haberlandt dhe tjera që ruhen në fondet etnografike¹⁸⁶). Tjetër zbukurim shumë i përhapur, sidomos në Shqipërinë e Jugut, ishin paftat ose follat metalike që përdoren për të mbërthyer brezin, i cili mund të ishte prej tekstili, prej lëkure, ose — për shtresat më të pasura edhe krejt prej argjendi. Paftat, në disa raste, ishin tepër të mëdha, të rumbullakta ose në formë dardhe (fig. 146 a); në të tjera kishin përmasa më të reduktura por pothuaj të njëjtat forma. Ekziston një shkallëzim e një kalim pothuaj i natyrshëm nga paftat te brezat. Midis tyre gjenden disa nga ekzemplarët më të bukur të punëve të mjeshtërve argjendarë të Beratit, Elbasanit, Shkodrës, Prizrenit, Gjakovës etj. (fig. 223, 224 a, b, c, d). Natyrisht në kostumet fshatare mbizotëronin brezat prej tekstili, të zbukuruar me pafta metalike.

Në disa zona të vendit gratë montonin mbi brezat e tyre, pafta, sumbulla dhe aplika të ndryshme metalike etj. Një ekzem-

plar interesant, me prejardhje nga Mirdita na e ka paraqitur. A. Haberlandt në veprën e cituar. Paftat janë prej bronxi dhe disa prej tyre paraqesin ngjashmëri me gjetjet e Komanit¹⁸⁷. Meritojnë vëmendje edhe pjesët prej bronxi të montuara në pjesën e përparme të disa brezave të Çermenikës.

Tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë një brez lëkure 5-6 cm. i gjër mbi të cilin montohehin pafta të ndryshme metalike; ai përdorej deri në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit tonë, në zonat malore të Shqipërisë Veriperëndimore, që shtrihen edhe përtej kufijve të sotëm politikë të vendit, në lugina të Alpeve apo rrëzë tyre. Si zbukurimi i paftave të mbërthyer tek brezi po veçanërisht unazat treshe e aplika të tjera, të varura në buzën e poshtme të tij, e bëjnë shumë interesant krahasimin me gjetjet të ndryshme të kulturës arbërore mesjetare, madje edhe me objekte të tjera shu-




Fig. 223 — Varse

186) A. Haberlandt, *vep e cit.* Tab. IV, fig. 2 dhe tab. V, fig. 1. Shih gjithashtu objektet me nr. inv. 1072.

187) A. Degrand, *vep. e cit.* f. 263.





Fig. 224 — a,b,c,d, Pafta brezi




b



c

më më të hershme, që vijnë nga tumat e luginës së Matit.

...Duke iu referuar këtyre unazave treshe



d

që vareshin te rripi, A. Degrandi ka shkruar: «Ka një identitet të plotë, në kostumin e grave malësore, midis disa ornamenteve prej bakri që ato mbajnë tek brezi i tyre e që punohen ende në pazarin e Shkodrës, dhe një numri objektësh, nga ato që zbulova (në varresën e Komanit); ngjashmëria është aq e plotë sa do të besonje se këto ornamente vijnë nga këto varre dhe që vetëm përdorimi i tyre i vazhdueshëm u ka hequr patinën e bukur të gjelbër, që i karakterizon; por ato që mbahen aktualisht janë prej bakri të verdhë dhe jo prej bronxi».¹⁸⁹⁾

Tek këto unaza treshe vareshin, zakonisht në anën e djathtë, dy-tre zinxhirë, që përfundonin me objekte të përdorimit të përditshëm për gruan gjatë punëve shtëpiake. Këtë aksesori interesant e kanë mbajtur si e shohim në disa fotografi të vjetra të Marubit — gratë malësore të Shllakut, ato të Shoshit, gratë e zonës së Mbishkodrës, shqiptarët e disa zonave të Malit të Zi etj. Ja një përshkrim i këtij aksesori të veshjes tek gratë e Vasojeviqeve në Mal të Zi: «Nusja e re mbante tek brezi, në anën e djathtë, varur me një zinxhir ose me një gjalm të gjatë, kotullaçin prej shajaku të zi të qepur si rreth; në zinxhirin tjetër mbante një mashë të vogël e në të tretën një thikë të vogël. Para këtyre, në po atë anë, varte, për zbukurim, këmborë e zile të vogla.

188) Krahaso p.sh. fig. nr. 8 (brez me pafta bronxi nga Mirdita në vepr. e A. Haberlandt me fig. në f. 253 tek vepra e A. Degrandit.

189) A. Degrand, vep e cit. f. 265.

Kotullaçi i shërbente për të kapur enët e nxehta, masha për të marrë thëngjill zjarri për t'ua afruar atyre burrave që pinin duhan me çibuk. Kotullaçi, thika e masha mbahehin pra si objekte të nevojshme¹⁹⁰.

Zinxhirë të varur tek brezi mbanin gratë edhe në zona të ndryshme të Shqipërisë së Jugut, ku varej zakonisht një thikë e vogël dhe ndonjë paftë zbururuese, por këta zinxhirë kapeshin drejt tek brezi dhe unazat treshe ose dyshe mungojnë.

Këto ishin disa nga llojet kryesore të stolive që përdorehin në vendin tonë. Këto punë të ekzekutuara plot durim e shkathësi nga mjeshtrit argjendarë të qyteteve kryesore të vendit, me disa vegla e mjete pune fare të thjeshta, është e qartë se kanë moshë dhe prerje të ndryshme.

OPINGAT.

Opingat janë një element i veshmbathjes me traditë shumë të vjetër, të bazuar në prototipe autoktone ballkanike.

Opingat e përdorura nga shqiptarët, i përkasin një tipi, karakteristikat kryesore të të cilit janë, këto: a), në variantet më të thjeshta ato bëhen prej një cope të vetme lëkure në formë katërkëndëshi kënddrejtë, e cila përbën si pjesën e poshtme ashtu edhe pjesën e sipërme të saj, duke mbuluar vetëm gishtat e këmbës; b), me një sistem retrash lëkure e gjalmash leshi, buzët e opingës së pari rrudhen duke u afruar pas këmbës, pastaj fiksohen duke u lidhur përmbi shpinën e këmbës dhe rreth pjesës të nyja. Sipas mënyrës si qepet maja, si mblidhen anët, si kalohen e kryqëzohen gjalmat e retrat, si vihen rripat e gjuhëza ose si thurret faqja e sipërme e opingës në format më të zhvilluara të asaj etj., mund të dallohen variante të shumta. (fig. 225-229).

Në të kaluarën ky element i veshmbathjes ka qenë edhe tregues i gjendjes shoqërore të bartësit. Ndërsa përfaqësuesit e shtresave të larta mbanin, sidomos në shekujt e mesjetës, lloje të ndryshme pantoflesh, këpucësh e çizmesh të stolisura, shumica dërrmuese e fshatarëve mbanin vetëm opinga. Si të tilla, opingat që kanë arritur




Fig. 225 — Opingë e thjeshtë e papërfunduar (nr. inv. 7932 FE)




Fig. 226 — Opinga me gjalma (norta) (inv. 9139 FE)




Fig. 227 — Opinga me retra FE

190) M. Vlahović, vep. e cit. f. 265.




Fig. 228 — a, b, c Opinga me gjuhëzë.






Fig. 229 — Opinga me xhufka a



b



b



c



Fig. 230 — Opingë e vitit 1725



Fig. 231 — Hedhësi i farës (shek. 18) mban opinga me retra

të përdoren deri në kohën tonë, duhen parë pra, jo vetëm si element me traditë të vjetër, por edhe si tregues i varfërisë dhe i prapambetjes ekonomike e shoqërore të këtyre shtresave.

Opingat janë përdorur gjerësisht nga fshatarësia jonë deri në prag të Çlirimit, në variante të shumta që paraqisnin shkallë të ndryshme zhvillimi. Në pazaret e qyteteve kryesore të vendit, para Çlirimit, kishte mje-

shtër opingarë, të cilët punonin, me shumë zotësi, lloje të ndryshme opingash, me karakteristika zonale, për gra e për burra, për vende malore e vende fushore, të përforcuara me proka poshtë për barinj të ose me qëndisje e zbukurime të tjera në faqen e sipërme, për nusët e reja etj.

Disa forma opingash, për shekujt e kaluar, i njohin nga materiale figurative me interes, që u përkasin jo vetëm shekujve XIX e XVIII¹⁹¹ (fig. 230, 231) por në ndonjë rast edhe shekullit XVI¹⁹². Ato janë ruajtur gjithashtu në kulturën materiale të arbëreshëve të Greqisë e të Italisë, të cilët, si dihet, janë shpërngulur nga trojet shqiptare që në shek. XIV.

Në tiparet morfologjike më të lashta që ruhen, sidomos në variantet më të thjeshta të opingave tona, duhen përmendur: fakti që ato janë të dyja të njëjta si ajo e këmbës së djathtë ashtu edhe ajo e këmbës së majtë, dhe fakti tjetër që ato kanë formë të njëjtë në prerje, si për burra e për gra.

Ka rëndësi të theksojmë se tipi i opingave që përshkruam më lart përdorej jo vetëm në vendin tonë, por në zona të gjera të Ballkanit. Por ai dallohet qartë në tërë strukturën e tij nga tipat e këpucëve apo sandaleve që përdorte bota klasike greko-romake (kalceus, kalige, karbatina, kothurna, krepida, sola etj.) të cilat janë të njohura e të studiuara gjerësisht, sepse figurojnë të paraqitura qartë në monumentet të shumta, të shpërndara në të gjitha anët e botës antike.

Përjasja e tyre me gjetje arkeologjike ku janë paraqitur opinga të popullsisë ilire, si janë një fragment opinge (vetëm pjesa e përparme e saj) gjetur në një minierë kripe në Durnberg (Austri), të shfrytëzuar nga ilirët në epokën Hallstat (pra shek. V-IV), fig. 232). pastaj dy relieve ilire, njëri i gjetur në Glasinac e tjetri në Bihaç (Jugosllavi), (fig. 233), tregojnë se ngjashmëritë janë të mëdha. Këto dëshmi të kulturës ilire janë analizuar e komentuar nga disa autorë dhe është vënë re se ato paraqesin afërsi të dukshme me opingat që përdornin edhe dakët, në shekujt e parë të erës sonë, ndërsa në popujt e tjerë si grekët, romakët, gjermanët e slla-

191) Për këtë shih gravura të ndryshme të shekujve XIX-XVIII, si p.sh. gravura të Stackelbergut (1825), Choiseul-Gouffier (1782) kuadri i një anonimi që paraqet ktiterët e Mitropolisë së Korçës.

192) Është fjala për opingat e një bariu të paraqitur në një ikonë të shek. XVI (ndodhet në Muz. Art. Mes. Korçë).




Fig. 232 — Opingë ilire e gjetur në Durinberg (Austri) (shek. V-IV per).




Fig. 233 — Opingë ilire (shek. III-II p.e.r.)

vët vihen re dallime të qarta¹⁹³. Opingat duhet t'i konsiderojmë pra si një element me burim iliro-trak.

Fakti që këtë tip opingash e ndeshim në gjithë vendin tonë tregon se elementi ilir përbën komponentin më të rëndësishëm edhe në këtë fushë të kulturës sonë materiale.

Prania e tyre në sllavët e Ballkanit duhet shpjeguar si një ndikim i nënshtresës ilire, sepse dihet mirë se opingat tipike të sllavëve kanë qenë «laptiet».

Përmbyllje

1. Kjo vepër është shkruar me pikësynim që të tregojë pasurinë, përhapjen, dhe rëndësinë e kostumeve popullore, duke shqyrtuar jo vetëm tipat por edhe variantet e shumta të tyre, të evidentojë funksionet e shumta të kostumit popullor, të ndjekë dhe të përcaktojë gjenezën e disa elementeve përbërëse dhe karakterin etnik të tyre. Kjo do të ndihmojë që fondi më origjinal të bëhet i njohur, të popullarizohet më mirë e të integrohet në sfera të ndryshme të kulturës sonë të re socialiste.

2. Njohja me hollësi e tipave kryesorë të veshjeve popullore shqiptare, si për burra dhe për gra, si edhe shtrirja territoriale e secilit tip në periudha të ndryshme kohore, tregon se ka disa pikëpamje në lidhje me kuadrin kostumologjik të vendit tonë, të cilat tashmë duhen korrigjuar si të pathe-melta dhe, në shumë raste, të përhapura nga autorë të huaj jo pa qëllim apo nga mosnjohja e materialit. I tillë është rasti i fustanit a fustanellës, e cila paraqitet përgjithësisht si veshje burrash vetëm për

Shqipërinë Jugore. Materiali dokumentar e figurativ i sjellë tregon pa mëdyshje se deri nga fillimi i shek. XX, kostumi me fustanellë është mbajtur jo vetëm në Jug, por edhe në Shqipërinë e Mesme e atë Veriore. Këtu janë sjellë edhe shembuj të shumtë të përdorimit të saj në pjesën Verilindore të vendit, në Kosovë e vise të banuara prej shqiptarësh në Serbi etj., dëshmi këto të njohura pak deri tani e të pavlerësuara aq sa duhet. Përhapjen e fustanellës duhet ta shohim pra si një nga shfaqjet e tipareve unitare të kulturës sonë popullore.

Tjetër element i keqinterpretuar i veshjeve janë brekeshat e tipit të veshjes së vjetër të Tiranës e të disa zonave të tjera të Shqipërisë së Mesme, të cilat shumëkush i konsideron për turke, duke i ngatërruar me shallvaret e gjera, që i përgjigjen prerjes së dimitëve e që janë më të vërtetë turke.

3. Janë analizuar gjerësisht gjurmët e disa elementeve të lashta mesdhetare e më

193) Shih. F. B. Floreseu, *Opincile la romani*. Bucuresti 1959.

vonë ilire-trake, gjurmë të cilat, në disa raste, janë hetuar jo vetëm në kulturën tonë, por edhe në atë të popujve të tjerë të Ballkanit. E kemi fjalën këtu jo vetëm për xhubletën karakteristike — atë përfaqësuese të rrallë të kulturave të lashta mesdhetare (kreto-mikenase) në variantet e saj ballkanike (si ai që paraqet statueta e gjetur në Kličevac, Jugosllavi) ku krahas fundit në formë këmbane shihet edhe brezi me tufa e përparja e vogël me thekë, por edhe për një varg elementesh të tjera të lidhura ngushtësisht me traditën ilire e iliro-trake.

Të tilla janë fustani a fustanella e burrave; kofsharët e kalcet, ata gypa të ngushtë shajaku që mbronin këmbët nga nyjet e deri lart në rrëzë të kofshëve; linja ose këmisha e gjatë e tipit «dalmatica»; disa lloje xhokash me ose pa mëngë; kapuçi i gjatë prej shajaku; shallet e gjera dhe tallaganet e ndryshme të tipit të «hlamidës» e të «lacernës» antike; mbulesat e mëdha të kokës të lëshuara lirshëm prapa (si ato të Fushë-Krujës, Myzeqesë e Dumresë etj.); kësulatat në formë pothuaj gjysmësferë, brezat e gjerë me zbukurime metalike dhe brezat «me rrema»; opingat e thjeshta prej lëkure të tipit të opingës ilire të gjetur në Dürnberg (Austri), veshja e grave me dy futa etj.

4. Monumentet e kohës së vjetër (shek. III p.e.r.) tregojnë se në Iliri, sidomos në bregdetin perëndimor të saj, ishin futur në përdorim edhe elemente që bënin pjesë në veshjen klasike greko-romake, shumë herë të kombinuara me pjesë të veshjes autoktone, por me kohë disa prej tyre dolën nga përdorimi dhe të tjera u asimiluan dhe u integruan dhe në veshjet popullore.

Për ne paraqet interes më të madh ana tjetër e këtij procesi, që ka të bëjë me ndikimin ilir tek romakët: si u manifestua ky ndikim, në ç'kohë e në ç'rrethana u ndie më fort ai. Mund të përmenden këtu elemente veshjeje të ilirëve, që hynë në përdorim në shtresa të ndryshme të shoqërisë romake, për të cilat burimet janë fare të qarta. Një nga ato është «*dalmatica*» ajo veshje tipike jo vetëm për fisin e dalmatëve — si e tregon vetë emri i saj — por edhe për fise të tjera ilire, si tregojnë monumentet. Dihet se dalmatika ishte një lloj linje a këmishë, e gjatë deri në gju, me shtat të drejtë e mëngë të gjata. Në shekujt e parë të erës sonë, dalmatika u përhap gjerësisht në Romë, si në njerëzit e thjeshtë, ashtu edhe në shtresat më të larta të aristokracisë së kohës, sigurisht me ndryshime të mëdha mi-

dis tyre, si në cilësinë e pëlhurës së përdorur, ashtu edhe në zbukurimet me qenarë (clavi) të purpurt ose jo etj.

Një tjetër element i veshjes ilire që depërtoi në kulturën romake ishte fustani (a fustanella). Atë e përdornin legjionarët romakë, me sa duket si një ndikim që hyri nëpërmjet kalorësve ilirë që bënin pjesë në kohortat romake.

Romakët njihnin dhe preferonin edhe të tjera pjesë të veshjeve të ilirëve, si ishin kapuçat e gjatë të liburnëve dhe të ardianëve, të cilët përmenden nga autorët romakë të cilësuar pikërisht si të tillë (cuculli liburnici, cuculli bardaici), shallet apo strukat, e ndryshme të kapura përpara me fibula (ato «*saga fibulatoria*» që përmenden në dokumente) dhe, me sa duket, — edhe një lloj tallaganesh të gjera, të leshta e me thekë («*lacerna*») për prodhimin e të cilave (si thonë burimet) ishin të përmendura disa zona të Ilirisë, si: Dalmacia, Istria etj.

Ky ndikim nuk ishte një fenomen i veçantë për kohën. Dihet se në shekujt e parë të erës sonë po gjenin qarkullim të gjerë në Romë veshje të ndryshme të popujve të ashtuquajtur barbarë, si «*braccae-t*» (brekeshat) dhe kapuçat e galëve, elemente nga veshja e fiseve të vjetera gjermanike etj. Bile mendohet se edhe «*hlamida*» apo «*sagum-i*» ka qenë një veshje e maqedonëve të vjetër, që pati hyrë gjerësisht në veshjet greko-romake.

5. Kultura bizantine e orientale ka ushtruar për një kohë një veprim deri-diku nivelues në veshjen e popujve të Ballkanit, kryesisht në shtresat e larta të shoqërisë së kohës, tek e cila rrezatimet e modës së Bizantit arrinin më lehtë. Këtë e tregojnë portretet e ktitorëve kudo nëpër Ballkan, veshjet e princave e të parisë feudale etj. Me kohë, disa rrezatime të zbehura të luksit të rënduar të këtyre veshjeve, mundën të depërtojnë edhe në kostumet popullore, si p.sh. parapëlqimi i theksuar i disa ngjyrave të konsakruara dikur vetëm për shtresat e larta të shoqërisë (si ishin: e kuqja, manushaqja dhe e gjelbra), dëshira për të imituar zbukurimet e rënduara me ar, mëndafsh e gurë të çmuar, zgjatja e mëngëve, me lapa të mëdha që shtriheshin përtej dorës ose të varurit e mëngëve dekorative prapa në shpinë etj.

6. Populli ynë nuk e ka përshkruar rrugën e historisë së tij kulturore në izolim e i panjohur nga të tjerët, por përkundrazi ka pasur lidhje të shumëllojshme kulturore. Këtu pikësynimi im nuk ishte të trajtoja

ndikimet e huaja në veshjet tona popullore, të cilat pa dyshim nuk kanë munguar, por desha të shtroj pyetjen e anasjelltë: a ka gjurmë të veshjeve shqiptare në popujt e tjerë. Përgjigjja është pohuese. Elemente të kostumeve popullore shqiptare, në periudha të caktuara, lidhur me ngjarjet e mëdha historike, kanë arritur të marrin një qarkullim ballkanik e madje të bëhen të njohura në pjesën më të madhe të kontinentit. Disa prej tyre i kam ndjekur e dokumentuar me kujdes, sidomos për shek. XVI, në vepra shkrihtarësh të dëgjuar, në tablo e gravura të kohës etj. Është e njohur tashmë që, në vepra të ndryshme të letërsisë franceze, angleze etj. përmenden elemente veshjeje ose aksesore të saj, të cilësuar shprehimisht si shqiptarë. Me sa duket, në ata shekuj. këto pjesë veshjeje gëzonin popullaritet të gjerë. Kështu, krahas ndonjë elementi, përdorimi i të cilit vjen që nga koha antike, si është p.sh. këmisha e gjatë në formën e dalmatikës, të cilën e mbanin ushtarët spanjollë e italianë nën armaturën e tyre në shekujt XV-XVI (shih «Grand Larouse Encyclopedique», vol. 3 zëri «Dalmatique»), mund të përmendim «kapelën e lartë shqiptare», që zë në gojë shkriktari i dëgjuar frëng i shekullit XVI F. Rabelais, e që në fjalorë të specialitetit thirret thjesht «albanois» (shih M. Leloir, *Dictionnaire du costume*, Paris 1964), apo atë «tallaganen e madhe të modës shqiptare» dhe xhamadanin me «mëngë të varura simbas modës shqiptare» të përmendura nga dramaturgu anglez i shekullit XVI E. Spenser etj. Kjo ngjiste në një kohë kur brenda në Shqipëri kulturës popullore po i zihej fryma, për shkak se një kulturë e huaj, kultura e agresorit osman, e kishte plakosur me tërë peshën e një perandorie në shpërthim.

Një fenomen i ngjashëm është vërejtur edhe në periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878). Veshjet shqiptare të kësaj kohe, sidomos ato të luftëtarëve, janë paraqitur gjerësisht dhe me vërtetësi, në shumë gravura të kohës, sidomos ato të zonave ku luftohej dhe kjo pat shërbyer shumë për t'i bërë ato të njohura nëpër Evropë.

7. Një çështje tjetër me interes është kjo: si e përballoi kultura jonë popullore agresionin kulturor islam, që i rëndoi mbi supë për pesë shekuj?

Dihet se veshje të ndryshme të modës së Stambollit si dollomatë, anteritë e gjata, dimitë, jelekët e shkurtë, binishët e kush-tueshëm, vërshuan sidomos në shekujt XVII

e XVIII, së pari në shtresat e aristokracisë së kohës (e myslimanizuar ose jo) në të gjitha vendet ballkanike të pushtuara, por në shtresat e gjera të popullsisë ky depërtim nuk qe as i lehtë e as i shpejtë. Në këtë proces të ndërlikuar bie në sy se, shumë veshje popullore me origjinë të lashtë, i përshkuan ato rrethana të vështira dhe mundën të arrijnë deri në kohën tonë. Kjo ngjau herë nga një farë rrudhjeje e strehimi të përkohshëm në zonat e mbyllura malore e herë thjesht nga varfëria, e cila sillte si pasojë imediate rikthimin në prodhimet e ekonomisë shtëpiake për veshjet tradicionale, por herë të tjera kjo mbrojtje e traditave, u bë me një kundërvënie të hapët e të ndërgjegjshme. Kështu që nga fundi i shek. XVIII, por sidomos gjatë shek. XIX, krahas rritjes së ndërgjegjes kombëtare, ndihet një frenim i përhapjes së ndikimit turk në shtresa të caktuara shoqërore, frenim i cili forcohet më shumë në periudhat e intensifikimit të lëvizjes kombëtare. Vijnë kështu situata kur heqja dorë nga ndikimet orientale në veshje, duke rivlerësuar kostumet popullore vendase, merr një theks të qartë politik dhe kjo i detyrohet pa dyshim edhe punës së madhe të Rilindasve për të ruajtur pastërtinë e gjuhës e të kulturës kombëtare. Jehona e kësaj qëndrese ka lënë gjurmët e veta në epikën popullore dhe sidomos në atë fond të gjerë veshjesh tradicionale, që mundi të sfidojë kundërshtimet e pengesat e të arrijë i gjallë deri tek ne.

Në situata analoge, me të njëjtën vendosmëri e ndjenjë të ligjshme krenarie, janë përpjekur ta ruajnë thesarin e tyre kulturor në fushën e veshjeve edhe shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi e të Serbisë edhe në ditët tona.

8. Duke parashtruar në këtë vepër, faqe nga historia shumëshekullore e veshjeve tradicionale, disa nga të cilat lidhen me kulturat më të lashta që kanë lulëzuar në Ballkan, jam përpjekur të provoj, në mënyrë sa më të dokumentuar, se veshjet popullore shqiptare ruajnë një varg tiparësh origjinale, të trashëguara përgjithësisht nga një nën-shtresë e vjetër ilire ose të fituara gjatë mesjetës, që u jep vlerat e një treguesi etnik dhe si i tillë bëhet një ndër faktorët që i dallojnë veshjet shqiptarë nga ato të popujve të tjerë. Por sidoqoftë nuk mund të mos përfillet fakti se ato paraqesin edhe tipare të përbashkëta me veshjet e popujve të tjerë, tipare këto që i integrojnë në një kontekst më të gjerë ballkanik.

Summary

Clothing, as one of the fundamental material conditions of human life, along with housing and feeding, is one of the major achievements of human society. Its earliest traces go as far back as to the Paleolithic period. Clothing emerged as an essential demand to protect the body from exposure to inclemency of the weather, and in the course of development over thousands of years it assumed many other functions, among which the social and aesthetic one which gave birth to a rich variety of forms, decorations and ways of dressing, and reflect changes due to age, sex, class and different social strata, ethnic groups, etc. The transformations it has undergone reflect, among other things, the level of the technical and technological development of society and the aesthetic requirements of different social groups at given historical epochs.

From every point of view, dressing remains one of the most powerful manifestations of popular culture, and, for this reason, its study contributes to illuminating aspects of interest for the history of different peoples.

The folk costume reflects, first of all, a given social environment under which it emerged and was used as a culture of the broad working masses. We can understand this more fully, if we bear in mind what Lenin said, that a people's culture is made up of two cultures, distinguishing folk culture from the culture of the ruling classes. From the aesthetic point of view, due to slow evolution, clothing preserves a series of ancient features, especially in the forms of tailoring and traditional decorations. However, this does not mean that folk costumes have not developed and been enriched from one epoch to the other; indeed, either due to their internal development or contacts with and borrowings from other cultures, they evolved considerably.

As with every people, with us, too, clothing evolved from one epoch to the other in conformity with the concrete historical, economic, and social conditions under which our people lived and worked. Because of this clothes are a concrete and very rich source which helps us reconstruct aspects of the way of life of the broad working masses in different periods. From the material used for this purpose, we can form a concrete idea of what the broad masses produced within their domestic economy, what were their work tools, what were the materials they bought on the market, etc. By the way they cut and decorated their clothes we understand how our people developed their taste for the beautiful,

which were their most favourite ornaments and colours, etc. The great variety of regional variants enables us not only to judge the creative abilities of the rural masses, but also to see to what extent regional characteristics were limited, whereas the existence of common types for extensive zones reveals their affinity in this field on a regional and national scale. Clothing has likewise clearly reflected class distinctions, the differentiation among various social strata, differences due to the function, religion, etc., which are evidence of a society consisting of different social classes and strata and, of relations of dependence and domination between classes.

Hence, the different data on clothing, the material utilized, the work techniques, work tools and implements, etc., very frequently back up and supplement the written sources which do not always reflect the material living conditions of the broad masses of the people to the proper extent. Thus, the history of folk costumes should be looked at as a material reality without which the tableau of the mode of living would be incomplete, lacking that element which clothing gives to the history of the social and cultural development of a country.

Another reason why we study and evaluate folk costumes is *their aesthetic value*. With their rich variety of forms, bright colours and rich decorative motifs, with their many regional characteristics in the combining of different elements, and generally, with their many-sided artistic values, folk costumes testify to the developed aesthetic tastes, to a rich spiritual life of the broad rural masses.

Dollamë cohe ngjyrë kafe disi të kuqërremtë që e përdorte dora e tretë e popullsisë, së cilës, deri më 1912, nuk i lejohej të vishte as dollamë jeshile as dollamë gjake.

Dollomá-ja

Veshje e sipërme grash a burrash, e modës orientale, krejt e hapur përpara, e gjatë deri

në pulpë të këmbëve, me mëngë të gjata; bëhej zakonisht prej cohe ose kadifeje dhe zbukurohej me qëndisje me ar ose me gajtan mëndafshi.

Dolloman-i

Një lloj mbështjellëseje me pala që bëhej zakonisht prej basmeje të kuqe (për nuse) e zbukurohej me dy shirita së gjeri; vihej në pjesën e prapme të trupit, nga beli e poshtë (Tunjë, Sulovë).

Done-t

Brekë të gjata pëlhure.

Dorake-kja

Pjesa e poshtme e mëngës së një fanelle, zakonisht e zbukuruar me qëndisma.

Dredhca-t

Rripa lëkure të dredhur, me të cilët bëheshin vangjet e opingave.

Drillë-a

Një lloj pëlhure e pambuktë disi e plotë dhe e fortë, zakonisht me vija ngjyrash të errëta, që përdorej për veshje të ndryshme (fustane të gjata grash, mintane etj), në shtresat e mesme e të varfra.

Dullak-u

Shih **duvak**.

Dumane

Shih: tumane, çitjane.

Duvak-u

Pëlhurë e qepur në formë kapuçi të gjatë, zakonisht e kuqe, e zbukuruar me lloj-lloj xhinglash, që i hidhej në kokë vajzës ditën që bëhej nuse; dullak.

Dylben-i

Lloj pëlhure e hollë me të cilën bëhej një shami koke, e bardhë, në formë trekëndëshi, që thirrej gjithashtu dylben ose dylbenkë.

Dyshe-ja

Shami e madhe katrore që gratë e venë në kokë duke e palosur më dysh si trekëndësh (Dumre).

Dysheme-ja

Mbulesë e madhe koke për gra; bëhej me dy fletë pëlhure shtëpiake, zbukuruar me vija e motive me ngjyra. Ishte në formë katërkëndëshi kënddrejtë, kapej në kokë e varej prapa në shpinë; e mbanin gratë myslimane në Myzeqenë e Lushnjës e të Fierit; në Mallakastër ishte pak më e vogël.

Dyshëll-a

Shtojcë në formë trekëndëshi, që i vihet këmbës nën sjetull. (Moravë e Epërme, Kosovë).

Dhipllar-i

Pjesë e sipërme e veshjes së gruas të Dropullit; një lloj xhoke e lehtë e bërë më pëlhurë liri të punuar me katër lisa; vishej përmbi këmbës nën gratë.

Enteri-ja

Xhamadan burrash, prej cohe, anteri.

Enteri Gjakove

Anteri, xhamadan burrash, i punuar në Gjakovë, me një stof ose cohë ngjyrë uthulle e qëndisur me gajtan mëndafshi; këto anteri të Gjakovës kërkoheshin e parapëlqeheshin në një pjesë të madhe të Shqipërisë Veriore (deri më 1912).

Ergjënde-t

Stoli, stringla.

Fallsë-a

Përparje e leshtë, ngjyrë kafe, me vija të bardha e të zeza, më e madhe se «skuta» (40 x 40 cm) (Çermetikë fals-i (Neshtë, Çermetikë).

Fanellë-a

Veshje e brendshme, me ose pa mëngë, e gjatë deri nën bel; deri në vitet '30 fshatarët i përgatitnin fanellat me një pëlhurë disi të rrallë avlemendi, thjesht të leshta për dimër, melesh e pambuk për verë; më vonë filluan t'i thurrit me shtiza si trikot.

Faqell-i

Shih **faqol**.

Faqol-i

Napë, mbulesë koke për gra, prej pëlhure të bardhë të fabrikuar; faqell.

Faqore-ja

Mbështjellësja e leshtë e zezë e vajzave të Zadrimes; quhej edhe «mbështjellak».

Farsulatë-a

Shami e madhe, që vihet në kokë e lëshohet lirshëm prapa (Kavajë, Durrës) (sipas Kristoforidhit).

Ferexhe-ja

Rrobe e zezë e ndikimit oriental, të cilën gratë myslimane e hidhnin në kokë, kur dilnin nga shtëpia në rrugë, duke mbuluar fytyrën dhe trupin.

Ferexhe-ja

Gunë leshi me kapuç, dhe me mëngë të shkurtra (Novosej, Kukës).

Fermele-ja

1. Një lloj xhybeje a manteli prej cohe, e modës orientale, e qëndisur me fije ari, argjendi ose me gajtan mëndafshi, që mbanin gratë në disa zona të Shqipërisë së Jugut.

2. Mantel cohe në veshjen e gruas së Lunxhërisë e të Pogonit deri në fillim të shek. XX.

Fermen-i

Një lloj jeleku prej cohe a kadifeje, për burra.

Fes-i

Shih: feste.

Feste-tja

Mbulesë koke për burra e bërë përgjithësisht prej cohe të kuqe, me një tufë mëndafshi blu ose të zezë. Feste grebeneçe, feste që bliheshin në Grebenë. Feste tonuze, feste që silleshin nga Tunizi.

Fistan-i

Veshje burrash, fustanellë; në këtë formë fjala ndeshet më fort në veri, në mbledhjet folklorike të fillimit të shekullit tonë.

Fistan krac

Këmishë prej kambriku të fabrikuar, që vishet me kanac; pjesë e kostumit të gruas myslimane në disa fshatra të rrethit të Pukës, p.sh., në Qerret.

Floke-kja

Veshje e sipërme dimri, pa mëngë; bëhej prej shajaku të zi me thekë përbrenda; shtati i drejtë me kinda verëf anëve; zbukurohej me gajtan të kuq; vishej vetëm me kohë të ftohtë, përmbi cibunin; është mbajtur deri rreth vitit 1900 (Opar, Korçë).

Flokatë-a

1. Veshje e sipërme burrash, në formë palltoje; bëhej prej pëlhure të bardhë, të trashë leshi me thekë të gjatë përbrenda; e ngushtë deri në bel dhe e derdhur nga mesi në gjunjët me kinda verëf; me lapa të gjera tek supet në vend të mëngëve. Vishej përmbi kostumin me fustanellë dhe doli nga përdorimi së bashku me të, në fillim të shekullit XX. Veshje e të gjitha shtresave shoqërore, pleq e të rinj, në gjithë Toskërinë.

2. Veshje analoge për gra, që mbahej vetëm në ditët e kremte, jo në veshjen e përditshme për punë (Kurvelesh, Vlorë).

3. Shark i bardhë, pa mëngë për gra. (Rrëza e Gjirokastrës).

Flokore-ja

Një lloj gune apo sharku, prej leshi, e bardhë, me thekë jashtë, e dërstilur; pa mëngë dhe me kauk (kapuç) për kokën në raste reshjesh (Polis i madh, Librazhd).

Florinjhtë e ballit

Zbukurim koke për nuset e reja i përbërë nga një ose disa monedha ari (Opar, Korçë).

Florinjhtë e gushës

Varg me monedha ari, që varnin në qafë nuset e gratë e reja (Korçë).

Follë-a

Tokëza a sumbulla metalike që viheshin si zbukurime në gjoks e në bel, si për gra dhe për burra, për të plotësuar kostumin festiv; tokë, zavë.

Follandinë-a

Stof leshi i dendur, tek arbëreshët e Frasnitës (Itali) (sipas E. Giordano); fillandinë.

Foqe-ja

Shokë brezi, brez i leshtë (Tërmjan, Gjakovë).

Fund e polkë

Veshje gruaje prej stofi të importuar, e përbërë prej dy pjesësh: fundi i gjerë me pala të vogla rreth e qark belit dhe polka në formën e një bluze të ngushtë, me mëngë të gjata. Në fillim të shekullit XX kjo ishte veshje martesë e festash të ndryshme familjare në shumë zona të Shqipërisë së Jugut.

Fustan mollokof

Fustan grash prej stofi a mëndafshi (gurazeje) të fabrikuar, me trup të drejtë e të ngushtë, me mëngë të ngushta tek kyçi i dorës e shumë të gjera tek supi; i gjatë gjer në fund të këmbëve; ka qenë në modë deri në fillim të shekullit tonë.

Fustan-i

Fustanellë, fustane, veshje burrash;

Fustanebardhë

Burrë i veshur me fustanellë të bardhë, me veshje festive (sipas Th. Mitkos, 1878).

Fustanellë-a

Veshje burrash prej pëlhure të bardhë, në formën e një fundi të gjerë, e të gjatë nga beli tek gjunjët, e përbërë prej shumë kindash që mbliidhen tek beli me rrudha të dendura; mbahej në gjithë Shqipërinë, nga Veriu në Jug dhe nga Perëndimi në Lindje deri thellë në Kosovë (afër Novipazarit); në disa zona ishte veshje e përgjithshme dhe e përditshme, në të tjera veshje festive e rasteve të mëdha ose veshje e shtresave të larta. Doli nga përdorimi në vitet mbas Shpalljes së Pavarësisë (1912).

Fustanehollë

Burra të veshur me fustanella të holla, pra me kostum ceremonial, me veshjen më të mirë.

Fustan-i

Fund i gjerë, këmishë për gra që bëhet prej kambriku të fabrikuar, për kostumin e martesës që nga çlirimi e këtej, (Bërzeshtë, Librazhd; Shpat, Elbasan, Çudhin, Krujë etj.).

Fustanegjërë

Fustanellë e gjerë, «tumba-tumba», me shumë kinda, «me dizet fletë» (Specia, Reinhold 1855), që vishej vetëm në raste festash të mëdha ose për dhëndëri; veshje e burrave të shtresave të pasura.

Fustane hajduçe

Fustanellë e shkurtër mbi gjunjë dhe e zezë, që e përdornin zakonisht komitët, «hajdutët» apo kaçakët, luftëtarë që ndiqeshin nga pushtuesit dhe prandaj mbanin fustanella të errëta që të mos diktoheshin lehtë gjatë lëvizjeve të tyre natën.

Fustane mbi gju

Fustanella e shkurtër, shenjë e trimave kapadainj, në shekullin XIX.

Fustanlli ose fistanli

Ai që mban kostumin me fustanellë, shqiptari.

Fustanth-i

Fustanellë, (në formë zvogëluese) (Laj fustanthin e tim zot / erdhi mbrëmë e iku sot — Mitko 1878).

Fustanzi

Burrë i veshur me fustanellë të zezë, pra kaçak, komit, kapedan, luftëtar. Fustanella të zeza mbanin shumë herë edhe karvanxhinjtë.

Fustë-a

Fustane, fustanellë tek arbëreshët e Specias në Greqi, (Reinhold, 1855).

Futan-i

Njeri i varfër e i pafat; njeri që vë futën (shaminë e zezë) në kokë, fatzi.

Futë-a

1. Përparje prej plaçke të importuar e njëjtë me atë të dollomasë, në veshjen e grave myslimane, deri në fillim të shekullit tonë (Konispol, Markat, Shalës, Vërvë, Dishat, Njanjar etj. rr. Sarandë).
2. Përparje prej stofi ose mëndafshi të importuar e zbukuruar përfundi me një ose dy rripa kadifeje të zezë; pjesë e veshjes së gravë ortodokse të Oparit (Korçë);
3. Dy copa pëlhure të leshtë vegle në formë katërkëndëshi kënddrejtë, e zbukuruar pak përfundi që vireshin përbmi këmishën e gjatë, njëra përpara dhe tjetra prapa, në veshjen e vjetër të grave në Malësinë e Vlçrës;
4. Përparje e leshtë zbukuruar përfundi, përçorej përpara bofçave (Kërçisht, Dibër).
5. Përparje e pambuktë (Dars dhe Gurrë, Mat).
6. Copë pëlhure e pambuktë me vija të kuqe e të verdha, me përmasa 50 x 45 cm, që vihej prapa; (e përparmja thirrej «bohçe») (Trebisht Dibër).
7. Përparje prej stofi të importuar në veshjen e grave të Mallakastrës («futë berberi»).
8. Përparje e madhe prej leshi e punuar me avlemend me dy lisa, zbukuruar me motive të thjeshta në pjesën e poshtme e me xhufka përfundi; përdorej para hyrjes së çitjaneve në Kurvelesh. Një futë, më e vogël e më e thjeshtë, vihej edhe prapa.

Futë-a

Shami koke grash, zakonisht e zezë, vihej në kokë si shenjë zije, sidomos në Mirditë e në Kosovë.

Futëmbrapës-i

Futë e vogël që vihej prapa.

Futëparës-i

Përparje

Futgunj-i

Fund i zi zhguni, pjesë e veshjes së plakave tek Kelmendasit e Sremit (sipas Windisch 1782).

Futurak-u

Përparje e vogël leshi që mbajnë gratë e Dukagjinit. (Gollak, Kosovë).

Gajtan-i

Shirit ose gjalmë i përdredhur, prej mëndafshi, leshi a pambuku, që u vihet veshjeve e rrobave për t'i qepur e për stoli ose për të mos u dalë thekët: fill i trashë e i përdredhur prej ari, argjendi ose mëndafshi me të cilin qëndiseshin a stoliseshin veshjet kombëtare.

Gajtan i Shkodrës

Gajtan mëndafshi, përgjithësisht i zi, por edhe me ngjyra të tjera, i punuar drejt e me cilësi të lartë; gjatë shekullit XIX, Shkodra ishte bërë e dëgjuar për gajtanët e sumbullat e veshura me gajtan, të cilat tregtoheshin në shumë vise të Ballkanit; në këngët popullore ka hyrë edhe si shprehje krahasimi (vetullën si gajtan i Shkodrës).

gandel-i

Papuçe e qëndisur me tel.

Garagiv

(Tirq garagiv) me shumë gajtan anëve. (Gjilan, Kosovë).

Gargi-të

Tirq me gajtanë tërthorë (Ferizaj, Kosovë).

Gazhup-i

Kapuç, gunë me gazhup (Bërzeshtë, Librazhd).

Gravlizë-a

Pëlhurë leshi bardhë-e-zi, me të cilën bëheshin veshjet e burrave tek arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano).

Grimbë-a

Një lloj manteli i kuq, tek arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano);

Grykë-a

1. Mbulesë e vogël pëlhure për gjoksin (Malësi e Madhe, Shkodër).
2. Mbulesë e vogël për gjoksin, pothuaj katrorë së bashku me një qafore; prej pëlhure të pambuktë, zbukuruar me qëndisje të imëta me kryq, plotësonte linjën e gjatë të grave të Fushë-Krujës.
3. Qafë çorapi (Junik, Kosovë)

Grykës-i

Jelek për burra, prej cohe të kuqe, me gajtan të zi anëve. (Polis i madh, Librazhd).

Grykole-lja

Copë pëlhure që vihej përpara për të mbuluar gjoksin; shumë herë bëhej e zezë dhe zbukurohej me tegela të bardhë ose me «serm». (Tamarë, Shkodër).

Grykse-sja

1. Këmishë burri e shkurtër, prej pëlhure të bardhë (Bërzeshtë, Sopot, Pishkash dhe Çermenikë, rrethi i Librazhdit).
2. gjoks këmishë (Zadrimë).

Guarnacë-a

Pjesë e veshjes mesjetare për burra; përmendet në një dokument të vitit 1335, si pjesë e veshjes së një marinari në portin e Drinit.

Gubere-ja

Pallto, pjesë e veshjes së ushtarëve turq, krahas shallvareve, e stigmatizuar në shumë vargje të këngëve popullore historike. Në shekullin tonë hyri në përdorim krahas fjalëve **guje** e **xhurdi** në disa zona të Shqipërisë Veriore.

Gubere-ja

Një lloj xhurdie, prej shajaku të zi, pjesë e veshjes së burrave (Postrisë, Shkodër).

Gujë-a

Xhokë shajaku për burra, e drejtë, e gjatë deri nën ije, me mëngë të shkurtra e jakë katrore, që duke u mbërthyer bëhej kapuç; hërkë, gubere. (Rrafshi i Dukagjinit, Kosovë, Nikaj, Tropojë).

Gugë-a

Këmishë foshnjeje; fustan i fëmijëve të vegjël. (I vesh ose i heq gugën fëmijës).

Gunar-i

Ai që pret e qep guna, xhokaxhi.

Gunë-a

1. veshje e sipërme e grave ortodokse; bëhej prej shajaku blu të errët, trupi i drejtë, me kinda verëf (krivakë) anëve; pa mëngë; zburkuar anëve me gajtan të kuq. Vishej përmbi një fustan të gjatë drille a manice. Mabajtur deri në fillim të shek. XX.

2. Një lloj cibuni prej shajaku të bardhë, për gra, në Myzeqenë e Fierit.

3. Një lloj xhoke prej shajaku ose prej lëkure deleje, në arbëreshët e Italisë (sipas E. Gior-dano).

Gunë mëngëgjatë

Khoka e mirë e nusërisë, prej shajaku të bardhë, e gjatë deri mbi gju, me mëngë të atro-fizuara, që varen nga supet si dy rripa të gjatë; pjesë e veshjes së gruas ortodokse të Mokrës; thuhet edhe thjesht «mëngëgjata».

Gunë me rrëke

Një lloj cibuni prej shajaku të bardhë i grave, që bënte pjesë në kostumin e mirë të nusë-risë; rrëke quheshin gajtanët prej leshi ngjyrë tulle që zburkonin kindat anësore të gunës, duke u qepur si vija paralele (Myzeqeja e Fierit).

Gunë me veshëza

Një lloj cibuni prej shajaku të bardhë, i grave ortodokse të Mokrës, që nuk kishte mëngë, por «veshëza» me formë trekëndëshi, tek supet; e mbanin gratë e moshës së mesme (Mokër, Pogradec).

Gunë xhulkë

Xhokë e shkurtër prej shajaku të bardhë, me mëngë të drejta, anëve me gajtan të bardhë; e mbanin gratë plaka në fshatrat ortodokse të Mokrës (Pogradec).

Gunë-a

Veshje e rëndë dimri, prej pëlhure leshi të dërstilur, mjaft e gjerë, me mëngë që nuk vishen, me kapuç, e gjatë deri në gjunjë.

Gunë çile

Gunë e bërë me lesh dhie, çile (Myzeqe).

Gunë e dhirtë

Gunë çile, çile; e mbanin zakonisht barinjtë (Myzeqeja e Beratit, Kurveleshi e Lopësi, Vlorë).

Gunë larë

Gunë e bërë me lesh të butë deleje, përdorej me kostumin festiv, p.sh., për dhëndëri, për të shkuar krushk etj. (Myzeqeja e Fierit).

Gunellë-a

Fustan gruaje pa mëngë, i bërë prej një pëlhure leshi me vija, e punuar në shtëpi; e mbanin gratë ortodokse të Myzeqesë.

Gunëzë-a

1. Xhokë e tñjeshtë, e shkurtër, prej shajaku të kuq, pa mëngë; pjesë e veshjes së përditshme të gruas në dimër (Zadrimë, Lezhë).

2. Cibun, veshje e sipërme shajaku të bardhë me gajtan anëve; pjesë e veshjes për nusëri (Bregu i Bunës, Shkodër).

Gurazë-ja

Pëlhurë e fabrikuar mëndafshi, e dendur, dhe me lulet e veta, domethënë të së njëjtës ngjyrë; përdorej për fustane të gjata dhe përparje grash në kostumin e mirë ose festiv të grave ortodokse të disa zonave, deri në Luftën e Parë Botërore.

Gushore-ja

Stoli me rruaza a me pare, e cila varej në gushë.

Gzof-i

1. Gozhup i gjatë, delesh; veshje e rëndë dimri, sidomos për barinjtë, që bëhej me 6-8 lëkura delesh dhe ishte i gjatë deri në pulpa të këmbëve, (Novosej, Kukës).

2. Veshje dimri për gra e bërë me lëkura berresh (Rugovë, Kosovë).

Gjaheng-u

Xhokë prej shajaku të bardhë, e gjatë deri nën gjunjë dhe me mëngë të gjata. Vishej nën xhup (Mirditë).

Gjalmatore-rja

Opingat që e kanë pjesën e sipërme të thurur bukur me gjalmë.

Gjalmëzëzë-t

Gratë labe, sidomos të veja, të cilat edhe opingat i lidhnin me gjalma të zeza.

Gjehe-hja

Xhokë prej shajaku të bardhë (Mat).

Gjeodon-i

Shih: xhamadan.

Gjerdan-i

Varg paresh, që varet për zburkim në qafë ose në gjoks, vlëra e të cilit varej nga vlëra e pareve. Gjerdan me grosha (Shkodër), gjerdan me rrushpa (Shkodër), gjerdan me gjela (napolona flori) (Shkodër) varg rruazash ose inxhish (perlash).

Gjoksore-ja

1. Pjesë e veshjes së grave që vihet për të mbajtur gjinjtë.

2. Parzmore.

Gjupetë-a

1. Këmishë burri e përgatitur me pëlhurë të leshtë të bardhë (Kukës).

2. Brekë prej pëlhure leshi, për djem (Gollak, Kosovë).

3. Këmishë e gjatë gruaje prej pëlhurë të leshtë jo fort të rrahur, që përdorej në verë, zbukurohej përfundi me rripa e shirita të kuq, të zinj e ngjyrë tulle (Shllak, Temal).

4. Xhubletë (Shala e Bajgorës, Kosovë).

Gjurdi-a

Khurdi, një lloj xhoke e shkurtër e zezë, me mëngë të shkurtra; pjesë e veshjes së burrave «gubere» të Postribës (Shkodër). Quhej edhe

Gjurmashkë-a

Shputa, gjurma çorapësh pa qafa, që vishen në dimër përmbi çorapet, për të mbajtur ngrohtë ose në vend të heqlave.

Gjybe-ja

Në Drenicë (Kosovë) kjo fjalë përdorej për: xhybe.

Gjymlek-u

1. Këmishë burrash, prej pëlhure shtëpiake (në Kosovë) ose prej basmeje.

2. Bluzë grash në kostumin e martesës (Mat).

Gjysllëk-u

Përparje (Moravë e Epërme, Kosovë)

Hare-rja

Pëlhurë e thjeshtë.

Harkate (pëlhurë)

Pëlhurë shtëpiake e punuar me fije mëndafshi e pambuku; në shekullin XIX ishin të dëgjura për cilësinë e lartë të tyre, pëlhurat harkate të Shkodrës.

Haxhe-t

Rripa cohe, penj me ngjyra, gajtan, rruaza e të tjera, që përdoren për të zbukuruar veshjet popullore.

Hase

Pëlhurë hasë, kambrik ose humai, faqell; e bardhë e pambuktë.

Havli-ja

Peshqir i bardhë koke (Fulqet, Mat).

Herkë-a

Guje, xhokë me mëngë të shkurtra e kapuç (Isniq, Kosovë).

Hërkë-a

Një lloj mintani, i bërë prej basmeje, me astar i mbushur me pak pambuk dhe i therur

me tegela; pjesë e veshjes me çitjane. E mbanin gratë myslimane të zonës së Shpiragut (rr. Berat) në vitet 1900-1920. Është mbajtur nga gratë edhe në Kosovë; hirkë.

humai-a

Kambrik, pëlhurë e bardhë pambuku, e fabrikuar. Fustanellat bëheshin përgjithësisht prej humaije.

Ibërshim ose bërshim

Fill mëndafshi i dredhur mirë si kordon, me trashësi të ndryshme, që përdorej në zbukurimin e shumë veshjeve popullore.

Ivë-a

Rrip shajaku; xhubleta bëhej me iva; rrogzinë.

Jakë-a

Kapuç, jaka e gunës.

Jakëz-a

Kapuç që i vihej xhurdisë ose gunës, liabane. «Guna pa jakëz si këmisha pa mëngë» (fjalë e urtë popullore).

Jakuçe-ija

Xhokë e shkurtër shajaku për burra, me mëngë të shkurtra dhe me një jakë të madhe katrore prapa; zbukurohej me tufa e qëndisje të shumta (Tiranë, Krujë, Elbasan) etj. Kapuçi i gunës (Myzeqeja e Fierit).

Jakule-ja

Kapole, kapuçi i gunës (Strugë, Maqedoni)

Jantë-a

Trastë lëkure për të mbajtur bukën (Strugë, Maqedoni).

Janxhik-u

Strajë lëkure e varur krahëqafë, ku bariu mban ushqimin e ditës.

Japanxhe-ja

Pelerinë e shkurtër prej cohe të kuqe, me një jakë të madhe katrore prapa; shumë e zbukuruar me qëndisje interesante, përpara të gjoksi dhe tek jaka; e kanë përdorur, deri në vitet '30 të shekullit tonë, gratë katolike të Shkodrës, kur dilnin nga shtëpia.

Jashmak-u

Perçe me të cilën gratë myslimane mbulonin fytyrën.

Jelek-u

Veshje për pjesën e sipërme të trupit, e hapur përpara e pa mëngë, për gratë mund të jetë edhe fare i shkurtër ose të arrijë deri në bel; për burrat mund të jetë i gjatë edhe deri pak nën bel; bëhej prej basmeje, mëndafshi, stofi, kadifeje etj., dhe kishte gjithmonë astar.

Zbukurohej me ngjyra të ndryshme: jelek me sërma, domethënë i qëndisur me fije argjendi; jelek me shirita, pra i zbukuruar me shirita të verdhë (ari) etj. Shpesh jeleku bëhej komplet me mitanin ose xhamadanin, prej të njëjtit stof e me zbukurime analoge, si psh., në kostumin me fustanellë, të burrave.

Jeleku i Halilit

Në epikën legjendare «jeleku i Halilit», të cilin e vesh Imeri i ri kur shkon të lirojë Mujin e Halilin, që krajl i ka zënë rob, është si një mjet njohës që ai e përdor për t'u dhënë shenjë të burgosurve se ka ardhur për ta. Imeri zberthen katër pulla të setrës që t'i duket mirë «jeleku i Halilit» dhe Muja e vë re menjëherë, ndërsa Halili prej zemërimit as ia shtie sytë.

Jemenije-t

Një lloj këpucësh ose opingash prej lëkure të kuqe, që mbanin dikur gratë e Zadrimes (Shkodër), sipas modës së Jemenit.

Jepinxhe-ja

Gunë e madhe në formë gjysmërrethi, prej shajaku të bardhë me gajtan të zi; e pajisur me kapuç; veshje dimri (Rugovë, Kosovë); pele-rinë (fig. 70).

Kablushë-a

Flokë të prera shkurt mbi ballë, balluke, (për gratë) (Rugovë, Kosovë).

Kacole-ja

Kapuçi i xhurdisë (Bare, Shala e Bajgorës, Kosovë).

Kaculitë-a

1. Mbulesë koke prej leshi dhie, për t'u mbrojtur nga shiu (Saxhak, Mat).

2. Kapuç i shkurtër leshi që e mbanin dikur vajzat (Mirditë) në vend të shamisë; kaçulitë.

Kacurretë-a

1. Jaka e madhe e xhurdisë, që kthehet në kapuç në raste reshjesh (Kosovë).

2. Gunë e shkurtër për fëmijë (Tërpezë, Drenicë, Kosovë).

Kaçule-ja

Jaka e gunës, që ka formën e një kapuçi të shkurtër.

Kadife-ja

Pjesë e veshjes ceremoniale të grave të Lunxhërisë, në formën e një manteli a të një cibuni prej kadifeje të zezë ose blu shumë të errët, e zbukuruar me gajtan ari dhe mëndafshi të gjelbër; zëvendësoi «cohën».

Kadife Berati

Kadifeja që tregtohej në Berat njihej edhe në rrethe të tjera të vendit për cilësinë e saj të mirë; me të përgatiteshin të famshmet «sako Berati» xhaketa grash prej kadifeje të qëndisur me ar, sipas stilit të Beratit.

Kaftan-i

Rrobe e gjatë e modës orientale, prej mëndafshi të rëndë dhe shumë të stolisur, që mbanin burrat e shtresave të pasura qytetare.

Kaftan-i

Shami e mëndafsh të e zezë, e fabrikuar; formë katrore zbukuruar me trëndafilë anëve. Gratë i shtonin anëve oja me penj mëndafshi, të punuara me gjelpërë ose me sovajkë; është mbajtur nga gratë ortodokse të Oparit, në fillim të shekullit XX (Lavdar, Opar).

Kaftë-tja

Pëlhurë e hollë me të cilën mbulohej fytyra.

Kajuke-ja

1. Veshje e sipërme burrash, që bëhej prej zhguni, me mëngë të shkurtra, e hapur përpara, pa kopsa dhe me jakë të hedhur në shpinë, jakuce;

2. kapuç.

Kalce-t

Kofsharë, dy gypa të ngushtë shajaku që i mbathnin burrat përmbi brekët e gjata e nën fustanellë, për të mbrojtur këmbët nga të ftohtit; fillonin nga nyjet poshtë e arrinin deri në rrëzë të kofshëve; kapeshin me iliqe tek të mbathurat, që të qëndronin më mirë; lidheshin me dizga të kuqe ose të zeza nën gju, që të mos vareshin poshtë.

Kolce-t

Qafa çorapësh, të punuara me fije leshi ngjyrash të ndryshme, i përdornin gratë e Mursisë deri rreth vitit 1910, pastaj i zëvendësuan me çorape të bardha.

Kalemqare-ja

Shami koke e mëndafsh të, e zezë me lule në të katër qoshet; kishte formë katrore dhe palosej diagonalisht më dysh për t'u lidhur në kokë. Pati hyrë në përdorim në Shqipërinë e Jugut (për gratë ortodokse) në çerekun e fundit të shekullit XIX.

Kaliqe-t

Nallane

Kallca-t

Qafa çorapësh prej leshi me shumë zbukurime pjesë e veshjes së grave të Zadrimes; kanë dalë nga përdorimi mbas Luftës së Parë Botërore.

Kallcinjel-i

Të mbathura, tek arbëreshët e Frasnites, Italia Jugore (sipas E. Giordano).

Kalleje-t

Çorape, tek arbëreshët e Italisë (Frasnitë) (sipas E. Giordano).

Kallçi-njt

1. Copa shajaku ose cohe, që mbulonin këmbët nga nyja deri në gju dhe mbërtheshin së gjati me kapsa teli; mund të zbukuroheshin me gajtan mëndafshi ose ari; ishin pjesë e kostumit me fustanellë. (për burra).

2. Mbulesa shajaku për kërcinjte e këmbëve; viheshin përmbi tirqit, në dimër: kalqi të zi (Prizren); kallçin t'zi (Suharekë); kallçin (Gjakovë).

Kallçina-t

Shih «tirq» (Dumre).

Kallma-t

Qafa çorapësh shumë të zbukuruara me spik të zi, kadife e rruaza (Malësi e Madhe).

Kallpak-u

Kësulë e lartë burrash, e bërë me lëkurë qengji.

Kamillaf-i

Kapele e lartë, e zezë, në formë cilindri, që mbanin priftërinjtë ortodoksë.

Kamizollë-a

Pjesë e veshjes së grave arbëreshe të Italisë, xhamadan i shkurtër mëndafshi.

Kanac-i

1. Pshtjellak, futë, pjesë e leshtë e veshjes që femrat fshatare mbajnë nën mes, para ose prapa (Kosovë).

2. Futë e thjeshtë që vihet përpara ose mbrapa. (Junik, Kosovë).

Kanac-i

Mbështjellëse me pala, prej pëlhere të leshtë e kuqe, e gjelbër ose ngjyrë tulle; pjesë e kostumit të gruas myslimane në rrethin e Pukës; ngjyrë vjollce mbahej edhe në Malësinë e Gjakovës, ku thirrej «pshtjellak i gjanë».

Kanac i bardhë

Përparje leshi për vajzat (Zym, dhe Prekorupë, Kosovë).

Kanac i dytë

Pshtjellak, futë e vogël, që vihej prapa (Has, Kukës).

Kanac i hollë

Përparje nusesh të reja, që vihej përmbi dimitë (Rahovec, Kosovë).

Kanac i parë

Futë prej pëlhere leshi punuar në avlemend, me dy fletë të vendosura horizontalisht; zbukuruar në pjesën e poshtme me qëndisje dhe anëve me një dantelë të zezë leshi punuar me grep; vihet përpara (përm. 82x56 cm) Zaprega (Has, Kukës).

Kanave-i

Mbulesë koke për gra prej pëlhere shtëpiake liri ose kërpi e përdorur tek Vasojeviqët e Ljeva Rekës në Mal të Zi, deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX; rubë.

Kandush-i

Fund i gjatë, me pala të dendura që mbanin vajzat e rritura arbëreshe, i zbukuruar me shirita (sipas E. Giordano).

Kapë-a

Kësulë, kapelë, mbulesë koke për burra.

Kapë-a

Një lloj xhoke e zezë, prej shajaku, me mëngë të shkurtra deri në bërryl (Pogon).

Kapicë-a

Zbukurim koke për nuse; kësulë e vogël, e cekët e mbështjellë me cohë të zezë ose kadife, mbi të cilën qepeshin për bukuri, pafta filigrane argjendi. (Malësi e Madhe, Shkodër): kapole (Rugovë, Kosovë).

Kapicë-a

Qeleshe e rrafshët (Mirditë).

Kapjel-i

Kësulë burrash (arbëreshët e Italisë, Plataci) (shih E. Giordano).

Kapole-lja

1. Kapuç i gjatë me vija ngjyrash të ndryshme që e mbanin dikur vajzat (Iballë, Pukë).

2. kapuç i tallaganit (Mërtur, Tropojë).

3. Kësulë e cekët, shumë e zbukuruar për nuse. (Rugovë, Kosovë).

Kapolliq-i

Një lloj kësule burrash tek arbëreshët e Italisë (Frasnitë) (shih E. Giordano).

Kaporan-i

Xhokë shajaku; me shtat të drejtë; mëngë të shkurtra e jakë katrore; pa zbukurime; koparan, kopran, guje etj (Dibër e Lumë).

Kapuç-i

Mbulesë koke e bardhë për burra. prej plisi; thirrej kështu në Shqipërinë Verilindore dhe në Kosovë; plis, qeleshe, kësulë. Kapuç Deve, domethënë i blerë në Devë.

Kapulaçë-a

Kapuçi i jepinxhes së burrave (Rugovë, Kosovë).

Kapuç-i

Feste prej cohe, e zbukuruar me rruaza vizllore; zbukurim koke i nuseve të reja ditën e dasmës, mbi të cilën vihej «mafesi rastakli» i zbukuruar gjithashtu me rruaza. (Suharekë, Kosovë).

Karamanto-ja

Veshje e sipërme e thjeshtë, manto prej cohe të zezë, që mbanin gratë e Lunxhërisë mbi moshën 45-50 vjeç, në vend të kavadhut të preshtë, që mbanin gratë e reja. E mbanin edhe gratë e Pogonit.

Kat tesha

Palë tesha të plota; nusja pruni pes kat tesha (Drenicë, Kosovë).

Katramëz-a

Tokëz metali për të mbërthyer një crip mes, a rripin e këpucëve.

Katullaq-i

Një rreth i bërë me penj leshi, me lecka përbrenda që vihet në kokë për të mbajtur tesha. (Istog, Kosovë); kurorëz (Myzeqe).

Kauk-u

Kapuç i flokores a i gunës (Polis i madh, Librazhd).

Kavadhe-ja

Pjesë e veshjes së grave të Pogonit, një lloj cibuni prej cohe të zezë, i stolisur pasurisht me gajtan mëndafshi.

Kavadh-i ose kavadh i preshtë

Një lloj cibuni a manteli, prej cohe të zezë ose blu të errët, i zbukuruar me gajtan mëndafshi të gjelbër; pjesë e veshjes së grave të Lunxhërisë të moshës 30-45 vjeç.

Kezë-a

Kësulë e vogël që vendosej në pjesën e prapme të kokës për të futur flokët e mbledhura «koçan» (top). Bëhej përgjithësisht prej kadi-feje ose mëndafshi të kuq në Kalabri, e të gjelbër në Siqeli dhe qëndisej me fije ari. Keza ishte simbol i gruas së martuar, tek arbëreshët e Italisë.

Këmishë-a

Veshje burrash dhe grash, përgjithësisht prej pëlhere të pambuktë, me shtat të drejtë e kinda anash dhe me mëngë të gjata; linjë. Këmishë me skepa ose me oja; këmishë me harxhe (me qëndisje); këmishë me qenarë; këmishë me vija, këmishë breshimit (mëndafshi); këmishë e trashë; këmishë e hollë; këmishë e gjërë.

Këmishë e gjatë

1. Veshje burrash për punë, prej pëlhere të trashë gjineshtre ose pambuku, e gjatë deri mbi gju, që mbahej në Kurveleshin e Sipërm e në Lopës, e shoqëruar me tirq kofsharë;
2. Veshje e përditshme prej pëlhere të trashë liri ose gjineshtre, por edhe prej lesi, që vishnin gratë deri në fillim të shekullit XX në Bregdetin e Poshtëm.

Këmishë-a

Fund i gjerë si fustanellë, që bëhej prej kambriku, pjesë e kostumit të nusërisë; shoqërohej me «mangore», që ishte një këmishë e shkurtër (Pishkash, Librazhd).

Këmisha e Arnaut Osmanit

Një lloj pengu i besës, që nusja i jep Arnaut Osmanit ditën e martesës, duke i thënë që t'ia verë veshin mirë, «sa t'rrin djalë ty këmisha pa t'u nxi/ die, kunora ty nuk t'u ka prishë». tek kënga: (Grueja e Arnaut Osmanit liron agët e Jutbinës).

Këmisha e beqarisë

Këmishë e thjeshtë, që djali i ri e mbante deri në ditën që do të martohej, e hiqte për të veshur «këmishën e dhëndërisë», të qapur e të stolisur me shumë kujdes nga vetë nusja.

Këmishë nate

Linjë e gjatë prej pëlhere të pambuktë; arinte deri në pulpë të këmbëve dhe përdorej vetëm për të fjetur (Gramsh).

Këmishë rendje

Këmishë gruaje prej pëlhere të thjeshtë, këmishë e përditshme, e radhës (Prrenjës, Librazhd).

Këmishë breshinit

Këmishë prej pëlhere të mëndafshhtë.

Këpuçë frënge

Këpuçë me taka.

Këpuçë me proka

Këpuçë të zeza, të forta, mjaft të mbyllura, me majën disi përpjetë dhe gjithë pjesa e poshtme e mbushur me proka a thumba; këpuçë barinjsh (Lopës e Kurvelesh i Sipërm).

Këputë-a

Shputa a gjurma e çorapeve të leshta; gjurmashkë.

Kërdhokël-la

Lloj brezi i gjerë, zakonisht prej shajaku, që qarkonte krejt belin (si në Malësinë e Madhe) ose mbulonte vetëm pjesën prapa dhe ijët (si në Shllak, Berishë, Mërtur).

Kërkdenë-a

Futa që vihej prapa, në veshjen e grave kelmendase të Sremit (sipas Windisch, 1782).

Kësulë-a

1. Përgjithësisht çdo lloj mbulese koke pa strehë, për burra.
2. Mbulesë koke për nusët e gratë e reja në Opar, e zbukuruar me pare, tufëza etj., e mbajtur deri nga fundi i shek. XIX, para se të përhapeshin shamitë e zeza (Lavdar, Korçë).

Klina-t

Shih: tina.

Kllapodan-i

Fije ari që përdorej për zbukurimin e veshjeve popullore.

Kllashë-shja

Gunë e dhirtë, me jakë të madhe që kthehej lehtë në kapuç për kokën (Dumre, rr. Elbasan).

Kmishë qenari

Këmishë prej pëlhere të trashë pambuku.

Kmishë me harçe

Këmishë e zbukuruar me shumë mënyra, duke përdorur penj me ngjyra për qëndisje të ndryshme, shirita, oja, temina, rruaza etj.

Kmishë me oja

Këmishë e zbukuruar me oja tek qafa e tek mëngët.

Kmish me skepa

Këmishë me oja tek mëngët, këmishë e dhëndërisë për burra.

Kocak-u

Flokë të vënë shtesë për të zgjatur gërshetat; gërsheta të rremë që i vinin gratë por jo vajzat. (Strugë, Maqedoni).

Koce-ja

Gërshet flokësh, kocol.

Koçan-i

Mënyra e të mbledhurit të flokëve të gjatë prapa kokës për t'i futur në «kezë», tek arbëreshët e Italisë (Frasnitë) (sipas E. Giordano).

Kofsharë-t

Tirq pa shtrat, prej shajaku të bardhë: kalce, gypa shajaku të hollë, të prerë verëf që mbulonin këmbët nga nyjat deri në rrëzë të kofshëve; visheshin përmbi të mbathurat e gjata, pjesë e kostumit me fustanellë, për burra.

Kokorroj

Bëj dantella ose rrexa

Kokorreth

Mënyrë e të lidhurit të shamisë rreth kokës.

Kollçak-u

Pjesë e qëndisur me gajtan që i vihej anteriorë së burrave e të grave, prej bërrylit deri në fundin e mëngës, për ta forcuar.

Kollçekë-t

Qafa çorapësh, prej zhguni (Mat).

Kondo-ja

Këmishë burri prej pëlature të fabrikuar, me mëngë të gjëra e të gjata deri në llërë; pjesë e veshjes së burrave në kostumin me poture, në fshatrat e rrethit të Sarandës.

Kondosh-i

Veshje e sipërme cohe e ndikimit oriental.

Kondoxhup-i

Manto grash prej stofi të importuar, zbukuruar tek qafa me gëzof (Gjirokastër).

Kondure-t

Këpucë.

Kopran-i

Shih: kaporan; veshje bariu, xhurdi, lurkë (Opojë, Kosovë).

Koret-i

Pjesë e veshjes më të mirë të grave në Zadrinë, përgatitej për nusëri e vishej vetëm në festa të rëndësishme; një lloj xhoke prej shajaku të zi, me rrudha të beli dhe me një bordurë të gjerë prej shajaku të kuq përfundi edhe pjesa nga beli e lart bëhej prej shajaku të kuq; dikur thirrej edhe «xhokë».

Korop-i

Futë e zezë grash, përdorej në rrethet e Strugës.

Koshula

Këmishë burri prej pëlature të pambuktë shtëpiake (Liqenas, Korçë).

Kotëll-a

Këmishë gruaje prej puplini, me rripa në supet (Seman, Fier).

Kotroman-i

Kapuç, qeleshe e lartë (Gjakovë, Kosovë).

Kotull-lla

Mbështjellëse e gjerë me pala të dendura e bërë prej një pëlature leshi të rrallë, krejt e zezë, pjesë e veshjes së mirë të grave në Zadrinë. Quhej edhe «pshtjellak» ose «pshtjellë».

Krahca-t ose kraca-t

Shih: krahoc-i.

Krahë-t

Këmishë burri prej pëlature shtëpiake, pa jakë, me mëngë të gjëra e të gjata deri në llërë (Shupal, Malësi e Tiranës).

Krahës-i

1. Këmishë e shkurtër gruaje prej pëlature liri a pambuku; zbukuruar me qëndisje të mëngët e të jaka. Vishej me një fund të thjeshtë pëlature që quhej «linjë me kinda». Është përhapur mbas 1912-ës. (Shpat, Elbasan).

2. Këmishë burri prej pëlature (Mokra e poshtme, Pogradec).

Krahëz-it

Këmishë burri, shih: «mëngëz» (Shpat, Elbasan; Shëngjergj e Shupal. Tiranë, Cudhin, Krujë etj.)

Krahnoç-i

Torbë, në të cilën barinjte mbanin ushqimin e ditës, kur shkonin me bagëti. (Curraj i epër, Shkodër).

Krahnore-ja

Gjoks këmishe (Prell, Mat).

Krahoc-i

Një zbukurim në veshjen e grave të reja të Rugovës; përbëhet nga dy rrathë të mëdhenj gajtanësh, me gjerësi 3-4 cm, të cilët qepen njëri me tjetrin vetëm 7-8 cm; kjo pjesë e qepur qëndron në mes të shpinës e në të dy rrathët futen krahët e gruas. (fig. 85), quhet edhe: kraca-t (krahca).

Krahol-i

1. Xhokë e shkurtër për gra prej shajaku të zi, me pala të dendura prapa; zbukurohej me thekë të gjatë tek supet (Malësi e Madhe, Shkodër);

2. Jelek i shkurtër shajaku të zi, zbukuruar me thekë të gjatë tek supet (Shllak, Temal, Shkodër).

Kryeshtruet

Pa kësulë, pa kapuç;

Kryq-ja

Shami koke në formë katrore (90x100 cm), prej pëlature shtëpiake, që e lidhnin gratë në kokë të palosur diagonalisht. (Shqipëria e Mesme).

Ksulë-a

Mbulesë koke për burra, qeleshe e ulët (Mat).

Kule-t

Të mbathura grash, prej pëlature të hollë e të rrallë leshi të bardhë, që përfundojnë me «këmbëza» pëlaturë leshi të dekoruar me vija e motive të ndryshme; pjesë e veshjes së grave të Hasit (Zym, Kosovë).

Kukultë (i)

Prej mëndafshi të cilësisë së dytë ose të tretë (tek arbëreshët e Frasnitës, Itali) (sipas F. Giordano).

Kulirë-a

Jaka e madhe e xhulinit, e cila mund të kthehet lehtë në kapuç, për të mbrojtur kokën në raste reshjesh (Dars, Mat).

Kullan ergjani

Brez argjendi, stoli për gratë e reja. (Kamenicë, Kosovë).

Kullore-ja

Kapuç (Pandelejmon, Sarandë).

Kundra

Këpucë, kundra të zeza. (Drenicë, Kosovë).

Kurorë-a

Rreth i gjerë, i veshur me penj leshi zakonisht me ngjyra të çelëta për gratë e reja, që përdorej si mbështetëse e enëve që vihen mbi kokë për t'u bartur; kokorreth, kurorëz (Myzeqe).

Kutni-a

1. Një lloj pëlhere ngjyrë të verdhë, me të cilën bëheshin anëritë dikur.

2. Këmishë e shkurtër pëlhere të hollë (Vuçitern, Kosovë).

Kyçet e brezit

Dy-tre zinxhirë argjendi të varur te brezi në anën e djathtë, tek skaji i të cilëve mbareshin kyçet e arkës, ndonjë thikë e vogël etj., këta zinxhirë tek brezi i kishin gratë por jo vajzat, deri në fillim të shekullit tonë, pothuaj kudo në Shqipëri.

Lahorë-ja

Brez, shokë e kuqe ose me lara; shami brezi. (Gollak, Kosovë).

Lahur-i ose lahuri-a

Shami koke e madhe, për gra e vajza e pambuktë por shumë e hollë (e tejdukshme), me lule në qoshet, importohet nga Stambolli (shek. XIX).

Lale-t

Lara; çorape me lale, domethënë të shkruara me lule ngjyrash të ndryshme.

Lamë-ja

Pëlhurë e fabrikuar; endej me fije ari ose argjendi që i jepnin reflekse të ndryshme sipas dritës dhe një fëshfëritje karakteristike. Përdorej për veshje luksi për gra; në disa shtresa qytetare janë mbajtur dimite laméje.

Laricë-a

Lloj pëlhere e fabrikuar, mëndafshi ose pambuku, me ngjyra të larme.

Larinë

Me lara; «bofçe larinë» (Opojë, Kosovë).

Laroshe-ja ose larë-a

Gunë larë, e bërë me lesh të butë deleje. (Myzeqeja e Beratit).

Lavare-ja

Varg me zbukurime të ndryshme që e varin në qafë a në trup vajzat ose nusët; lavare rruezash.

Lavareë-a

Harqe të vegjël të formuar nga ajo dredhçë lëkure që përshkohet buzëve të opingës, për të formuar brimat, nëpër të cilat do të kalojnë gjalmat apo tojet e opingës; (Curraj i epër); vang.

Lavesh-i

Pjesët e skajshme të tirqve poshtë (Gollak, Kosovë).

Lavosh-i

Njeri i veshur me rrobe të vjetra, të grisura, të mbajtura keq.

Lepitkë-a

Gjysma këpucësh, kanë vetëm pjesën e përparme, kurse prapa janë krejt të çelura; heqël, sheshje etj.

Leshkerrë-a

Leshprerë, gruaja që i priste flokët në shenjë zije të thellë pas vdekjes së burrit, në qoftë se vendoste të mos martohej më.

Leshnik-u

Veshje popullore burrash e punuar me lesh deleje ose dhie, me mëngë të rreme, që mbahej si pallto në dimër, tallagan. «Hëngre fikun vish leshnikun».

Lesh therre

Tufëza të vogla leshi të mbetura nëpër ferra e kaçube; në një baladë popullore (Vëllavrasja, Gollak, Kosovë) thuhet se një grua e ve me dy jetimë ishte aq e varfër sa «me lesh therrash» i kishte rritë e burrnue djemtë e saj.

Lëkurçe-ja

Veshje e sipërme e bërë me lëkurë deleje të paqethur, që arrin deri në mes, gozhup i shkurtër. (Dukagjin, Shkodër).

Lëkurçe-ja

Jelek i gjatë pa mëngë, i bërë me lëkurë delej, që vishej me leshin nga brënda. Nga fundi i shekullit XIX bëhej prej pëlhere të lehtë avlemendi me flokë ose thekë përbrënda, përgjithësisht e bardhë deri në Luftën e Parë Botërore, pastaj edhe e zezë dhe me thekët jashtë. Ka dalë nga përdorimi në vitet '60. Veshje e përditshme për punë në Kurvelesh (Vlorë).

Lëverë-

Këmishë, ndërresë.

Lëverë-ja

1. Shami e bardhë pëlhere të hollë shtëpiake, anëve me penj të lëshuar; në të katër qoshet nga një lule; e mbanin nusët e reja; lidhej në kokë duke kryqëzuar lart dy çipat e anëve dhe ngrihej sa të dukeshin dy-tre gisht flokët (Opar, Korçë).

2. Napë e bardhë që përdorej si mbulesë koke për gratë (Dumre, Elbasan).

Libade-ja

Veshje grash e ndikimit oriental, një vaj xhakete e bërë me dy faqe pëlhere ose hasme e mbushur përbrënda me pak pambuk dhe e

përshkuar me tegela (Kurvelesh, Vlorë dhe Rrëza e Gjirokastrës).

Libaden-i

Shih: libade.

Lic-i

Lidhëse e ngushtë 2-3 cm, që ngjishej përmbi brezin e zakonshëm të grave, për ta fiksuar më mirë; shenjë e grave të martuara, vajzat nuk mbanin lic (zona e Kallmetit, Lezhë).

Lidhëcë balli

Rrip pëlhere shtëpiake (12x130 cm), prej mëndafshi ose prej pambuku, me zbulurime tek krejt, që përdorej nga gratë e Hasit e të Rrafshit të Dukagjinit (Kosovë) për të fiksuar mahramën në kokë.

Lidhje-a

Gjerdan rruazash në formë diademe, që e vënë në kokë, përmbi lëveren e gjatë e të bardhë, gratë e reja në Malësinë e Tiranës (Mner, Tiranë).

Lila-t

Stoli të ndryshme nusesh, stringa, (shqiptarët e Greqisë, sipas Reinholdit, 1855).

Ling-u

Krahol, pjesë e veshjes së grave tek Kelmendasi e Sremit (sipas Windisch, 1782).

Linjë-a

1. Këmishë e gjatë për vajza ose gra; bëhej prej pëlhere leshi, liri a gjineshtre, në shekullin tonë edhe prej pëlhere pambuku (Kurvelesh, Vlorë).

2. Këmishë e gjatë gruaje prej pëlhere të pambuktë shtëpiake (Myzeqeja e Fierit);

3. Këmishë gruaje prej pëlhere të pambuktë, e gjatë gjer mbi gju, me mëngë të gjata, qepur e stolisur nga gratë fshatare; për nusëri bëhej me pëlhurë të mëndafshtë dhe quhej «linjë e ngrirë» (Skrapar);

4. Këmishë e gjatë e gruas ortodokse, prej pëlhere liri ose kërpi, më vonë edhe pambuku (Mokër, Pogradec);

5. Këmishë e gjatë gruaje tek arbëreshët e Italisë (sipas Dorëshkrimit të Kieutit, 1737).

Linjë e gjatë

1. Këmishë e gjatë gruaje prej pëlhere (Malësi e Madhe).

2. Këmishë gruaje prej pëlhere liri ose pambuku, e gjatë deri në pulpat e këmbëve, e zbuluar me qëndisje ose përfundi (Shpat, Elbasan).

Linjë-a

1. Fund i gjerë prej pëlhere të pambuktë shtëpiake që vishej me «mëngët» (Myzeqe e Fierit dhe e Lushnjës; Dumre, Elbasan; Kutalli, Berat).

Linjë e ngrirë

Linjë prej pëlhere të mëndafshtë shtëpiake (Skrapar); linjë byzinxhyke, lijë e hollë.

Lira në fyt

Varg me lira, monedha ari, që varnin në qafë nusët e reja (Drenicë, Kosovë).

Livere-ja ose lëvere-ja

Mbulesë koke për gra, në formë katërkëndëshi kënddrejtë, më i gjatë se i gjerë, e bërë me dy fletë pëlhere të pambuktë të bardhë, zbuluar me vija anëve e me motive të thjeshta në gjithë sipërfaqen, të cilat ndryshonin sipas moshës (Fushat Bregdetare).

Loshnik-u

Pjesë veshjeje, e leshtë (Progonat, Labëri); loznik.

Loznik-u

Një lloj gune a tallaganeje e leshtë, që hidhej supeve në dimër (arbëreshët e Italisë).

Lula majë kreje

Në lule mali e vendosur në flokët, zbuluar koke për vajzat e reja në stinën e pranverës (Drenicë, Kosovë).

Lurk-u

Veshje e pjesës së sipërme të trupit, e shoqëruar me tirq. Përmendet në vargjet e një balade të mbledhur në fshatin Karaçevë e Epërme, Kamenicë, (Kosovë); me sa duket ka të bëjë me veshjen mesjetare «lorica».

Llabane-ia

Kapuç i gjatë i punuar me lesh dhie, i gjatë deri te beli ose deri tek gjunjët, pra mbulonte jo vetëm kokën për tërë shpinën; e mbanin barinjët në kohë reshjesh (Livadhja, Sarandë).

Llaçkë-a

Mënyrë e të mbledhurit të flokëve të grave prapa kokës, në Myzeqe.

Llambadhori-i

Pëlhurë e shndritshme e endur me fije mëndafshi e fije ari ose argjendi, një lloj lamëje; tek arbëreshët e Frasnitës (Itali) përdorej për të bërë «xhypunin» apo jelekun e grave (sipas E. Giordano).

Llapunër-a

Opinga të vjetëruara, që përdoren vetëm për të qarkulluar nëpër oborrin e shtëpisë (Shala e Bajgorës, Kosovë).

Mafes-i

Shami koke prej pëlhere të pambuktë a prej mëndafshi. «Mafes rastakli» = shami e zbuluar me rruaza; hidhej përmbi kapuçin prej cohe, që vinte nusja në kokë ditën e dasmës (Kosovë).

Mafër-fra

Shami koke për gra, zakonisht e zezë.

Magore-ja

1. Këmishë burrash prej pëlhere të punuar në Prezë; prej liri (për pleqtë) ose prej pambuku (për të rinjtë) (Fusha e Krujës).

2. Këmishë burri prej pëlhurë shtëpiake ose prej kambriku, e gjatë deri në gju, me mëngë të drejta (Perlat, Lufaj etj., Mirditë).

Mahramë-a

Mbulesë koke për gra të martuara; një fletë pëlhure shtëpiake e pambuktë ose e mëndafshhtë me krerë të stolisur, që mbulonte kokën duke kaluar edhe nën mjekër; fiksohej me lidhçën. (Has dhe Rrafsh i Dukagjinit etj).

Makë-t

Këmishë e shkurtër gruaje, me mëngë të gjata; bëhej prej kambriku; pjesë e veshjes me xhubletë të grave malësore në Bregun e Matës.

Mallotë-a

1. Një lloj gune prej leshi të zi, e gjatë deri në gju, e pajisur me kapuç (Shqipëria Veriore) (sipas Nopcsës).

2. Një lloj gune tek arbëreshët e Italisë; mandjel (sipas E. Giordano).

Mandile-ja

Shami koke e hollë, zbukuruar me thekë të holla anëve; e përdornin gratë në Shqipërinë e Jugut, që në mesin e shekullit XIX (sipas Hahn-it, 1854).

Mandjel-i

Fjalë e arbëreshëve të Italisë për: mantel, mallotë.

Mangë-t

1. Këmishë e shkurtër burrash, prej pëlhure të pambuktë avlemëndi, me shtat të drejtë e mëngë të gjera me dorëza të qëndisura (Dumre);

2. Këmishë grash prej pëlhure të pambuktë shtëpiake, «linjë» (Sulovë).

Mangore-ja

1. Këmishë e shkurtër burrash, me mëngë të gjata (Dumre);

2. Këmishë gruaje (Pishkash, Librazhd).

Mungore me gufa

Këmishë burri prej pëlhure shtëpiake (Guri i Zi, Elbasan).

Manore-ja

Xhokë shajaku me mëngë (Guri i bardhë, Mat).

Manore-ja

Këmishë me mëngë të gjera (Saxhak, Mat).

Manicë

Pëlhurë e pambuktë e fabrikuar që importohet deri në vitet '30, për të bërë pjesë të ndryshme veshjeje për shtresat e ulëta shoqërore e sidomos për fshatarësinë.

Mashali-a

Lloj pushke më e moçme se martina (Gollak, Kosovë).

Mathcë-a

Gjalm leshi, që shërben për të lidhur opinë, por jo çorapet (Drenicë, Kosovë).

Mbështjellak-u

Faqore, mbështjellëse prej pëlhure leshi të zezë e të rrallë, me pak rrudha në ijët, që mbanin vajzat në Zadrimë.

Mbështjellëse-ja

Veshje gruaje, në formën e një fundi të hapur, të gjerë, mbledhur me rrudha ose pala tek beli, ose mbledhur me rrudha vetëm tek ijët.

Mbrapanicë-a

Futë e vogël, që vihej prapa, përmbi mbështjellësen, në veshjen e nusërisë (Has).

Mbrapanik-u

Pshjtjellak, futa e vogël që vihej prapa në veshjen e gruas me xhubletë (Shllak, Temal).

Mbrostëllë-a

Përparje kadifeje e zbukuruar me qëndisje; pjesë e veshjes së grave të Lunxhërisë dhe të Pogonit deri në Luftën e Parë Botërore.

Mend-i

Një xhokë tradicionale tek arbëreshët e Piana degli Albanesi (sipas E. Giordano)

Meste-ja

Çorap i shkurtër për burra, shputë, gjur maskë, zakonisht shumë e stolisur tek qafa e shkurtër. Mestet janë dhurata më e zakonshme që nuset e reja sjellin për meshkujt e shtëpisë

Mëngë-t

1. Këmishë e shkurtër prej pëlhure, me mëngë të gjata, shoqërohej me një fund këmishe, që thirrej linjë. (Myzeqeja e Fierit dhe e Lushnjës Dumre dhe Rroshnik (Berat), Shpat (Elbasan) Bërsnik (Vërçë).

2. Këmishë e shkurtër prej pëlhure pambuku, e gjatë deri nën brez, me mëngë të gjata të mbledhura me dorëza. Qëndisej tek gryka me penj e rruaza. (Kërpitë, Tomoricë).

Mëngëz-t

Këmishë burri prej pëlhure tjerri (liri), thjeshtë e pa zbuqurime (Karavasta dhe Seman Myzeqe).

Mëngore-ja

1. Këmishë e shkurtër gruaje deri nën bel, që shoqërohej me një fund këmishe të veçantë i cili thirrej «këmishë» Pishkash (Librazhd) dhe Radokal (Mokër).

Mëngore-rja

Xhamadan prej shajaku ose prej cohe, i stolisur me gajtanë e me fije ari, me mëngë të gjata, të hapura, që nuk visheshin por vareshin prapa kraheve për bukuri.

Mëngë me llapa ose sqepa përtej dorës

Mëngë të modës bizantine ose postbizantine të ruajtura në disa veshje popullore p.sh., mëngët e «cohës» apo të «kavadhit» të grave të Lunxhërisë e të Pogonit, mëngët e hapura të shumë mëngoreve prej cohe të qëndisura me ar, mëngët e xhokës tek kostumi i gruas së Malësisë së madhe etj.

Mërtheckë-a

Sumbull (Belsh, Dumre).

Mësallë-a

1. Përparje e leshtë ose e pambuktë, pjesë e veshjes së grave me dimite e dolloma (Vërzhezë, Skrapar).

2. Përparje pëlhere të leshtë me përmasa 70 x 50 cm; pjesë e veshjes së grave myslimane të Oparit (Korçë).

3. Përparje me të njëjtin stof si fustani pjesë e veshjes së grave ortodokse të Devollit (Korçë).

Mësallëzë-a

Përparje e vogël e mëndafshhtë në veshjen e grave arbëreshe të Italisë (sipas Dorëshkrimit të Kieutit, 1737).

Mitan-i

Një lloj xhamadani me mëngë të gjata, i bërë prej basmeje ose allaxhe, me astar që vishet nën jelek, si nga burrat dhe nga gratë; mintan.

Mintan Gjakove

Mintan i një cilësie të lartë, i punuar në Gjakovë ose sipas modeleve të Gjakovës. Dikur mintanët e qepur nga terzinjtë e Gjakovës gëzonin një famë të merituar në gjithë Shqipërinë e Veriut.

Mjetë-a

Leshi, pambuku a liri i shkurtër që mbetet pasi zgjedhim pjesën e mirë dhe që përdoret në endje si fill për së gjëri; me mjetë leshi bëhen bërrucat.

Mongë-t

Këmishë burri prej pëlhurë të fabrikuar, me mëngë të gjata deri tek llërët e shumë të gjera (Sulova e Sipërme, Gramsh).

Morosë-a

Xhurdi, xhokë e shkurtër shajaku të zi, me mëngë të shkurtra e jakë të madhe katrore grapa (Malësitë e Elbasanit).

Mshstellë e bardhë

Mbështjellëse leshi krejt e bardhë, me rru-dha tek beli, pjesë e veshjes së grave të Lumës (Kukës).

Mungore burrash

Këmishë e gjatë burri prej pëlhere liri ose pambuku, e gjerë me katër shpat; mëngët të gjata (Budëll, Tiranë).

Nafë-ja

Rrip gëzofi të mirë që i vihet xhybes, qyrkut etj., tek jaka dhe anëve përpara.

Napëzë-a

Mbulesë koke për gra, tek arbëreshët e Italisë; shih: napë.

Napë-a

Mbulesë koke për gratë, e bërë prej pëlhere të hollë pambuku, që mund të zbukurohet edhe

me fije ari (arbëreshët e Italisë) (Shih edhe E. Giordano, R. Parisi etj).

Neçë-ja

Përparje leshi në veshjen dimërore të grave myzeqare (Seman, Fier).

Neçë-a

1. Përparje leshi me vija ngjyrash të ndryshme; pjesë e veshjes së grave ortodokse të Mokrës (Pogradec);

2. Përparje e leshtë me vija punuar në avlemend; pjesë e veshjes dimërore të grave të Myzeqesë (Rreth-Greth, Durrës) dhe Karavasta, Lushnjë).

Nemte-tja

Xhokë shajaku të bardhë për gra, pa mëngë (Mirditë e Lurë).

Nërfyca-t

Tre rrjeshta rruazash që varen në qafë për stoli. (Shala e Bajgorës, Kosovë).

Nërskamcë-a

Lëkurë që qepet poshtë çorapeve për t'i forcuar (Drenicë, Kosovë).

Ndortë-a

Shih: nortë.

Nipte

Një lloj xhoke e bardhë për gra, disi e atrofizuar dhe e reduktuar gati në tre rripa. (Gur i Bardhë, Mat).

Nortë-a

Gjalm leshi i gjatë që përshkohet nëpër vangjet e opingës, tërhiqet sa duhet për ta puthitur mirë opingën pas këmbës e pastaj lidhet te nyjat e këmbës; ndortë;

Oborbat e jopangës

Dredhcat prej lëkure të opingës (Krujë).

Oleve-t

Dollakë

Olltak-u

Pjesa e poshtme e mëngës së qëndisur të xhamadani (Strugë).

Opangë-a

Shih: opingë.

Opingë-a

Një lloj këpucësh prej lëkure; më të thjeshtat bëheshin me një copë lëkurë në formë katërkëndëshi kënddrejtë, të qepur pak tek maja e të mbledhur rreth e rrotull me dredhca lëkure e gjalma leshi, që të puthitej mirë pas këmbës. Kishte edhe shumë lloje të tjera opingash më të bukura e më të forta.

Opinga me përkyca

Opinga të zbukuruara sipër me një rrjetë spage dhe penjesh me ngjyra. (Mitrovicë, Kosovë).

Opinga me rrjetë

Opinga të zbukuruar sipër me dredhca lëkure (Mitrovicë, Kosovë).

Opinga lope me retra

Opinga të thjeshta të punuara në shtëpi (Kurvelesh i Sipërm e Lopës, Vlorë) (Leshicë, etj).

Opinga qoseleje të verdha

Opinga të punuara me kujdes e shumë të zbukuruar, që i mbanin gratë e reja në Opar (Korçë), deri në fillim të shekullit tonë.

Opinga me shollë e me xhufka

Opinga të forta për burra, të blera në treg (Kurvelesh, Vlorë).

Opinga telatine të kuqe

Opinga të mira për dhëndurë, me xhufkë të zezë në majë (Myzeqe e Fierit).

Oputë-a

Lidhcë lëkure, me të cilën qepet opinga.

Paftë brezi

Stoli metalike në forma të ndryshme që vihen përpara te brezi, për zbukurim.

paft-i

Pëlhurë e bardhë pambuku që përdoret edhe për pjesë veshjeje.

Palapetë-a

Kind i ngushtë i një veshjeje të sipërme, që varet mbi gjunjë, një copë rrobe sa për të mbuluar trupin.

Pan-i

Shall i leshtë për gra, që mbulon kokën edhe shpatullat (arbëreshët e Italisë Fresnitë) (shih E. Giordano).

Pandofka-t

Papuçe leshi (Seman, Fier).

Panëz-nza

Shall i vogël i leshtë me të cilin u mbështejllin kokën fëmijëve (arbëreshët e Italisë) (shih E. Giordano).

Pandofël-a

Heqëla prej lëkure, prej stofi a prej plisi, pa lidhëse dhe të hapura prapa, që mbahen nëpër shtëpi.

Papuçe-ja

Pandofla të lehta e të sheshta si gjurmashka, zakonisht prej cope të leshtë a prej stofi për sipër, që mbahen nëpër shtëpi.

Paragatë-a

Një lloj opingash a sheshlash tek arbëreshët e Italisë (Frasnitë) (sipas E. Giordano).

Paranik-u

1. në veshjen e vjetër të grave myslimane të Iballës (Pukë) ai ishte një përparje e bërë me

dy fletë pëlhure të leshtë ngjyrë tulle e zbukuruar me vija e gërshanëza të bardha, anëve me spik të zi (Perm. 35 x 50 cm).

2. Në veshjen e grave katolike të Bregut të Drinit (Pukë) ishte një përparje leshi me truall të zi, anëve me gajtan e përfundi me thekë;

3. përparje e veshjes me xhubletë, zbukuruar me thekë të gjatë ngjyrë vjollcë përfundi (Shllak, Temal).

Parenica-t

Monedha që viheshin për zbukurim në kësulën e grave. (Rugovë, Kosovë).

Pastamall-i

1. Përparje e madhe, e pambuktë me dy fletë; pjesë e kostumit festiv të grave të reja (Dragostunjë dhe Zdranjsh, Librazhd);

2. Përparje prej pëlhure të pambuktë shtëpiake e kuqe me vija të bardha, për veshjen e mirë të grave myslimane (Bërzeshtë, Librazhd).

Pastemall-i

Përparje e pambuktë (arbëreshët e Italisë) (sipas E. Giordano).

Pasten-i

Një lloj struke që hidhej në kokë për t'u mbrojtur nga shiu.

Pashmangë-t

Pandofle të tipit oriental krejt të sheshta e shumë të cekëta, me majë të ngritur përpjetë, prej lëkure të kuqe e të qëndisur me ar, që mbanin gratë katolike të Shkodrës me kostumin me brandavekë të zinj.

pashnik-u

Mbulesë koke për gra e bërë me një fletë të vetme pëlhure të pambuktë të bardhë, të punuar me avlemend, me gjerësi 35-40 cm dhe gjatësi 110-140 cm dhe e zbukuruar tek krerët (Rranxat e Lezhës).

Pashtamall-i

1. Përparje e madhe e bërë me dy fletë pëlhure të pambuktë me vija, punuar në avlemend; vihej përmbi dimitet (Kurdari, Mat). Pashtamalle (Dars, Mat)

2. Përparje e madhe pambuku, pjesë e kostumit festiv (Pishkash, Librazhd).

Patisk-u

Kambrik ose humai, me të cilën bëheshin pjesët më të dukshme të këmishëve të burrave (jaka, mëngët), ndërsa pjesa tjetër bëhej prej pëlhure avlëmend (Kosovë).

Pec-i

Xhup, xhokë prej shajaku të bardhë, pa mëngë, e gjatë deri në gju; pjesë e veshjes së grave të Prellit (Mat).

Pelicun-i

Veshje barinjsh e bërë me dy-tri lëkura berri (arbëreshët e Italisë).

Pelerinë-a

Petk në formë gjysmërrethi që nuk vishet por hidhet supeve, duke u mbërthyer tek qafa; pa mëngë, me ose pa kapuç; bëhej prej stofi ose mëndafshi, shpesh me astar ngjyrë tjetër nga ajo e sipërmja.

Fellandë-a

Veshje luksi mesjetare, e bërë prej cohe ose mëndafshi, në formën e një manteli dhe e veshur përbrenda me gëzof të kushtueshëm, që formonte edhe jakën.

Perçe-çja

1. Tufë flokësh, që linin dikur burrat në majë të kokës, ndërsa flokët e tjera i qethnin (deri në mesin e shekullit XIX).

2. Pëlhurë e tejdukshme, e zezë, me të cilën gratë myslimane mbulonin fytyrën, para Çlirimit.

Perçedredhun

Me flokët e dredhura të perçes (Kërçovë, Maqedoni).

Perishan-i

Stoli balli, që mbanin nusët e reja (shih Kristoforidhi); perushan.

Peshli-u

1. Xhamadan a mëngore për burra; në Labëri e në Bregdet bëhej prej shajaku të bardhë për myslimanët; po kështu edhe në zonën e Tërpanit e të Plashnikut (rr. Berat) deri në rreth vitit 1912; tek ortodoksët e Lunxhërisë, të Zagorisë e të Dropullit (rr. Gjirokastër) peshliu bëhej prej cohe blu të errët;

2. Një lloj xhamadani për gra që bëhej me stof të importuar; pjesë e veshjes së grave në Bregdetin e Poshtëm (Sarandë) në fillim të shek. XX, në Nahijen e Beratit etj.

Peshqir-i

1. Mbulesë koke për gra, e bërë me një fletë pëlhurë të pambuktë shtëpiake, zbukuruar me vija së gjëri, ngjyrë të verdhë, të kuqe etj., pjesë e veshjes së grave ortodokse në Myzeqe (përmasat 35 x 130 cm);

2. Mbulesë koke për gra, prej pëlhurë të pambuktë të bardhë, zbukuruar me motive të ekzekutuara me një fiçe pambuku më të trashë, në truallin pothuaj të tejdukshëm të pëlhurës (Gurrë, Mat).

3. Peshqiri i kresë, mbulesë koke për gra, që bëhej prej pëlhurë të pambuktë (Llap, Kosovë).

Peshqir-i

1. Përparje prej pëlhurë kërpi, fare e thjeshtë; e përdornin vajzat dhe plakat myslimane të fshatrave të Mokrës (Pogradec);

2. Përparje leshi, pjesë e veshjes së grave myslimane, me përmasa 70 x 100 cm (Pishkash, Berzeshtë, e Përrenjas, (rr. Librazhd) dhe Radokal. (rr. Pogradec).

Peshqiri mbahej i bardhë vetëm për të dalë në ditë festash, në dasma etj., kurse për punë mbahej i zi (Përrenjas).

Peshqira varës

Rripa zbukurimi, prej mëndafshi me ngjyra të ndryshme, që vareshin përçark brezit, në veshjen e grave të Bendës (Malësi e Tiranës);

Peshtemall-i

1. Përparje prej pambuku me vija e pafta me ngjyra të ndryshme, përmasa 150 x 125 cm, pjesë e veshjes së grave myslimane të moshës së re, në Mokër (Pleshisht, Pogradec).

2. Përparje prej pëlhurë të pambuktë blu me vija të kuqe, së gjati pëlhurës; bohçe, përparcë (Cërrec, Dibër).

3. Përparje e madhe prej pëlhurë të pambuktë vegle, e kuqe me vija të holla ngjyrash të ndryshme, e bërë me dy fletë të vendosura horizontalisht; përmasat 82 x 72 cm; pjesë e kostumit festiv të gruas. (Pishkash Librazhd); pashtamall.

4. Përparje pëlhurë të pambuktë blu me vija të verdha, të bardha e të kuqe (rrethet e Strugës)

5. Përparje pëlhurë të pambuktë, e kuqe me vija të verdha dhe me xhufka përfundi, përmasat 50 x 60 cm (Gjergjevicë dhe Bitinckë, Korçë).

Peshirkë-a

Përparëse leshi e zezë, që mbanin gratë e sidomos plakat (rrethet e Strugës, Maqedoni).

Petkat e beqarisë

Rrobet që pati mbajtur djali ose vajza para martesë, të cilat nuk mund t'i vishte më mbas martesë; rrobet e beqarisë, teshat e beqarisë.

Petkat të lulzu

Rrobet e mira; që vishen për të marrë pjesë në dasma e ngjarje të tjera të gëzueshme (sipas baladës «Motra me nandë vllazën» Orosh, Mirditë).

Petkat m'u zezue

Rrobe që vishen për të shkuar në ndonjë vdekje a ngushëllim (sipas baladës «Motra me nandë vllazën» nga Oroshi, Mirditë).

Petkat e nusnisë

Rrobet që veshte nusja e re në shkëmbim të petkave të vajzërisë, ditën që martohej; ato ishin njëkohësisht rrobet më të mira që vishte gjatë gjithë jetës.

Petkat e vajzërisë

shih: teshat e çiknisë

Petkat e verës të Igjidi Brahimit.

Këto petka, që ia ka lënë trashëgim i ati, janë: dollama jeshile dhe e zbukuruar me «nëntë okë serm» dhe shpata sedeflije; ndërsa i ati i kishte mbajtur të panjolllosura. Igjidi Brahimit «ia përgjak» krali (sipas këngës Igjidi Brahimi)

Petkaxhi-u

Krushku që shkonte për të marrë pajën e nusës e për ta sjellë tek shtëpia e dhëndrit (Kosovë).

Petrahil-i

Pjesë e veshjes së priftërinjve ortodoksë. në formën e një shalli të ngushtë, dy anët e të cilit bashkoheshin afër belit dhe vareshin përpara deri nën pulpat; petrailet zbukuroheshin me shirita e qëndisje të kushtueshme.

Pëlhurë tjerri

Pëlhurë liri (Myzeqe e Fierit)

Përkryesë-a

Faqja e sipërme e opingave e thurur me spagë ose me dredhca lëkure (Kosovë).

Përmbropës-i

Mbështjellëse prej pëlhurë të zezë të lehtë, që e mbanin vetëm gratë e moshuara (Zogaj, Dibër).

Përparse-t

Shirita pëlhere të qëndisura, të cilat i vihe-
shin këmishës përpara, tek e çara për kokën
(Mat).

Përparcë-a

Përparje e vogël, prej pëlhere të pambuktë
me vija të bardha e të verdha, e zbukuruar në
pjesën e poshtme të saj; pjesë e veshjes së gruas
në zonën e Kallmetit (Lezhë).

Përparje-a

1. Copë pëlhere e pambuktë avlemendi me vija,
e motive me ngjyra të ndryshme, rrethuar me
thekë të shkurtër pambuku të kuq e të zi; pjesë
e veshjes së grave ortodokse të Myzeqesë (Rreth-
-Greth, Durrës);

2. Copë pëlhere e leshtë, me dy fletë, punuar
në avlemend dhe shumë e dekoruar; pjesë e ve-
shjes së gruas ortodokse të Shpatit (Elbasan).

Përparjë-a

Përparje e thjeshtë e bardhë, prej pëlhere
leshi, që mbanin gratë e reja myslimane në Mo-
kër (Pogradec).

Përparjë-ja

Përparje e thjeshtë prej pëlhere liri ose tjerri
(Karavasta, Lushnjë).

Pështerkë-a

Përparje prej pëlhere lesli të zezë, në veshjet
popullore të disa zonave të rrethit të Dibrës,
sidomos në fshatrat e Grykës së Vogël (Kacni);
thuhet edhe: «poshterkë».

Pështjellcë-a

Futë prej pëlhere avlemendi, me vija horizon-
tale të bardha (pambuk ose lesli) e të kuqe a
vishnje (lesli); e njëjtë si për gratë e për vajzat;
për plakat bardhë e zi; vihej prapa (Dragoç,
Postribë).

Përveshkë-a

Cibun apo xhokë e vjetëruar (Rehovë, Ko-
lonjë).

Pirpiri-a

Xhybe stofi të zi të importuar, me trup të
ngushtë e fund të gjerë, pa mëngë, e qëndisur
rëndë me fije ari; veshje festive për gratë e
reja (Gjirokastër, Libohovë, etj).

Pirpiri voskopojarçe

Pirpiri cohe e qëndisur rëndë me ar që pu-
rohej në Voskopojë ose sipas modeleve të vos-
kopojarëve. Gratë e Zagorisë (Gjirokastër) e vish-
nin këtë pirpiri në raste festash të mëdha, për-
mbi fustanin e tyre të gjatë me fund të gjerë
nga beli e poshtë.

Plahurë-a

Këmishë gruaje prej plëhere shtëpiake (Kër-
cisht, Dibër).

Plis-i

Qeleshe e bardhë e rrumbullakët, mbulesë ko-
ke për burra; kapuç (Kosovë); Plisi n'janin sy —
kapuç i vënë mënjanë, shenjë e djemve të rinj.
Plis Deve — plis i sjellë nga Deva, ose i pu-
nuar në Devë (Kosovë).

Plungë-a

Copë e leshtë katërkëndëshe, me toje të tra-
sha në të katër qoshet, që u shërbente grave për
të bartur sende në shpinë, (Junik, Kosovë).

Pllusha-t

Çorape lesli të shkurtra, për burra.

Podhiqe-ja

Përparje e leshtë për dimër, neçë; pjesë e
veshjes së gruas ortodokse, Karavasta (Lushnjë)
dhe Seman (Fier).

Podhja

Përparje lesli, me formë pothuaj katrore, pu-
nuar me vija të bardha e vishnjë në manusha-
qe, anëve me gajtan; është përdorur deri në
Luftën e Parë Botërore në kostumin popullor të
fshatrave Kakodhiq, Lefterohor, Kardhikaq, Pëcë,
Kostar, Muzinë.

2. Podhë-ja përdorej edhe tek arbëreshët e
Siqelisë (sipas Çabejt).

Pokoinë-a

Përparje, pjesë e veshjes së grave kelmendase të
Sremit, në shek XVIII (sipas Windisch, 1782).

Postat-i

Brez i gjërë në veshjen e grave kelmendase
të Sremit (sipas Windisch, 1782).

Poshterkë-a

1. Përparje prej pëlhere të leshtë avlemendi me
ngjyra e motive të ndryshme; pjesë e veshjes
së grave në Lumë (Kukës).

2. Përparje e leshtë e zezë krejt, pjesë e ve-
shjes së grave në Luzni (Dibër).

Potina-t

Këpucë luksi për gra, me pak takë (4-5 cm të
lartë) dhe me qafa, që bliheshin në treg. Në
disa zona të vendit që nga fundi i shekullit
XIX ato zëvendësuan opingat qorsele, në kostu-
min e martesës të nuseve të reja.

Poture-t

Pantallona burrash, prej shajaku, ose cohe, të
gjata deri në gju dhe mjaft të gjera, visheshin
së bashku me tirqit gjunjarë; janë mbajtur në
Shqipërinë Jugore, aty-këtu deri në prag të Çli-
rimit (1944).

Prapanik-u

1. Futë e vogël që vihej prapa nën xhubletë;
shih «bythcak». (Malësi e Madhe, rr. Shkodër);

2. Futë e vogël që vihej prapa mbi xhubletën
e ngushtë; kishte formë trapezi; pjesë e ve-
shjes së grave në Shllak e Temal (rr. Shkodër).

Pregaç-i

Përparje lesli njëngjyrëshe, që mbanin gratë
e martuara në Fushën e Korçës e në Devoll,
me kostumin me cibun, deri nga fillimi i she-
kullit XX.

Prehër-i

Përparje stofi të importuar, që vihej mbi fusta-
nin e gjatë, që mbanin gratë ortodokse në rre-
thin e Kolonjës.

Prëhrore-ja

Përparje, tek arbëreshët e Italisë (sipas Santorit).

Prçeja-t

Opinga të thjeshta lëkure e shumë të përdorura (Guci, Mali i Zi).

Prosop-i

Mbulesë koke për gratë ortodokse deri në çerekun e parë të shekullit tonë; bëhej me një rrip të gjerë pëlhere të bardhë pambuku, të rru-dhur, që mbështillej rreth kokës e pastaj kthehej vertikalisht duke kaluar nën mjekër e duke mbu-luar kështu edhe veshët (Korçë, Kolonjë etj.)

Prishja e bistekut

Një nga shenjat e jashtme të kalimit të vajzës në grupin e grave të martuara, në një pjesë të madhe të Kosovës; në shumë këngë popullore thuhet «m'at dit si t'u prish bysteku/t'la çiknija, l'la lezetë».

Prraka-t

Nallane, i përdornin gratë (Seman, Fier).

Pshillc-i

Veshje vajzash në formën e një fundi të ngushtë e të gjatë deri në gju (Rrugovë, Kosovë)

Pshtjellak-u

1. Futë leshi, përgjithësisht në formë trapezi, punuar në avlemend dhe zbukuruar me gajtan e rripa cohe; ai që vihej prapa ishte me për-masa të vogla (M. Madhe, Bregu i Drinit, Puka, e Shala, Shoshi, Toplana dhe Gucia); ai që vihej përpara ishte më i madh; pshtjellak i madh, pshtjellak i vogël;

2. Futë e vogël me dy fletë shumë të zbu-kuruara me motive të ndryshme, që vihej prapa, në kostumin e grave të Hasit (Kukës); kanac i dytë. Futa e përparme ishte më e madhe dhe quhej: kanac i parë.

3. Futë e leshtë, pjesë e veshjes së grave një vihet para e një tjetër mbrapa (Kosovë) (pshe-llak, pshallak, pshtellak).

Pshtjellak-u

Mbështjellëse e zezë, e leshtë, pjesë e veshjes së mirë të grave të Zadrimës; kotull.

Pshtjellak i gjanë

Mbështjellëse leshi, ngjyrë të kuqe ose vjollcë, në formën e një fundi të hapur dhe me pala; pjesë e veshjes së re të gruas në Malësinë e Gja-kovës (Tropojë) pothuaj e njëjtë me «kanacin» e Kabashit (Pukë).

Pshtjellcë-a

1. Përparje, pshtjellak (Obri, Dranicë) (shih edhe «Zavjaç»);

2. Futë e punuar në avlemend, që vihej prapa, në kostumin e gruas së Postribës (Shkodër).

Pshtjellcë-a

Mbështjellëse e leshtë e zezë (shih: kotull, pshstjellak) (Zadrimë).

Pshtjellc-i

Fund leshi ose liri për vajza (Junik, Kosovë).

Pshullak-u

Pshtjellak, futë; «ku shkon pshullaku, shkon gjaku» — Ferizaj Kosovë (sipas V. Dançeto-viq).

Pucir-i

Pancir, parzmore çeliku tek disa personazhe të epikës legjendare si Gjyre Harambashi, Krali i Miskovit etj., ku edhe shpatës së Mujit «i bëhet batall tehu».

Pushai-ja

Shami koke për gra (Sulovë).

Qaçka

Plaçka, rrobe

Qafetë-a

Jakë (Podgoricë, Mali i Zi)

Qafëshoke-kja

Shami e kuqe e zbukuruar me thekë që e vënë nusët në mes si brez, në disa vise të Shqipërisë së Veriut.

Qafore-ja

Gjoks këmishe, për gra; copë e vogël sa për të mbuluar gjoksin (Fand, Mirditë).

Qafore-ja

Qafa e çorapit.

Qafore-ja

Varëse qafe, stoli grash; anakë (arbëreshët e Italisë) (sipas F. Giordano).

Qashë-a

1. Shajak (Dibër, Mat); (Kërçovë, Maqedoni)

2. Xhokë shajaku të bardhë, me shtat të drejtë e tre-katër kinda të ngushtë në çdo anë, zbu-kuruar me gajtan të zi e të gjelbër (Dibër, Mat, Kurbin); nemte.

Qelepoçe-ja

Mbulesë koke prej pëlhere të bardhë, në formën e takijes myzeqare; ishte «e rrahur» me shumë tegela.

Qeleposhe-ja

Një feste e kuqe e zbukuruar me tufëza, te-mina, monedha etj., në veshjen e grave të Fierit.

Qeleposhe-ja

Mënyrë e posaçme e lidhjes së shamisë së kokës nga gratë e reja myslimane, për raste festash, në çerekun e parë të shek. XX (Opar, Korçë).

Qeleshe-ja

Kësulë e bardhë burrash, e punuar me lesh të krehur mirë, i cili lahej disa herë me sapun për të fituar kompaktësinë e duhur dhe së fundi vihej në kallëpë druri a qeramike për të marrë formën dhe madhësinë e dëshiruar, të rumbu-llakët, trung koni etj.; plis, sheshe, rrethatore etj.

Qelush

Fistan qelush, fustan, pa rrudha ose pala tek beli.

Qenarë-t

Vija së gjati pëlhurës, të cilat bëheshin që në endje të trëmbës, qoftë me fiye pambuku më të trashë se ajo e truallit, qoftë me fiye me ngjyrë.

Qesike-ja

Jelek shajaku të bardhë, i zbukuruar anëve me gajtan ngjyrë vishnjë; në pjesën e poshtme të saj vareshin thekë të gjatë leshi blu e vishnjë; pjesë e kostumit të grave myslimane në Mokrën e Poshtme.

Qorsele-të

Opinga luksi për gra, të bëra me lëkurë të kuqe, të qëndisura në faqen e sipërme dhe me xhuftka; janë mbajtur në shumë zona të Shqipërisë së Jugut, deri në Shpalljen e Pavarësisë (1912).

Qostek-u

Zbukurim gjoksi për burra, prej argjendi, i përbërë prej pafdash e zinxhirësh që kapeshin pas jelekut me gremça.

Qylaf-i

Kësulë e bardhë burrash, e leshtë, mjaft e lartë, me një thumb në majë; e mbante gjithë Labëria.

Qyrkë-a

Veshje prej gëzofi ose me gëzof tek arbëreshët e Italisë (sipas F. Giordano).

Qyrk me nafe

Veshje e sipërme e modës orientale, e veshur së brendshmi me gëzof.

Rekam-i rekam-i

Tërësia e stolive që mbante një grua e re; Stringlat.

Rashë-a

Këmishë ose fund këmishe, prej pëlhure a puplini që vishnin nën xhubletë gratë malësore të Kelmendit; raçë, ragjë, raxhë etj. (Tamarë, Shkodër; Rrilë, Bregu i Matës; Luzhë, Gash).

Raxhë-a

Fund pëlhure, fustë që vishnin nën këmishën e gjatë prej pëlhure të bardhë gratë e Krajës e të Shestanit (në Mal të Zi); bëhej prej pëlhure leshi shtëpiake (për dimër), por edhe prej faqelli të fabrikuar.

Reshme-ja

1. Një lloj jeleku i zbukuruar me pare të verdha metali, të cilin e mbanin dikur nusët e reja;
2. zbukurime metali, monedha argjendi, bakri etj., të kapura tek zinxhirët, që varnin në gjoks nusët e reja, që të tringëllonin kur nusja ishte në ecje; stringla.

Retër-tra

Dredhcë lëkure, jë përdorej për të qepur anash opingat e për të bërë vangjet.

Rgjane-t

Shih: stringla; stoli metalike.

Ride-ja

Mbulesë koke e pambuktë; e punuar në avlemend dhe e zbukuruar në skajet (Kurbini, rr. Krujë).

Rizë-a

1. Mbulesë koke për gra, e bërë prej një fletë pëlhure mëndafshi ose pambuku, me krrerët shumë të zbukuruar. (Zadrimë, rr. Shkodër), (Pejë, Kosovë);

2. Peshqir, mbulesë koke prej pëlhure shtëpiake të pambuktë e të bardhë (Kurdari, Mat).

Rizat e brezit

Dy riza që viheshin për bukuri tek brezi (Ljare-Shestan, Mali i Zi).

Rubë-a

1. Shami, mbulesë koke për gra e vajza, e bërë prej pëlhure shtëpiake të bardhë; për shenjë zije ngjyhej e zezë, (Shqipëria Veriperëndimore);

2. Napë e bardhë liri që e përdornin si mbulesë koke gratë kelmendase të Sremit (sipas Windisch 1782).

Rragë-a

Përparje prej pëlhure të trashë liri që vihej për të bërë punë të rëndomta.

Rrahstulë-a

Dërstilë, shkaltore

(i) rrakën

I tejdukshëm, sqep i rrakën, vel, i tejdukshëm (arbëreshët e Italisë) (sipas E. Giordano).

Regëzinë-a

Copa shajaku për të mbështjellë këmbët në vend të çorapeve, peca (Novosej, Kukës).

Rrethe-t

Opinga, të cilat e kishin faqen e sipërme të thurur me dredhca lëkure ose me spango.

Rrethatore-ja

1. Qeleshe e rrafshët.
2. Fund i leshtë për vajza (Drenicë, Kosovë); pshtjellc (Junik, Kosovë).

Rrethocë-a

Stravecë e shkurtër, përparje me thekë, (Mirditë).

Rëzhgjatë-a

Stoli qafe dhe gjoksi për gra (Vuthaj, Mali i Zi)

Rrip-i

Brez lëkure të regjur, i gjerë tre-katër gisht, për gra; ngjishej përmbi cibunin; është përdorur deri në fillim të shekullit tonë (Lavdar i Oparit Korçë).

Rroba të donatisura

Rroba shumë të stolisura, për dhëndëri.

Rrobet e beqarisë

Shih: petkat e beqarisë.

Rrobe Janine

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX rrobet e burrave të qepura e të qëndisura nga terzinjtë e Janinës ishin të dëgjuara për cilësinë e lartë të tyre dhe kërkoheshin shumë, sidomos për dhëndëri; këtu është fjala për kostumin me fustanellë.

Rrobik-u

Xhamadan, xipun (?) (tek arbëreshët e Italisë).

Rrogzina-t

Një lloj tirqish të shkurtër, prej shajaku, tirq cungj.

Rrudhak-u

Pshjtjellak i prapmë (Ferizaj, Kosovë)

Rryp-i

Rrip lëkure, në veshjen e gruas me xhubletë (Nikaj, Tropojë).

Saftjan-i

Lëkurë dhie ose deleje, e hollë, e butë e cila regjej, ngjyhej dhe lëmohej sa të shkëlqente.

Sajë-a

Pëlhurë e bardhë pambuku (Fulqet, Mat).

Sako-ua

Xhakete e shkurtër gruaje, me bel të theksuar, që bëhej prej kadifeje ngjyrë vjollce ose të kuqe a të gjelbër; pjesë e veshjes së grave aristokrate qytetare në Berat, Fier etj.

Sako Berati

Veshje gruaje në formën e një xhakete prej kadifeje Berati, ngjyrë vjollcë, vishnje ose të gjelbër, e tëra e qëndisur me ar, me motive e teknika pune karakteristike për Beratin.

Sako me nafe

Xhybe cohe të zezë, me gëzof (qengji) përbrenda dhe me lëkurë dhelpre te qafa e tek të dy anët përpara; në shekullin XVIII ishte ende veshja e burrave pasanikë, kurse nga fillimi i shekullit tonë është përdorur edhe si veshje grash, pasi kishin dalë nga përdorimi cibunet, bedenët etj., (Korçë).

Sako me sahat

Sako kadifeje ngjyrë vjollcë ose të gjelbër, e zbukuruar përpara me disa motive rrumbullake në madhësinë e një sahati xhepi, motivi i zakonshëm tek qëndistarët e mirënjohur të Beratit.

Sallman-i

Zbukurim koke i përdorur nga gratë katolike të Shkodrës, në kohën kur mbanin kostumin me brandavekë të zinj dhe xhybe cohe; bëhej me një copë mëndafshi të qëndisur me rruaza e tmina që kishte afërsisht formën e një gjarpëri, koka e të cilit vendosej në mes të ballit, ndërsa bishti i binte prapa kokës; sallmani lidhej me dy rripa prapa qafës dhe përmbi të vihej një shami.

Samaroskut-i

Pëlhurë e rrallë leshi të butë që përdorej për të bërë fanella leshi për të moshuarit dhe shpërgenj për fëmijët; e bërë prej leshi të zakonshëm përdorej edhe si astar për samarët etj.

Saraviliust. (i)

Prej kadifeje të mëndafshët (arbëreshët e Italisë) (sipas E. Giordano).

Salgi-a

Pëlhurë kërpi.

Silë-a

Rrip i gjerë brezi (Saxhak, Mat).

Silah-u

Brez, rrip lëkure për burra, me 3-4 fletë përpara që formonin xhepa ku futeshin armët e brezit; shumë i zbukuruar me qëndisje me fije ari në pjesën e përparme; pjesë e kostumit me fustanellë dhe atij me poture.

Simtel-i

Dërrasë që u vihej sipër rrobeve të leshta, për t'i mbajtur palë; mbi dërrasë vihej një gur i madh për t'i shtuar peshën.

Skarpina-t

Këpucë grash, me takë të gjerë e mjaft të hapura përsipër, fiksoheshin me një rrip që mbërthehej tek një kopsë.

Skiepë-a ose sqepë-a

Napë për të mbuluar kokën e përdornin gratë tek arbëreshët e Italisë; thuhet edhe «skiepëz» ose «sqepëz» (sipas dorëshkrimit të Kieutit 1737, de Radës 1866 etj.)

Skufje me pare

Një mbulesë koke prej pëlhure ose prej stofi, e puthitur mirë mbas koke, në të cilën vajzat qepnin, të renditura varg, monedhat e prikës së tyre, tek arbëreshët e Salaminës, (Greqi), në shekullin XIX.

Skunilica

Përparje leshi e bërë me një fletë pëlhure të ngushtë të vendosur së gjati, zbukuruar me thekë e tufëza përfundi; skuniliet janë mbajtur përpara neçave (Fusha e Pogradecit).

Skuni-a

Zbukurim koke për gra, i bërë me një copë të vogël kambriku në formë trekëndëshi, e mbuluar e gjitha me qëndisje të imëta, që lidhej mbi flokë me anë të dy rripave dhe vendosej rrëzë ballit, nënë liveren e kokës.

Skutë-a

Përparje e vogël katrore (25x25 cm) prej pëlhure të leshtë avlemendi, me vija horizontale bardhë e zi, zbukuruar anëve me thekë e tufa (Çermenikë-Librazhd).

Skutaçe-ja

Përparje, pjesë e veshjes së vajzave shqiptare në fshatrat e Tetovës (sipas këngëve popullore të dasmës).

Sokmali

Mënyrën e të ngriturit të gërshetave në pjesën e prasmë të kokës (Drenicë, Kosovë)

Spiga-t

Shuh stringla.

Sqep-i

Pëlhurë e hollë me të cilën arbëreshët e Italisë bënin shalle për në qafë (për burrat) ose mbulesa koke për gratë (sqepëz).

Stërveçë-a

Përparje e madhe, e bërë me dy fletë pëlhure të pambuktë, të punuar në avlemend; arrinte nga beli deri tek nyjat e këmbëve; punuar me vija e motive ngjyrash të ndryshme. Pjesë e kostumit të gruas katolike (Dërven, Fushë-Krujë).

Stiavuke-ja

Përparje, mësallë, pjesë e veshjes festive të grave arbëreshe të Italisë (sipas dorëshkrimit të Kieutit 1737).

Straveçë-a

Përparje e vogël me thekë të gjata në tri anë, pjesë e veshjes së grave të Mirditës dhe e atyre të fshatrave të Grykës së Vogël në rrethin e Dibrës.

Stravec-i

Përparje me thekë të gjata (Saxhak, Mat).

Stringla-t

Stoli të ndryshme qafe e gjoksi, vargje paresh, gjerdanë etj., që janë pjesë e pamungueshme e kostumit të martesës në shumë krahina të Shqipërisë, stringa, spiga, lila, rgjane etj.

Strokë-a

Xhamadan, xipun (tek arbëreshët e Italisë).

Strukë-a

Një lloj shalli i gjerë, për burra e për gra, në formë katërkëndëshi kënddrejtë, prej pëlhure të trashë e të bardhë leshi të dërstilur, që mbahej supëve në kohë të ftohtë, por mund të vihej edhe mbi kokë në raste reshjesh (Postribë, Shkodër, dhe Podujevë, Kosovë).

Strukë-a

Mbështjellëse, një lloj fundi i hapur, i bërë me dy fletë pëlhure të lehtë të kuqe, me vija të bardha e blu, me rrudha te beli; pjesë e veshjes së grave myslimane (Novosej, Kukës).

Sukulloj

Mbështjell kokën me lëvere në një mënyrë tradicionale (Prell, Mat).

Sumbull-a

Kopsa metalike të derdhura në forma të ndryshme, që u viheshin përpara jelekëve dhe mëngoreve për zbukurim. Sumbullat bëheshin edhe me gajtan mëndafshi ose tehri ari, nëpër të cilën përshkoheshin aty-këtu edhe rruaza të vogla.

Shage-ja

Mbështjellëse në formën e një fundi të hapur, mjaft të gjerë, me rrudha të dendura tek ijët; bëhej prej pëlhure të trashë liri ose pambuku; ojesë e veshjes së grave të zonës së Kallmetit (Lezhë).

Shajak-u

Pëlhurë leshi, e punuar në avlemend shtëpiak, me katër lisa dhe e dërstilur; përdorej për veshje të ndryshme fshatare, sidomos deri në prag të Luftës së Dytë Botërore.

Shaloke-t

Mbathje grash, të gjata deri në gju.

Shallvare-t

1. Një lloj pantallonash prej cohe, shumë të gjera nga beli deri në gju e të ngushta poshtë; veshje e tipit oriental; në epikën popullore të shekullit XIX, epitete për të stigmatizuar pushuesin osman; o halldup shallvaregjerë;

2. Në shekullin tonë kjo fjalë është përdorur shumë herë për të treguar brekushet e burrave të Shqipërisë së Mesme.

Shalli i kësulës

Shamia ose pëlhura që lidhej mbi kësulën ose kapuçin e burrave (Krajë, Mali i Zi).

Shamergë-a

Një lloj xhoke, që ngjan si e pluhurosur; në një baladë e mban të veshur Kostandini i ngritur nga varri, i cili ka marrë të motrën në vithe të kalit e po e sjell në shtëpi tek e ëma.

Shami koke

Copë pëlhure të fabrikuar, e pambuktë, e mëndafshë ose e lehtë, në formë katrore, me ngjyra e lule të ndryshme ose e thjeshtë; e palosur më dysh diagonalisht, përdorej si mbulesë koke në shumë zona të vendit. Shamikuqe, shami-verdhë ajo që mban shami të kuqe ose të verdhë; shamimurgë — ajo që mban shami të zezë, grua që kishte burrin në kurbet ose ishte e ve.

Shaminë për fyt

Mënyrë tradicionale e lidhjes së shamisë për vajzat e pamartuara, duke kryqëzuar nën mjekër, (në fyt) dy cepat anësorë.

Shapka-t

Sheshla, pandofla të thjeshta që mbahen nëpër shtëpi.

Shapkë-a

Mbulesë koke për burra, një lloj kësule me strehë përpara, kasketë. Shapkë frëngu — kasketë, kësulë e modës evropiane.

Shargan-i

Një lloj gune e bardhë me flokë përbrenda; veshje burri për stinën e ftohtë, në raste festash (Kurvelesh i Sipërm e Lopës, Vlorë).

Shargan-i

1. Xhokë për gra, prej shajaku të zi, pa mëngë. E vishnin gratë myslimane në Rrëzën e Gjirokas-trës, për dimër, me veshjen me çitjane;

2. Kjo lloj xhoke, e zezë ose e bardhë mbahej dikur nga gratë edhe në Malësinë e Vlorës.

Sharkë-a

Xhokë gruaje në disa vise të Labërisë, p.sh., në Vranisht (rr. Vlorë)

Sharkë-a

1. Veshje e sipërme leshi për burra; flokatë;

riron në të folmen e ishullit Poros në Greqi (sipas E. Çabejt).

2. Veshje dimri për burra (Polis i madh, rr. Librazhd).

Shark-u

Një lloj xhoke prej shajaku blu të errët, që mbanin gratë e Zagorisë (Gjirokastër). Zbukurohej anëve me gajtan blu e rrallë të kuq; vishej përmbi një fustan të gjatë.

Shegunjë-a

Veshje e sipërme grash, prej shajaku: «Me kmish mnashit e me kunra/grat e moçme me shegunja». (Ftjan, Krajë).

Shark-u

Bërruc, veshje e sipërme dimri për burra; ishte si pelerinë, (Kurvelesh i Sipërm e Lopës, Vlorë).

Sharkël-a

Pjesë e veshjes së gruas lunxhiote; bëhej prej shajaku dhe zbukurohej te beli, prapa me tufa të kuqe, bojë qielli etj.

Shegune-ja

Veshje e sipërme prej shajaku; cibun; e përdornin edhe arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano).

Sheshje-t

Pandofla të sheshta, që mbaheshin nëpër shtëpi, shapka.

Sheshe-shja

Qeleshe e ulët dhe e rrafshët, në dallim nga qelesha e rumbullakët; rrafshatake.

Shimis-izi

Pjesë e veshjes në Frasnitë (arbëreshët e Italisë) (sipas E. Giordano).

Shitë-a

Një lloj xhoke e bardhë shajaku, pa mëngë; e mbanin gratë e Dropullit (vishej përmbi dhiplarin).

Shive-t

Cullufet e flokëve të grave (Medvegje Kosovë)

Shkaltore-ja

Punishte për shkeljen e shajakut me forcën e ujit (Podrime, Kosovë); mullizhguni, dërshtë, valanicë.

Shkeka-t

Dy të çara përpara, të rrethuara me gajtan, që kanë tirqit; shtjeka shqeka; bëhen për të lehtësuar mbathjen e tirqve, që janë përgjithësisht të ngushtë te beli.

Shkurte-ja

1. Këmishë e shkurtër grash, që shoqërohej me një fund të veçantë këmishë (Bërzeshët, Librazhd).

2. Këmishë gruaje e gjatë deri në gju prej pëlhere të pambuktë, të punuar në avlemend; kishte shtat të drejtë me dy kinda në çdo anë, mëngë të drejta, pa jakë por me një rrip të ngushtë rreth qafës; zbukurohej te gjoksi me penj me ngjyra;

në fillim të shekullit tonë, në fshatrat e Skraparit ajo zëvendësoi «linjën» prej pëlhere, që mbahet më përpara (Gjerbës, Skrapar).

3. Këmishë e shkurtër pëlhere, për gra e për burra (Mat).

4. Këmishë burri (Skrapar dhe fshatrat e Vakëfeve, Korçë).

Shkurtellë-a

Një lloj palltoje e shkurtër prej cohe të zezë, e zbukuroar te qafa e anëve përpara me gëzof (Fier). Shih: sako me nafe.

Shokë-a

Brez lesi, në veshjen e gruas me xhubletë (Nikaj, Tropojë).

Shokë-a

Brez lesi i gjërë, për burra, i punuar në avlemend dhe i gjatë dy-tre metra, sa të silltet disa herë rreth trupit (Kosovë). Shokë me tire (Karadaku i Gjilanit, Kosovë).

Shokë me lara

Brez lesi për burra (Prizren, Kosovë).

Shokë me vija

Brez lesi për burra; i zbukuroar me vija ngjyrash të ndryshme. (Prizren, Kosovë).

Shokëzë-a

Brez fare i ngushtë, lidhëz; pjesë e veshjes së grave (Ana e malit, Shkodër).

Shollë-at

1. Opinga, këpucë fshatarësh.
2. Meste apo shputa me lesh dhie (Kaçanik, Kosovë).

Shollëz-a

Shputë, çorap i shkurtër (Tuhin, Kërçovë, Maqedoni)

Shorte-ja

Këmishë e shkurtër gruaje prej pëlhere të hollë mëndafshi të punuar në avlemend; pjesë e veshjes qytetare me dimitë, për raste festash (Gjakovë, Kosovë).

Shpatore-ja

Përparje pëlhere të leshtë, me sa duket e bërë me një shpat (një fletë); pjesë e veshjes së grave në Polis të Madh deri rreth vitit 1920 (Librazhd).

Shpellak-u

Futë a përparje (Rugovë, Kosovë); shih: pshellak

Shqënd-i

Petk, tek arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano).

Shtatëz-t

Këmishë e shkurtër prej pëlhere (Seman, Fier).

Shubare-ja

Një lloj kësule për burra, mjaft e lartë, që bëhej me lëkurë qengji; shushë.

Shytarkë-a

Lloj pushke pa kaçik (Istog, Kosovë).

Taban-i

Gunë bariu, tek arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano).

Takije-ja

Mbulesë koke për burra, e bërë prej pël-hure të bardhë, nga vetë gratë fshatare; mund të ishte me majë ose disi rrafshatake; e mbante e gjithë Myzeqeja dhe disa zona kufitare me të;

2. Një lloj kësule në formën e një qelesheje shumë të rrafshët, e bërë prej pël-hure të thjeshtë me astar, e mbushur me lesh dhe e thurur me tegela; e kanë mbajtur deri në fillim të shekullit XX shkodranët dhe mirditorët.

Tallagan-i

Një gunë e lehtë burrash, e shkurtër mbi gjunjë, prej leshi dhie në ngjyrë natyrore, me mëngë të varura prapa. «Ia la në tallagan» e mashtroi (Fjalë e urtë popullore).

Tapina-t

Sheshje, pandofla të sheshta për në shtëpi, tek arbëreshët e Italisë (Frasnitë) (sipas E. Giordano).

Tarçuk-u

Çantë prej lëkure dhie; e përdorin më tepër barinjët për të mbajtur bukën me vete.

Tarka-çi

Trastë lëkure ku barinjët mbanin bukën e ditës; targaç-i, tragaxhik.

Tarogzë-a

Parzmore, pllakë me fletë metali që përdorej për të mbrojtur kraharorin.

Tarrallëk-u

Lloj kësule e bërë me fije leshi e kërrabëza (Rrugovë, Kosovë)

Tasfes-i

Kësulë e rrafshët cohe të kuqe e zbukuruar me pare, rruaza, temina etj., e përgatitur posaçërisht për nusët e reja (Kosovë).

Tashket-i

Një lloj kësule për burra tek arbëreshët e Italisë, (sipas Bilotës) (shih E. Giordano).

Tatuazh-i

Figura të vogla të bëra në duart e vajzave të vogla ortodokse, duke gërvishtur lëkurën me gjilpërë sipas formës së dëshiruar dhe duke hedhur pastaj barot në vendin e gjakosur (Misras dhe Lavdar, Opar).

Tavolone

Përparje e madhe e pambuktë, bëhej me dy fletë pël-hure shtëpiake me ngjyra; pjesë e veshjes së grave të Myzeqesë.

Tavzë-a

Qafa e qëndisur e këmishës së grave (Mat).

Tehri-a

Dy fije ari ose mëndafshi të dredhura së bashku që përdoreshin për të qëndisur shumë

pjesë veshjesh si për gra e për burra: tehrinë e përgatisnin kazazët.

Tela-t

Zbukurim koke për nusët ditën e martesës, fije të holla e të gjata metali të bardhë e të ndritshëm, që viheshin tek flokët; përmenden që në mesin e shekullit XIX (sipas Hahn-it 1854).

Telatin-i

Lëkurë viçi e regjur mirë, e butë dhe e shkëlqyer, që përdorej për të bërë opinga dhe këpucë luksi.

Terelegë-a

Lloj pushke e gjatë, e vjetër (Strugë, Maqedoni)

Tereqe-ja

Një lloj manteli prej kadifeje, për burra (sipas E. Giordano).

Terlik-u

Një lloj manteli i gjerë prej cohe të zezë, që nuk vishej por hidhej mbi krye; gratë muslimane të qyteteve nuk delnin në rrugë pa hedhur terlikun mbi kokë (Kosovë).

Teshat e beqarisë

Shih: -petkat e beqarisë.

Teshat e burrnis

Rrobet që vishte ditën që martohej djali, i cili me këtë rast hiqte rrobat e beqarisë ose të çobanisë.

Teshat e çiknisë

Rrobat që kishte mbajtur vajza para martesës të cilat nuk mund t'i vishte më mbas martesë; në këngët popullore thuhet se vajzës ia heqin me zor teshat e çiknisë dhe se ajo qan e mallëngjyer kur ia heqin; veshja e çiknisë.

Teshat e çobanisë

Rrobet e djalërisë, veshja e djalit deri ditën që martohej, kur e linte përfundimisht, për të veshur «teshat e burrnis».

Teshat maxharisht

Në epikën heroike legjendare, disa nga heronjtë kryesorë, në rrethana të caktuara, detyrohen të vishen tepdil, për të mos rënë në sy të kundërshtarëve e për të vepruar më lirish. Kështu djali i Mujës, Ymeri i ri, kur nisët të kërkojë të atin e burgosur në Krajli, veshën «teshat maxharisht» pra, sipas modës hungareze, flokët e tij të gjatë i thur në dy bystekë (gëresheta), që i var njerin përpara e tjetrin prapa, var në gjoks një kryq ari etj.; po kështu vesh «teshat maxharisht» edhe Sokol Halili, kur shkon të grabitë vajzën e Kralit të Talirit, etj.

Tesha t'mejdanit

Pajisjet e një luftëtari (të Mujit) për të dalë në fushën e dyluftimit, sipas vargjeve të epikës legjendare. (Kënga: Muja lufton me shtatë kralat-Gollak, Kosovë).

Teshat shqiptarisht

Në epikën tonë heroike legjendare ka personazhe të palës kundërshtarë, të cilët për të

kryer më lehtë gjestet e tyre në mjedise shqiptare, bëhen tepdil duke veshur «teshat shqiptarisht», p.sh., Gjyre Bylykbashi para se të shkojë në Jutbinë, hyn në një rrobaqepsi (terzihane) për t'u kamufluuar me «teshat shqiptarisht».

Tëmthore-t

Stoli metali, që gratë i kapnin tek mbulesa e kokës në mënyrë të tillë që t'u vareshin tek tëmthtat.

Të paana-t

Brekë, të mbathura, mbathje, (Ljare, Krajë)

Tërçllak-u

Kapuç i cekët prej bezeje (Drenicë Kosovë)

Tierq-it

Kështu thirren tirqit në disa vise të Kosovës si Drenicë, Llap, Preshevë etj.

Tiagëlla-t

Zbukurime të ndryshme metalike që vinin gratë fshatare në qafë e në gjoks, në veshjen festive; stringla.

Tire-t

Çorape të gjata prej pambuku të bardhë që i mbanin gratë.

Tire-ja

Fije e hollë pambuku, me të cilën endeshin pëlhura për këmbishë, ose thurreshin çorape.

Tire-ja

Mbulesë koke për gra prej pëlhure të pambukitë të punuar në avlemend.

Tirk-u

Qafa çorapësh të gjata deri në gju tek arreshët e Italisë (në Piana degli Albanesi) e ata të Greqisë (në ishullin Poros e në Salaminë).

Tirq-it

Pantallona burrash prej shajaku të bardhë e ndonjëherë të murmë ose të zi, në pjesën e poshtme të puthitur fort mbas këmbëve, me shtrat të shkurtër dhe me dy shqeka përpara; zbukuruar me gajtan të zi ose të bardhë, kurse tek arbëreshët e Greqisë me gajtan bojë tulle; çakshire, xhedikë etj;

2. Në Nahijen e Beratit, tirqit janë fare të shkurtër dhe mbulojnë këmbët nga nyjat deri tek gjuri.

Tirqe-t

1. Një lloj qafe çorapësh prej lesi (pa shpu-të); kallçina (Dumre); qafa çorapësh nga nyja tek gjuri (Çermenikë);

2. qafa çorapësh lesi për gra, krejt të bardha; shoqëroheshin me çorape të shkurtra (Pishkash e Bërzesh të, Librazhd).

Tirq gargi

Tirq të zbukuruar jo me gajtanë drejt por dredha-dredha.

Tirq gjunjarë

Tirq fare të shkurtër prej shajaku të bardhë që mbulojnë këmbët nga nyjet tek gjunjtë, të

cilët visheshin së bashku me poturet (Kurvesh i Sipërm e Lopës, Vlorë); toslukë, tirq cungj.

Tirtir-i

Fije e dredhur ari ose argjendi, që përdorej për qëndisje.

Tizgë-a

Rrip jo shumë i gjerë, zakonisht prej lesi, që përdorej për të lidhur kallcet, tirqit, çorapet etj.

Tlina-t

Brekë pëlhure, të mbathura (Saxhak, Mat).

Toje-t

Gjalma lesi që shërbejnë për të lidhur çorapet pas këmbës, por jo opingat (Drenicë, Kosovë).

Toja e opangës

Gjalm prej lesi me të cilin lidhen opingat (Gollak, Kosovë); në Drenicë quhet: mathcë.

Tokë-a, ose toká-ja

Shih follë.

Tokëz-a

Pjesa metalike e qepur në skaj të një rripi, që shërben për t'i mbërthyer anët e tij.

Tollumba-t

Opinga a këpucë llastiku të sheshta.

Tonuz-i

Lloj qylahu i gjatë, feste tonuze, nga emri turqisht i qytetit të Tunizit.

Toska

Fustanellë, veshje burrash në disa vise të Maqedonisë.

Tosllukë-t

Kallçinj prej cohe të qëndisur me gajtan ari ose mëndafshi; kallçinj prej lëkure.

Trastëzë armakoll

Trastë e vogël e varur krahaqafë, tek arbëreshët e Italisë (Dorëshkrimi i Kieutit 1737).

Trik-u

Tirk, zhgun. (Shala e Bajgorës, Kosovë).

Tuqil-i

Copë e vogël pëlhure të bardhë që gratë arbëreshe vënë përpara tek gjoksi, për të zvogëluar disi pjesën e hapur përpara të këmbishës së tyre (Frasnitë) (sipas E. Giordano).

Thaliqe-t

Opinga apo këpucë të thjeshta tek arbëreshët e Italisë (sipas E. Giordano).

Thekë-t

Tufat e penjve, që varen në skaj të një veshjeje për ta zbukuruar atë, si: thekët e përparjes, thekët e xhokës tek supet, etj.

Thurak-u

Këmishë e gjatë e thurur si rrjetë, me rripa a me fije të trasha prej metali, që e vishnin luftëtarët në kohë të vjetra për t'u mbrojtur nga armët e ftohta; parzmore e thurur.

Urjez

Mënyrë të qepuri tek këmishët prej pëlhure të grave të Mokrës (Pogradec).

Uvje-a

Buza e një pëlhure a e një stofi.

Vangu i opangës

Iliq i lëkurtë anës buzëve të opingës, në të cilat kalohen gjalmat e leshta «me ia gjetë vangun» me ia gjetë vendin e duhur.

Vargare-ja

Varg me monedha ari që varte nusja e re në qafë; stoli për gratë e reja.

Vesha e çeknisë

Shih: teshat e çiknisë.

Veshja e Imerit të ri

Kur Imeri i ri, i biri i Mujës, niset për të liruuar nga burgu Mujin e Halilin, e ëma i jep të veshë këto teshat; çakshirt bojgjake, jelekun e Halilit, çizme e kollçin e kapuç të kuq në kokë (sipas vargjeve të këngës Imeri i ri).

Veshja e Mujës

Sipas një kënge të epikës legjendare veshja e Mujit ishte kjo: këmishë e tllina, mitan e libade, çakshirë bojgjake dhe kallçinj e çizme. (Kënga Dizdar Osman Aga e tradhton Mujën).

Veshatore-ja

Grua e specializuar për të veshur nusen ditën e martesës (Drenicë, Kosovë).

Vidella-t

Lloje këpucësh për gra, me lëkurë kafe të çelët, që i përdornin edhe gratë fshatare me rastin e martesës.

Vijama-t

Çorape grash malsore (Rugovë, Kosovë)

Vilare-ja

Pjesë e veshjes së vjetër të gruas së Malësisë së Vlorës.

Villar-i

Rrip i gjatë pëlhure; një villar pëlhurë, vilazë.

Vramull-a

Tojet e plungës, që lidhen përpara në krahëror, ndërsa pjesa që rri prapa me plaçka quhet ngarkojsë (Vrellë, Istog, Kosovë).

Vrazha-t

Gajtanët e zinj të tirqve (Tuhin, Kërçovë, Maqedoni)

Xipon-i ose Xipun

Një lloj mëngoreje a mintan i shkurtër, prej mëndafshi, që mbanin, gratë arbëreshe të Italisë; rrobik, strokë.

Xollufe-t

Shih: cullufe.

Xhamadan-i

Veshje e sipërme prej shajaku, cohe, etj., për burra dhe gra, e hapur përpara me pëqinjtë që kryqëzohen ose jo, me ose pa mëngë i zburkuar me gajtan ose fije ari.

Xhanfes-i

Pëlhurë e mëndafshtë shumë e shkëlqyer, që rri si e ngrirë, tafta.

Xhebadon-i

Xhamadan.

Xhakë-a

Trastë e vogël e grave të Malësisë së Madhe, e punuar me të njëjtën teknikë si xhubleta dhe e stolisur me motive të të njëjtit repertor. (Tamarë, Malësi e Madhe — Shkodër).

Xhedikë-t

1. Kështu quheshin poturet në Myzeqenë e Fierit;

2. Në Krujë e në Dibër xhedikë quheshin tirqet e bardhë të stolisur me gajtan të zi;

3. Tirq të ngushtë shajaku të zi (në Myzeqenë e Beratit, në Nahije e në zonën e Shpiragut, (rr. Berat).

Xhëtar-i

Xhokë (Kurdari, Mat)

Xhëngerima-t

Shih stringla

Xhokë-a

Pjesë e veshjes së gruas me xhubletë, që ka dalë nga përdorimi në vitet '30; të shekullit tonë; shih: krahol.

Xhokë e bardhë

Një lloj cibuni prej shajaku të bardhë, që përdorej për nusëri e pastaj vetëm në ditë kremtesh me rëndësi (Myzeqe e Fierit).

Xhokë-a

Krahol, prej shajaku të fortë, pjesë e veshjes me xhubletë (Ftjan, Krajë; Kosovë).

Xhokë-a

Veshje e sipërme, e hapur përpara, prej shajaku të bardhë, ose të zi, e gjatë deri nën bel ose deri mbi gjunjë; mund të ishte pa mëngë, me mëngë të shkurtra ose me mëngë të gjata. Njihen shumë emra lokalë për këtë pjesë të veshjes, si xhup, pec, nemte, cibun, dollamë, etj.

Xhubletë-a

1. Këmishë gruaje prej pëlhure të rrallë, të leshtë (Mat).

